

Aneksi 1/1

Raportti i

Zonave Funktionale

PASQYRA E LENDES

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE 5

HYRJE	5
PROCESI I PËRGATITJES SË RAPORTIT	6
<i>Faza e analizës</i>	6
ZONAT FUNKSIONALE TË PROPOZUARA – 5 VARIANTET	13
<i>Varianti me 30 Zona Funksionale</i>	13
<i>Varianti me 39 Zona Funksionale</i>	14
<i>Varianti me 47 Zona Funksionale</i>	15
<i>Varianti me 57 Zona Funksionale</i>	16
<i>Varianti me 63 Zona Funksionale</i>	17
<i>Varianti me 61 Zona Funksionale</i>	18

QARKU BERAT 19

PROFILI I QARKUT BERAT	20
PROPOZIMI I ZONAVE FUNKSIONALE NË QARKUN E BERATIT	21
<i>Zona funksionale Berat</i>	22
<i>Përfundime</i>	33
<i>Zona funksionale Ura-Vajgurore</i>	34
<i>Përfundime</i>	34
<i>Zona funksionale Kuçovë</i>	35
<i>Përfundime</i>	43
<i>Zona funksionale Skrapar</i>	44
<i>Përfundime</i>	51
<i>Zona Funksionale Poliçan</i>	53
<i>Përfundime</i>	53

QARKU DIBËR 54

PROFILI I QARKUT DIBËR	55
ZONA FUNKSIONALE DIBËR	74
<i>Përfundime</i>	79
<i>Zona funksionale e rrethit Bulqizë</i>	80
<i>Përfundime</i>	85
<i>Zona funksionale e rrethit Mat</i>	86
<i>Zona funksionale e rrethit Bulqizë</i>	99
<i>Zona funksionale Mat</i>	103
<i>Përfundime</i>	107

QARKU DURRËS..... 109

PROFILI I QARKUT DURRËS.....	110
PROPOZIMI I ZONAVE FUNKSIONALE NË QARKUN DURRËS	118
<i>Zona funksionale Durrës</i>	119
<i>Përfundime</i>	129
<i>Zona funksionale Shijak</i>	130
<i>Përfundime</i>	138
<i>Zona funksionale Krujë</i>	140
<i>Përfundime</i>	149

QARKU ELBASAN 151

PROFILI I QARKUT ELBASAN	152
PROPOZIMI I ZONAVE FUNKSIONALE NË QARKUN ELBASAN	154
PROPOZIMI I ZONAVE FUNKSIONALE NË QARKUN ELBASAN	160
<i>Zona funksionale Elbasan</i>	161
<i>Përfundime</i>	172

<i>Zona funksionale Cërrik</i>	173
<i>Përfundime</i>	179
<i>Zona funksionale Peqin</i>	181
<i>Përfundime</i>	186
<i>Zona funksionale Gramsh</i>	187
<i>Përfundime</i>	192
<i>Zona funksionale Librazhd</i>	193
<i>Përfundime</i>	198
QARKU FIER.....	200
PROFILI I QARKUT FIER.....	201
PROPOZIMI I ZONAVE FUNKSIONALE NË QARKUN FIER	203
<i>Zona funksionale Fier</i>	208
<i>Përfundime</i>	227
<i>Zona funksionale Lushnjë</i>	228
<i>Përfundime</i>	242
<i>Zona funksionale Patos</i>	243
<i>Përfundime</i>	254
<i>Zona funksionale Divjakë</i>	256
<i>Përfundime</i>	267
<i>Zona funksionale Mallakastër</i>	268
<i>Zhvillimi ekonomik dhe të dhënat ekonomike financiare</i>	268
<i>Përfundime</i>	280
QARKU GJIROKASTËR.....	281
PROFILI I QARKUT TË GJIROKASTRËS	282
<i>Zona funksionale Gjirokastër</i>	287
<i>Përfundime</i>	299
<i>Zona funksionale Përmet</i>	301
<i>Përfundime</i>	312
<i>Zona funksionale Tepelenë</i>	314
<i>Përfundime</i>	326
QARKU KORÇË	328
PROFILI I QARKUT KORÇË.....	329
PROPOZIMI PËR NDARJEN E ZONAVE FUNKSIONALE NË QARKUN E KORÇËS	330
<i>Zona funksionale Korçë</i>	332
<i>Përfundime</i>	344
<i>Zona funksionale Pogradec</i>	346
<i>Përfundime</i>	354
<i>Zona funksionale Maliq</i>	355
<i>Përfundime</i>	362
<i>Zona funksionale Pustec</i>	363
<i>Përfundime</i>	365
<i>Zona funksionale Kolonjë</i>	366
<i>Përfundime</i>	376
<i>Zona funksionale Devoll</i>	377
<i>Përfundime</i>	385
QARKU KUKËS	386
PROFILI I QARKUT KUKËS	387
PROPOZIMI I ZONAVE FUNKSIONALE NË QARKUN E KUKËSIT	394
<i>Zona funksionale Kukës</i>	394
<i>Përfundime</i>	406
<i>Zona funksionale Tropojë</i>	407
<i>Përfundime</i>	416

<i>Zona funksionale Has</i>	417
<i>Përfundime</i>	426
QARKU LEZHË	427
PROFILI I QARKUT LEZHË	428
<i>Ndërveprimi institucional në qarkun e Lezhës</i>	429
<i>Ndërveprimi ekonomik ndërmjet njërive vendore të qarkut Lezhë</i>	430
PROPOZIMI I ZONAVE FUNKSIONALE NË QARKUN E LEZHËS	437
<i>Zona funksionale Lezhë</i>	439
<i>Përfundime</i>	451
ZONA FUNKSIONALE E MIRDITËS.....	452
<i>Përfundime</i>	461
ZONA FUNKSIONALE KURBIN.....	462
<i>Përfundime</i>	469
QARKU SHKODËR	470
PROFILI I QARKUT SHKODËR.....	471
PROPOZIMI I ZONAVE FUNKSIONALE NË QARKUN SHKODËR	477
<i>Zona funksionale Shkodër</i>	478
<i>Përfundime</i>	488
<i>Zona funksionale Vau i Dejës</i>	489
<i>Përfundime</i>	498
<i>Zona funksionale Malësi e Madhe</i>	499
<i>Përfundime</i>	511
<i>Zona funksionale Pukë</i>	512
<i>Përfundime</i>	524
QARKU TIRANË	526
PROFILI I QARKUT TIRANË.....	527
PROPOZIMI I ZONAVE FUNKSIONALE NË QARKUN TIRANË	529
<i>Zona funksionale Tiranë</i>	535
<i>Përfundime</i>	547
<i>Zona funksionale Kamëz</i>	548
<i>Zona funksionale Vorë</i>	553
<i>Zona funksionale Kavajë</i>	558
<i>Përfundime</i>	564
<i>Zona funksionale Rrogozhinë</i>	565
<i>Përfundime</i>	570
QARKU VLORË	571
PROFILI I QARKUT VLORË	572
PROPOZIMI I ZONAVE FUNKSIONALE NË QARKUN E VLORËS	581
<i>Zona Funksionale Vlorë</i>	586
<i>Përfundime</i>	599
<i>Zona Funksionale Himarë</i>	600
<i>Përfundime</i>	608
<i>Zona Funksionale Sarandë</i>	609
<i>Përfundime</i>	617
<i>Zona Funksionale Delvinë</i>	619
<i>Përfundime</i>	627
<i>Zona Funksionale Livadhjë</i>	628

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Hyrje

Ky raport jep një paraqitje përmblendhëse të opsioneve për ndarjen territoriale në përputhje me metodologjinë e hartuar sipas kriterëve të miratuara nga Komisioni Parlamentar për Reformën Territoriale. Raporti është ndarë në 12 kapituj të veçantë, sipas të dymbëdhjetë qarqeve ekzistuese. Në secilin prej kapitujve është paraqitur gjendja aktuale për qarqet, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ekonomisë, llojit dhe nivelit të infrastrukturës dhe shërbimeve ekzistuese në secilin prej qarqeve dhe shtrirjes së tyre. Secili kapitull bën propozime specifike për ndarjen e re territoriale, sipas konceptit të zonave funksionale që kanë shërbyer si bazë për përgatitjen e 5 varinateve të ndarjes së re administrativo-territoriale. Raporti u përgatit nga grupi i ekspertëve të projektit STAR që mbështetet financiarisht nga qeveritë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Suedisë, Zvicrës, Italisë dhe PNUD-it.

Procesi i përgatitjes së raportit

Raporti u përgatit duke u bazuar në fazat e mëposhtme:



Faza e analizës

Grupi i ekspertëve dhe sekretariati teknik i reformës punuan bazuar në një metodë të kombinuar të analizës të kuadrit ligjor dhe dokumenteve/raporteve zyrtare. Të dhënat në lidhje me popullsinë në këtë raport janë marrë nga Regjistrimi i popullsisë i vitit 2011 (INSTAT, Census 2011). INSTAT është gjithashtu burimi për të dhënat për shpërndarjen e bizneseve. Të dhënat financiare janë siguruar nga Drejtoria e Buxhetit/ Ministria e Financave. Të dhënat financiare të përdorura në raport i përkasin vitit 2012, si viti i fundit për të cilin kishte të dhëna të disponueshme në kohën e realizimit të këtij raporti; përveçse nëse është specifikuar ndryshe.

Gjithashtu grupi i ekspertëve analizoi gjithë dokumentet dhe studimet mbi çështjen e reformës administrative-territoriale në Shqipëri.

Aplikimi i kriterëve dhe metodologjisë së zonës funksionale

Bazuar në raportin e analizës së detajuar si më sipër, faza e mëtejshme që u ndoq nga grupi i ekspertëve, sekretariati teknik dhe kordinatorët teknikë rajonalë ishte aplikimi i metodologjisë së zonave funksionale dhe kriteret e përcaktuar nga komisioni për të arritur në identifikimin e zonave funksionale për çdo qark. Gjetjet paraprake u formësuan në propozimin e një harte të zonave funksionale në 12 Qarqet e vendit.

Gjetjet paraprake u krahasuan dhe u ballafaquan me rezultatet e raportit të përgatitur mbi “zonat funksionale” nga programi zviceran DLDP si dhe me raportin e hartuar nga organizata “ShtetiWeb” për ndarjen e re administrative-territoriale.

Konsultimi i raportit paraprak

Gjetjet e raportit paraprak më tej ju nënshtruan ballafaqimit me 12 grupet rajonale të punës dhe me përfaqësues të qeverisjes vendore. Inputet dhe sugjerimet të dala nga ky proces u reflektuan në raportin përfundimtar të “zonave funksionale” në Shqipëri që formësuan një hartë të ndarjes së re administrative-territoriale me 5 variante paraprake me ndarjen me 30, 39, 47, 57 dhe 63 njësi të qeverisjes vendore.

Prezantimi i zonave funksionale dhe hartës së re administrative-territoriale me 5 variante

Bazuar në raportin përfundimtar të ekspertëve mbi zonat funksionale, Ministri për Çështjet Vendore prezantoi përpara Komisionit të Posaçëm Parlamentar, raportin dhe propozimin për ndarjen e re administrativo-territoriale me 5 variante.

Kriteret teknike të miratuara

Kriteret e miratuara nga Komisioni i Posaçëm Parlamentar shërbyen si udhërrëfyese i punës së grupit të ekspertëve në hartimin e raportit. Kriteret teknike paraqiten si më poshtë:

Kriteret

Niveli bazë i qeverisjes vendore: Bashkitë dhe komunat

1. Procesi i ndarjes administrativo-territoriale do të fillojë nga "rrethet", si njësi bazë e qeverisjes vendore, sipas përcaktimit të ligjit Nr. 8653 dt.31.07.2000 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë".
2. Njësi të reja bazë të qeverisjes vendore mund të krijohen brenda kufijve të rrethit, ose nga territore të dy ose më shumë rretheve, nëse plotësohen kriteret e mëposhtme:
 - a. Njësia e re e krijuar është një **zonë funksionale** më vehte. Me "*Zonë funksionale*" nënkuptohet një hapësirë territoriale ku ka një ndërveprim të dendur dhe të shpeshtë mes banorëve dhe institucioneve për qëllime ekonomike, sociale, zhvillimore dhe kulturore. **Zona funksionale** është e organizuar **rreth një qendre urbane** që ka numrin më të lartë të popullsisë, krahasuar me qendrat e tjera brenda zonës dhe ka mundësi për ofrimin e gamës së plotë të shërbimeve publike që duhet të ofrojë një njësi vendore.
 - b. **Distanca e territorit** me qendrën e njësisë mundëson ofrimin e gamës së plotë të shërbimeve për banorët e saj.
 - c. Njësia e re e krijuar respekton parimin e **vazhdimësisë territoriale**. Me "*vazhdimësi territoriale*" nënkuptohet që territori i një njësie të qeverisjes vendore është i vazhdueshëm dhe nuk ka "ishuj" territorialë që i përkasin një njësie tjetër vendore.
 - d. Duhet të ketë një **numër të konsiderueshëm banorësh**, mbështetur edhe në karakteristikat gjeografike të zonës. Me numër të konsiderueshëm banorësh konsiderohet një popullsi mesatarisht **mbi 30.000 banorë**.
 - e. Ka një **traditë historike** dhe karakterizohet nga lidhje tradicionale mes banorëve të gjithë territoreve përbërës;
 - f. Si rregull, kufijtë e komunave që bashkohen me njësitë e reja nuk do ndahen, por bashkohen si një e tërë me njësinë e re.
3. Në përjashtim nga kriteret e mësipërme dhe **si kriter i veçantë përjashtues** mund të shqyrtohen rastet që marrin në konsideratë praktikën më të mira ndërkombëtare për mbrojtjen e **minoriteteve etnike**, aty ku këto minoritete vendosin shumicën e popullsisë së NJQV-ve ekzistuese.

Ndarja administrativo-territoriale të njësive të nivelit të dytë të qeverisjes vendore

Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore, bazuar në konsultimet me të gjithë grupet e interesit dhe grupin ekspertëve i propozon Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Administrativo-Territoriale, ndarjen e re administrativo-territoriale të Qarqeve si nivel i dytë i qeverisjes vendore, brenda afateve të përcaktuara nga Komisioni.

Metodologjia e dhe aplikimi i zonës funksionale

Koncepti i zonës funksionale përdoret për të përkufizuar një hapësirë ku ndërveprimet ndërmjet banorëve dhe bashkëpunimi ndërmjet enteve qeveritare janë të shpeshta dhe të dendura. Në themel të këtij koncepti vendoset qytetari dhe nevojat e tij për shkëmbime të vazhdueshme në territor, të cilat tipikisht i tejkalojnë kufijtë aktualë administrativë. Ndërveprimet e qytetarëve me administratën shtetërore, qendrat e biznesit dhe të punësimit, qendrat e ofrimit të shërbimeve, arsimit dhe shëndetësisë, artit e kulturës. Kriteret e përcaktuara janë përdorur për të kryer analizën e shkëmbimeve brenda çdo qarku, duke nxjerrë në pah polet kryesore që mbështesin zhvillimin në secilën zonë. Zonat funksionale ndërtohen mbi **strukturën ekonomike dhe sociale të territorit dhe** identifikohen kryesisht nëpërmjet lëvizjeve për punësim, potencialit ekonomik dhe zinxhirit të vlerës (përqendrimi i bizneseve); ofertës së shërbimeve dhe rrjetit të infrastrukturës fizike. Qendrat e zonave funksionale kanë popullsi dhe dendësi më të madhe; janë destinacione të udhëtimit për qëllim pune dhe kanë përqendrim biznesesh e shumëllojshmëri aktivitësh.

Raporti i mëposhtëm vrojton ndikimet e pritshme të riorganizimit territorial në zonat funksionale të propozuara, sipas kriterëve të mëposhtëm:

1. Funksionaliteti, i identifikuar mbi bazën e strukturës ekonomike dhe sociale të zonave, në veçanti ndërveprimet ekonomik (punësimi, përqendrimi i bizneseve sipas sektorëve ekonomikë dhe potencialet e zhvillimit); ndërveprimet institucionale (përqendrimi i institucioneve shtetërore/qendrave të shërbimit) dhe ndërveprimet social (infrastruktura arsimore/kulturore/sociale).

Funksionaliteti, i vrojtuar në prizmin e ndërveprimet dhe analizimit të vektorëve të ndërveprimeve ekonomike, sociale, zhvillimore dhe kulturore. Tipikisht “zona funksionale” përqendrohet rreth qendrave më të mëdha urbane, ku ofrohet një gamë e plotë e shërbimeve, përfshirë infrastrukturën social-ekonomike si ekzistenca e rrjetit të shkollave, spitaleve, qendrat e kujdesit social, shërbimet e policisë, të shërbimit zjarrfikës, të shërbimeve të transportit interurban, të shërbimeve shtetërore apo private në funksion të qytetarëve dhe bizneseve, si degët e tatimeve, postave, të rrjetit bankar.

Një tipar tjetër i rëndësishëm i qendrës së zonës funksionale është një bazë ekonomike relativisht e qëndrueshme, në veçanti potencial i zhvillimit ekonomik dhe përqendrim krahasimisht më i madh i bizneseve se në zonat rrethuese. Potenciali i zhvillimit ekonomik është një parakusht që mundëson mobilizimin e të ardhurave vendore; si edhe rezultojnë në flukse natyrale shkëmbimi të qytetarëve të zonave përreth.

Tipikisht qendrat e zonave funksionale përkrijnë me qendrat e konsoliduara urbane të vendit (qendrat e qarqeve dhe/ose qendrat e ish-rretheve), për shkak të zhvillimit më të madh të infrastrukturës fizike dhe të shërbimeve në këto qendra, çka është pasuar me kapacitete më të larta për thithjen e bizneseve dhe zhvillimin ekonomik e social në këto qendra krahasuar me periferitë. Në qendrat e rretheve vendosen zyrat arsimore, zyrat e punësimit, drejtoritë shëndetësore rajonale, drejtoritë e shërbimit pyjor, gjykata e rrethit gjyqësor, prokuroria, degët e tatimeve. Në disa prej qendrave të rrethit janë vendosur dhe një sërë institucionesh sociale, shëndetësore dhe arsimore: shtëpitë e të moshuarve, shtëpitë e foshnjës, qendrat e formimit profesional, qendrat e zhvillimit, etj.

Jo rrallë qendrat ekzistuese urbane janë kthyer në destinacionin kryesor për flukset migratore nga zonat rurale drejt qendrave urbane. Kjo dukuri është akoma më e dukshme për qytetet më të mëdha të vendit dhe zonat e tyre suburbane, të cilat në raste të caktuara janë kthyer në pole

të qenësishme zhvillimi si rezultat i ndryshimeve strukturore e demografike të dhjetëvjeçarëve të fundit (si për shembull rasti i Kamzës).

2. Përmasat e zonave funksionale të propozuara, në përputhje me kriteret e paracaktuara nga Komisioni Parlamentar, nga pikëpamja e numrit të popullsisë; distancave dhe kohës së nevojshme për përshkrimin e tyre.

Njësitë e reja vendore nën konceptin e zonës funksionale presupozohen si *hapësira administrative të mëdha nga pikëpamja e territorit dhe popullsisë* që përfshin si zona urbane ashtu dhe zona rurale duke lejuar një harmonizim të politikave zhvillimore dhe duke ulur pabarazitë e thella midis zonave urbane dhe rurale. Tipikisht ndërveprimet janë më intensive mes qendrës urbane dhe zonave suburbane dhe dobësohen në periferi.

Megjithatë, përmirësimet e infrastrukturës rrugore kanë bërë të mundur që distanca e qendrës së zonës funksionale (NJQV e re) me periferitë të jetë e aksesueshme në një kohë të arsyeshme në shumicën dërrmuese të rasteve. Parimi i distancës së qendrës së NJQV-së me territorin është parë në mënyrë të njëkohshme me parimin e numrit të konsiderueshëm të popullsisë, në mënyrë që të sigurohen qendra eficiente për efekt të ekonomive të shkallës, por edhe shmangies së fragmentimit të territoreve e shërbimeve në rastet e afërsisë së madhe gjeografike.

Kriteri tjetër i propozuar lidhet me *distancën e qendrës së NJQV-së* me territorin. Nga një anë kjo distancë nuk duhet të jetë e tillë sa të pengojë ofrimin e shërbimeve për komunitetin, por nga ana tjetër nuk mund të krijohen NJQV të reja nëse ato gjenden shumë pranë NJQV të tjera, të cilat mund të ofrojnë më mirë shërbimet për publikun dhe të sigurojnë mundësi më të mëdha zhvillimi.

Një tjetër kriter i rëndësishëm është parimi i *vazhdimësisë territoriale*. Ky parim nënkupton që territori i një njësie të qeverisjes vendore është i vazhdueshëm dhe nuk ka "ishuj" territorialë që i përkasin një njësie tjetër vendore.

Kriteri i *numrit të popullsisë* shërben si një kriter referues për NJQV-të e reja të propozuara. Duke marrë parasysh gjeografinë e territorit dhe shpërndarjen e popullsisë do ishte e rekomandueshme që NJQV-të e reja të kenë një numër të konsiderueshëm banorësh, që Komisioni Parlamentar e përcaktoi si një popullsi mesatarisht mbi 30.000.

Kriteri i rëndësishëm (dhe kërkesë kushtetuese dhe ligjore) është edhe garantimi i *lidhjeve historike dhe tradicionale* të NJQV-ve të reja. Në këtë rast NJQV-të e reja do të kishin një traditë historike të mëparshme dhe të karakterizuara nga shkëmbime tradicionale mes banorëve, me qëllim sigurimin e kohezionit social. Në përgjithësi ky kriter plotësohet në mënyrë shteruese në zonat funksionale të propozuara, ku janë marrë parasysh edhe ndarjet dhe shkëmbimet historike mes popullsisë së zonës.

Në përjashtim nga kriteret e mësipërme dhe si kriter i veçantë përjashtues mund të shqyrtohen rastet që marrin në konsideratë praktikatat më të mira ndërkombëtare për mbrojtjen e pakicave etnike aty ku këto pakica përbëjnë shumicën e popullsisë së NJQV-ve ekzistuese.

3. Parametrat buxhetorë dhe ekonomikë të njësisë të reja të propozuara në krahasim me ekzistueset

Parametrat buxhetorë dhe ekonomikë në zonat e reja funksionale janë shqyrtuar për të vrojtuar performancën aktuale të buxheteve vendore, në veçanti i) fondet që aktualisht shpenzohen për kosto fikse si administrata e njësisë vendore, kostot e mirëmbajtjes së zyrave; ii) fondet që shpenzohen për investime dhe fondet që shpenzohen për shërbime.

Kriteri i fondeve të shpenzuara për frymë është përdorur gjerësisht, pasi ai siguron një bazë më të mirë krahasimore mes njësive të vogla dhe të mëdha. Një analizë e gjerë e situatës financiare dhe buxhetore në njësitë ekzistuese është prezantuar në analizën paraardhëse të këtij raporti. Ky raport mbështetet gjerësisht mbi analizën e bërë dhe identifikon në mënyrë të veçantë ndryshimet e pritshme në strukturën buxhetore të njësisë së re, duke marrë parasysh kursimet e pritshme administrative.

Bashkimi i njësive në një zonë funksionale do të rezultojë veçanërisht në optimizimin e shpenzimeve administrative dhe atyre operative.

Në nivel funksionesh drejtuese/politike për njësitë e suprimuara parashikohet të pushojnë së ekzistuari këto pozicione: Kryetari dhe N/Kryetari i Bashkisë/Komunës, Sekretarët e Kryetarëve për NJQV, Sekretarët e Këshillave të Bashkive/Komunave për NJQV.

Në nivel funksionesh administrative parashikohet të shkohet drejt qendërimit të funksioneve mbështetëse (financë, jurist, topograf, inxhinier etj) në njësinë qendër të njësisë së re vendore duke bërë që nëpërmjet parimit të ekonomisë së shkallës të kryhet i njëjti shërbim në qendër por me një numër shumë më të vogël punonjësish se sa totali i këtyre punonjësve në çdo njësi vendore ekzistuese. Qendërimiti i këtyre funksioneve mund të përballohet nga zyrat aktuale të njësive që do të fuqizohen, duke maksimizuar efikasitetin e stafit ekzistues të tyre ose me shtesa (një ose dy punonjësish për njësi) në varësi të ngarkesës së re. Me tej, mund të parashikohet reduktimin e një kategorie pozicionesh mbështetëse si shofer, pastrues, roje, etj.

Rritje efiçence administrative pritet edhe në zyrat e planifikimit urban dhe të administrimit të territorit. Me qendërimitin e këtij funksioni në qendrën e zonës së re funksionale do të shfrytëzohet eksperiencia më e mirë dhe do të evitohet dublikimi me staf në këto funksione në NJQV.

Bashkitë e reja do të detyrohen me ligj që të sigurojnë ofrimin në territoret e bashkive/komunave ekzistuese të përthithura disa nga shërbimet të cilat nuk mund të ofrohen në mënyrë qendrore si p.sh gjendjen civile, shpërndarjen e ndihmës ekonomike, mbledhjen e taksave, inspektimin e territorit, mirëmbajtje, grumbullim tarife për shërbim ujësjellës kanalizime atje ku nuk ka SHAUK, etj. Këto shërbime do të ofrohen në ambjentete aktuale të gidinave ekzistuese të zyrave komunës apo bashkisë. Përlllogaritjet janë kryer që administrata e mbetur në këto zyra të jetë rreth 30 – 40% të administratës aktuale vendore.

Analiza sugjeron se nga bashkimi i njësive të qeverisjes vendore, impakti i llogaritur në efiçencën administrative si më sipër, mund të shkojë rreth 80% - 90% e kostove të personelit dhe rreth 20% - 30% e shpenzimeve të tjera operative në njësitë që suprimohen, sipas një analize të dy qarqeve pilot Kukës dhe Elbasan. Megjithatë përlllogaritjet e përfshira në raport kanë ruajtur një skenar më konservator sesa sugjerimi i analizës më sipër, duke projektuar një përlllogaritje në nivelin e 60 – 70% të efiçencës në mirëadministratimin e kostove të personelit dhe deri në 10% të kostove të tjera operative në njësitë që suprimohen, duke parashikuar se veçoritë e relievit dhe nevojave të vendit mund të ndryshojnë në varësi të njësive të ndryshme. Përlllogaritjet e mësipërme janë gjithashtu në harmoni edhe me rastet analoge të llogaritura në literaturën dhe praktikën ndërkombëtare, e cila konfirmon se madhësia optimale për arritjen e efiçencës së shërbimeve publike, është tek njësitë vendore me popullsi nga 25,000 banorë deri në 250,000 banorë (*McKinlay Douglas Limited, 2006; Holzer et al., 2009*).

Megjithatë, duhet të theksohet se efiçenca administrative është një projektion i llogaritur i cili do të verifikohet në praktikë nëpërmjet zbatimi konkret pas reformës territoriale, e cila pritet të sjellë efekte të tjera pozitive në administrimin e burimeve në mënyrë të integruar, aksesin në kapacitete njerëzore më të kualifikuara, shpërndarje më të drejtë të të ardhurave nga taksat e banorëve dhe orientim të financimeve shtetërore aty ku kanë impaktin më të madh.

Në veçanti, organizimi sipas zonave funksionale pritet të sjellë efekte pozitive në vetëqeverisjen vendore, në veçanti në drejtim të:

- Mundësi për menaxhim të integruar të territoreve dhe burimeve, nëpërmjet mundësisë për plane të integruara zhvillimit, shmangies së konkurrencës për, si dhe keqadministrimit të burimeve të përbashkëta. Gjithashtu, territori më i madh mundëson edhe diversitetin brenda zonës, duke ofruar potenciale më të mëdha natyrore dhe kapital njerëzor.
- Zbutje e pabarazive në zhvillim mes zonave rurale dhe urbane, që mund të arrihet nëpërmjet shpërndarjes më të mirë të burimeve financiare.
- Rritje e eficiencës ekonomike, nëpërmjet shmangies së fragmentimit institucional, kanalizimit të investimeve drejt përfituesve por edhe kontribuuesve direktë; si edhe rritjes së kapaciteteve për investime në infrastrukturën fizike e njerëzore. Eficienca ekonomike mund të materializohet në mënyrë të veçantë nëpërmjet realizimit të ekonomive të shkallës në ofrimin e disa shërbimeve me rritjen e territorit të shërbimeve dhe uljen e kostove fikse të lidhura me to.
- Ndërveprimi i shtuar i njësive me qendrat e zonave pritet të sjellin përmirësime të mëtejshme të infrastrukturës rrugore.
- Menaxhimi qendror nga entitete të mëdha dhe me eksperience në administrim vendor pritet të çojnë në një menaxhim më të mirë të ndërmarrjeve shtetërore vendore, në veçanti të atyre të ujësjellës-kanalizime.
- Menaxhimi qendror i shërbimeve të tjera (pastrim, mirëmbajtje) do të bëjë të mundur modernizim e këtyre shërbimeve në zonat me buxhet të vogël.
- Menaxhimi qendror i zonave të reja do të lehtësojë pjesëmarrjen në projekte zhvillimi rajonale dhe kombëtare si dhe aksesin në financime nga buxheti i shtetit dhe donatorë të huaj.


Zonat funksionale të propozuara – 5 variantet

Raporti i zonave funksionale për çdo qark sugjeroi hartimin e propozimit të ndarjes administrativ-territoriale të Shqipërisë me 5 variante si më poshtë:

Varianti me 30 Zona Funksionale

Karakteristika:


- Popullsia mesatare 93,338 Banore/Njësi
- Sipërfaqja mesatare 944.302 Km² /Njësi



Varianti me 39 Zona Funktionale

Karakteristika:


- Popullsia mesatare 71,798 Banore/Njësi
- Sipërfaqja mesatare 726.38 Km²/Njësi



Varianti me 47 Zona Funktionale

Karakteristika:


- Popullsia mesatare 59,577 Banore/Njesi
- Sipërfaqja mesatare 602 Km² /Njesi



Varianti me 57 Zona Funktionale

Karakteristika:

- Popullsia mesatare 49,125 Banore/Njësi
- Sipërfaqja mesatare 497 Km²/Njësi



Krijohen 10 njësi te reja nga varianti me 47

1. SUKTH (MANZË, ISHËM)
2. ROSKOVEC (STRUM, KURJAN, KUMAN)
3. RROGOZHINË (SINABALLAJ, LEKAJ, KRYEVIDH, GOSË)
4. FUSHË KRUIJË (THUMANË, BUBQ, NIKËL)
5. PRRENJAS (QUKËS, RRAJC, STRAVAJ)
6. KELCYRË (DËSHNICË, BALLABAN, SUKË)
7. POLIÇAN (BOGOVË, VENDRESHË,)
8. MEMALIAJ (MEMALIAJ-FSHAT, LUFTINJE, BUZ, KRAHËS, QESARAT)
9. VORË (PREZË, BËRXULL)
10. SELENICË (ARMEN, VLLAHINË, KOTE, SEVASTER, BRATAJ)


Varianti me 63 Zona Funktionale

Karakteristika:

- Popullsia mesatare 44,446 Banore/Njësi
- Sipërfaqja mesatare 449 Km² /Njësi

Krijohen 6 njësi te reja nga varianti me 57

1. FUSHË ARRËZ (FIERZ,BLERIM,QAFE-MALI,IBALLE)
2. KLOS (XIBER, GURRE, SUC)
3. BELSH (GREKAN, KAJAN, FIERZE, RASE)
4. URA VAJGURORE (POSHNJE, KUTALLI, CUKALAT)
5. KONISPOL (XARRE, MARKAT)
6. LIBHOVË (LUNXHERI, ODRIE, QENDER-LIBHOVE, ZAGORIE, ANTIGONE)



Varianti me 61 Zona Funktionale

Karakteristika:

- Popullsia mesatare 45,925 Banore/Njësi
- Sipërfaqja mesatare 464 Km² /Njësi




QARKU BERAT

Profili i qarkut Berat

Qarku i Beratit përbëhet nga 25 njësi të qeverisjes vendore. Nënndarjet administrative janë tre rrethe, respektivisht: rrethi i Beratit (12 njësi, qendër Berat); rrethi i Kuçovës (3 njësi, qendër Kuçovë) dhe rrethi i Skraparit (10 njësi, qendër Çorovodë). Në vitin 2011 popullsia e qarkut të Beratit është 141 944 banorë, ndër të cilët 70% (97 942 banorë) jetojnë në rrethin e Beratit, 19% (27 281) jetojnë në rrethin e Kuçovës dhe vetëm rreth 12% (16 721 banorë) jetojnë në Skrapar (INSTAT, Census 2011).

Figura 1 Njësitë vendore në qarkun e Beratit sipas popullsisë (INSTAT 2011)



Qarku i Beratit ka pasur një humbje neto të popullsisë prej rreth 39% ose mbi 90 mijë banorë krahasuar me të dhënat zyrtare të Regjistrit të Gjendjes Civile të vitit 2011. Sipas të dhënave zyrtare të RGJC në janar 2012 në qarkun e Beratit ishin të regjistruar 231 986 banorë me përqendrim të ngjashëm me atë të raportuar nga Censusi 2011, pra 67%, 21% dhe 12% të regjistruar përkatësisht në Berat, Kuçovë dhe Skrapar.

Referuar të dhënave të Census-it 2011 popullsia mesatare për njësi të qeverisjes vendore në këtë qark rezulton 5678 banorë/NJQV ose 30% më e ulët se mesatarja kombëtare prej 8016 banorë/NJQV. Njësitë e rrethit të Skraparit janë veçanërisht të vogla me një mesatare prej 1672 banorësh, ndërkohë që 5 nga 8 njësitë me popullsi më të vogël se 2000 banorë të këtij qarku ndodhen në Skrapar.

Rreth 32% e njësive ose 8 nga totali prej 25 njësish kanë një popullsi të regjistruar deri në 2000 banorë, ndërsa po kaq njësi, pra 32% e totalit regjistrojnë një popullsi që varion nga 2001 deri në 5000 banorë, ndërsa 7 njësi ose 28% e totalit kanë një popullsi që varion nga 5000 deri në 10 000 banorë. Pjesa tjetër 1 njësi ose 5% e totalit ka një popullsi me të madhe se 30 000 banorë (qyteti i Beratit me 36 500 banorë).

Dendësia mesatare e popullsisë në qarkun e Beratit është 408 banorë/km² krahasuar me 97,4 banorë/km² në rang vendi. Berati si qendër ekonomike ka dendësi më të ulët (1924 banorë/km²) se Kuçova (4017 banorë/km²) dhe Çorovoda (2340 banorë/km²). Gjysma e njësisve kanë dendësi më të ulët se 55 banorë/km², ndërsa komunat e Gjerrës, Leshnjës dhe Zhebes në Skrapar kanë dendësi shumë më të ulët me më pak se 6 banorë për km².

Propozimi i zonave funksionale në qarkun e Beratit

Ndarja e zonave funksionale në qarkun e Beratit është bërë në respekt të konceptit të zonës funksionale si një hapësirë territoriale banorët e së cilës kanë tradicionalisht një ndërveprim intensiv dhe garantojnë komunikim të pandërprerë dhe të lehtë.

Gjithashtu zonat funksionale¹ janë të organizuara rreth një qendre urbane, që në dallim nga zona të tjera urbane dhe/ose rurale, sigurojnë shërbime dhe funksione sipas kritereve që vijnë si më poshtë:

1. Qyteti është qendër qarku (QQ) me popullsi mbi 35 000 banorë
2. Qyteti është qendër rrethi (QR) me popullsi më të madhe se 20 000 banorë
3. Qyteti është qendër lokale ose qyteti i vogël qendër rrethi dhe qytete të tjera, (QL) me popullsi jo më të vogël se 10 000 – 20 000 banorë

Tabela 1 Pasqyrimi i përmbledhur i kritereve të përzgjedhjes së qytetit qendër të zonës funksionale në qarkun e Beratit.

Qyteti/Fshati	Statusi administrativ			Qendër ekonomike						
	Qendër qarku	Qendër rrethi	Qendër lokale	Industri	Bujqësi	Shërbime/Tregti	Qendër tradicionale	Kryen funksione qendrore	Zonë përqendrimi minoritar	Pesha në pikë për çdo qendër ZF
Berat	x	x		x		x	x	x		6
Kuçovë		x		x		x	x	x		5
Skrapar		x			x	x	x	x		5

Funksionaliteti i zonës është parë gjithashtu edhe nga këndvështrimi i intensitetit dhe i drejtimit të lëvizjes dhe komunikimit. Drejtimi dhe intensiteti i lëvizjes ose i komunikimit brenda një zone funksionale është vlerësuar si mundësia për të gjetur punë apo për të marrë shërbime bazë si shërbimet shëndetësore, sociale, arsimore etj.

Mbi bazën e kritereve të mësipërme qarku i Beratit mbulohet nga 3 zona funksionale të cilat nga veriu në jug janë ilustruar si në hartën e mëposhtme:

¹ Kriteret janë bazuar mbi studimin “Statistikat socio – demografike të Shqipërisë”, “Tipologjia e komunave dhe definicioni i aglomerateve në Shqipëri” INSTAT, 2010 me autor Martin Schuler, Alain Jarne, Ervin Shameti, Ledjo Seferkolli dhe EPFL-CEAT-Lausanne, Zvicër

1. Berat
2. Kuçovë
3. Skrapar

Në vijim jepet përshkrimi i detajuar për secilën prej zonave funksionale të këtij qarku.

Figura 2 Ndarja e zonave funksionale në qarkun e Beratit



Tabela 2 Të dhëna demografike për zonën funksionale të qarkut Berat

Nr	Zona funksionale	Nr. i njësive	Qendra e ZF	Popullsia	% popullsisë urbane	Distanca mesatare nga qendra në km
1	Berat	11	Qyteti Berat	93 961	47%	11,7
2	Skrapar	10	Qyteti Çorovodë	16 721	50%	16,9
3	Kuçovë	4	Qyteti Kuçovë	31 262	40%	6
Shuma		25		141 944		

Burimi: INSTAT 2012, llogaritjet e autorëve

Zona funksionale Berat

Profili administrativo – territorial

Zona funksionale Berat përfshin 11 njësi territoriale administrative. Qendra urbane e kësaj zone është qyteti i Beratit. Zona funksionale përfshin komunat Roshnik, Vërtop, Tërpan,

Velabisht, Sinjë, dhe Otlak, të gjitha të përkufizuara si zona bujqësore (ZB) fushore, malore ose të përziera, të cilat nuk përmbushin kriteret për të qëndruar si qendër e një zone funksionale. Zona funksionale përfshin gjithashtu edhe qytetin e Urës Vajguore, një qytet kryesisht industrial me lidhje të forta me Beratin, si edhe me komunat Cukalat, Kutalli dhe Poshnjë.

Figura 3 Harta e zonës funksionale Berat



Profili social - demografik

Zona funksionale Berat ka një popullsi totale prej 93 961 banorësh. Tabela në vijim na jep një përmbledhje të të dhënave bazë socio-demografike të kësaj zone.

Tabela 3 Të dhëna socio-demografike për zonën funksionale Berat

Bashki/komuna	Statusi funksional – administrativ	Popullsia (2013)	Sip.km ²	Densiteti banorë/km ²	Distanca në km nga qendra e zonës
Berat	B	36 496	19	1923,5	0
Cukalat	K	3045	31	97,1	14
Kutalli	K	9643	44	217,4	15
Otllak	K	9218	53	174,9	25
Poshnjë	K	7375	38	196,6	3
Roshnik	K	2513	79	31,9	19
Sinjë	K	3351	139	24,2	6
Tërpan	K	1716	168	10,2	
Ura Vajgurore	B	7232	43	167,0	
Velabisht	K	8453	93	90,6	
Vërtop	K	4919	89	55,4	
Shuma		93 961	795	118	82
Mesatare				271	11,7
Urbane		43 728			
Rurale		50 233			
% Urbane		46%			

Burimi: INSTAT 2012, llogaritjet e autorëve


Sipas të dhënave statistikore pas agregimit rezulton se 46% e popullsisë në zonën funksionale jeton në zonë urbane ndërsa 54% në zonë rurale.

Zona ka një sipërfaqe totale prej 795 km² ose 8,5 km² për 1000 banorë.

Dendësia e popullsisë është 118 banorë/km² krahasuar me mesataren prej 271 banorë/km² kur njësitë brenda zonës analizohen në mënyrë të veçuar.

Qyteti i Beratit është njëkohësisht qendër qarku dhe rrethi. Ai hyn në kategorinë e qyteteve me rëndësi kombëtare (36 496 banorë) ku janë përqendruar institucionet qendrore, të cilat sigurojnë shërbime ekstra kur krahasohen me qendra të tjera urbane.

Figura 4 Harta e ndërveprimit ekonomik e qarkut Berat



Burimi: MÇV; Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve

Sipas të dhënave të Censur 2011, edhe pse raporti i migrimit jashtë qarkut krahasuar me migrimin drejt qarkut Berat është 2/3 (mesatare vendi), qyteti i Beratit mbetet qendra kryesore e migrimit për banorët e pjesës më të madhe të komunave që e rrethojnë atë.

Qyteti i Beratit është gjithashtu destinacioni kryesor (mbas zonave Tiranë - Durrës dhe Fier - Vlorë) për lëvizjen e banorëve të komunave që e rrethojnë për të marrë shërbime si dhe mundësi punësimi.

Figura 5 Harta e shpërndarjes së bizneseve në zonën funksionale Berat





Figura 6 Shpërndarja e bizneseve për 1000 banorë ZF Berat



Burimi: INSTAT, llogaritjet e autorëve

Profili ekonomik - financiar

Shpenzimet publike

Duke iu referuar të dhënave ekonomiko - financiare të vitit 2012 shuma e shpenzimeve totale për të gjitha njësitë e zonës është 643 milion lekë, ndër të cilat shpenzimet e personelit zënë 41% të totalit, shpenzimet operative për të gjitha njësitë në zonën funksionale të propozuar (250 milionë lekë) zënë rreth 39% të totalit, ndërsa shpenzimet për investime (127 milionë lekë) zënë më pak se 20%.

Tabela 4 Shpenzimet para agregimit, njësitë e ZF, Berat 2012

Njësia	Popullsia 2011	Totali i shpenzimeve 2012 (000/lek)	Shpenzime Personel Total	Shpenzime operative	Shpenzime Investime
Berat	36 496	362 000	156 000	174 000	32 000
Cukalat	3045	20 000	7000	6000	7000
Kutalli	9643	30 000	8000	6000	16 000
Otlak	9218	41 000	14 000	9000	18 000
Poshnjë	7375	28 000	9000	8000	11 000
Roshnik	2513	21 000	8000	4000	9000
Sinjë	3351	20 000	9000	5000	6000
Tërpan	1716	11 000	6000	5000	-
Ura Vajgurore	7232	59 000	33 000	23 000	3000
Velabisht	8453	27 000	7000	5000	15 000
Vërtop	4919	24 000	9000	5000	10 000
Shuma Shpenzime	93 961	643 000	266 000	250 000	127 000
Shpenzime/frymë (lek)		6843	2831	2661	1352
% ndaj totalit			41%	39%	20%

Burimi: Ministria e Financave 2012, llogaritjet e autorëve

Nga ulja e shpenzimeve për personelin (paga dhe sigurime shoqërore) dhe duke llogaritur një reduktim në masën 70% të shpenzimeve për paga vetëm për njësitë që përthithen për efekt të agregimit, vlera e shpenzimeve për personelin do të ulet nga 266 milionë në 189 milionë lekë. Po kështu, do të ulen shpenzimet operative nga 250 milionë në 242 milionë lekë.


Tabela 5 Shpenzimet pas agregimit, njësitë e ZF, Berat 2012

Njësia	Popullsia 2011	Shpenzime 2012 (milionë lek)					Interesa të paguara	
		Totali i shpenzimeve 2012 (000/lek)	Shpenzime Personel Total	Shpenzime operative	Shpenzime Investime			
Shpenzime të njësive që përthithen	57 465	281 000	110 000	76 000	95 000	-	-	
Reduktimi i shpenzimeve të njësive që përthithen			77 000	7600		-	-	
ZF Shuma Shpenzime	93 961	643 000	189 000	242 400	211 600	-	-	
ZF Shpenzime/frymë		6843	2011	2580	2252	-	-	
NJQV/gjendja ekzistuese %			41%	39%	20%	0%	0%	
ZF % e shpenzimeve ndaj totalit			29%	38%	33%	0%	0%	

Burimi INSTAT 2012, llogaritjet e autorëve

Nëse diferenca e shpenzimeve të kursyera për efekt të agregimit do të rishpërndahet në kursin e shpenzimeve, atëherë shpenzimet për investime në zonën funksionale do të rriteshin nga 127 milionë në 212 milionë lekë duke e ndryshuar peshën aktuale të investimeve në buxhetin e zonës funksionale nga 20% në 33% dhe rrjedhimisht duke përfitur një rritje prej rreth 67% të vlerës së investimeve.


Figura 7 Ndryshimi i raportit të shpenzimeve vendore para dhe pas agregimit në zonën funksionale Berat



Burimi: Ministria e Financave, llogaritjet e autorëve

E njëjta tendencë pozitive vërehet edhe kur krahasohen raportet e shpenzimeve të personelit, operative dhe të investimeve kundrejt totalit të shpenzimeve. Pesha që zënë shpenzimet për investime do të rritet nga 20% në 33% ndërsa shpenzimet e personelit do të ulen nga 41% në 29%.


Figura 8 Krahasimi i raportit të shpenzimeve ndaj totalit në zonën funksionale Berat (2012)



Burimi: INSTAT 2012, llogaritjet e autorëve

Figura 9 në vijim tregon shpërndarjen e shpenzimeve për banorë në zonën funksionale kundrejt njësisve të veçanta që përthithen në këtë zonë.

Figura 9 Krahasimi i shpenzimeve totale për frymë të zonës funksionale Berat ndaj njësisve të veçanta




Burimi: Llogaritjet e autorëve

Të ardhurat publike

Pa marrë në konsideratë rritjen potenciale të normës së arkëtimeve për tarifatat dhe taksat vendore, zona funksionale do të sigurojë një buxhet total në vlerën e 11,3 mijë lekëve për banor.


Figura 10 Krahasimi i të ardhurave totale/banorë të ZF Berat ndaj njësive të veçanta



Burimi: INSTAT 2012, llogaritjet e autorëve

Ndërsa të ardhurat e veta për banorë, gjithashtu në kushte të njëjta si më sipër, llogariten në vlerën 3081 lekë.

Figura 11 Krahasimi i të ardhurave të veta/banorë të ZF Berat ndaj njësive të veçanta



Burimi: Ministria e Financave 2012, llogaritjet e autorëve

Administrata

Si rezultat i krijimi të zonës funksionale numri i përgjithshëm i administratës parashikohet të ulet nga 687 punonjës në 389 punonjës pa llogaritur këtu numrin e këshilltarëve të këshillave bashkiakë dhe të komunave.


Tabela 6 Shpërndarja teorike e personelit të NJQV

NJQV	Popullsia	Aktuale		Zona funksionale	
		Nr.	Nr./1000 Banorë	Nr.	Nr./1000 Banorë
Berat	36 496	261	7	261	7
Cukalat	3045	14	5	10	3
Kutalli	9643	53	5	37	4
Otllak	9218	57	6	40	4
Poshnjë	7375	68	9	48	6
Roshnik	2513	27	11	19	8
Sinjë	3351	20	6	14	4
Terpan	1716	20	12	14	8
Ura Vajgurore	7232	83	11	58	8
Velabisht	8453	47	6	33	4
Vërtop	4919	37	8	26	5
Total	93 961	687	8	389	3

Burimi: MÇV, llogaritjet e autorëve

Ngarkesa e punonjësve për 1000 banorë do të ulet nga 8 në 3 duke rritur mundësinë për një personel më të kualifikuar dhe efikasitet financiar.

Figura 12 Shpenzime personeli për frymë në ZF Berat (2012 - në lek)



Burimi: Llogaritjet e autorëve


Të dhëna të tjera për zonën funksionale

Transporti dhe Komunikacioni

Arteriet kryesore rrugore të qarkut të Beratit lidhin qendrat kryesore, kryesisht qytetet. Zonat e tjera kanë një rrjet rrugor relativisht të zhvilluar i cili mundëson një qarkullim të moderuar deri në të vështirë. Brenda zonës funksionale kanë lidhje rrugore relativisht cilësore Berat, Otlak, Vërtop të cilat gjenden në trajektoren e rrugës Berat - Poliçan si dhe Berat – Tërpan, ndërsa njësitë e tjera lidhen me rrugë lokale.

Distanca mesatare nga qyteti i Beratit (qendra e zonës funksionale) në qendrat e komunave përbërëse është 11,7 km. Pika më e afërt me qytetin është 3 km (fshati Velabisht) dhe 6 km (fshati Otlak) ndërsa pika më e largët është 25 km (fshati Tërpan). Tabela më sipër tregon në mënyrë të detajuar distancat që lidhin qendrën (qytetin) e zonës funksionale me qendrat (fshatrat) e tjera.


Figura 13: Harta e distancave kohore



Furnizimi me ujë dhe kanalizime

Në zonën funksionale të Beratit aktualisht ka 1 operator për furnizimin me ujë dhe shërbimin e kanalizimeve Sh.A UK Berat – Kuçovë, i cili administron shërbimin e furnizimit me ujë dhe të kanalizimeve në qytetin e Beratit, si dhe shërbimin e furnizimit me ujë në komunat Otllak dhe Vërtop të kësaj zone, ndërsa të gjitha njësitë e tjera e administrojnë vetë këtë shërbim. Shpenzimet për këtë shërbim nga njësitë janë minimale. Aktualisht vetëm Otllak, Roshnik dhe Vërtop kanë shpenzuar 7 milion lekë ose 4 % të totalit të shpenzimeve për njësitë që përthithen.

Figura 14 Harta e mbulimit me shërbimin e ujësjellës - kanalizime



Krijimi i kësaj zone funksionale mund të shoqërohet në të ardhmen edhe me ristrukturimin e operatorit dhe shtirjen e mbulimit me shërbim të furnizimit me ujë dhe kanalizime në të gjitha njësitë përbërëse të zonës.

Pastrimi dhe menaxhimi i mbetjeve

Pjesa më e madhe e shpenzimeve të njërive, që përthithen për realizimin e funksioneve në vlerën 96 milion lekë ose 56 % të totalit shkojnë për shërbime të tjera publike, kryesisht për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve. Bashkimi i këtyre njërive do të rrisë efektivitetin e përdorimit të këtyre fondeve duke mbuluar edhe zonat periferike por edhe duke përmirësuar standardin e shërbimit.

Tabela në vijim pasqyron të përmbledhur shpërndarjen e shpenzimeve sipas funksioneve në njësitë e zonës funksionale Berat.

Tabela 7 Shpërndarja e shpenzimeve sipas funksioneve

Berat	Shpërndarja e shpenzimeve sipas funksioneve kryesore				
	Totali	Ujësjellës	Shërbime publike	Transport	Të tjera
Shpenzime	510	7	196	90	21 700
% ndaj totalit	100%	1%	38%	18%	43%

Burimi: Ministria e Financave 2012, llogaritjet e autorëve

Ndërsa grafiku më poshtë ilustron shpërndarjen e shpenzimeve sipas funksioneve në këtë zonë funksionale.

Përfundime

Bashkimi i njërive në zonën funksionale me qendër qytetin e Beratit do të bëjë që shpenzimet administrative dhe ato korrente të ulen me rreth 85 milion lekë ose rreth 12% të shpenzimeve të përgjithshme të njërive të zonës funksionale, krahas uljes së ngarkesës së administratës vendore nga 8 punonjës për 1000 banorë në 3 punonjës për 1000 banorë (nga 687 në 390 punonjës gjithsej)

Për të njëjtin buxhet, vetëm nga kjo diferencë prej shkurtimeve të shpenzimeve administrative dhe korrente të marra së bashku, njësitë e re zona funksionale Berat do të rrisë shpenzimet vjetore për investime për njësitë që përthithen nga 127 milionë lekë në 211 milionë lekë në vit. Investimet për frymë mund të rriten nga 1625 lekë për frymë në 2135 lekë për frymë.

Përveç njërive që shtrihen përgjatë aksit Lushnje – Çorovodë pjesa tjetër e njërive të zonës funksionale Berat që kanë një distancë relative nga qyteti i Beratit, veçanërisht fshatrat e komunës Sinjë, Tërpan dhe periferitë e komunave Otlak, Roshnik dhe Vërtop kanë komunikim të vështirë rrugor me qendrën e zonës (qytetin e Beratit) për shkak të cilësisë së rrugëve.

Zona funksionale do të krijojë mundësinë për strukturimin e shumë shërbimeve publike, veçanërisht të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime i cili aktualisht administrohet nga 1 operator por që lë jashtë mbulimit pjesën më të madhe të komunave që bashkohen në këtë zonë.

Zona funksionale Ura-Vajgurore

Bashkia Ura-Vajgurore dhe komnat Poshnjë, Kutalli, Cukalat

Përfundime

Përfundimet e mëposhtme janë llogaritur për ZF Ura-Vajgurore si njësi funksionale që qëndron më vete jashtë ZF Berat.

ZF Ura-Vajgurore e përbërë nga 4 njësi ekzistuese, ka popullsi prej 27,295 banorë, nga mesatarisht 6,824 banorë aktualisht në NJQV ekzistuese;

Reduktim i shpenzimeve administrative të njësisë me rreth 18,8 milionë lekë në vit, ose 19% e shpenzimeve administrative (shpenzime paga dhe operative) dhe 12% e shpenzimeve vjetore gjithsej;

Ulja e shpenzimeve të personelit për banor në masën 30%, nga 2,088 lekë në 1,473 lekë për banor;

Mirëadministrimi i burimeve financiare mund të sjellë rritje të investimeve në masën 50%, ose nga 37 milionë lekë, në 55,8 milionë lekë në vit;

Investimet për banor mund të rriten nga 1,356 lekë, në 2,044 lekë për banor në njësinë e re;

Bashkimi në një zonë funksionale mund të sigurojë rishpërndarje më të mirë të të ardhurave duke zbutur pabarazitë e mëdha mes zonave; pa llogaritur efektet e efijencës së rritur në menaxhimin e të ardhurave: mesatarisht ZF e re do të realizonte 2,242 lekë të ardhura të veta për frymë, ose 7% më shumë se mesatarja e të ardhurave të veta për frymë në njësitë ekzistuese (2,099 lekë) dhe 31% më shumë se mediani i të ardhurave të veta për frymë në këto njësi (1,717 lekë);

Zona funksionale Kuçovë

Profili administrativo - territorial

Zona funksionale Kuçovë përfshin 4 njësi territoriale administrative. Kjo zonë është ndërtuar rreth qendrës urbane (qytet qendër rrethi) të Kuçovës. Zona funksionale përfshihet komunat Perondi, Kozarë dhe Lumas. Të gjitha komunat që përfshihen klasifikohen si zona bujqësore (ZB) fushore, kodrinore ose të përziera.

Figura 15 Harta dhe infrastruktura e zonës funksionale Kuçovë



Bashkia e Kuçovës paraqitet si qendër rrethi dhe komunikimi me interes ekonomik kryesisht në sektorin e naftës, por edhe si qendër bujqësore.

Profili socio - demografik

Zona funksionale Kuçovë ka një popullsi totale prej 31 262 banorësh. Tabela në vijim na jep një përmbledhje të të dhënave bazë socio - demografike për këtë zonë funksionale.

Tabela 8 Të dhëna bazë socio - demografike për zonën funksionale Kuçovë

Bashki/komuna	Statusi funksional – administrativ	Popullsia (2013)	Sip. km ²	Densiteti banorë/km ²	Sip km ² /1000 banorë	Sip. bujqësore ha	Sip. ha/1000 banorë	Distanca në km nga qendra e zonës
Kuçovë	Q	12 654	3,5	3615	0	-	-	0
Kozarë	ZB	5622	38,6	146	7	2635	469	5
Perondi	ZB	9005	42	214	5	2865	318	1
Lumas	ZB	3981	79	50	20	2684	674	18
Shuma		31 262	163,1	192	5,2	8184	27,2	6
Mesatare				1006,5	8,0		487,0	6
Urbane		12 654						
Rurale		18 608						
% Urbane		40%						

Burimi: INSTAT 2012, llogaritjet e autorëve

Sipas të dhënave statistikore, rezulton se në zonën e re funksionale 40% e popullsisë jeton në zonën urbane ndërsa 60% në zonën rurale.


Zona ka një sipërfaqe totale prej 163 km² ose 5,2 km²/1000 banorë dhe një sipërfaqe bujqësore totale prej 8184 ha ose 27 ha/1000 banorë, ndërsa mesatarja para agregimit është 487 ha/1000 banorë.

Dendësia e popullsisë është 192 banorë/km² krahasuar me mesataren prej mbi 1000 banorë/km² kur njësitë brenda zonës analizohen në mënyrë të veçantë.

Si qendër rrethi, qyteti i Kuçovës siguron shërbime shtesë kryesisht komunikacioni dhe arsimore në një distancë dhe drejtim komod për banorët e komunave që përthithen në këtë zonë funksionale. Zona ka një potencial të madh bujqësor dhe burime të tjera natyrore, si rezerva të rëndësishme naftë.

Harta në vijim paraqet shpërndarjen e bizneseve në zonën funksionale të Kuçovës.

Figura 16 Harta e shpërndarjes së bizneseve së zonës funksionale Kuçovë



Profili ekonomiko - financiar

Shpenzimet publike

Duke iu referuar të dhënave ekonomiko - financiare të vitit 2012 shuma e shpenzimeve totale për të gjitha njësitë e zonës ishte 394 milion lekë ku shpenzimet e personelit (149 milion lekë) zinin 38% të totalit, shpenzimet operative (171 milion lekë) rreth 43% të totalit dhe shpenzimet për investime (74 milion lekë) vetëm 19%.

Tabela 9 Shpenzimet para agregimit, njësitë e ZF, Kuçova 2012

Njësia	Popullsia 2011				
		Totali i shpenzimeve 2012 (000/lek)	Shpenzime Personel Total	Shpenzime operative	Shpenzime Investime
Kuçovë	12 654	135	50	85	0
Kozarë	5622	43	13	12	18
Perondi	9005	53	22	24	7
Lumas	3981	26	7	7	12
Shuma Shpenzime (milionë lek)	31 262	257	92	128	37
Shpenzime/frymë (lek)		8221	2943	4094	1184
% Ndaj Totalit			36%	50%	14%
Totali i shpenzimeve i njësive të tjera		122	42	43	37
Reduktimi i shpenzimeve			29,4	4,3	

Burimi: INSTAT 2012, llogaritjet e autorëve

Nga ulja e numrit të personelit, për efekt të agregimit në një mesatare me 70%, vlera e shpenzimeve për personelin do të ulet nga 92 milion lekë ose 36% të totalit në 62,6 milion lekë ose 24% e totalit. Po kështu, do të ulen shpenzimet operative nga 128 milion lekë në 123,7 milion lekë ose në 48% kundrejt totalit të shpenzimeve.


Tabela 10 Shpenzimet e NJQV para dhe pas agregimit

Njësia	Popullsia 2011				
		Totali i shpenzimeve 2012 (000/lek)	Shpenzime Personel Total	Shpenzime operative	Shpenzime Investime
Shuma Shpenzime	31 262	257 000	92 000	128 000	37 000
Shpenzime/frymë		2943	4094	1184	2943
ZF/gjendja ekzistuese (%)			36%	50%	14%
ZF % shpenzimeve ndaj totalit			24%	48%	28%

Burimi: Llogaritjet e autorëve

Grafiku në vijim ilustron reduktimin e shpenzimeve të personelit dhe ato operative kundrejt rritjes së shpenzimeve për investime.


Figura 17 Ndryshimi i raportit të shpenzimeve vendore para dhe pas agregimit në zonën funksionale Kuçovë



Burimi: Ministria e Financave 2012, llogaritjet e autorëve

Nëse diferenca e shpenzimeve të kursyera për efekt të agregimit do të rishpërndahej në kursin e shpenzimeve, atëherë shpenzimet për investime në zonën funksionale do të rriteshin nga 37 milion në rreth 71 milion lekë duke e ndryshuar raportin aktual nga 14% në 28% të totalit të shpenzimeve, rrjedhimisht duke përfutur një rritje prej mbi 2 herë të totalit të investimeve të njësisë para agregimit.

Figura 18 Krahasimi i raportit të shpenzimeve ndaj totalit në zonën funksionale Kuçovë




Burimi: Ministria e Financave 2012, llogaritjet e autorëve

E njëjta tendencë pozitive vërehet edhe kur krahasohet raporti i shpenzimeve totale për çdo banor ashtu si dhe raporti i shpenzimeve për investime për çdo banor të zonës funksionale duke dhënë një shpërndarje më të drejtë të shpenzimeve në përgjithësi.

Në vijim grafiku ilustron shpenzimet për banor në njësitë e veçanta të zonës kundrejt zonës funksionale.


Figura 19 Krahasimi i shpenzimeve totale/banor të zonës funksionale Kuçovë ndaj njërive të veçanta



Burimi: Ministria e Financave 2012, llogaritjet e autorëve

Ndërsa grafiku në vijim ilustron shpenzimet e investimeve për banor në njësitë e veçanta krahasuar me zonën funksionale Kuçovë.

Figura 20 Krahasimi i shpenzimeve për investime/banorë të ZF Kuçovë ndaj njërive të veçanta



Burimi: INSTAT 2012, llogaritjet e autorëve

Administrata

Si rezultat i krijimit të zonës funksionale, numri i përgjithshëm i administratës parashikohet të ulet nga 423 punonjës në 228 punonjës pa llogaritur këtu numrin e këshilltarëve të këshillit bashkiak dhe të komunave.

Tabela 11 Ngarkesa e punonjësve të NJQV për 1000 banorë

NJQV	Popullsia	Aktual		Zona funksionale	
		Nr.	Nr./1000 Banorë	Nr.	Nr./1000 Banorë
Kuçovë	12 654	140	11,1	140	11
Perondi	9005	36	4,0	11	1
Lumalas	3981	7	1,8	5	1
Kozarë	5622	22	3,9	7	1
Zona funksionale	31 262	205	6,6	160	5,1

Burimi: Llogaritjet e autorëve

Ngarkesa e punonjësve për 1000 banorë do të ulet nga 7,2 punonjës në 4 punonjës duke rritur mundësinë për një personel më të kualifikuar dhe efikasitet financiar.


Të dhëna të tjera për zonën funksionale

Komunikacioni dhe transporti

Zona ka një rrjet rrugor relativisht në gjendje të mirë dhe komunikim të lehtë. Gjithashtu shtrirja e kufizuar e zonës lejon qarkullim të lehtësuar për efekt të distancave relativisht të shkurtra ndërmjet qytetit qendër (Kuçovë) dhe shumë prej njësive të tjera. Përjashtim këtu bën komunikimi rrugor me komunën Lumas, (16 km) dhe Cukalat (23 km).

Ndërsa rrugët për në qendrat e tjera, Kozarë (5 km) dhe Perondi (1 km) dhe Urë Vajguore (6 km) sigurojnë një komunikim të mirë dhe të pandërprerë.


Figura 21 Harta e distancave kohore



Furnizimi me ujë dhe kanalizime

Në zonë funksionon Sh.A UK Berat – Kuçovë që mbulon me shërbim territorin e bashkisë Kuçovë dhe pjesërisht atë të komunave Perondi dhe Kozarë.

Figura 22 Harta e mbulimit me ujësjellës të zonës funksionale Kuçovë



Gjithashtu në zonë funksionon ShA. U. Ura Vajguore e cila mbulon me shërbime vetëm territorin e bashkisë dhe pjesërisht territorin e komunës Poshnjë.

Në kuadër të zonës funksionale, vetëm një operator mund të mbulojë menaxhimin e shërbimit në komunën Lumas si dhe të gjitha komunave të tjera duke siguruar me mbulim të gjithë territorin e zonës funksionale.

Përgjithësisht asnjë prej komunave që mbulohen me shërbim nga Sh.A. Kuçovë – Berat nuk shpenzojnë për këtë shërbim.

Ndërsa në zonën e shërbimit të Sh.A. U. Ura Vajgurore komuna Poshnjë financon rreth 8 milion lekë vetëm për shërbimin e furnizimit me ujë.

Shërbime të tjera publike

Pjesën më të madhe të shpenzimeve në shumën prej 214 milion lekë ose 70% të totalit prej 240 milion lekë e zënë shërbimet publike, kryesisht të natyrës pastrim, menaxhim mbetjesh etj., ndërsa transporti zë pjesën tjetër prej 63 milion lekë ose 29% të totalit.

Rigrupimi i këtyre njësive në një zonë funksionale do të bëjë të mundur përdorimin me efikasitet të burimeve financiare dhe mundësinë për të përmirësuar cilësinë dhe mbulimin me këto shërbime.

Tabela 12 Shpërndarja totale e shpenzimeve sipas funksioneve.

Kuçovë	Shpërndarja e shpenzimeve sipas funksioneve kryesore				
	Totali	Ujësjetës	Shërbime Publike	Transport	Të tjera
Shpenzime	352	9	231	74	38,0
% ndaj totalit	100%	3%	66%	21%	11%

Burimi: Ministria e Financave 2012, llogaritjet e autorëve

Përfundime

Bashkimi i njësive në zonën funksionale me qendër qytetin e Kuçovës do të sjellë uljen e shpenzimeve administrative dhe ato korrente të marra së bashku nga 220 milion në 186 milion lekë duke na dhënë një diferencë pozitive prej 34 milionë lekësh ose rreth 11% më pak se në rastin e funksionimit të veçuar të njësive që bashkohen.

Kjo diferencë do të bëjë të mundur që njësia e re, zona funksionale Kuçovë të rrisë shpenzimet vjetore për investime nga 37 milionë lekë në rreth 71 milionë lekë ose pothuajse dyfish më shumë, vetëm nga shkurtime të shpenzimeve administrative dhe korrente të marra së bashku.

Për sa i takon rrjetit rrugor dhe komunikimit, paraqitet relativisht i vështirë rasti i fshati Lumas (18 km) i cili është në distancë relativisht më të gjatë krahasuar me komunat e tjera të zonës. Distanca mesatare nga qendra e zonës është 9,4 km.

Ngarkesa e punonjësve për 1000 banorë do të ulet nga 6,6 punonjës në 5 punonjës duke rritur mundësinë për një personel më të kualifikuar dhe efikasitet financiar.

Zona funksionale Skrapar

Profili administrativo-territorial

Zona funksionale Skrapar përfshin 10 njësi territoriale administrative. Kjo zonë është ndërtuar rreth qendrës urbane (qendër rrethi) Çorovodë. Zona funksionale përfshihet qytetet Çorovodë dhe Poliçan si dhe komunat Gjerbës, Potom, Vendreshë, Zhepë, Bogovë, Cepan, Leshnjë, Qendër Çorovodë. Të gjitha komunat që përfshihen klasifikohen si zona bujqësore (ZB) fushore, kodrinore ose të përziera.

Figura 23 Harta e zonës funksionale Skrapar



Bashkia e Çorovodës paraqitet si qendër rrethi dhe komunikimi me interes administrativ dhe ekonomik, por edhe si qendër bujqësore.

Profili social-demografik

Zona funksionale Skrapar ka një popullsi totale prej 16 741 banorësh.

Tabela 13 Të dhëna bazë socio - demografike për këtë zonë funksionale.

Bashki/komuna	Statusi funksional – administrativ	Popullsia (2013)	Sip. km ²	Densiteti banorë/km ²	Sip. km ² /1000 banorë	Sip. bujqësore ha	Sip. ha/1000 banorë	Distanca në km nga qendra e zonës
Çorovodë	Q	4051	3	1500	1	204	50	0
Zhepë	ZB	799	107	7	134	1620	2028	37,7
Qendër	ZB	2545	127	20	50	2798	1099	2
Gjerbës	ZB	813	108	8	132	1223	1504	27
Leshnjë	ZB	496	82	6	165	714	1440	21
Potom	ZB	897	116	8	129	1255	1399	30
Çepan	ZB	740	87	9	118	1570	2122	21
Poliçan	Q	4318	4	1028	1	204	47	27
Vendreshë	ZB	984	56	18	57	1130	1148	11
Bogovë	ZB	1098	85	13	78	1224	1115	18
Shuma		16 741	774	21,62	46	11 942	713	194,7
Mesatare				353	45		770	35,40
Urbane		8369						
Rurale		2082						
% Urbane		50%						

Burimi: INSTAT 2012, llogaritjet e autorëve

Siç shihet edhe nga Tabela 13, 7 nga 10 njësitë e kësaj zone kanë një popullsi më të vogël ose rreth 1000 banorë. Sipas të dhënave statistikore rezulton se në zonën e re funksionale 50% e popullsisë jeton në zonë urbane ndërsa gjysma tjetër në zonë rurale.

Zona ka një sipërfaqe totale prej 774 km² ose 46 km²/1000 banorë dhe një sipërfaqe bujqësore totale prej 11 942 ha ose 713 ha/1000 banorë, ndërsa mesatarja para agregimit është rreth 770 ha/1000 banorë.

Dendësia e popullsisë në zonën funksionale është e vogël me rreth 22 banorë/1 km² krahasuar me mesataren prej 353 banorë/km² kur njësitë brenda zonës analizohen në mënyrë të veçantë. Si qendër rrethi, qyteti i Çorovodës siguron shërbime shtesë kryesisht administrative, komunikacioni dhe arsimore në një distancë dhe drejtim komod për banorët e komunave që përthithen në këtë zonë funksionale.

Profili ekonomiko-financiar

Shpenzimet Publike

Duke iu referuar të dhënave ekonomiko - financiare të vitit 2012, shuma e shpenzimeve totale për të gjitha njësitë e zonës është 211 milion lekë, ndërsa shpenzimet e personelit 110 milion lekë zënë 52% të totalit, shpenzimet operative për të gjitha njësitë (66 milion lekë) zënë rreth 31% të totalit, ndërsa shpenzimet për investime (35 milion lekë) zënë vetëm 17% të totalit.

Tabela 14 Shpenzimet para agregimit, njësitë e ZF, Çorovodë

Njësia	Popullsia 2011	Totali i shpenzimeve e 2012 (mln/lek)	Shpenzime Personel Total	Shpenzime operative	Shpenzime Investime
Çorovodë	4051	73	35	26	12
Poliçan	4318	45	30	15	0
Qendër	2545	21	10	4	7
Potom	897	7	4	3	0
Leshnjë	496	5	3	2	0
Çepan	740	10	6	4	0
Vendreshë	984	9	3	2	4
Bogovë	1098	20	7	5	8
Zhepë	799	9	6	3	0
Gjerbës	813	12	6	2	4
Shuma Shpenzime	16 741	211,0	110,0	66,0	35,0
Shpenzime/frymë (lek)		12 619	6579	3947	2093
% ndaj totalit			52%	31%	17%
Shpenzime për njësitë e tjera		138	75	40	23
Reduktimi i shpenzimeve për njësitë e tjera		211,0	22,5	12,0	103,5

Burimi: INSTAT 2012, llogaritjet e autorëve

Nga ulja e numrit të personelit për efekt të agregimit në një mesatare prej 70%, vlera e shpenzimeve për personelin do të ulet nga 110 milion në 57 milion lekë ose 27% e totalit. Po kështu, do të ulen shpenzimet operative nga 66 milion në 38 milion lekë ose në 18% kundrejt totalit të shpenzimeve.


Tabela 15 Shpenzimet pas agregimit, ZF Skrapar

Njësia	Popullsia 2011	Totali i shpenzimeve 2012 (000/lek)	Shpenzime Personel Total	Shpenzime operative	Shpenzime Investime
ZF Shuma Shpenzime	16 741	211	57,5	62	91,5
ZF Shpenzime/frymë		12 619	3439	3708	5472
ZF/gjendja ekzistuese %			52%	31%	17%
ZF % shpenzimeve ndaj totalit			27%	29%	43%

Burimi: Ministria e Financave 2012, llogaritjet e autorëve

Grafiku në vijim ilustron reduktimin e shpenzimeve të personelit dhe ato operative kundrejt rritjes së shpenzimeve për investime.


Figura 24 Ndryshimi i raportit të shpenzimeve vendore para dhe pas agregimit në zonën funksionale Skrapar



Burimi: Ministria Financave 2012, Ilogaritjet e autorëve

Nëse diferenca e shpenzimeve të kursyera për efekt të agregimit do të rishpërndahet në kursin e shpenzimeve, atëherë shpenzimet për investime në zonën funksionale do të rriten nga 35 milionë në rreth 91,5 milionë lekë duke e ndryshuar peshën e investimeve në buxhetin vendor nga 17% në 43% të totalit duke përfituar kështu një rritje pothuaj 3 herë kundrejt totalit të investimeve të njëjësive para agregimit.


Figura 25 Krahasimi i raportit të shpenzimeve ndaj totalit në zonën funksionale Skrapar



Burimi: Ministria e Financave 2012, Ilogaritjet e autorëve

E njëjta tendencë pozitive vërehet edhe kur krahasohet raporti i shpenzimeve totale për çdo banor ashtu si dhe raporti i shpenzimeve për investime për çdo banor të zonës funksionale duke dhënë një shpërndarje më të drejtë të shpenzimeve në përgjithësi.


Figura 29 Krahasimi i shpenzimeve totale/banorë të zonës funksionale Kuçovë ndaj njësive të veçanta



Burimi: Ministria e Financave 2012, llogaritjet e autorëve

Ndërsa grafiku në vijim ilustron shpenzimet e investimeve për banor në njësitë e veçanta krahasuar me shpenzimet e investimeve për banor në zonën funksionale Skrapar.

Figura 26 Krahasimi i shpenzimeve për investime/banorë të ZF Skrapar ndaj njësive të veçanta



Burimi: Ministria e Financave 2012, llogaritjet e autorëve

Administrata

Si rezultat i krijimi të zonës funksionale, numri i përgjithshëm i administratës parashikohet të ulet nga 351 punonjës në 178 punonjës pa llogaritur këtu numrin e këshilltarëve të këshillave të bashkive dhe të komunave.


Tabela 16 Ngarkesa administrative para dhe pas agregimit, ZF Skrapar

NJQV	Popullsia	Aktual		Zona funksionale	
		Nr.	Nr./1000 Banorë	Nr.	Nr./1000 Banorë
Çorovodë	4051	102	25,2	102	25
Qendër	2545	26	10,2	7,8	3
Bogovë	1098	25	22,8	7,5	7
Zhepë	799	16	20,0	4,8	6
Polican	4318	111	25,7	33,3	8
Vendreshë	984	12	12,2	3,6	4
Gjerbës	813	17	20,9	5,1	6
Çepan	740	15	20,3	4,5	6
Potom	897	12	13,4	3,6	4
Leshnjë	496	15	30,2	4,5	9

Burimi: Ministria Financave 2012, Ilogaritjet e autorëve

Ngarkesa e punonjësve për 1000 banorë do të ulet nga 21 punonjës në 10 punonjës duke rritur mundësinë për një personel më të kualifikuar dhe efikasitet financiar.

Figura 27: Shpenzimet e personelit për frymë në ZF Skrapar




Të dhëna të tjera për zonën funksionale

Komunikacioni dhe transporti

Zona ka një rrjet rrugor në gjendje jo të mirë dhe komunikimi në përgjithësi është i vështirë. Shtrirja e gjerë e zonës e vështirëson gjithashtu qarkullimin për efekt të distancave relativisht të gjata ndërmjet qytetit qendër (Çorovodë) veçanërisht me disa prej komunave përfshirë këtu komunën Zhepë (37,7 km), Gjerbë (25 km) dhe Potom (30 km) etj.

Të gjitha njësitë së bashku shpenzojnë rreth 23 milion lekë ose 11% të totalit të shpenzimeve për transport duke justifikuar kështu mesataren e lartë të distancës me rrugët kryesore dhe qendrën e rrethit.

Figura 28 Harta e distancave kohore



Furnizimi me ujë dhe kanalizime

Në zonë funksionon Sh.A UK Berat – Kuçovë i cili shfrytëzon burimet në Bogovë. Në zonë funksionon njëkohësisht Sh.U Poliçan që mbulon me shërbim bashkinë Poliçan dhe pjesërisht komunat Bogovë dhe Vendreshë, si dhe SH. A U Skrapar që mbulon me shërbim bashkinë Çorovodë dhe pjesërisht komunat e tjera në rreth.

Në kuadër të zonës funksionale mundet që gjithashtu të agregohen operatorët e Poliçanit dhe Skraparit në një kompani e cila do të mundësojë mbulimin me shërbim në të gjithë zonën funksionale.


Aktualisht vetëm dy njësi, Poliçani dhe Çorovoda, shpenzojnë rreth 15 milion lekë të marra së bashku ose rreth 7% të totalit të shpenzimeve prej 211 milion lekë si shumë e të gjitha njësite në zonën funksionale. Ndërsa asnjë prej komunave të tjera nuk shpenzon për këtë shërbim.

Shërbime të tjera publike

Pjesën më të madhe të shpenzimeve në shumën prej 129 milion lekësh ose 70% të totalit prej 240 milion lekësh e zënë shërbimet publike, kryesisht të natyrës pastrim, menaxhim mbetjesh etj., ndërsa transporti zë pjesën tjetër prej 63 milion lekësh ose 29% të totalit.

Figura 29 në vijim ilustron shpërndarjen e shpenzimeve sipas funksioneve kryesore në zonën funksionale Skrapar.

Figura 29 Shpërndarja e shpenzimeve sipas funksioneve kryesore ZF Skrapar.



Burimi: Ministria e Financave 2012, llogaritjet e autorëve

Agregimi i këtyre njësite në një zonë funksionale do të bëjë të mundur përdorimin me efikasitet të burimeve financiare dhe mundësinë për të përmirësuar cilësinë dhe mbulimin me këto shërbime.

Përfundime

Bashkimi i njësite në zonën funksionale me qendër qytetin e Çorovodës do të sjellë uljen e shpenzimeve administrative dhe ato korrente të marra së bashku nga 176 milion në 120 milionë lekë duke na dhënë një diferencë pozitive prej 56,5 milion lekësh ose rreth 50% më pak shpenzime administrative se në rastin e funksionimit të veçuar të njësite që bashkohen.

Kjo diferencë do të bëjë të mundur që njësi e re zona funksionale Skrapar të rrisë shpenzimet vjetore për investime nga 35 milionë lekë në rreth 92 milion lekë ose gati 3 herë

më shumë vetëm nga shkurtimeve administrative dhe korrente të marra së bashku.

Ngarkesa e punonjësve për 1000 banorë do të ulet nga 21 punonjës në 10 punonjës duke rritur mundësinë për një personel më të kualifikuar dhe efikasitet financiar.

Zona Funktionale Poliçan

Bashkia Poliçan dhe komunat Vërtop, Tërpan

Përfundime

Përfundimet e mëposhtme janë llogaritur për ZF Poliçan si njësi funksionale që qëndron më vete jashtë ZF Skrapar.

ZF Poliçan e përbërë nga 3 njësi vendore ekzistuese, ka popullsi prej 11,937 banorë, nga mesatarisht 2,984 banorë aktualisht në NJQV ekzistuese;

Reduktim i shpenzimeve administrative të njësisë me rreth 16,9 milionë lekë në vit, ose 21% e shpenzimeve administrative (shpenzime paga dhe operative) dhe 15% e shpenzimeve vjetore gjithsej;

Ulja e shpenzimeve të personelit për banor në masën 30%, nga 4,356 lekë në 3,066 lekë për banor;

Mirëadministrimi i burimeve financiare mund të sjellë rritje të investimeve pothuaj dyfish, ose nga 18 milionë lekë, në 34,9 milionë lekë në vit;


Investimet për banor mund të rriten nga 1,508 lekë, në 2,924 lekë për banor në njësinë e re;

Bashkimi në një zonë funksionale mund të sigurojë rishpërndarje më të mirë të të ardhurave duke zbutur pabarazitë e mëdha mes zonave; pa llogaritur efektet e eficiencës së rritur në menaxhimin e të ardhurave: mesatarisht ZF e re do të realizonte 2,530 lekë të ardhura të veta për frymë, ose 18% më shumë se mesatarja e të ardhurave të veta për frymë në njësitë ekzistuese (2,136 lekë) dhe 31% më shumë se mediani i të ardhurave të veta për frymë në këto njësi (1,936 lekë);

QARKU DIBËR

Profili i qarkut Dibër

Figura 30 Qarku Dibër



Harta e qarkut Dibër

Sipas Zyrës së Gjendjes Civile të qarkut numri i popullsisë së qarkut Dibër është 190 000 banorë, e cila përbën rreth 4% të popullsisë së të gjithë vendit dhe është e shpërndarë në 35 NJQV: 4 bashki dhe 31 komuna ku përfshihen 276 fshatra. Megjithatë, sipas Census-it numri i popullsisë më 2011 ishte 137 047. Tabela e mësipërme paraqet numrin e popullsisë në vitet 2001 e 2011, dallimet ndërmjet tyre, sipërfaqen e NJQV-ve dhe dendësinë e popullsisë. Këto NJQV janë të grupuara në tre grupe që përbëjnë dhe rrethet ekzistuese të qarkut, të barasvlershme me zonat funksionale të rrethit të propozuara (ZF-të e rrethit), të cilat do të referohen në mënyrë të tillë në këtë dokument.

ZF-ja e rrethit të Dibrës përfshin 15 NJQV me një popullsi prej 61 619 banorë, ZF-ja e rrethit Mat ka 12 NJQV me një popullsi prej 44 218 dhe ZF-ja e rrethit Bulqizë ka 8 NJQV dhe një popullsi prej 31 210 banorë. Komuna Tomin ka një numër popullsie të barabartë me bashkitë e Bulqizës dhe të Klosit dhe komuna Maqellarë ka popullsi të njëjtë me bashkinë e Burrelit.

Ndërmjet dy regjistrimeve vihet re një rënie dramatike e numrit të popullsisë prej 53 988 banorë dhe që nga viti 2001 vërehet një rënie prej 28% (në të gjithë vendin numri i popullsisë është ulur me 11%). Reduktimi në bashkitë kryesore varion nga 6-22%, ndërsa në të katra komunat është më shumë se 50%, ku vetëm komuna Zall Reç ka një reduktim popullsie prej

dy të tretash. Dendësia mesatare e popullsisë në të gjithë qarkun është 56 banorë/km² (mesatarja kombëtare është 98 banorë/km²), ndërsa dendësia ndërmjet NJQV-ve varion nga 9 banorë/km² (Lurë) deri në 8282 banorë/km² (Peshkopi; Tirana ka një shifër prej 4987 banorë/km²). Nga të gjitha komunat, dendësinë më të madhe të popullsisë (146 banorë/km²) e ka Fushë-Çidhen, ndërsa Klosi ka dendësinë më të vogël nga të gjitha komunat (61banorë/km²). Popullsia urbane përbën 29% të numrit total të popullsisë, ku popullsia e Peshkopisë përbën 10%; popullsia e Burrelit 8%, popullsia e Bulqizës 6% dhe popullsia e Klosit 6%. Të dhënat e qarkut për vitin 2010 tregojnë se 24% e popullsisë përbëhet nga grupmoshat 0-14 vjeç, 50% nga grup-moshat 15–64 vjeç dhe 26% nga moshat mbi 65 vjeç. Në vitin 2008 raporti i moshës së re kundrejt asaj të vjetër ishte rreth 4 me 1.

Figura 1. Numri i popullsisë, ndryshimi, sipërfaqja (S) dhe dendësia e popullsisë së 35 NJQV-ve të tre zonave funksionale të qarkut Dibër (2001–2011)

Zonat funksionale	NJQV-të	Regjistrimi i popullsisë		Ndryshimi		S (km ²)	Dendësia
		2001	2011	Nr.	% [#]		
Dibër	B. Peshkopi	14 136	13 251	-885	-6	1,6	8281,9
	Q. Tomin	10 269	7590	-2679	-26	63,5	119,5
	Lurë	2050	1096	-954	-47	125,5	8,7
	F. Muhurr	4047	2780	-1267	-31	50,2	55,4
	Selishtë	3142	1605	-1537	-49	90,7	17,7
	K. e Dodës	4036	2252	-1784	-44	75,4	29,9
	Zall Dardhë	2169	1051	-1118	-52	39,6	26,5
	Zall Reç	1975	681	-1294	-66	46,3	14,7
	Fushë-Çidhen	4217	2909	-1308	-31	20,0	145,5
	Luzni	3800	2433	-1367	-36	39,8	61,1
	Maqellarë	12 627	10 662	-1965	-16	87,2	122,3
	Melan	5501	3649	-1852	-34	65,6	55,6
	Kastriot	8517	6200	-2317	-27	63,4	97,8
	Sillovë	4492	2405	-2087	-46	78,0	30,8
	Arras	5166	3055	-2111	-41	50,8	60,1
		86 144	61 619	-24 525	-28	957	68,6
Dibër në total							
Mat	Komsi	6149	4283	-1866	-30	99,7	43,0
	Ulëz	2063	1229	-834	-40	59,1	20,8
	Rukaj	4705	2507	-2198	-47	39,4	63,6
	Derjan	2601	1102	-1499	-58	64,0	17,2
	Lis	4978	3824	-1154	-23	76,3	50,1
	Baz	3374	2228	-1146	-34	81,1	27,5
	Macukull	3496	1565	-1931	-55	98,6	15,9
	Burrel M.	12 139	10 862	-1277	-11	2,9	3745,5
	Gurrë	4365	3369	-996	-23	72,5	46,5
	Klos M.	10 552	7873	-2679	-25	129,3	60,9
	Xibër	3870	2660	-1210	-31	88,1	30,2
Suç	3614	2716	-898	-25	41,2	65,9	
Mati në total		61 906	44 218	-17 688	-29	2804	51,9
Bulqizë	Shupenzë	6847	5503	-1344	-20	86,7	63,5
	Gjoricë	5336	4214	-1122	-21	34,8	121,1
	Zerqan	6174	4111	-2063	-33	127,5	32,2
	Martanesh	3540	1836	-1704	-48	169,2	10,9
	Bulqizë M.	10 475	8177	-2298	-22	45,5	179,7
	F-Bulqizë	4168	3342	-826	-20	67,8	49,3
	Trebisht	1590	993	-597	-38	53,0	18,7
	Ostren	4855	3034	-1821	-38	96,3	31,5
Bulqiza në total		42 985	31 210	-11 775	-27	6323	45,8
Totali		191 035	137 047	-53 988	-28	2431,0	56,0

Burimi: Këshilli i qarkut Dibër: me shkronja të zeza jepet ndryshimi > 20%; me ngjyrë të verdhë jepet ndryshimi prej 31–40%; me portokalli jepet ndryshimi 41–50% dhe me të kuqe jepet ndryshimi > 50%

Qarku i Dibrës ndodhet në verilindje të Shqipërisë, në zonën qendrore malore dhe me një sipërfaqe prej 2431 km² (9% të sipërfaqes së vendit), me tokë bujqësore relativisht të kufizuar (15%) dhe me më shumë pyje dhe kullota (25%), ndërsa pjesa tjetër (60%) është kryesisht sipërfaqe malore. NJQV-të me përqindjen më të madhe të tokës bujqësore janë komunat e Fushë Çidhen (47%), Tomin (40%), Kastriot (38%) dhe Gjoricë (35%), ndërsa Ulza (68%), Arrëza (66%), Zall Reçi (64%) dhe Melani (63%) kanë kryesisht pyje dhe kullota. Aktualisht, përdorimi i tokës bujqësore në qark përbën 0,22 ha për frymë duke e krahasuar me nivelin kombëtar prej 0,67 ha. Që nga viti 2001 ka pasur një rritje të madhe prej (19%) në përqindjen e tokës së përdorur për bujqësi, kjo ndoshta e lidhur me shpopullimin në masë të gjerë. Ndërtimi i hidrocentralit të Skavicës do të ndikojë shumë në përdorimin e tokës, mbase duke reduktuar përqindjen e tokës së përdorur për bujqësi.


Ndërveprimi ekonomik

Aktiviteti ekonomik

Katër bashkitë janë pikat kryesore të tërheqjes në qark për sa i përket punësimit, tregtisë, arsimit dhe shëndetësisë, ku njerëzit vijnë nga komunat më rurale për të pasur akses në këto shërbime. Banorët e qarkut frekuentojnë në një shkallë më të vogël tregun e Lisit, Shupenzës dhe Ostrenit, dhe përtej kufirit me Maqedoninë, tregun e Dibrës së Madhe, sikurse edhe tregjet në qendrat më të lagëta të vendit Durrës Tiranë. Edhe pse komuna Klos ka një qendër shëndetësore dhe 14 infermiere, shumë banorë i marrin shërbimet shëndetësore në Burrel.

Qarku Dibër ka nivelin më të ulët të PBB-së në vend, për afërsisht 60% të nivelit kombëtar.² Bujqësia, nxjerrja e mineraleve, peshkimi dhe pyjet përbëjnë pjesën më të madhe (35%) të vlerës së shtuar bruto³. Aktivitetet ekonomike dhe sociale janë të përqendruara kryesisht në bashkitë e Bulqizës, Burrelit dhe Peshkopisë dhe më pak në Klos. Që nga viti 2002, numri i sipërmarrjeve aktive jobujqësore është rritur ndjeshëm me 435%.

Figura 3: Vlera e shtuar bruto për sektor në vitin 2009



Burimi: INSTAT

² Pabarazitë rajonale në Shqipëri (2010), tabela 11, vlerat e PBB-së për frymë për qark (2007) fq. 47

³ VSHB = PBB + subvencionimet – taksat (e shitjeve të drejtpërdrejta)

Figura 4: Sipërmarrje aktive jobujqësore për 10 000 banorë (2002–2010)

Sipërmarrje aktive jobujqësore	2002	2004	2006	2008	2010
Numri	25	44	70	106	135

Burimi: Drejtoria e Tatimeve e qarkut Dibër

Numri më i madh i sipërmarrjeve aktive jobujqësore gjendet në Burrel (396), Peshkopi (380) dhe në Bulqizë (326). Në zonat rurale, numri më i madh i tyre në raport me numrin e popullsisë është në Martanesh, kryesisht për shkak të emigracionit dhe pranisë së një numri të madh biznesesh, të cilat janë të lidhura me aktivitetet e nxjerrjes së mineralit të kromit. Të dhënat nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve tregojnë se numri i sipërmarrjeve të reja të krijuara dhe të rikrijuara në vitin 2002 ishte 36, ndërsa në vitin 2010 ky numër arrinte në 235, edhe pse numri i sipërmarrjeve të huaja u ul 5,5 herë gjatë asaj periudhe.

Figura 5: Sipërmarrje aktive jobujqësore të reja për 10 000 banorë (2002–2010)

Sipërmarrje jo bujqësore të krijuara të reja	2002	2004	2006	2008	2010
Numri	1,6	7,7	11,3	16,3	12,4

Burimi: Drejtoria e Tatimeve e qarkut Dibër

Sipas “Raportit diagnostikues të çështjeve ekonomike” në qark ndodhen 192 biznese të mëdha, 41 biznese të mesme dhe 2954 biznese të vogla. Ndërkohë, Drejtoria e Tatimeve të qarkut të Dibrës raporton se të ardhura nga bizneset e vogla arrijnë në 32 149 000 lekë, nga të cilat 15 609 000 lekë janë të ardhura nga ZF-ja e rrethit Dibër, 10 116 000 lekë të ardhurat nga ZF-ja e rrethit Mat dhe 6 424 000 lekë të ardhurat nga ZF-ja e rrethit Bulqizë. Një analizë më e detajuar e shpërndarjes së bizneseve paraqitet më poshtë nën analizën e zonave funksionale.

Në qark ndodhen më shumë se 2500 sipërmarrje aktive jobujqësore, pjesa më e madhe e të cilave përfshijnë sektorët e shërbimeve (36%), tregtisë (34%) dhe transportit 19% dhe pjesa më e madhe e tyre (84%) kanë aktivitet në bashkitë kryesore. Pothuajse të gjitha këto sipërmarrje (90%) punësojnë të paktën një person.

Figura 6: Sipërmarrjet aktive jobujqësore në ZF-në e rrethit Dibër, për sektor (2010)

ZF	Tregti	Ndërtim	Prodhim	Shërbime	Transport	Totali
Dibër	370	25	57	401	219	1072
Mat	294	56	51	326	147	874
Bulqizë	208	23	49	200	121	601
Qark	872	104	157	927	487	2547

Burimi: Drejtoria Rajonale e Tatimeve

Në qarkun e Dibrës punëdhënësi kryesor është shteti me një numër total punonjësish prej 5865, 50% më shumë se sektori privat (3872), me përjashtim të bujqësisë. Megjithatë, numri i punonjësve në bizneset bujqësore arrin 15 546. Eksporti kryesor nga Dibra përfshin produktet e industrisë së minierave, me një vlerë eksporti prej 2,672 bilion lekë (18,8 mln Euro) për vitin 2010.

Duke u bazuar në shifrat e paraqitura më sipër, sektori kryesor i ekonomisë së qarkut është


bujqësia, i cili përbën 61% të punësimit në rajon. Megjithatë, pjesa më e madhe e produkteve bujqësore dhe gjësë së gjallë dhe nënprodukteve janë për përdorim shtëpiak, ndërsa disa produkte arrijnë tregun e gjerë, kryesisht fasulet, mishi dhe mjalti. Midis viteve 2006 dhe 2010, sasia e tokës së kultivuar në qark u rrit me 1089 ha (rreth 11 km²), çka tregon interesin dhe rëndësinë e bujqësisë në ekonominë e saj.

Një tjetër sektor potencial është turizmi malor, i cili frekuentohet si për parqet natyrore edhe për banjat termale, por ka një karakter sezonal edhe prej aksesit më të vështirë në dimër.

Tregjet


Studimi për zonat funksionale në Shqipëri (Helvetas, DLDP, 2014) përfshin modelet e konsumit në qarkun Dibër si më poshtë, duke treguar lëvizjet e popullsisë. Tre tregjet kryesore janë tre qytetet kryesore të Peshkopisë, Burrelit dhe Bulqizës (qytetet kryesore në secilën prej tre ZF-ve të rrethit) dhe në një shkallë më të vogël tregu i qytetit të Klosit, Tiranës-Durrësit dhe Dibrës së Madhe e Maqedonisë, të ndjekura nga Lisi, Shupenza dhe Ostreni.

Figura 8: Tregjet kryesore në qarkun Dibër (me ngjyrë blu jepet tregtia kryesore; me jeshile jepet tregtia e vogël)



Lëvizjet për punësim

Në mbështetje dhe të argumentit që rezultojnë nga tregjet kryesore, edhe paraqitja grafike e lëvizjeve për punësim që jepet me poshtë rikonfirmon zonat funksionale me qendër në Peshkopi, Burrel dhe Bulqizë.



Burimi: MÇV; Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve

Nëpërmjet lëvizjeve për punësim vlerësojmë edhe shërbimet, partneritetet, rrjetin e infrastrukturave etj. Sikurse ilustron në hartë, lëvizjet për punësim ndjekin gjithashtu qendërsitë e krijuara, përqendrimin e bizneseve në qarkun Dibër.

Për sa i përket tipareve kryesore, vihet re se më shumë se gjysma e popullsisë (53%) është në moshë për punë, por ka nivel të lartë papunësie dhe pasiviteti. Megjithatë barrën kryesore në punësim e mban sektori bujqësor dhe midis viteve 2002 dhe 2010 ka pasur një rritje të madhe si në bujqësi (56%), ashtu edhe në sektorin privat jobujqësor (45%), ndërsa punësimi në sektorin publik është reduktuar me 24%. Gjatë kësaj periudhe popullsia ekonomike aktive e qarkut është rritur me 50%, edhe pse përbën vetëm 54% të popullsisë në moshë pune. Në vitin 2010, struktura e forcës së punës me bazë gjinore përbëhej nga 13% femra kundrejt 87% meshkuj. Ndërsa nga vitet 2002-2010, pjesëmarrja e grave në fuqinë punëtore u reduktua me 70%, ndërsa pjesëmarrja e meshkujve në fuqinë punëtore u rrit me 37%, si rrjedhojë e pezullimeve të konsiderueshme në sektorin publik. Përqindja e papunësisë së regjistruar është 16%; pra vërehet një ulje prej 43% në krahasim me shifrën 28% në vitin 2002.

Kohezioni social

Sipas LSMS 2012, 13% e popullsisë së qarkut jeton në varfëri, ku 2,3% jeton në varfëri të thellë dhe 0,7% në varfëri ekstreme. Në nivel krahasues, mesatarja kombëtare është 14,3%, 2,9 % dhe 1%. Megjithatë, shifra e konsumit për frymë prej 9862 lekë është pothuajse e njëjte me atë të Kukësit, qarkun më të varfër në vend, ku pjesa më e madhe e qarqeve kanë një shifër prej 11 000 lekësh ose më shumë. Aktualisht (2014), numri i familjeve që marrin asistencë sociale është 12 491, nga të cilat 1192 familje marrin asistencë të plotë dhe 11 299 marrin asistencë të pjesshme. Pra, vërehet një reduktim prej 50% për asistencën e plotë dhe 26% për asistencën e pjesshme. Pothuajse të gjitha familjet (98%) që marrin asistencë ekonomike të plotë banojnë në zonat urbane, ku numri për 10 000 banorë zë 305% të mesatares rajonale (në Peshkopi shifrat janë rritur me 72% që nga viti 2002). Ndërkohë, pothuajse të gjitha pagesat e asistencës ekonomike të pjesshme shkojnë në familjet rurale.

Shëndetësia

Numri i qendrave shëndetësore mbetur i pandryshueshëm, konkretisht në 2 për 10 000 banorë: 1,8 për bashkitë dhe 2,1 për komunat. Në vitin 2010, komunat e Muhurit, Sillovës, Recit, Gjorishtit dhe Trebishtit nuk kishin një qendër shëndetësore. Për më tepër, ndodhen 10,8 ambulanca për 10 000 banorë, ku bashkitë (5,6) kanë më pak se gjysma në krahasim me komunat (13,2). Ndërmjet viteve 2002 dhe 2010 numri i ambulancave në qark u rrit me 191 të tilla, kryesisht në komuna. Që nga viti 2010, numri i qendrave shëndetësore është rritur me rreth 10%: një analizë më e detajuar jepet nën zonat funksionale të rrethit, ku termi qendër shëndetësore përfshin ambulancat dhe të dhënat e NJQV-së janë për vitin 2014.

Në vitin 2010, numri i shtretërve spitalorë për 10 000 banorë ishte 30, një rritje prej 70% në krahasim me vitin 2002 (numri i tyre në Burrel u rrit me më shumë se 200% dhe në Bulqizë me 85%). Shifrat për frymë janë përmirësuar për shkak të shpopullimit në masë të gjerë. Nga viti 2002 deri në vitin 2010 numri i vizitave për 10 000 banorë u rrit me 23% më shumë te bashkitë (Burreli mesatarisht 183% ; Klosi 155%; Peshkopia 149%) dhe shtatë komunat (Komsa 182%; Derjan 159%). Sipas LSMS (2012) koha mesatare e udhëtimit për te doktori ose për në qendrën shëndetësore në zonat rurale ishte 23 minuta dhe në zonat urbane ishte 11 minuta, me një mesatare të përgjithshme prej 20 minutash në krahasim me kohët mesatare në të gjithë vendin, përkatësisht 19, 15 dhe 18 minuta. Për rrjedhojë, në Dibër, udhëtimi për te mjeku ishte pak më i gjatë në zonat rurale sesa mesatarja e përgjithshme e të gjithë vendit, por ishte më i shpejtë në zonat urbane. Me të vërtetë, këto ishin më të shpejtat e më të ngadaltat, përkatësisht në të gjithë qarqet. Për njerëzit që jetojnë në varfëri, mesatarja e qarkut ishte 24 minuta dhe për ata që jetojnë relativisht më mirë ishte 19 minuta, duke e krahasuar me kohën mesatare të vendit përkatësisht 20 dhe 17 minuta. Këto kohë udhëtimi ishin më të gjatat në vend. Sipas Ministrisë së Shëndetësisë, Institutit të Shëndetit Publik dhe INSTAT-it (2014), qarku kishte 0,22 spitale, 4,5 qendra shëndetësore, 8,3 mjekë dhe 37,2 shtretër për 10 000 banorë, në krahasim me mesataret e vendit, të cilat ishin përkatësisht 0,16, 6,0, 12,2 dhe 29,7 . Për këtë arsye, në Dibër ka pak më shumë spitale dhe shtretër për 10 000 banorë sesa në të gjithë vendin, por më pak qendra shëndetësore dhe më pak mjekë për 10 000 banorë.

Arsimi

ZF-ja e rrethit Dibër ka dyfishin e numrit të shkollave për secilin nivel në krahasim me Bulqizën dhe të njëjtin numër shkollash fillore, një të katërtat më shumë kopshte dhe një të tretat më pak shkolla të mesme se Mati. Gjithsesi, duke marrë parasysh numrin e popullsisë (p.sh. në llogaritjen e numrit të shkollave për 10 000 banorë) shifrat janë të njëjta në të tria ZF-të e rrethit, me shifra pak më të larta për Matin. Meqenëse infrastruktura shpesh herë është ajo e para vitit 1990, ngjashmëria duhet të jetë për shkak të përqindjes së njëjtë të popullsisë emigruese nga secili rreth i ZF-së së rrethit (emigrim jashtë ose diku në Shqipëri, si për shembull në Tiranë) dhe drejt bashkisë kryesore të ZF-së së rrethit. Megjithatë, sikurse theksohet nga raporti për arsimin, ka pasur një ndarje të gjerë midis infrastrukturës rurale dhe asaj urbane që tregon lëvizjen nga zonat rurale për në zonat urbane, dhe kjo është e pandryshueshme në të tria ZF-të e rrethit, edhe pse më pak në Mat sesa në dy ZF-të e tjera. Nga ky këndvështrim, e veçanta e Matit vjen nga fakti se ZF-ja e rrethit ka dy bashki në krahasim me një bashki që ka Bulqiza dhe Dibra. Më poshtë diskutohen në mënyrë më të detajuar të dhënat për treguesit arsimor për secilën zonë funksionale të rrethit.

Numri i shkollave në zonat rurale dhe urbane

Numri i kopshteve në zonat rurale të qarkut Dibër variojnë nga 1-16 dhe në zonat urbane nga 4-12, numër ky që rritet me rritjen e numrit të popullsisë dhe dendësisë në zonat rurale, por që qëndron relativisht i pandryshueshëm në zonat urbane. 83% e shkollave fillore të Dibrës gjenden në komuna.

Figura 9: Të dhënat për treguesit arsimorë për ZF-në e rrethit Dibër

Treguesi		Dibër			Mat			Bulqizë		
		Kopshte	shkollat fillore	shkollat e mesme	kopshte	shkollat fillore	shkollat e mesme	kopshte	shkollat fillore	shkollat e mesme
Nr. i shkollave	në total	68	40	8	55	38	12	34	20	5
	rural	63	36	6	38	27	7	30	18	4
	urban	5	4	2	17	11	5	4	2	1
Fëmijët e regjistruar	në total	1907	12 218	2804	1342	7944	2510	806	5871	1230
	rural	1315	9226	1014	660	4123	771	548	4196	544
	urban	592	2992	1790	682	3821	1739	258	1675	686
Nr. i mësuesve	në total	128	797	121	87	512	134	53	334	56
	rural	80	656	50	40	302	51	31	260	26
	urban	48	141	71	47	210	83	22	74	30
Fëmijë: Mësues	në total	15	15	23	15	16	19	15	18	22
	rural	16	14	20	17	14	15	18	16	21
	urban	12	21	25	15	18	21	12	23	23
Nr. i shkollave /10 000 banorë	në total	11,0	6,5	1,3	12,4	8,6	2,7	10,9	6,4	1,6
	rural	10,2	5,8	1,0	8,6	6,1	1,6	9,6	5,8	1,3
	urban	0,8	0,6	0,3	3,8	2,5	1,1	1,3	0,6	0,3
Nr. i mësuesve /10 000 banorë	në total	21	129	20	20	116	30	17	107	18
	rural	13	106	8	9	68	12	10	83	8
	urban	8	23	12	11	47	19	7	24	10

Burimi: Ministria e Arsimit dhe Sporteve, përlogaritjet e autorëve

Numri i shkollave rritet me rritjen e numrit të popullsisë si në zonat rurale, ashtu edhe në ato urbane, ndërsa numri për 10 000 banorë reduktohet. Shkollat e mesme, të cilat përbëjnë 68%, ndodhen në pothuajse më shumë se gjysmat e komunave, ndërsa 45% e komunave nuk kanë shkollë të mesme. Numri i fëmijëve të regjistruar në kopshtet e zonave rurale varion nga 20-397, ndërsa në zonat urbane ky numër shkon nga 258-592 fëmijë. Shumë më tepër fëmijë përdorin ato pak kopshte në zonat urbane sesa kopshtet e shumta në zonat rurale. Për si i përket shkollave fillore, numri i fëmijëve të regjistruar në zonat rurale varion nga 158–2020, ndërsa në zonat urbane ky numër shkon nga 1470–2992 fëmijë. Në shkollat e mesme, numri i fëmijëve të regjistruar në zonat rurale varion nga 12-427, ndërsa në zonat urbane ky numër varion nga 469–1790, shifër e cila rritet dyfish me rritjen e numrit të popullsisë dhe dendësisë në zonat urbane sesa në zonat rurale.

Numri i mësuesve që punojnë në kopshtet në zonat rurale varion nga 1-19, ndërsa në zonat urbane kjo shifër varion nga 15-48. Numri i mësuesve të kopshteve është rritur në përpjesëtim të drejtë me dendësinë e popullsisë, por më shpejt në zonat urbane sesa në zonat rurale. Numri i mësuesve që punojnë në shkollat fillore të zonave rurale varion nga 12-116 ndërsa në zonat urbane nga 74-141, pa ndonjë dallim të dukshëm ndërmjet tyre me rritjen e numrit të popullsisë. Numri i mësuesve të shkollave të mesme në zonat rurale varion nga 2-18 dhe në

zonat urbane nga 23-71 mësues , ku ky numër rritet dyfish në raport me rritjen e numrit të popullsisë dhe dendësisë në zonat urbane sesa në zonat rurale.

Në kopshte, numri i fëmijëve për mësues varion nga 9-24 në zonat rurale dhe nga 12-18 në zonat urbane, me një reduktim të vogël në raport me rritjen e numrit të popullsisë. Në shkollat fillore raporti ndryshon nga 8-18 në zonat rurale dhe nga 15-23 në zonat urbane dhe ky raport rritet në mënyrë të qëndrueshme me rritjen e numrit të popullsisë. Megjithatë, ka pasur një ndryshim të dukshëm në raportin fëmijë-mësues sipas vendbanimit me rritjen e dendësisë së popullsisë. Në shkollat e mesme ky raport u luhet nga 6-25 në zonat rurale dhe nga 20-25 në zonat urbane. Nuk ka pasur shumë ndryshime për sa i përket numrit të fëmijëve për mësues në shkollat e mesme të zonave rurale dhe urbane.

Zonat rurale kishin dy herë më shumë kopshte për 10 000 banorë sesa zonat urbane me rritjen e dendësisë së popullsisë. Numri i shkollave fillore për 10 000 banorë ka rënë në mënyrë të qëndrueshme kundrejt rritjes së numrit të popullsisë, me një dallim të vogël në përqindjen e reduktimit ndërmjet zonave rurale dhe atyre urbane. Gjithsesi, zonat rurale kishin mesatarisht katër herë më shumë shkolla fillore për 10 000 banorë sesa zonat urbane. Një model i ngjashëm u vu re për shkollat e mesme në zonat rurale dhe urbane të Dibrës.

Numri i mësuesve të kopshteve për 10 000 banorë varion nga 3-33 në zonat rurale dhe nga 19-36 në zonat urbane, me një rritje të qëndrueshme të numrit të mësuesve me rritjen e dendësisë së popullsisë (ndryshe nga situata e përgjithshme në të gjithë vendin; shih përmbledhjen ekzekutive të raportit diagnostikues të arsimit). Numri i mësuesve të shkollës fillore për 10 000 banorë varion nga 89-294 në zonat rurale dhe nga 90-122 në zonat urbane, me një shtrirje më të gjerë sesa në të gjithë vendin. Numri i mësuesve të shkollave të mesme për çdo 10 000 banorë në zonat rurale varion nga 12-64, ndërsa në zonat urbane ky numër shkon nga 29-55. Ndryshe nga situata e përgjithshme, në shkollat e mesme të Dibrës ka pasur një numër të barabartë mësuesish për 10 000 banorë si në zonat urbane, ashtu edhe në ato rurale.

Mjedisi

Qarku i Dibrës përshkohet nga lumi i Matit dhe lumi Drini i Zi -. Ujërat e këtyre lumenjve konsiderohen të një cilësie të mirë e me nivele të ulëta ndotjeje. Terreni malor në disa pjesë të rezervuarve të lumit i bën ata të përshtatshëm si burime të hidroenergjisë. Në vitin 2012 kishte shtatë hidrocentrale me një kapacitet prej 55 MW. Shtatë stacione të reja të vogla me një kapacitet total prej 40 MW priten që të vihen në funksion së shpejti. Aktualisht është duke u diskutuar kryerja e një investimi të madh në lumin Skavica. Liqenet e shumtë të qarkut kanë një potencial për vaditje dhe peshkim. Gjithashtu, ndodhen dhe shumë burime minerare: kromi (Bulqizë), mermeri (Muhur) dhe gipsi (Mali i Korabit). Niveli i ndotjes së ajrit është i ulët pasi aktivitetet e ndërtimit janë të kufizuara dhe nuk ka prodhim të industrisë së rëndë. Mbetjet urbane përlllogariten të jenë 0,09 tonë për banor, 32% më pak se në vitin 2004. Të dhënat për pjesën më të madhe të komunave nuk janë të disponueshme pasi në shumë lokalitete të vogla nuk janë ngritur shërbimet e menaxhimit të mbetjeve.

Infrastruktura dhe shërbimet

Transporti rrugor

Në qarkun Dibër ka 527 km rrugë me propozime për të zgjatur distancën e përgjithshme. Edhe pse akseset ndaj dhe brenda rajonit mbetet problematik, situata është përmirësuar

ndjeshëm gjatë dhjetë viteve të fundit. Gjatësia e rrugëve ndërrurbane është 272 km, e ndarë midis tre zonave funksionale të rrethit. Pjesa më e madhe e vendbanimeve, me përjashtim të atyre që gjenden përgjatë rrugëve kryesore, ndodhen më shumë se 25 km larg nga rrugët kombëtare. Peshkopia është qendra e vetme që nuk ka akses të drejtpërdrejtë në korridorin kombëtar.

Figura 10: Km rrugë në ZF-në e qarkut Dibër

ZF	Rrugët		
	Rurale	E propozuara	Ndërrurbane
Mat	273	273	92
Bulqizë	137	148	68
Dibër	117	195	112
Qark	527	616	272

Burimi: INSTAT, 2011

Vetëm pjesa perëndimore e qarkut ka një kohëzgjatje udhëtimi relativisht të shkurtër prej 1-2 orë deri në aeroportin e Rinasit. Ndërlirimet administrative dhe të patentave kanë sjellë një kosto të lartë për ofruesit e transportit rrugor, të cilët ofrojnë një shërbim të copëzuar dhe me cilësi të dobët.

Aksesi ndaj ujit të pijshëm dhe trajtimi i ujërave të zeza

Të dhënat e INSTAT-it tregojnë se 49% e popullsisë së qarkut ka akses në sistemit të ujit të pijshëm. Pavarësisht përmirësimeve në dekadën e kaluar, vetëm tre qytetet kryesore furnizojnë me ujë të pijshëm më shumë se 90% të banesave.

Figura 11: Numri i banesave që furnizohen me ujë në ZF-të e qarkut Dibër

ZF e rrethit	Banesa		
	Nr.	Nr. me ujë	%
Dibër	12 261	4933	40,2
Mat	10 013	5074	50,7
Bulqizë	6673	4098	61,4
Qark	28 947	14 105	48,7

Burimi: INSTAT, 2011

Vetëm 35% e qarkut ka akses në këtë shërbim, kryesisht popullsia urbane (84%). Komunitat përdorin gropat septike, ku vetëm 8 komuna kanë akses të pjesshëm në trajtimin e ujërave të zeza (më pak se 50% e banorëve).

Komunikimi elektronik

Komunikimi me anë të telefonisë fikse dhe celulare dhe shërbimet e Internetit është përmirësuar ndjeshëm gjatë viteve 2002-2010. Telefonia fikse është e disponueshme vetëm në zonat urbane. Kjo shpjegon rritjen e ndjeshme (43%) në numrin e shtëpive me të paktën një telefon celular: në vitin 2010 91% e familjeve kishte të paktën një telefon të tillë. Rritja më e madhe ka qenë në komuna (95%). Shërbimet e internetit mbeten të kufizuara. Gjatë viteve 2008-2010 shërbimi ADSL u rrit me 11%, ndërsa për sa i përket numrit të kontratave në zonat urbane dhe numrit të personave që kanë një adresë emaili është vërejtur një rritje prej 68%.

Financat lokale


Figura 12: Të ardhurat totale për frymë të NJQV-ve (2012)

< 80% e mesatares së qarkut		81–120 % e mesatares së rajonit		> 120% e mesatares së rajonit	
Maqellarë	38	Gjoricë	81	Ostren	126
Xibër	39	Bulqizë M.	82	Zall Dardhë	163
F-Bulqizë	39	K. e Dodës	89	Derjan	179
Komsi	42	Peshkopi M.	94	Macukull	187
Kastriot	45	F. Muhurr	95	Selishtë	196
Q. Tomin	48	Gurrë	101	Trebisht	214
Rukaj	66	Sillovë	103	Ulëz	217
Lis	71	Arras	111	Luzni	233
Shupenzë	74	Fushë-Çidhen	112	Zall Reç	447
Zerqan	76	Suç	113	Martanesh	490
Klos M.	77	Melan	116	Lurë	538
		Baz	117		
		Burrel M.	120		

Burimi: Ministria e Financave, llogaritjet e autorëve

Në vitin 2012, nivelet më të larta të të ardhurave shënohen në komunat Lurë 538%, Martanesh 490%, Zall Reçi 447%, Luzni 233%, Ulëz 217%, dhe Trebisht 214%, të gjitha me nivel të ardhurash dy herë më të lartë se mesatarja rajonale. Nivelet më të ulëta të të ardhurave janë gjithashtu në komuna të tilla si Maqellara 38%, Xibra 39%, Fushë-Bulqiza 39%, Komsi 42%, Kastrioti 45% dhe Tomini 48%, ku të gjitha kanë nivele më të ulëta se mesatarja në të gjithë qarkun.

Figura 13. Të ardhurat totale për frymë të NJQV-ve si % mesatare për qarkun Dibër



Burimi: Ministria e Financave, llogaritjet e autorëve

Pabarazia ndërmjet NJQV-ve është edhe më e dukshme në masën relative të të ardhurave të tyre për frymë. Vetëm tre nga komunat i kanë të ardhurat e tyre për frymë mbi mesataren e qarkut, përkatësisht Trebishti 161%; Ulëza 166%; Martaneshi 349%, , me Martaneshin në krye të listës, gjë që mund të jetë pasojë e mundshme e reduktimit me 48% të numrit të popullsisë midis viteve 2001 dhe 2011 (reduktimi më i madh në ZF-në e rrethit Bulqizë). Tre nga katër bashkitë e kanë nivelin e të ardhurave për frymë më të lartë se dyfishi i mesatares së qarkut. Nga ana tjetër, 90% e komunave e kanë nivelin e të ardhurave të tyre për frymë më të ulët se mesatarja e qarkut, ku me Kalaja e Dodës (2%), Macakulli dhe Derjani kanë një nivel prej 5% ose më të ulët se mesatarja.


Figura 14: Të ardhurat për frymë të NJQV-ve (2012)

< 20% e mesatares së qarkut	21–50 % e mesatares së rajonit	> 50% e mesatares së rajonit			
K. e Dodës	2	Zall Dardhë	20	Komsi	54
Macukull	5	Gjoricë	21	Lurë	56
Derjan	5	Gurrë	25	Melan	59
Luzni	6	Lis	26	Zerqan	87
Rukaj	9	F. Muhurr	27	Klos M.	106
Sillovë	10	Suç	28	Trebisht	161
Selishtë	10	Kastriot	28	Ulëz	166
Fushë-Çidhen	11	Maqellarë	29	Burrel M.	247
Q. Tomin	13	Zall Reç	34	Bulqizë M.	252
Baz	16	Ostren	34	Peshkopi M.	338
Xibër	17	F-Bulqizë	39	Martanesh	349
Arras	18	Shupenzë	41		

Burimi: Ministria e Financave, llogaritjet e autorëve

Të ardhurat nga taksat janë paraqitur vetëm për Peshkopinë, e cila së bashku me NJQV-të e tjera (pjesa më e madhe e tyre në ZF-të e rrethit Bulqizë Burrel dhe Gurrë) raportojnë të ardhura nga taksat e ndikimit të infrastrukturës. Shumica e NJQV-ve i sigurojnë të ardhurat e tyre nga taksat kryesore lokale (biznes i vogël, toka bujqësore, ndërtesat, regjistrimi i makinave, përdorimi i hapësirës publike, reklamat, pastrimi dhe të tjera).

Figura 15. Të ardhurat për frymë të vetë NJQV-ve si % mesatare në të gjithë qarkun Dibër



Për sa u përket transfertave të kushtëzuara nga qeveria qendrore, vetëm Martaneshi raporton të ardhura nga investimet e arsimit, Arras dhe Gjoricë për punimet publike dhe Luzni për një transfertë nga Ministria e Ekonomisë. Të gjitha NJQV-të marrin një grant të kushtëzuar nga qeveria qendrore, në pjesën më të madhe të rasteve si ndihmë ekonomike për të varfrit. Të ardhurat totale nga këto burime paraqiten në tabelën e mëposhtme dhe trajtohen për secilën zonë funksionale. Shuma totale e të ardhurave ishte 69,4, 53,6 dhe 46,6 milion lekë (495, 383 dhe 333 mijë euro) përkatësisht për Dibrën, Matin dhe Bulqizën.

Shumë zona rurale, të tilla si Kalaja e Dodës, Macakulli dhe Derjani (të përmendura më sipër si zonat me ardhura për frymë më të ulëta), varen kryesisht nga grantet e qeverisë qendrore, ku grantet e kushtëzuara, të cilat kryesisht përfshijnë ndihmën financiare, përbëjnë shumicën e të ardhurave totale për NJQV-të dhe pjesa më e madhe e tyre u shpërndahet banorëve në nevojë. Pra, ato shërbejnë si një subvencion nga qeveria për të ndihmuar e mbështetur komunitetet në zonat e largëta.

Tabela 16: Të ardhurat e NJQV-ve (000 lek) në tre zonat funksionale të qarkut Dibër (2012; në rend zbritës sipas të ardhurave totale për secilën ZF të rrethit)

Zona funksionale e rrethit	NJQV-të	Të ardhurat totale	Të ardhurat e vetat në total	Të ardhurat nga burime të ndryshme nga taksat	Të ardhurat nga taksat	Transferrat e pakushtëzuar	Transferrat e kushtëzuara
Dibër	Peshkopi M.	189 496	55 494	18 505	36 989	88 135	45 867
	Lurë	89 496	763	520	243	12 233	76 499
	Luzni	86 144	195	0	195	11 159	74 790
	Melan	64 000	2676	1432	1244	15 238	46 086
	Maqellarë	61 972	3850	83	3767	26 713	31 409
	Q. Tomin	54 686	1186	128	1058	22 844	30 655
	Arras	51 390	689	55	635	15 206	35 494
	Fushë-Çidhen	49 558	410	0	410	11 186	37 962
	Selishtë	47 752	199	158	42	12 088	35 465
	Zall Reç	46 131	286	0	286	7112	38 734
	Kastriot	42 324	2115	1653	462	19 209	21 000
	F. Muhurr	39 957	937	615	323	11 897	27 123
	Sillovë	37 625	285	0	285	12 624	24 716
	K. e Dodës	30 426	61	0	61	12 193	18 173
	Zall Dardhë	26 011	256	168	88	7766	17 989
	ZF-të e rrethit në total	916 968	69 401	23 315	46 086	285 603	561 964
Mat	Burrel M.	197 894	33 199	10 994	22 205	64 402	100 292
	Klos M.	92 099	10 316	4788	5527	43 029	38 754
	Gurrë	51 798	1058	730	327	15 132	35 608
	Suç	46 379	924	229	696	10 826	34 628
	Macukull	44 447	102	14	88	12 403	31 941
	Lis	41 398	1249	826	422	16 274	23 875
	Ulëz	40 481	2528	985	1543	8704	29 249
	Baz	39 652	435	196	239	13 463	25 754
	Derjan	29 855	74	19	55	9373	20 408
	Komsi	27 601	2862	961	1901	14 388	10 352
	Rukaj	24 984	278	133	145	13 326	11 380
	Xibër	15 643	564	459	105	15 079	0
	ZF-të e rrethit në total	652 231	53 588	20 335	33 252	236 401	362 243
Bulqizë	Martanesh	136 488	7923	2253	5670	17 257	111 308
	Bulqizë M.	101 247	25 506	5631	19 875	52 276	23 465
	Shupenzë	62 119	2769	821	1948	21 894	37 456
	Ostren	58 125	1293	180	1114	15 629	41 202
	Gjoricë	51 695	1086	125	961	15 799	34 810
	Zerqan	47 439	4436	881	3555	22 970	20 034
	Trebisht	32 190	1981	1232	749	7638	22 570
	F-Bulqizë	19 819	1624	155	1469	12 574	5622
	ZF-të e rrethit në total	509 123	46 618	11 278	35 340	166 037	296 468
Totali		2 078 322	169 607	54 928	114 679	688 040	1 220 675

Burimi: Ministria e Financave, llogaritjet e autorëve

Shpenzimet

Shpenzimet totale janë 420, 345 dhe 266 milion lekë, përkatësisht për Dibërën, Matin dhe Bulqizën-. Përqindjen më të madhe e zënë shpenzimet për personelin (42%), të ndjekura nga investimet (30%) dhe shpenzimet operacionale (28%). Më shumë se dy të tretat e NJQV-ve shpenzojnë më pak se gjysma e shpenzimeve të tyre për koston e personelit, edhe pse përqindja varion nga 18-86%. Mesatarja për secilën nga tri zonat funksionale të rrethit është 46% (Dibër) dhe 40% (Mati dhe Bulqiza).

Tabela 17: Shpenzimet e NJQV-ve (000 lek) të tre zonave funksionale të qarkut Dibër (2012; në rend zbritës sipas shpenzimeve totale për secilën ZF të rrethit)

Zona funksionale e rrethit	NJQV-të	Shpenzimet totale (ShT)	Kosto për personelin	Shpenzimet operacionale	Investime	Kostopër personelin si % e ShT[1]
Dibër	Peshkopi M.	163 000	88 000	31 000	44 000	54
	Q. Tomin	79 000	21 000	25 000	33 000	27
	Maqellarë	32 000	13 000	8000	11 000	41
	Kastriot	23 000	12 000	11 000	0	52
	Melan	14 000	8000	6000	0	57
	Zall Dardhë	14 000	3000	11 000	0	21
	Arras	13 000	7000	4000	2000	54
	F. Muhurr	12 000	5000	3000	4000	42
	Fushë-Çidhen	11 000	4000	2000	5000	36
	K. e Dodës	11 000	7000	4000	0	64
	Lurë	11 000	7000	4000	0	64
	Luzni	10 000	6000	4000	0	60
	Sillovë	10 000	3000	3000	4000	30
	Selishtë	9000	4000	2000	3000	44
	Zall Reç	8000	3000	5000	0	38
ZF-të në total		420	191	123	106	45
Mat	Burrel M.	96 000	50 000	43 000	3000	52
	Klos M.	69 000	28 000	8000	33 000	41
	Derjan	39 000	7000	7000	25 000	18
	Rukaj	33 000	7000	8000	18 000	21
	Suç	24 000	8000	5000	11 000	33
	Koms	19 000	8000	5000	6000	42
	Gurrë	14 000	6000	5000	3000	43
	Macukull	13 000	6000	4000	3000	46
	Xibër	13 000	5000	2000	6000	39
	Baz	9000	4000	1000	4000	44
	Lis	9000	3000	2000	4000	33
	Ulëz	7000	6000	1000	0	86
ZF-të në total		1185	520	337	328	40
Bulqizë	Bulqizë M.	99 000	45 000	30 000	24 000	46
	Gjoricë	47 000	9000	19 000	19 000	19
	Zerqan	33 000	12 000	4000	17 000	36
	Martanesh	24 000	10 000	8000	6000	42
	Shupenzë	21 000	11 000	3000	7000	52
	Ostren	20 000	9000	3000	8000	45
	F-Bulqizë	13 000	6000	4000	3000	46
	Trebisht	9000	5000	2000	2000	56
ZF-të në total		2636	1147	747	742	40
Totali		1 031 000	436 000	287 000	308 000	42

Burimi: Ministria e Financave, llogaritjet e autorëve

Në vitin 2012, shpenzimet e përgjithshme për frymë ishin 7523 lekë, krahasuar me 15 165

lekë, të cilat ishin të ardhurat për frymë. Secila zonë funksionale e rrethit ka pasur një ndryshim të njëjtë ndërmjet të ardhurave të veta dhe shpenzimeve totale për frymë (Dibër -5,6 milion lekë; Mat -6,6 milion lekë; Bulqizë -7,0 milion lekë) dhe dallime shumë të ngjashme midis të ardhurave të veta dhe kostove të personelit për frymë. Shpenzimet për frymë të NJQV-ve variojnë nga 2354 deri në 13 321 lekë për individ, përveç Derjanit ku kjo shifër është 35 390 për frymë.


Tabela 18: Shpenzimet e NJQV-së në krahasim me të ardhurat e veta në tre zonat funksionale të qarkut Dibër (2012; në rend zbritës sipas shpenzimeve në total për secilën ZF të rrethit)

Rrethi	NJQV-të	Census-i 2011	Të ardhurat e veta në total (AV; 000 lek)	Shpenzimet në total (ShT; 000 lek)	Kostoja e personelit (KP; 000 lek)	AV-ShT për frymë (000 lekë)	AV-KP për frymë (lekë)	Shpenzimet për frymë (lekë)
Dibër	Zall Dardhë	1051	256	14 000	3000	-13 077	-2611	13 321
	Peshkopi M.	13 251	55 494	163 000	88 000	-8113	-2453	12 301
	Zall Reç	681	286	8000	3000	-11 328	-3986	11 747
	Q. Tomin	7590	1186	79 000	21 000	-10 252	-2611	10 408
	Lurë	1096	763	11 000	7000	-9340	-5691	10 036
	Selishtë	1605	199	9000	4000	-5483	-2368	5607
	K. e Dodës	2252	61	11 000	7000	-4858	-3081	4885
	F. Muhurr	2780	937	12 000	5000	-3979	-1462	4317
	Arras	3055	689	13 000	7000	-4030	-2066	4255
	Sllovë	2405	285	10 000	3000	-4040	-1129	4158
	Luzni	2433	195	10 000	6000	-4030	-2386	4110
	Melan	3649	2676	14 000	8000	-3103	-1459	3837
	Fushë-Çidhen	2909	410	11 000	4000	-3641	-1234	3781
	Kastriot	6200	2115	23 000	12 000	-3369	-1594	3710
Maqellarë	10 662	3850	32 000	13 000	-2640	-858	3001	
ZF në total		<i>61 619</i>	<i>69 401</i>	<i>420 000</i>	<i>191 000</i>	<i>-5690</i>	<i>-1973</i>	<i>6816</i>
Mat	Derjan	1102	74	39 000	7000	-35 323	-6285	35 390
	Rukaj	2507	278	33 000	7000	-13 052	-2681	13 163
	Burrel M.	10 862	33 199	96 000	50 000	-5782	-1547	8838
	Suç	2716	924	24 000	8000	-8496	-2605	8837
	Klos M.	7873	10 316	69 000	28 000	-7454	-2246	8764
	Macukull	1565	102	13 000	6000	-8241	-3768	8307
	Ulëz	1229	2528	7000	6000	-3639	-2825	5696
	Xibër	2660	564	13 000	5000	-4675	-1668	4887
	Komsi	4283	2862	19 000	8000	-3768	-1200	4436
	Gurrë	3369	1058	14 000	6000	-3842	-1467	4156
	Baz	2228	435	9000	4000	-3844	-1600	4039
Lis	3824	1249	9000	3000	-2027	-458	2354	
ZF në total		<i>44 218</i>	<i>53 588</i>	<i>345 000</i>	<i>138 000</i>	<i>-6590</i>	<i>-1909</i>	<i>7802</i>
Bulqizë	Zerqan	1836	7923	24 000	10 000	-8757	-1131	13 072
	Gjoricë	8177	25 506	99 000	45 000	-8988	-2384	12 107
	Shupenzë	4214	1086	47 000	9000	-10 896	-1878	11 153
	Martanesh	993	1981	9000	5000	-7068	-3040	9063
	Bulqizë M.	4111	4436	33 000	12 000	-6948	-1840	8027
	F-Bulqizë	3034	1293	20 000	9000	-6166	-2540	6592
	Trebisht	3342	1624	13 000	6000	-3404	-1309	3890
	Ostren	5503	2769	21 000	11 000	-3313	-1496	3816
ZF në total		<i>31 210</i>	<i>46 618</i>	<i>266 000</i>	<i>107 000</i>	<i>-7029</i>	<i>-1935</i>	<i>8523</i>
Totali		137 047	169 607	1 031 000	436 000	-6285	-1944	7523

Burimi: Ministria e Financave, llogaritjet e autorëve


Duke treguar performancën e secilës NJQV, ndryshimi ndërmjet kostos së të ardhurave të veta dhe kostos së personelit varion nga -458 në -6285 lekë për frymë.

Figura 19: Shpenzimet për frymë të NJQV-ve në qarkun e Dibrës



Burimi: Ministria e Financave, llogaritjet e autorëve

Figura 20: Ndryshimi midis të ardhurave të NJQV-së dhe kostos së personelit për frymë në qarkun Diber



Burimi: Ministria e Financave, llogaritjet e autorëve

Zona funksionale Dibër

Profili administrativo – territorial

Sipas regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë (Census-i) të vitit 2011, numri i popullsisë së ZF-së Dibër ishte 61 619 nga 86 144 banorë në vitin 2001, (28%). ZF-ja ka një sipërfaqe prej 897,6 km². Gjatë kësaj periudhe, dendësia e popullsisë është reduktuar nga 96 në 69 banorë/km². Zona funksionale e rrethit Dibër ka një bashki dhe 14 komuna.

Profili ekonomik dhe financiar

Shumë zona rurale varen tërësisht nga transfertat e qeverisë qendrore. Për shembull, zona e largët e Lurës renditet e dyta për nga shuma më e madhe e të ardhurave totale të zonës funksionale, por pothuajse të gjitha këto të ardhura përbëhen nga transfertat të pakushtëzuara (13,7%) dhe transfertat të kushtëzuara (85,5%) nga qeveria qendrore. Transfertat e kushtëzuara kryesisht përfshijnë ndihmën financiare, pjesa më e madhe e së cilës u rimbursohet më pas banorëve të varfër. Të ardhurat e veta përbëjnë më pak se 1% të të ardhurave totale. Kështu, në të vërtetë subvencioni nga qeveria ndihmon për të mbështetur komunitetet e largëta. Ndërkohë, Peshkopia sigurisht që ka nivelin më të lartë të të ardhurave të veta, 80% e të ardhurave të të gjithë zonës funksionale të rrethit, por vetëm 31% e tyre janë transfertat të pakushtëzuara dhe 8% transfertat të kushtëzuara. Të ardhurat totale të bashkisë përbëjnë 21% të totalit të të ardhurave të 15 NJQV-ve.

Të ardhurat totale tatimore për zonën e propozuar funksionale të Dibrës, për momentin përbëjnë 5% të të ardhurave totale dhe të ardhurat jo tatimore përbëjnë 2,5% të të ardhurave totale.

Peshkopia përbën 39% të shpenzimeve totale të zonës funksionale, përfshirë këtu 46% të kostove të personelit, 25% të shpenzimeve operacionale dhe 42% të investimeve. Megjithatë, ajo është e pesta në lidhje me koston më të lartë të personelit si një përqindje e shpenzimeve në total, ku katër komunat e largëta kanë një përqindje edhe më të lartë. Në të gjithë zonën funksionale, kostoja e personelit zë 45% të shpenzimeve totale, kostoja operacionale 29% dhe investimet 25%.

Tabela 21: Shpenzimet e NJQV-së në krahasim me të ardhurat e veta të zonës funksionale të Dibrës

NJQV	Census -i 2011	Të ardhurat e veta totale (AV; 000 lek)	Shpenzimet totale (ShT; 000 lek)	Kosto totale e personelit (KP; 000 lek)	AV-ShT për frymë (lekë)	AV-KP për frymë (lekë)	Shpenzimet për frymë (lekë)
Zall Dardhë	1051	256	14 000	3000	-13 077	-2611	13 321
B. Peshkopi	13 251	55 494	163 000	88 000	-8113	-2453	12 301
Zall Reç	681	286	8000	3000	-11 328	-3986	11 747
Q. Tomin	7590	1186	79 000	21 000	-10 252	-2611	10 408
Lurë	1096	763	11 000	7000	-9340	-5691	10 036
Selishtë	1605	199	9000	4000	-5483	-2368	5607
K. e Dodës	2252	61	11 000	7000	-4858	-3081	4885
F. Muhurr	2780	937	12 000	5000	-3979	-1462	4317
Arras	3055	689	13 000	7000	-4030	-2066	4255
Sillovë	2405	285	10 000	3000	-4040	-1129	4158
Luzni	2433	195	10 000	6000	-4030	-2386	4110
Melan	3649	2676	14 000	8000	-3103	-1459	3837
Fushë-Çidhen	2909	410	11 000	4000	-3641	-1234	3781
Kastriot	6200	2115	23 000	12 000	-3369	-1594	3710
Maqellarë	10 662	3850	32 000	13 000	-2640	-858	3001
Në total	<i>61 619</i>	<i>69 401</i>	<i>420 000</i>	<i>191 000</i>	<i>-5690</i>	<i>-1973</i>	<i>6816</i>

Burimi: Ministria e Financave, llogaritjet e autorëve

Shpenzimet për frymë variojnë nga 3 000-13 321 lekë, ku pesë NJQV-ë kanë një nivel më të lartë se 10 000 lekë për frymë, duke përfshirë këtu edhe qendrën e zonës funksionale, Peshkopinë. Tre nga këto NJQV-ë, së bashku me Selishtën (e gjashta në listë), ndodhen në zona të largëta. Shuma totale e të ardhurave në të gjithë ZF-në e rrethit përbën vetëm 16% të nivelit të shpenzimeve.

Bizneset

ZF-ja e rrethit Dibër ka më shumë se 1000 biznese jobujqësore të regjistruara dhe ato janë të shpërndara në NJQV të ndryshme. 84% e bizneseve të zonës funksionale të rrethit ndodhen në Peshkopi, ndërsa shumica e pjesës tjetër ndodhet në Maqellarë. Në të gjitha NJQV-të e tjera ndodhen afërsisht 100 biznese.

Profili socio-demografik

Arsimi

Tabela 22: Treguesit e arsimit në zonën funksionale Dibër

Tregues		Kopshte	Shkolla fillore	Shkolla të mesme
Nr. i shkollave	totali	68	40	8
	rural	63	36	6
	urban	5	4	2
Fëmijë të regjistruar	totali	1907	12 218	2804
	rural	1315	9226	1014
	urban	592	2992	1790
Nr. i mësuesve	totali	128	797	121
	rural	80	656	50
	urban	48	141	71
Fëmijë: mësues	totali	15	15	23
	rural	16	14	20
	urban	12	21	25
Nr. i shkollave/10 000 banorë	totali	11,0	6,5	1,3
	rural	10,2	5,8	1,0
	urban	0,8	0,6	0,3
Nr. i mësuesve/10 000 banorë	totali	21	129	20
	rural	13	106	8
	urban	8	23	12

Burimi: Të dhëna administrative, llogaritjet e autorëve

Zona funksionale ka 68 kopshte, 40 shkolla fillore dhe 8 shkolla të mesme, 90% e të cilave gjenden në zonat rurale. Ndërkohë, 68% e fëmijëve në ZF e ndjekin shkollën në zonat rurale, ku ata mësohen nga 75% e mësuesve. Kështu, zonat rurale në ZF-në Dibër përfitojnë më shumë shkolla dhe mësues për fëmijë sesa zonat urbane.

Shëndetësia

Tabela 23: Qendra shëndetësore (përfshirë ambulancat) në zonën funksionale Dibër

NJQV	Nr.	Nr. / 10 000 banorë
Zall Reç	4	58,7
Zall Dardhë	4	38,1
Sillovë	9	37,4
Selishtë	4	24,9
Arras	7	22,9
K. e Dodës	5	22,2
F. Muhurr	6	21,6
Maqellarë	21	19,7
Lurë	2	18,2
Luzni	4	16,4
Kastriot	10	16,1
Fushë-Çidhen	4	13,8
Q. Tomin	6	7,9
B. Peshkopi	5	3,8
Melan	1	2,7
ZF e rrethit në total	92	14,9
Qarku në total	212	15,5

Burimi: Të dhëna administrative, llogaritjet e autorëve

ZF-ja Dibër ka më shumë se një të tretat e qendrave shëndetësore në qark, por kjo shifër është afërsisht e barabartë me shifrën mesatare për 10 000 banorë. Megjithatë, pothuajse të gjitha qendrat ndodhen në zona të largëta, ku gjenden afërsisht 60 qendra për 10 000 banorë. Peshkopia ka një nga raportet më të vogla me 3,8 qendra për 10 000 banorë, ku raportin më të vogël e ka NJQV-ja e saj fqinje, Melani. Gjithsesi, bashkia ka një spital.

Varfëria

Një tregues për numrin e familjeve që jetojnë në varfëri nxirret nga transfertat e kushtëzuara për NJQV-të (pjesa më e madhe e të cilave shkon për të paguar familjet e varfra. Në ZF-në Dibër, shumat më të mëdha të ndihmës ekonomike u transferohen Lurës dhe Luznit. Nëse dikush shqyrton transfertën e kushtëzuar në lidhje me numrin e popullsisë, përsëri efekti i largësisë për disa NJQV është i dukshëm. Si rrjedhojë, zonat më të largëta përfitojnë shumën më të madhe për frymë, ku Peshkopia, Kastrioti dhe Maqellara marrin shumën më të vogël për frymë.

Mbetjet

Tabela 23: Treguesit e menaxhimit të mbetjeve dhe distancat rrugore në zonën funksionale Dibër

NJQV	Mbulimi me ShMM (%)	Mbledhja e tarifës së pastrimit
B. Peshkopi	100	6756
Melan	70–90	165
Maqellarë	30	474
F. Muhurr	0	106
Lurë	0	90
Arras	0	80
Q. Tomin	0	15
Fushë-Çidhen	0	0
K. e Dodës	0	0
Kastriot	0	0
Luzni	0	0
Selishtë	0	0
Silovë	0	0
Zall Dardhë	0	0
Zall Reç	0	0
ZF e rrethit në total	33	7685
Qarku në total	34	37 594

Burimi: Të dhëna administrative, llogaritjet e autorëve

Vetëm tre NJQV të ZF-së Dibër kanë shërbimin e menaxhimit të mbetjeve (ShMM) dhe vetëm një nga këto NJQV-ë mbulohet plotësisht nga ky shërbim. Mbulimi për të gjithë zonën funksionale është rreth 33%. Peshkopia mbledh pjesën më të madhe të tarifave për grumbullimin e mbetjeve në të gjithë zonën funksionale (88%), në krahasim me 18% të mbledhjes së tarifave të mbetjeve në të gjithë qarkun.

Furnizimi me ujë të pijshëm

Ndërmarrja e ujit të pijshëm dhe e ujërave të zeza të Peshkopisë furnizon me ujë banorët e 7 nga 15 NJQV-të e ZF-së së rrethit (47%: Peshkopi, Qendër Tomin, Kala e Dodës, Fushë-Çidhen, Luzni, Kastriot dhe Silovë), të cilat përbëjnë 60% të banorëve të zonës funksionale. Ndërmarrjet e tjera furnizojnë me ujë të pijshëm banorët e NJQV-ve të tjera. Numri i banesave në zonën funksionale që furnizohen me ujë të pijshëm paraqitet në tabelën në vijim. Bashkia e Peshkopisë ka një sistem pothuajse të njëjtë të furnizimit me ujë të pijshëm, ndërsa gjysma e komunës së Muhurrit ka ujë të pijshëm në banesa. NJQV-të e tjera kanë një nivel të ulët të furnizimit me ujë të pijshëm në shtëpitë e tyre, ndërsa Zall Reçi nuk e ka një shërbim të tillë.

Figura 24: Numri i banesave që furnizohen me ujë në NJQV-të e ZF-së së rrethit Dibër

NJQV	Banesa		
	Nr.	Nr. me ujë të pijshëm	%
B. Peshkopi	2999	2947	98,3
F. Muhurr	546	277	50,7
Melan	726	280	38,6
Q. Tomin	1473	503	34,1
Kastriot	1172	369	31,5
Arras	572	163	28,5
Lurë	213	52	24,4
Zall Dardhë	206	40	19,4
Selishtë	281	50	17,8
Maqellarë	2138	171	8,0
Sllovë	459	30	6,5
Luzni	457	25	5,5
Fushë-Çidhen	556	23	4,1
K. e Dodës	348	3	0,9
Zall Reç	115	-	0,0
Në total	12 261	4933	40,2

Burimi: Ministria Transportit dhe Infrastrukturës, 2011

Sistemi i rrugëve rurale

ZF-ja Dibër ka 117 km rrugë rurale dhe 112 km rrugë ndërrbane, të cilat përfaqësojnë përkatësisht 22% dhe 41% të përqindjes totale të qarkut.

Përfundime

ZF Dibër ka një popullsi prej 61 619 banorë, mesatarisht 4108 banorë për njësi

Reduktim i shpenzimeve administrative (paga dhe të shpenzime të tjera operative) me rreth 81,3 milionë lekë ose 17% e shpenzimeve totale të kryera nga të gjitha njësitë.

Ulje e shpenzimeve të pagave nga 3100 në 1930 lekë për banor në njësinë e re

Rritje e buxhetit vjetor të investimeve me 80% në vit, nga 106 në 187 milionë lekë

Rritje e investimeve për frymë nga 1720 në 3040 lekë në njësinë e re

Zona funksionale e rrethit Bulqizë

Profili territorial-administrativ

Sipas regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë (Census-it) të vitit 2011, numri i popullsisë së ZF-së Bulqizë ishte 31 210 banorë, shifër e cila është reduktuar me 27% krahasuar me 42 985 banorë në vitin 2001. ZF-ja ka një sipërfaqe prej 680,8 km². Gjatë kësaj periudhe, dendësia e popullsisë është reduktuar nga 63 në 46 banorë për km². Zona funksionale Bulqizë ka një bashki dhe shtatë komuna.

Profili ekonomik dhe financiar

Të ardhurat

Sikurse edhe në ZF-në Dibër, shumë zona rurale varen tërësisht nga transfertat e qeverisë qendrore. Për shembull, Shupenza siguron më pak se 5% të të ardhurave nga të ardhurat e veta dhe 60% e të ardhurave i siguron nga qeveria qendrore si ndihmë ekonomike për të varfrit, ndërsa 35% nga transfertat e pakushtëzuara. Ndërkohë, bashkia e Bulqizës ka nivelin më të lartë të të ardhurave të veta, 55% e të ardhurave të të gjithë zonës funksionale, ku vetëm 31% janë transfertat të pakushtëzuara dhe 8% transfertat të kushtëzuara (shifra të ngjashme me Peshkopinë në ZF-në Dibër). Të ardhurat totale të bashkisë përbëjnë 20% të totalit të të ardhurave të 15 NJQV-ve. Martaneshi ka nivelin më të lartë të të ardhurave totale, i dyti për sa i përket të ardhurave të veta dhe sigurisht ka nivelin më të madh të transfertave të kushtëzuara.

Të ardhurat totale tatimore për zonën funksionale Bulqizë për momentin përbëjnë 7% të të ardhurave totale dhe të ardhurat jo tatimore përbëjnë 2,2% të numrit total të të ardhurave.

Shpenzimet

Bulqiza përbën 37% të shpenzimeve totale të zonës funksionale, përfshirë këtu 42% të kostos së personelit, 41% të shpenzimeve operacionale dhe 28% të investimeve. Megjithatë, ajo është e shtata (afër nivelit më të ulët) për sa i përket kostos më të lartë të personelit dhe ka një përqindje e shpenzimeve në total, ku pesë komunat e largëta kanë përqindje më të lartë. Në të gjithë zonën funksionale të rrethit, kostoja e personelit zë 40% të shpenzimeve totale, kostoja operacionale 27% dhe investimet 32%.

Shpenzimet për frymë variojnë nga 3816–13 072 lekë, ku tre NJQV-ë kanë një nivel më të lartë se 10 000 lekë për frymë. Qendra e zonës funksionale, bashkia e Bulqizës, ka një nivel të shpenzimeve për frymë prej 8027 lekësh. Tre nga katër NJQV-të me nivel më të lartë të shpenzimeve për frymë se Bulqiza ndodhen në zona të largëta. Në total, të ardhurat e veta në të gjithë ZF-në përbëjnë vetëm 17% të nivelit të shpenzimeve.

Tabela 24: Shpenzimet e NJQV-së/të ardhurat e veta totale të zonës funksionale Bulqizë

NJQV	Census-i 2011	Të ardhurat e veta totale (AV; 000 lek)	Shpenzimet totale (ShT; 000 lek)	Kosto e personelit në total (KP; 000 lek)	AV-ShT për frymë (lekë)	AV-KP për frymë (lekë)	Shpenzimet për frymë (lekë)
Zerqan	1836	7923	24 000	10 000	-8757	-1131	13 072
Gjoricë	8177	25 506	99 000	45 000	-8988	-2384	12 107
Shupenzë	4214	1086	47 000	9000	-10 896	-1878	11 153
Martanesh	993	1981	9000	5000	-7068	-3040	9063
B. Bulqizë	4111	4436	33 000	12 000	-6948	-1840	8027
F-Bulqizë	3034	1293	20 000	9000	-6166	-2540	6592
Trebisht	3342	1624	13 000	6000	-3404	-1309	3890
Ostren	5503	2769	21 000	11 000	-3313	-1496	3816
Në total	31 210	46 618	266 000	107 000	-7029	-1935	8523

Burimi: Të dhëna administrative, përlogaritjet e autorëve

Bizneset

ZF Bulqizë ka më shumë se 600 biznese të regjistruara dhe ato janë të shpërndara në NJQV-ë të ndryshme, siç paraqitet në tabelën vijuese. 71% e bizneseve të zonës funksionale ndodhen në Bulqizë, ndërsa pjesa më e madhe e atyre që mbeten ndodhet në Martanesh. NJQV-të e tjera kanë rreth 100 biznese.

Tabela 25: Nr. i bizneseve të regjistruara në NJQV-ë të ndryshme të zonës funksionale Bulqizë

NJQV	Bizneset	
	Nr.	%
B. Bulqizë	432	71,4
Martanesh	73	12,1
Shupenzë	30	5,0
Zerqan	24	4,0
Gjoricë	21	3,5
F-Bulqizë	11	1,8
Ostren	10	1,7
Trebisht	4	0,7
<i>Në total</i>	<i>605</i>	<i>100,0</i>

Profili socio-demografik

Arsimi

Tabela 26: Treguesit e arsimit në zonën funksionale Bulqizë

Treguesit		Kopshte	Shkolla fillore	Shkolla të mesme
Nr. i shkollave	totali	34	20	5
	rural	30	18	4
	urban	4	2	1
Fëmijë të regjistruar	totali	806	5871	1230
	rural	548	4196	544
	urban	258	1675	686
Nr. i mësuesve	totali	53	334	56
	rural	31	260	26
	urban	22	74	30
Fëmijë, mësues	totali	15	18	22
	rural	18	16	21
	urban	12	23	23
Nr. i shkollave/10 000 banorë	totali	10,9	6,4	1,6
	rural	9,6	5,8	1,3
	urban	1,3	0,6	0,3
Nr. i mësuesve/10 000 banorë	totali	17	107	18
	rural	10	83	8
	urban	7	24	10

Burimi: Të dhëna administrative, përlogaritjet e autorëve

ZF Bulqizë ka 34 kopshte, 20 shkolla fillore dhe 5 shkolla të mesme, 88% e të cilave ndodhen në zonat rurale. Ndërkohë, 67% e fëmijëve të ZF-së banojnë në zonat rurale, ku mësohen nga 72% e mësuesve. Pra, ashtu si për dy ZF-të Dibër dhe Mat, zonat rurale në Bulqizë kanë më shumë shkolla dhe mësues për fëmijë sesa zonat urbane.

Shëndetësia

ZF Bulqizë ka më pak se 1/4 e qendrave shëndetësore në qark dhe vetëm paksa më pak sesa shifra mesatare për 10 000 banorë. Megjithatë, ashtu si në ZF-në e Dibrës, pothuajse të gjitha qendrat ndodhen në zona të largëta, në të cilat gjenden afërsisht deri në 40 qendra për 10 000 banorë. Bulqiza ka një nga raportet më të vogla me 7,3 qendra për 10 000 banorë (dyfishi i shifrës së Peshkopisë), ku raportin më të vogël e ka NJQV-ja e saj fqinje, Shupenza, ndërmjet të cilave kalon rruga kombëtare.

Figura 27: Qendra shëndetësore (përfshirë ambulancat) në zonën funksionale Bulqizë

NJQV	Nr.	Nr./10 000 banorë
Trebisht	4	40,3
Zerqan	11	26,8
Ostren	7	23,1
F-Bulqizë	5	15,0
Gjoricë	6	14,2
Martanesh	2	10,9
B. Bulqizë	6	7,3
Shupenzë	4	7,3
ZF e rrethit në total	45	14,4
Qarku në total	212	15,5

Burimi: Të dhëna administrative, përlllogaritjet e autorëve

Varfëria

Në ZF-në Bulqizë pjesa më e madhe e ndihmës ekonomike i kalon Martaneshit, e cila është një nga zonat më të largëta të vendit. Nëse shqyrtojmë transfertat e kushtëzuara në lidhje me numrin e popullsisë, efekti i largësisë për disa NJQV është përsëri i dukshëm. Kështu, zonat më të largëta marrin shumën më të madhe për frymë, nga të cilat Bulqiza dhe Fushë-Bulqiza marrin më pak.

Tabela 30: Transfertat e kushtëzuara (000 lek) për NJQV-të e zonës funksionale të rrethit Bulqizë

NJQV	Transferta të kushtëzuara	Transferta për frymë
Martanesh	111 308	60,6
Trebisht	22 570	22,7
Ostren	41 202	13,6
Gjoricë	34 810	8,3
Shupenzë	37 456	6,8
Zerqan	20 034	4,9
B. Bulqizë	23 465	2,9
F-Bulqizë	5622	1,7
ZF e rrethit në total	296 468	9,5
Në total	1 220 675	8,9

Burimi: Të dhëna administrative, përlllogaritjet e autorëve

Mbetjet

Vetëm tre NJQV-ë të ZF-së së rrethit Bulqizë nuk kanë shërbimin e menaxhimit të mbetjeve. Nga pesë NJQV-të që e kanë këtë shërbim, asnjëra prej tyre nuk mbulohet plotësisht, dy prej tyre mbulohen deri në 50% dhe dy të tjerat kanë vetëm një mbulim prej një të tretave. Mbulimi në të gjithë zonën funksionale të rrethit është rreth 39%. Bulqiza mbledh pjesën më të madhe të tarifave (66%) për grumbullimin e mbetjeve, krahasuar me 33% të tarifave të pastrimit që mblihen në të gjithë qarkun.

Tabela 28: Treguesit e menaxhimit të mbetjeve dhe distancat rrugore në zonën funksionale Bulqizë

NJQV	Mbulimi me ShMM (%)	Mbledhja e tarifës së pastrimit
B. Bulqizë	75-90	12 349
Fushë-Bulqizë	30-50	0
Zerqan	30-50	916
Shupenzë	30	190
Ostren	30	0
Martanesh	0	5200
Gjoricë	0	0
Trebisht	0	0
ZF e rrethit në total	39	18 655
Qarku në total	34	37 594

Burimi: Të dhëna administrative, llogaritjet e autorëve

Furnizimi me ujë të pijshëm

Ndërmarrja e ujit të pijshëm dhe e ujërave të zeza të Bulqizës furnizon me ujë banorët e 2 nga 8 NJQV-të e ZF-së së rrethit (25% Bulqiza dhe Shupenza) që përbëjnë 44% të banorëve të zonës funksionale. Ndërmarrjet e tjera furnizojnë me ujë të pijshëm banorët e NJQV-ve të tjera. Kështu, bashkia Bulqizë dhe komuna e Fushë-Bulqizës kanë një sistem pothuajse universal të furnizimit me ujë, ndërsa rreth dy të tretat e komunës së Zerqanit dhe më shumë se gjysma e Shupenzës dhe Martaneshit kanë ujë të pijshëm në banesa. Tre komunat e tjera kanë një përqindje të vogël të shtëpive që furnizohen me ujë të pijshëm.

Tabela 29: Numri i banesave që furnizohen me ujë të pijshëm në NJQV-të e zonës funksionale Bulqizë

NJQV	Banesa		
	Nr.	Nr. me ujë të pijshëm	%
B. Bulqizë	1901	1781	93,7
F-Bulqizë	686	595	86,7
Zerqan	841	564	67,1
Shupenzë	1064	603	56,7
Martanesh	451	250	55,4
Trebisht	215	55	25,6
Gjoricë	852	164	19,2
Ostren	663	86	13,0
Në total	6673	4098	61,4

Burimi: INSTAT 2011

Sistemi i rrugëve rurale

ZF Bulqizë ka 137 km rrugë rurale dhe 68 km rrugë ndërrurbane që përfaqësojnë përkatësisht 26% dhe 25% të përqindjes totale të qarkut.

Përfundime

ZF Bulqizë ka një popullsi prej 31 201 banorësh, mesatarisht 3901 banorë për njësi

Reduktim i shpenzimeve administrative (paga dhe të tjera operative) me rreth 47,7 milionë lekë ose 16% e shpenzimeve totale të kryera nga të gjitha njësitë.

Ulje e shpenzimeve të pagave nga 107 milionë lekë në 63,6 milionë lekë në vit. Shpenzimet për pagat për banor janë ulur nga 3428 në 2038 lekë për banor në njësinë e re

Rritje e buxhetit vjetor të investimeve me 60% në vit, saktësisht nga 86 milionë lekë në 133,7 milionë lekë

Rritje e investimeve për frymë nga 2756 në 4284 lekë në njësinë e re

Zona funksionale e rrethit Mat

Profili territorial-administrativ

Sipas regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë (Census-it) të vitit 2011, numri i popullsisë i ZF-së rrethit Mat ishte 44 218 banorë, shifër e cila është reduktuar nga 61 906 banorë në vitin 2001 (- 29%). ZF-ja e Matit ka një sipërfaqe prej 852,2 km². Gjatë kësaj periudhe, dendësia e popullsisë është reduktuar nga 73 në 52 banorë për km².

Profili ekonomik dhe financiar

Të ardhurat

Të gjitha zonat rurale të ZF-së së rrethit Mat varen tërësisht nga transfertat e qeverisë qendrore. Për shembull, Derjani siguron 0,2% të të ardhurave nga të ardhurat e veta, 68% i siguron nga qeveria qendrore si ndihmë ekonomike dhe 31% nga transfertat e pakushtëzuara. Ndërkohë, bashkia Burrel ka nivelin më të lartë të të ardhurave që i siguron vetë, 62% të të ardhurave të të gjithë zonës funksionale, por vetëm 27% transfertat të pakushtëzuara dhe 28% transfertat të kushtëzuara. Të ardhurat totale të Burrelit dhe Klosit përbëjnë 44% të totalit të të ardhurave të 12 NJQV-ve në zonën funksionale.

Të ardhurat tatimore për zonën e propozuar funksionale të rrethit Mat për momentin përbëjnë 5% të të ardhurave totale dhe të ardhurat jo tatimore përbëjnë 3,1% të të ardhurave totale.

Shpenzimet

Burreli përbën 28% dhe Klosi 20% të shpenzimeve totale të zonës funksionale të rrethit, përfshirë këtu 36% dhe 20%, për kostot përkatëse të personelit, 47% dhe 9% përkatësisht për shpenzimet operacionale dhe 3% e 28% përkatësisht për investimet. Kështu, Klosi ka një nivel relativisht të ulët të shpenzimeve operacionale në krahasim me bashkitë e tjera të qarkut Dibër, ndonëse është i dyti për nivelin më të lartë të shpenzimeve për investime. Burreli renditet i dyti (pas Ulzës) dhe Klosi renditet i shtati për nga niveli më i lartë i shpenzimeve për personelin si përqindje e shumës totale të shpenzimeve. Në të gjithë zonën funksionale të rrethit kostoja e personelit zë 40% të shpenzimeve në total, kostoja operacionale 27% dhe investimet 34%.

Me përjashtim të Derjanit, shpenzimet për frymë variojnë ndërmjet 2354–13163 lekë, ku dy NJQV-të kanë një nivel më të lartë se 10 000 lekë për frymë. Bashkitë e Burrelit dhe Klosit kanë një nivel të shpenzimeve për frymë përkatësisht 8838 dhe 8764 lekë, shifër e ngjashme me Bulqizën. Dy NJQV-të me nivel të shpenzimeve për frymë më të lartë se Burreli ndodhen në zonat e largëta. Në total, të ardhurat e veta në të gjithë ZF-në e rrethit përbëjnë vetëm 15% të nivelit të shpenzimeve.

Figura 30: Shpenzimet e NJQV-së në krahasim me të ardhurat e veta totale të zonës funksionale Mat

NJQV	Census-i 2011	Të ardhurat e veta totale (AV; 000 lekë)	Shpenzimet totale (ShT; 000 lekë)	Kostoja totale për personeli n (KP; 000 lekë)	AV-ShT për frymë (lekë)	AV-KP për frymë (lekë)	Shpenzimet për frymë (lekë)
Derjan	1102	74	39 000	7000	-35 323	-6285	35 390
Rukaj	2507	278	33 000	7000	-13 052	-2681	13 163
B. Burrel	10 862	33 199	96 000	50 000	-5782	-1547	8838
Suç	2716	924	24 000	8000	-8496	-2605	8837
B. Klos	7873	10 316	69 000	28 000	-7454	-2246	8764
Macukull	1565	102	13 000	6000	-8241	-3768	8307
Ulëz	1229	2528	7000	6000	-3639	-2825	5696
Xibër	2660	564	13 000	5000	-4675	-1668	4887
Komsi	4283	2862	19 000	8000	-3768	-1200	4436
Gurrë	3369	1058	14 000	6000	-3842	-1467	4156
Baz	2228	435	9000	4000	-3844	-1600	4039
Lis	3824	1249	9000	3000	-2027	-458	2354
Në total	44 218	53 588	345 000	138 000	-6590	-1909	7802

Burimi: Ministria e Financave, llogaritjet e autorëve

ZF Mat ka më pak se 900 biznese të regjistruara dhe ato janë të shpërndara në NJQV të ndryshme.

Tabela 31: Numri i bizneseve të regjistruara në NJQV-ë të ndryshme të zonës funksionale Mat

NJQV	Biznese	
	Nr.	%
B. Burrel	703	80,7
B. Klos	101	11,6
Lis	18	2,1
Ulëz	12	1,4
Gurrë	11	1,3
Komsi	7	0,8
Rukaj	6	0,7
Baz	4	0,5
Suç	3	0,3
Derjan	2	0,2
Macukull	2	0,2
Xibër	2	0,2
<i>Në total</i>	<i>871</i>	<i>100,0</i>

Burimi: Të dhëna administrative, për llogaritjet e autorëve

81% e bizneseve të zonës funksionale ndodhet në Burrel dhe pjesa më e madhe e atyre që mbeten ndodhen në Klos. Në NJQV-të e tjera ndodhen rreth 70 biznese.

Profili socio-demografik

Arsimi

ZF Mat ka 55 kopshte, 38 shkolla fillore dhe 12 shkolla të mesme, 68% e të cilave ndodhet në zona rurale. Ndërkohë, 47% e fëmijëve në ZF banojnë në zonat rurale, ku mësohen nga 53% e mësuesve. Kështu, ashtu si për dy ZF-të Dibër dhe Bulqizë, zonat rurale në Mat përfitojnë nga më shumë shkolla dhe mësues për fëmijë sesa zonat urbane.

Figura 32: Treguesit e arsimit në zonën funksionale Mat

Treguesi		Kopshte	Shkolla fillore	Shkolla të mesme
Nr. i shkollave	totali	55	38	12
	rural	38	27	7
	urban	17	11	5
Fëmijë të regjistruar	totali	1342	7944	2510
	rural	660	4123	771
	urban	682	3821	1739
Nr. i mësuesve	totali	87	512	134
	rural	40	302	51
	urban	47	210	83
Fëmijë, mësues	totali	15	16	19
	rural	17	14	15
	urban	15	18	21
Nr. i shkollave/10 000 banorë	totali	12,4	8,6	2,7
	rural	8,6	6,1	1,6
	urban	3,8	2,5	1,1
Nr. i mësuesve/10 000 banorë	totali	20	116	30
	rural	9	68	12
	urban	11	47	19

Burimi: Të dhëna administrative, llogaritjet e autorëve

Shëndetësia

Figura 33: Qendrat shëndetësore (përfshirë ambulancat) në zonën funksionale Mat

NJQV	Nr.	Nr./10 000 banorë
Derjan	5	45,4
Ulëz	4	32,5
Macukull	5	31,9
Baz	6	26,9
Rukaj	6	23,9
Komsi	10	23,3
Xibër	6	22,6
Suç	5	18,4
Lis	7	18,3
Gurrë	6	17,8
B. Klos	12	15,2
B. Burrel	3	2,8
ZF e rrethit në total	75	17,0
Qarku në total	212	15,5

ZF Mat ka 1/3 e qendrave shëndetësore të qarkut dhe vetëm diçka më pak sesa shifra mesatare për 10 000 banorë. Megjithatë, ashtu si në ZF-të Dibër dhe Bulqizë, pothuajse të gjitha qendrat ndodhen në zonat e largëta, në të cilat gjenden afërsisht deri në 45 qendra shëndetësore për 10 000 banorë. Bashkia Burrel ka një nga raportet më të vogla me 2,8 qendra për 10 000 banorë, e ndjekur nga bashkia e Klosit me raportin tjetër më të ulët. Megjithatë, bashkia ka një spital, i cili shërben për të gjithë ZF-në.

Varfëria

Për ZF-në Mat, transfertat e kushtëzuara nuk janë aq të mëdha sikurse në dy ZF-të e tjera të qarkut të Dibrës. Megjithatë, efekti i largësisë për disa NJQV është i dukshëm, ku Macukulli, Derjani dhe Suçi janë pesë të parët në tabelën vijuese. (Ulëza dhe Baza ndodhen në rrugën kombëtare për në Burrel). Dy bashkitë janë më poshtë në listë, edhe pse nuk janë në fund të saj.

Mbetjet

Tabela 34: Treguesit e menaxhimit të mbetjeve dhe distancat rrugore në zonën funksionale Mat

NJQV	Mbulimi me ShMM (%)	Mbledhja e tarifës së pastrimit
B. Burrel	100	10 032
B. Klos	30	1056
Komsi	30	0
Ulëz	0	80
Lis	0	41
Suç	0	24
Macukull	0	21
Baz	0	0
Derjan	0	0
Gurrë	0	0
Rukaj	0	0
Xibër	0	0
ZF e rrethit në total	33	11 254
Qarku në total	34	37 594

Vetëm tre NJQV-ë të ZF-së Mat kanë shërbim të menaxhimit të mbetjeve. Nga to, vetëm njëra ka mbulim të plotë dhe dy të tjerat mbulohe vetëm në masën e 1/3. Mbulimi në të gjithë zonën funksionale është rreth 33%. Burreli mbledh pjesën më të madhe të tarifave (89%) për grumbullimin e mbetjeve, në krahasim me 27% të tarifave të pastrimit që mbledhen në të gjithë qarkun. Klosi mbulohet nga këto shërbime vetëm në një nivel prej 30% dhe mbledh 9% të tarifave të pastrimit që mbledhen në të gjithë zonën funksionale të rrethit. Ndërmjet tyre, Burreli dhe Klosi mbledhin 29% të tarifave të pastrimit të mbledhura në nivel qarku, në krahasim me 33% të Bulqizës dhe 18% të Peshkopisë.

Furnizimi me ujë të pijshëm

Ndërmarrja e ujit të pijshëm Mat (Burrel) furnizon me ujë banorët e 2 nga 12 NJQV-të e ZF-së (17% Burreli dhe Lisi) që përbëjnë 33% të banorëve të zonës funksionale. Ndërmarrjet e tjera furnizojnë me ujë banorët e NJQV-ve të tjera. Bashkia Burrel ka një sistem të furnizimit me ujë pothuajse të njëjtë, ndërsa gjysma dhe dy të tretat e banesave të Klosit, Ulzës dhe Lisit furnizohen me ujë të pijshëm. Komsi dhe Suçi mbulohe përkatësisht vetëm në masën 43% dhe 31%, ndërsa NJQV-të e tjera kanë një nivel të ulët të furnizimit të shtëpive me ujë.

Tabela 35: Numri i banesave që furnizohen me ujë të pijshëm në NJQV-të e ZF-së Mat

NJQV	Banesa		
	Nr.	Nr. me ujë të pijshëm	%
B. Burrel	2775	2587	93,2
Lis	826	533	64,5
Ulëz	305	169	55,4
B. Klos	1755	827	47,1
Komsi	961	413	43,0
Suç	588	184	31,3
Xibër	557	98	17,6
Rukaj	543	94	17,3
Gurrë	667	87	13,0
Macukull	317	40	12,6
Derjan	231	28	12,1
Baz	488	14	2,9
Në total	10 013	5074	50,7

Burimi: INSTAT, 2011

Sistemi i rrugëve rurale

ZF Mat ka 273 km rrugë rurale dhe 92 km rrugë ndërrbane, të cilat përfaqësojnë përkatësisht 51,8% dhe 338% të përqindjes totale të qarkut.

Përmbledhje për zonat funksionale të qarkut Dibër

Kjo pjesë paraqet një raport të shkurtuar të treguesve kryesorë socio-ekonomik të analizuar në nivelin e zonave funksionale të qarkut dhe rrethit.

Çdo përmbledhje për ZF-në është e shoqëruar me llogaritjen e kursimeve të mundshme, të cilat janë parashikuar duke u bazuar në zbatimin e reformës territoriale-administrative, si edhe me llogaritjen e mundësisë që kanë NJQV-të e asimiluara për të arritur në qendrën e ZF-së.

Nuk ka të dhëna në lidhje me kostot e funksionimit të qendrave shëndetësore dhe shkollave në qarkun Dibër. Si rrjedhim, llogaritjet kryesore që mund të bëhen nëpërmjet reformës territoriale administrative janë bazuar në koston e personelit dhe koston operacionale të NJQV-ve. Përshtatjet e bëra këtu do të ishin përshtatjet më minimale të mundshme për shkak të kursimeve të kostos paralele për sistemet arsimore dhe shëndetësore, në veçanti kur këto janë përgjegjësi të qeverisë vendore.


Nëse për administrimin e zonës funksionale do të qëndronte një NJQV e vetme, kjo do të shmangte kostot e mëdha të personelit (pagat dhe sigurimet shoqërore) dhe shpenzimet operacionale. Megjithatë, është sugjeruar se personeli bazë do të qëndrojë në administratat e mëparshme vendore dhe do të vazhdojë të përdorë disa nga ato kosto të kursyera. Një tjetër gjykim është se, nëse personeli bazë do të mbahej në nivelin e mëparshëm të NJQV-ve, për ndërtesat do të nevojiteshin të njëjtat kosto për mirëmbajtjen.

Në të gjithë qarkun Dibër, kursimet mund të arrijnë një shifër midis 161 dhe 195,4 milion lekë (1,15–1,39 mil Euro).

Nëse personeli që largohet nga puna nuk do të jetë në gjendje të punësohet, kjo do të ketë kosto të konsiderueshme për sa i përket përfitimeve të papunësisë, mbase për 50% të 530 punonjësve (265 individë) në të tria ZF-të e qarkut Dibër (rreth 16 milion lekë), në disa raste edhe për asistencën ekonomike. Kjo do të reduktonte shumë e kursyer të kostos. Për më tepër, do të ketë edhe ndikim social nga personat që mbeten pa punë. Këto pasoja do të kërkonin masa zbutëse.



Harta e zonës funksionale të rrethit Dibër që tregon secilën nga NJQV-të ekzistuese



Harta e zonës funksionale të rrethit Dibër që tregon numrin dhe llojin e bizneseve për secilën NJQV ekzistuese

ZF-ja Dibër ka më shumë se 1000 biznese jobujqësore të regjistruara dhe ato janë të shpërndara në NJQV-ë të ndryshme. 84% e bizneseve të zonës funksionale ndodhen në Peshkopi, ndërsa pjesa më e madhe e atyre që mbeten ndodhen në Maqellarë. Rreth 100 biznese janë të vendosura në NJQV- e tjera.

Zona funksionale Dibër, siç pasqyrohet edhe në tabelën përmbledhëse të treguesve kryesorë, është e organizuar rreth qendrës urbane të Peshkopisë dhe ka 61 619 banorë, popullsi e cila është zvogëluar me 28% përgjatë dhjetë viteve të fundit. Peshkopia popullohet nga 22% e popullsisë në ZF-në Dibër, e cila shtrihet në një sipërfaqe prej 898 km² dhe ka dendësi 69 banorë për km².

Peshkopia është qendër graviteti në ZF-në e Dibrës për sa i përket punësimit, tregjeve, shkollimit dhe kujdesit shëndetësor. Ajo përbën edhe tregun kryesor ku përbushen nevojat e konsumit për gjithë zonën funksionale. Bizneset në Peshkopi përbëjnë 84% të numrit të përgjithshëm për ZF-në Dibër.

Në shërbimin arsimor janë regjistruar gjithsej 16 929 persona (1907 fëmijë në kopshte, 12 218 nxënës në shkollat 9–vjeçare dhe 2804 nxënës në shkollat e mesme). Shërbimi i arsimit ofrohet nga 68 kopshte, 40 shkolla 9-vjeçare dhe 8 shkolla të mesme, ku 90% e tyre gjenden në zonën rurale. ZF-ja e rrethit Dibër ka 10,9 kopshte, 6,4 shkolla 9-vjeçare dhe 1,6 shkolla të mesme për 10 000 banorë, ndërkohë që ka 17 edukatorë në kopshte, 107 mësues në shkolla 9 vjeçare dhe 18 mësues në shkolla të mesme për 10 000 banorë. Numri i nxënësve për një mësues është 15 në kopshte, 15 në shkollat 9–vjeçare dhe 23 në shkollat e mesme. Qyteti i Peshkopisë ofron edhe arsimin universitar me anë të filialit të Universitetit “Aleksandër Moisiu” të Durrësit.

Shërbimi shëndetësor ofrohet nga 92 qendra shëndetësore ose 14,9 qendra për 10 000 banorë dhe një spital, i cili gjendet në qytetin e Peshkopisë. Rreth 94% e qendrave shëndetësore gjenden në komuna me një mesatare prej 60 qendra shëndetësore për 10 000 banorë.

Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm ofrohet nga ndërmarrja publike e Peshkopisë, ku përfshihen 47% e NJQV–ve (bashkia Peshkopi, komunat Qendër Tomin, Kala e Dodës, Fushë-Çidhen, Luzni, Kastriot dhe Sllövë) për 60% të popullatës së Dibrës, ndërkohë që në NJQV–të e tjera ky shërbim ofrohet nga ndërmarrje të ndryshme. Rreth 40% e banesave në ZF-në e Dibrës i ofrohet furnizimi me ujë të pijshëm.

Sipërfaqja e ZF-së që mbulohet nga shërbimi i largimit të mbetjeve është 33%. Në tre njësi vendore është ngritur sistemi i largimit të mbetjeve të ngurta urbane, nga të cilat vetëm bashkia e Peshkopisë e ofron shërbimin në të gjithë territorin. Bashkia e Peshkopisë mbledh 88% të tarifës për grumbullimin e mbetjeve në të gjithë ZF-në e Dibrës apo 18% të tarifës në të gjithë qarkun. Peshkopia ofron shërbimin spitalor edhe për banorët e zonave përreth.

ZF Dibër është e pasur në minerale metalore si xeheroret e kromit e hekurit, okside e silikate, hekur-nikel, bakër, mangan, vandan, arsenik polimetalik, bokside alumini, platini e sqfuri të nikelit.

Minerale jometalore janë mermerët, argjilat, travenitet, sqfuri, bojërat e dheut, gipset, anhidritet, selenitet, guri i talkut, pirofilitet, kuarcitet, gëlqerorët, dunitet, graniti, azbesti dhe grafitet.

Kërçishtit dhe Maqellara ofron edhe sqfur të cilësisë së lartë.

Zona përshkohet nga Drini i Zi dhe është e njohur për ujërat termale kurative, si dhe për potencialin zhvillimor që ofron Mali i Korabit dhe Parku Kombëtar i Lurës.

Tregues kyç të zonës funksionale të rrethit Dibër	
Juridiksionet e qeverisjes vendore	
njësi vendore të nivelit të parë, numri	15
Të dhënat demografike të rrethit si zonë funksionale	
numri i banorëve (Census 2011)	61 619
dendësia mesatare, banorë për km ²	69
ndryshimi i popullsisë 2001–2011 (Census)	-28%
sipërfaqja e rrethit, km ²	898
Buxheti i rrethit si zonë funksionale	
të ardhurat totale (Lekë)	916 968 000
të ardhurat e veta (Lekë)	69 401 000
të ardhurat nga taksat vendore në raport me totalin e të ardhurave	5%
të ardhurat jo tatimore në raport me totalin e të ardhurave	3%
të ardhurat nga burimet kombëtare në raport me të ardhurat në total	92%
shpenzimet totale (Lekë)	420 000 000
shpenzimet për personelin (Lekë)	191 000 000
shpenzimet për investime (Lekë)	106 000 000
të ardhurat e veta/shpenzimet	17%
kostoja e personelit në raport me shpenzimet totale	45%
kostoja operacionale në raport me shpenzimet totale	29%
investimet në raport me shpenzimet totale	25%
të ardhurat totale për frymë (Lekë)	14 881
të ardhurat e veta për frymë (Lekë)	1126
shpenzimet totale për frymë (Lekë)	6816
shpenzimet për personelin për frymë (Lekë)	3100
shpenzimet për investime për frymë (Lekë)	1720
investimet (që vijnë të shtuara nga efekti i kursimit administrativ)	39%
investimet (që vijnë të shtuara nga efekti i kursimit administrativ), për frymë	1078
ekonomia vendore	
numri i bizneseve të regjistruara, jobujqësore	1072
bizneset jobujqësore në bashkinë e Peshkopisë	84%
Shpërndarja e të punësuarve sipas aktiviteteve ekonomike	
bujqësi, pyje dhe peshkim	62%
tregti me shumicë dhe pakicë	3%
ndërtim	4%
industri	3%
Shërbime	21%
struktura e prodhimit bujqësor (2010), (drithëra, 3643; foragjere, 5128; frutorë, 1000; vreshta, 47; perime, 360; fasule, 160; patate, 412; strategjia e qarkut), në ton	10 750

Efektet në strukturat administrative	
totali i personelit në njësitë e qeverisjes vendore (B, K)	456
ngarkesa administrative (personel për 1000 banorë)	0,46
ndryshimi i ngarkesës administrative (personel për 1000 banorë në ZF-në e rrethit)	0,33
Të dhënat për shërbimet	
qendra shëndetësore në total	92
qendra shëndetësore për 10 000 banorë	15
numri i fëmijëve të regjistruar në kopshte	1907
numri i nxënësve të regjistruar në shkollat 9 vjeçare	12 218
numri i nxënësve të regjistruar në shkollat e mesme	2804
numri i kopshteve për 10 000 banorë	11
numri i shkollave 9-vjeçare për 10 000 banorë	7
numri i shkollave për 10 000 banorë	1
edukatorë në kopshte për 10 000 banorë	21
mësues në shkolla 9-vjeçare për 10 000 banorë	129
mësues në shkolla të mesme për 10 000 banorë	20
sipërfaqja që mbulon shërbimi i largimit të mbetjeve	33%
njësi vendore që kanë ngritur sistemin e grumbullimit të mbetjeve	3
numri i banesave që furnizohen me ujë të pijshëm,	4933
përqindja e banesave të cilave u ofrohet furnizimi me ujë të pijshëm	40%
përfitimi i ndihmës ekonomike, Lekë për frymë	9
rrugë rurale, km	117
Të dhënat për burimet natyrore	
Rezervat minerare	
minerale metalore: xeherorët e kromit, hekurit oksid e silikat, hekur-nikelit, bakrit, manganit, vandanit, arsenikut polimetalik, bokside të aluminit, platinit e sqfurit të nikelit	
ndër mineralet jometalore mund të përmenden mermerët, argjilat, travenitet, sqfuri, bojërat e dheut, gipset, anhidritet, selenitet, guri i talkut, pirofilitet, kuarcitet, gëlqerorët, dunitet, graniti, azbesti dhe grafitet	
gipset anhidrite (gjatësi 10 km, gjerësi 3-5 km dhe trashësi (thellësi) mbi 1200 m)	
vendburimet e mermerit (Muhurrit, Kovashicës, Ostrenit të Vogël, Gjurasit, Mazhicës, Radomirës, Dushajt)	
sqfuri (i cilësisë shumë të mirë në Kërçisht të Maqellarës)	
Burime ujore	
Drini i Zi	
Ujerat termale	
Mali i Korabit	



Harta e Zonës funksionale të rrethit Dibër në të cilën tregohet udhëtimi për në vendet e punës


Kursimet e parashikuara në ZF-në e Dibrës

Shpenzimet në total të ZF-së Dibër, siç ekziston aktualisht (d.m.th Dibër) arrijnë në 420 milion lekë, shuma e kostove të personelit është 191 milion lekë, 123 milionë lekë janë kosto operacionale dhe 106 milion lekë kosto të investimeve. Duke u bazuar në udhëzimin për kursime deri në 60-70% në kostot e personelit dhe 5-10% në koston operacionale, ku e vetmja NJQV që do të vazhdojë të ekzistojë do të jetë bashkia Peshkopi, mund të kursehet 60% nga 103 milion lekë (61,8 milion lekë) dhe 5% nga 92 milion lekë (4,6 milion lekë) – një shumë totale prej 66,4 milion lekë. Një tjetër përllogaritje më ambicioze është kursimi rreth 70% nga 103 milion lekë (72,1 milion lekë) dhe 10% nga 92 milion lekë (9,2 milion lekë)—një shumë totale prej 81,3 milion lekë.

Për rrjedhojë, bazuar në udhëzimin e dhënë nga ministria mund të kursehet nga 55,2 milion lekë deri në 66,4 milion lekë.

Mundësia e arritjes së ZF-së Dibër

NJQV-të e asimiluara në ZF-në Dibër do të kenë një distancë mesatare prej 22 km nga qendra administrative e zonës funksionale.



Harta e zonës funksionale Dibër që tregon largësinë e NJQV-ve të asimiluara nga qendra

Duke u bazuar në distancën në kohë udhëtimi prej një ore, objektivi i përcaktuar nga MÇV-ja, harta paraqet gjithashtu distancën e matur në bazë të treguesit kohë udhëtimi. 64% e NJQV-ve të asimiluara do të ketë mundësinë që të arrijnë qendrën e ZF-së në më pak ose brenda një ore, ndërsa pesë të tjerat kanë nevojë për një kohë udhëtimi prej 150-250% të distancës së synuar të udhëtimit nga qendra e ZF. Megjithatë, popullsia që banon në NJQV—të më të largëta dhe ekzistuese përbën vetëm 12% të numrit total të popullsisë në ZF.

Figura 36: Distanca e NJQV-ve të asimiluara nga qendra e ZF-së

NJQV	Distanca nga Peshkopia, qendra e ZF-së		
	Km	Min	% e objektivit; 1 orë kohë udhëtimi
Melan	2	5	8%
Tomin	1,5	5	8%
Kastriot	9	15	25%
Fushë-Muhurr	11	20	33%
Maqellarë	18	30	50%
Luzni	20	40	67%
Sllovë	22	40	67%
Fushë Çidhën	12	45	75%
Kala e Dodës	34	60	100%
Arras	26	90	150%
Selishtë	25	90	150%
Zall-Dardhë	37	120	200%
Lurë	46	150	250%
Zall-Reç	39	150	250%
Mesatarja e ZF-së së rrethit	22	61	102%

Burimi: MÇV

Zona funksionale e rrethit Bulqizë



Treguesit kryesor ekonomike dhe socio-demografike

Treguesit kryesorë në zonat funksionale të Bulqizës	
Juridiksionet e qeverisjes vendore	
numri i njësisve vendore të nivelit të parë	8
Të dhënat demografike të rrethit si zonë funksionale	
numri i banorëve (Census 2011)	31 210
dendësia mesatare, banorë për km ²	46
ndryshimi i popullsisë 2001–2011 (Census)	-27%
sipërfaqja e rrethit, km ²	681
Buxheti i rrethit si zonë funksionale	
të ardhurat e veta (Lekë)	46 618 000
të ardhurat nga taksat vendore në raport me totalin e të ardhurave	7%
të ardhurat jo tatimore në raport me totalin e të ardhurave	2%
të ardhurat nga burimet kombëtare në raport me të ardhurat -totale	91%
shpenzimet total (Lekë)	266 000 000
shpenzimet për personelin (Lekë)	107 000 000
shpenzimet për investime (Lekë)	86 000 000
të ardhurat e veta/shpenzimet në %	18%
kostoja e personelit në raport me shpenzimet totale	40%
kostoja operacionale në raport me shpenzimet totale	27%
investimet në raport me shpenzimet totale	32%
të ardhurat totale për frymë (Lekë)	16 313
të ardhurat e veta për frymë (Lekë)	1494
shpenzime totale për frymë (Lekë)	8523
shpenzime për personelin për frymë (Lekë)	3428
shpenzimet për investime për frymë (Lekë)	2756
investimet (që sigurohen nga efekti i kursimit administrativ) në %	30%
investimet (që sigurohen nga efekti i kursimit administrativ), për frymë	1192
Ekonomia vendore	
numri i bizneseve jo bujqësore të regjistruara	605
bizneset jobujqësore në bashkinë Bulqizë	71%
Shpërndarja e të punësuarve sipas aktiviteteve ekonomike	
bujqësi, pylltari dhe peshkim	35%
tregti me shumicë dhe pakicë	5%
ndërtim	7%
industri	22%
shërbime	25%
struktura e prodhimit bujqësor në vitin 2010: drithëra, 1507; foragjere 2375, frutorë 250; vreshta 12, perime 191, fasule 101, patate 240; (në ton)	4676
Efektet në strukturat administrative	
totali i personelit në njësitë e qeverisjes vendore (B, K)	224
ngarkesa administrative (personel për 1000 banorë)	0,22
ndryshimi i ngarkesës administrative (personel për 1000 banorë në ZF-në e rrethit)	0,15
numri total i qendrave shëndetësore	45
qendra shëndetësore për 10 000 banorë	14
numri i fëmijëve të regjistruar në kopshte	806
numri i nxënësve të regjistruar në shkollat 9-vjeçare	5871
numri i nxënësve të regjistruar në shkollat e mesme	1230
numri i kopshteve për 10 000 banorë	11
numri i shkollave 9-vjeçare për 10 000 banorë	6

numri i shkollave për 10 000 banorë	2
edukatorë në kopshte për 10 000 banorë	17
mësues në shkolla 9-vjeçare për 10 000 banorë	107
mësues në shkolla të mesme për 10 000 banorë	18
sipërfaqja e mbuluar nga shërbimi i largimit të mbetjeve	39%
njësi vendore që kanë ngritur sistemin e mbledhjes së mbetjeve	3
numri i banesave të cilave u ofrohet furnizimi me ujë të pijshëm	4098
përqindja e banesa të cilave u ofrohet furnizimi me ujë të pijshëm	61%
përfitimi i ndihmës ekonomike, Lekë për frymë	10
rrugë rurale, km	137
rrugë interurbane, km	68

Kursimet e parashikuara në ZF-në Bulqizë

Shpenzimet totale të ZF-së Bulqizë, siç ekziston aktualisht (d.m.th Bulqizë), janë 266 milion lekë, shumën e kostove të personelit është 107 milion lekë, 73 milionë lekë janë kosto operacionale dhe 86 milion lekë janë kostot e investimeve. E vetmja NJQV që do të vazhdojë të ekzistojë do të jetë bashkia Bulqizë, pra në total mund të kursehet 60% e 62 milion lekëve (37,2 milion lekë) dhe 5% e 43 milion lekëve (2,2 milion lekë) – në total 39,4 milion lekë. Një tjetër llogaritje më ambicioze është të kursehet 70% nga 62 milion lekë (43,4 milion lekë) dhe 10% nga 43 milion lekë (4,3 milion lekë)—para, një shumë totale prej 47,7 milion lekë. Për rrjedhojë, mund të kursehet nga 39,4 milion lekë deri në 47,7 milion lekë.

Distanca dhe koha e udhëtimit

NJQV-të e asimiluara në ZF-në e Bulqizës do të kenë një distancë mesatare prej 25 km nga qendra administrative e zonës funksionale.

Duke u bazuar në afatin kohor të udhëtimit prej një ore, objektiv i përcaktuar nga MÇV-ja, në tabelën 43 paraqitet gjithashtu distanca e matur në bazë të treguesit kohë udhëtimi. 71 % e NJQV-ve të asimiluara do të mund të arrijnë në qendrën e ZF-së në më pak ose për një orë, ndërsa dy NJQV-të e tjera kanë nevojë për një kohë udhëtimi midis 200-250% të distancës së synuar të udhëtimit nga qendra e ZF-së. Gjithsesi, popullsia që banon në NJQV-të ekzistuese më të largëta përbën vetëm 6% të numrit total të popullsisë në ZF.

Figura 37: Distanca e NJQV-ve të asimiluara nga qendra e ZF-së

NJQV	Distanca nga Bulqiza, qendra e ZF-së		
	km	Min	% e objektivit; koha e udhëtimit- 1 orë
F-Bulqizë	8	15	25%
Zerqan	22	20	33%
Shupenzë	21	35	58%
Gjoricë	23	45	75%
Martanesh	20	60	100%
Ostren	37	120	200%
Trebisht	46	150	250%
Mesatarja e ZF-së	25	64	106%

Burimi: MÇV

HARTA E DISTANCAVE KOHORE
BASHKIA BULQIZË



SHPJEGUES

Kufiri i Bashkise

Qendrat e Banuara

Qytet

Fshat


**Distanca ne Minuta
nga Qendra e Zones**

< 15 min

15 - 30

30 - 70

Zona funksionale Mat



Treguesit kryesorë ekonomike dhe socio-demografike

Treguesit kyç për zonën funksionale Mat	
Juridiksionet e qeverisjes vendore	
numri i njësisve vendore të nivelit të parë	12
Të dhënat demografike të rrethit si zonë funksionale	
numri i banorëve (Census 2011)	44 218
dendësia mesatare, banorë për km ²	52
ndryshimi i popullsisë 2001–2011 (Census), negative	29%
sipërfaqja e rrethit, km ²	852
Buxheti i rrethit si zonë funksionale	
të ardhurat totale (Lekë)	652 231 000
të ardhurat e veta (Lekë)	53 588 000
të ardhurat nga taksat vendore në raport me totalin e të ardhurave	5%
të ardhurat jo tatimore në raport me totalin e të ardhurave	3%
të ardhurat nga burimet kombëtare në raport me të ardhurat totale	92%
shpenzimet total (Lekë)	345 000 000
shpenzimet për personelin (Lekë)	138 000 000
shpenzimet për investime (Lekë)	116 000 000
të ardhurat e veta/shpenzimet	16%
kostoja për personelin në raport me shpenzimet totale	40%
kostoja operacionale në raport me shpenzimet totale	26%
investimet në raport me shpenzimet totale	34%
të ardhurat totale për frymë (Lekë)	14 750
të ardhurat e veta për frymë (Lekë)	1212
shpenzime totale për frymë (Lekë)	7802
shpenzime për personelin për frymë (Lekë)	3121
shpenzimet për investime për frymë (Lekë)	2623
investimet (që shtohen nga efekti i kursimit administrativ)	31%
investimet (që shtohen nga efekti i kursimit administrativ), për frymë	1194
Ekonomia vendore	
numri i bizneseve jo bujqësore të regjistruara	871
bizneset jobujqësore në bashkinë Burrel	81%
shpërndarja e të punësuarve sipas aktiviteteve ekonomike	
bujqësi, pylltari dhe peshkim	46%
tregti me shumicë dhe pakicë	4%
ndërtim	3%
industri	11%
shërbime	31%
struktura e prodhimit bujqësor (2010), (drithëra, 1540; foragjere, 5250; frutorë, 100; vreshta, 105; perime, 702; fasule, 143; patate, 178; strategjia e qarkut), në ton	8018
blegtoaria (66 700 krerë dele e dhi) dhe 10 400 gjedhë (krerë lopë)	77 100
Efektet në strukturat administrative	
totali i personelit në njësitë e qeverisjes vendore (B, K)	316
ngarkesa administrative (personel për 1000 banorë)	0,32

ndryshimi i ngarkesës administrative (personel për 1000 banorë në ZF)	0,19
Të dhënat për shërbimet	
qendra shëndetësore në total	75
qendra shëndetësore për 10 000 banorë	17
numri i fëmijëve të regjistruar në kopshte	1342
numri i nxënësve të regjistruar në shkollat 9-vjeçare	7944
numri i nxënësve të regjistruar në shkollat e mesme	2510
numri i kopshteve për 10 000 banorë	12
numri i shkollave 9-vjeçare për 10 000 banorë	9
numri i shkollave për 10 000 banorë	3
edukatorë në kopshte për 10 000 banorë	20
mësues në shkolla 9-vjeçare për 10 000 banorë	116
mësues në shkolla të mesme për 10 000 banorë	30
sipërfaqja e mbuluar me shërbimin e largimit të mbetjeve	33%
njësi vendore që kanë ngritur sistemin e mbledhjes së mbetjeve	3
popullsia e rrethit që i ofrohet furnizimi me ujë të pijshëm nga ndërmarrja publike Burrel (Burrel dhe Lis)	33%
numri i banesave të cilave u ofrohet furnizimi me ujë të pijshëm	5074
% e banesa të cilave u ofrohet furnizimi me ujë të pijshëm	51
përfitimi i ndihmës ekonomike, Lekë për frymë	8
rrugë rurale, km	273
Të dhënat për burimet natyrore	
tokë bujqësore, (përfshirë 300 vreshta), dynym	13 542
rezervat minerare	
minerali i kromit gjendet në sasi të mëdha në Batër të Martaneshit, në fshatin Vinjoll dhe rrethina të tjera të qytetit të Burrelit	
burime ujore	
Rrethi i Matit është i pasur me rezerva ujore, të tilla si liqene artificiale (Liqeni i Ulzës, Shkopetit, Mídhës, Kurdarisë etj.), të cilat përdoren për vaditjen e tokave apo dhe për peshkim nga banorët e zonave. Mati dhe lugina e tij përshkohet nga Lumi Mat i cili ka një gjatësi prej 113 km	

Kursimet e parashikuara për ZF-në Mat

Shpenzimet në total të ZF-së Mat, siç ekziston aktualisht (d.m.th rrethi Mat), janë 345 milion lekë, shumica e kostove për personelin është 138 milion lekë, 91 milionë lekë janë kosto operacionale dhe 116 milion lekë kosto të investimeve. Duke u bazuar në udhëzimin për kursime deri në 60-70% në kostot e personelit dhe 5-10% në koston operacionale, ku e vetmja NJQV që do të vazhdojë të ekzistojë është bashkia e Burrelit, mund të kursehet 60% i 88 milion lekëve (52,8 milion lekë) dhe 5% i 48 milion lekëve (2,4 milion lekë) – në total rreth 55,2 milion lekë. Një tjetër përlllogaritje më ambicioze është të kursehet 70% i 88 milion lekëve (74,9 milion lekë) dhe 10% i 48 milion lekëve (4,8 milion lekë) – pra, në total 66,4 milion lekë. Për rrjedhojë, duke u bazuar në udhëzimin e dhënë mund të kursehet nga 55,2 milion lekë deri në 66,4 milion lekë.

Mundësia e arritjes së ZF-së Mat


NJQV-të e asimiluara në ZF-në Mat do të kenë një distancë mesatare prej 20 km nga qendra administrative e zonës funksionale

Duke u bazuar në distancën kohore të udhëtimit prej një ore, objektiv i përcaktuar nga MÇV-ja, në tabelën e mëposhtme paraqitet edhe distanca e matur duke u bazuar në treguesin kohë të udhëtimit. 82% e NJQV-ve të asimiluara do të mund të arrijnë në qendrën e ZF-së së rrethit në një orë ose më pak, ndërsa dy NJQV-të e tjera kanë nevojë për një kohë udhëtimi midis 150-200% të distancës së synuar të udhëtimit nga qendra e ZF-së së rrethit. Gjithsesi, popullsia që banon në NJQV-të ekzistuese më të largëta përbën vetëm 10% të numrit total të popullsisë në ZF.

Tabela 38: Distanca e NJQV-ve të asimiluara nga qendra e ZF-së

NJQV	Distanca nga Burreli, qendra e ZF-së		
	km	min	% e objektivit; 1 orë kohë udhëtimi
Komsi	5	8	13%
Suç	7	15	25%
Baz	14	20	33%
Klos M.	18	25	42%
Lis	16	25	42%
Gurrë	20	40	67%
Ulëz	26	40	67%
Derjan	16	45	75%
Rukaj	15	60	100%
Macukull	37	90	150%
Xibër	42	120	200%
Mesatarja e ZF-së së rrethit	20	44	74%

Burimi: MÇV



Përfundime

Përfundimet për zonën e rrethit Mat janë llogaritur në variantin me dy njësi funksionale më vete, përkatësisht ZF Mat dhe ZF Klos.

1. ZF Mat (Bashkia Burrel dhe Komunat Baz, Derjan, Rukaj, Macukull, Komsil, Lis, Ulëz,)

ZF Mat e përbërë nga 8 njësi ekzistuese, ka popullsi prej 27,600 banorë, nga mesatarisht 3,450 banorë për njësi aktualisht;

Reduktim i shpenzimeve administrative të njësisë me rreth 31,5 milionë lekë në vit (shpenzime paga dhe operative);

Ulja e shpenzimeve të personelit për banor në masën 32%, nga 3,297 në 2,257 lekë;

Mirëadministrimi i burimeve financiare mund të sjellë rritje të investimeve në masën 50%, ose nga 63 milionë lekë, në 94,5 milionë lekë në vit;

Investimet për banor mund të rriten nga 2,283 lekë në 3,424 lekë në njësinë e re;

Bashkimi në një zonë funksionale mund të sigurojë rishpërndarje më të mirë të të ardhurave, pa llogaritur efektet e eficiencës së rritur në menaxhimin e të ardhurave: mesatarisht ZF e re do të realizonte 1,476 lekë për frymë të ardhura të veta; ose 80% më shumë se mesatarja ekzistuese e të ardhurave për frymë në NJQV aktuale (814 lekë) dhe 5 herë sa mediani i të ardhurave për frymë në njësitë aktuale (261).

2. ZF Klos (Bashkia Klos dhe Komunitat Xiber, Gurre, Suç)

- ZF Klos e përbërë nga 4 njësi ekzistuese, ka popullsi prej 16,618 banorë, nga mesatarisht 4,155 banorë për njësi aktualisht;
- Reduktim I shpenzimeve administrative të njësisë me rreth 14,5 milionë lekë në vit (shpenzime paga dhe operative), ose 22% e kostove administrative (personel dhe mirëmbajtje) dhe 11% e shpenzimeve gjithsej të NJQV ekzistuese;
- Ulja e shpenzimeve të personelit për banor në masën 29%, nga 2,828 në 2,028 lekë;
- Mirëadministrimi I burimeve financiare mund të sjellë rritje të investimeve në masën 27%, ose nga 53 milionë lekë, në 67,5 milionë lekë në vit;
- Investimet për banor mund të rriten nga 3,189 lekë në 4,062 lekë në njësinë e re;


Bashkimi në një zonë funksionale mund të sigurojë rishpërndarje më të mirë të të ardhurave, pa llogaritur efektet e eficiencës së rritur në menaxhimin e të ardhurave: mesatarisht ZF e re do të realizonte 774 lekë për frymë të ardhura të veta; ose 42% më shumë se mesatarja ekzistuese e të ardhurave për frymë në NJQV aktuale (544 lekë) dhe 2,4 herë sa mediani i të ardhurave për frymë në njësitë aktuale (327);

QARKU DURRËS

Profili i qarkut Durrës

Qarku i Durrësit përbëhet prej dy rretheve: atij të Durrësit dhe të Krujës, dhe prej 16 njësive të qeverisjes vendore (NJQV) të organizuara - 10 në rrethin e Durrësit (Durrës, Gjepalaj, Ishëm, Katund i Ri, Maminas, Manzë, Rrashbull, Shijak, Sukth dhe Xhafzotaj) dhe 6 në rrethin e Krujës (Bubq, Cudhi, Fushë Krujë, Kodër Thumanë, Krujë, Nikël). Popullsia totale e qarkut sipas Census-it të popullsisë dhe banesave të vitit 2011 është, 262 785 banorë nga të cilët rreth 203 000 i përkasin rrethit të Durrësit dhe 59 814 rrethit të Krujës. Ky qark renditet i katërti në Shqipëri për nga numri i popullsisë dhe ashtu si Tirana është një nga destinacionet kryesore për migrimin e brendshëm.

Figura 31. NJQV-të në qarkun e Durrësit sipas popullsisë



Burimi: INSTAT

Këto shifra paraqiten konsiderueshëm më të ulëta, referuar të dhënave të Regjistrimit të Gjendjes Civile, sipas të cilit në janar 2012 popullsia e qarkut të Durrësit rezulton 414 677 (në rrethin e Durrësit 336 524 banorë dhe në rrethin e Krujës 78 153 banorë).

Diferenca e madhe midis popullsisë rezidente dhe asaj në Regjistrin Civil vjen si rrjedhim i emigracionit të lartë që vjen kryesisht nga qyteti i Durrësit.

Rreth 38% e njësive vendore në qark ose 6 komuna kanë një popullsi më të vogël se 10 000 banorë të regjistruar, 9 njësi ose 56% e totalit të njësive kanë një popullsi të regjistruar, midis 10 000 dhe 30 000 banorë dhe vetëm bashkia Durrës numëron 203 918 banorë të regjistruar ose rreth 50% e gjithë popullsisë së qarkut.

Tabela 17. Popullsia e qarkut Durrës

RRETHI	NJQV-ja	INSTAT 2011
DURRËS	DURRËS	113 249
DURRËS	RASHBULL	24 081
DURRËS	SUKTH	15 966
DURRËS	XHAFZOTAJ	12 381
DURRËS	KATUND I RI	10 161
DURRËS	SHIJAK	7568
DURRËS	MANEZ	6652
DURRËS	ISHËM	5001
DURRËS	MAMINAS	4463
DURRËS	GJEPALAJ	3449
TOTAL DURRËS		202 971
KRUJË	FUSHE KRUJË	18 477
KRUJË	KODËR THUMANË	12 335
KRUJË	KRUJË	11 721
KRUJË	NIKEL	9518
KRUJË	BUBQ	5951
KRUJË	CUDHI	1812
TOTAL KRUJË		59 814
TOTAL QARKU		262 785

Burimi: INSTAT, Census 2011

Tre nga 10 njësitë e qeverisjes vendore të rrethit Durrës shtrihen në bregun e Adriatikut, me potencial të madh për turizëm dhe për shkëmbime tregtare. Në njësinë më të madhe vendore të qarkut, në bashkinë e Durrësit ndodhet edhe porti më i madh në vend për shkëmbimet e udhëtareve dhe mallrave.


Bashkia Fushë - Krujë është njësi vendore më e madhe e rrethit Krujë. Së bashku me Krujën, dy bashkitë fqinje luajnë rolin kryesor në rreth duke plotësuar njëra tjetrën me kontributet në fushën e turizmit, tregtisë dhe industrisë.

Në Census-in e popullsisë të vitit 2011 u vu re një rritje populsië prej 9% në këtë qark, kryesisht në zonat urbane. Popullsia në zonat urbane të qarkut (bashkitë) u rrit me 56% gjatë kësaj periudhe, prurjet më të mëdha besohet të kenë ardhur nga zonat rurale të vetë qarkut të cilat janë tkurrur me 46%.

Dendësia mesatare e popullsisë është 473 banorë/km², krahasuar me 97,4 banorë/km² në rang vendi. Durrësi (2985 banorë/km²) dhe Shijaku (1552 banorë/km²) janë njësitë vendore me dendësi më të lartë, ndërsa Cudhi (22 banorë/km²) dhe Ishmi (55 banorë/km²) janë njësitë me dendësinë më të ulët.

Edhe pse me pozitë gjeografike të favorshme dhe me tradita të hershme turistike e tregtare, qarku Durrës ka një nivel varfërie më të lartë se sa mesatarja e vendit. Sipas LSMS-së të vitit 2012, qarku Durrës shënon një nivel varfërie prej 16,2%, me thellësi 3,3% dhe ashpërsi 1,1%, ndërkohë që nivelet mesatare të këtyre treguesve në vend janë 14,3%, 2,9% dhe 1%. Kjo dukuri është pasojë e dallimeve të mëdha në zhvillim midis bashkive më të pasura dhe komunave tërësisht të pazhvilluara.

Figura 32: Shtrirja gjeografike e qarkut Durrës



Mesatarja e të ardhurave për frymë në NJQV-të e qarkut Durrës është rreth 54 Euro në vitin 2011, krahasuar me 68 Euro në nivel vendi. E ardhura më e lartë për frymë rezulton në Krujë dhe Fushë Krujë (rreth 70 Euro/banor), ndërsa më e ulëta në Bubq (rreth 38 Euro/banor).

Thuajse i njëjti trend vihet re edhe në shpërndarjen e shpenzimeve vendore për banor. Qarku ka një popullsi me etni homogjene, pa pakica të konfiguruar qartë.



Ndërveprimi institucional

Ndërveprimet institucionale në qarkun e Durrësit tentojnë të jenë të organizuara rreth qendrave të ish-rretheve, rrethit të Durrësit dhe rrethit të Krujës.

Qyteti i Durrësit është zemra e ndërveprimeve institucionale duke qenë në të njëjtën kohë qendër e qarkut Durrës dhe qendër e rrethit. Ky qytet është pikë ndërveprimi për të gjithë institucionet e NJQV-ve përbërëse të rrethit Durrës duke u kushtëzuar me prezencën e një sërë drejtorive rajonale (shëndetësore, të arsimit, kujdesit social dhe pyjore), Dega e Thesarit, si dhe Drejtoria e Tatimeve. Qendra e qarkut kushtëzon gjithashtu ndërveprimin me të gjithë qytetarët e qarkut në sajë të prezencës së Zyrës së Punësimit, Gjykatës dhe Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Shtëpisë së të Moshuarve, Qendrës së Zhvillimit Profesional dhe Shtëpisë së Foshnjës.

Ndërkohë që të gjitha NJQV-të e rrethit Krujë, kanë një ndërveprim të dendur institucional me qytetin e Krujës, ku gjithashtu ndodhen një sërë institucioneve shumë të rëndësishme për banorët e këtij rrethi si: Zyra Arsimore, Zyra e Punësimit, Drejtoria Shëndetësore, Prokuroria e Rrethit dhe Gjykata.

Figura 33. Vendndodhja e institucioneve në qarkun Durrës



Ndërveprimi ekonomik


Nga analiza e të dhënave të Censur-it të popullsisë dhe banesave të vitit 2011, vihet re se përqendrimi i bizneseve dhe shumëllojshmëria e tyre më e madhe janë më të spikatura në qytetet që janë edhe qendra të rretheve përbërëse të qarkut.

Vëmë re se për rrethin e Durrësit qyteti i Durrësit ka përqendrimin më të madh të bizneseve për 1000 banorë , si dhe përfaqësimin e të gjithë kategorive të biznesit me përjashtim të atij bujqësor, i rrethuar nga NJQV me përqendrim të mesëm.

Qendra e dytë në rrethin Durrës për nga përqendrimi i bizneseve dhe shumëllojshmëria e aktiviteteve është Shijaku, i ndjekur nga Xhafzotaj të cilët kufizohen me fshatin Gjepalaj, zonë me një numër të ulët biznesesh për 1000 banorë dhe aktivitete ku dominon tregtia e ndjekur nga bujqësia dhe me pak shërbime, tregues ky për zhvillimin e ndryshëm ekonomik të dy zonave kufitare.

Në rrethin e Krujës, janë Kruja dhe Fushë-Kruja dy NJQV-të me përqendrimin më të lartë të bizneseve në rreth, e kufizuar në jug dhe perëndim me Niklën dhe Bubqin me një nivel të mesëm numri biznesesh dhe në lindje me Kodër Thumanën me numër të ulët biznesesh por me një larmi aktivitete. Tërheq vëmendjen zona e Cudhit e cila edhe pse kufitare me Krujën ka një zhvillim ekonomik të limituar, numër të ulët biznesesh kryesisht të orientuara vetëm në fushën e shërbimeve.

Figura 34. Shpërndarja e bizneseve në qarkun Durrës



Burimi: INSTAT

Ndërkohë tendenca interesante vihen re në lëvizjen e përditshme të banorëve të qarkut drejt qendrave të punës, bazuar në të dhënat e Census-it 2011.


Nga analiza e të dhënave vëmë re se, përqendrimi më i madh i të punësuarve të cilëve nuk ju duhet të udhëtojnë për të shkuar në punë është në qytetin e Durrësit. Mbi 90% e të punësuarve të këtij qyteti punojnë në qytetin ku banojnë. Duke parë nivelin e lartë të udhëtimit për në

punë në NJQV-të kufitare me Durrësin, arrihet në përfundimin që ky qytet shërben edhe si vend punësimi për një pjesë të madhe të të punësuarve në NJQV-të kufitare.

Zona me nivel të lartë punësimi brenda tyre janë edhe qyteti i Krujës dhe i Fushë Krujës, si dhe Ishmi. Pra, dukshëm shumica e banorëve të këtyre zonave punojnë aty ku kanë vendbanimin.

Ndërkohë që 40 – 60% e të punësuarve të Xhafzotajt, Shijakut e Manzës punojnë në zonat ku banojnë, ndërsa pjesa tjetër udhëtojnë për të punuar në zonat fqinje, respektivisht drejt Durrësit, Shijakut dhe Xhafzotajt. Niveli më i ulët i punësimit në zonën e banimit dhe tendenca më e lartë për të punuar në NJQV-të kufitare vihet re në Katundin e Ri, Sukth, Gjepalaj e Rrashbull i cili është edhe tregues i zhvillimit të ulët ekonomik të këtyre NJQV-ve.

Figura 35. Harta e ndërveprimit ekonomik qarku Durrës



Burimi: MÇV; Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve

Distancat me qendrat e rretheve

Pozicioni gjeografik dhe niveli i zhvillimit të infrastrukturës diktojnë edhe shpejtësinë e aksesit të NJQV-ve drejt qendrave të rretheve.


Në rrethin Durrës, zona e Ishmit është zona së cilës i duhet më shumë kohë për të aksesuar shërbimet në qendrën e rrethit (40 – 60 minuta për një udhëtim). Banorëve të Katundit të Ri iu duhet një kohë disi më e gjatë për të arritur në qytetin e Durrësit se sa disa zona të tjera më të largëta si pasojë e infrastrukturës së pa modernizuar (20 – 40 minuta), ndërsa pjesa tjetër e NJQV-ve kanë akses shumë të shpejtë në qendrën e rrethit, më pak se 20 minuta për një udhëtim.

Në tërësi distanca e NJQV-ve të rrethit Durrës është e mjaftueshme për të lejuar marrjen normale të shërbimeve të këtyre zonave nga qendra e rrethit.

Një dukuri e ngjashme vihet re edhe në rrethin e Krujës. Banorëve të fshatrave që përbëjnë komunën e Cudhit ju duhet rreth një orë për të arritur në qytetin e Krujës. Edhe pse komunë kufitare me bashkinë Krujë, aksesit vështirësohet si pasojë e shpërndarjes gjeografike të fshatrave dhe infrastrukturës rrugore pjesërisht të zhvilluar.

Të gjitha NJQV-të e tjera kanë akses të mirë në qytetin e Krujës dhe në tërësi të gjitha NJQV-të e këtij rrethi janë në distancë të mjaftueshme nga qendra për të lejuar marrjen normale të shërbimeve që ofrohen në qendër të rrethit.

Figura 36. Distancat nga qendrat e rretheve në qarkun Durrës



Burimi: INSTAT


Figura 37. Zonat e mbrojtura në qarkun Durrës



Burimi: Ministria e Mjedisit

Aksesi në shërbime

Figura 38. Shpërndarja e ndërmarrjeve SHAUK ne qarku Durrës



Propozimi i zonave funksionale në qarkun Durrës

Qarku i Durrësit është një shembull i qartë i qarkut policentrik, veçori kjo qartësisht e dallueshme në rrethin e Durrësit. Duke marrë parasysh shkëmbimet midis njësive administrative nga të cilat ato më vendimtarët janë aksesit në shërbime, aksesit në edukim, aksesit në punësim dhe shkëmbimet e konsumit, në Qark mund të dallohen me lehtësi disa qendra funksionale ku janë përqendruar këto shërbime, të cilat aksesohen edhe nga njësitet administrative përreth tyre.

Këto qendra tentojnë të jenë në linjë me ndarjen midis rretheve dhe brenda të njëjtit ish rreth vihen re shkëmbime më të dendura midis njësive të caktuara vendore në përputhje me zhvillimin e secilës zonë.

Rrethi Durrës

Rrethi Durrës propozohet të ndahet në dy zona funksionale, respektivisht:

- 1- Zona funksionale Durrës e përbërë nga NJQV ekzistuese Durrës, Katund i Ri, Rrashbull, Sukth dhe Ishëm.
- 2- Zona funksionale Shijak e përbërë nga NJQV ekzistuese Shijak, Xhafzotaj, Gjepalaj, Maminas e Manzë.

Një studim i të dhënave statistikore lidhur me tendencat e shkëmbimeve për punësimin dhe konsumin, aksesin në shërbime, në shëndetësi dhe në edukim tregon për ekzistencën qartë të dy qendrave funksionale në rrethin e Durrësit:

1. Bashkia Durrës ku kanë tendenca të larta shkëmbimesh banorët e njësive vendore të Katundit të Ri, Rrashbullit e Sukthit.
2. Bashkia Shijak ku kanë tendenca të larta shkëmbimesh banorët e Xhafzotajt, Gjepalit dhe Maminasit.

Njësia administrative e Ishmit paraqet tendenca të përziera ndërveprimi që janë pasojë e vendndodhjes gjeografike kufitare të saj, shtrirjes në një territor të madh por me denduri të vogël popullore dhe nivelit të ulët të zhvillimit. Manza paraqet tendenca shkëmbimesh të dendura me Sukthin.


Rrethi Krujë

Rrethi Krujë propozohet të organizohet në një zonë funksionale, respektivisht:

- 1- Zona funksionale Krujë e përbërë nga NJQV ekzistuese të Krujës, Fushë Krujës, Bubqit, Kodër Thumanës dhe Cudhit.

Nga studimi i të dhënave lidhur me tendencat e shkëmbimeve për punësimin dhe konsumin, aksesin në shërbime, në shëndetësi dhe në edukim tregojnë qartë për ekzistencën e të dy qendrave në rrethin e Krujës dhe atë të Fushë Krujës, kryesisht për shkëmbime tregtare dhe konsumi, si dhe Krujën si qendër për të gjitha llojet e shkëmbimeve duke pasur epërsinë e shkëmbimeve institucionale, shëndetësore, arsimore dhe atyre për punësim.

Figura 39. Zonat funksionale në qarkun Durrës




Zona funksionale Durrës

Profili administrativo-territorial

Zona funksionale Durrës me qendër qytetin e Durrësit përbehet nga pesë njësi vendore ekzistuese: bashkia Durrës, bashkia Sukth dhe komunat e Rrashbullit, Katundit të Ri dhe Ishmit. Katër njësitë e reja kanë një lidhje të natyrshme territoriale me qytetin e Durrësit, dy nga të cilat janë njësi kufitare me qytetin e Durrësit, katër prej tyre shtrihen në bregdet ose menaxhojnë një pjesë të bregut duke ndarë interesa të përbashkëta në zhvillime infrastrukturore, urbane, mjedisore dhe industriale, orientuar kryesisht drejt turizmit, tregtisë, industrisë fashone dhe asaj përpunuese. Këto njësi lidhen ngushtë me qytetin e Durrësit nëpërmjet shkëmbimeve me natyrë vendimtare si punësimi, edukimi dhe shëndetësia, dhe ndajnë të njëjtin territor të vazhduar.

Të gjitha njësitë janë në distancë të favorshme nga qendra e zonës funksionale. Njësia me distancë më të largët nga Durrësi është Ishmi me 30 km, distancë që pritet të shkurtohet me përmirësimin e mëtejshëm të infrastrukturës. Njësitë e tjera janë në largësi të papërfillshme nga qendra Durrës. Infrastruktura që lidh Sukthin, Xhafzotajn dhe Rrashbullin me qytetin e Durrësit është e re, e ndërtuar në 10 vitet e fundit dhe secila nga këto njësi ka akses në qendër në më pak se 30 minuta.

Figura 40. Shtrirja territoriale dhe përbërja e zonës funksionale Durrës



Zonës së re i jepet mundësia të sigurojë një administrim të unifikuar të bregdetit prej 62 km me plane të harmonizuara të zhvillimit urban duke i mbështetur këto plane me zhvillime të infrastrukturës atje ku ka më shumë nevojë.

Profili social-demografik

Zona funksionale Durrës do të ketë një popullsi rezidente prej 168 458 banorësh.

Tabela 18. Popullsia e zonës funksionale Durrës

Njësitë përbërëse bashki/komuna	Popullsia Census 2011	Popullsia Regjistri Civil	Sip. Km ²	Dendësia banore për km ²	Distanca nga qendra e ZF Km
Durrës (B)	113 249	201 947	38	2980	0
Rrashbull	24 081	27 615	59	408	10
Sukth (B)	15 966	25 344	53	301	14
Katund I Ri	10 161	15 256	54	188	19
Ishëm	5001	8527	91	55	37
ZF Durrës	168 458	278 689	295	571	


Burimi: INSTAT, RGJC, Llogaritjet e autorëve

Popullsia e zonës është homogjene dhe me traditë shkëmbimesh kulturore të ndërsjella. Edhe pse katër njësitë satelitore kontribuojnë me 87% të sipërfaqes së zonës ato përbëjnë vetëm 33% të popullsisë të të gjithë zonës duke e çuar dendësinë e zonës në 571 banorë për km katror, dendësi e cila është larg nga dendësitë aktuale ekstreme të larta të bashkisë Durrës dhe asaj më të ulët në Ishëm.

Fokus i veçantë do të kërkohet për zonën e Ishmit, zonë e cila ka një shpërndarje të madhe të banorëve dhe ka largësinë më të madhe nga shërbimet.

Ndërveprimi ekonomik


Figura 41. Shpërndarja e bizneseve dhe ndërveprimi ekonomik në ZF Durrës



Burimi: INSTAT

Aksesi në arsim

Figura 42. Shpërndarja e shkollave në ZF Durrës



Burimi: INSTAT

Profili ekonomiko-financiar

Zona funksionale e propozuar me qendër në Durrës do të ofrojë shërbimet e veta në të gjithë territorin e saj. Një pjesë e shërbimeve që janë të lidhura drejtpërdrejt me qytetarin si p.sh. gjendja civile apo ato që lidhen drejtpërdrejt me biznesin (si p.sh. inspektorët e taksave) do të vazhdojnë të ofrohen në të gjitha njësitë.

Shërbimet që lidhen me funksionet e brendshme mbështetëse si financa, prokurimi, marrëdhënia me publikun, planifikimi urban do të përqendrohen në qendrën e zonës duke siguruar një efikasitet më të lartë të punës në sajë të ekonomisë së shkallës dhe evitimit të dublikimit të pozicioneve në zonat e vogla, duke mbuluar volumin e punës për të gjithë territorin me një numër shumë më të vogël personeli mbështetës.

Krahasuar me funksionimin në organizimin aktual në pesë njësi të ndryshme të qeverisjes vendore, zona e re funksionale do të ofrojë shërbimet e veta për të njëjtin territor duke pasur një administratë më efektive dhe do të sigurojë një vendimmarrje më të shpejtë dhe administrim më efikas të territorit me një numër më të reduktuar funksionarësh vendorë.

Tabela 19. Nr. i punonjësve aktualë në NJQV

	NJQV	Nr. i punonjësve	Gjendja Civile
1.	Durrës	240	
2.	Sukth	84	2
3.	Katund i Ri	27	2
4.	Rrashbull	84	2
5.	Ishëm	44	1
	Totali	479	7

Burimi: Prefektura Durrës

Në nivel funksionesh drejtuese për njësitë e vogla do të pushojnë së ekzistuari këto pozicione;

Kryetari dhe n/kryetari i bashkisë/komunës për 4 NJQV, sekretarët e kryetarëve për 4 NJQV, sekretarët e këshillave të bashkive/komunave për 4 NJQV.

Në nivel funksionesh administrative do të shkohet drejt qendërimit të funksioneve mbështetëse (financë, jurist, topograf, inxhinier etj.) në njësinë qendër të zonës së re funksionale, duke bërë që nëpërmjet parimit të ekonomisë së shkallës të kryhet i njëjti shërbim në qendër por me një numër shumë më të vogël punonjësish se sa totali i këtyre punonjësve në çdo njësi vendore ekzistuese. Qendërimi i këtyre funksioneve mund të përballohet nga zyrat aktuale të bashkisë Durrës, duke maksimizuar efikasitetin e stafit ekzistues të tyre ose me shtesa prej një ose dy punonjësish në varësi të ngarkesës së re.

Mungesa e ekzistencës së administratave në katër NJQV-të do të çojë gjithashtu edhe në reduktimin e një sërë pozicionesh mbështetëse, si shoferë, pastruese, roje etj.

Këto pozicione do të vazhdojnë të ekzistojnë në të njëjtën masë në bashkinë Durrës. Ngarkesa e re e punës do të çojë në shtesa prej një ose dy specialistësh në sektorët e financës dhe urbanistikës së kësaj bashkie.

Duhet marrë parasysh se për shkak të ndarjes së detyrave një NJQV aktuale është e detyruar të ketë një strukturë financiare ku përfshihen pozicionet e dublikuara në çdo NJQV të drejtorëve, shefave të sektorëve dhe specialistëve të financës me dy deri në 3 punonjës, të paktën një jurist, roje në tre turne, të paktën një sekretare, një shofer, magazinier, etj. Zona e re funksionale do të ketë të paktën 50 punonjës, më pak vetëm nga evitimi i dublikimeve në pozicionet e drejtorëve dhe të përgjegjësve të sektorëve, shifër e cila pritet të dyfishohet me marrjen në konsideratë të drejtueseve dhe të stafit të tyre mbështetës.

Rritje efikase pritet edhe në zyrat e planifikimit urban dhe të administrimit të territorit. Me qendërimin e këtij funksioni në qendrën e zonës së re funksionale do të shfrytëzohet eksperiencia më e mirë dhe do të evitohet dublikimi me staf në këto funksione në NJQV-të e Sukthit, Rrashbullit, Katundit të Ri dhe Ishmit.

Zona e re funksionale do të vazhdojë të ofrojë në territoret e katër NJQV-ve të përthithura disa nga shërbimet, të cilat nuk mund të ofrohen në mënyrë qendrore, si p.sh. gjendjen civile, shpërndarjen e ndihmës ekonomike, mbledhjen e taksave, inspektimin e territorit,

mirëmbajtjen, grumbullim tarife për shërbimin e ujësjellësit dhe kanalizimeve atje ku nuk ka SHAUK, etj. Administrata e mbetur zë rreth 30 – 40% të administratës aktuale vendore.

Funksionet e NJQV-ve të Sukthit, Katundit të Ri, Rashbullit dhe Ishmit të cilat do të ofrohen në mënyrë qendrore nga qendra e ZF-së së re, si dhe funksionet e shkurtuara si pasojë e zvogëlimit të administratës në këto katër NJQV përbëjnë rreth 60 – 70% të organikës aktuale të këtyre njësive.

Shkurtimi i administratës në katër njësi vendore, dy prej të cilave bashki, do të çojë në shkurtimin proporcional të hapësirave të zyrave dhe të shpenzimeve që lidhen me to si energji elektrike, ujë, qira, mirëmbajtje, shpenzime administrative, shpenzime për blerjen dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të zyrës etj.

Kjo do të çojë në një efekt të menjëhershëm në këtë kategori shpenzimi duke e ulur atë në masën 70% për katër nga pesë njësitë vendore të përthithura në zonën funksionale Durrës.

Bazuar në parimet e mësipërme dhe duke marrë të mirëqenë ruajtjen e të njëjtit nivel shpenzimesh për shërbime dhe investime, me poshtë paraqitet një përlogaritje e situatës së shpenzimeve të zonës funksionale Durrës e krahasuar me funksionimin aktual në pesë njësi vendore të veçanta:

Tabela 20: Efekti në shpenzimet e personelit dhe operative para dhe pas bashkimit

NDARJA EKZISTUESE							
N.R	Njësia	K/B	Popullsia	Shpenzime Total (2012)	Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik (mijë lekë)		
					Shpenzime Personeli Total	Shpenzime Operative	Shpenzimet për Investime
						602-604	230-231
1	Durrës	B	113 249	1 350 000	553 000	529 000	268 000
2	Ishëm	B	15 966	36 000	9000	5000	22 000
3	Katund i Ri	K	24 081	60 000	25 000	6000	29 000
4	Rashbull	K	10 161	163 000	68 000	27 000	68 000
5	Sukth	K	5001	69 000	43 000	19 000	7000
	TOTAL		168 458	1 678 000	698 000	586 000	394 000

NDARJA E RE							
N.R	Njësia	K/B	Popullsia	Shpenzime Total (2012)	Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik (mijë lekë)		
					Shpenzime Personeli Total	Shpenzime Operative	Shpenzimet për Investime
						602-604	230-231
1	Durrës	B	168 458	1 678 000	596 500	580 300	501 200

Burimi: Llogaritjet e autorëve

Riorganizimi i funksioneve dhe administratës vetëm në këtë zonë funksionale çon në një reduktim të përgjithshëm të shpenzimeve në masën 6% ose prej rreth 107 milionë lekë ose


mbi një milionë dollarë të cilat mund të përdoren për investime të reja në këtë zonë me qëllim zhvillimin e balancuar dhe harmonik të të gjithë territorit.

Nëse shpenzimet e kursyera në sajë të mirëadministrimit të burimeve në organizmin e ri territorial do të shtoheshin nivelit aktual total të investimeve në të pesta NJQV-të, ato do të rriteshin nga 394 milionë lekë në 501 milionë lekë në vitin 2012, ose në masën 30%.

Volumi i ri i investimeve për të gjithë zonën u jep një mundësi reale njësisive më pak të zhvilluara për të qenë pjesë e planeve harmonike të zhvillimit të zonës si një e tërë. Në shumicën e NJQV-ve treguesi i investimeve ndryshon ndjeshëm pozitivisht me përjashtim të Durrësit dhe Ishmit, treguesit e të cilëve ndikohen negativisht nga ky bashkim. Veçanërisht në Sukth dhe në Katundin e Ri ky tregues rritet ndjeshëm.


Një efekt shumë pozitiv ndihet edhe në të ardhurat për frymë në zonën e re funksionale, ku ky tregues rritet ndjeshëm për njësitë me të ardhura shumë të ulëta. Në rastin e Katundit të Ri dhe të Sukthit ky tregues katërfishohet duke shprehur qartë mundësinë e banorëve të këtyre zonave për një akses më të lartë në të ardhurat e zonës. Edhe pse treguesi i Durrësit ndikohet negativisht nga qenia pjesë e zonës së re funksionale, pjesa tjetër e zonës përfiton pozitivisht.

Figura 43: Ndryshimi i strukturës së shpenzimeve në zonën funksionale Durrës




Burimi: Llogaritjet e autorëve

Figura 44: Investimet për frymë në ZF Durrës (lekë, 2012)



Llogaritjet e autorëve

Figura 45. Ndryshimi i raportit të të ardhurave të veta për banor në zonën funksionale Durrës



Llogaritjet e autorëve

Figura 46. Ndryshimi i raportit të buxhetit për banor në zonën funksionale Durrës






Figura 47. Ndryshimi i raportit të shpenzimeve operative për banor në zonën funksionale Durrës




Burimi: Llogaritjet e autorëve

Figura 48. Ndryshimi i raportit të shpenzimeve të personelit/banor në zonën funksionale Durrës



Burimi: Llogaritjet e autorëve

Figura 49. Ndryshimi i raportit të numrit të bizneseve/1000 banorë në zonën funksionale Durrës




Burimi: Llogaritjet e autorëve

Të dhëna të tjera për zonën funksionale

Zona ka një infrastrukturë të zhvilluar në sajë të pozicionit të saj strategjik në zonën qendrore të detit Adriatik dhe shërben si nyje e rëndësishme e transportit të udhëtarëve dhe mallrave për të gjithë vendin, për rrjedhojë edhe për vetë banorët e zonës. Një pjesë e saj përshkohet nga rrugë kombëtare të rëndësishme, si autostrada Tiranë-Durrës, rruga Durrës-Kukës, aksi kombëtar Durrës - Rrogozhinë.

Figura 50. Rrjeti rrugor ZF Durrës



Burimi: MÇV

Të gjitha komunat dhe bashkitë e zonës lidhen me qendrën në Durrës me rrugë interurbane dytësore dhe pothuajse të gjitha fshatrat kanë akses në rrugë të shtruara.

Shërbimi i furnizimit me ujë dhe kanalizime në pesë njësitë e zonës ofrohet nga SHAUK Durrës ku NJQV-të janë aksionare. Krijimi i zonave të reja funksionale do të çojë në një menaxhim më të drejtpërdrejtë dhe në një vendimmarrje më të thjeshtuar në këtë SHAUK, duke hedhur premisat për përmirësimin e indikatorëve të shërbimit për të gjithë zonën. Kjo SHAUK ka nën administrim edhe impiantin e grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura në Durrës i cili është një nga investimet më të mëdha të viteve të fundit në zonë. Ky impiant ka një rëndësi strategjike për cilësinë e detit, për turizmin në zonë dhe për të gjithë vendin. Në kushtet aktuale me drejtimin e komplikuar dhe pamundësinë e SHAUK për të mbuluar kostot operuese të këtij impianti ky investim mbetet i rrezikuar. Menaxhimi i drejtpërdrejtë i SHAUK Durrës do të çojë në rritjen e mundësive ekonomike për të mbajtur në punë këtë impiant të rëndësishëm.

Përfundime

Organizimi i pesë njësive vendore në një zonë të re funksionale me qendër Durrësin do të çojë në një menaxhim më të mirë të burimeve njerëzore dhe kapitale të zonës duke rritur kapacitetin investues me rreth 107 milionë lekë (2012) vetëm nga ndikimi në staf dhe shpenzime operative.

Rritja e kapacitetit investues dhe bashkimi i tij në një buxhet të vetëm rrit mundësinë e territoreve me popullsi të vogël për të pasur akses më të madh në investime dhe për t'u bërë pjesë e zhvillimit të harmonizuar të zonës.

Mesatarja e investimeve për frymë në zonë do të rritet nga 2,4 mijë lekë në rreth 3 mijë lekë.

Ngarkesa mesatare e administratës vendore për 1000 banorë do të ulet nga 2,84 aktualisht në 1,89 për 1000 banorë. Paralelisht me këtë fakt ulen edhe shpenzimet administrative për frymë në këtë zonë, krahasuar me mesataren e këtij treguesi në pesë njësitë e ndara, nga 4,1 mijë lekë për frymë në 3,5 mijë lekë për frymë.

Ndërveprimi i shtuar i njësive me qendrën e zonës do të çojë në përmirësime të mëtejshme të infrastrukturës rrugore.

Menaxhimi qendror nga entitete të mëdha dhe me eksperience në administrim vendor do të çojë në një menaxhim më të mirë të ndërmarrjeve shtetërore vendore, në veçanti të atyre të ujësjellës-kanalizime.

Menaxhimi qendror i shërbimeve të tjera në zonë (pastrim dhe mirëmbajtje) do të bëjë të mundur modernizim e këtyre shërbimeve në zonat me buxhet të vogël.

Menaxhimi qendror i zonës do të lehtësojë pjesëmarrjen në projekte zhvillimi rajonale dhe kombëtare, si dhe aksesin në financime nga buxheti i shtetit dhe donatorë të huaj.


Zona funksionale Shijak

Profili administrativo-territorial

Zona funksionale Shijak me qendër qytetin e Shijakut përbëhet nga pesë njësi vendore ekzistuese: bashkia Shijak, bashkia Manëz, komunat Xhafzotaj, Gjepalaj dhe Maminas. Tre nga këto njësi janë njësi kufitare me Shijakun dhe kanë një shtrirje territoriale të vazhdueshme duke ndarë interesa të përbashkëta në zhvillime infrastrukturore, urbane, mjedisore dhe industriale, orientuar kryesisht drejt turizmit, tregtisë, industrisë fasone dhe asaj përpunuese e prodhuese. Këto njësi lidhen ngushtë me qytetin e Shijakut nëpërmjet shkëmbimeve me natyrë vendimtare si punësimi, edukimi dhe shëndetësia, si dhe ndajnë të njëjtin territor të vazhduar.

Të gjitha njësitë janë në distancë të favorshme nga qendra e zonës funksionale.

Figura 51. Shtrirja territoriale dhe përbërja e zonës funksionale Shijak



Njësia me distancë më të largët nga qendra e zonës funksionale është Manza me 30 km, e cila lidhet me Shijakun me infrastrukturë të mirë dytësore. Njësitë e tjera janë në largësi të papërfillshme nga qendra Shijak. Infrastruktura që lidh Gjepalajn, Xhafzotajn, Maminasin e Manzën me Shijakun është e re e ndërtuar në 10 vitet e fundit dhe secila nga këto njësi ka akses në qendrën Shijak në më pak se 30 minuta.

Profili social-demografik

Zona funksionale Shijak do të ketë një popullsi rezidente prej 34 513 banorësh.

Tabela 21. Popullsia e zonës funksionale Shijak

Njësitë përbërëse	Popullsia Census 2011	Popullsia Regjistri Civil	Sip. Km ²	Dendësia banore për km ²	Distanca nga qendra e ZF km
Shijak (B)	7568	12 930	4,88	1551	0
Xhafzotaj	12 381	17 297	26,74	463	1,8
Gjepalaj	3449	5776	32,96	105	1,8
Maminas	4463	6926	27,62	162	6,3
Manzë (B)	6652	10 906	43,25	154	15
ZF Shijak	34 513	53 835	135,45	255	

Burimi: INSTAT, Google maps

Popullsia e zonës është homogjene dhe me traditë shkëmbimesh kulturore të ndërsjella. Në vitet e fundit zona është kthyer në një destinacion atraktiv për migrimin e brendshëm, tendencat e të cilit janë nga zonat rurale të qarkut Dibër drejt komunave të Xhafzotajt, Manzës, e Maminasit, si edhe Sukthit dhe Kamzës. Edhe pse katër njësitë satelitore përbëjnë mbi 96% të sipërfaqes së zonës ato përbëjnë vetëm 33% të popullsisë të të gjithë zonës duke e çuar dendësinë e zonës në 255 banorë për km², dendësi e cila është sa një e gjashta e dendësisë aktuale ekstreme të bashkisë Shijak dhe dy herë më e lartë se dendësia më e ulët në zonën e Gjepalajt. Duke parë ndryshimin e madh midis popullsisë rezidente dhe asaj prezente në regjistrat civilë vihet re se, zona është e prekur ndjeshëm nga emigracioni. Remitancat e emigrantëve kanë luajtur një rol të madh në zhvillimin e zonës, kryesisht në Shijak dhe Xhafzotaj.

Profili ekonomiko-financiar

Zona funksionale e propozuar me qendër në Shijak do të ofrojë të gjitha shërbimet e veta në të gjithë territorin e saj. Një pjesë e shërbimeve që janë të lidhura drejtpërdrejt me qytetarin si p.sh. gjendja civile apo ato që lidhen drejtpërdrejt me biznesin (si p.sh. inspektorët e taksave) do të vazhdojnë të ofrohen në të gjitha njësitë.

Shërbimet që lidhen me funksionet e brendshme mbështetëse si financa, prokurimi, marrëdhëniet me publikun, planifikimi urban, do të përqendrohen në qendrën e zonës duke siguruar një efikasitet më të lartë të punës në sajë të ekonomisë së shkallës dhe evitimit të dublikimit të pozicioneve në zonat e vogla, duke mbuluar volumin e punës për të gjithë territorin me një numër më të vogël personeli mbështetës.

Krahasuar me funksionimin në organizimin aktual në pesë njësi të ndryshme të qeverisjes vendore, zona e re funksionale do të ofrojë shërbimet e veta për të njëjtin territor duke pasur një administratë më efikase dhe do të sigurojë një vendimmarrje më të shpejtë dhe administrim më efikas të territorit me një numër më të reduktuar funksionarësh vendorë.

Tabela 22. Nr. i punonjësve aktualë në NJQV, zona funksionale Shijak

NJQV	Nr. i punonjësve	Gjendja Civile
Shijak	52	2
Xhafzotaj	31	2
Gjepalaj	24	1
Maminas	38	1
Manëz	52	1
Totali	197	7

Burimi: Prefektura Durrës

Në nivel funksionesh drejtuese për njësitë e vogla do të pushojnë së ekzistuari këto pozicione;

Kryetari dhe n/kryetari i bashkisë/komunës, sekretarët e kryetarëve dhe sekretaret e këshillave të bashkive/komunave për 4 NJQV-të e Xhafzotajt, Gjepalajt, Maminasit dhe Manzës.

Në nivel funksionesh administrative do të shkohet drejt qendërimit të funksioneve mbështetëse (financë, jurist, topograf, inxhinier, urbanist etj.) në njësinë qendër të zonës së re funksionale duke bërë që nëpërmjet parimit të ekonomisë së shkallës të kryhet i njëjti shërbim në qendër por me një numër shumë më të vogël punonjësish se sa totali i këtyre punonjësve në çdo njësi vendore ekzistuese. Qendërimi i këtyre funksioneve mund të përballohet nga zyrat aktuale të bashkisë Shijak, duke maksimizuar efikasitetin e stafit ekzistues të tyre ose me shtesa prej një ose dy punonjësish në varësi të ngarkesës së re.

Mungesa e ekzistencës së administratave në katër NJQV-të do të çojë gjithashtu edhe në reduktimin e një sërë pozicionesh mbështetëse, si shoferë, pastruese, roje etj.

Këto pozicione do të vazhdojnë të ekzistojnë në të njëjtën masë në bashkinë Shijak.

Duhet marrë parasysh se për shkak të ndarjes së detyrave, një NJQV aktuale është e detyruar të ketë një strukturë financiare ku përfshihen pozicionet e dublikuara në çdo NJQV të drejtorëve, shefave të sektorëve dhe specialisteve të financës me dy deri në tre punonjës, të paktën një jurist, roje në tre turne, të paktën një sekretare, një shofer, magazinier, etj. Zona e re funksionale do të ketë të paktën 93 punonjës, më pak vetëm nga evitimi i dublikimeve në pozicionet e drejtorëve dhe të përgjegjësve të sektorëve, shifër e cila pritet të dyfishohet me marrjen në konsideratë të drejtuesve dhe të stafit të tyre mbështetës.

Rritje efikasiteti pritet edhe në zyrat e planifikimit urban dhe të administrimit të territorit. Me qendërimin e këtij funksioni në qendrën e zonës së re funksionale do të shfrytëzohet eksperiencia më e mirë dhe do të evitohet dublikimi në këto funksione në NJQV-të e Xhafzotajt, Gjepalajt, Maminasit dhe Manzës.

Zona e re funksionale do të vazhdojë të ofrojë në territoret e katër NJQV-ve të përthithura disa nga shërbimet, të cilat nuk mund të ofrohen në mënyrë qendrore, si p.sh. gjendjen civile, shpërndarjen e ndihmës ekonomike, mbledhjen e taksave, inspektimin e territorit, mirëmbajtjen, grumbullim tarife për shërbimin e ujësjellësit dhe kanalizimeve atje ku ka, etj. Administrata e mbetur zë rreth 35% të administratës aktuale.

Funksionet e NJQV-ve të Xhafzotajt, Gjepalajt, Maminasit dhe Manzës të cilat do të ofrohen në mënyrë qendrore nga qendra e ZF-së së re, si dhe funksionet e shkurtuara si pasojë e zvogëlimit të administratës në këto katër NJQV përbëjnë rreth 60 – 70% të organikës aktuale të këtyre njësive.

Shkurtimi i administratës në katër njësi vendore, njëra prej të cilave bashki, do të çojë në shkurtimin proporcional të hapësirave të zyrave dhe të shpenzimeve që lidhen me to si energji elektrike, ujë, qira, mirëmbajtje, shpenzime administrative, shpenzime për blerjen dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të zyrës etj.

Kjo do të çojë në një efekt të menjëhershëm në këtë kategori shpenzimi duke e ulur atë në masën 65% për katër nga pesë njësitë vendore të përthithura në zonën funksionale Shijak.

Bazuar në përlllogaritje paraprake, duke marrë të mirëqenë ruajtjen e punonjësve të shërbimeve publike dhe atyre të gjendjes civile në çdo komunë aktuale, pamja e re e përlllogaritur e numrit të punonjësve në zonën e re funksionale Shijak është si më poshtë:

Tabela 23. Nr. i përlllogaritur i punonjësve në ZF Shijak

	Nr. i punonjësve	Gjendja Civile
Shijak	54	2
Xhafzotaj	11	2
Gjepalaj	8	1
Maminas	13	1
Manëz	18	1
Totali	104	7

Burimi: Llogaritjet e autorëve

Bazuar në parimet e mësipërme dhe duke marrë të mirëqenë ruajtjen e të njëjtit nivel shpenzimesh për shërbime dhe investime, më poshtë paraqitet një përlllogaritje e situatës së shpenzimeve të zonës funksionale Shijak e krahasuar me funksionimin aktual në pesë njësi vendore.

Tabela 24. Efekti në shpenzimet e personelit dhe operative para dhe pas bashkimit


NDARJA EKZISTUESE							
N.R	Njësia	K/B	Popullsia	Shpenzime Total (2012)	Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik (mijë lekë)		
					Shpenzime Personeli Total	Shpenzime Operative 602-604	Shpenzimet për Investime 230-231
1	Gjepalaj	B	3449	36 000	8000	7000	21 000
2	Maminas	K	4463	20 000	14 000	6000	-
3	Manëz	K	6652	55 000	28 000	12 000	15 000
4	Shijak	K	7568	51 000	25 000	14 000	12 000
5	Xhafzotaj	B	12 381	122 000	22 000	35 000	65 000
TOTAL			34 513	284 000	97 000	74 000	113 000

NDARJA E RE							
N.R	Njësia	K/B	Popullsia	Shpenzime Total	Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik (mijë lekë)		
					Shpenzime Personeli	Shpenzime Operative	Shpenzimet Investime
1	Krujë	B	34 513	284 000	46 600	68 000	169 400

Riorganizimi i funksioneve dhe administratës vetëm në këtë zonë funksionale krijon një reduktim të përgjithshëm të shpenzimeve në masën 18% ose prej rreth 56 milionë lekë, të cilat mund të përdreshin për investime të reja në këtë zonë, me qëllim zhvillimin e balancuar dhe harmonik të të gjithë territorit.

Nëse shpenzimet e kursyera në sajë të mirëadministrimit të burimeve në organizmin e ri territorial do t'i shtoheshin nivelit aktual total të investimeve në të pesta NJQV-të, ato do të rriteshin nga 113 milionë lekë në 170 milionë lekë ose në masën 50%.


Figura 52. Ndryshimi i strukturës së shpenzimeve në zonën funksionale Shijak (mijë lekë, 2012)



Burimi: Llogaritjet e autorëve

Volumi i ri i investimeve për të gjithë zonën u jep një mundësi reale njësisive më pak të zhvilluara për të qenë pjesë e planeve harmonike të zhvillimit të zonës si një e tërë. Treguesi i investimeve për banor ndryshon si tek Figura 53 më poshtë:


Figura 53. Investimet për frymë në ZF Shijak (lekë, 2012)



Burimi: Llogaritjet e autorëve


Efekti në të ardhurat për frymë është pozitiv për të gjitha njësitë përbërëse me përjashtim të Maminasit, i cili është edhe kontribuues kryesor në të ardhurat e zonës dhe ndikohet negativisht nga ky bashkim.

Figura 54. Ndryshimi i raportit të të ardhurave të veta për banor në zonën funksionale Shijak




Burimi: Llogaritjet e autorëve

Figura 55. Ndryshimi i raportit të shpenzimeve të personelit për banor në zonën funksionale Shijak




Burimi: Llogaritjet e autorëve

Figura 56. Ndryshimi i raportit të shpenzimeve operative për banor në zonën funksionale Shijak




Burimi: Llogaritjet e autorëve

Figura 57. Ndryshimi i raportit të buxhetit për banor në zonën funksionale Shijak



Burimi: Llogaritjet e autorëve

Figura 58. Ndryshimi i raportit të numrit të bizneseve/1000 banorë në zonën funksionale Shijak




Burimi: Llogaritjet e autorëve

Të dhëna të tjera për zonën funksionale


Të gjitha njësitë përbërëse të zonës funksionale kanë akses shumë të shpejtë në qendër të zonës. Gjepalaj, Xhafzotaj dhe Manza lidhen me Shijakun brenda 10 minutave ndërsa zona më e largët është Maminasi, e cila merr akses në Shijak brenda jo më shumë se 20 minuta. Këto distanca bëjnë të mundur funksionimin normal të Shijakut si qendër e zonës.

Figura 59. Distancat e njësive përbërëse të ZF Shijak



Edhe pse institucionet arsimore janë të shpërndara në të gjithë zonën, në hartën më poshtë kuptojmë se shkollat në zonat e Manzës dhe Gjepalajt janë në kushte më të pafavorshme se ato të njësive të tjera. Kjo mund të çojë në një orientim të nxënësve drejt shkollave me kushte më të mira në njësitë fqinje.

Figura 60. Shtrirja territoriale dhe gjendja e institucioneve arsimore në zonën funksionale Shijak



Përfundime

Organizimi i pesë njësive vendore në një zonë të re funksionale me qendër Shijakun do të çojë në një menaxhim më të mirë të burimeve njerëzore dhe kapitale të zonës duke rritur kapacitetin investues me rreth 57 milionë lekë vetëm nga ndikimi i kursimeve në staf dhe shpenzime operative.

Shpenzimet administrative për banor ulen me 32,5% ndërsa investimet për frymë rriten nga 3300 lekë në 4900 lekë për frymë.

Rritja e kapacitetit investues dhe bashkimi i tij në një buxhet të vetëm rrit mundësinë e territoreve me popullsi të vogël për të pasur akses më të madh në investime dhe për tu bërë pjesë e zhvillimit të harmonizuar të zonës, në veçanti të qendrës Shijak e cila është në nevojë të ngutshme për investime, në sektorin e arsimit dhe atë shëndetësor në sajë të dendurisë së popullsisë dhe qenies së saj si pikë reference për shkëmbime të kësaj natyre me komunat rreth saj.

Ndërveprimi i shtuar i njësive me qendrën e zonës do të çojë në përmirësime të mëtejshme të infrastrukturës rrugore.

Menaxhimi qendror nga entitete më të mëdha dhe me eksperiencë në administrim vendor do të çojë në një menaxhim më të mirë të ndërmarrjeve shtetërore vendore.

Menaxhimi qendror i shërbimeve të tjera në zonë (pastrim dhe mirëmbajtje) do të bëjë të mundur modernizimin e këtyre shërbimeve në zonat me buxhet të vogël.

Ngarkesa mesatare e administratës vendore do të ulet nga 5,7 punonjës për 1000 banorë në 3 punonjës për 1000 banorë.

Menaxhimi qendror i zonës do të lehtësojë pjesëmarrjen në projekte zhvillimi rajonale dhe kombëtare, si dhe aksesin në financime nga buxheti i shtetit dhe donatorë të huaj.

Zona funksionale Krujë


Profili administrativo-territorial

Zona funksionale Krujë përputhet në territor me rrethin Krujë, pjesë e qarkut të Durrësit, i përbërë nga gjashtë njësi të qeverisjes vendore: bashkia Krujë, bashkia Fushë-Krujë, komunat Thumanë, Nikël, Cudhi dhe Bubq.

Në zonë dallohen dy qendra: për sa i përket demografisë dhe ekonomisë qendra e zonës është Fushë-Kruja, ndërkohë që tradicionalisht, institucionalisht dhe administrativisht, si dhe për lidhje të forta historike, qendra e zonës mbetet qyteti i Krujës.

Katër nga njësitë e përthithura janë njësi kufitare me bashkinë Krujë dhe qëndrojnë kundrejt Krujës sipas modelit koncentrik. Njësia e vetme jo-kufitare me Krujën është Bubqi, e cila dallon edhe nga natyra e ndërveprimeve të cilat do të shpjegohen më poshtë. Për shkak të parimit të vazhdimësisë territoriale, numrit të vogël dhe dendësisë së ulët të popullsisë kjo njësi do të jetë pjesë e ZF Krujë, për të rritur kapacitetin e saj të marrjes së shërbimeve nga një ZF më e madhe dhe më e fortë financiarisht.

Figura 61: Shtrirja e zonës funksionale Krujë



E njëjta situatë paraqitet në studim edhe për komunën e Niklës, e cila në sajë të pozitës kufitare në rreth dhe afërsisë territoriale tenton të ketë shkëmbime të shpeshta me Tiranën pothuajse në të gjithë treguesit përcaktues. Për arsye tradicionale që lidhen me origjinën e popullsisë, lidhjet historike dhe përkatësinë kulturore kjo njësi do të jetë pjesë e ZF Krujë.

Tre prej NJQV-ve shtrihen në zona malore dhe përbëjnë edhe kufirin veri-lindor të qarkut dhe zonat me dendësinë më të vogël të popullsisë në rreth. Kruja mbetet pika e vetme e referimit për këto dy komuna për sa u përket shërbimeve jetike.

Ndërkohë që zhvillimi i infrastrukturës dhe pozita ndërkufitare në rreth bën që komunat e Niklës dhe Bubqit përveç tendencave të shkëmbimeve me dy qendrat e zonës (Fushë-Krujë e Krujë) të kenë shkëmbime të shpeshta dhe me zonat funksionale kufitare: Tiranë e Durrës.


Profili social-demografik

Tabela 25. Popullsia dhe tregues të tjerë të zonës funksionale Krujë

Njësitë përbërëse bashki/komuna	Popullsia Census 2011	Sip. Km2	Dendësia banore për km2	Distanca nga qendra e ZF Km	Distanca në min.
Krujë (B)	11 721	49,85	235	0	
Fushë-Krujë (B)	18 477	44,54	415	11,2	17
Thumanë	12 335	68,60	180	19,6	21
Cudhi	1812	81,25	22	17,1	23
Bubq	5951	49,26	121	16	19
Nikël	9518	42,15	226	24	1orë5min.
ZF Krujë	59 814	335,65	178		


Burimi: Llogaritjet e autorëve

Figura 62. Distancat e njësive përbërëse të ZF Krujë. Ndërveprimi për punësim në ZF Krujë



Edhe pse jo kufitare me Krujën, zonat e Bubqit ashtu, si dhe zonat fqinje të Niklës, Kodër Thumanës e Fushë Krujës kanë akses shumë të shpejtë në qendrën e zonës funksionale Krujë si rrjedhojë e vendosjes gjeografike dhe infrastrukturës së përmirësuar. Banorët të cilëve ju duhet të udhëtojnë më shumë për të marrë shërbimet në Krujë janë ata të Cudhit, kohë e cila kushtëzohet nga vendndodhja gjeografike në një zonë malore dhe infrastruktura e pazhvilluar. Gjithsesi, distanca është e përballueshme për të lejuar një udhëtim ditor dhe Kruja mbetet qendra më e afërt për banorët e Cudhit për të kryer pjesën më të madhe të shkëmbimeve të rëndësishme.

Figura 63. Shpërndarja dhe gjendja e institucioneve arsimore në ZF Krujë



Ndërveprimi për shërbime shëndetësore

Prezenca e spitali rajonal në Krujë dikton qartësisht edhe tendencën e shkëmbimeve në këtë faktor vendimtar. Banorët e ZF Krujë drejtohen drejt qytetit të Krujës për shërbime shëndetësore. Kjo tendencë në këtë rast është e qartë edhe për Bubqin, ndërsa Nikla i kryen këto shërbime në Tiranë, ku qendra më e afërt spitalore është Spitali Ushtarak.

Profili ekonomiko-financiar

Zona funksionale e propozuar me qendër në Krujë do të ofrojë të gjitha shërbimet e veta në të gjithë territorin e saj.

Një pjesë e shërbimeve që janë të lidhura drejtpërdrejt me qytetarin si p.sh. gjendja civile apo ato që lidhen drejtpërdrejt me biznesin si p.sh. inspektorët e taksave do të vazhdojnë të ofrohen në të gjitha njësitë.

Shërbimet që lidhen me funksionet mbështetëse si financa, prokurimi, marrëdhënia me publikun, planifikimi urban etj., do të përqendrohen në qendrën e zonës duke siguruar një efikasitet më të lartë të punës në sajë të ekonomisë së shkallës dhe evitimit të dublikimit të

pozicioneve në zonat e vogla, duke mbuluar volumin e punës për të gjithë territorin me një numër më të vogël personeli mbështetës.

Krahasuar me funksionimin në organizimin aktual në pesë njësi të ndryshme të qeverisjes vendore, zona e re funksionale do të ofrojë shërbimet e veta për të njëjtin territor duke pasur një administratë më efikase dhe do të sigurojë një vendimmarrje më të shpejtë dhe administrim më efikas të territorit, me një numër më të reduktuar funksionarësh vendorë.

Tabela 26. Nr. i punonjësve aktual në NJQV zona funksionale Krujë,

Numri ekzistues i punonjësve buxhetore në 6 NJQV		
NJQV	Nr. i punonjësve	Gjendja Civile
Krujë	127	2
Fushë-Krujë	92	2
Nikël	43	1
Bubq	50	1
Kodër Thumanë	84	2
Cudhi	16	1
Totali	412	9

Burimi: Bashkitë dhe komunat

Në nivel funksionesh drejtuese për njësitë e vogla do të pushojnë së ekzistuari këto pozicione:

Kryetari dhe n/kryetari i bashkisë/komunës, sekretarët e kryetarëve dhe sekretarët e këshillave të bashkive/komunave për 5 NJQV-të e Fushë-Krujës, Kodër Thumanës, Cudhit, Bubqit dhe Niklës.

Në nivel funksionesh administrative do të shkohet drejt qendërimit të funksioneve mbështetëse (financë, jurist, topograf, inxhinier, urbanist etj.) në njësinë qendër të zonës së re funksionale duke bërë që nëpërmjet parimit të ekonomisë së shkallës të kryhet i njëjti shërbim në qendër por me një numër shumë më të vogël punonjësish se sa totali i këtyre punonjësve në secilën njësi vendore ekzistuese. Qendërimi i këtyre funksioneve mund të përballohet nga zyrat aktuale të bashkisë Krujë, duke maksimizuar efikasitetin e stafit ekzistues të tyre ose me shtesa prej një ose dy punonjësish në varësi të ngarkesës së re.

Mungesa e ekzistencës së administratave në katër NJQV-të do të çojë gjithashtu edhe në reduktimin e një sërë pozicionesh mbështetëse, si shoferë, pastruese, roje etj.

Këto pozicione do të vazhdojnë të ekzistojnë në të njëjtën masë në bashkinë Krujë.

Duhet marrë parasysh se për shkak të ndarjes së detyrave, një NJQV aktuale është e detyruar të ketë një strukturë financiare ku përfshihen pozicionet e dublikuara në çdo NJQV të drejtorëve, shefave të sektorëve dhe specialistëve të financës me dy deri në 3 punonjës, të paktën një jurist, roje në tre turne, të paktën një sekretare, një shofer, magazinier, etj. Zona e re funksionale do të ketë të paktën 180 punonjës më pak vetëm nga evitimi i dublikimeve në

pozicionet e drejtorëve dhe të përgjegjësve të sektorëve, shifër e cila pritet të dyfishohet me marrjen në konsideratë të drejtuesve dhe të stafit të tyre mbështetës.

Rritje efikase pritet edhe në zyrat e planifikimit urban dhe të administrimit të territorit. Me qendërzimin e këtij funksioni në qendrën e zonës së re funksionale do të shfrytëzohet eksperiencia më e mirë dhe do të evitohet dublikimi në këto funksione në NJQV-të e përthithura.

Zona e re funksionale do të vazhdojë të ofrojë në territoret e pesë NJQV-ve të përthithura disa nga shërbimet, të cilat nuk mund të ofrohen në mënyrë qendrore, si p.sh. gjendjen civile, shpërndarjen e ndihmës ekonomike, mbledhjen e taksave, inspektimin e territorit, mirëmbajtjen, grumbullim tarife për shërbimin e ujësjellësit dhe kanalizimeve atje ku ka, etj. Administrata e mbetur në këto territore zë rreth 35% të administratës aktuale.

Shkurtimi i administratës në katër njësi vendore, njëra prej të cilave është bashki, do të çojë në shkurtimin proporcional të hapësirave të zyrave dhe të shpenzimeve që lidhen me to si energji elektrike, ujë, qira, mirëmbajtje, shpenzime administrative, shpenzime për blerjen dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të zyrës etj.

Kjo do të çojë në një efekt të menjëhershëm në këtë kategori shpenzimi duke e ulur atë në masën 30% për pesë nga njësitë vendore të përthithura në zonën funksionale Krujë.

Bazuar në përlllogaritje paraprake, duke marrë të mirëqenë ruajtjen e punonjësve të shërbimit, atyre të gjendjes civile në çdo komunë aktuale, pamja e re e përlllogaritur e numrit të punonjësve në zonën e re funksionale Krujë është si më poshtë:

Tabela 27. Numri aktual i punonjësve në NJQV

Numri i ri i përlllogaritur i punonjësve në ZF Krujë		
	Nr. i punonjësve	Gjendja Civile
Krujë	130	2
Fushë-Krujë	32	2
Nikël	15	1
Bubq	18	1
Kodër Thumanë	29	2
Cudhi	6	1
Totali	230	9

Burimi: Llogaritjet e autorëve

Bazuar në parimet e mësipërme dhe duke marrë të mirëqenë ruajtjen e të njëjtit nivel shpenzimesh për shërbime dhe investime, më poshtë paraqitet një përlllogaritje e situatës së shpenzimeve të zonës funksionale Krujë e krahasuar me funksionimin aktual në gjashtë njësi vendore të veçanta.

Tabela 28. Efekti në shpenzimet e personelit dhe operative para dhe pas bashkimit

NDARJA EKZISTUESE							
N.R	Njësia	K/B	Popullsia	Shpenzime Total	Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik (milion lekë)		
					Shpenzime Personeli Total	Shpenzime Operative	Shpenzimet Investime
1	Krujë	B	11 721	82	56	17	9
2	Fushë-Krujë	B	18 477	151	46	68	37
3	Nikël	K	9518	29	20	9	0
4	Bubq	K	5951	25	12	5	8
5	Kodër Thumanë	K	12 335	68	22	12	34
6	Cudhi	K	1812	13	5	3	5
TOTAL			59 814	368	161	114	93


NDARJA E RE							
N.R	Njësia	K/B	Popullsia	Shpenzime Total	Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik (milion lekë)		
					Shpenzime Personeli	Shpenzime Operative	Shpenzimet Investime
1	Krujë	B	59 814	368	91	92	185

Burimi: Llogaritjet e autorëve

Riorganizimi i funksioneve dhe administratës vetëm në këtë zonë funksionale çon në një reduktim të përgjithshëm të shpenzimeve në masën 25% ose prej rreth 92 milionë lekë ose 920 mijë dollarë të cilat mund të përdoren për investime të reja në këtë zonë me qëllim zhvillimin e balancuar dhe harmonik të të gjithë territorit.


Nëse shpenzimet e kursyera në sajë të mirëadministrimit të burimeve në organizmin e ri territorial do t'i shtoheshin nivelit aktual total të investimeve në të pesta NJQV-të, ato pothuajse do të dyfishoheshin duke u rritur nga 93 milionë lekë në 185 milionë lekë.

Figura 64. Ndryshimi i grupeve të shpenzimeve në zonën funksionale Krujë




Burimi: Llogaritjet e autorëve

Figura 65. Ndryshimi i raportit të investimeve për banor në zonën funksionale Krujë




Burimi: Llogaritjet e autorëve

Figura 66. Ndryshimi i raportit të të ardhurave për banor në zonën funksionale Krujë




Burimi: Llogaritjet e autorëve

Figura 67. Ndryshimi i raportit të buxhetit për banor në zonën funksionale Krujë




Burimi: Llogaritjet e autorëve

Figura 68. Ndryshimi i raportit të shpenzimeve të personelit për banor në zonën funksionale Krujë




Burimi: Llogaritjet e autorëve

Figura 69. Ndryshimi i raportit të shpenzimeve operative për banor në zonën funksionale Krujë



Burimi: Llogaritjet e autorëve

Figura 70. Ndryshimi raportit të shpenzimeve të bizneseve/banor në zonën funksionale Krujë



Burimi: Llogaritjet e autorëve

Përfundime

Organizimi i gjashtë njësive vendore në një zonë të re funksionale me qendër Krujën, do të hapë rrugën për një menaxhim më të mirë të burimeve njerëzore dhe kapitale të zonës duke rritur kapacitetin investues me rreth 92 milionë lekë vetëm nga ndikimi i ekonomisë së shkallës në staf dhe në shpenzime operative.

Rritja e kapacitetit investues dhe bashkimi i tij në një buxhet të vetëm rrit mundësinë e territoreve me popullsi të vogël për të pasur akses më të madh në investime dhe për tu bërë pjesë e zhvillimit të harmonizuar të zonës, në veçanti të zonave disi të izoluara, si Cudhi dhe Kodër Thumanë.

Ndërveprimi i shtuar i njësive me qendrën e zonës do të çojë në përmirësime të mëtejshme të infrastrukturës rrugore veçanërisht për njësitë skajore të zonës.

Njësia me distancë më të madhe nga qendra e zonës funksionale mbetet Nikla e cila kryen me qendrën vetëm shkëmbime të natyrës administrative. Shkëmbimet e tjera kjo njësi i kryen kryesisht me njësitë kufitare Tiranë e Fushë-Krujë.

Shpenzimet administrative për banor ulen me 25% nga 5 mijë lekë në 4 mijë lekë për frymë, ndërsa investimet për frymë rriten nga 2 mijë lekë në 3,09 mijë lekë për frymë.

Ngarkesa mesatare e administratës vendore do të ulet nga 6,89 punonjës për 1000 banorë në 3,85 punonjës për 1000 banorë.

Menaxhimi qendror nga entitete të mëdha dhe me eksperiencë në administrim vendor do të çojë në një menaxhim më të mirë të ndërmarrjeve shtetërore vendore.

Menaxhimi qendror i shërbimeve të tjera në zonë (pastrim dhe mirëmbajtje) do të bëjë të mundur modernizim e këtyre shërbimeve në zonat me buxhet të vogël.


Menaxhimi qendror i zonës do të lehtësojë pjesëmarrjen në projekte zhvillimi rajonale dhe kombëtare, si dhe do të rrisë aksesin në financime nga buxheti i shtetit dhe donatorë të huaj.

QARKU ELBASAN

Profili i qarkut Elbasan

Qarku i Elbasanit përbëhet nga 50 njësi të qeverisjes vendore në katër rrethe: rrethi i Elbasanit (23 njësi, qendër Elbasan); rrethi i Gramshit (10 njësi, qendër Gramsh), rrethi i Librazhdit (11 njësi, qendër Librazhd) dhe rrethi i Peqinit (6 njësi, qendër Peqin). Popullsia e qarkut të Elbasanit ishte 295 827 banorë në vitin 2011, ndër të cilët 64% (188 662 banorë) jetojnë në rrethin e Elbasanit, 19% (56 798) jetojnë në rrethin e Librazhdit dhe vetëm nga 9% jetojnë përkatësisht në Gramsh dhe Peqin. (INSTAT, Census 2011).

Figura 1: NJQV-të në qarkun e Elbasanit sipas popullsisë



Burimi: INSTAT, Census 2011; Llogaritjet e autorëve

Qarku i Elbasanit ka pasur një humbje neto të popullsisë prej rreth 31% ose mbi 131 mijë banorë krahasuar me të dhënat zyrtare të Regjistrimit të Gjendjes Civile të vitit 2011. Sipas të dhënave zyrtare të RGJC-së në janar 2012 në qarkun e Elbasanit ishin të regjistruar 427 114 banorë, me përqendrim të ngjashëm me atë të raportuar nga Censusi 2011, pra 65% në Elbasan, 17,7% në Librazhd dhe 8,7% dhe 8,4% të regjistruar përkatësisht në Peqin dhe Gramsh.

Tabela 1: Diferenca mes popullsisë sipas INSTAT-it dhe RGJC-së në 2011 për qarkun Elbasan

Qarku	Rrethi	Njësia	Census 2011	Regjistri civil 2011	Ndryshimi i popullsisë	Ndryshimi ne %
Elbasa	Elbasan	Rrasë	1594	2294	-700	-31%
Elbasa	Elbasan	Zavalinë	1622	2100	-478	-23%
Elbasa	Elbasan	Fierzë	2065	3738	-1673	-45%
Elbasa	Elbasan	Funarë	2122	3137	-1015	-32%
Elbasa	Elbasan	Gracen	2192	2521	-329	-13%
Elbasa	Elbasan	Tregan	3036	4282	-1246	-29%
Elbasa	Elbasan	Grekan	3138	5014	-1876	-37%
Elbasa	Elbasan	Klos	3262	4160	-898	-22%
Elbasa	Elbasan	Gjinar	3478	4808	-1330	-28%
Elbasa	Elbasan	Shalës	3842	6831	-2989	-44%
Elbasa	Elbasan	Kajan	3925	6423	-2498	-39%
Elbasa	Elbasan	Gjergjan	5126	7532	-2406	-32%
Elbasa	Elbasan	Labinot Mal	5291	5474	-183	-3%
Elbasa	Elbasan	Mollas	5530	7673	-2143	-28%
Elbasa	Elbasan	Papër	6348	8895	-2547	-29%
Elbasa	Elbasan	Cërrik	6695	14 711	-8016	-54%
Elbasa	Elbasan	Labinot	7058	6263	795	13%
Elbasa	Elbasan	Shirgjan	7307	9789	-2482	-25%
Elbasa	Elbasan	Gostimë	8116	12 297	-4181	-34%
Elbasa	Elbasan	Shushicë	8731	10 543	-1812	-17%
Elbasa	Elbasan	Belsh	8781	13 675	-4894	-36%
Elbasa	Elbasan	Bradashesh	10 700	12 428	-1728	-14%
Elbasa	Elbasan	Elbasan	78 703	123 884	-45 181	-36%
ELBASAN gjithsej			188 662	278 472	-89 810	-32%
Elbasa	Gramsh	Sult	631	1353	-722	-53%
Elbasa	Gramsh	Kushovë	659	1062	-403	-38%
Elbasa	Gramsh	Lënie	779	1807	-1028	-57%
Elbasa	Gramsh	Skënderbeg	1239	2291	-1052	-46%
Elbasa	Gramsh	Poroçan	1269	1050	219	21%
Elbasa	Gramsh	Tunjë	1393	2230	-837	-38%
Elbasa	Gramsh	Kodovjat	2355	3244	-889	-27%
Elbasa	Gramsh	Kukur	2560	3417	-857	-25%
Elbasa	Gramsh	Pishaj	4906	6307	-1401	-22%
Elbasa	Gramsh	Gramsh	8440	13 243	-4803	-36%
Gramsh Total			24 231	36 004	-11 773	-33%
Elbasa	Librazh	Stëblevë	809	1198	-389	-32%
Elbasa	Librazh	Stravaj	2427	3059	-632	-21%
Elbasa	Librazh	Lunik	2621	3715	-1094	-29%
Elbasa	Librazh	Polis	3385	5011	-1626	-32%
Elbasa	Librazh	Orenjë	3883	5210	-1327	-25%
Elbasa	Librazh	Hotolisht	5706	6926	-1220	-18%
Elbasa	Librazh	Përrenjas	5847	8459	-2612	-31%
Elbasa	Librazh	Librazhd	6937	9760	-2823	-29%
Elbasa	Librazh	Qukës	8211	10 604	-2393	-23%
Elbasa	Librazh	Rrajcë	8421	10 289	-1868	-18%

Elbasa	Librazh	Qendër	8551	11 234	-2683	-24%
Librazhd gjithsej			56 798	75 465	-18 667	-25%
Elbasa	Peqin	Karinë	1350	1799	-449	-25%
Elbasa	Peqin	Shezë	3177	5253	-2076	-40%
Elbasa	Peqin	Përparim	3423	5376	-1953	-36%
Elbasa	Peqin	Gjocaj	5207	7012	-1805	-26%
Elbasa	Peqin	Peqin	6353	9150	-2797	-31%
Elbasa	Peqin	Pajovë	6626	8583	-1957	-23%
Peqin Total			26 136	37 173	-11 037	-30%
Grand Total			295 827	427 114	-131 287	-31%

Burimi: INSTAT, Census 2011; RGJC 2012 dhe Llogaritjet e autorëve

Popullsia e qarkut Elbasan përbën rreth 12,8% të popullsisë së vendit, referuar të dhënave të Census-it 2011 dhe popullsia mesatare për njësi të qeverisjes vendore në këtë qark rezulton 5917 banorë/NJQV ose 25% më e ulët se mesatarja kombëtare prej 8016 banorë/NJQV. Në secilin qark ka njësi të vogla dhe më të mëdha, por përqendrimi më i madh i njësive me popullsi të vogël vërehet në rrethin e Gramshit, ku mesatarja është 2423 banorë. Njësitë më të vogla në qark janë komunat Stëblevë në Librazhd dhe komunat Sult, Kushovë e Lënie në Gramsh.

Tabela 2: Klasifikimi i NJQV-ve të qarkut Elbasan sipas numrit të popullsisë krahasuar me shifrat në nivel vendi

	<i>Nr. i njësive</i>	<i>Min.</i>	<i>Maks.</i>	<i>Mesatare/ njësi</i>	<i>Shuma</i>	<i>% e popullsisë</i>	<i>Shqipëria</i>
Shqipëria				8016	2 311 848	100%	
Elbasan				5917	295 827	12,8	
0-2000	10	631	1622	1135	11 345	3,8%	27,61%
2001-5000	18	2065	4906	3100	55 797	18,9%	34,58%
5001-10 000	20	5126	8781	6964	139 282	47,1%	26,27%
10 001 – 20 000	1	10 700	10 700	10 700	10 700	3,6%	6,70%
20 001-30 000						0,0%	1,61%
30 001-50 000						0,0%	1,07%
50 000-100 000	1	78 703	78 703	78 703	78 703	26,6%	1,61%
100 000-200 000						0,0%	0,27%
200 000+						0,0%	0,27%

Burimi: INSTAT, Census 2011; Llogaritjet e autorëve

Dendësia mesatare e popullsisë është 335 banorë/km², krahasuar me 97,4 banorë/km² në rang vendi. Zonat urbane kanë dendësi më të lartë, si qyteti i Elbasanit (3548 banorë/km²), Librazhdit (3778 banorë/km²), Gramshit (3404 banorë/km²) dhe më pak Peqini (1690 banorë/km²). Komunat më të vogla të qarkut kanë gjithashtu edhe dendësinë më të ulët, nga 7 deri në 12 banorë për km², ndërkohë që gjysma e njësive kanë dendësi më të ulët se 63 banorë/km².

Propozimi i zonave funksionale në qarkun Elbasan

Duke iu referuar përcaktimit të Zonës Funksionale (ZF) sipas kritereve të miratuara nga Komisioni Parlamentar për Reformën Territoriale Administrative (KPRTA) – “një hapësirë


territoriale ku ka një ndërveprim të dendur dhe të shpeshtë mes banorëve dhe institucioneve për qëllime ekonomike, sociale, zhvillimore dhe kulturore” – më poshtë do të analizojmë pikërisht këto forma të ndërveprimit për të identifikuar zonat funksionale në qarkun e Elbasanit.

Ndërveprimi institucional në qarkun Elbasan

Sot në Shqipëri si rudiment i organizimit më të hershëm të shtetit dhe qeverisjes qendrat e rretheve janë përqendrimet kryesore të institucioneve qendrore (kryesisht Ministrive të Linjës) në nivelin më pranë qytetarit. Në qendrat e rretheve vendosen zyrat arsimore, zyrat e punësimit, drejtoritë shëndetësore rajonale, drejtoritë e shërbimit pyjor, gjykata e rrethit gjyqësor, prokuroria dhe degët e tatimeve. Në disa prej qendrave të rrethit janë vendosur dhe një sërë institucionesh sociale, shëndetësore dhe arsimore: shtëpitë e të moshuarve, shtëpitë e foshnjës, qendrat e formimit profesional, qendrat e zhvillimit, etj.

Kjo është ndër arsyet kryesore që bën që qendrat e rretheve të shndërrohen në pika kontakti për sa i përket ndërveprimit institucional (pra të institucioneve me njëra tjetrën) por njëkohësisht dhe të qytetarit me institucionet. Bizneset po ashtu duket se preferojnë të vendosen në qendrat e rretheve po për të njëjtën arsye; praninë e institucioneve e cila shoqërohet njëkohësisht me kapacitete më të mira njerëzore, cilësi më të lartë shërbimi dhe mundësi më të mira zgjedhjeje për sa i përket fushës së aktivitetit.

Figura 0. Shpërndarja e institucioneve dhe agjencive qendrore dhe ndërveprimi institucional në qarkun e Elbasanit



Burimi: DAP; Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve

Institucionet që kryejnë aktivitetin dhe janë vendosur në qendrën e qarkut janë: Drejtoritë Rajonale (Bujqësia, AKU, Arsimi, Shëndetësia, Punësimi dhe Shërbimi Pyjor); Bordi i Kullimit; Zyra e Kujdesit Social, Gjykata e Rrethit Gjyqësor; Prokuroria e Rrethit, Drejtoria e Policisë, Dega e Thesarit, Dega e Tatimeve Rajonale, etj.


Pikërisht për këtë arsye, duke iu referuar ndërveprimit institucional, përqendrimit të popullsisë dhe bizneseve, si dhe ndërveprimit mes këtyre të fundit, në qarkun e Elbasanit identifikojmë katër zona funksionale: atë me qendër Elbasanin; me qendër Librazhdin; me qendër Peqinin; me qendër Gramshin. Pranë Elbasanit, me qendër Cërrikun tenton të krijohet një tjetër zonë e vogël funksionale si rezultat kryesisht i ndërveprimit mes banorëve dhe rrjeteve të tjera sociale dhe ekonomike.

Ndërveprimi ekonomik në qarkun Elbasan

Do ta vlerësojmë nëpërmjet LËVIZJEVE PËR PUNËSIM: shërbimet, partneritetet, rrjeti i infrastrukturave, zinxhiri i vlerave (bizneset), etj. – Pra, dendësia e popullsisë; shpeshësia e udhëtimit për në punë; përqendrimi i bizneseve dhe diversiteti i aktiviteteve, potenciali zhvillimit ekonomik; cilësia e jetës dhe shërbimet.

Le të shikojmë përqendrimin e bizneseve dhe llojin e aktiviteteve kryesore të biznesit.

Figura 3: Përqendrimi i bizneseve dhe lloji i aktiviteteve në qarkun Elbasan




Burimi: INSTAT 2012; Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve

Duke iu referuar përqendrimit të bizneseve dhe shumëllojshmërisë së aktivitetit të tyre (i cili indirekt dëshmon për nivel më të lartë të shërbimeve) në qarkun e Elbasanit sërish identifikohen qartë katër zona funksionale: ajo me qendër Elbasanin; me qendër Librazhdin; me qendër Peqinin; me qendër Gramshin. Veç këtyre dy qendrave lexojmë një tjetër zonë që tenton të krijohet mes Cërrikut dhe Paprit. Një tjetër zonë funksionale shumë më modeste po ashtu identifikohet rreth Përrenjasit.

Për të qartësuar me tej zonat funksionale le të shikojmë drejtimet kryesore të lëvizjes së të punësuarve brenda qarkut të Elbasanit.

Figura 4: Harta e ndërveprimit ekonomik Qarku Elbasan




Burimi: MÇV; Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve

Përsëri konfirmohen zonat funksionale me qendër si Elbasanin, Librazhdin, Gramshin, Peqinin, por njëkohësisht lexohen tendencat për krijimin e zonave të tjera funksionale më të vogla përkatësisht me qendër si Paprin, Cërrikun dhe Përrenjasin.

Aksesi në shërbime dhe cilësia e jetës në qarkun Elbasan

Një tjetër element që vlerësojmë për të përcaktuar zonat funksionale në qarkun e Elbasanit është përqendrimi i shërbimeve dhe infrastrukturave. Materialet e mëposhtme grafike prezantojnë qendërsitë kryesore me nivelin më të lartë të shërbimeve prej nga përfitojnë edhe periferitë urbane dhe rurale duke krijuar kështu një tjetër shtresë (*layer*) të përcaktimit/identifikimit të zonave funksionale.


Figura 5 Qendërsitë dhe aksesit në shërbime (internet dhe telefoni fikse)



Burimi: INSTAT, Census 2011; Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve

Kështu, duke iu referuar hartave që prezantojnë lidhjet me internetin dhe telefoninë fikse vërejmë përsëritjen e tendencës dhe qendërsive me zonat e prezantuara me të gjelbër në hartën e zhvendosjeve të popullsisë gjatë viteve 2001 – 2011. Në këtë mënyrë përdorim të dhëna dhe informacione të ndryshme për të identifikuar zonat funksionale në Shqipëri në përgjithësi dhe në këtë rast në qarkun e Elbasanit.


Figura 6: Shpërndarja e institucioneve arsimore sipas përqendrimit të popullsisë (kopshtet, shkollat 9-vjeçare dhe shkollat e mesme)



Burimi: INSTAT, Census 2011; Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve

Informacioni për aksesin në shërbime plotësohet me informacionin e prezantuar në hartat e mësipërme për shpërndarjen e institucioneve arsimore (para-shkollore dhe të arsimit 9-vjeçar dhe të mesëm), si dhe atyre shëndetësore.

Figura 7: Aksesin në shërbime (ujësjellës dhe kanalizime) dhe shpërndarja e SHAUK



Burimi: INSTAT, Census 2011; DPUK, MTI 2013; Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve


Një tjetër informacion i rëndësishëm që përdorim në evidentimin e zonave funksionale është edhe shërbimi me ujë të pijshëm dhe kanalizime të ujërave të zeza.

Të gjitha këto analiza të vendosura së bashku rikonfirmojnë evidentimin e katër zonave funksionale shumë të qarta në qarkun e Elbasanit: ZF Elbasan; ZF Librazhd; ZF Gramsh; ZF Peqin, si dhe tendencën për krijimin e dy zonave të tjera funksionale me qendër si Cërrikun dhe Përrenjasin.

Propozimi i zonave funksionale në qarkun Elbasan

Siç përmendëm më sipër, në qarkun e Elbasanit evidentohen deri në 4 deri në 7 zona funksionale, të prezantuara grafikisht si më poshtë:

Figura 8: Ndarjet e propozuara sipas 5 varianteve për reformën territoriale (30; 39; 47; 57 dhe 63 zona funksionale)



Burimi: Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve

Varianti 1 me 30 NJQV – Zona funksionale Elbasan; ZF Librazhd dhe ZF Gramsh me kufij që përputhen me kufijtë përkatës të rretheve në rastin e Librazhdit dhe Gramshit, ndërsa në rastin e Elbasanit me kufijtë e bashkuar të Peqinit dhe Elbasanit.

Varianti 2 me 39 NJQV – Brenda qarkut të Elbasanit evidentohen katër zona funksionale kufijtë e të cilave përputhen me kufijtë përkatës të rretheve: ZF Elbasan; ZF Peqin; ZF Gramsh dhe ZF Librazhd.

Varianti 3 me 47 NJQV – Brenda qarkut të Elbasanit identifikohen pesë zona funksionale: ZF Elbasan; ZF Cërrik; ZF Peqin; ZF Gramsh dhe ZF Librazhd.

Varianti 4 me 57 NJQV – Brenda qarkut të Elbasanit identifikohen gjashtë zona funksionale: ZF Elbasan; ZF Cërrik; ZF Peqin; ZF Gramsh; ZF Librazhd dhe ZF Përrenjas.

Varianti 5 me 63 NJQV – Brenda qarkut të Elbasanit identifikohen shtatë zona funksionale: ZF Elbasan; ZF Cërrik; ZF Belsh; ZF Peqin; ZF Gramsh; ZF Librazhd dhe ZF Përrenjas.

Materiali më poshtë do të analizojë zonat funksionale të prezantuara në variantin me 47 NJQV, dhe do të ndalet më pak në zonat funksionale të Belshit dhe të Përrenjasit.

Analiza në nivel zone funksionale

Kur të analizojmë zonat funksionale më poshtë, duhet pasur parasysh se:


- Në rastin e zonës funksionale të Elbasanit analiza përqendrohet duke konsideruar si pjesë të kësaj zone funksionale NJQV-të ekzistuese: Elbasan; Labinot Fushë; Labinot Mal; Funar; Gracen; Bradashesh; Shushicë; Papër; Shirgjan; Tregan; Gjergjan; Gjinar; Zavalinë.

- Në rastin e zonës funksionale Cërrik pjesë e saj janë NJQV-të ekzistuese: Cërrik; Shalës; Belsh; Gostimë; Klos; Grekan; Fierzë; Kajan; Rrasë; Mollas.
- Në rastin e zonës funksionale Peqin konsiderohen NJQV-të ekzistuese: Pajovë, Përparim; Karinë; Peqin; Gjocaj; Shezë.
- Zona funksionale Gramsh konsideron NJQV-të ekzistuese: Gramsh; Poroçan; Pishaj; Sult; Tunjë; Kukur; Kodovjat; Kushove; Skënderbegas; Lënie.
- Zona funksionale Librazhd konsideron NJQV-të ekzistuese: Orenjë; Lunik; Stëblevë; Polis; Qendër; Librazhd; Hotolisht; Qukës; Përrenjas; Rrajcë; Stravaj.
- Zona funksionale Belsh konsideron NJQV-të ekzistuese: Belsh; Grekan; Kajan; Fierzë; Rrasë.
- Zona funksionale Përrenjas konsideron NJQV-të ekzistuese: Përrenjas; Qukës; Rrajcë dhe Stravaj.

Zona funksionale Elbasan

Zona funksionale Elbasan shtrihet dhe përfshin 13 njësi ekzistuese të qeverisjes vendore; Elbasan; Labinot Fushë; Labinot Mal; Funar; Gracen; Bradashesh; Shushicë; Papër; Shirgjan; Tregan; Gjergjan; Gjinar; Zavalinë (shiko figurën 4.1).

Figura 9: Zona funksionale Elbasan sipas Variantit 3 të propozuar (me 47 zona funksionale në nivel vendi)



Burimi: Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve


Do të shikojmë efektet demografike, ekonomiko-financiare, në ofrimin e shërbimeve, distancat dhe aksesin referuar zonës funksionale të propozuar.

Efektet demografike

Popullsia e zonës funksionale Elbasan duke iu referuar të dhënave të Census-it 2011 rezulton rreth 141 714 banorë. Sipërfaqja e ZF Elbasan është 872 km² dhe dendësia e popullsisë në

këtë zonë funksionale është 162 banorë/km². Referuar të dhënave të Regjistrit të Gjendjes Civile raportohet rreth 202 948 banorë.

Figura 10: Ndryshimet demografike për ZF Elbasan dhe NJQV-të ekzistuese që përfshihen në të



Burimi: INSTAT, Census 2011 & RGJC 2012

Kjo është zona funksionale më e madhe e propozuar qarkun Elbasan për sa i përket numrit dhe dendësisë së popullsisë. Kjo justifikohet me përqendrimin e lartë të numrit të institucioneve dhe aktiviteteve ekonomike në zonë.

Efektet ekonomiko-financiare

Le të shikojmë ndërveprimin dhe efektet ekonomike dhe financiare në zonën funksionale të propozuar me qendër Elbasanin.

Tabela më poshtë prezanton përqendrimin e bizneseve dhe llojin e aktiviteteve që zhvillojnë bizneset në këtë zonë. Vihet re se bizneset e përqendruara në shërbime, por edhe në tregti përbëjnë numrin më të lartë të aktiviteteve në këtë zonë.


Tabela 0: Ndërmarrjet aktive sipas NJQV-ve ekzistuese në ZF Elbasan dhe aktivitetit ekonomik

Komuna / Bashki	Biznese gjithsej	Popullsia INSTAT 2011	Biznese /1000 banorë	Bujqësia Peshkimi	Industria	Ndërtimi	Tregtia	Shërbime
Bradashesh	278	10 700	26	*	67	5	97	106
Elbasan	3707	78 703	47	8	347	90	1788	1474
Funar	18	2122	8	4	*	*	*	12
Gjergjan	55	5126	11	*	7	*	21	22
Gjinar	32	3478	9	*	3	*	6	22
Gracen	48	2192	22	7	4	*	8	28
Labinot Fushë	109	7058	15	*	11	*	48	47
Labinot Mal	20	5291	4	*	*	*	*	16
Papër	93	6348	15	*	13	*	31	46
Shirgjan	161	7307	22	7	30	10	53	61
Shushicë	102	8731	12	*	17	*	36	44
Tregan	60	3036	20	*	*	*	9	47
Zavalinë	6	1622	4	*	*	*	*	6
ZF ELBASAN	4689	141 714	33	45	503	115	2097	1931

Burimi: INSTAT 2012

Elbasani dhe deri diku Bradasheshi dhe Shirgjani kanë po ashtu një numër të konsiderueshëm të bizneseve të cilat përqendrohen në aktivitete industriale, por edhe në ndërtim.


Figura 11: Harta e shpërndarjes dhe llojit të aktiviteve të biznesit në ZF Elbasan



Burimi: INSTAT 2012. Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve

Siç e kemi përmendur edhe më sipër, vihet re se në qendësinë e zonës funksionale lloji i aktiviteve është më i lartë dhe me largimin prej kësaj qendërsie në mungesë të një niveli të lartë të shërbimeve aktivitetet uniformizohen duke u fokusuar vetëm në shërbime.

Figura 12: Harta e ndërveprimit ekonomik në ZF Elbasan: Përqendrimi i bizneseve dhe drejtimi i lëvizjes për punë



Burimi: INSTAT 2012. Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve

Kjo tendencë konfirmohet prej hartës së mësipërme (figura 12) e cila tregon flukset kryesore të lëvizjeve të të punësuarve. Pra zona funksionale në të cilën niveli i shkëmbimeve në lidhje me punësimin dhe shërbimet prezantohet si më sipër.


Qendrat urbane brenda kësaj zone funksionale bëhen ofruese të infrastrukturave, shërbimeve dhe punësimit, ndërkohë që qendrat rurale përfaqësojnë tyre bëhen furnizuese me produkte bujqësore dhe kryesisht me fuqi punëtore.

Le të shikojmë ndikimin që do të kishte krijimi i një njësie të re vendore duke iu referuar kufijve të zonës funksionale të propozuar dhe duke konsideruar të gjithë faktorët që ndikojnë buxhetin dhe të ardhurat e njëjësive ekzistuese vendore të njëjtë.

Siç kemi përmendur edhe më sipër, qëllimi dhe përfitimi kryesor nga riorganizimi i njëjësive vendore sipas zonave funksionale do të ishte një rishpërndarje më e mirë e shpenzimeve vendore dhe efikasiteti në ofrimin e shërbimeve.

Kështu, nëse i referohemi nivelit të shpenzimeve për banor që sot kanë NJQV-të që përbëjnë ZF të Elbasanit, vëmë re se ato lëvizin prej 1700 lekë/banor në Labinot Fushë në 10 560 lekë/banor në Bradashesh. Në kontekstin e zonës funksionale Elbasan në të njëjtat kushte të shpërndarjes së buxhetit (transfertat dhe të ardhurat e veta të njëjësive), buxheti për banor do të ishte 7130 lekë, pra rreth katër herë më i lartë se buxheti i NJQV-së më të varfër brenda zonës funksionale dhe 30% më i lartë se mesatarja e buxhetit për banor njëjësive ekzistuese të zonës funksionale.

Figura 13: Buxheti total për banor në NJQV-të ekzistuese dhe ZF Elbasan (në mijë lekë)




Burimi: MF 2012. Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve

Thuajse e njëjta tendencë prezantohet në lidhje me të ardhurat vendore të krijuara në NJQV-të ekzistuese dhe të parashikuara në ZF Elbasan të propozuar më poshtë.

Sot të ardhurat vendore të komunës Gracen janë 200 lekë/banor – më të ulëtat mes NJQV-ve të përfshira në ZF Elbasan, ndërsa të ardhurat vendore të komunës Bradashesh janë 8130 lekë/banor – 40 herë më të larta krahasuar me komunën Gracen.

Figura 14: Të ardhurat e veta për banor në NJQV-të ekzistuese dhe ZF Elbasan




Burimi: MF 2012. Interpretimi dhe paraqitja grafike e jona

Mesatarisht në të njëjtat kushte të ardhurat për banor të parashikuara në ZF Elbasan do të jenë 2350 lekë/banor, ose rreth 12 herë më të larta se të ardhurat vendore të komunës Gracen.

Një tjetër element i rëndësishëm që lidhet drejtpërdrejtë me efikasitetin në ofrimin e shërbimeve dhe mirë menaxhimin e fondeve publike në nivel vendor është numri i punonjësve të angazhuar në administratën vendore.

Figura 15: Numri i punonjësve në administratë në NJQV-të e qarkut Elbasan



Burimi: NJQV-të dhe MSHÇV. Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve

Duke iu referuar situatës ekzistuese në NJQV-të ekzistuese në ZF Elbasan vihet re se në NJQV të ndryshme pesha e administratës vendore në buxhetin e NJQV-së ndryshon shumë. Ndonëse në disa raste kjo lidhet drejtpërdrejtë me zgjedhjen që bëjnë njësitet e ndryshme në mënyrën se si do të ofrohen shërbimet, sërish në disa raste numri i raportuar i punonjësve vendorë për banor është shumë i lartë në krahasim me NJQV-të e tjera.


Figura 4.6 raporton pikërisht këtë shpërndarje në qarkun e Elbasanit. Vihet re se në disa NJQV si Cërrik, Stëblevë, Lënie, Skënderbegas, etj. numri i punonjësve vendorë për banor është rreth 15, krahasuar me mesataren e NJQV-ve të qarkut ku ky numër është mes 5 dhe 8 punonjës për banor.

Le të shikojmë këtë element nga këndvështrimi i kostove për NJQV-në dhe qytetarët. Gjithmonë duke konsideruar të njëjtat kushte ekonomike, financiare, por njëkohësisht edhe të

përgjegjësi dhe funksioneve, në grafikun më poshtë (figura 16) paraqiten shpenzimet e personelit për banor në NJQV-të ekzistuese të ZF Elbasan.

Duke konsideruar se krijimi i njësisë së re vendore duke iu referuar kufijve të zonës funksionale do të përqendrojë një pjesë të shërbimeve të cilat sot ofrohen në të gjitha NJQV-të vetëm në një qendër (të tilla janë zyrat e financave, burimet njerëzore, drejtoritë e mjedisit, drejtoritë e planifikimit urban, kadastrat urbane, etj.), kemi llogaritur se shpenzimet e NJQV-së së re që do të krijohen vetëm për personelin do të reduktohen me të paktën 70% në NJQV-të ekzistuese në rastin e ZF Elbasan. Si rezultat kosto e personelit për banor do të reduktohet nga një mesatare që sot rezulton rreth 2800 lekë/banor në më pak se 1270 lekë për banor.

Figura 16: Shpenzimet e personelit për banor në NJQV-të ekzistuese dhe në ZF Elbasan (000 lekë)




Burimi: MF 2012. Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve

Me të njëjtën logjikë analizojmë edhe kostot për shpenzimet operative të NJQV-ve ekzistuese dhe të NJQV-së të propozuar sipas kufijve të ZF Elbasan.

Gjatë kësaj analize duhet të kemi parasysh se në shpenzimet operative llogariten të gjitha shpenzimet e NJQV-ve për shpenzimet e tyre rutine të mirëmbajtjes apo edhe ofrimit të shërbimeve, por njëkohësisht edhe kostot e qirave dhe mirëmbajtjes së godinave ekzistuese të NJQV-ve. Në një llogaritje të përgjithshme paraprake, vlerësojmë se kostot operative do të reduktohen me rreth 5% si rezultat i eficientimit të ambienteve dhe stafit pas organizimit të propozuar. Grafiku më poshtë prezanton pikërisht këtë eficientim të shprehur në reduktimin e kostove operative për banor në ZF të Elbasanit krahasuar me mesataren e NJQV-ve përbërëse të ZF-së.


Figura 17: Shpenzimet operative për banor në NJQV-të ekzistuese dhe në ZF Elbasan (000 lekë)



Burimi: MF 2012. Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve

Në të njëjtën logjikë – pra duke konsideruar kushtet ekonomike dhe financiare të pandryshueshme, por njëkohësisht edhe tërësinë e përgjegjësisë dhe funksioneve të NJQV-ve, bëjmë supozimin se kursimi i fondeve për shpenzimet operative dhe të personelit do të përdoret në masën 100% në rritjen e investimeve kapitale, analizojmë nivelin e investimeve të pritshme për banor në ZF të propozuar.

Figura 18: Investimet për banor në NJQV-të ekzistuese dhe në ZF Elbasan



Burimi: MF 2012. Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve


Figura 18 tregon nivelin e investimeve për banor në NJQV-të ekzistuese, si dhe nivelin e investimeve të pritshme në NJQV-në e propozuar. Siç vihet re nga grafiku niveli i investimeve në ZF Elbasan është rreth 2080 lekë për banor – 40% më i lartë, krahasuar me nivelin mesatar të investimeve sot në të gjitha NJQV-të ekzistuese i cili prezantohet në rreth 1460 lekë/banor.

Efektet në ofrimin e shërbimeve

Veç efijencës ekonomike dhe financiare, organizimi i NJQV-ve të propozuara sipas zonave funksionale pritët të krijojë një sërë efektësh dhe eksternalitetësh pozitive në nivelin dhe cilësinë e ofrimit të shërbimeve.

Në një analizë të shpejtë në disa prej shërbimeve të rëndësishme të ofruara prej nivelit vendor në Shqipëri, organizimi sipas zonave funksionale do të krijojë mundësinë për harmonizimin më të mirë të politikave të cilat kanë nevojë për territor të gjerë dhe mundësitë për zhvillimin ekonomik. Kështu copëzimi i madh i territorit sipas kufijve të NJQV-ve ekzistuese ka qenë ndër arsyet kryesore të diskutuara në lidhje me keqmenaxhimin e territorit dhe mjedisit. Riorganizimi sipas konceptit të zonave funksionale në mos do të zhdukë, do të zbusë këtë problem duke mundësuar bërjen e politikave të zhvillimit dhe menaxhimit për territore gjeografike më të plota dhe me potenciale më të mëdha për mirëmenaxhimin e burimeve.

Figura 19: Harta e zonave të mbrojtura në Shqipëri dhe në ZF Elbasan



Burimi: Ministria e Mjedisit, Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve


Në figurën më sipër prezantohen zonat e mbrojtura në Shqipëri, por edhe në qarkun e Elbasanit. Deri tani, këto zona në kushte të copëzimit mes shumë NJQV-ve vendore në mos keqpërdorur, nuk kanë përdorur e menaxhuar potencialin e tyre natyror. Në kushtet e riorganizimit pjesa më e madhe e zonave të mbrojtura do të menaxhohen prej një apo maksimumi dy njësive vendore, të cilat do të kenë mundësi dhe shanse më të mira për të ndërtuar mbi potencialin e këtyre zonave.

I njëjti diskutim është i vlefshëm edhe për çështjet e planifikimit të territorit, menaxhimit të tokës apo kontrollit mbi territorin.

Një tjetër kategori e rëndësishme e shërbimeve që ofrohen pjesërisht në nivel vendor e pjesërisht në atë qendror është arsimiti. Sot NJQV-të janë përgjegjëse për mirëmbajtjen e infrastrukturave arsimore. Në figurën më poshtë prezantohet pikërisht shpërndarja dhe cilësia e këtyre strukturave. Çfarë tërheq vëmendjen në këtë analizë është se cilësia e dobët e infrastrukturave arsimore lidhet drejtpërdrejtë me gjenerimin e ulët të të ardhurave prej NJQV-ve (kuptohet edhe si rezultat i nivelit të ulët të transfertave). Riorganizimi në NJQV më të mirë të fondeve në dispozicion. Madje duke shkuar më tej dhe duke përdorur si argument kryesor parimin e subsidiaritetit, do të kishte kuptim që edhe pjesë të tjera të

funksionit (siç mund të jetë emërimi i stafit dhe drejtuesve, etj.) të jenë përgjegjësi e nivelit vendor të qeverisjes.


Figura 20: Harta e shpërndarjes së infrastrukturave të arsimit të mesëm në Shqipëri dhe cilësia e infrastrukturës arsimore në ZF Elbasan



Burimi: Ministria e Arsimit dhe Sportit, Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve

Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimit të ujërave të zeza, po ashtu duket se ka shanse për të funksionuar më mirë dhe në mënyrë më efikase. Figura më poshtë tregon organizimin e ndërmarrjeve të ujësjellësve dhe të KUZ-ve sot. Siç vihet re edhe nga figura e mëposhtme menaxhimi i ndërmarrjeve të ujësjellësve sot bëhet nëpërmjet bordeve (ne më të shumtën e rasteve) të zgjedhura prej një numri të madh NJQV-sh, duke u bërë në shumë raste i vështirë për të marrë vendime dhe mirë menaxhuar ndërmarrjen. Riorganizimi sipas zonave funksionale duket se krijon kushte më të mira edhe për mirëmenaxhimin dhe organizimin e këtij shërbimi.

Figura 21: Harta e mbulimit me shërbimin e furnizimit me ujë në Shqipëri dhe ZF Elbasan




Burimi: DPU/Ministria e Transportit, Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve

Së fundmi, një nga çështjet më të diskutuara në lidhje me riorganizimin e NJQV-ve sipas zonave funksionale është aksesit dhe distancat në ofrimin e shërbimeve. Më poshtë kemi sjellë dy elementë të rëndësishëm të cilët përpiqen të adresojnë këtë problem.

Së pari është aksesit në qendërsinë e zonës funksionale nëpërmjet infrastrukturës rrugore (figura 4.13) dhe së dyti në krahasim me këtë është koha e udhëtimit që do t'i duhet çdo banori të zonës për të vajtur këtë qendër (figura 4.14).


Figura 22: Infrastruktura rrugore dhe aksesit në ZF Elbasan



Burimi: DPR/Ministria e Transportit, Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve

Si rezultat i aksesit përgjithësisht të mirë me infrastrukturë rrugore thuhet se 85% e popullsisë së zonës funksionale mund të arrijë në qendër në më pak se 30 minuta duke udhëtuar me automjetet. Janë banorët e dy njësisive – Labinot Mal dhe Funarë, aksesit për të cilët është disi më i vështirë (mbi 50 minuta).

Figura 23: Distancat kohore nga qendra në ZF Elbasan



Ka disa mënyra për të adresuar këtë problem. Një prej tyre lidhet me nevojën që do të kenë banorët për të arritur në qendrën e ZF-së në të përditshmen e tyre. Në kushtet kur pranë banorëve ekzistojnë shërbimet bazë për të cilat ata kanë nevojë të shkojnë më shpesh, udhëtimi drejt qendrës do të shmanget. Një tjetër mënyrë do të ishte rritja e investimeve dhe përqendrimi i prioriteteve në investime në infrastrukturën fizike dhe transportin që lehtëson këtë akses.

Përfundime

ZF Elbasan me popullsi 141 714 banorë, nga mesatarisht 10 901 banorë për njësi
Reduktimi i shpenzimeve administrative (paga dhe të tjera operative) me rreth 92,2 milionë lekë (ose 8% e shpenzimeve totale të kryera nga të gjitha njësitë ekzistuese).
Ulje e shpenzimeve të pagave nga 406 milionë lekë, në 321,3 milionë lekë në vit.
Shpenzimet për paga për banor ulen nga 2865 në 2267 lekë për banor në njësinë e re.
Rritje e buxhetit vjetor të investimeve me 40% në vit, nga 207 milionë në 299,2 milionë lekë në vit.
Rritje e investimeve për frymë nga 1461 në 2111 lekë në njësinë e re.

Zona funksionale Cërrik

Zona funksionale Cërrik shtrihet dhe përfshin dhjetë NJQV ekzistuese: Cërrik; Shalës; Belsh; Gostimë; Klos; Grekan; Fierzë; Kajan; Rrasë; Mollas. Përcaktimi i zonës funksionale brenda këtyre kufijve vjen si rezultat i ndërveprimit që ndodh mes banorëve, bizneseve apo aktorëve të tjerë që operojnë dhe përqendrohen në këtë zonë. Në nivel institucional ky ndërveprim nuk duket të jetë i theksuar si rezultat i përqendrimit të institucioneve kryesisht në qendrat e rretheve (Elbasan, Gramsh e Librazhd) dhe distanca fizike mes Cërrikut dhe këtyre qendrave me sa duket nuk kanë qenë të tilla sa të kenë imponuar krijimin e një tjetër qendërsie për sa i përket përqendrimit të institucioneve.

Figura 24. Zona funksionale Cërrik sipas variantit 3 të propozuar (me 47 zona funksionale në nivel vendi)



Do të shikojmë më poshtë efektet demografike, ekonomiko-financiare në ofrimin e shërbimeve, distancat dhe aksesin referuar zonës funksionale të propozuar.

Efektet demografike

Popullsia e zonës funksionale Cërrik duke iu referuar të dhënave të Census-it 2011 rezulton rreth 46 948 banorë. Sipërfaqja e ZF Cërrik është 386 km² dhe dendësia e popullsisë në këtë zonë funksionale është 122 banorë/km². Referuar të dhënave të Regjistrit të Gjendjes Civile raportohet rreth 77 903 banorë.

Tabela 5. Të dhëna demografike për ZF Cërrik dhe NJQV-të ekzistuese që përfshihen në të

Nr.	Njësite Vendore	Popullsia	Dendësia	Sipërfaqja	RGJC	Diferenca
		INSTAT	INSTAT	km ²	Popullsia	INSTAT -
		2011	ba./km ²	km ²	Jan. 2012	RGJC
1	BELSH	8781	148	59	16 364	-7583
2	CËRRIK	6695	610	11	14 861	-8166
3	FIERZË	2065	51	40	3779	-1714
4	GOSTIMË	8116	162	50	12 482	-4366
5	GREKAN	3138	86	36	5030	-1892
6	KAJAN	3925	86	46	6520	-2595
7	KLOS	3262	127	26	4204	-942
8	MOLLAS	5530	92	60	7728	-2198
9	RRASE	1594	109	15	-	1594
10	SHALËS	3842	89	43	6935	-3093
	ZF Cërrik	46 948	122	386	77 903	-30 955

Burimi: INSTAT, Census 2011 & RGJC 2012

Siç është përmendur më sipër zona funksionale me qendërsi Cërrikun është e diskutueshme në disa aspekte, veçanërisht për sa i përket përqendrimit të institucioneve dhe ndërveprimit mes tyre, megjithatë ajo prezanton një tendencë për ndërveprim të lartë mes banorëve në NJQV-të e përfshira.

Efektet ekonomiko-financiare

Le të shikojmë ndërveprimin dhe efektet ekonomike dhe financiare në zonat funksionale të propozuara.

Tabela 6. Ndërmarrjet aktive sipas NJQV-ve ekzistuese në ZF Cërrik dhe aktivitetit ekonomik

Komuna / Bashki	Biznese gjithsej	Popullsia INSTAT 2011	Biznese/1000 banorë	Bujqësia e Peshkimi	Industria	Ndërtimi	Tregtia	Shërbime
Belsh	200	8781	23	7	23	*	75	94
Cërrik	196	6695	29	*	24	7	86	77
Fierzë	12	2065	6		*		*	10
Gostimë	123	8116	15	*	13	*	49	57
Grekan	25	3138	8		*		9	14
Kajan	31	3925	8	*	*		13	15
Klos	22	3262	7	*	*	*	6	11
Mollas	41	5530	7	*	6	*	18	15
Rrasë	12	1594	8	*			*	7
Shalës	65	3842	17	*	6	*	23	32
ZF Cërrik	727	46 948	15	17	80	12	279	332


Burimi: INSTAT 2012

Në këtë zonë funksionale aktivitetet kryesore duket se janë ato në fushën e shërbimeve dhe tregtisë, por nuk përjashtohen edhe aktivitetet në fushën e industrisë. Në NJQV-të e Fierzës, Rrasës, Grekanit dhe Klosit përqendrimi i bizneseve është më i ulët, por ekzistojnë disa marrëdhënie të bashkëveprimit me Cërrikun e Belshin si rezultat i përqendrimit dhe llojshmërisë së aktiviteteve të bizneseve.

Le të shikojmë ndikimin që do të kishte krijimi i një njësie të re vendore duke iu referuar kufijve të zonës funksionale Cërrik të propozuar dhe duke konsideruar të gjithë faktorët që ndikojnë buxhetin dhe të ardhurat e njëjësive ekzistuese vendore të njëjtë.

Siç kemi përmendur edhe më sipër qëllimi dhe përfitimi kryesor nga riorganizimi i njëjësive vendore sipas zonave funksionale do të ishte një rishpërndarje më e mirë e shpenzimeve vendore dhe efikasiteti në ofrimin e shërbimeve.

Figura 25. Buxheti total për banor në NJQV-të ekzistuese dhe ZF Cërrik (000 lekë)




Burimi: MF 2012. Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve

Kështu, nëse i referohemi nivelit të shpenzimeve për banor që sot kanë NJQV-të që përbëjnë ZF të Cërrikut, vëmë re se ato lëvizin prej 2510 lekë/banor në Rrasë në 9880 lekë/banor në Grekan. Në kontekstin e zonës funksionale Cërrik në të njëjtat kushte të shpërndarjes së buxhetit (transfertat dhe të ardhurat e veta të njëjësive), buxheti për banor do të ishte 5670 lekë, pra më tepër se 2 herë më i lartë se buxheti i NJQV-së më të varfër brenda zonës funksionale.

Thuajse e njëjta tendencë prezantohet në lidhje me të ardhurat vendore të krijuara në NJQV-të ekzistuese dhe të parashikuara në ZF Cërrik të propozuar më sipër.

Sot të ardhurat vendore të komunës Klos janë 330 lekë/banor – më të ulëtat mes NJQV-ve të përfshira në ZF Cërrik, ndërsa të ardhurat vendore të bashkisë Cërrik janë 3490 lekë/banor. Mesatarisht të ardhurat për banor të parashikuara për ZF Cërrik janë rreth 1000 lekë (figura 4.17).

Figura 26. Të ardhurat e veta për banor në NJQV-të ekzistuese dhe ZF Cërrik (000 lekë)




Burimi: MF 2012. Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve

Le të shikojmë shpërndarjen e personelit të NJQV-ve nga këndvështrimi i kostove për NJQV-në dhe qytetarët. Gjithmonë duke konsideruar të njëjtat kushte ekonomike, financiare, por njëkohësisht edhe të përgjegjësive dhe funksioneve, në grafikun më poshtë (figura 26) paraqiten shpenzimet e personelit për banor në NJQV-të ekzistuese të ZF Cërrik.

Duke konsideruar se krijimi i njësisë së re vendore duke iu referuar kufijve të zonës funksionale do të përqendrojë një pjesë të shërbimeve të cilat sot ofrohen në të gjitha NJQV-të vetëm në një qendër (të tilla janë zyrat e financave, burimet njerëzore, drejtoritë e mjedisit, drejtoritë e planifikimit urban, kadastrat urbane, etj.) kemi llogaritur se shpenzimet e NJQV-së së re që do të krijohen vetëm për personelin, do të reduktohen me të paktën 70% në rastin e ZF Cërrik. Si rezultat kosto e personelit për banor do të reduktohet nga një mesatare që sot rezulton rreth 2530 lekë/banor në rreth 1400 lekë për banor.

Figura 27. Shpenzimet e personelit për banor në NJQV-të ekzistuese dhe në ZF Cërrik (000 lekë)




Burimi: MF 2012. Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve

Me të njëjtën logjikë analizojmë edhe kostot për shpenzimet operative të NJQV-ve ekzistuese dhe të NJQV-së të propozuar sipas kufijve të ZF Cërrik.

Gjatë kësaj analize duhet të kemi parasysh se në shpenzimet operative llogariten të gjitha shpenzimet e NJQV-ve për shpenzimet e tyre rutine të mirëmbajtjes apo edhe ofrimit të shërbimeve, por njëkohësisht edhe kostot e qirave dhe mirëmbajtjes së godinave ekzistuese të NJQV-ve. Në një llogaritje të përgjithshme paraprake, vlerësojmë se kostot operative do të reduktohen me rreth 5% si rezultat i eficientimit të ambienteve dhe stafit pas organizimit të propozuar. Grafiku më poshtë prezanton pikërisht këtë eficientim të shprehur në reduktimin e kostove operative për banor në ZF të Cërrikut krahasuar me mesataren e NJQV-ve përbërëse të ZF-së.


Figura 28. Shpenzimet operative për banor në NJQV-të ekzistuese dhe në ZF Cërrik



Burimi: MF 2012. Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve

Duke konsideruar kushtet ekonomike dhe financiare të pandryshueshme, por njëkohësisht edhe tërësinë e përgjegjësive dhe funksioneve të NJQV-ve, bëjmë supozimin se kursimi i fondeve për shpenzimet operative dhe të personelit do të përdoret në masën 100% në rritjen e investimeve kapitale, analizojmë nivelin e investimeve të pritshme për banor në ZF të propozuar.

Figura 29. Investimet për banor në NJQV-të ekzistuese dhe në ZF Cërrik



Burimi: MF 2012. Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve

Figura 29 tregon nivelin e investimeve për banor në NJQV-të ekzistuese, si dhe nivelin e investimeve të pritshme në NJQV-në e propozuar. Siç vihet re nga grafiku niveli i investimeve në ZF Cërrik është rreth 4170 lekë për banor – 1,4 herë më e lartë, krahasuar me nivelin mesatar të investimeve sot në të gjitha NJQV-të ekzistuese i cili prezantohet në rreth 2990 lekë/banor.

Përfundime

Përfundimet më poshtë janë llogaritur në variantin me dy njësi funksionale më vete, përkatësisht ZF Cërrik dhe ZF Belsh.

1. ZF Cërrik (Bashkia Cërrik dhe komunat Gostimë, Klos, Mollas, Shalëz)

ZF Cërrik e përbërë nga 5 njësi ekzistuese, ka popullsi prej 27,445 banorë, nga mesatarisht 5,489 banorë aktualisht në NJQV ekzistuese;

Reduktim i shpenzimeve administrative të njësisë me rreth 23,3 milionë lekë në vit, ose 22% e shpenzimeve administrative (shpenzime paga dhe operative) dhe 16% e shpenzimeve vjetore gjithsej;

Ulja e shpenzimeve të personelit për banor në masën 30%, nga 2,696 lekë në 1,906 lekë për banor;

Mirëadministrimi i burimeve financiare mund të sjellë rritje të investimeve në masën 69%, ose nga 34 milionë lekë, në 57,3 milionë lekë në vit;

Investimet për banor mund të rriten nga 1,239 lekë, në 2,088 lekë për banor në njësinë e re;

Bashkimi në një zonë funksionale mund të sigurojë rishpërndarje më të mirë të të ardhurave duke zbutur pabarazitë e mëdha mes zonave; pa llogaritur efektet e eficiencës së rritur në menaxhimin e të ardhurave: mesatarisht ZF e re do të realizonte 1,994 lekë të ardhura të veta për frymë, ose 14% më shumë se mesatarja e të ardhurave të veta për frymë në njësitë ekzistuese (1,749 lekë).

2. ZF Belsh (Belsh, Grekan, Kajan, Fierze, Rasë)

ZF Cërrik e përbërë nga 5 njësi ekzistuese, ka popullsi prej 19,503 banorë, nga mesatarisht 3,901 banorë aktualisht në NJQV ekzistuese;

Reduktim i shpenzimeve administrative të njësisë me rreth 18,6 milionë lekë në vit, ose 25% e shpenzimeve administrative (shpenzime paga dhe operative) dhe 13% e shpenzimeve vjetore gjithsej;

Ulja e shpenzimeve të personelit për banor në masën 37%, nga 2,307 lekë në 1,446 lekë për banor;

Mirëadministrimi i burimeve financiare mund të sjellë rritje të investimeve në masën 37%, ose nga 50 milionë lekë, në 68,6 milionë lekë në vit;

Investimet për banor mund të rriten nga 2,564 lekë, në 3,517 lekë për banor në njësinë e re;

Bashkimi në një zonë funksionale mund të sigurojë rishpërndarje më të mirë të të ardhurave duke zbutur pabarazitë e mëdha mes zonave; pa llogaritur efektet e eficiencës

së rritur në menaxhimin e të ardhurave: mesatarisht ZF e re do të realizonte 1,277 lekë të ardhura të veta për frymë, ose 34% më shumë se mesatarja e të ardhurave të veta për frymë në njësitë ekzistuese (952 lekë) dhe 57% më shumë se mediani.

Zona funksionale Peqin

Zona funksionale Peqin shtrihet dhe përfshin NJQV-të ekzistuese: Pajovë, Përparim, Karinë, Peqin, Gjocaj dhe Shezë. Përcaktimi i zonës funksionale brenda këtyre kufijve vjen si rezultat i ndërveprimit që ndodh mes banorëve, bizneseve apo aktorëve të tjerë që operojnë dhe përqendrohen në këtë zonë. Në nivel institucional ky ndërveprim është i ulët referuar faktit se përqendrimi i institucioneve në Elbasan si qendër e qarkut është i lartë dhe distanca fizike mes Peqinit dhe Elbasanit janë relativisht të vogla për të krijuar një tjetër qendërsi për sa i përket përqendrimit të institucioneve.

Figura 30. Zona funksionale Peqin sipas Variantit 4 dhe 5 të propozuar (respektivisht me 57 dhe 63 zona funksionale në nivel vendi)



Do të shikojmë më poshtë efektet demografike, ekonomiko-financiare në ofrimin e shërbimeve, distancat dhe aksesin referuar zonës funksionale të propozuar.

Efektet demografike

Popullsia e zonës funksionale Peqin duke iu referuar të dhënave të Census-it 2011 rezulton rreth 26 136 banorë. Sipërfaqja e ZF Peqin është 198 km² dhe dendësia e popullsisë në këtë zonë funksionale është 132 banorë/km². Referuar të dhënave të Regjistrit të Gjendjes Civile popullsia raportohet rreth 37 578 banorë.

Tabela 7. Të dhëna demografike për ZF Peqin dhe NJQV-të ekzistuese që përfshihen në të

Nr.	Njësiti Vendore	Popullsia	Dendësia	Sipërfaqja	RGJC	Diferenca
		INSTAT 2011	INSTAT ba./km ²	km ²	Popullsia Jan. 2012	INSTAT - RGJC
1	GJOCAJ	5207	138	38	7122	-1915
2	KARINE	1350	49	28	-	1350
3	PAJOVE	6626	109	61	8719	-2093
4	PEQIN	6353	1690	4	10 972	-4619
5	PËRPARIM	3423	74	46	5438	-2015
6	SHEZË	3177	147	22	5327	-2150
	ZF Peqin	26 136	132	198	37 578	-11 442

Burimi: INSTAT, Census 2011 & RGJC 2012

Siç është përmendur më sipër zona funksionale me qendër Peqinin është e diskutueshme në disa aspekte, veçanërisht për sa i përket përqendrimit të institucioneve dhe ndërveprimit mes tyre, megjithatë ajo prezanton një tendencë për ndërveprim të lartë mes banorëve në NJQV-të e përfshira, si dhe bizneseve të përqendruara brenda territorit të këtyre NJQV-ve.

Efektet ekonomike-financiare

Le të shikojmë ndërveprimin dhe efektet ekonomike dhe financiare në zonat funksionale të propozuara.

Tabela 8. Ndërmarrjet aktive sipas NJQV-ve ekzistuese në ZF Peqin dhe aktivitetit ekonomik

Komuna / Bashki	Biznese gjithsej	Popullsia INSTAT 2011	Biznese/1 000 banorë	Bujqësia e Peshkimi	Industria	Ndërtimi	Tregtia	Shërbime
Gjocaj	50	5207	10	*	4		35	10
Karinë	16	1350	12		*	*	*	8
Pajovë	144	6626	22		14	*	81	46
Peqin	178	6353	28		14	16	78	70
Përparim	49	3423	14	*	9		24	15
Shezë	30	3177	9	*	*	*	18	6
ZF Cërrik	467	26 136	18	5	46	23	238	155


Burimi: INSTAT 2012

Në ZF Peqin aktivitetet kryesore janë ato në fushën e tregtisë, por nuk përjashtohen edhe aktivitetet në fushën e shërbimeve dhe më pak në industri dhe ndërtim. Në NJQV-të e Shezës dhe Karinës përqendrimi i bizneseve është më i ulët, por ndërveprimi si rezultat i shërbimeve të ofruara në bashkinë e Peqinit duket të jetë i lartë.

Le të shikojmë ndikimin që do të kishte krijimi i një njësie të re vendore duke iu referuar kufijve të zonës funksionale Peqin të propozuar dhe duke konsideruar të gjithë faktorët që ndikojnë buxhetin dhe të ardhurat e njësive ekzistuese vendore të njëjtë.

Siç kemi përmendur edhe më sipër qëllimi dhe përfitimi kryesor nga riorganizimi i njësive vendore sipas zonave funksionale do të ishte një rishpërndarje më e mirë e shpenzimeve vendore dhe efikasiteti në ofrimin e shërbimeve.

Figura 31. Buxheti total për banor në NJQV-të ekzistuese dhe ZF Peqin




Burimi: MF 2012. Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve

Kështu, nëse i referohemi nivelit të shpenzimeve për banor që sot kanë NJQV-të që përbëjnë ZF të Peqinit, vëmë re se ato lëvizin prej 3150 lekë/banor në Shezë në 15 780 lekë/banor në Përparim. Në kontekstin e zonës funksionale Peqin në të njëjtat kushte të shpërndarjes së buxhetit (transfertat dhe të ardhurat e veta të njëjësive), buxheti për banor do të ishte 7120 lekë, pra më tepër se dy herë më i lartë se buxheti i NJQV-së më të varfër brenda zonës funksionale.

Thuajse e njëjta tendencë prezantohet në lidhje me të ardhurat vendore të krijuara në NJQV-të ekzistuese dhe të parashikuara në ZF Peqin të propozuar më sipër.

Sot të ardhurat vendore të komunës Shezë janë 800 lekë/banor – më të ulëtat mes NJQV-ve të përfshira në ZF Peqin, ndërsa të ardhurat vendore të bashkisë Peqin janë 3060 lekë/banor. Mesatarisht të ardhurat për banor të parashikuara për ZF Peqin janë rreth 1040 lekë (figura 31).

Figura 32. Të ardhurat e veta për banor në NJQV-të ekzistuese dhe ZF Peqin




Burimi: MF 2012. Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve

Le të shikojmë shpërndarjen e personelit të NJQV-ve nga këndvështrimi i kostove për NJQV-në dhe qytetarët. Gjithmonë duke konsideruar të njëjtat kushte ekonomike, financiare, por njëkohësisht edhe të përgjegjësive dhe funksioneve, në grafikun më poshtë (figura 32) paraqiten shpenzimet e personelit për banor në NJQV-të ekzistuese të ZF Peqin.

Duke konsideruar se krijimi i njësisë së re vendore duke iu referuar kufijve të zonës funksionale do të përqendrojë një pjesë të shërbimeve të cilat sot ofrohen në të gjitha NJQV-të vetëm në një qendër (të tilla janë zyrat e financave, burimet njerëzore, drejtoritë e mjedisit, drejtoritë e planifikimit urban, kadastrat urbane, etj.) kemi llogaritur se shpenzimet e NJQV-së së re që do të krijohen vetëm për personelin, do të reduktohen me të paktën 70% në rastin e ZF Peqin. Si rezultat kosto e personelit për banor do të reduktohet nga një mesatare që sot rezulton rreth 2560 lekë/banor në rreth 1390 lekë për banor.

Figura 32. Shpenzimet e personelit për banor në NJQV-të ekzistuese dhe në ZF Peqin




Burimi: MF 2012. Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve

Me të njëjtën logjikë analizojmë edhe kostot për shpenzimet operative të NJQV-ve ekzistuese dhe të NJQV-së të propozuar sipas kufijve të ZF Peqin.

Gjatë kësaj analize duhet të kemi parasysh se në shpenzimet operative llogariten të gjitha shpenzimet e NJQV-ve për shpenzimet e tyre rutine të mirëmbajtjes apo edhe ofrimit të shërbimeve, por njëkohësisht edhe kostot e qirave dhe mirëmbajtjes së godinave ekzistuese të NJQV-ve. Në një llogaritje të përgjithshme paraprake, vlerësojmë se kostot operative do të reduktohen me rreth 5% si rezultat i eficientimit të ambienteve dhe stafit pas organizimit të propozuar. Grafiku më poshtë prezanton pikërisht këtë eficientim të shprehur në reduktimin e kostove operative për banor në ZF të Peqinit krahasuar me mesataren e NJQV-ve përbërëse të ZF-së.


Figura 33. Shpenzimet operative për banor në NJQV-të ekzistuese dhe në ZF Peqin



Burimi: MF 2012. Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve

Duke konsideruar kushtet ekonomike dhe financiare të pandryshueshme, por njëkohësisht edhe tërësinë e përgjegjësive dhe funksioneve të NJQV-ve, bëjmë supozimin se kursimi i fondeve për shpenzimet operative dhe të personelit do të përdoret në masën 100% në rritjen e investimeve kapitale, analizojmë nivelin e investimeve të pritshme për banor në ZF të propozuar.

Figura 34. Investimet për banor në NJQV-të ekzistuese dhe në ZF Peqin



Burimi: MF 2012. Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve

Figura 34 tregon nivelin e investimeve për banor në NJQV-të ekzistuese, si dhe nivelin e investimeve të pritshme në NJQV-në e propozuar. Siç vihet re nga grafiku niveli i investimeve në ZF Peqin është rreth 3670 lekë për banor – 50% më i lartë, krahasuar me

nivelin mesatar të investimeve sot në të gjitha NJQV-të ekzistuese, i cili prezantohet në rreth 2450 lekë/banor.

Përfundime

ZF Peqin me popullsi 26 136 banorë, nga mesatarisht 4356 banorë për njësi.

Reduktimi i shpenzimeve administrative (paga dhe të tjera operative) me rreth 33 milionë lekë (ose 17% e shpenzimeve totale të kryera nga të gjitha njësitë ekzistuese).

Ulje e shpenzimeve të pagave nga 67 milionë lekë, në 36 milionë lekë në vit. Shpenzimet për paga për banor ulen nga 2564 në 1385 lekë për banor në njësinë e re.

Rritje e buxhetit vjetor të investimeve me 50% në vit, nga 64 milionë në 97 milionë lekë në vit.

Rritje e investimeve për frymë nga 2449 në 3715 lekë në njësinë e re.

Zona funksionale Gramsh

Zona funksionale Gramsh konsideron NJQV-të ekzistuese: Gramsh; Poroçan; Pishaj; Sult; Tunjë; Kukur; Kodovjat; Kushovë; Skënderbegas; Lënie. Përcaktimi i zonës funksionale brenda këtyre kufijve vjen si rezultat i ndërveprimit që ndodh mes banorëve, bizneseve apo aktorëve të tjerë që operojnë dhe përqendrohen në këtë zonë.

Figura 35. Zona funksionale Gramsh sipas variantit 3 të propozuar (me 47 zona funksionale në nivel vendi)



Do të shikojmë më poshtë efektet demografike, ekonomiko-financiare, në ofrimin e shërbimeve, distancat dhe aksesin referuar zonës funksionale të propozuar.

Efektet demografike

Popullsia e zonës funksionale Gramsh duke iu referuar të dhënave të Censur-it 2011 rezulton rreth 24 231 banorë. Sipërfaqja e ZF Gramsh është 737 km² dhe dendësia e popullsisë në këtë zonë funksionale është 33 banorë/km². Referuar të dhënave të Regjistrimit të Gjendjes Civile, raportohet rreth 36 250 banorë. Zona funksionale Gramsh nisur nga karakteristikat dhe morfologjia e territorit rezulton të jetë me një dendësi relativisht të ulët të popullsisë.

Tabela 9. Të dhëna demografike për ZF Gramsh dhe NJQV-të ekzistuese që përfshihen në të

Nr.	Njësiti Vendore	Popullsia	Dendësia	Sipërfaqja	RGJC	Diferenca
		INSTAT	INSTAT		Popullsia	INSTAT -
		2011	ba./km ²	km ²	Jan. 2012	RGJC
1	GRAMSH	8440	3405	2	16 426	-7986
2	KODOVJAT	2355	28	83	4406	-2051
3	KUKUR	2560	29	89	3426	-866
4	KUSHOVE	659	12	54	-	659
5	LENIE	779	8	101	-	779
6	PISHAJ	4906	47	104	9734	-4828
7	POROÇAN	1269	15	82	-	1269
8	SKËNDERBEGAS	1239	16	78	-	1239
9	SULT	631	10	63	-	631
10	TUNJË	1393	17	80	2258	-865
ZF Gramsh		24 231	33	737	36 250	-12 019

Burimi: INSTAT, Census 2011 & RGJC 2012

Zona funksionale Gramsh bën pjesë në atë kategori të zonave funksionale ku ndërveprimi institucional është i moderuar, ndërsa ndërveprimi mes rrjetit të bizneseve dhe banorëve rezulton të jetë më domethënës dhe i rëndësishëm.

Efektet ekonomiko-financiare

Le të shikojmë ndërveprimin dhe efektet ekonomike dhe financiare në zonat funksionale të propozuara.

Tabela 10. Ndërmarrjet aktive sipas NJQV-ve ekzistuese në ZF Gramsh dhe aktivitetit ekonomik

Komuna / Bashki	Biznese gjithsej	Popullsia INSTAT 2011	Biznese/1000 banorë	Bujqësia e Peshkimi	Industria	Ndërtimi	Tregtia	Shërbime
Gramsh	384	8440	45	*	37	9	167	170
Kodovjat	9	2355	4		*		*	7
Kukur	10	2560	4		*		*	7
Kushovë	5	659	8				*	4
Lenie	9	779	12		*		*	5
Pishaj	47	4906	10	*	10	*	22	11
Poroçan	4	1269	3					4
Skënderbegas	7	1239	6	*				6
Sult	3	631	5	*				*
Tunjë	8	1393	6	0	*	*	*	5
ZF Gramsh	486	24 231	20	4	52	13	196	221

Burimi: INSTAT 2012


Edhe në rastin e kësaj zone funksionale, aktivitetet kryesore duket se janë ato në fushën e shërbimeve dhe tregtisë, por nuk përjashtohen edhe aktivitetet në fushën e industrisë. Në NJQV-të e Poroçanit, Kodovjatit, Kukurit dhe Sultit përqendrimi i bizneseve është më i ulët, por ndërveprimi si rezultat i shërbimeve të ofruara në bashkinë e Gramshit duket të jetë i lartë.

Le të shikojmë ndikimin që do të kishte krijimi i një njësie të re vendore, duke iu referuar kufijve të zonës funksionale Gramsh të propozuar dhe duke konsideruar të gjithë faktorët që ndikojnë buxhetin dhe të ardhurat e njësive ekzistuese vendore të njëjtë.

Siç kemi përmendur edhe më sipër qëllimi dhe përfitimi kryesor nga riorganizimi i njësive vendore sipas zonave funksionale do të ishte një rishpërndarje më e mirë e shpenzimeve vendore dhe efikasiteti në ofrimin e shërbimeve.

Kështu, nëse i referohemi nivelit të shpenzimeve për banor që sot kanë NJQV-të që përbëjnë ZF të Gramshit, vëmë re se ato lëvizin prej 4480 lekë/banor në Pishaj dhe në 18 210 lekë/banor në Kushovë. Në kontekstin e zonës funksionale Gramsh në të njëjtat kushte të shpërndarjes së buxhetit (transfertat dhe të ardhurat e veta të njësive), buxheti për banor do të ishte 8050 lekë, pra rreth dy herë më i lartë se buxheti i NJQV-së më të varfër brenda zonës funksionale.

Figura 36. Buxheti total për banor në NJQV-të ekzistuese dhe ZF Gramsh




Burimi: MF 2012. Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve

Thuajse e njëjta tendencë prezantohet në lidhje me të ardhurat vendore të krijuara në NJQV-të ekzistuese dhe të parashikuara në ZF Gramsh të propozuar më sipër.

Sot të ardhurat vendore të komunës Sult janë 250 lekë/banor – më të ulëtat mes NJQV-ve të përfshira në ZF Gramsh, ndërsa të ardhurat vendore të bashkisë Gramsh janë 4430 lekë/banor. Mesatarisht të ardhurat për banor të parashikuara për ZF Gramsh janë rreth 2070 lekë (figura 37).

Figura 37. Të ardhurat e veta për banor në NJQV-të ekzistuese dhe ZF Gramsh




Burimi: MF 2012. Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve

Le të shikojmë shpërndarjen e personelit të NJQV-ve nga këndvështrimi i kostove për NJQV-në dhe qytetarët. Gjithmonë duke konsideruar të njëjtat kushte ekonomike, financiare, por njëkohësisht edhe të përgjegjësive dhe funksioneve, në grafikun më poshtë (figura 38) paraqiten shpenzimet e personelit për banor në NJQV-të ekzistuese të ZF Gramsh.

Duke konsideruar se krijimi i njësisë së re vendore, duke iu referuar kufijve të zonës funksionale do të përqendroje një pjesë të shërbimeve të cilat sot ofrohen në të gjitha NJQV-të vetëm në një qendër (të tilla janë zyrat e financave, burimet njerëzore, drejtoritë e mjedisit, drejtoritë e planifikimit urban, kadastrat urbane, etj.), kemi llogaritur se shpenzimet e NJQV-së së re që do të krijohen vetëm për personelin, do të reduktohen me të paktën 70% në rastin e ZF Gramsh. Si rezultat kosto e personelit për banor do të reduktohet nga një mesatare që sot rezulton rreth 4100 lekë/banor në rreth 2580 lekë për banor.

Figura 38. Shpenzimet e personelit për banor në NJQV-të ekzistuese dhe në ZF Gramsh




Burimi: MF 2012. Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve

Me të njëjtën logjikë analizojmë edhe kostot për shpenzimet operative të NJQV-ve ekzistuese dhe të NJQV-së të propozuar sipas kufijve të ZF Gramsh.

Gjatë kësaj analize duhet të kemi parasysh se në shpenzimet operative llogariten të gjitha shpenzimet e NJQV-ve, për shpenzimet e tyre rutine të mirëmbajtjes apo edhe ofrimit të shërbimeve, por njëkohësisht edhe kostot e qirave dhe mirëmbajtjes së godinave ekzistuese të NJQV-ve. Në një llogaritje të përgjithshme paraprake, vlerësojmë se kostot operative do të reduktohen me rreth 5% si rezultat i eficientimit të ambienteve dhe stafit pas organizimit të propozuar. Grafiku më poshtë prezanton pikërisht këtë eficientim të shprehur në reduktimin e kostove operative për banor në ZF të Gramshit krahasuar me mesataren e NJQV-ve përbërëse të ZF-së.

Figura 39. Shpenzimet operative për banor në NJQV-të ekzistuese dhe në ZF Gramsh




Burimi: MF 2012. Interpretimi dhe paraqitja grafike tonat

Duke konsideruar kushtet ekonomike dhe financiare të pandryshueshme, por njëkohësisht edhe tërësinë e përgjegjësi dhe funksioneve të NJQV-ve, bëjmë supozimin se kursimi i

fondeve për shpenzimet operative dhe të personelit do të përdoret në masën 100% në rritjen e investimeve kapitale, analizojmë nivelin e investimeve të pritshme për banor në ZF të propozuar.

Figura 40. Investimet për banor në NJQV-të ekzistuese dhe në ZF Gramsh



Burimi: MF 2012. Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve

Figura 40 tregon nivelin e investimeve për banor në NJQV-të ekzistuese, si dhe nivelin e investimeve të pritshme në NJQV-në e propozuar. Siç vihet re nga grafiku niveli i investimeve në ZF Gramsh është rreth 2680 lekë për banor – thuhet 2,5 herë më i lartë, krahasuar me nivelin mesatar të investimeve sot në të gjitha NJQV-të ekzistuese i cili prezantohet në rreth 1100 lekë/banor.

Përfundime

ZF Gramsh me popullsi 24 231 banorë, nga mesatarisht 2423 banorë për njësi.

Reduktimi i shpenzimeve administrative (paga dhe të tjera operative) me rreth 39,4 milionë lekë (ose 40% e shpenzimeve totale të kryera nga të gjitha njësitë ekzistuese).

Ulje e shpenzimeve të pagave nga 99 milionë lekë në 62,6 milionë lekë në vit. Shpenzimet për paga për banor ulen nga 4086 në 2583 lekë për banor në njësinë e re.


Rritje e buxhetit vjetor të investimeve me dy herë e gjysmë, nga 27 milionë në 66,4 milionë lekë në vit.

Rritje e investimeve për frymë nga 1114 në 2583 lekë në njësinë e re.

Zona funksionale Librazhd

Zona funksionale Librazhd konsideron NJQV-të ekzistuese: Orenjë; Lunik; Steblevë; Polis; Qendër; Librazhd; Hotolisht; Qukës; Përrenjas; Rrajcë; Stravaj. Përcaktimi i zonës funksionale brenda këtyre kufijve vjen si rezultat i ndërveprimit që ndodh mes banorëve, bizneseve apo aktorëve të tjerë që operojnë dhe përqendrohen në këtë zonë.

Figura 01. Zona funksionale Librazhd sipas Variantit 3 të propozuar (me 47 zona funksionale në nivel vendi)



Do të shikojmë më poshtë efektet demografike, ekonomiko-financiare në ofrimin e shërbimeve, distancat dhe aksesin referuar zonës funksionale të propozuar.

Efektet demografike

Popullsia e zonës funksionale Librazhd duke iu referuar të dhënave të Census-it 2011 rezulton rreth 56 798 banorë. Sipërfaqja e ZF Librazhd është 1116 km² dhe dendësia e popullsisë në këtë zonë funksionale është 51 banorë/km². Referuar të dhënave të Regjistrit të Gjendjes Civile raportohen rreth 76 601 banorë.

Tabela 11. Të dhëna demografike për ZF Librazhd dhe NJQV-të ekzistuese që përfshihen në të

Nr.	Njësitë Vendore	Popullsia	Dendësia	Sipërfaqja km ²	RGJC	Diferenca INSTAT - RGJC
		INSTAT 2011	INSTAT ba./km ²		Popullsia Jan. 2012	
1	HOTOLISHT	5706	33	175	7022	-1316
2	LIBRAZHD	6937	3778	2	11 742	-4805
3	LUNIK	2621	26	103	3680	-1059
4	ORENJË	3883	38	102	5153	-1270
5	PËRRENJAS	5847	453	13	8630	-2783
6	POLIS	3385	37	91	5098	-1713
7	QENDËR	8551	43	198	11 215	-2664
8	QUKËS	8211	65	127	10 724	-2513
9	RAJÇË	8421	136	62	10 290	-1869
10	STËBLEVË	809	7	123	-	809
11	STRAVAJ	2427	20	122	3047	-620
ZF Librazhd		56 798	51	1116	76 601	-19 803

Burimi: INSTAT, Census 2011 & RGJC 2012

Siç është përmendur më sipër, zona funksionale me qendërsi Librazhdin në disa raste mund të tentojë të përfshij brenda saj edhe një qendërsi tjetër më modeste, atë të Përrenjasit. Kjo veçanërisht po t'i referohemi ndërveprimit institucional. Ndërkohë duke konsideruar ndërveprimin mes rrjetit të bizneseve dhe banorëve brenda kufijve të rrethit të Librazhdit identifikojmë dy zona funksionale me valencë të ndryshme. Kuptohet se për sa i përket aspekteve të efikasitetit ekonomike organizimi në një zonë të vetme funksionale do të rezultonte më efektiv.

Efektet ekonomiko-financiare

Le të shikojmë ndërveprimin dhe efektet ekonomike dhe financiare në zonat funksionale të propozuara.

Tabela 12. Ndërmarrjet aktive sipas NJQV-ve ekzistuese në ZF Librazhd dhe aktivitetit ekonomik

Komuna / Bashki	Biznes e gjithsej	Popullsia INSTAT 2011	Biznese/1 000 banorë	Bujqësia e Peshkimi	Industria	Ndërtimi	Tregtia	Shërbime
Hotolisht	34	5706	6	*	3	*	9	20
Librazhd	437	6937	63	*	36	10	199	189
Lunik	13	2621	5	*	0		5	7
Orenjë	21	3883	5	*	*	*	*	15
Polis	25	3385	7	*	3		5	16
Përrenjas	227	5847	39	*	17	4	103	102
Qendër	37	8551	4	*	*	*	*	28
Qukës	62	8211	8	*	7	5	15	32
Rrajçë	63	8421	7	*	9		18	35
Steblevë	5	809	6		*	*		*
Stravaj	16	2427	7	4	*		4	7
ZF Librazhd	940	56 798	17	17	81	25	363	454

Burimi: INSTAT 2012

Aktivitetet kryesore duket se janë ato në fushën e shërbimeve dhe tregtisë, por disa aktivitete në fushën e industrisë. Në NJQV-në e Lunikut, Orenjës, Hotolishtit etj. përqendrimi i


bizneseve është më i ulët, ndërkohë që përqendrimi dhe ndërveprimi me bashkinë e Librazhdit, por edhe Përrenjasit duket të jetë i lartë.

Le të shikojmë ndikimin që do të kishte krijimi i një njësie të re vendore duke iu referuar kufijve të zonës funksionale Librazhd, të propozuar dhe duke konsideruar të gjithë faktorët që ndikojnë buxhetin dhe të ardhurat e njëjësive ekzistuese vendore të njëjtë.

Siç kemi përmendur edhe më sipër, qëllimi dhe përfitimi kryesor nga riorganizimi i njëjësive vendore sipas zonave funksionale do të ishte një rishpërndarje më e mirë e shpenzimeve vendore dhe efikasiteti në ofrimin e shërbimeve.

Kështu, nëse i referohemi nivelit të shpenzimeve për banor që sot kanë NJQV-të që përbëjnë ZF të Librazhdit, vëmë re se ato lëvizin prej 4160 lekë/banor në Rrajcë dhe në 11 120 lekë/banor në Stëblevë. Në kontekstin e zonës funksionale Librazhd në të njëjtat kushte të shpërndarjes së buxhetit (transfertat dhe të ardhurat e veta të njëjësive), buxheti për banor do të ishte 6920 lekë, pra rreth 50% më i lartë se buxheti i NJQV-së më të varfër brenda zonës funksionale.

Figura 42. Buxheti total për banor në NJQV-të ekzistuese dhe ZF Librazhd




Burimi: MF 2012. Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve

Thujse e njëjta tendencë prezantohet në lidhje me të ardhurat vendore të krijuara në NJQV-të ekzistuese dhe të parashikuara në ZF Librazhd të propozuar më sipër.

Sot të ardhurat vendore të komunës Hotolisht janë 260 lekë/banor – më të ulëtat mes NJQV-ve të përfshira në ZF Librazhd, ndërsa të ardhurat vendore të bashkisë Librazhd janë 5760 lekë/banor. Mesatarisht të ardhurat për banor të parashikuara për ZF Librazhd janë rreth 1190 lekë (figura 43).

Figura 03. Të ardhurat e veta për banor në NJQV-të ekzistuese dhe ZF Librazhd




Burimi: MF 2012. Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve

Le të shikojmë shpërndarjen e personelit të NJQV-ve nga këndvështrimi i kostove për NJQV-në dhe qytetarët. Gjithmonë duke konsideruar të njëjtat kushte ekonomike, financiare, por njëkohësisht edhe të përgjegjësive dhe funksioneve, në grafikun më poshtë (figura 44) paraqiten shpenzimet e personelit për banor në NJQV-të ekzistuese të ZF Librazhd.

Duke konsideruar se krijimi i njësisë së re vendore, duke iu referuar kufijve të zonës funksionale do të përqendrojë një pjesë të shërbimeve të cilat sot ofrohen në të gjitha NJQV-të vetëm në një qendër (të tilla janë zyrat e financave, burimet njerëzore, drejtoritë e mjedisit, drejtoritë e planifikimit urban, kadastrat urbane, etj.), kemi llogaritur se shpenzimet e NJQV-së së re që do të krijohen vetëm për personelin do të reduktohen me të paktën 70% në rastin e ZF Librazhd. Si rezultat kosto e personelit për banor do të reduktohet nga një mesatare që sot rezulton rreth 3030 lekë/banor në rreth 1450 lekë për banor.

Figura 44. Shpenzimet e personelit për banor në NJQV-të ekzistuese dhe në ZF Librazhd




Burimi: MF 2012. Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve

Me të njëjtën logjike analizojmë edhe kostot për shpenzimet operative të NJQV-ve ekzistuese dhe të NJQV-së të propozuar sipas kufijve të ZF Librazhd.

Gjatë kësaj analize duhet të kemi parasysh se në shpenzimet operative llogariten të gjitha shpenzimet e NJQV-ve, për shpenzimet e tyre rutine të mirëmbajtjes apo edhe ofrimit të shërbimeve, por njëkohësisht edhe kostot e qirave dhe mirëmbajtjes së godinave ekzistuese të NJQV-ve. Në një llogaritje të përgjithshme paraprake, vlerësojmë se kostot operative do të reduktohen me rreth 5% si rezultat i eficientimit të ambienteve dhe stafit pas organizimit të propozuar. Grafiku më poshtë prezanton pikërisht këtë eficientim të shprehur në reduktimin e kostove operative për banor në ZF të Librazhdit krahasuar me mesataren e NJQV-ve përbërëse të ZF-së.


Figura 45. Shpenzimet operative për banor në NJQV-të ekzistuese dhe në ZF Librazhd



Burimi: MF 2012. Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve

Duke konsideruar kushtet ekonomike dhe financiare të pandryshueshme, por njëkohësisht edhe tërësinë e përgjegjësiave dhe funksioneve të NJQV-ve, bëjmë supozimin se kursimi i fondeve për shpenzimet operative dhe të personelit do të përdoret në masën 100% në rritjen e investimeve kapitale, analizojmë nivelin e investimeve të pritshme për banor në ZF të propozuar.

Figura 46. Investimet për banor në NJQV-të ekzistuese dhe në ZF Librazhd



Burimi: MF 2012. Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve

Figura 46 tregon nivelin e investimeve për banor në NJQV-të ekzistuese, si dhe nivelin e investimeve të pritshme në NJQV-në e propozuar. Siç vihet re nga grafiku niveli i investimeve në ZF Librazhd është rreth 5800 lekë për banor – rreth 40% më i lartë, krahasuar me nivelin mesatar të investimeve sot në të gjitha NJQV-të ekzistuese.

Përfundime

Përfundimet për zonën e rrethit Librazhd janë llogaritur në variantin me dy njësi funksionale më vete, përkatësisht ZF Librazhd dhe ZF Prrenjas.

1. ZF Librazhd (Bashkia Librazhd dhe komunat Qendër Librazhd, Hotolisht, Lunik, Orenjë, Polis, Stëblevë)

ZF Librazhd e përbërë nga 7 njësi ekzistuese, ka popullsi prej 31,892 banorë, nga mesatarisht 4,556 banorë aktualisht në NJQV ekzistuese;

Reduktim i shpenzimeve administrative të njësisë me rreth 38,3 milionë lekë në vit, ose 30% e shpenzimeve administrative (shpenzime paga dhe operative) dhe 15% e shpenzimeve vjetore gjithsej;

Ulja e shpenzimeve të personelit për banor në masën 38%, nga 3,010 lekë në 1,869 lekë për banor;

Mirëadministrimi i burimeve financiare mund të sjellë rritje të investimeve në masën 34%, ose nga 113 milionë lekë, në 151,3 milionë lekë në vit;

Investimet për banor mund të rriten nga 3,543 lekë, në 4,744 lekë për banor në njësinë e re;

Bashkimi në një zonë funksionale mund të sigurojë rishpërndarje më të mirë të të ardhurave duke zbutur pabarazitë e mëdha mes zonave; pa llogaritur efektet e eficiencës së rritur në menaxhimin e të ardhurave: mesatarisht ZF e re do të realizonte 1,678 lekë të ardhura të veta për frymë, ose 21% më shumë se mesatarja e të ardhurave të veta për frymë në njësitë ekzistuese (1390 lekë) dhe 3 herë më shumë se mediani (503).

2. ZF Prrenjas (Bashkia Përrenjas dhe komunat Qukës, Rrajcë, Stravaj)

ZF Përrenjas e përbërë nga 4 njësi ekzistuese, ka popullsi prej 24,906 banorë, nga mesatarisht 6,227 banorë aktualisht në NJQV ekzistuese;

Reduktim i shpenzimeve administrative të njësisë me rreth 32,8 milionë lekë në vit, ose 28% e shpenzimeve administrative (shpenzime paga dhe operative) dhe 20% e shpenzimeve vjetore gjithsej;

Ulja e shpenzimeve të personelit për banor në masën 40%, nga 3,051 lekë në 1,815 lekë për banor;

Mirëadministrimi i burimeve financiare mund të sjellë rritje të investimeve pothuajse dyfish, ose nga 34 milionë lekë, në 66,8 milionë lekë në vit;

Investimet për banor mund të rriten nga 1,365 lekë, në 2,682 lekë për banor në njësinë e re;

Bashkimi në një zonë funksionale mund të sigurojë rishpërndarje më të mirë të të ardhurave duke zbutur pabarazitë e mëdha mes zonave; pa llogaritur efektet e eficiencës së rritur në menaxhimin e të ardhurave: mesatarisht ZF e re do të realizonte 721 lekë të ardhura të veta për frymë, ose 17% më shumë se mesatarja e të ardhurave të veta për frymë në njësitë ekzistuese (618 lekë) dhe 14% më shumë se mediani (632).

QARKU FIER

Profili i qarkut Fier


Qarku i Fierit përbëhet nga 42 njësi të qeverisjes vendore të ndara në tre rrethe: Fier (17 njësi, qendër Fier); Lushnjë (16 njësi, qendër Lushnjë) dhe Mallakastër (9 njësi, qendër Ballsh). Sipas të dhënave të regjistrimit të popullsisë 2011 (INSTAT, Census 2011), qarku i Fierit ka një popullsi prej 310 331 banorësh prej të cilëve 165 356 ose 53% e popullsisë janë përqendruar në rrethin e Fierit dhe 18% në qytetin e Fierit. Rrethi i Lushnjës ka 117 913 banorë (38%) dhe rrethi i Mallakastrës 27 062 banorë (9%).

Tabela 29. Ndryshimi i popullsisë në qarkun Fier mes viteve 2001 dhe 2011

Rrethi	Njësia	INSTAT 2011	INSTAT 2001	Diferenca	Diferenca në %
Fier	Cakran	11 722	14 799	11 722	-21%
Fier	Dermenas	7788	10 048	7788	-22%
Fier	Fier	55 845	56 164	55 845	-1%
Fier	Frakull	6820	8679	6820	-21%
Fier	Kuman	5611	7319	-1708	-23%
Fier	Kurjan	3618	5201	-1583	-30%
Fier	Levan	8159	11 549	8159	-29%
Fier	Libofshë	6149	8333	6149	-26%
Fier	Mbrostar	7460	8521	7460	-12%
Fier	Patos	15 397	21 812	-6415	-29%
Fier	Portëz	8259	8711	8259	-5%
Fier	Qendër	4207	8659	4207	-51%
Fier	Roskovec	4975	5939	-964	-16%
Fier	Ruzhdie	2326	3177	-851	-27%
Fier	Strum	7538	7923	-385	-5%
Fier	Topojë	4246	5494	4246	-23%
Fier	Zharrëz	5236	6754	5236	-22%
Total rrethi Fier		165 356	199 082	-33 726	-17%
Lushnjë	Allkaj	4319	5492	-1173	-21%
Lushnjë	Ballagat	2461	3431	-970	-28%
Lushnjë	Bubullimë	5548	6515	-967	-15%
Lushnjë	Divjakë	8445	10 916	-2471	-23%
Lushnjë	Dushk	7872	9111	-1239	-14%
Lushnjë	Fiershegan	7023	8327	-1304	-16%
Lushnjë	Golem	5243	6191	-948	-15%
Lushnjë	Grabian	3638	4862	-1224	-25%
Lushnjë	Gradishtë	7521	8939	-1418	-16%
Lushnjë	Hysgjokaj	2603	3139	-536	-17%
Lushnjë	Karburnarë	4193	5356	-1163	-22%
Lushnjë	Kolonjë	5728	7099	-1371	-19%
Lushnjë	Krutje	7564	9000	-1436	-16%
Lushnjë	Lushnjë	31 105	37 860	-6755	-18%
Lushnjë	Rremas	4449	5712	-1263	-22%
Lushnjë	Tërbuf	10 201	11 983	-1782	-15%
Total rrethi Lushnjë		117 913	143 933	-26 020	-18%
Mallakastër	Aranitas	2714	4530	-1816	-40%
Mallakastër	Ballsh	7657	9154	-1497	-16%
Mallakastër	Fratar	3221	4593	-1372	-30%
Mallakastër	Greshicë	1152	1899	-747	-39%
Mallakastër	Hekal	2623	4412	-1789	-41%
Mallakastër	Kute	877	1779	-902	-51%
Mallakastër	Ngraçan	1977	3356	-1379	-41%
Mallakastër	Qendër	588	1030	-442	-43%
Mallakastër	Selitë	6253	8776	-2523	-29%
Total rrethi Mallakastër		27 062	39 529	-12 467	-32%
Total qarku Fier		310 331	382 544	-72 213	-19%

Burimi: INSTAT Census 2001, 2011

Figura 71. NJQV në qarkun e Fierit sipas popullsisë



Burimi: INSTAT, Census 2011 Llogaritjet e autorëve

Trendi në uljen e popullsisë është i qartë edhe nëse krahasohen të dhënat e Census-it 2011 me Census-in 2001. Në vitin 2001 në qarkun e Fierit ishin regjistruar 382 544 banorë 19% (72 213 banorë) më shumë se dhjetë vjet më vonë. Të gjitha rrethet kanë humbur popullsi me ritme pak a shumë të ngjashme gjatë këtij dhjetëvjeçari: Fieri ka humbur rreth 17% të popullsisë krahasuar me vitin 2001, Lushnja 18%, ndërkohë që Mallakastra ka humbur 32% të popullsisë.

Popullsia e qarkut Fier përbën rreth 11,1% të popullsisë së vendit sipas të dhënave të Census-it 2011 dhe popullsia mesatare për njësi të qeverisjes vendore në këtë qark rezulton 7389 banorë/NJQV. Kjo mesatare është afër (rreth 7% më e ulët) se mesatarja e popullsisë për NJQV në rang vendi (8016 banorë/NJQV). Rreth 43% e NJQV kanë popullsi më të vogël se 5000 banorë (kryesisht njësitë e rrethit të Mallakastrës) dhe 12% e NJQV kanë popullsi më të lartë se 10 000 banorë. Ndërkohë 60% e popullsisë në rrethin e Fierit jetojnë në njësi me popullsi më të ulët se 10 mijë banorë dhe në të gjithë qarkun ka vetëm dy njësi me popullsi relativisht më të lartë: Fieri me mbi 50 mijë banorë dhe Lushnja me mbi 30 mijë banorë.

Tabela 30 Shpërndarja e popullsisë në njësitë e qarkut të Fierit

	<i>Nr. i njësive</i>	<i>Min</i>	<i>Maks</i>	<i>Mesatare/ njësi</i>	<i>Shuma</i>	<i>% e popullsisë</i>	<i>Shqipëria</i>
Shqipëria				8016	2 311 848	100%	
Fier				7389	310 331	11,1%	
0-2000	4	588	1977	1149	4594	1,5%	27,61%
2001-5000	14	2326	4975	3542	49 593	16,0%	34,58%
5001-10 000	19	5236	8445	6940	13 1874	42,5%	26,27%
10 001 – 20 000	3	10 201	15 397	12 440	37 320	12,0%	6,70%
20 001-30 000	0					0,0%	1,61%
30 001-50 000	1	31 105	31 105	31 105	31 105	10,0%	1,07%
50 000-100 000	1	55 854	55 845	55 845	55 845	18,0%	1,61%
100 000-200 000							0,27%
200 000+							0,27%

Burimi: INSTAT, Census 2011 Llogaritjet e autorëve

Dendësia mesatare e popullsisë është 320,3 banorë/km², krahasuar me 97,4 banorë/km² në rang vendi. Dendësia reflekton kryesisht përqendrimin e popullsisë në njësi vendore me sipërfaqe jo shumë të madhe dhe kjo lidhet kryesisht me morfologjinë e territorit në të cilin shtrihet qarku i Fierit. Fieri (4212 banorë/km²) dhe Ballshi (3085 banorë/km²) janë njësitë vendore me dendësi më të lartë, ndërsa komunat Selitë (25,47 banorë/km²) dhe Kute (35,14 banorë/km²) janë njësitë me dendësinë më të ulët. Me dendësi të ulët janë edhe njësitë Hekal, Aranitas, Topojë, etj. Rrethi i Fierit ka dendësi më të lartë se 412 banorë/km², ndërsa rrethi i Lushnjës ka dendësi mesatare të njësive prej 180,6 banorësh për km². Rrethi i Mallakastrës ka dendësi mesatare të lartë (395 banorë/km²), por me përjashtim të qytetit të Ballshit dhe komunës Qendër (6253 banorë, 103 banorë/km²) të gjitha njësitë e tjera në këtë rreth kanë dendësi më të ulët se 100 banorë/km² dhe popullsi më të ulët se 3000 banorë.

Lëvizjet e popullsisë

Siç vërehet edhe nga të dhënat e popullsisë e gjithë zona e qarkut të Fierit ka pasur humbje të popullsisë gjatë këtyre viteve. Humbjen më të madhe të popullsisë e ka zona e Mallakastrës (mbi 32%) ku disa prej njësive kanë humbur edhe gjysmën e popullsisë gjatë një dhjetëvjeçari. Sipas INSTAT-it mbi 54% e popullsisë së larguar janë vendosur në Tiranë, ndërkohë që nga 8% përkatësisht janë vendosur në qarqet e Durrësit dhe të Beratit. Të dhënat (Tabela 29) tregojnë se njësitë më të vogla kanë tendencën të kenë humbje relative më të mëdha të popullsisë.

Propozimi i zonave funksionale në qarkun Fier

Duke iu referuar përcaktimit të zonës funksionale (ZF) sipas kriterëve të miratuara nga Komisioni parlamentar për reformën territoriale administrative (KPRTA) – “një hapësirë territoriale ku ka një ndërveprim të dendur dhe të shpeshtë mes banorëve dhe institucioneve për qëllime ekonomike, sociale, zhvillimore dhe kulturore” – më poshtë do të analizojmë pikërisht këto forma të ndërveprimit për të identifikuar zonat funksionale në qarkun e Fierit

Ndërveprimi institucional në qarkun Fier


Sot në Shqipëri si rudiment i organizimit më të hershëm të shtetit dhe qeverisjes qendrat e rrethëve janë përqendrimet kryesore të institucioneve qendrore (kryesisht ministrive të linjës)

në nivelin më pranë qytetarit. Në qendrat e rretheve vendosen zyrat arsimore, zyrat e punësimit, drejtoritë shëndetësore rajonale, drejtoritë e shërbimit pyjor, gjykata e rrethit gjyqësor, prokuroria dhe degët e tatimeve. Në disa prej qendrave të rrethit janë vendosur dhe një sërë institucionesh sociale, shëndetësore dhe arsimore, si shtëpitë e të moshuarve, shtëpitë e foshnjës, qendrat e formimit profesional, qendrat e zhvillimit etj.

Kjo është ndër arsyet kryesore që bën që qendrat e rretheve të shndërrohen në pika kontakti për sa i përket ndërveprimit institucional pra, të institucioneve me njëri-tjetrin, por njëkohësisht edhe të qytetarit me institucionet. Bizneset po ashtu duket se preferojnë të vendosen në qendrat e rretheve po për të njëjtën arsye; praninë e institucioneve e cila shoqërohet njëkohësisht me kapacitete më të mira njerëzore, cilësi më të lartë shërbimi dhe mundësi më të mira zgjedhjeje për sa i përket fushës së aktivitetit.

Institucionet që kryejnë aktivitetin dhe janë vendosur në qendrën e qarkut janë: drejtoritë rajonale (bujqësia, AKU, arsimi, shëndetësia, punësimi, shërbimi pyjor); Bordi i Kullimit; Zyra e Kujdesit Social, Gjykata e Rrethit Gjyqësor; Prokuroria e Rrethit, Drejtoria e Policisë, Dega e Thesarit, Dega e Tatimeve Rajonale, etj.

Figura 72. Shpërndarja e institucioneve dhe agjencive qendrore dhe ndërveprimi institucional në qarkun e Fierit



Burimi: DAP Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve

Pikërisht për këtë arsye duke iu referuar ndërveprimit institucional, përqendrimit të popullsisë dhe bizneseve si dhe ndërveprimit mes këtyre të fundit në qarkun e Fierit identifikojmë tre zona kryesore funksionale: atë me qendër Fierin, me qendër Lushnjën dhe me qendër Ballshin. Pranë Fierit evidentohet mjaft mirë një tjetër pol zhvillimi, zona me në qendër


Patosin, e cila është qendër kryesisht industriale dhe ka përqendrim biznesesh e shërbimesh të lidhura me to. Po ashtu Divjaka si zonë turistike shfaq tendenca të krijimit të një tjetër zone të vogël funksionale si rezultat kryesisht i ndërveprimit mes banorëve dhe rrjeteve të tjera sociale dhe ekonomike.

Ndërveprimi ekonomik në qarkun Fier

Do ta vlerësojmë nëpërmjet LËVIZJEVE PËR PUNËSIM: shërbimet, partneritetet, rrjeti i infrastrukturave, zinxhiri i vlerave (bizneset), etj. – Pra, dendësia e popullsisë, shpeshësia e udhëtimit për në punë, përqendrimi i bizneseve dhe diversiteti i aktiviteteve, potenciali i zhvillimit ekonomik, cilësia e jetës dhe shërbimet.

Le të shikojmë përqendrimin e bizneseve dhe llojin e aktiviteteve kryesore të biznesit.

Figura 73. Përqendrimi i bizneseve dhe lloji i aktiviteteve në qarkun Fier




Burimi: INSTAT 2012 Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve

Duke iu referuar përqendrimin të bizneseve dhe shumëllojshmërisë së aktivitetit të tyre (i cili indirekt dëshmon për nivel më të lartë të shërbimeve) në qarkun e Fierit identifikohen tashmë qartë katër zona funksionale, zona me në qendër Fierin, zona me qendër Lushnjën, zona me qendër Ballshin si edhe zona e Patosit, e cila tenton të krijohet në afërsi të Fierit dhe që përfshin edhe qytetin e Roskovecit. Veç këtyre qendrave lexojmë një tjetër zonë që tenton të krijohet rreth Divjakës. (Figura 73).

Për të qartësuar me tej zonat funksionale le të shikojmë drejtimet kryesore të lëvizjes së të punësuarve brenda qarkut të Fierit. Siç demonstron nga Figura 74 ka tendenca shumë të forta lëvizjeje për punë drejt Fierit dhe drejt Patosit në rrethin e Fierit. Siç shikohet nga drejtimet e lëvizjes Patosi është destinacioni ku një pjesë e mirë e banorëve të zonave përreth, por edhe nga vetë qendra e qarkut, udhëtojnë për punë. E ngjashme paraqitet situata edhe në

zonat e tjera të qarkut Fier, ku ka tendenca lëvizjesh të shpeshta drejt Lushnjës dhe Divjakës, si edhe Ballshit në Mallakastër.

Figura 74 Harta e ndërveprimit ekonomik qarku Fier



Burimi: MÇV

Përsëri konfirmohen zonat funksionale me qendër Fierin, Lushnjën, Ballshin, por lexohen tashmë qartë tendencat për krijimin e zonave të tjera funksionale më të vogla me qendër përkatësisht Divjakën dhe Patosin (Figura 75).

Figura 75. Zonat funksionale të propozuara në qarkun e Fierit



Vështrim i zonave funksionale

Rrethi i Fierit

Rrethi i Fierit ka popullsi të përgjithshme prej mbi 165 000 banorësh dhe dy qendra urbane kryesore: qyteti i Fierit që është qartësisht poli kryesor i zhvillimit ekonomik të rrethit, por edhe qyteti i Patosit, i cili ka një popullsi të konsiderueshme prej mbi 15 mijë banorësh dhe shërben si qendër industriale e si destinacion punësimi për zonat përreth. Për këtë arsye rrethi i Fierit është studiuar në dy zona funksionale: zona e Patosit, që përfshin bashkinë Patos, komunën Ruzhdie, bashkinë Roskovec dhe komunat Kuman, Kurjan dhe Strumë përreth saj të cilat kanë afërsi gjeografike dhe shkëmbime më të shpeshta, si dhe bashkia Fier me komunat e tjera të rrethit.

Zona funksionale Fier

Zona Fier (bashkia Fier, bashkia Levan, komunat Cakran, Dermenas, Frakull, Libofshë, Mbrostar, Portëz, Qendër, Topojë, Zharrëz)

Kjo zonë funksionale ka një popullsi prej 125 891 banorësh sipas të dhënave të Censurit 2011 dhe është e përbërë nga 11 njësi ekzistuese (10 komuna dhe 1 bashki). Dendësia mesatare në zonën funksionale është 190 banorë për km², në krahasim me 145 banorë për km² që është vlera mesatare (*median*) e dendësisë në njësitë ekzistuese.

Vështrim i gjendjes ekonomike, financiare dhe administrative

Zhvillimi ekonomik dhe të dhënat ekonomike financiare

Sektori mbizotërues në ekonominë e rajonit të Fierit është bujqësia, e cila prodhon rreth 37% të vlerës së shtuar për të gjithë rajonin. Ndonëse të dhëna më të detajuara në nivel njësie vendore nuk janë të disponueshme, konfigurimi i zonës funksionale të re sugjeron se me përjashtim të bashkisë Fier pjesa dërrmuese e njërive të reja të përfshira kanë karakter bujqësor.

Kjo hipotezë mbështetet edhe nga të dhënat mbi shpërndarjen e bizneseve në këto zona. Zona funksionale Fier ka gjithsej 4242 biznese nga të cilët 71% janë të vendosur në qytetin e Fierit. Mesatarisht 47% e të punësuarve në zonë me përjashtim të qytetit të Fierit veprojnë në sektorin e bujqësisë, ndërkohë që 11% punojnë në ndërtim dhe 10% në industri. Punësimi në qytetin e Fierit mbizotërohet nga shërbimet (42%) i ndjekur nga industria (23%) dhe shërbimet (22%).

Tabela 31. Numri i bizneseve në njësitë e rrethit Fier

Rrethi	Njësia	B/K	Nr. i bizneseve	Biznese për 1000 banorë
Fier	Cakran	K	94	8,0
Fier	Dermenas	K	74	9,5
Fier	Fier	B	3031	54,3
Fier	Frakull	K	57	8,4
Fier	Levan	K	137	16,8
Fier	Libofshë	K	107	17,4
Fier	Mbrostar	K	137	18,4
Fier	Portëz	K	167	20,2
Fier	Qendër (Çlirim)	K	238	56,6
Fier	Topojë	K	68	16,0
Fier	Zharrëz	K	132	25,2
Gjithsej zona Fier para bashkimit			4242	23
Gjithsej zona Fier pas bashkimit			4242	34

Burimi: INSTAT

Figura 76. Harta e shpërndarjes së bizneseve në ZF Fier





Figura 77. Biznese për një mijë banorë në ZF Fier



Siç shihet nga të dhënat shumica e njësive në zonën funksionale në shqyrtim kanë numër të ulët biznesesh për 1000 banorë. Kujtojmë se kjo është një zonë kryesisht bujqësore, me përjashtim të bashkisë Fier. Bizneset për 1000 banorë në njësitë e veçanta variojnë nga 8 (Cakran) në 56 në komunën Qendër. Mesatarisht para bashkimit në këto 11 njësi ka më pak se 23 biznese për 1000 banorë. Ndërkohë, në zonën funksionale ky tregues rritet në pothuajse 34 biznese për 1000 banorë për të gjithë zonën funksionale.

Të dhëna buxhetore


Të gjitha njësitë e zonës kanë një buxhet (të ardhura) prej rreth 1,5 miliardë lekësh në vitin 2012. Nga këto rreth 43% ose 650 milionë janë realizuar në bashkinë e Fierit, ndërsa pjesa tjetër në komuna. (Tabela 32).

Tabela 32. Të dhëna buxhetore për zonën funksionale Fier

	Të ardhura totale	Të ardhura të veta	Shpenzime totale
Cakran	87 046	7386	43 000
Dermenas	58 802	7900	41 000
Fier	646 131	354 388	624 000
Frakull	65 340	8471	27 000
Levan	84 731	18 408	48 000
Libofshë	96 798	24 975	45 000
Mbrostar	98 268	50 788	84 000
Portëz	83 558	23 795	45 000
Qendër (Çlirim)	66 358	19 858	52 000
Topojë	89 653	10 104	21 000
Zharrëz	123 840	76 040	65 000
Gjithsej ZF	1 500 526	602 112	1 095 000


Po të vërejmë të ardhurat për frymë shohim se mesatarja e të ardhurave të veta për frymë për të gjitha njësitë është 4260 lekë. Pas bashkimit ky tregues rritet në 4783 lekë për frymë për të gjithë zonën funksionale. Të ardhurat e veta për frymë në zonën funksionale janë më të ulëta nga çfarë raportohet nga ky tregues në bashkinë e Fierit apo në komunat Zharrëz dhe Mbrostar. Megjithatë ky tregues përmirësohet për shumicën e njërive.

Figura 78 Të ardhurat e veta për frymë në zonën funksionale Fier




Ndërkohë situata paraqitet disi më ndryshe për treguesit mbi të ardhurat gjithsej të njërive: mesatarja e të ardhurave për frymë në zonën funksionale pëson disi rënie në krahasim me mesataren e njërive individuale. Kjo shpjegohet me faktin se njësitë më të vogla subvencionohen në masë shumë të madhe nga buxheti i shtetit duke rezultuar në të ardhura të larta për frymë. Treguesi i të ardhurave të veta për frymë mund të përmirësohet më tej në rastin e zonës funksionale nëse shfrytëzohen avantazhet që rrjedhin nga dimensionimi më i madh i njësisë së re – si në pikëpamjen e administratës më të kualifikuar, ashtu edhe në dobësimin e tendencës për të mos mbledhur taksat në lokalitete më të vogla ku administrata tatimore deri tani ka pasur lidhje shumë të ngushta me taksapaguesit.

Figura 79. Të ardhurat për frymë në zonën funksionale Fier



Në përgjithësi mund të themi se varësia e njësisve në zonën funksionale të Fierit ndaj transfertave buxhetore është shumë e lartë. Në zonën funksionale Fier kjo varësi ulet, pasi pesha e të ardhurave të veta në buxhetin total rritet nga 29% në 40%.


Figura 80. Struktura e buxhetit në njësitë e ZF Fier: burimi i të ardhurave



Të dhëna mbi shpenzimet

Po të vërejmë shpenzimet për frymë të dhënat janë të ngjashme:

Figura 81. Shpenzimet për frymë



Shpenzimet për frymë në zonën funksionale Fier do të ishin rreth 8700 lekë pra, rreth 15% më të larta se mesatarja e shpenzimeve për frymë në njësitë ekzistuese ose 30% më e lartë se vlera mesatare (*median*) e shpenzimeve për frymë në NJQV ekzistuese. Kjo do të sigurote nga njëra anë rishpërndarje më të mirë të burimeve financiare, por nga ana tjetër edhe planifikimin më të mirë strategjik të buxhetit në zonën funksionale, e cila do të ketë burime krahasimisht më të mëdha. Kjo mund të përkthehet edhe në krijimin e kontigjencave për investime me ndikim më të madh nga fondet e veta dhe shpërndarjen e tyre në zonën funksionale përgjatë harkut kohor të disa viteve.

Tabela 33. Të ardhurat dhe shpenzimet për frymë në zonën funksionale Fier

	Të ardhura për frymë	Të ardhurat e veta për frymë	Shpenzime për frymë
Cakran	7426	630	3668
Dermenas	7550	1014	5265
Fier	11 570	6346	11 174
Frakull	9581	1242	3 959
Levan	10 385	2256	5883
Libofshë	15 742	4062	7318
Mbrostar	13 173	6808	11 260
Portëz	10 117	2881	5449
Qendër (Çlirim)	15 773	4720	12 360
Topojë	2115	2380	4946
Zharrëz	23 652	14 522	12 414
ZF gjithsej	11 919	4783	8698


Njësitë shpenzojnë mesatarisht 49% të buxhetit për shpenzime administrative, minimumi përfaqësohet nga komuna Zharrëz (38%) dhe maksimumi nga komuna Qendër me 62%. Treguesi i shpenzimeve administrative për zonën ulet në 33% duke marrë parasysh rritjen e efikasitetit në menaxhimin e shërbimeve të parashikuar, e cila do të trajtohet më poshtë.

Tabela 34. Struktura e shpenzimeve në zonën funksionale Fier

	Shpenzime totale	Shpenzime personel	Shpenzime operative të tjera	Investime 2012	Shp. personel si % e totalit	Inv. si % e totalit 2012	Operative të tjera si % e totalit
Cakran	43 000	25 000	7000	11 000	58%	26%	16%
Dermenas	41 000	19 000	14 000	8000	46%	20%	34%
Fier	624 000	269 000	258 000	97 000	43%	16%	41%
Frakull	27 000	14 000	6000	7000	52%	26%	22%
Levan	48 000	29 000	12 000	7000	60%	15%	25%
Libofshë	45 000	21 000	13 000	11 000	47%	24%	29%
Mbrostar	84 000	30 000	15 000	39 000	36%	46%	18%
Portëz	45 000	23 000	6000	16 000	51%	36%	13%
Qendër (Çlirim)	52 000	32 000	11 000	9000	62%	17%	21%
Topojë	21 000	10 000	4000	7000	48%	33%	19%
Zharrëz	65 000	25 000	22 000	18 000	38%	28%	34%
Mesatare	1 095 000	497 000	368 000	230 000	49%	26%	25%
Gjithsej ZF Fier*	1 095 000	337 400	357 000	400 600	31%	37%	33%

*Të dhënat për ZF Fier janë nxjerrë me supozimin se do të kursehet rreth 70% e shpenzimeve administrative dhe 10% e shpenzimeve të tjera operative të njësive që suprimohen.

Figura 82. Struktura e shpenzimeve në zonën funksionale krahasuar me mesataren e njësisë ekzistuese



Treguesit e investimeve


Treguesit e investimeve vrojtohen më mirë në një periudhë të gjatë kohore. Në këtë rast janë shqyrtuar të dhënat për pesë vjet, të cilat tregojnë se niveli i investimeve në këtë zonë ka qenë shumë i ulët. Në veçanti në qytetin e Fierit në këto pesë vjet janë investuar vetëm 11% e të ardhurave totale që mund të jetë një tregues i vështirësive financiare të këtyre viteve. Po të supozojmë se ritmi i investimeve do të ishte ulur në masën e reduktimit nga shpenzimet administrative, pesha e investimeve ndaj buxhetit total të zonës funksionale do të rritej në 23% nga 14% mesatarisht.

Figura 83 Investimet si përqindje e buxhetit total në zonën funksionale dhe njësitë ekzistuese

	Investime 2008 - 2012	Të ardhura 2008 - 2012	Inv. si % e ardh. totale 2008 - 2012
Cakran	104 886	602 369	17%
Dermenas	57 449	407 620	14%
Fier	426 298	3 901 275	11%
Frakull	58 089	347 386	17%
Levan	99 733	613 512	16%
Libofshë	75 535	392 658	19%
Mbrostar	113 873	489 223	23%
Portëz	65 763	403 093	16%
Qendër (Çlirim)	61 424	423 124	15%
Topojë	45 526	328 125	14%
Zharrëz	84 015	415 389	20%
Mesatare	1 192 591	8 323 774	14%
Zona funksionale	1 955 849	8 323 774	23%

Investimet mesatare për frymë në periudhën 2008 – 2012 në njësitë e qarkut Fier variojnë nga 1475 lekë për frymë në Dermenas në 3209 lekë për frymë në Zharrëz. Nëse këto njësi do të menaxhoheshin brenda zonës funksionale Fier duke rezultuar në ekonomitë e shkallës për menaxhimin e shërbimeve dhe uljen e shpenzimeve administrative (kostot e personelit dhe kostot operative), fondet e çliruara do të mund të rialokoheshin për investime. Në teori, kjo do të sillte një mesatare shpenzimesh për frymë në zonën funksionale prej 3300 lekësh për frymë (Figura 84).

Figura 84. Investimet për frymë në ZF Fier mesatare 2008 - 2012




Analiza e efekteve administrative

Një nga elementet e rëndësishëm që lidhet drejtpërdrejt me efikasitetin në ofrimin e shërbimeve dhe mirë menaxhimin e fondeve publike në nivel vendor është numri i punonjësve të angazhuar në administratën vendore.

Figura 85 tregon ngarkesën administrative në NJQV-të ekzistuese të qarkut Fier. Shihet qartë që disa nga njësitë në veçanti ato më të voglat kanë ngarkesë të lartë administrative – (kjo pa llogaritur funksionet vendimmarrëse si këshilli bashkiak), çka dëshkohet edhe nga të dhënat mbi shpenzimet e personelit. (Figura 86). Natyrisht, në disa raste kjo lidhet drejtpërdrejt me zgjedhjen që bëjnë njësitë e ndryshme në menaxhimin e shërbimeve. Nëse NJQV i menaxhon tërë shërbimet me strukturat e veta struktura e personelit është krahasimisht më e lartë se ç'do të ishte në rastin se këto shërbime do të jashtë kontrakttoheshin. Megjithatë, ky është një faktor domethënës kryesisht për bashkitë dhe njësitë e mëdha, të cilat ofrojnë shërbime të shumëllojshme mirëmbajtjeje. Sërish, në disa raste numri i raportuar i punonjësve vendorë për banorë është shumë i lartë krahasimisht me NJQV-të e tjera.

Bashkimi i njësive në një zonë funksionale do të rezultojë në kursime veçanërisht nga shpenzimet e personelit dhe një pjesë të shpenzimeve operative për mirëmbajtjen e zyrave. Në veçanti, në dhjetë nga njëmbëdhjetë njësitë e zonës funksionale do të shkurtohen pozicionet e kryetarit dhe të kabinetit të tij dhe shpenzimet për shpërblimet e këshilltarëve. Gjithashtu, shkurtime të mëtejshme do të realizohen nga realizimi i asaj që rëndom quhet si *economy of scope* (efekti i bashkimit), më konkretisht shkurtimi i funksioneve të përsëritura administrative, të cilat do të përqendrohen në njësinë administrative të zonës funksionale. Të tilla pozicione janë sektori i menaxhimit financiar (specialistët e financës dhe buxhetit), sektori i prokurimeve dhe sektori i auditivit financiar, por edhe sektori i urbanistikës. Një llogari paraprake e reduktimit të mundshëm sugjeron se nga bashkimi mund të kursehen rreth 60% - 70% e kostove të personelit dhe rreth 10% e shpenzimeve të mirëmbajtjes së zyrave. Përlllogaritjet e mëposhtme janë bazuar mbi këtë model.

Figura 85 Ngarkesa administrative në NJQV e ZF Fier



Burimi: MÇV

Figura 86. Shpenzimet e personelit për frymë në NJQV-të individuale dhe ZF Fier (2012, lek)




Tabela 35. Reduktimi i shpenzimeve të personelit dhe të mirëmbajtjes

	Reduktimi nga personeli 60%)	Reduktimi nga zyrat (10%)
Cakran	17 500	700
Dermenas	13 300	1400
Fier		
Frakull	9800	600
Levan	20 300	1200
Libofshë	14 700	1300
Mbrostar	21 000	1500
Portëz	16 100	600
Qendër (Çlirim)	22 400	1100
Topojë	7000	400
Zharrëz	17 500	2200
	159 600	11 000
Reduktimi si % e zërit përkatës	32%	3,0%
Reduktimi si % e shpenzimeve totale	15%	1%


Me supozimet e bëra në zonën funksionale Fier pas bashkimit kursehen mbi 170 milionë lekë ose 16% e shpenzimeve totale të kryera nga të gjitha njësitë. Nëse do të supozonim se fondet e liruara nga rritja e efikasitetit në menaxhim do të rialokoheshin 100% në investime, mund të themi se këto fonde të çliruara janë pothuajse të barabarta me përqindjen e buxhetit që alokohet për investime në këtë zonë, çka do të thotë se me *këto kursime në teori dyfishohen investimet për zonën.*

Efektet në ofrimin e shërbimeve

Veç efijencës ekonomike dhe financiare organizimi i NJQV-ve të propozuara sipas zonave funksionale pritet të krijojë një sërë efektesh dhe eksternalitetesh pozitive në nivelin dhe cilësinë e ofrimit të shërbimeve.

Në një analizë të shpejtë në disa prej shërbimeve të rëndësishme të ofruara prej nivelit vendor në Shqipëri, organizimi sipas zonave funksionale do të krijojë mundësinë për harmonizimin më të mirë të politikave të cilat kanë nevojë për territor të gjerë dhe mundësitë për zhvillimin ekonomik. Kështu copëzimi i madh i territorit sipas kufijve të NJQV-ve ekzistuese ka qenë ndër arsyet kryesore të diskutuara në lidhje me keq menaxhimin e territorit dhe mjedisit. Riorganizimi sipas konceptit të zonave funksionale në mos do të zhdukë do të zbusë këtë problem duke mundësuar bërjen e politikave të zhvillimit dhe menaxhimit për territore gjeografike më të plota dhe me potenciale më të mëdha për mirë menaxhim burimesh.

Figura 87. Harta e zonave të mbrojtura në Fier dhe në Shqipëri




Burimi: Ministria e Mjedisit Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve

Në figurën më sipër prezantohen zonat e mbrojtura në Shqipëri, por edhe në Fier. Deri në tani këto zona në kushte të copëzimit mes shumë NJQV-ve vendore në mos keqpërdorur, nuk kanë përdorur e menaxhuar potencialin e tyre natyror. Në kushtet e riorganizimit pjesa më e madhe e zonave të mbrojtura do të menaxhohen prej një apo maksimumi dy njësive vendore, të cilat do të kenë mundësi dhe shanse më të mira për të ndërtuar mbi potencialin e këtyre zonave. I njëjti diskutim është i vlefshëm edhe për çështjet e planifikimit të territorit, menaxhimit të tokës apo kontrollit mbi territorin.

Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimit të ujërave të zeza po ashtu duket se ka shanse për të funksionuar më mirë dhe në mënyrë më efektive. Figura më poshtë tregon organizimin e ndërmarrjeve të ujësjellësve dhe të KUZ-ve sot. Siç vihet re edhe nga figura e mëposhtme menaxhimi i ndërmarrjeve të ujësjellësve sot bëhet nëpërmjet bordeve (në më të shumtën e rasteve) të zgjedhura prej një numri të madh NJQV-sh duke u bërë në shumë raste i vështirë për të marrë vendime dhe mirë menaxhuar ndërmarrjen. Riorganizimi sipas zonave funksionale duket se krijon kushte më të mira edhe për mirë menaxhimin dhe organizimin e këtij shërbimi.

Figura 88. Harta e mbulimit me shërbimin e furnizimit me ujë në Shqipëri dhe ZF Fier



Shpjegues
MBULIMI ME UK
Aksesi ne Sherbim
 PO-SH.a UK Fier
 PO-Sh.a U Lushnjë Fshat
 PO-Sh.a U Patos
 JO
Zone Funktionale
 FIER

Burimi: DPU/Ministria e Transportit Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve

Distancat e njësive të përthithura me njësinë e re

Largësia në kohë udhëtimit me qendrën e bashkisë është një tregues vendimtar për të siguruar mundësinë e ndërveprimit të qytetarëve me qeverisjen. Në përgjithësi është e dëshirueshme që qendra e njësive të re të arrihet brenda 1 ore nga njësitet e suprimuara. Siç shikohet nga Figura 90, qendra e Fierit është e arritshme nga qytetarët në më pak se 20 minuta. Vetëm Libofsha dhe Çakrani janë të vendosur në distancë rreth 25 minuta nga qendra e Fierit dhe me infrastrukturë më pak të mirë për të arritur. (Figura 89 dhe Figura 90). Ka disa mënyra për të adresuar këtë problem. Një prej tyre lidhet me nevojën që do të kenë banorët për të arritur në qendrën e ZF-së në të përditshmen e tyre. Në kushtet kur pranë banorëve ekzistojnë shërbimet bazë për të cilat ata kanë nevojë të shkojnë më shpesh, udhëtimi drejt qendrës do të shmanget. Një tjetër mënyrë do të ishte rritja e investimeve dhe përqendrimi i prioriteteve në investime në infrastrukturën fizike dhe transportin që lehtëson këtë akses.

Figura 89 Harta e rrjetit rrugor në ZF Fier Figura 89




Figura 90. Distanca e udhëtimit drejt qendrës së ZF të re




Tabela 36. Distancat e njësive ekzistuese nga qendra e re në ZF Fier

			Sip. në km ²	Popullsia Census 2011	Distanca në km	Koha e udhëtimit (min)
Fier	Cakran	K	22,7	11 722	25	86,3
Fier	Dermenas	K	6,8	7788	8	101,2
Fier	Fier	B	0	55 845	0	
Fier	Frakull	K	13	6820	14	59,1
Fier	Levan	K	10,8	8159	11	70,9
Fier	Libofshë	K	14,8	6149	22	95,3
Fier	Mbrostar	K	4,5	7460	8	50,9
Fier	Portëz	K	4,5	8259	7	23,4
Fier	Qendër (Çlirim)	K	3	4207		45,2
Fier	Topojë	K	12,1	4246	15	98,3
Fier	Zharrez	K	11	5236	16	20,5
Gjithsej			651,1	125 891	9,4	12,6

Treguesit socialë

Bashkimi i njësive në një zonë funksionale mund të ketë efekte pozitive edhe për treguesit socialë dhe arsimorë të zonës. Në veçanti niveli arsimor mesatar përgjithësisht është në përpjesëtim të drejtë me largësinë gjeografike nga qendrat funksionale, të cilat janë dhe qendra të vjetra urbane me një traditë arsimore dhe zhvillim elitash. Po ashtu, mund të bëhet një shpërndarje më e mirë e institucioneve arsimore (kopshte, shkolla) në raport të drejtë me dendësinë e popullsisë.

Niveli arsimor dhe faktori gjeografik

Në përgjithësi, qendrat historike kanë frekuencë të treguesit të nivelit arsimor të lartë më të shpeshtë sesa në zonat rurale. Ky tregues zbehet më rritjen e distancës gjeografike nga qendra historike ku diploma më e lartë është e arsimit të mesëm.

Sigurisht ky tregues duhet parë në krahasim me ofertën arsimore të zonës por edhe me përqendrimin e vendeve më të kualifikuara të punës të cilat gjenden kryesisht pranë qendrave urbane.


Është interesante dhe tradita historike e zhvillimit të qendrave urbane pasi bashkitë që kanë pasur universitete dhe një jetë kulturore më të gjallë reflektojnë dhe nivel arsimor më të lartë të një elite qytetare më të konsoliduar, siç është rasti i qytetit të Fierit.

Ndërkohë që qendrat urbane më të vogla kanë pasur një traditë kryesisht industriale reflektojnë nivel arsimor të lartë në shkallë më të ulët, si p.sh. Patos 6% krahasuar me totalin e popullsisë zonës, ndjekur nga Ballshi e pastaj Lushnja. Në rastin e Lushnjës gjithashtu ka pasur një jetë urbane më aktive se në Ballsh apo në Patos, edhe pse flasim për shifra relativisht të vogla reflektohet dhe në përqendrimin e popullsisë me diploma të arsimit të lartë.

Tradita e përqendrimit të banorëve me arsim të lartë drejt qendrës urbane reflekton gjithashtu segregimin e popullsisë sipas grupeve profesionale, çka ka qenë traditë e sistemit të mëparshëm komunist, tipare që nuk kanë reflektuar ndryshim. Ndërkohë që totali i popullsisë së Fierit për shembull si pasojë e valëve të brendshme migratore.

Në zonën e Fierit, duke përjashtuar vetë Fierin urban, nuk vihet re ndonjë korrelacion i veçantë i distancave gjeografike të njësive me qendrën urbane dhe nivelin arsimor. Niveli mbizotërues është ai i arsimit 9 vjeçar dhe nivelet përkatëse të të gjitha njësive sillen drejt shifrave të njëjta. Nëse merret parasysh vetëm Fieri, raportet e niveleve arsimore kthehen dukshëm në favor të arsimit të mesëm dhe atij të lartë.


Figura 91. Diploma më e lartë për zonën funksionale të Fierit



Një përfundim që mund të nxirret nga kjo analizë e nivelit arsimor e parë nga optika e distancës gjeografike nga qendra urbane është se në ndryshim nga çfarë mund të pasqyrojnë të dhënat për qarkun Tiranë, nuk vërehet ndonjë ndikim i ndjeshëm mes afërsisë gjeografike të banorëve me qendrën dhe nivelin arsimor të lartë. Fakti që ka një përqendrim në të katër rastet të nivelit të arsimit të lartë në zonën urbane dhe më pak e për më tepër në mënyrë të çrregullt në zonat rurale, reflekton kërkesën e tregut të punës dhe mundësitë për zhvillim.

Kategoria e rëndësishme e shërbimeve që ofrohen pjesërisht në nivel vendor e pjesërisht në atë qendror është arsimi. Sot NJQV-të janë përgjegjëse për mirëmbajtjen e infrastrukturave arsimore. Në figurën më poshtë prezantohet pikërisht shpërndarja dhe cilësia e këtyre strukturave. Ajo çfarë tërheq vëmendjen në këtë analizë është se cilësia e dobët e infrastrukturave arsimore lidhet drejtpërdrejtë me gjenerimin e ulët të të ardhurave prej NJQV-ve (kuptohet edhe si rezultat i nivelit të ulët të transfertave). Riorganizimi në NJQV më të madhe – sipas zonës funksionale të propozuar do të çonte në efikasitetet dhe shpërndarje më të mirë të fondeve në dispozicion. Madje duke shkuar më tej dhe duke përdorur si argument kryesor parimin e subsidiaritetit, do të kishte kuptim që edhe pjesë të tjera të funksionit (siç mund të jetë emërimi i stafit dhe drejtuesve, etj.) të jenë përgjegjësi e nivelit vendor të qeverisjes.

Figura 92 Gjendja e objekteve arsimore në ZF Fier




Burimi: Ministria e Arsimit dhe Sportit, Interpretimi dhe paraqitja grafike të autorëve

Institucionet arsimore

Në zonën e Fierit, dimensionin e arsimit si parashkollor dhe atij shkollor na jep një tablo të detajuar të kapacitetit dhe orientimit të sistemit për t'iu ardhur në ndihmë banorëve. Ky kapacitet vlerësohet si për zonat urbane dhe rurale si përgjithësisht i ngjashëm pa ndonjë diferencë të theksuar. Për shembull në zonat rurale të Fierit numri i fëmijëve për edukatorë dhe mësues varion nga 18 – 24 për edukatorë dhe 11 – 16 për shkollat 9 vjeçare. Për qytetin e Fierit shifra qëndron në 19 për edukatorët dhe 17 për mësuesit. Situata pëson një ndryshim të lehtë nga pikëpamja e arsimit të mesëm ku diferencat në disa raste bëhen më të theksuara. Për shembull, komuna Dermenas shënon vetëm 4 nxënës për mësues dhe komuna Topojë raporton 9 nxënës për mësues ndërkohë që të gjitha komunat e tjera shënojnë një raport prej 13 – 21. Ndonëse distanca nuk luan ndonjë rol thelbësor shihet qartë një disproporcion i cili verifikohet edhe nga raporti i shkollave dhe mësuesve për 10 000 banorë.

Figura 93. Raporti mes mësuesve dhe nxënësve me dendësinë e popullsisë për zonën funksionale Fier



Shëndetësia

Tabela 37. Shpërndarja e mjekëve në ZF Fier

		Popullsia	Nr. mjekësh	10 000 banorë
Cakran	K	11 722	6	5,1
Dermenas	K	7788	5	6,4
Fier	B	55 845	131	23,5
Frakull	K	6820	4	5,9
Levan	K	8159	6	7,4
Libofshë	K	6149	4	6,5
Mbrostar	K	7460	4	5,4
Portëz	K	8259	4	4,8
Qendër (Çlirim)	K	4207	4	9,5
Topojë	K	4246	3	7,1
Zharrëz	K	5236	3	5,7
Total		125 891	174	13,8

Shërbimet sociale

Për sa i përket shpërndarjes së shërbimeve sociale trendi i përgjithshëm është që ka një përqendrim në zonat urbane e në qendrat e mëdha urbane, ndërkohë që zonat rurale mbeten të pambuluara me shërbime e banorët duhet të udhëtojnë drejt qendrës urbane më të afërt për të marrë shërbimin.

Argumenti kryesor është që komunat nuk kanë as kapacitete financiare e as ato njerëzore për të ofruar shërbime sociale. Riorganizimi territorial pritet të ndikojë ndjeshëm në ofrimin e drejtë të shërbimeve duke i dhënë një prioritet mbulimit të zonave rurale.

Gjithashtu, vihet re që peshën kryesore të shërbimeve sociale e mbajnë OJQ-të, ndërsa kategoritë e shërbimeve janë të limituara dhe të ndikuara jo detyrimisht nga nevojat e komunitetit të cilit i shërbehet, por nga agjendat e donatorëve që janë dhe mbështetësit kryesorë të tyre.

Tabela 38. Shërbimet sociale në ZF Fier

Zona funksionale Fier		
Institucioni/organizata	Tipologjia e shërbimit	Grup mosha
Shoqata e Invalidëve të Punës	Përkujdes ditor për të moshuarit	Shërbime sociale për të moshuar
Shtëpia e të Moshuarve	Përkujdes rezidencial për të moshuarit	Shërbime sociale për të moshuar
Qendra Sociale "Murialdo"	Qendër ditore për 6-14 vjeç dhe kurse te formimit profesional për moshat 14-25 vjeç.	Shërbime sociale për fëmijë 0-3 vjeç dhe 3-14 vjeç
Shoqata e të verbërve	Kurse kompjuteri dhe trajnime për të verbrit	Shërbime për persona me aftësi të kufizuar
Qendra Rinore "Epoka e Re"	Kurse dhe trajnime, zhvillime aktiviteteve të specifikuar për grupet rinore	Shërbime multidisiplinare për të rinjtë mbi 16 vjeç
Drejtoria e Shërbimeve të Përkujdesjes Shoqërore	Qendër këshillimi për të rinjtë, monitoruese e ofrimit të shërbimeve shoqërore, studime në nivel qarku për shërbime sociale	Shërbime multidisiplinare për familjet me probleme sociale dhe për komunitetin
Qendra ditore "Jeta ime"	Multifunksionale	Shërbime sociale për fëmijë 0-3 vjeç dhe 3-14 vjeç
Njësia për mbrojtjen e fëmijëve - Fier	Shërbime ditore për moshat 6-14 vjeç dhe 0-3 vjeç.	Shërbime sociale për fëmijë 0-3 vjeç dhe 3-14 vjeç
PNUD	Shërbime rezidenciale për moshat 0-3 vjeç, 6-14 vjeç, për të moshuarit dhe PAK	Shërbime sociale për fëmijë 0-3 vjeç dhe 3-14 vjeç
Shoqata e fëmijëve jetimë	Shoqatë për fëmijët jetimë të moshës 0-18 vjeç	Shërbime sociale për fëmijë 0-3 vjeç dhe 3-14 vjeç
Kryqi i Kuq Shqiptar	Shërbime për fëmijët jetimë, projekte për integrimin e fëmijëve në shkolla dhe fëmijët PAK.	Shërbime sociale për fëmijë 0-3 vjeç dhe 3-14 vjeç
Terres des Homes		Shërbime sociale për fëmijë 0-3 vjeç dhe 3-14 vjeç

Përfundime

ZF Fier me popullsi 125 891 banorë nga mesatarisht 11 445 banorë për njësi.

Reduktim i shpenzimeve administrative (paga dhe të tjera operative) me rreth 171 milionë lekë ose 16% e shpenzimeve totale të kryera nga të gjitha njësitë.

Ulje e shpenzimeve të pagave nga 3950 në 2680 lekë për banor në njësinë e re ose nga totali prej 497 milionë në 337 milionë në njësinë e re.

Rritje e buxhetit të investimeve me 74% në vit ose nga 230 milionë në 401 milionë në një vit.

Rritje e investimeve për frymë nga 1827 në 3182 lekë në njësinë e re.

Zona funksionale Lushnjë

Zona Lushnjë (Bashkia Lushnjë, komunat Allkaj, Ballagat, Bubullimë, Dushk, Fier-shegan, Golem, Hysgjokaj, Karbunarë, Kolonjë, Krutje)

Kjo zonë funksionale ka një popullsi prej 83 659 banorësh sipas të dhënave të Censur-it 2011 dhe është e përbërë nga 11 njësi ekzistuese (10 komuna dhe 1 bashki). Kjo zonë ka humbur rreth 18% të popullsisë që nga viti 2001 sipas të dhënave të INSTAT-it. Dendësia mesatare në zonën funksionale është 217 banorë/km² në krahasim me 166 banorë/km² që është vlera mesatare (*median*) e dendësisë në njësitë ekzistuese.

Rrethi i Lushnjës

Rrethi i Fierit ka popullsi të përgjithshme prej rreth 118 mijë banorësh dhe dy qendra urbane kryesore: qyteti i Lushnjës që është qartësisht poli kryesor i zhvillimit ekonomik të rrethit, por edhe qyteti i Divjakës, i cili ndonëse ka një popullsi të vogël (8445 banorë) shërben si qendër për shkak të potencialit të turizmit e si destinacion punësimi për zonat përreth. Për këtë arsye rrethi i Lushnjës është studiuar në dy zona funksionale: zona e Lushnjës, që përfshin bashkinë Lushnjë dhe komunat Allkaj, Ballagat, Bubullimë, Dushk, Fier-shegan, Golem, Hysgjokaj, Karbunarë, Kolonjë dhe Krutje dhe zona e Divjakës, që përfshin bashkinë Divjakë dhe komunat përreth saj të cilat kanë afërsi gjeografike dhe shkëmbime më të shpeshta (Grabian, Gradishtë, Rremas, Tërbuf).

Vështrim i gjendjes ekonomike, financiare dhe administrative

Zhvillimi ekonomik dhe të dhënat ekonomike financiare

Spektori mbizotërues në ekonominë e rajonit të Lushnjës është bujqësia. Ndonëse të dhëna më të detajuara në nivel njësie vendore nuk janë të disponueshme, konfigurimi i zonës funksionale të re sugjeron se me përjashtim të bashkisë Lushnjë pjesa dërrmuese e njësive të reja të përfshira kanë karakter bujqësor.


Kjo hipotezë mbështetet edhe nga të dhënat mbi shpërndarjen e bizneseve në këto zona. Zona funksionale Lushnjë ka 2825 biznese gjithsej nga të cilët 60% janë të vendosur në qytetin e Lushnjës. Mesatarisht 70% e të punësuarve në zonë me përjashtim të qytetit të Lushnjës veprojnë në sektorin e bujqësisë. Punësimi në qytetin e Lushnjës mbizotërohet nga shërbimet (45%), i ndjekur nga tregtia (21%) dhe industria (11%).

Tabela 39 Bizneset për 1000 banorë në ZF Lushnjë

Rrethi	Njësia	B/K	Nr. i bizneseve	Biznese për 1000 banorë
Lushnjë	Allkaj	K	73	17
Lushnjë	Ballagat	K	34	14
Lushnjë	Bubullimë	K	111	20
Lushnjë	Dushk	K	182	23
Lushnjë	Fier Shegan	K	160	23
Lushnjë	Golem	K	117	22
Lushnjë	Hysgjokaj	K	25	10
Lushnjë	Karbunarë	K	49	12
Lushnjë	Kolonjë	K	198	35
Lushnjë	Krutje	K	179	24
Lushnjë	Lushnjë	B	1697	55
Gjithsej zona Fier mbas bashkimit			2825	34

Burimi: INSTAT, llogaritjet e autorëve

Figura 94: Numri i bizneseve për 1000 banorë



Siç shihet nga të dhënat shumica e njësive në zonën funksionale në shqyrtim kanë numër të ulët biznesesh për 1000 banorë. Kujtojmë se kjo është një zonë kryesisht bujqësore me përjashtim të bashkisë Lushnjë. Bizneset për 1000 banorë në njësitë e veçanta variojnë nga 10 (Hysgjokaj) në 55 në Lushnjë. Në zonën funksionale ky tregues rritet në 34 biznese për 1000 banorë.

Të dhëna buxhetore


Të gjitha njësitë e zonës kanë një buxhet (të ardhura) prej rreth 780 milionë lekësh në vitin 2012. Nga këto rreth 40% ose 312 milionë janë realizuar në bashkinë e Lushnjës, e cila realizon edhe 59% të të ardhurave të veta.

Tabela 40 Të dhëna buxhetore për zonën funksionale Lushnjë

	Të ardhura totale	Të ardhura të veta	Shpenzime totale
Allkaj	52 699	9463	18 000
Ballagat	25 499	2980	23 000
Bubullimë	64 042	19 440	34 000
Dushk	37 536	13 061	26 000
Fier Shegan	47 954	9958	25 000
Golem	48 611	11 524	24 000
Hysgjokaj	41 624	1893	6000
Karburnarë	27 003	2515	13 000
Kolonjë	66 184	19 317	30 000
Krutje	56 589	16 924	53 000
Lushnjë	311 697	151 797	324 000
Gjithsej ZF	779 436	258 872	576 000

Po të vërejmë të ardhurat për frymë shohim se mesatarja e të ardhurave të veta për frymë për të gjitha njësitë është 2182 lekë. Pas bashkimit ky tregues rritet në 3094 lekë për frymë për të gjithë zonën funksionale ose 30% më shumë se mesatarja e njërive.


Figura 95 Të ardhurat e veta për frymë në zonën funksionale Fier



Ndërkohë, situata paraqitet disi më ndryshe për treguesit mbi të ardhurat gjithsej të njërive: mesatarja e të ardhurave për frymë në zonën funksionale pëson disi rënie në krahasim me

mesataren e njësive individuale. Kjo shpjegohet me faktin se njësitë më të vogla subvencionohen në masë shumë të madhe nga buxheti i shtetit duke rezultuar në të ardhura të larta për frymë. Gjithashtu, baza për përllogaritjen e transfertave buxhetore është popullsia administrative, e cila raportohet më e lartë se të dhënat nga Census-i.


Figura 96 Të ardhurat për frymë në zonën funksionale Lushnjë



Të dhëna mbi shpenzimet

Po të vërejmë shpenzimet për frymë të dhënat janë të ngjashme:

Figura 97 Shpenzimet për frymë



Shpenzimet për frymë në zonën funksionale Fier do të ishin rreth 6885 lekë pra, rreth 22% më të larta se mesatarja e shpenzimeve për frymë në njësitë ekzistuese ose 34% më e lartë se vlera mesatare (*median*) e shpenzimeve për frymë.

Tabela 41 Të ardhurat dhe shpenzimet për frymë në zonën funksionale Fier

	Të ardhura për frymë	Të ardhurat e veta për frymë	Shpenzime për frymë
Allkaj	12 202	2191	4168
Ballagat	10 361	1211	9346
Bubullimë	11 543	3504	6128
Dushk	4768	1659	3303
Fier Shegan	6828	1418	3560
Golem	9272	2198	4578
Hysgjokaj	15 991	727	2305
Karbunarë	6440	600	3100
Kolonjë	11 554	3372	5237
Krutje	7481	2237	7007
Lushnjë	10 021	4880	10 416
ZF gjithsej	9317	3094	6885


Njësitë shpenzojnë mesatarisht 45% të buxhetit për shpenzime administrative, minimumi përfaqësohet nga komuna Ballagat (22%) dhe maksimumi nga komuna Dushk me 73%. Treguesi i shpenzimeve administrative për zonën ulet në 31% duke marrë parasysh kursimet e parashikuara të cilat do të trajtohen më poshtë, ndërkohë që pesha e investimeve rritet nga 16% në 31%.

Tabela 42 Struktura e shpenzimeve në zonën funksionale Fier

	Shpenzime totale	Shpenzime personel	Shpenzime operative të tjera	Investime 2012	Shp. personel si % e totalit	Operative të tjera si % e totalit	Inv. si % e totalit 2012
Allkaj	18 000	7000	4000	7000	39%	22%	39%
Ballagat	23 000	5000	6000	12 000	22%	26%	52%
Bubullimë	34 000	13 000	6000	15 000	38%	18%	44%
Dushk	26 000	19 000	7000	0	73%	27%	0%
Fier Shegan	25 000	12 000	5000	8000	48%	20%	32%
Golem	24 000	10 000	6000	8000	42%	25%	33%
Hysgjokaj	6000	4000	2000	0	67%	33%	0%
Karbunarë	13 000	8000	3000	2000	62%	23%	15%
Kolonjë	30 000	13 000	7000	10 000	43%	23%	33%
Krutje	53 000	23 000	15 000	15 000	43%	28%	28%
Lushnjë	324 000	145 000	166 000	13 000	45%	51%	4%
Mesatare	576 000	259 000	227 000	90 000	45%	39%	16%
Gjithsej ZF Fier	576 000	179 200	220 900	175 900	31%	38%	31%

*Të dhënat për ZF Lushnjë janë nxjerrë me supozimin se do të reduktohen rreth 70% e shpenzimeve administrative dhe 10% e shpenzimeve të tjera operative të njërive që suprimohen.

Figura 98 Struktura e shpenzimeve në zonën funksionale krahasuar me mesataren e njësjive ekzistuese




Treguesit e investimeve

Treguesit e investimeve vrojtohen më mirë në një periudhë të gjatë kohore. Në këtë rast janë shqyrtuar të dhënat për pesë vjet, të cilat tregojnë se niveli i investimeve në këtë zonë ka qenë mesatarisht më i lartë se ai kombëtar. Në veçanti në qytetin e Fierit në këto pesë vjet janë investuar 47% e të ardhurave totale. Po të supozojmë se ritmi i investimeve do të ishte ulur në masën e reduktimit nga shpenzimet administrative, pesha e investimeve ndaj buxhetit total të zonës funksionale do të rritej në 58% nga 45% mesatarisht.

Figura 99 Investimet si përqindje e buxhetit total në zonën funksionale dhe njësitë ekzistuese

	Investime 2008 - 2012	Të ardhura 2008 - 2012	Inv. si % e ardh. totale 2008 - 2012
Allkaj	98 161	193 925	51%
Ballagat	74 478	110 521	67%
Bubullimë	151 482	261 259	58%
Dushk	102 596	317 323	32%
Fier Shegan	107 912	257 940	42%
Golem	108 134	297 567	36%
Hysgjokaj	55 517	155 290	36%
Karburnarë	55 518	182 712	30%
Kolonjë	145 501	383 642	38%
Krutje	179 513	359 913	50%
Lushnjë	1 111 494	2 376 683	47%
Mesatare	2 190 308	4 896 774	45%
Zona funksionale	2 847 400	4 896 774	58%

Figura 100 Treguesit e investimeve për frymë në zonën funksionale (2008 – 2012, lek)



Analiza e efekteve administrative

Bashkimi i njësive në një zonë funksionale do të rezultojë në kursime veçanërisht nga shpenzimet e personelit dhe një pjesë të shpenzimeve operative për mirëmbajtjen e zyrave. Në veçanti, në dhjetë nga njëmbëdhjetë njësitë e zonës funksionale do të shkurtohen pozicionet e kryetarit dhe të kabinetit të tij dhe shpenzimet për shpërblimet e këshilltarëve. Gjithashtu, shkurtime të mëtejshme do të realizohen nga realizimi i asaj që rëndom quhet si *economy of scope*, më konkretisht shkurtimi i funksioneve të përsëritura administrative të cilat do të përqendrohen në njësinë administrative të zonës funksionale. Të tilla pozicione janë sektori i menaxhimit financiar (specialistët e financës dhe buxhetit), sektori i prokurimeve dhe sektori i auditivit financiar, por edhe sektori i urbanistikës. Një llogari paraprake e reduktimit të mundshëm sugjeron se nga bashkimi mund të kursehen rreth 60% - 70% e kostove të personelit dhe rreth 10% e shpenzimeve të mirëmbajtjes së zyrave. Përlllogaritjet e mëposhtme janë bazuar mbi këtë model.

Tabela 43 Kursimet nga shpenzimet e personelit dhe të mirëmbajtjes

	Reduktimi nga personeli (60%)	Reduktimi nga zyrat (10%)
Allkaj	4900	400
Ballagat	3500	600
Bubullimë	9100	600
Dushk	13 300	700
Fier Shegan	8400	500
Golem	7000	600
Hysgjokaj	2800	200
Karbunarë	5600	300
Kolonjë	9100	700
Krutje	16 100	1500
Lushnjë		
Gjithsej	79 800	6100
Reduktimi si % e zërit përkatës	31%	3%
Reduktimi si % e shpenzimeve totale	14%	1%

Me supozimet e bëra në zonën funksionale Fier pas bashkimit kursehen rreth 86 milionë lekë ose 15% e shpenzimeve totale të kryera nga të gjitha njësitë. Këto fonde të çliruara janë të përafërta me fondet e alokuara për investime në këtë zonë çka do të thotë se me ***këto kursime në teori dyfishohen investimet për zonën.***

Distanca e njërive të përthithura me qendrën/njësinë e re

Largësia në kohë udhëtimit me qendrën e bashkisë është një tregues vendimtar për të siguruar mundësinë e ndërveprimit të qytetarëve me qeverisjen. Në përgjithësi, është e dëshirueshme që qendra e njësisë së re të arrihet brenda 1 ore nga njësitë e suprimuara. Vlen të theksohen edhe rastet kur koha e udhëtimit për në qendrën e njësisë së re është më shumë se 1 orë me mjetet e transportit publik. Figura 102 tregon se qyteti i Lushnjës është i aksesueshëm në më pak se 21 minuta nga të gjitha qendrat ekzistuese të komunave që do të përbëjnë ZF Lushnjë.

Figura 101 Harta e infrastrukturës rrugore në ZF Lushnjë




Figura 102 Distancat kohore nga qendra Lushnjë




Tabela 44 Distanca e njësive ekzistuese nga qendra e re

			Sip. në km ²	Popullsia Census 2011	Distanca në km	Koha e udhëtimit (min)
Lushnjë	Allkaj	K	16,7	4319	15	16,7
Lushnjë	Ballagat	K	24,3	2461	11	24,3
Lushnjë	Bubullimë	B	42,5	5548	17	42,5
Lushnjë	Dushk	K	44,2	7872	21	44,2
Lushnjë	Fier Shegan	K	27,4	7023	11	27,4
Lushnjë	Golem	K	27,1	5243	4	27,1
Lushnjë	Hysgjokaj	K	18,1	2603	15	18,1
Lushnjë	Karbunarë	K	58,6	4193	3	58,6
Lushnjë	Kolonjë	K	29,7	5728	17	29,7
Lushnjë	Krutje	K	55,6	7564	11	55,6
Lushnjë	Lushnjë	K	41	31 105	0	0
Gjithsej			385	83 659	12	16

Treguesit socialë

Bashkimi i njërive në një zonë funksionale mund të ketë efekte pozitive edhe për treguesit socialë dhe arsimorë të zonës. Në veçanti, niveli arsimor mesatar përgjithësisht është në përpjesëtim të drejtë me largësinë gjeografike nga qendrat funksionale, të cilat janë dhe qendra të vjetra urbane me një traditë arsimore dhe zhvillim elitash. Po ashtu, mund të bëhet një shpërndarje më e mirë e institucioneve arsimore (kopshte, shkolla) në raport të drejtë me dendësinë e popullsisë.

Niveli arsimor dhe faktori gjeografik

Në përgjithësi, qendrat historike kanë frekuencë të treguesit të nivelit arsimor të lartë më të shpeshtë sesa në zonat rurale. Ky tregues zbehet me rritjen e distancës gjeografike nga qendra historike ku diploma më e lartë është e arsimit të mesëm.

Sigurisht ky tregues duhet parë dhe në krahasim me ofertën arsimore të zonës por dhe me përqendrimin e vendeve më të kualifikuara të punës të cilat gjenden kryesisht pranë qendrave urbane.


Është interesante dhe tradita historike e zhvillimit të qendrave urbane pasi bashkitë që kanë pasur universitete dhe një jetë kulturore më të gjallë reflektojnë dhe nivel arsimor më të lartë e një elite qytetare më të konsoliduar siç është rasti i qytetit të Fierit.

Ndërkohë që qendrat urbane më të vogla që kanë pasur një traditë kryesisht industriale reflektojnë nivel arsimor të lartë në shkallë më të ulët, si p.sh. Patos 6% krahasuar me totalin e popullsisë së zonës, ndjekur nga Ballshi e pastaj Lushnja. Në rastin e Lushnjës gjithashtu ka pasur një jetë urbane më aktive se Ballshi apo Patosi; edhe pse flasim për shifra relativisht të vogla, kjo reflektohet edhe në përqendrimin e popullsisë me diploma të arsimit të lartë.

Tradita e përqendrimin të banorëve me arsim të lartë drejt qendrës urbane reflekton gjithashtu segregimin e popullsisë sipas grupeve profesionale çka ka qenë traditë e sistemit të mëparshëm komunist, tipare që nuk kanë reflektuar ndryshim.

Në zonën e Lushnjës nga ana tjetër, ndonëse distanca duket të ketë pak rëndësi, situata duket disi më e çrregullt për të tre nivelet e arsimit. Veçanti përbën përsëri, zona urbane e Lushnjës në të cilën vihet re një prezencë më e madhe e arsimit të lartë dhe atij të mesëm.

Figura 103 Diploma më e lartë për zonën funksionale të Lushnjës dhe Divjakës



Një përfundim që mund të nxirret nga kjo analizë e nivelit arsimor e parë nga optika e distancës gjeografike nga qendra urbane është se në ndryshim nga çfarë mund të pasqyrojnë të dhënat për qarkun, nuk vërehet ndonjë ndikim i ndjeshëm mes afërsisë gjeografike të banorëve me qendrën dhe nivelin arsimor të lartë. Fakti që ka një përqendrim në të katër rastet të nivelit të arsimit të lartë në zonën urbane dhe më pak e për më tepër në mënyrë të çrregullt në zonat rurale, reflekton kërkesën e tregut të punës dhe mundësitë për zhvillim.

Institucionet arsimore


Arsimi është një nga shërbimet thelbësore, i cili menaxhohet në mënyrë të përbashkët nga qeverisja qendrore dhe ajo vendore. Në mënyrë të veçantë, njësitë vendore kanë përgjegjësinë për mirëmbajtjen dhe investimin në objektet fizike të arsimit parashkollor dhe para universitar. Figura 104 tregon se gjendja e objekteve shkollore në zonën funksionale Lushnjë lë shumë për të dëshiruar, me përjashtimin e bashkive Lushnjë dhe komunës Golem, pjesa tjetër e njësive përbërëse të zonës funksionale kanë infrastrukturë mjaft të vjetërsuar arsimi. Bashkimi në një zonë funksionale të vetme do të mund të krijonte parakushtet për menaxhimin më efikas të mirëmbajtjes së shkollave, ndërhyrjes me investime falë fondeve të çliruara nga reduktimi i shpenzimeve administrative, si dhe prioritizimin e sektorit sipas nevojave të komuniteteve. Në përputhje me parimin e subsidiaritetit dhe bazuar në hipotezën se bashkimi në një zonë funksionale do të rezultojë në kapacitete më të mira menaxhimi të administratës bashkiake, do të ishte frytdhënëse që njësitë vendore të kishin më shumë zë edhe në administrimin e personelit dhe stafit arsimor të shkollave.

Figura 104 Gjendja e institucioneve arsimore në ZF Lushnjë

Bashkia LUSHNJE
ARSIMI




MINISTRIA E ÇËSHTJEVE VENDORE
REPUBLIKA E SHQIPËRISË



Në zonën e Lushnjës dimensionimi i arsimit si parashkollor dhe ai shkollor na jep një tablo të detajuar të kapacitetit dhe orientimit të sistemit për t'u ardhur në ndihmë banorëve. Ky kapacitet vlerësohet si për zonat urbane dhe rurale si përgjithësisht i ngjashëm pa ndonjë diferencë të theksuar. Në Lushnjë kemi 17 fëmijë për edukatorë ndërsa në rrethina shifra varion nga 21 në Rrembas deri në 26 në Dushk. Për sa i përket numrit të nxënësve për mësues situata paraqitet e ngjashme e varion nga 12,9 – 19,5. Diferencimet dalin në pah edhe për shkollat e mesme ku grupi i nxënësve për mësues varion nga 16 – 30.

Ndonëse distanca nuk luan ndonjë rol thelbësor shihet qartë një disproporcion, i cili verifikohet edhe nga raporti i shkollave dhe mësuesve për 10 000 banorë.

Figura 105 Raporti mes mësuesve dhe nxënësve me dendësinë e popullsisë për zonën funksionale Fier



Spitalet dhe poliklinikat

Tabela 45 Shpërndarja e mjekëve në ZF Lushnjë

		Popullsia	Nr. mjekësh	10 000 banorë
Allkaj	K	4319	2	4,6
Ballagat	K	2461	1	4,1
Bubullimë	K	5548	3	5,4
Dushk	K	7872	4	5,1
Fier Shegan	K	7023	3	4,3
Golem	K	5243	2	3,8
Hysgjokaj	K	2603	1	3,8
Karbunarë	K	4193	2	4,8
Kolonjë	K	5728	14	24,4
Krutje	K	7564	3	4,0
Lushnjë	B	31 105	76	24,4
Total		83 659	111	13,3

Shërbimet sociale

Për sa i përket shpërndarjes së shërbimeve sociale, trendi i përgjithshëm është që ka një përqendrim në zonat urbane dhe në qendrat e mëdha urbane, ndërkohë që zonat rurale mbeten të pambuluara me shërbime e banorët duhet të udhëtojnë drejt qendrës urbane më të afërt për të marrë shërbimin.

Argumenti kryesor është që komunat nuk kanë as kapacitete financiare e as ato njerëzore për të ofruar shërbime sociale. Riorganizimi territorial pritet të ndikojë ndjeshëm në ofrimin e drejtë të shërbimeve duke i dhënë një prioritet mbulimit të zonave rurale.

Gjithashtu, vihet re që peshën kryesore të shërbimeve sociale e mbajnë OJQ-të, ndërsa kategoritë e shërbimeve janë të limituara dhe të ndikuara jo detyrimisht nga nevojat e komunitetit të cilit i shërbehet, por nga agjendat e donatorëve që janë dhe mbështetësit kryesor të tyre.

Tabela 46 Shërbimet sociale në qendrën funksionale Lushnjë

Zona funksionale Lushnjë	
Tipologjia e shërbimit	Grup mosha
Dhuna në familje	Shërbime sociale për gra dhe vajza
Shërbime ditore për moshat 0-3 vjeç dhe 6-14 vjeç si dhe Qendër këshillimi për familjarët	Shërbime sociale për fëmijë 0-3 vjeç dhe 3-14 vjeç
Kurse kompjuterike, kualifikimi, të ndihmës së parë, si dhe shërbime urgjence	Shërbime multidisiplinare për familjet me probleme sociale dhe për komunitetin

Përfundime

ZF Lushnjë me popullsi 83 659 banorë nga mesatarisht 7605 banorë për njësi.

Reduktim i shpenzimeve administrative (paga dhe të tjera operative) me rreth 86 milionë lekë ose 15% e shpenzimeve totale të kryera nga të gjitha njësitë.

Ulje e shpenzimeve të pagave nga 259 milionë në 179 milionë lekë në vit. Shpenzimet e personelit për frymë do të ulëshin nga 3096 lekë në 2142 lekë për banor në njësinë e re.

Rritje e buxhetit të investimeve pothuaj dyfish nga 90 milionë në vit në 176 milionë lekë në vit.

Rritje e investimeve për frymë nga 1076 lekë në 2103 lekë çdo vit në njësinë e re.

Zona funksionale Patos

Zona Patos (bashkia Patos, Roskovec, komunat Ruzhdie, Strumë, Kuman, Kurjan)

Kjo zonë funksionale ka një popullsi prej 39 465 banorësh sipas të dhënave të Censur-it 2011 dhe është e përbërë nga 6 njësi ekzistuese (4 komuna dhe 2 bashki). Zona e Patosit ka pasur një humbje populsi prej rreth 23% që prej vitit 2001. Dendësia mesatare në zonën funksionale është 247 banorë/km², ndërkohë që dendësia në Patos dhe Roskovec është përkatësisht 544 dhe 347 banorë/ km².

Vështrim i gjendjes ekonomike, financiare dhe administrative

Zhvillimi ekonomik dhe të dhënat ekonomike financiare

Sektorët mbizotërues në ekonominë e rajonit të Patosit janë industria, tregtia dhe shërbimet. Ndonëse të dhëna më të detajuara në nivel njësie vendore nuk janë të disponueshme, konfigurimi i zonës funksionale të re sugjeron se kjo zonë do të ketë karakter të kombinuar industrial (Patos, Roskovec, Kuman) dhe bujqësor. Pjesa më e madhe e të punësuarve në zonë përveç Patosit veprojnë në sektorin e bujqësisë, përfshirë edhe bashkinë Roskovec (34%). Në komunën Kuman rreth 25% janë të punësuar në industri dhe 32% në bujqësi.


Tabela 47 Shpërndarja e bizneseve në ZF Patos

Rrethi	Njësia	B/K	Nr. i bizneseve	Biznese për 1000 banorë
Fier	Kuman	K	79	14
Fier	Kurjan	K	25	7
Fier	Patos	B	474	31
Fier	Roskovec	B	236	47
Fier	Ruzhdie	K	13	6
Fier	Strumë	K	111	15
Gjithsej zona Patos para bashkimit			938	20
Gjithsej zona Patos mbas bashkimit			938	24

Burimi: INSTAT

Kjo hipotezë mbështetet edhe nga të dhënat mbi shpërndarjen e bizneseve në këto zona. Zona funksionale Patos ka gjithsej 938 biznese, nga të cilët vetëm 38 janë të vendosur në Ruzhdie e Kurjan. Mesatarisht 35% e të punësuarve në Patos veprojnë në sektorin e industrisë, ndërkohë që 19% punojnë në tregti dhe shërbime. Punësimi në Ruzhdie mbizotërohet nga bujqësia (56%).

Figura 106 Numri i bizneseve për 1000 banorë



Burimi: INSTAT

Siç shihet nga të dhënat, shumica e njësive në zonën funksionale në shqyrtim kanë numër të ulët biznesesh për 1000 banorë. Kujtojmë se kjo është një zonë kryesisht bujqësore. Bizneset për 1000 banorë në njësitë e veçanta variojnë nga 6 (Ruzhdie), në 47 në Roskovec. Zona funksionale ka 24 biznese për 1000 banorë.

Të dhëna buxhetore


Të gjitha njësitë e zonës kanë një buxhet (të ardhura) prej rreth 630 milionë lekësh në vitin 2012. Nga këto rreth 30% ose 193 milionë janë realizuar në komunën Kurjan e cila ka një buxhet mbi dyfish më të madh se bashkia Roskovec dhe rreth 20% më të madh se bashkia Patos. Komuna Kurjan gjithashtu realizon 55% të të ardhurave të veta në zonën funksionale, ndërsa bashkia Patos realizon 27% të të ardhurave të veta. (Tabela 48).

Tabela 48 Të dhëna buxhetore për zonën funksionale Patos

	Të ardhura totale	Të ardhura të veta	Shpenzime totale
Kuman	192 648	133 079	108 000
Kurjan	48 264	5850	15 000
Patos	170 840	65 843	254 000
Roskovec	92 380	32 719	59 000
Ruzhdie	40 760	644	6000
Strumë	85 723	5833	19 000
Gjithsej ZF Patos	630 615	243 968	461 000

Po të vërejmë të ardhurat për frymë, shohim se mesatarja e të ardhurave të veta për frymë është disa herë më e lartë në Kuman në krahasim me Patosin dhe Roskovecin, ndërkohë që njësitë e tjera kanë të ardhura mjaft të ulëta për frymë. Pas bashkimit ky tregues rezulton në rreth 6182 lekë për frymë për të gjithë zonën funksionale, një vlerë shumë pranë mesatares së njësive ekzistuese, por mbi dyfish më e lartë se mesatarja (*median*) i të ardhurave për frymë aktuale. (Figura 107).


Figura 107 Të ardhurat e veta për frymë në zonën funksionale Patos



Burimi: Ministria e Financave, llogaritjet e autorëve

Ndërkohë situata paraqitet disi më ndryshe për treguesit mbi të ardhurat gjithsej të njëjësive. Është e qartë nga të dhënat që komuna Ruzhdie, ndonëse ka një buxhet shumë të vogël, ka të ardhura shumë më të larta për frymë se vetë Patosi. Kjo shpjegohet me faktin se njësitë më të vogla subvencionohen në masë shumë të madhe nga buxheti i shtetit duke rezultuar në të ardhura të larta për frymë. **(Error! Reference source not found.)**


Figura 108 Të ardhurat për frymë në zonën funksionale Patos



Të dhëna mbi shpenzimet

Po të vërejmë shpenzimet për frymë të dhënat janë të ngjashme:

Figura 109 Shpenzimet për frymë në zonën funksionale Patos



Shpenzimet për frymë në zonën funksionale Patos do të ishin rreth 11 6781 lekë pra, rreth 45% më të larta se vlera mesatare (*median*) e shpenzimeve për frymë në njësitë ekzistuese duke siguruar një shpërndarje më të barabartë të shpenzimeve për popullsinë.

Tabela 49 Të ardhurat dhe shpenzimet për frymë në zonën funksionale Patos

	Të ardhura për frymë	Të ardhurat e veta për frymë	Shpenzime për frymë
Kuman	34 334	23 718	19 248
Kurjan	13 340	1617	4146
Patos	11 096	4276	16 497
Roskovec	18 569	6577	11 859
Ruzhdie	17 524	277	2580
Strumë	11 372	774	2521
ZF gjithsej	15 979	6182	11 681


Njësitë shpenzojnë mesatarisht 38% të buxhetit për shpenzime administrative, por kjo peshë është më e lartë në komunën Strumë ku shpenzimet e personelit përbëjnë 68% të shpenzimeve. Treguesi i shpenzimeve administrative për zonën ulet në 26%, duke marrë parasysh kursimet e parashikuara të cilat do të trajtohen më poshtë. Përfitime të drejtpërdrejta edhe më të rëndësishme do të lindin nga shpërndarja më e drejtë e të ardhurave dhe shpenzimeve për frymë.

Tabela 50 Struktura e shpenzimeve në zonën funksionale Patos

	Shpenzim e totale	Shpenzime personel	Shpenzime operative të tjera	Investime 2012	Shp. personel si % e totalit	Operative të tjera si % e totalit	Inv. si % e totalit 2012
Kuman	108 000	29 000	23 000	56 000	27%	21%	52%
Kurjan	15 000	5000	3000	7000	33%	20%	47%
Patos	254 000	99 000	78 000	77 000	39%	31%	30%
Roskovec	59 000	27 000	11 000	21 000	46%	19%	36%
Ruzhdie	6000	3000	3000	-	50%	50%	0%
Strumë	19 000	13 000	4000	2000	68%	21%	11%
Mesatare	461 000	176 000	122 000	163 000	38%	26%	35%
Gjithsej ZF Patos*	461 000	122 100	117 600	221 300	26%	26%	48%

*Të dhënat për ZF Patos janë nxjerrë me supozimin se do të kursehet rreth 70% e shpenzimeve administrative dhe 10% e shpenzimeve të tjera operative të njësisë që suprimohet.

Figura 110 Struktura e shpenzimeve në zonën funksionale Patos krahasuar me mesataren e njësive ekzistuese




Treguesit e investimeve

Treguesit e investimeve vrojtohen më mirë në një periudhë të gjatë kohore. Në këtë rast janë shqyrtuar të dhënat për pesë vjet, të cilat tregojnë se niveli i investimeve në këtë zonë ka qenë relativisht i ulët. Në veçanti në qytetin e Patosit në këto pesë vjet janë investuar vetëm 12% e të ardhurave totale që mund të jetë një tregues i vështirësive financiare të këtyre viteve. Treguesit më të mirë të investimeve i ka komuna Ruzhdie (36% e të hyrave totale) të financuara në pjesën dërrmuese nga të ardhurat e buxhetit të shtetit. Po të supozojmë se ritmi i investimeve do të ishte ulur në masën e reduktimit nga shpenzimet administrative, pesha e investimeve ndaj buxhetit total të zonës funksionale do të rritej në 25% nga 18% mesatarisht. Gjithashtu, bashkimi në zonë funksionale do të siguronte një shpërndarje më efikase të investimeve.

Tabela 51 Investimet si përqindje e buxhetit total në zonën funksionale dhe njësitë ekzistuese

	Investime 2008 - 2012	Të ardhura 2008 - 2012	Inv. si % e ardh totale 2008 - 2012
Kuman	198 679	560 050	35%
Kurjan	29 758	265 707	11%
Patos	184 121	1 514 760	12%
Roskovec	82 093	379 566	22%
Ruzhdie	53 259	146 176	36%
Strumë	47 121	401 175	12%
Mesatare	595 031	3 267 435	18%
Zona funksionale	807 855	3 267 435	25%

Figura 111 Investimet për frymë ne zonën funksionale Patos 2008 – 2012



Analiza e efekteve administrative

Bashkimi i njësive në një zonë funksionale do të rezultojë në kursime veçanërisht nga shpenzimet e personelit dhe një pjesë të shpenzimeve operative për mirëmbajtjen e zyrave. Në veçanti, në dhjetë nga njëmbëdhjetë njësitë e zonës funksionale do të shkurtohen pozicionet e kryetarit dhe të kabinetit të tij dhe shpenzimet për shpërblimet e këshilltarëve. Gjithashtu, shkurtime të mëtejshme do të realizohen nga realizimi i asaj që rëndom quhet si *economy of scope*, më konkretisht shkurtimi i funksioneve të përsëritura administrative të cilat do të përqendrohen në njësinë administrative të zonës funksionale. Të tilla pozicione janë sektori i menaxhimit financiar (specialistët e financës dhe buxhetit), sektori i prokurimeve dhe sektori i auditivit financiar, por edhe sektori i urbanistikës. Një llogari paraprake e reduktimit të mundshëm sugjeron se nga bashkimi mund të kursehen rreth 60% - 70% e kostove të personelit dhe rreth 10% e shpenzimeve të mirëmbajtjes së zyrave. Përlllogaritjet e mëposhtme janë bazuar mbi këtë model.

Tabela 52 Reduktimi i kostove të personelit dhe të mirëmbajtjes

	Reduktimi nga personeli (70%)	Reduktimi nga zyrat (10%)
Kuman	20 300	2300
Kurjan	3500	300
Patos		
Roskovec	18 900	1100
Ruzhdie	2100	300
Strumë	9100	400
Gjithsej ZF Patos	53 900	4400
Reduktimi si % e zërit përkatës	31%	4%
Reduktimi si % e shpenzimeve totale	12%	1%

Me supozimet e bëra në zonën funksionale Patos pas bashkimit kursehen rreth 58 milionë lekë ose rreth 13% shpenzimeve totale të kryera nga të gjitha njësitë. Në rast se këto fonde të kursyera nga shpenzimet administrative do të akordoheshin për investime, në zonën funksionale Patos do të ishin investuar mbi 30% më shumë fonde në vitin 2012. Gjithashtu, bashkimi në zonë funksionale mund të ketë përfitime në shpërndarjen më efikase të shpenzimeve e në veçanti investimeve.

Treguesit socialë

Bashkimi i njërive në një zonë funksionale mund të ketë efekte pozitive edhe për treguesit socialë dhe arsimorë të zonës. Në veçanti, niveli arsimor mesatar përgjithësisht është në përpjesëtim të drejtë me largësinë gjeografike nga qendrat funksionale, të cilat janë dhe qendra të vjetra urbane me një traditë arsimore dhe zhvillim elitash. Po ashtu, mund të bëhet një shpërndarje më e mirë e institucioneve arsimore (kopshte, shkolla) në raport të drejtë me dendësinë e popullsisë.

Niveli arsimor dhe faktori gjeografik

Në përgjithësi, qendrat historike kanë frekuencë të treguesit të nivelit arsimor të lartë më të shpeshtë sesa në zonat rurale. Ky tregues zbehet më rritjen e distancës gjeografike nga qendra historike ku diploma më e lartë është e arsimit të mesëm.

Sigurisht ky tregues duhet parë dhe në krahasim me ofertën arsimore të zonës por dhe me përqendrimin e vendeve më të kualifikuara të punës të cilat gjenden kryesisht pranë qendrave urbane.


Është interesante dhe tradita historike e zhvillimit të qendrave urbane pasi bashkitë që kanë pasur universitete dhe një jetë kulturore më të gjallë reflektojnë dhe nivel arsimor më të lartë dhe një elite qytetare më të konsoliduar siç është rasti i qytetit të Fierit.

Ndërkohë që qendrat urbane më të vogla kanë pasur një traditë kryesisht industriale reflektojnë nivel arsimor të lartë në shkallë më të ulët si p.sh. Patos 6% krahasuar me totalin e popullsisë së zonës ndjekur nga Ballshi e pastaj Lushnja. Në rastin e Lushnjës gjithashtu ka pasur një jetë urbane më aktive se në Ballsh apo Patos, edhe pse flasim për shifra relativisht të vogla, reflektohet dhe në përqendrimin e popullsisë me diploma të arsimit të lartë.

Tradita e përqendrimit të banorëve me arsim të lartë drejt qendrës urbane reflekton gjithashtu segregimin e popullsisë sipas grupeve profesionale, çka ka qenë traditë e sistemit të mëparshëm komunist, tipare që nuk kanë reflektuar ndryshim. Ndërkohë që totali i popullsisë së Fierit për shembull si pasojë e valëve të brendshme migratore.

Në zonën e Patosit, mbizotërimi i nivelit 9 vjeçar është i theksuar dhe niveli i arsimit të lartë është tejet i kufizuar.

Figura 112 Diploma më e lartë për zonën funksionale të Patosit dhe Roskovecit



Një përfundim që mund të nxirret nga kjo analizë e nivelit arsimor e parë nga optika e distancës gjeografike nga qendra urbane është se në ndryshim nga çfarë mund të pasqyrojnë të dhënat për qarkun nuk vërehet ndonjë ndikim i ndjeshëm mes afërsisë gjeografike të banorëve me qendrën dhe nivelin arsimor të lartë. Fakti që ka një përqendrim në të katër rastet të nivelit të arsimit të lartë në zonën urbane dhe më pak e për më tepër në mënyrë të çrregullt në zonat rurale, reflekton kërkesën e tregut të punës dhe mundësitë për zhvillim.

Institucionet arsimore

Dimensioni i arsimit si parashkollor dhe atij shkollor na jep një tablo të detajuar të kapacitetit dhe orientimit të sistemit për t'iu ardhur në ndihmë banorëve. Ky kapacitet vlerësohet si për zonat urbane dhe rurale si përgjithësisht i ngjashëm pa ndonjë diferencë të theksuar. Situata paraqitet e njëjtë – mbase me një diferencim më të theksuar në zonën e Patosit. Numri i nxënësve për mësues në shkollën 9 vjeçare është më i ulët në Ruzhdië (13) se në Patos. Përsëri, distanca nuk luan ndonjë rol kryesor në mbulimin e realizuar nga sistemi arsimor.

Figura 113 Raporti i mësuesve dhe nxënësve me dendësinë e popullsisë për zonën funksionale Patos dhe Roskovec





Figura 114 Shpërndarja dhe gjendja fizike e infrastrukturës arsimore në ZF Patos



Shëndetësia

Raporti i mjekëve për 10 000 banorë në zonën funksionale është si më poshtë:

Tabela 53 Shpërndarja e mjekëve në ZF Patos

Patos		Popullsia	Nr. mjekësh	10 000 banorë
Kuman	K	5611	3	0,9
Kurjan	K	3618	2	5,5
Patos	B	15 397	12	7,8
Roskovec	B	4975	3	6,0
Ruzhdie	K	2326	1	4,3
Strumë	K	7538	3	4,0
Total		39 465	24	4,8

Shërbimet sociale

Për sa i përket shpërndarjes së shërbimeve sociale trendi i përgjithshëm është që ka një përqendrim në zonat urbane dhe në qendrat e mëdha urbane, ndërkohë që zonat rurale mbeten të pambuluara me shërbime dhe banorët duhet të udhëtojnë drejt qendrës urbane më të afërt për të marrë shërbimin.

Argumenti kryesor është që komunat nuk kanë as kapacitete financiare dhe as ato njerëzore për të ofruar shërbime sociale. Riorganizimi territorial pritet të ndikojë ndjeshëm në ofrimin e drejtë të shërbimeve duke i dhënë një prioritet mbulimit të zonave rurale.


Gjithashtu, vihet re që peshën kryesore të shërbimeve sociale e mbajnë OJQ-të, ndërsa kategoritë e shërbimeve janë të limituara dhe të ndikuara jo detyrimisht nga nevojat e komunitetit të cilit i shërbehet, por nga agjendat e donatorëve që janë dhe mbështetësit kryesor të tyre.

Në zonën funksionale Patos nuk ka shërbime sociale. Shërbimet më të afërta janë të vendosura në bashkinë e Fierit.

Distanca e njësive të përthithura me qendrën/njësinë e re

Largësia mesatare në kohë udhëtimi me qendrën e njësisë së re është 34 minuta, çka mund të ndihmojë në sigurimin e mundësisë së ndërveprimit të qytetarëve me qeverisjen. Figura 115 tregon se shumica e banorëve mund ta arrijnë qendrën e Patosit brenda 20 minutash.

Figura 115 Distancat kohore drejt qendrës Patos



Infrastruktura e transportit në ZF Patos është mjaft e mirë përfshirë të paktën dy akse kombëtare (rugë të kategorisë së parë), si edhe akses në rrjetin hekurudhor. Infrastruktura e brendshme e rrugëve mund të ketë nevojë për përmirësim në veçanti në zonat e Kumanit dhe Kurjanit.



Përfundime

ZF Patos me popullsi 39 465 banorë nga mesatarisht 6578 banorë për njësi.

Reduktim i shpenzimeve administrative (paga dhe të tjera operative) me rreth 58 milionë lekë ose 13% e shpenzimeve totale të kryera nga të gjitha njësitë.

Ulje e shpenzimeve të pagave nga 4460 në 3094 lekë për banor në njësinë e re (nga 176 milionë në 122 milionë në vit)

Rritje e buxhetit të investimeve nga 163 milionë lekë në vit në 221 milionë lekë në vit ose 36% rritje të buxhetit vjetor për investime.

Rritje e investimeve për frymë nga 4130 lekë në 5608 lekë në njësinë e re.

Përfundimet e mëposhtme janë llogaritur për ZF Roskovec si njësi funksionale që qëndron më vete jashtë ZF Patos.

1. ZF Roskovec (Bashkia Roskovec dhe komunat Strumë, Kuman, Kurjan)

ZF Roskovec e përbërë nga 4 njësi ekzistuese, ka popullsi prej 21,742 banorë, nga mesatarisht 5,436 banorë aktualisht në NJQV ekzistuese;

Reduktim i shpenzimeve administrative të njësisë me rreth 35,9 milionë lekë në vit, ose 31% e shpenzimeve administrative (shpenzime paga dhe operative) dhe 16% e shpenzimeve vjetore gjithsej;

Ulja e shpenzimeve të personelit për banor në masën 45%, nga 3,404 lekë në 1,890 lekë për banor;

Mirëadministrimi i burimeve financiare mund të sjellë rritje të investimeve pothuajse dyfish, ose nga 86 milionë lekë, në 121,9 milionë lekë në vit;

Investimet për banor mund të rriten nga 3,955 lekë, në 5,607 lekë për banor në njësinë e re;

Bashkimi në një zonë funksionale mund të sigurojë rishpërndarje më të mirë të të ardhurave duke zbutur pabarazitë e mëdha mes zonave; pa llogaritur efektet e eficiencës së rritur në menaxhimin e të ardhurave: mesatarisht ZF e re do të realizonte 8,163 lekë të ardhura të veta për frymë (e barabartë me mesataren e njësisë), ose dyfish më shumë se mediani (632) i të ardhurave për frymë në njësitë ekzistuese.

Zona funksionale Divjakë

Zona Divjakë (bashkia Divjakë, komunat Grabian, Gradishtë, Rremas, Tërbuf)

Kjo zonë funksionale ka një popullsi prej 34 254 banorësh sipas të dhënave të Censur-it 2011 dhe është e përbërë nga 5 njësi ekzistuese (4 komuna dhe 1 bashki). Dendësia mesatare në zonën funksionale është 291 banorë/km² në krahasim me 96 banorë/km² që është vlera mesatare (*median*) e dendësisë në njësitë ekzistuese.

Vështrim i gjendjes ekonomike, financiare dhe administrative

Zhvillimi ekonomik dhe të dhënat ekonomike financiare

Sektori mbizotërues në ekonominë e rajonit të Divjakës është bujqësia, ndonëse kjo zonë ka potenciale ende të pazhvilluara në fushën e turizmit.


Zona funksionale Divjakë ka gjithsej 828 biznese nga të cilët 335 janë të vendosur në qytetin e Lushnjës. Grabiani dhe Tërbufi, si njësi me popullsi të madhe kanë gjithashtu një numër të konsiderueshëm biznesesh.

Tabela 54 Shpërndarja e popullsisë në ZF Divjakë

Rrethi	Njësia	B/K	Nr. i bizneseve	Biznese për 1000 banorë
Lushnjë	Divjakë	B	335	40
Lushnjë	Grabian	K	52	14
Lushnjë	Gradishtë	K	176	23
Lushnjë	Rremas	K	66	15
Lushnjë	Tërbuf	K	199	20
Gjithsej zona Divjakë mbas bashkimit			828	24

Burimi: INSTAT

Figura 116 Numri i bizneseve për 1000 banorë



Siç shihet nga të dhënat shumica e njësive në zonën funksionale në shqyrtim kanë numër të ulët biznesesh për 1000 banorë. Kujtojmë se kjo është një zonë kryesisht bujqësore me

përrjashtim të bashkisë Divjakë. Bizneset për 1000 banorë në njësitë e veçanta variojnë nga 14 (Hysgjokaj) në 40 në Lushnjë. Në zonën funksionale ky tregues rritet në 24 biznese për 1000 banorë.

Të dhëna buxhetore


Të gjitha njësitë e zonës kanë një buxhet (të ardhura) prej rreth 780 milionë lekësh në vitin 2012. Nga këto rreth 40% ose 312 milionë janë realizuar në bashkinë e Lushnjës, e cila realizon edhe 59% të të ardhurave të veta.

Tabela 55 Të dhëna buxhetore për zonën funksionale Lushnjë

	Të ardhura totale	Të ardhura të veta	Shpenzime totale
Divjakë	89 774	41 833	94 000
Grabian	62 098	5694	20 000
Gradishtë	57 885	12 638	28 000
Rremas	43 975	8979	33 000
Tërbuf	65 577	11 310	40 000
Gjithsej ZF	319 310	80 454	215 000


Po të vërejmë të ardhurat për frymë shohim se mesatarja e të ardhurave të veta për frymë për të gjitha njësitë është 2265 lekë. Pas bashkimit ky tregues rritet disi në 2349 lekë për frymë për të gjithë zonën funksionale rreth 5% më shumë se mesatarja dhe 29% më shumë se mesatarja (*median*) i të ardhurave të veta për frymë të njësisive.

Figura 117 Të ardhurat e veta për frymë në zonën funksionale Divjakë



Ndërkohë, situata paraqitet disi më ndryshe për treguesit mbi të ardhurat gjithsej të njësisive: mesatarja e të ardhurave për frymë në zonën funksionale pëson disi rënie në krahasim me mesataren e njësisive individuale. Kjo shpjegohet me faktin se njësitë më të vogla subvencionohen në masë shumë të madhe nga buxheti i shtetit duke rezultuar në të ardhura të larta për frymë. Gjithashtu, baza për përllogaritjen e transfertave buxhetore është popullsia administrative, e cila raportohet më e lartë se të dhënat nga Census-i.


Figura 118 Të ardhurat për frymë në zonën funksionale Divjakë



Të dhëna mbi shpenzimet

Po të vërejmë shpenzimet për frymë, të dhënat janë të ngjashme:

Figura 119 Shpenzimet për frymë



Shpenzimet për frymë në zonën funksionale Divjakë do të ishin rreth 6277 lekë pra, rreth 20% më të larta se mesatarja (*median*) i shpenzimeve për frymë në njësitë ekzistuese.

Tabela 56 Të ardhurat dhe shpenzimet për frymë në zonën funksionale Divjakë

	Të ardhura për frymë	Të ardhurat e veta për frymë	Shpenzime për frymë
Divjakë	10 630	4954	11 131
Grabian	17 069	1565	5498
Gradishtë	7696	1680	3723
Rremas	9884	2018	7417
Tërbuf	6429	1109	3921
ZF gjithsej	9322	2349	6277


Njësitë shpenzojnë mesatarisht 50% të buxhetit për shpenzime administrative, minimumi përfaqësohet nga komuna Rremas (39%) dhe maksimumi nga bashkia Divjakë me 59%. Treguesi i shpenzimeve administrative për zonën ulet në 35% duke marrë parasysh kursimet e parashikuara të cilat do të trajtohen më poshtë, ndërkohë që pesha e investimeve rritet nga 24% në 41%.

Tabela 57 Struktura e shpenzimeve në zonën funksionale Divjakë

	Shpenzime totale	Shpenzime personel	Shpenzime operative të tjera	Investime 2012	Shp. personel si % e totalit	Operative të tjera si % e totalit	Inv. si % e totalit 2012
Divjakë	94 000	55 000	18 000	21 000	59%	19%	22%
Grabian	20 000	8000	5000	7000	40%	25%	35%
Gradishtë	28000	14 000	7000	7000	50%	25%	25%
Rremas	33 000	13 000	11 000	9000	39%	33%	27%
Tërbuf	40 000	18 000	14 000	8000	45%	35%	20%
Mesatare	215 000	108 000	55 000	52 000	50%	26%	24%
Gjithsej ZF Divjakë*	215 000	70 900	51 300	92 800	33%	24%	43%

*Të dhënat për ZF Divjakë janë nxjerrë me supozimin se do të kursehet rreth 70% e shpenzimeve administrative dhe 10% e shpenzimeve të tjera operative të njësisë që suprimohen.

Figura 120 Struktura e shpenzimeve në zonën funksionale krahasuar me mesataren e njësive ekzistuese




Treguesit e investimeve

Treguesit e investimeve vrojtohen më mirë në një periudhë të gjatë kohore. Në këtë rast janë shqyrtuar të dhënat për pesë vjet, të cilat tregojnë se niveli i investimeve nuk ka qenë në nivele të këqija në krahasim me të ardhurat. Po të supozojmë se ritmi i investimeve do të ishte ulur në masën e reduktimit nga shpenzimet administrative, pesha e investimeve ndaj buxhetit total të zonës funksionale do të rritej në 70% nga 47% mesatarisht. Natyrisht kjo është një rritje vetëm teorike pasi me përmirësimin e infrastrukturës rritet edhe nevoja për mirëmbajtje, si edhe pritshmëria qytetare për shërbime më të mira (pra, do të rriteshin shpenzimet operative më shpejt se investimet).

Figura 121 Investimet si përqindje e buxhetit total në zonën funksionale dhe njësitë ekzistuese

	Investime 2008 - 2012	Të ardhura 2008 - 2012	Inv. si % e ardh totale 2008 - 2012
Divjakë	319 607	580 498	55%
Grabian	107 793	248 082	43%
Gradishtë	126 523	307 558	41%
Rremas	118 954	253 505	47%
Tërbuf	156 887	386 603	41%
Mesatare	829 764	1 776 246	47%
Zona funksionale	1 244 646	1 776 246	70%

Figura 122 Treguesit e investimeve për frymë në zonën funksionale



Analiza e efekteve administrative

Bashkimi i njësive në një zonë funksionale do të rezultojë në kursime veçanërisht nga shpenzimet e personelit dhe një pjesë të shpenzimeve operative për mirëmbajtjen e zyrave. Në veçanti, në dhjetë nga njëmbëdhjetë njësitë e zonës funksionale do të shkurtohen pozicionet e kryetarit dhe të kabinetit të tij dhe shpenzimet për shpërblimet e këshilltarëve. Gjithashtu, shkurtime të mëtejshme do të realizohen nga realizimi i asaj që rëndom quhet si *economy of scope*, më konkretisht shkurtimi i funksioneve të përsëritura administrative të cilat do të përqendrohen në njësinë administrative të zonës funksionale. Të tilla pozicione janë sektori i menaxhimit financiar (specialistët e financës dhe buxhetit), sektori i prokurimeve dhe sektori i auditivit financiar, por edhe sektori i urbanistikës. Një llogari paraprake e reduktimit të mundshëm sugjeron se nga bashkimi mund të kursehen rreth 60% - 70% e kostove të personelit dhe rreth 10% e shpenzimeve të mirëmbajtjes së zyrave. Përlllogaritjet e mëposhtme janë bazuar mbi këtë model.

Tabela 58 Reduktimet nga shpenzimet e personelit dhe të mirëmbajtjes

	Reduktimi nga personeli 60%)	Reduktimi nga zyrat (10%)
Divjakë		
Grabian	5600	500
Gradishtë	9800	700
Rremas	9100	1100
Tërbuf	12 600	1400
Gjithsej	37 100	3700
Reduktimi si % e zërit përkatës	34%	7%
Reduktimi si % e shpenzimeve totale	17%	2%

Me supozimet e bëra në zonën funksionale Divjakë pas bashkimit kursehen mbi 40 milionë lekë ose 19% e shpenzimeve totale të kryera nga të gjitha njësitë. Këto fonde të çliuara janë gati 80% e buxhetit të akorduar për investime në këtë zonë në vitin në shqyrtim, çka do të thotë se me *këto reduktime të shpenzimeve administrative në teori mund të rriteshin investimet për zonën me 80% për efekt të rritjes së efikasitetit në ofrimin e shërbimeve.*

Treguesit socialë

Bashkimi i njërive në një zonë funksionale mund të ketë efekte pozitive edhe për treguesit socialë dhe arsimorë të zonës. Në veçanti, niveli arsimor mesatar përgjithësisht është në përpjesëtim të drejtë me largësinë gjeografike nga qendrat funksionale, të cilat janë dhe qendra të vjetra urbane me një traditë arsimore dhe zhvillim elitash. Po ashtu, mund të bëhet një shpërndarje më e mirë e institucioneve arsimore (kopshte, shkolla) në raport të drejtë me dendësinë e popullsisë

Niveli arsimor dhe faktori gjeografik

Në përgjithësi, qendrat historike kanë frekuencë të treguesit të nivelit arsimor të lartë më të shpeshtë sesa në zonat rurale. Ky tregues zbehet më rritjen e distancës gjeografike nga qendra historike ku diploma më e lartë është e arsimit të mesëm.

Sigurisht ky tregues duhet parë dhe në krahasim me ofertën arsimore të zonës por dhe me përqendrimin e vendeve më të kualifikuara të punës të cilat gjenden kryesisht pranë qendrave urbane.


Është interesante dhe tradita historike e zhvillimit të qendrave urbane pasi bashkitë që kanë pasur universitete dhe një jetë kulturore më të gjallë reflektojnë dhe nivel arsimor më të lartë dhe një elitë qytetare më të konsoliduar siç është rasti i qyteteve të mëdha.

Ndërkohë që qendrat urbane më të vogla kanë pasur një traditë kryesisht industriale reflektojnë nivel arsimor të lartë në shkallë më të ulët si p.sh. Patos 6% krahasuar me totalin e popullsisë zonës, ndjekur nga Ballshi e pastaj Lushnja. Në rastin e Lushnjës gjithashtu ka pasur një jetë urbane më aktive se Ballshi apo Patosi, e edhe pse flasim për shifra relativisht të vogla, reflektohet dhe në përqendrimin e popullsisë me diploma të arsimit të lartë.

Tradita e përqendrimit të banorëve me arsim të lartë drejt qendrës urbane reflekton gjithashtu segregimin e popullsisë sipas grupeve profesionale, çka ka qenë traditë e sistemit të mëparshëm komunist, tipare që nuk kanë reflektuar ndryshim.

Në zonën e Lushnjës nga ana tjetër, ndonëse distanca duket të ketë pak rëndësi, situata duket disi më e çrregullt për të tre nivelet e arsimit. Veçanti përbën përsëri, zona urbane e Lushnjës në të cilën vihet re një prezencë më e madhe e arsimit të lartë dhe atij të mesëm.

Figura 123 Diploma më e lartë për zonën funksionale të Lushnjës dhe Divjakës



Një përfundim që mund të nxirret nga kjo analizë e nivelit arsimor e parë nga optika e distancës gjeografike nga qendra urbane është se në ndryshim nga çfarë mund të pasqyrojnë të dhënat për qarkun nuk vërehet ndonjë ndikim i ndjeshëm mes afërsisë gjeografike të banorëve me qendrën dhe nivelin arsimor të lartë. Fakti që ka një përqendrim në të katër rastet të nivelit të arsimit të lartë në zonën urbane dhe më pak e për më tepër në mënyrë të çrregullt në zonat rurale, reflekton kërkesën e tregut të punës dhe mundësitë për zhvillim.

Institucionet arsimore

Në zonën e Lushnjës, dimensionin e arsimit si parashkollor dhe atij shkollor na jep një tablo të detajuar të kapacitetit dhe orientimit të sistemit për t’iu ardhur në ndihmë banorëve. Ky kapacitet vlerësohet si për zonat urbane dhe rurale si përgjithësisht i ngjashëm pa ndonjë diferencë të theksuar. Në Lushnjë kemi 17 fëmijë për edukatorë ndërsa në rrethina shifra varion nga 21 në Rrembas deri në 26 në Dushk. Për sa i përket numrit të nxënësve për mësues situata paraqitet e ngjashme e varion nga 12,9 – 19,5. Diferencimet dalin në pah edhe për shkollat e mesme ku grupi i nxënësve për mësues varion nga 16 – 30.

Ndonëse distanca nuk luan ndonjë rol thelbësor, shihet qartë një disproporcion, i cili verifikohet edhe nga raporti i shkollave dhe mësuesve për 10 000 banorë.

Figura 124 Raporti i mësuesve dhe nxënësve me dendësinë e popullsisë për zonën funksionale Divjakë





Figura 125 Shpërndarja dhe gjendja fizike e objekteve arsimore në ZF Divjakë



Siç shihet nga Figura 125, pjesa më e madhe e objekteve arsimore në zonën funksionale të Divjakës kanë nevojë për ndërhyrje në infrastrukturë, me përjashtim të bashkisë ekzistuese Divjakë, ku shumica e shkollave nuk duket të kenë probleme thelbësore. Bashkimi në një zonë funksionale do të kërkojë edhe planifikim strategjik për ndërhyrjet në infrastrukturën arsimore.

Spitalet dhe poliklinikat

Tabela 59 Shpërndarja e mjekëve në zonën funksionale Divjakë

Divjakë		Popullsia	Nr. mjekësh	Mjekë për 10 000 banorë
Divjakë	B	8445	5	5,9
Grabian	K	3638	2	5,5
Gradishtë	K	7521	4	5,3
Rremas	K	4449	2	4,5
Tërbuf	K	10 201	5	4,9
Total		34 254	18	5,3

Shërbimet sociale

Për sa i përket shpërndarjes së shërbimeve sociale, trendi i përgjithshëm është që ka një përqendrim në zonat urbane e në qendrat e mëdha urbane, ndërkohë që zonat rurale mbeten të pambuluara me shërbime e banorët duhet të udhëtojnë drejt qendrës urbane më të afërt për të marrë shërbimin.

Argumenti kryesor është që komunat nuk kanë as kapacitete financiare dhe as ato njerëzore për të ofruar shërbime sociale. Riorganizimi territorial pritet të ndikojë ndjeshëm në ofrimin e drejtë të shërbimeve duke i dhënë një prioritet mbulimit të zonave rurale.

Gjithashtu, vihet re që peshën kryesore të shërbimeve sociale e mbajnë OJQ-të, ndërsa kategoritë e shërbimeve janë të limituara dhe të ndikuara jo detyrimisht nga nevojat e komunitetit të cilit i shërbehet, por nga agjendat e donatorëve që janë dhe mbështetësit kryesor të tyre.

Në zonën e Divjakës nuk ka shërbime sociale specifike. Qendra më e afërt është bashkia Lushnjë.

Distanca e njërive të përthithura me qendrën/njësinë e re

Largësia mesatare në kohë udhëtimi me qendrën e bashkisë është 11 minuta, faktor ky që mund të ndikojë pozitivisht në mundësinë e ndërveprimit të qytetarëve me qeverisjen. Gjithashtu, bashkimi në një zonë funksionale dhe potenciali më i madh financiar mund të prodhojë efekte pozitive në planifikimin strategjik dhe realizimin e investimeve në infrastrukturën rrugore duke përmirësuar më tej aksesin e qytetarëve drejt qendrës së Divjakës dhe zonave turistike, si edhe drejt qendrave të tjera kombëtare.

Tabela 60 Distancat e njërive nga qendra e re

Zona funksionale Divjake			Distanca në km	Koha e udhëtimit
Fier	Divjakë	B	0	0
Fier	Grabian	K	32,5	45
Fier	Gradishtë	K	17,4	20
Fier	Rremas	K	14	19
Fier	Tërbuf	K	13	19
			24,0	11,2

Figura 126 Infrastruktura rrugore në ZF Divjakë



Figura 127 Distancat kohore nga qendra e re





Figura 128 Distancat kohore nga qendra Divjakë



Përfundime

ZF Divjakë me popullsi 34 254 banorë me nga mesatarisht 6851 banorë për njësi.

Reduktim i shpenzimeve administrative (paga dhe të tjera operative) me rreth 41 milionë lekë ose 19% e shpenzimeve totale të kryera nga të gjitha njësitë.

Ulje e shpenzimeve të pagave nga 108 milionë në 71 milionë lekë në vit. Shpenzimet e personelit për frymë do të uleshin nga 3153 lekë në 2070 lekë për banor në njësinë e re.

Rritje e buxhetit të investimeve me pothuajse 80% nga 52 milionë në vit në 92,8 milionë lekë në vit.

Rritje e investimeve për frymë nga 1518 lekë në 2709 lekë çdo vit në njësinë e re.

Zona funksionale Mallakastër

Zona Mallakastër (bashkia Ballsh, komunat Aranitas, Fratar, Greshicë, Hekal, Kapaj, Kute, Ngacan, Qendër)

Kjo zonë funksionale ka një popullsi prej 27 062 banorësh sipas të dhënave të Censur-it 2011 dhe është e përbërë nga 9 njësi ekzistuese (8 komuna dhe 1 bashki). Kjo zonë ka humbur rreth 32% të popullsisë që nga viti 2001 sipas të dhënave të INSTAT dhe është zona me ritmin më të lartë të largimit të popullsisë në qarkun Fier. Dendësia mesatare në zonën funksionale është 75 banorë/km² në krahasim me 63 banorë/km² që është vlera mesatare (*median*) e dendësisë në njësitë ekzistuese.

Vështrim i gjendjes ekonomike, financiare dhe administrative

Zhvillimi ekonomik dhe të dhënat ekonomike financiare


Zona funksionale Mallakastër ka gjithsej 704 biznese nga të cilët 60% janë të vendosur në qytetin e Ballshit. Mbi 60% e popullsisë në zonat rurale është e punësuar në bujqësi, ndërkohë që në qytetin e Ballshit burimi kryesor i punësimit janë industria dhe shërbimet.

Tabela 61 Shpërndarja e popullsisë në ZF Mallakastër

Rrethi	Njësia	B/K	Nr. i bizneseve	Biznese për 1000 banorë
Mallakastër	Aranitas	K	24	9
Mallakastër	Ballsh	B	424	55
Mallakastër	Fratar	K	60	19
Mallakastër	Greshicë	K	14	12
Mallakastër	Hekal	K	24	9
Mallakastër	Kapaj	K	13	15
Mallakastër	Kute	K	14	7
Mallakastër	Ngracan	K	7	12
Mallakastër	Qendër	K	124	20
Gjithsej zona Mallakastër mbas bashkimit			2825	704

Burimi: INSTAT

Figura 129 Numri bizneseve për 1000 banorë



Siç shihet nga të dhënat shumica e njësive në zonën funksionale në shqyrtim kanë numër të ulët biznesesh për 1000 banorë. Kujtojmë se kjo është një zonë kryesisht bujqësore me përjashtim të bashkisë Ballsh. Bizneset për 1000 banorë në njësitë e veçanta variojnë nga 7 (Kute) në 55 në Ballsh. Në zonën funksionale ky tregues rritet në 26 biznese për 1000 banorë.

Të dhëna buxhetore


Të gjitha njësitë e zonës kanë një buxhet (të ardhura) prej rreth 598 milionë lekësh në vitin 2012. Nga këto, vetëm 20% ose 123 milionë janë realizuar në bashkinë e Ballshit, e cila realizon edhe 40% të të ardhurave të veta. Në vitin 2012 buxhetin më të madh e ka komuna Greshicë, e cila ka përndryshe tregues shumë të ulët të të ardhurave të veta, çka tregon se kjo peshë specifike e lartë në vitin në shqyrtim është rezultat i ndonjë investimi buxhetor.

Tabela 62 Të dhëna buxhetore për zonën funksionale Mallakastër

	Të ardhura totale	Të ardhura të veta	Shpenzime totale
Aranitas	40 036	7692	12 000
Ballsh	122 746	47 869	89 000
Fratar	30 362	6683	15 000
Greshicë	196 656	1560	6000
Hekal	39 600	9674	14 000
Kapaj	19 566	544	10 000
Kute	32 002	2578	13 000
Ngracan	49 843	384	2000
Qendër	67 321	32 549	58 000
Gjithsej ZF	598 132	109 534	219 000


Po të vërejmë të ardhurat për frymë shohim se mesatarja e të ardhurave të veta për frymë për të gjitha njësitë është 2665 lekë. Pas bashkimit ky tregues rritet në 4048 lekë për frymë për të gjithë zonën funksionale ose 34% më shumë se mesatarja e njësive.

Figura 130 Të ardhurat e veta për frymë në zonën funksionale Mallakastër



Situata paraqitet e ngjashme për treguesit mbi të ardhurat gjithsej të njëjve: mesatarja e të ardhurave për frymë në zonën funksionale është më e lartë se shumica e njëjve ekzistuese. Në këtë rast kemi disa njësi të cilat kanë të ardhura për frymë veçanërisht të larta, të cilat nuk përbëjnë trend, por vijnë si rezultat i të hyrave nga buxheti i shtetit në mënyrë tipike për investime. Çka është interesante në zonën funksionale Ballsh është se treguesit ekonomike dhe financiarë të bashkisë qendër nuk ndryshojnë në mënyrë dramatike nga ai i komunave rrethuese.


Figura 131 Të ardhurat për frymë në zonën funksionale Mallakastër



Të dhëna mbi shpenzimet

Po të vërejmë shpenzimet për frymë, të dhënat janë të ngjashme:

Figura 132 Shpenzimet për frymë



Shpenzimet për frymë në zonën funksionale Mallakastër do të ishin rreth 8093 lekë pra, rreth 22% më të larta se mesatarja e shpenzimeve për frymë në njësitë ekzistuese ose 34% më e lartë se vlera mediane e shpenzimeve për frymë.

Tabela 63 Të ardhurat dhe shpenzimet për frymë në zonën funksionale Mallakastër

	Të ardhura për frymë	Të ardhurat e veta për frymë	Shpenzime për frymë
Aranitas	14 752	2834	4422
Ballsh	16 031	6252	11 623
Fratar	9426	2075	4657
Greshicë	170 708	1354	5208
Hekal	15 097	3688	5337
Kapaj	22 310	621	11 403
Kute	16 187	1304	6576
Ngracan	84 767	653	3401
Qendër	10 766	5205	9276
ZF gjithsej	22 102	4048	8093


Njësitë shpenzojnë mesatarisht 45% të buxhetit për shpenzime administrative, minimumi përfaqësohet nga komuna Ballagat me (22%) dhe maksimumi nga komuna Dushk me 73%. Treguesi i shpenzimeve administrative për zonën ulet në 33% duke marrë parasysh kursimet e parashikuara të cilat do të trajtohen më poshtë, ndërkohë që pesha e investimeve rritet nga 16% në 29%.

Tabela 64 Struktura e shpenzimeve në zonën funksionale Mallakastër

	Shpenzime totale	Shpenzime personel	Shpenzime operative të tjera	Investime 2012	Shp. personel si % e totalit	Operative të tjera si % e totalit	Inv. si % e totalit 2012
Aranitas	12 000	6000	3000	3000	50%	25%	25%
Ballsh	89 000	51 000	38 000	0	57%	43%	0%
Fratar	15 000	5000	4000	6000	33%	27%	40%
Greshicë	6000	1000	2000	3000	17%	33%	50%
Hekal	14 000	7000	2000	5000	50%	14%	36%
Kapaj	10 000	2000	4000	4000	20%	40%	40%
Kute	13 000	5000	3000	5000	38%	23%	38%
Ngracan	2000	1000	1000	0	50%	50%	0%
Qendër	58 000	19 000	11 000	28 000	33%	19%	48%
Mesatare	219 000	97 000	68 000	54 000	44%	31%	25%
Gjithsej ZF Mallakastër*	219 000	64 800	65 000	89 200	30%	30%	41%

*Të dhënat për ZF Mallakastër janë nxjerrë me supozimin se do të kursehet rreth 70% e shpenzimeve administrative dhe 10% e shpenzimeve të tjera operative të njësive që suprimohen.

Figura 133 Struktura e shpenzimeve në zonën funksionale krahasuar me mesataren e njësive ekzistuese




Treguesit e investimeve

Treguesit e investimeve vrojtohen më mirë në një periudhë të gjatë kohore. Në këtë rast janë shqyrtuar të dhënat për pesë vjet, të cilat tregojnë se niveli i investimeve në këtë zonë ka qenë mesatarisht më i lartë se ai kombëtar. Po të supozojmë se ritmi i investimeve do të ishte ulur në masën e reduktimit nga shpenzimet administrative, pesha e investimeve ndaj buxhetit total të zonës funksionale do të rritej në 68% nga 53% mesatarisht.

Figura 134 Investimet si përqindje e buxhetit total në zonën funksionale dhe njësitë ekzistuese

	Investime 2008 - 2012	Të ardhura 2008 - 2012	Inv. si % e ardh totale 2008 - 2012
Aranitas	71 728	158 920	45%
Ballsh	348 615	550 629	63%
Fratar	67 045	199 743	34%
Greshicë	210 216	260 638	81%
Hekal	77 274	168 388	46%
Kapaj	40 110	127 419	31%
Kute	60 581	123 201	49%
Ngracan	54 227	108 595	50%
Qendër	215 870	483 864	45%
Mesatare	1 145 666	2 181 397	53%
Zona funksionale	1 489 366	2 181 397	68%

Figura 135 Treguesit e investimeve për frymë në zonën funksionale



Analiza e efekteve administrative

Bashkimi i njësive në një zonë funksionale do të rezultojë në kursime veçanërisht nga shpenzimet e personelit dhe një pjesë të shpenzimeve operative për mirëmbajtjen e zyrave. Në veçanti, në dhjetë nga njëmbëdhjetë njësitë e zonës funksionale do të shkurtohen pozicionet e kryetarit dhe të kabinetit të tij, si dhe shpenzimet për shpërblimet e këshilltarëve. Gjithashtu, shkurtime të mëtejshme do të realizohen nga realizimi i asaj që rëndom quhet si *economy of scope*, më konkretisht shkurtimi i funksioneve të përsëritura administrative të cilat do të përqendrohen në njësinë administrative të zonës funksionale. Të tilla pozicione janë sektori i menaxhimit financiar (specialistët e financës dhe buxhetit), sektori i prokurimeve dhe sektori i auditivit financiar, por edhe sektori i urbanistikës. Një llogari paraprake e reduktimit të mundshëm sugjeron se nga bashkimi mund të kursehen rreth 60% - 70% e kostove të personelit dhe rreth 10% e shpenzimeve të mirëmbajtjes së zyrave. Përlllogaritjet e mëposhtme janë bazuar mbi këtë model.

Tabela 65 Reduktimi i shpenzimeve të personelit dhe të mirëmbajtjes

	Reduktimi nga personeli 60%)	Reduktimi nga zyrat (10%)
Aranitas	4200	300
Ballsh		
Fratar	3500	400
Greshicë	700	200
Hekal	4900	200
Kapaj	1400	400
Kute	3500	300
Ngracan	700	100
Qendër	13 300	1100
Gjithsej	32 200	3000
Reduktimi si % e zërit përkatës	33%	4%
Reduktimi si % e shpenzimeve totale	15%	1%

Me supozimet e bëra në zonën funksionale Mallakastër pas bashkimit kursehen rreth 35 milionë lekë ose 16% e shpenzimeve totale të kryera nga të gjitha njësitë. Këto fonde të çliruara janë të afërsisht 60% e fondeve të alokuara për investime në këtë zonë në vitin e fundit nën shqyrtim, çka do të thotë se me *këto kursime në teori mund të rriteshin me 60% investimet për zonën.*

Treguesit socialë

Bashkimi i njërive në një zonë funksionale mund të ketë efekte pozitive edhe për treguesit socialë dhe arsimorë të zonës. Në veçanti, niveli arsimor mesatar përgjithësisht është në përpjesëtim të drejtë me largësinë gjeografike nga qendrat funksionale, të cilat janë dhe qendra të vjetra urbane me një traditë arsimore dhe zhvillim elitash. Po ashtu, mund të bëhet një shpërndarje më e mirë e institucioneve arsimore (kopshte, shkolla) në raport të drejtë me dendësinë e popullsisë

Niveli arsimor dhe faktori gjeografik

Në përgjithësi, qendrat historike kanë frekuencë të treguesit të nivelit arsimor të lartë më të shpeshtë sesa në zonat rurale. Ky tregues zbehet më rritjen e distancës gjeografike nga qendra historike ku diploma më e lartë është e arsimit të mesëm.

Sigurisht ky tregues duhet parë dhe në krahasim me ofertën arsimore të zonës por dhe me përqendrimin e vendeve më të kualifikuara të punës të cilat gjenden kryesisht pranë qendrave urbane.

Është interesante dhe tradita historike e zhvillimit të qendrave urbane pasi bashkitë që kanë pasur universitete dhe një jetë kulturore më të gjallë reflektojnë dhe nivel arsimor më të lartë dhe një elite qytetare më të konsoliduar, siç është rasti i qytetit të Fierit.


Ndërkohë që qendrat urbane më të vogla kanë pasur një traditë kryesisht industriale reflektojnë nivel arsimor të lartë në shkallë më të ulët, si p.sh. Patos 6% krahasuar me totalin e popullsisë zonës ndjekur nga Ballshi e pastaj Lushnja. Në rastin e Lushnjës gjithashtu ka

pasur një jetë urbane më aktive se në Ballsh apo në Patos; edhe pse flasim për shifra relativisht të vogla, kjo reflektohet edhe në përqendrimin e popullsisë me diploma të arsimit të lartë.

Tradita e përqendrimit të banorëve me arsim të lartë drejt qendrës urbane reflekton gjithashtu segregimin e popullsisë sipas grupeve profesionale, çka ka qenë traditë e sistemit të mëparshëm komunist, tipare që nuk kanë reflektuar ndryshim.

Mbizotërimi i nivelit 9 vjeçar është i theksuar në zonën e Mallakastrës, ndërkohë që vihet re një përqendrim disi më i madh i arsimit të mesëm dhe të lartë në qytetin e Ballshit.

Figura 136 Niveli arsimor në zonën funksionale Mallakastër



Një përfundim që mund të nxirret nga kjo analizë e nivelit arsimor e parë nga optika e distancës gjeografike nga qendra urbane është se në ndryshim nga çfarë mund të pasqyrojnë të dhënat për qarkun, nuk vërehet ndonjë ndikim i ndjeshëm mes afërsisë gjeografike të banorëve me qendrën dhe nivelin arsimor të lartë. Fakti që ka një përqendrim në të katër rastet të nivelit të arsimit të lartë në zonën urbane dhe më pak e për më tepër në mënyrë të çrregullt në zonat rurale, reflekton kërkesën e tregut të punës dhe mundësitë për zhvillim.

Institucionet arsimore

Në zonën e Mallakastrës, dimensionin e arsimit si parashkollor dhe atij shkollor na jep një tablo të detajuar të kapacitetit dhe orientimit të sistemit për t'iu ardhur në ndihmë banorëve. Ky kapacitet vlerësohet si për zonat urbane dhe rurale si përgjithësisht i ngjashëm pa ndonjë diferencë të theksuar. Në Mallakastër numri edukatorëve për fëmijë sillet rreth grupit 16 – 19 me bashkinë Ballsh që ka raportin 17. Për shkollat 9 vjeçare ky numër është 10 -20 me zonën urbane të Ballshit që raporton nivelin maksimal. Për shkollat e mesme – që janë 3 në këtë zonë, niveli i mësuesve varion nga 12 – 19 që është në nivele të respektueshme në krahasim me zonat e tjera të qarkut të Fierit.

Ndonëse distanca nuk luan ndonjë rol thelbësor, shihet qartë një disproporcion i cili verifikohet edhe nga raporti i shkollave dhe mësuesve për 10 000 banorë.

Figura 137 Shpërndarja dhe gjendja fizike e objekteve arsimore në ZF Mallakastër




Figura 137 tregon se gjendja e objekteve arsimore në zonën funksionale të Mallakastrës është mjaft kritike në të gjitha njësitë përfshirë qendrën Ballsh, por në veçanti në zonat e Greshicës dhe Selitës. Ndërhryjet në infrastrukturën arsimore mund të jenë më domethënëse në kushtet e planifikimit strategjik të investimeve dhe grumbullimit të fondeve në një zonë me popullsi por edhe potencial ekonomik më të lartë siç do të jetë zona funksionale Ballsh. Kjo do të kërkojë gjithashtu mbështetje nga Ministria e Arsimit pasi buxheti i ZF Mallakastër mbetet modest, si edhe prioritizim të mirë të ndërhyrjeve duke peshuar nevojat si edhe numrin e popullsisë përfituese në zonat përbërëse e aksesin në shkolla.

Spitalet dhe poliklinikat

Tabela 66 Shpërndarja e mjekëve në ZF Mallakastër

Mallakastër		Popullsia	Nr. mjekësh	10 000 banorë
Aranitas	K	2714	2	7,4
Ballsh	B	7657	5	6,5
Fratar	K	3221	2	6,2
Greshicë	K	1152	1	8,7
Hekal	K	2623	1	3,8
Kapaj	K	877	0	0,0
Kute	K	1977	1	5,1
Ngracan	K	588	1	17,0
Qendër	K	6253	6	9,6
Total		27 062	19	7,0

Shërbimet sociale

Për sa i përket shpërndarjes së shërbimeve sociale trendi i përgjithshëm është që ka një përqendrim në zonat urbane dhe në qendrat e mëdha urbane, ndërkohë që zonat rurale mbeten të pambuluara me shërbime e banorët duhet të udhëtojnë drejt qendrës urbane më të afërt për të marrë shërbimin.

Argumenti kryesor është që komunat nuk kanë as kapacitete financiare dhe as ato njerëzore për të ofruar shërbime sociale. Riorganizimi territorial pritet të ndikojë ndjeshëm në ofrimin e drejtë të shërbimeve duke i dhënë një prioritet mbulimit të zonave rurale.

Gjithashtu, vihet re që peshën kryesore të shërbimeve sociale e mbajnë OJQ-të, ndërsa kategoritë e shërbimeve janë të limituara dhe të ndikuara jo detyrimisht nga nevojat e komunitetit të cilit i shërbehet, por nga agjendat e donatorëve që janë dhe mbështetësit kryesor të tyre.

Tabela 67 Shërbimet sociale në ZF Mallakastër

Zona Funktionale Mallakastër		
Institucioni/Organizata	Tipologjia e shërbimit	Grup moshë
Kryqi i Kuq – Ballsh, Mallakastër	Kurse të ndihmës së parë	Shërbime multidisiplinare për familjet me probleme sociale dhe për komunitetin
Shoqata e Invalidëve të Punës – Ballsh, Mallakastër	Përkujdes ditor për të moshuarit	Shërbime sociale për të moshuar
Shoqata e jetimëve - Mallakastër	Shërbime ditore për moshat 0-3 dhe 6-14 vjeç dhe qendër këshillimi për familjarët	Shërbime sociale për fëmijë 0-3 vjeç dhe 3-14 vjeç

Distanca e njësive të përthithura me qendrën/njësinë e re

Largësia në kohë udhëtimit me qendrën e bashkisë është një tregues vendimtar për të siguruar mundësinë e ndërveprimit të qytetarëve me qeverisjen. Në përgjithësi, është e dëshirueshme që qendra e njësisë së re të arrihet brenda 1 ore nga njësitet e suprimuara. Vlen të theksohen edhe rastet kur koha e udhëtimit për në qendrën e njësisë së re është më shumë se 1 orë me

mjetet e transportit publik. Në zonën Mallakastër koha e udhëtimit nga qendrat e njësive ekzistuese për në Ballsh është mesatarisht 15 minuta. Megjithatë, komunave më të largëta si Kute dhe Kapaj u duhet edhe 45 minuta për të arritur në Ballsh.

Figura 138 Distancat kohore për në Ballsh




Tabela 68 Distancat e njësive ekzistuese nga qendra e re

			Sip. km ²	Distanca në km	Koha e udhëtimit (min)
Mallakastër	Aranitas	K	50	7,2	13
Mallakastër	Ballsh	B	0	0	0
Mallakastër	Fratar	K	54	19,1	27
Mallakastër	Greshicë	K	48	9,8	13
Mallakastër	Hekal	K	54	7,4	12
Mallakastër	Kapaj	K	13	8,1	18
Mallakastër	Kute	K	52	9	
Mallakastër	Ngracan	K	15	11,1	17
Mallakastër	Qendër	K	70	1,5	3
Gjithsej			356,2	9,2	147

Figura 139 Infrastruktura rrugore në ZF Mallakastër



Infrastruktura rrugore në zonën e Mallakastrës është mjaft e zhvilluar, përfshirë edhe aksesin në disa akse rrugore kombëtare. Si rezultat, qendra e njësisë së re arrihet në kohë relativisht të

shkurtër (Figura 138). Megjithatë, aksesit i disa zonave – si Ngracan, Kute dhe Selitë ka nevojë për përmirësim në kushtet e njësisë së re.

Përfundime

ZF Mallakastër me popullsi 27 062 banorë nga mesatarisht 3007 banorë për njësi.

Reduktim i shpenzimeve administrative (paga dhe të tjera operative) me rreth 35 milionë lekë në vit ose 16% e shpenzimeve totale të kryera nga të gjitha njësitë.

Ulje e shpenzimeve të pagave nga 97 milionë në 64,8 milionë lekë në vit. Shpenzimet e personelit për frymë do të ulëshin nga 3584 lekë në 2395 lekë për banor në njësinë e re.

Rritje e buxhetit të investimeve mbi 65% nga 54 milionë në vit në mbi 89 milionë lekë në vit.

Rritje e investimeve për frymë nga 1995 lekë në 3296 lekë çdo vit në njësinë e re.

QARKU GJIROKASTËR

Profili i qarkut të Gjirokastrës


Qarku i Gjirokastrës përbëhet nga 3 rrethe: Gjirokastrër, Përmet dhe Tepelenë, si dhe nga 32 njësi të qeverisjes vendore (NJQV) të organizuara – 13 në rrethin e Gjirokastrës, 9 në rrethin e Përmetit dhe 10 në rrethin e Tepelenës. Qarku i Gjirokastrës ka një popullsi prej 72 176 banorësh (në rrethin e Gjirokastrës – 35 843 banorë; në rrethin e Përmetit – 16 727 banorë dhe në rrethin e Tepelenës – 19 606 banorë) (INSTAT, Census 2011).

Tabela 69: Ndryshimi i popullsisë në qarkun e Gjirokastrës gjatë viteve 2001 dhe 2011

RRETHI	NJQV-ja	INSTAT 2011	INSTAT 2001	Diferenca	Diferenca në %
Gjirokastrër	Antigone	998	1224	-226	-18%
Gjirokastrër	Cepo	1727	3024	-1297	-43%
Gjirokastrër	Dropull i Poshtëm	2100			
Gjirokastrër	Dropull i Sipërm	971			
Gjirokastrër	Gjirokastrër	19 836	20 601	-765	-4%
Gjirokastrër	Lazarat	2801	3155	-354	-11%
Gjirokastrër	Libohovë	1992	2317	-325	-14%
Gjirokastrër	Lunxhëri	1941	2820	-879	-31%
Gjirokastrër	Odrie	433	561	-128	-23%
Gjirokastrër	Picar	937	1656	-719	-43%
Gjirokastrër	Pogon	432	907	-475	-52%
Gjirokastrër	Qendër Libohovë	1264	1583	-319	-20%
Gjirokastrër	Zagorie	411	716	-305	-43%
TOTAL GJIROKASTËR		35 843		-5792	-26%
PËRMET	BALLABAN	1047	2170	-1123	-52%
PËRMET	CARCOVË	918	1578	-660	-42%
PËRMET	DISHNICË	1159	2289	-1130	-49%
PËRMET	FRASHËR	387	813	-426	-52%
PËRMET	KËLCYRË	2651	3419	-768	-22%
PËRMET	PËRMET	5945	7726	-1781	-23%
PËRMET	PETKAN	1622	2226	-604	-27%
PËRMET	QENDËR PISKOVË	1742	2751	-1009	-37%
PËRMET	SUKË	1256	2808	-1552	-55%
TOTAL PËRMET		16 727	33 325	-9053	-35%
TEPELENË	BUZ	737	1682	-945	-56%
TEPELENË	FSHAT MEMALIAJ	1606	2564	-958	-37%
TEPELENË	KRAHËS	2554	3738	-1184	-32%
TEPELENË	KURVELESH	705	1393	-688	-49%
TEPELENË	LOPES	723	1259	-536	-43%
TEPELENË	LUFTINJE	1734	3881	-2147	-55%
TEPELENË	MEMALIAJ	2647	4748	-2101	-44%
TEPELENË	QENDËR	3179	4255	-1076	-25%
TEPELENË	QESARAT	1379	2345	-966	-41%
TEPELENË	TEPELENË	4342	6539	-2197	-34%
TOTAL TEPELENË		19 606	32 404	-12 798	-39%
TOTAL QARKU GJIROKASTËR		72 176	96 748	-27 643	-29%

Burimi: INSTAT Census 2001, 2011

Figura 140 NJQV-të në qarkun e Gjirokastrës sipas popullsisë



Burimi: INSTAT, Census 2011; Llogaritjet e autorëve

Trendi në uljen e popullsisë është e qartë edhe nëse krahasohen të dhënat e Census-it të vitit 2011 me të dhënat e Census-it për vitin 2001. Në vitin 2001, në qarkun e Gjirokastrës ishin regjistruar pothuajse 30% më shumë banorë se dhjetë vjet më vonë. Të gjitha rrethet kanë humbur popullsi me ritme pak a shumë të ngjashme gjatë këtij dhjetëvjeçari: Krahasuar me vitin 2001, Gjirokastra ka humbur rreth 26% të popullsisë, Përmeti 35%, ndërsa Tepelena ka humbur 39% të popullsisë.

Sipas të dhënave të Census-it për vitin 2011, popullsia e qarkut të Gjirokastrës përbën vetëm 2,58% të popullsisë së vendit dhe popullsia mesatare për njësi të qeverisjes vendore në këtë qark rezulton 2256 banorë/NJQV. Qarku Gjirokastrë është qarku me popullsinë më të vogël dhe njëkohësisht mesatarja e popullsisë për NJQV është më e ulët në vend, gati 4 herë më e ulët se mesatarja në rang vendi. 72% e NJQV-ve të qarkut Gjirokastrë kanë më pak se 2000 banorë dhe vetëm 2 njësi vendore kanë mbi 5000 banorë (Gjirokastra – 19 836 banorë dhe Përmeti - 5945 banorë)

Dendësia mesatare e popullsisë është 254 banorë/km², krahasuar me 97,4 banorë/km² në rang vendi. Përmeti (3123 banorë/km²); Memaliaj (2003 banorë/km²); Tepelena (1791 banorë/km²) dhe Gjirokastra (667 banorë/km²) janë njësitë vendore me dendësinë më të lartë, ndërsa komunat Pogon, Frashër e Zagorie (2-3 banorë/km²) janë njësitë me dendësinë më të ulët, ndërkohë që 9 NJQV kanë dendësi më të ulët se 10 banorë/km² (Dropull i Sipërm, Picar, Çarçovë, Buz, Kurvelesh, Lopës, etj.).

Lëvizjet e popullsisë

Siç vërehet edhe nga të dhënat për popullsinë, e gjithë zona e qarkut të Gjirokastrës ka pasur humbje të popullsisë gjatë këtyre viteve. Humbjen më të madhe të popullsisë e ka zona e Tepelenës (mbi 39%), ku disa prej njësive kanë humbur edhe gjysmën e popullsisë gjatë një dhjetëvjeçari. Të dhënat tregojnë se njësitë më të vogla kanë tendencën të kenë humbje më të madhe relative të popullsisë.

Ndërveprimi institucional


Si pasojë e traditës qeverisëse në Shqipëri, institucionet qendrore përqendrohen kryesisht në qendrat e rretheve Ky evidentim natyrisht që vlen dhe për qarkun e Gjirokastrës. Gjithashtu, në qendrat e rretheve vendosen zyrat arsimore, zyrat e punësimit, Drejtoritë Rajonale të Shëndetësisë, Drejtoritë e Shërbimit Pyjor, Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Prokuroria dhe degët e tatimeve. Në disa prej qendrave të rrethit janë vendosur dhe një sërë institucioneve sociale, shëndetësore dhe arsimore: shtëpitë e të moshuarve, shtëpitë e fëmijës, qendrat e formimit profesional, qendrat e zhvillimit, etj.

Kjo ka sjellë shndërrimin e qendrave të rretheve në pika kyçe për sa i përket ndërveprimit institucional dhe ndërveprimit të qytetarit me institucionet. Edhe bizneset duket se preferojnë të vendosen në qendrat e rretheve, po për të njëjtën arsye, praninë e institucioneve, e cila shoqërohet njëkohësisht me kapacitete më të mira njerëzore, cilësi më të lartë shërbimi dhe mundësi më të mira zgjedhjeje për sa i përket fushës së aktivitetit.

Institucionet që kryejnë aktivitetin dhe të cilat janë vendosur në qendrën e qarkut janë: ministritë dhe agjencitë qendrore, Drejtoria e Bujqësisë, Bordi i Kullimit, Drejtoria Rajonale e AKU-së, Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë Drejtoria e Arsimit; Drejtoria Rajonale e Punësimit; Zyra e Kujdesit Social, Inspektorati Shtetëror i Punës; Drejtoria e Shërbimit Pyjor; Gjykata e Apelit; Prokuroria e Apelit, Drejtoria e Policisë, SHISH, Dega e Thesarit, Drejtoria Rajonale Tatimore.

Pikërisht për këtë arsye, duke iu referuar ndërveprimit institucional, përqendrimit të popullsisë dhe bizneseve, si dhe ndërveprimit mes këtyre të fundit, në qarkun e Gjirokastrës identifikojmë zona funksionale me qendra si **Gjirokastra, Tepelena, Përmeti dhe Dropulli bashkë me Pogonin.**


Figura 01: Harta e zonave funksionale në qarkun e Gjirokastrës



Lëvizjet për punësim

Siç e kemi përmendur edhe në kapitujt e tjerë, vihet re se në qendrën e zonës funksionale përqendrimi i bizneseve është më i lartë, ndërsa me largimin prej kësaj qendre e në mungesë të një niveli të mjaftueshëm shërbimesh aktivitetet unifikohen duke u fokusuar vetëm te shërbimet. Kjo tendencë konfirmohet prej hartës që përmbledh flukset kryesore të lëvizjeve të të punësuarve, niveli i shkëmbimeve në lidhje me punësimin dhe shërbimet.

Figura 02 Lëvizjet për punësim



Qendrat urbane brenda kësaj zone funksionale ofrojnë infrastrukturën, shërbimet dhe punësim, ndërkohë që qendrat rurale përreth tyre furnizojnë produkte bujqësore dhe kryesisht fuqi punëtore.

Krijimi i një njësie të re vendore duke iu referuar kufijve të zonës funksionale të propozuar do të ndikojë në një rishpërndarje më e mirë të shpenzimeve vendore, shërbimeve dhe efikasitetit në ofrimin e këtyre shërbimeve.

Zona funksionale Gjirokastrë

Rrethi i Gjirokastrës ka popullsi të përgjithshme prej rreth 36 000 banorësh dhe ka një qendër urbane kryesore, qytetin e Gjirokastrës, i cili është qartësisht qendra kryesore e zhvillimit ekonomik të rrethit. Qendra tjetër urbane në Gjirokastrë është Libohova: kjo e fundit ka traditë të fortë, por nuk ka zhvillim të krahasueshëm me Gjirokastrën. Për këtë arsye, rrethi i Gjirokastrës është studiuar duke u bazuar vetëm në një zonë funksionale. Rrethi i Gjirokastrës ka edhe dy komuna shumica e popullsisë së të cilave u përket pakicave etnike: Dropulli i Poshtëm dhe Dropulli i Sipërm. Këto dy komuna nuk do të trajtohen si pjese e zonës funksionale Gjirokastrë për t'u dhënë mundësinë e vetëqeverisjes në përputhje me parimet ndërkombëtare.

Zona Gjirokastrë (bashkia Gjirokastrë, bashkia Libohovë, komunat Cepo, Lazarat, Libohovë, Lunxhëri, Odrie, Picar, Pogon)

Sipas të dhënave të Census-it të vitit 2011, kjo zonë funksionale ka një popullsi rreth 32 772 banorë dhe përbëhet nga 11 njësi ekzistuese (9 komuna dhe 2 bashki). Dendësia mesatare në zonën funksionale është 27 banorë për km², në krahasim me 16 banorë për km² që është vlera mesatare e dendësisë në njësitë ekzistuese. Duhet theksuar që rrethi i Gjirokastrës ka një relief kryesisht malor, çka shpjegon edhe dendësinë relativisht të ulët të popullsisë

Vështrim i gjendjes ekonomike, financiare dhe administrative

Zhvillimi ekonomik dhe të dhënat ekonomike financiare

Sektorët dominues në ekonominë e rajonit të Gjirokastrës janë ata të tregtisë dhe shërbimeve, si edhe sektori i pasurive të paluajtshme dhe financiar. Bujqësia prodhon rreth 30% të vlerës së shtuar për të gjithë rajonin. Ndonëse nuk disponohen të dhëna më të detajuara në nivel njësie vendore, konfigurimi i zonës funksionale të re sugjeron se me përjashtim të bashkisë së Gjirokastrës, pjesa më e madhe e njësive të reja të përfshira kanë karakter bujqësor.


Kjo hipotezë mbështetet edhe nga të dhënat mbi shpërndarjen e bizneseve në këto zona. Zona funksionale Gjirokastrë ka gjithsej 1397 biznese, nga të mbi 80% e të cilave janë të vendosura në qytetin e Gjirokastrës. Më pak se 30% e të punësuarve në zonë, me përjashtim të qytetit të Gjirokastrës, veprojnë në sektorin e bujqësisë, ndërkohë që ndërtimi dhe shërbimet punësojnë një përqindje të lartë të popullsisë.

Tabela 70: Shpërndarja e bizneseve dhe bizneset për frymë

Rrethi	Njësia	B/K	Nr. i bizneseve	Biznese për 1000 banorë
Gjirokastër	Antigonë	K	16	16
Gjirokastër	Cepo	K	37	21
Gjirokastër	Gjirokastër	K	1177	59
Gjirokastër	Lazarat	K	50	18
Gjirokastër	Libohovë	K	24	12
Gjirokastër	Lunxhëri	K	28	14
Gjirokastër	Odrie	K	19	44
Gjirokastër	Picar	K	22	23
Gjirokastër	Pogon	K	6	14
Gjirokastër	Qendër Libohovë	K	13	10
Gjirokastër	Zagorie	K	5	12
Gjithsej në ZF-në e Gjirokastrës			1397	43

Burimi: INSTAT

Figura 141: Numri i bizneseve për 1000 banorë



Burimi: Llogaritjet e autorëve

Siç shihet nga të dhënat, shumica e njësive në zonën funksionale në shqyrtim kanë numër të ulët biznesesh për 1000 banorë. Kujtojmë se kjo është një zonë kryesisht bujqësore, me përjashtim të bashkisë së Gjirokastrës. Bizneset për 1000 banorë në njësitet e veçanta variojnë nga 10 (Qendër Libohovë) deri në 59 në Gjirokastër. Mesatarisht, përpara bashkimit, në këto 11 njësi ka më pak se 22 biznese për 1000 banorë. Ndërkohë, në zonën funksionale ky tregues rritet në 43 biznese për 1000 banorë për të gjithë zonën funksionale.

Të dhëna buxhetore

Në vitin 2012, të gjitha njësitë e zonës kanë një buxhet (të ardhura) prej rreth 488 milionë lekësh. Nga këto, rreth 48% ose 236 milionë janë siguruar në bashkinë e Gjirokastrës, e cila siguron edhe 82% të të ardhurave të zonës funksionale.


Tabela 71: Të dhëna buxhetore për zonën funksionale Gjirokastrë

	Të ardhurat totale	Të ardhurat e veta	Shpenzime totale
Antigonë	14 249	3464	10 000
Cepo	28 691	4975	18 000
Gjirokastrë	236 239	149 209	202 000
Lazarat	26 426	4541	14 000
Libohovë	21 048	2760	18 000
Lunxhëri	22 385	6352	18 000
Odrë	17 323	459	6000
Picar	28 730	3069	14 000
Pogon	22 240	3206	13 000
Qendër Libohovë	15 177	2240	15 000
Zagorie	55 755	1150	10 000
Gjithsej në ZF	488 264	181 424	338 000

Burimi; Llogaritjet e autorëve

Po të vërejmë të ardhurat për frymë, shohim se mesatarja e të ardhurave të veta për frymë për të gjitha njësitë është 3300 lekë. Pas bashkimit, ky tregues rritet në 5536 lekë për frymë për të gjithë zonën funksionale ose është 40% më i lartë se mesatarja dhe 50% më i lartë se mediani i të ardhurave për frymë në njësitë ekzistuese.

Figura 142: Të ardhurat e veta për frymë në zonën funksionale Gjirokastrë




Burimi; Llogaritjet e autorëve

Ndërkohë, situata paraqitet disi më e ndryshme për treguesit e të ardhurave totale të njërive: Mesatarja e të ardhurave për frymë në zonën funksionale pëson njëfarë rënijeje në krahasim me mesataren e njërive individuale. Kjo shpjegohet me faktin se njësitë më të vogla

subvencionohen më shumë nga buxheti i shtetit, duke rezultuar në të ardhura të larta për frymë.


Figura 143: Të ardhurat për frymë në zonën funksionale Gjirokastrë



Të dhëna rreth shpenzimeve

Po të vërejmë shpenzimet për frymë, të dhënat janë të ngjashme:

Figura 144: Shpenzimet për frymë



Burimi: Llogaritjet e autorëve

Shpenzimet për frymë në zonën funksionale Gjirokastrë do të ishin rreth 10 314 lekë; pra afërsisht sa mediani i shpenzimeve për frymë në njësitë ekzistuese, duke siguruar një shpërndarje më të mirë të fondeve.

Tabela 72: Të ardhurat dhe shpenzimet për frymë në zonën funksionale Gjirokastër

	Të ardhura për frymë	Të ardhurat e veta për frymë	Shpenzime për frymë
Antigonë	14 277	3471	10 020
Cepo	16 613	2880	10 423
Gjirokastër	11 910	7522	10 184
Lazarat	9435	1621	4998
Libohovë	10 566	1385	9036
Lunxhëri	11 533	3273	9274
Odrie	40 008	1059	13 857
Picar	30 662	3275	14 941
Pogon	51 482	7421	30 093
Qendër Libohovë	12 007	1772	11 867
Zagorie	135 658	2799	24 331
ZF gjithsej	14 899	5536	10 314

Burimi: Llogaritjet e autorëve


Njësitë shpenzojnë mesatarisht 51% të buxhetit për shpenzime personeli, nga të cilat shpenzimet minimale bëhen nga komuna Picar (29%) dhe ato maksimale nga komuna Odrie (67%). Duke marrë parasysh kursimet e parashikuara të cilat do të trajtohen më poshtë, treguesi i shpenzimeve administrative për zonën ulet në 41%.

Tabela 73: Struktura e shpenzimeve në zonën funksionale Gjirokastër

	Shpenzimet totale	Shpenzi met për personel in	Shpenzimet operative të tjera	Investimet e 2012	Shpenzime për persone lin si % e totalit	Inv. si % e totalit	Shpenzimet tjera operative si % e totalit
Antigonë	10 000	5000	2000	3000	50%	20%	30%
Cepo	18 000	6000	4000	8000	33%	22%	44%
Gjirokastër	202 000	115 000	69 000	18 000	57%	34%	9%
Lazarat	14 000	5000	3000	6000	36%	21%	43%
Libohovë	18 000	6000	8000	4000	33%	44%	22%
Lunxhëri	18 000	8000	3000	7000	44%	17%	39%
Odrie	6000	4000	2000	0	67%	33%	0%
Picar	14 000	4000	3000	7000	29%	21%	50%
Pogon	13 000	5000	3000	5000	38%	23%	38%
Qendër Libohovë	15 000	8000	4000	3000	53%	27%	20%
Zagorie	10 000	6000	4000	0	60%	40%	0%
Mesatare	338 000	172 000	105 000	61 000	51%	31%	18%
Gjithsej ZF Gjirokastër*	338 000	137 800	94 500	105 700	41%	28%	31%

*Të dhënat për ZF Gjirokastër janë nxjerrë bazuar në supozimin se do të kursethet rreth 60% e shpenzimeve administrative dhe 10% e shpenzimeve të tjera operative të njësisve që suprimohen

Figura 145: Struktura e shpenzimeve në zonën funksionale, krahasuar me mesataren e njësisive ekzistuese.



Burimi: Llogaritjet e autorëve

Treguesit e investimeve

Treguesit e investimeve vrojtohen më mirë në një periudhë të gjatë kohore. Në këtë rast, janë shqyrtuar të dhënat gjatë një periudhe pesë vjeçare dhe këto të dhëna tregojnë se niveli i investimeve në këtë zonë ka qenë mjaft i ulët. Veçanërisht në qytetin e Gjirokastrës, në këto pesë vjet janë investuar vetëm 15% e të ardhurave totale, gjë që mund të jetë tregues i vështirësive financiare të këtyre viteve. Po të supozojmë se ritmi i investimeve do të ishte ulur në masën e kursimit nga shpenzimet administrative, pesha e investimeve ndaj buxhetit total të zonës funksionale do të rritej mesatarisht nga 21% në 37% .

Figura 146: Investimet si përqindje e buxhetit total në zonën funksionale dhe njësitë ekzistuese

	Investime 2008 - 2012	Të ardhurat 2008 - 2012	Investimet si % e të ardhurave totale 2008 - 2012
Antigonë	36 057	68 483	53%
Cepo	33 028	182 941	18%
Gjirokastrë	227 321	1 545 889	15%
Lazarat	98 563	194 600	51%
Libohovë	44 325	172 316	26%
Lunxhëri	37 725	178 666	21%
Odrie	41 836	61 525	68%
Picar	20 765	115 653	18%
Pogon	15 195	97 761	16%
Qendër Libohovë	48 065	92 434	52%
Zagorie	2114	106 201	2%
Mesatare	604 994	2 816 468	21%
Zona funksionale	1 028 490	2 816 468	37%

Burimi: Llogaritjet e autorëve

Analiza e efekteve administrative

Bashkimi i njësive në një zonë funksionale do të rezultojë në kursime, veçanërisht nga shpenzimet e personelit dhe një pjesë e shpenzimeve operative për mirëmbajtjen e zyrave. Në veçanti, në dhjetë nga njëmbëdhjetë njësitë e zonës funksionale do të shkurtohen pozicionet e kryetarit dhe të kabinetit të tij; shpenzimet për shpërblimet e këshilltarëve. Gjithashtu, shkurtime të mëtejshme të shpenzimeve do të rezultojnë nga realizimi i asaj që rëndom quhet si *economy of scope* (ekonomia e qëllimit), më konkretisht nga shkurtimi i funksioneve të përsëritura administrative, të cilat do të përqendrohen në njësinë administrative të zonës funksionale. Të tilla pozicione janë Sektori i Menaxhimit Financiar (specialistët e financës dhe buxhetit); Sektori i Prokurimeve dhe Sektori i Auditit Financiar, por edhe Sektori i Urbanistikës. Nga llogaritë paraprake të kursimit të mundshëm rezulton se nga bashkimi mund të kursehen rreth 60% - 70% e kostove për personelin dhe rreth 10% e shpenzimeve për mirëmbajtjen e zyrave. Përlllogaritjet e mëposhtme janë bazuar mbi këtë model.

Tabela 74: Kursimet nga shpenzimet për personelin dhe mirëmbajtjen

	Kursimi nga personeli 60%)	Kursimi nga zyrat (10%)
Antigonë	3000	200
Cepo	3600	400
Gjirokastrë		
Lazarat	3000	300
Libohovë	3600	800
Lunxhëri	4800	300
Odrje	2400	200
Picari	2400	300
Pogon	3000	300
Qendër Libohovë	4800	400
Zagorie	3600	400
Gjithsej	34 200	3600
Kursimi si % e zërit përkatës	20%	3%
Kursimi si % e shpenzimeve totale	10%	1%

Burimi: INSTAT, Census 2011; Llogaritjet e autorëve

Me supozimet e bëra, pas bashkimit në zonën funksionale kursehen rreth 38 milionë lekë ose 11% e shpenzimeve totale të kryera nga të gjitha njësitë. Këto fonde të gjeneruara mund ta rrisin me mbi 50% përqindjen e buxhetit që caktohet për investime në këtë zonë.


Treguesit sociale

Arsimi dhe infrastruktura

Një tjetër kategori e rëndësishme e shërbimeve që ofrohen pjesërisht në nivel vendor e pjesërisht në atë qendror është arsimi. Sot, NJQV-të janë përgjegjëse për mirëmbajtjen e infrastrukturave arsimore. Në figurën më poshtë prezantohet pikërisht shpërndarja dhe cilësia e këtyre strukturave. Ajo që vihet re, pothuaj në secilin qark të ZF-së së propozuar, është se cilësia e dobët e infrastrukturave arsimore lidhet drejtpërdrejtë me gjenerimin e ulët të të ardhurave nga NJQV-të (kuptohet edhe si rezultat i nivelit të ulët të transfertave). Riorganizimi në një NJQV më të madhe, sipas zonës funksionale të propozuar, do të

rezultonte në efikasitet dhe shpërndarje më të mirë të fondeve në dispozicion. Madje, duke shkuar më tej dhe duke përdorur si argument kryesor parimin e subsidiaritetit, do të kishte kuptim edhe fakti që edhe pjesë të tjera të funksionit (siç mund të jetë emërimi i stafit dhe i drejtuesve, etj.) të jenë përgjegjësi e nivelit të qeverisjes vendore.


Figura 03: Harta e shpërndarjes së infrastrukturave të arsimit në Shqipëri dhe cilësia e infrastrukturës arsimore në ZF




Burimi: Ministria e Arsimit dhe Sportit, Interpretimi dhe paraqitja grafike nga ne

Niveli arsimor dhe faktori gjeografik

Situata e arsimit në Gjirokastrë paraqitet me dy veçori të dukshme urbane dhe rurale. Ndërsa në qytetin e Gjirokastrës presioni qëndron dukshëm mbi arsimin parashkollor dhe mbi atë 9-vjeçar, në zonat e tjera vihet re një numër tejet i ulët i fëmijëve për edukator dhe mësues. Në përgjithësi, numri i fëmijëve për mësues në shkollat 9-vjeçare varion nga 5–16. Është interesante të nënvizohet se në krahina, të tilla si Odrije apo Zagorie, ky numër është minimal, 5 fëmijë për edukator dhe mësues, gjë që ilustron faktin e pranisë së kufizuar të fëmijëve në këto zona si pasojë e migrimit. Në të vërtetë, kjo përputhet dhe me të dhënat e Census-it ku Gjirokastra shquhet si një qark me popullsi në rënie dhe në plakje.



Duke parë shpërndarjen e popullsisë sipas nivelit arsimor dhe duke e lidhur atë edhe me distancën nga qendra e zonës, qyteti i Gjirokastrës, mund të bëhet një analizë sipërfaqësore e ofertës në tregun e punës dhe e aftësive të shprehura me nivelin arsimor. Ndarja urbane-rurale shprehet qartë me ekzistencën e një numri më të vogël të personave me arsim bazë dhe e një numri më të lartë me arsim të lartë në qytet. Largësia nga qendra nuk shpreh ndonjë gjetje të veçantë e duket se ofron një korrelacion standard me nivelin arsimor, me përjashtim të Libohovës ku distanca e largët nga Gjirokastra (25 km) shoqërohet me numër më të madh të personave me arsim bazë.



Shëndetësia

Në Gjirokastrë gjendet 1 spital; ndërkohë që shpërndarja e qendrave shëndetësore sipas komunave dhe bashkive është si më poshtë:

Gjirokastrë	Total MPF	Total MS
Bashkia Gjirokastrë		
Q.SH. Gjirokastrë	9	1
Bashkia Libohovë	0	0
Q.SH.Libohovë	2	0
Komunat e Gjirokastrës		
Q.SH. Libohovë	1	0
Q.SH. Odrije	1	1
Q.SH. Lunxhëri	1	0
Q.SH. Antigone	1	0
Q.SH. Lazarat	1	0
Q.SH. Cepo	2	0
Q.SH. Picar	1	0
Q.SH. Dropull i Poshtëm	2	0
Q.SH. Dropull i Sipërm	2	0
Q.SH. Pogone	1	0
Q.SH. Zagori	1	0
Total	25	2

Numri i mjekëve për 10 000 banorë

Komunat/Bashkia	B/K	Popullsia 2011	Dendësia	Nr. I mjekëve	10 000 banorë
Zona funksionale					
Antigonë	K	998	35	1	10
Cepo	K	1727	15	2	12
Gjirokastrë	B	19 836	451	46	23
Lazarat	K	2801	67	1	4
Libohovë	B	1992	86	1	5
Lunxhëri	K	1941	24	1	5
Odrie	K	433	2	2	46
Picar	K	937	7	1	11
Qendër Libohovë	K	1264	11	2	16
Zagorie	K	411	3	1	24
Gjithsej		32 340		58	18

Shërbimet sociale

Për sa i përket shpërndarjes së shërbimeve sociale, edhe për qarkun Gjirokastrë vërehet i njëjti trend i përgjithshëm i përqendrimit të shërbimeve në qendrat e mëdha urbane, ku pjesa më e madhe gjenden në Gjirokastrë dhe vetëm dy qendra në Tepelenë. Ndërkohë zonat rurale mbeten të pambuluara nga këto shërbime e banorët duhet të udhëtojnë drejt qendrës urbane më të afërt për t'i marrë ato.

Gjithashtu, vihet re që peshën kryesore të shërbimeve sociale e mbajnë ofruesit jopublikë, OJQ-të, ndërsa kategoritë e shërbimeve janë të kufizuara dhe jo detyrimisht ndikohen nga nevojat e komunitetit të cilit i shërbehet, por nga axhendat e donatorëve, të cilët janë dhe mbështetësit kryesorë të tyre. Nga këndvështrimi rajonal, qarku i Gjirokastrës ka dhe përqindjen më të lartë të personave me aftësi të kufizuara, me 8,0%. Ky tregues ndikohet nga lidhja e ngushtë midis aftësisë së kufizuar dhe moshës (sidomos pas moshës 50-vjeçare), e pikërisht Gjirokastra veçohet për shkak të numrit të madh të popullsisë mbi moshën 65 vjeç. Ndërkohë që sipas informacioneve rreth institucioneve e shërbimeve sociale, ky shërbim mungon në nivel qarku. Nga ana tjetër, Gjirokastra është qarku i dytë, pas Elbasanit, që ka ngritur shërbim social në varësi të qarkut.

Njësitë më të mëdha të pushtetit vendor kanë ngritur dhe i financojnë vetë shërbimet sociale. Strukturat rajonale, në mënyrën si janë të strukturuar aktualisht nuk kanë fuqi të krijojnë fonde nga burimet e tyre. Për rrjedhim ato nuk kanë buxhete të mjaftueshme për të realizuar analiza të hollësishme të nevojave, për të përpiluar plane koherente dhe nuk kanë as shërbime mbështetëse të tyre apo në emër të njërive të pushtetit vendor në përbërje të tyre. Burimet e jashtme të financimit janë gjithashtu të rralla: buxheti për mbrojtjen sociale i pushtetit qendror dominohet nga programi i ndihmës ekonomike (pagesat me para në dorë), ndërsa fondet për shërbimin social janë të kufizuara të financimi i shërbimeve rezidenciale në kurriz të shërbimeve me bazë komunitare dhe familjeje. Shërbimet e reja novatore zakonisht krijohen me fondet e donatorëve dhe shpesh nuk janë të qëndrueshme.


Argumenti kryesor është që komunat nuk kanë as kapacitetet financiare e as ato njerëzoret për të ofruar shërbime sociale. Riorganizimi territorial pritet të ndikojë ndjeshëm në ofrimin e drejtë të shërbimeve, duke i dhënë prioritet mbulimit të zonave rurale. Reforma territoriale ofron një mundësi pozitive për planifikimin social lokal në një shkallë më të gjerë dhe me role dhe përgjegjësi të qarta. Nëse qarku do të mbetet qoftë dhe me numra të reduktuar, roli i tyre duhet të rishikohet tërësisht, sidomos në lidhje me vlerësimin e nevojave dhe planifikimin e shërbimeve sociale dhe me përgatitjen e tyre për të ofruar shërbime të specializuara, të cilat mundësohen vetëm në shkallë të gjerë.

Tregues të tjerë që hedhin dritë mbi situatën social-ekonomike të Gjirokastrës

Ndihma Ekonomike: Një këndvështrim tjetër që ka të bëjë me nivelin e varfërisë është edhe shpërndarja e ndihmës ekonomike. Në zonën e Gjirokastrës, e cila si qark nuk hyn tek ata më të varfrit në Shqipëri, gjithsesi vihen re xhepa varfërie ku përqindja e familjeve që marrin asistencë është pak më e lartë në krahasim me të tjerat. Komuna e Cepos dhe deri diku ajo e Zagories janë ato që veçohen në kuadër të këtij treguesi që sidoqoftë, siç kemi parë dhe në argumentet e tjera, nuk ndikohet në mënyrë të njëtrajtshme nga distanca nga qyteti.

Kategoria e Shërbimit	Ofrues publik	Ofrues jopublik
Shërbime sociale për të moshuar	2	0
Shërbime sociale për gra dhe vajza	0	0
Shërbime sociale për fëmijët	1	3
Shërbime sociale për familjet dhe komunitetet	0	1
Shërbime sociale për PAK	0	0
Shërbime sociale për të rinjtë me probleme sociale	0	1
Gjithsej	3	5


Shërbimet e tjera: Ndërkohë që kryesisht vihet re një përqindje e lartë e familjeve që kanë akses në furnizim me ujë dhe në rrjetin e ujërave të zeza, në disa raste të veçanta si në Pëcar, ky tregues është tejet i ulët (40%). Zagoria, Odria dhe Cepo janë tre komunat e tjera të cilat ndodhen me nivele më të ulëta se të tjerat si për furnizimin me ujë ashtu dhe për aksesin në shërbimin e ujërave të zeza. Tregues të tjerë të cilët mund të hedhin dritë përsëri për lëvizshmërinë dhe komunikimin janë numri i makinave dhe aksesin në internet, si edhe telefonia fikse dhe ajo celulare. Ndërkohë përveç dy ekstremeve, Zagorisë (18%) dhe Lazaratit (67%), gama e makinave për familje varion nga 23 deri në 40 %. Për sa i përket aksesit në telefoninë fikse, ai është më i lartë. Për t'u veçuar është fakti që aksesin në internet është tejet i ulët. Përveç Gjirokastrës (19%) dhe Libohovës (15%), aksesin në internet raportohet të jetë tejet i ulët (nga 0–6%).



Distanca e njësive të përthithura me qendrën/njësinë e re

Sikurse ilustron dhe në hartën e mëposhtme, koha mesatare e udhëtimit drejt qendrës së zonës funksionale, bashkia Gjirokastrë, është rreth 26 min. Krijimi i kësaj zone funksionale me më pak njësi rreth qendrës, rrit mundësinë e ndërveprimit të qytetarëve me njësinë e qeverisjes vendore dhe aksesin në shërbime dhe tregje.

Figura 0.4: Harta e distancave kohore



Përfundime

Zona funksionale Gjirokastrë (bashkia Gjirokastrë, komunat Cepo, Lazarat, Picar)

ZF Gjirokastrë ka një popullsi prej 32 340 banorësh, mesatarisht 3234 banorë për njësi

Njësitë vendore nuk reflektojnë peshën e ndryshimeve demografike: krahasuar me vitin 2001 Gjirokastra ka humbur rreth 26% të popullsisë, Përmeti 35% dhe Tepelena 39% të popullsisë.

Shpenzimet administrative reduktohen (paga dhe të tjera operative) me rreth 40 milionë lekë ose 12% e shpenzimeve totale të kryera nga të gjitha njësitë.

Shpenzimet për pagat ulen nga 167 milionë në 130,6 milionë lekë në vit. Shpenzimet e personelit për frymë do të ulëshin nga 5164 lekë në 4038 lekë për banor në njësinë e re

Buxheti i investimeve rritet me mbi 70%, nga 56 milionë në vit në 95,7 milionë lekë në vit

Investimet për frymë rriten nga 1732 lekë në 2959 lekë çdo vit në njësinë e re

Të ardhurat e veta për frymë për të gjitha njësitë aktualisht janë 3300 lekë; pas bashkimit ato rriten në 5536 lekë për frymë për të gjithë zonën funksionale ose 40% më të larta se mesatarja dhe 50% më të larta se mediani i të ardhurave për frymë në njësitë ekzistuese.

Përfundimet e mëposhtme janë llogaritur për ZF Libohovë si njësi funksionale që qëndron më vete jashtë ZF Gjirokastrë.

ZF Libohovë (Bashkia Libohovë dhe komunat Lunxhëri, Odrie, Qendër Libohovë; Zagori, Antigone)

ZF Libohovë e përbërë nga 6 njësi ekzistuese, ka popullsi prej 7,039 banorë, nga mesatarisht 1,173 banorë aktualisht në NJQV ekzistuese

Reduktim i shpenzimeve administrative të njësisë me rreth 23,2 milionë lekë në vit, ose 39% e shpenzimeve administrative (shpenzime paga dhe operative) dhe 28% e shpenzimeve vjetore gjithsej

Ulja e shpenzimeve të personelit për banor në masën 60%, nga 5,256 lekë në 2,174 lekë për banor

Mirëadministrimi i burimeve financiare mund të sjellë rritje të investimeve mbi dyfish, ose nga 17 milionë lekë, në 40,2 milionë lekë në vit

Investimet për banor mund të rriten nga 2,415 lekë, në 5,711 lekë për banor në njësinë e re

Bashkimi në një zonë funksionale mund të sigurojë rishpërndarje më të mirë të të ardhurave duke zbutur pabarazitë mes zonave; pa llogaritur efektet e eficiencës së rritur në menaxhimin e të ardhurave: mesatarisht ZF e re do të realizonte 2,333 lekë të ardhura të veta për frymë, ose 2% më shumë se mesatarja në njësitë ekzistuese (2,293 lekë); si edhe të mundësonte planifikim më të mirë strategjik.

Zona funksionale Përmet

Rrethi i Përmetit

Rrethi i Gjirokastrës ka një popullsi të përgjithshme rreth 16 727 banorë dhe ka një qendër urbane kryesore, qytetin e Përmetit, i cili është qartësisht qendra kryesore e zhvillimit ekonomik të rrethit. Qendra tjetër urbane në Përmet është Këlcyra, e cila është një zonë me traditë të fortë, por nuk ka zhvillim të krahasueshëm me Përmetin. Për këtë arsye, rrethi i Përmetit është studiuar vetëm në një zonë funksionale.

Zona funksionale Përmet

Zona funksionale Përmet (bashkia e Përmetit, Këlcyra, komunat Ballaban, Çarshovë, Dëshnicë, Frashër, Petran, Qendër Piskovë, Sukë)

Sipas të dhënave të Census-it të vitit 2011, kjo zonë funksionale ka një popullsi prej rreth 16 727 banorësh dhe përbëhet nga 10 njësi ekzistuese (8 komuna dhe 2 bashki). Dendësia mesatare në zonën funksionale është 14 banorë për km², pak më e lartë se 12 banorë për km² që është dendësia mesatare në njësitë ekzistuese. Duhet theksuar që rrethi i Përmetit ka një relief kryesisht malor, çka shpjegon edhe dendësinë relativisht të ulët të popullsisë.

Vështrim i gjendjes ekonomike, financiare dhe administrative

Zhvillimi ekonomik dhe të dhënat ekonomike financiare

Sektori dominues në ekonominë e rajonit të Përmetit është bujqësia, e cila punëson rreth 50% të të punësuarve të njërive, përveçme përjashtim të Përmetit. Ndonëse nuk disponohen të dhëna më të detajuara në nivel njësie vendore, konfigurimi i zonës funksionale të re sugjeron se me përjashtim të bashkisë së Përmetit, pjesa më e madhe e njërive të reja të përfshira kanë karakter bujqësor.


Kjo hipotezë mbështetet edhe nga të dhënat mbi shpërndarjen e bizneseve në këto zona. Zona funksionale Gjirokastrë ka 576 biznese gjithsej, mbi 60% e të cilave janë vendosur në qytetin e Përmetit.

Tabela 75: Shpërndarja e bizneseve dhe bizneset për frymë

Rrethi	Njësia	B/K	Nr. i bizneseve	Biznese për 1000 banorë
Gjirokastrë	Ballaban	K	12	11
Gjirokastrë	Çarshovë	K	19	21
Gjirokastrë	Dëshnicë	K	0	0
Gjirokastrë	Frashër	K	4	10
Gjirokastrë	Këlcyrë	K	124	47
Gjirokastrë	Përmet	K	354	60
Gjirokastrë	Petran	K	29	18
Gjirokastrë	Qendër Piskovë	K	23	13
Gjirokastrë	Sukë	K	11	9
Gjithsej ZF Përmet			576	34

Burimi: INSTAT

Figura 147 Numri i bizneseve për 1000 banorë



Burimi: Llogaritjet e autorëve

Siç shihet nga të dhënat, shumica e njësive në zonën funksionale në shqyrtim kanë numër të ulët të bizneseve për 1000 banorë. Kujtojmë se kjo është një zonë kryesisht bujqësore, me përjashtim të bashkisë Përmet. Numri i bizneseve për 1000 banorë në njësitë e veçanta varion nga 0 (Deshnicë) në 60 (Gjirokastrë). Mesatarisht, para bashkimit në këto 11 njësi gjenden 21 biznese për 1000 banorë. Ndërkohë, në zonën funksionale ky tregues rritet në 34 biznese për 1000 banorë për të gjithë zonën funksionale.

Të dhëna buxhetore

Në vitin 2012, të gjitha njësitë e zonës kanë një buxhet (të ardhura) prej rreth 321 milionë lekësh . Nga këto, rreth 24% ose 76 milionë janë siguruar nga bashkia e Përmetit, e cila siguron edhe 48% të të ardhurave të veta për zonën funksionale.

Tabela 76: Të dhëna buxhetore për zonën funksionale Përmet


	Të ardhurat totale	Të ardhurat e veta	Shpenzimet totale
Ballaban	15 644	2312	13 000
Çarshovë	31 391	2262	12 000
Deshnicë	24 846	1657	10 000
Frashër	23 053	876	21 000
Këlcyrë	30 536	9918	36 000
Përmet	75 929	25 541	56 000
Petran	65 239	5391	20 000
Qendër Piskovë	31 193	3901	15 000
Sukë	23 530	1808	11 000
Gjithsej ZF	321 360	53 666	194 000

Burimi; Llogaritjet e autorëve

Po të vërejmë të ardhurat për frymë, shohim se mesatarja e të ardhurave të veta për frymë për të gjitha njësitë është 2600 lekë. Pas bashkimit, ky tregues rritet në 3208 lekë për frymë për të

gjithë zonën funksionale, 20% më i lartë se mesatarja dhe 30% më i lartë se mediani i të ardhurave për frymë në njësitë ekzistuese.


Figura 148: Të ardhurat e veta për frymë në zonën funksionale Gjirokastrë



Burimi; Llogaritjet e autorëve

Ndërkohë, situata paraqitet disi më e ndryshme në lidhje me të ardhurat totale të njërive: Mesatarja e të ardhurave për frymë në zonën funksionale pëson njëfarë rënieje në krahasim me mesataren e njërive individuale. Kjo shpjegohet me faktin se njësitë më të vogla subvencionohen në masë shumë të madhe nga buxheti i shtetit, duke rezultuar në të ardhura të larta për frymë.

Figura 149: Të ardhurat për frymë në zonën funksionale Përmet




Burimi; Llogaritjet e autorëve

Të dhëna rreth shpenzimeve

Po të vërejmë shpenzimet për frymë, të dhënat janë të ngjashme:

Figura 150: Shpenzimet për frymë



Burimi: Llogaritjet e autorëve

Shpenzimet për frymë në zonën funksionale Përmet do të ishin rreth 11 598 lekë; pra afërsisht sa mediani i shpenzimeve për frymë në njësitë ekzistuese, duke siguruar një shpërndarje më të mirë të fondeve.

Tabela 77: Të ardhurat dhe shpenzimet për frymë në zonën funksionale Përmet

	Të ardhura për frymë	Të ardhurat e veta për frymë	Shpenzime për frymë
Ballaban	14 941	2208	12 416
Çarshovë	34 195	2464	13 072
Deshnicë	21 437	1430	8628
Frashër	59 569	2263	54 264
Këlcyrë	11 519	3741	13 580
Përmet	12 772	4296	9420
Petran	40 221	3323	12 330
Qendër Piskovë	17 906	2240	8611
Sukë	18 734	1439	8758
ZF gjithsej	19 212	3208	11 598

Burimi; Llogaritjet e autorëve

Njësitë shpenzojnë mesatarisht 47% të buxhetit për shpenzime personeli, ku shpenzimet minimale përfaqësohen nga komuna Deshnicë (20%) dhe ato maksimale nga vetë bashkia e Përmetit me 61%. Duke marrë parasysh kursimet e parashikuara që do të trajtohen më poshtë, treguesi i shpenzimeve administrative për zonën ulet në 29%.


Tabela 78: Struktura e shpenzimeve në zonën funksionale Përmet

	Shpenzim et totale	Shpenzim et për personelin	Shpenzim e operative te tjera	Investim e 2012	Shpenzim et për personelin si % e totalit	Investim et si % e totalit 2012	Shpenzim e operative të tjera si % e totalit
Ballaban	13 000	6000	2000	5000	46%	15%	38%
Çarshovë	12 000	6000	3000	3000	50%	25%	25%
Deshnicë	10 000	2000	4000	4000	20%	40%	40%
Frashër	21 000	9000	8000	4000	43%	38%	19%
Këlcyrë	36 000	13 000	10 000	13 000	36%	28%	36%
Përmet	56 000	34 000	22 000	0	61%	39%	0%
Petran	20 000	8000	4000	8000	40%	20%	40%
Qendër Piskovë	15 000	7000	4000	4000	47%	27%	27%
Sukë	11 000	6000	2000	3000	55%	18%	27%
Mesatare	194 000	91 000	59 000	44 000	47%	30%	23%
Gjithsej ZF Përmet*	194 000	56 800	55 300	81 900	29%	29%	42%

Burimi; Llogaritjet e autorëve

*Të dhënat për ZF-në Përmet janë nxjerrë bazuar në supozimin se do të kursehet rreth 60% e shpenzimeve administrative dhe 10% e shpenzimeve të tjera operative të njërive që suprimohen

Figura 151: Struktura e shpenzimeve në zonën funksionale krahasuar me mesataren e njërive ekzistuese



Burimi: Llogaritjet e autorëve

Treguesit e investimeve

Treguesit e investimeve vrojtohen më mirë në një periudhë të gjatë kohore. Në këtë rast janë shqyrtuar të dhënat për gjatë një periudhe pesë vjeçare, të cilat tregojnë se niveli i investimeve në këtë zonë ka qenë relativisht i mirë në krahasim me nivelin mesatar kombëtar. Po të supozojmë se ritmi i investimeve do të ishte ulur në masën e kursimit nga shpenzimet administrative, pesha e investimeve ndaj buxhetit total të zonës funksionale do të rritej në 61%, nga 44% mesatarisht.

Tabela 11: Investimet si përqindje e buxhetit total në zonën funksionale dhe njësitë ekzistuese

	Investime 2008 - 2012	Të ardhurat 2008 - 2012	Investimet si % e të ardhurave totale 2008 - 2012
Ballaban	43 956	138 620	32%
Çarshovë	57 652	144 078	40%
Deshnicë	46 503	142 650	33%
Frashër	65 929	90 629	73%
Këlcyrë	112 455	244 072	46%
Përmet	213 470	513 902	42%
Petran	110 629	179 837	62%
Qendër Piskovë	65 095	158 995	41%
Sukë	47 338	138 249	34%
Mesatare	763 026	1 751 033	44%
Zona funksionale	1 068 236	1 751 033	61%

Burimi; Llogaritjet e autorëve

Analiza e efekteve administrative

Bashkimi i njërive në një zonë funksionale do të rezultojë në kursime, veçanërisht nga shpenzimet e personelit dhe një pjesë e shpenzimeve operative për mirëmbajtjen e zyrave. Në veçanti, në dhjetë nga njëmbëdhjetë njësitë e zonës funksionale do të shkurtohen pozicionet e kryetarit dhe të kabinetit të tij dhe shpenzimet për shpërblimet e këshilltarëve. Gjithashtu, shkurtime të mëtejshme do të rezultojnë nga realizimi i asaj që rëndom quhet si *economy of scope* (efekti i bashkimit), më konkretisht nga shkurtimi i funksioneve administrative të përsëritura, të cilat do të përqendrohen në njësinë administrative të zonës funksionale. Të tilla pozicione janë Sektori i Menaxhimit Financiar (specialistët e financës dhe buxhetit), Sektori i Prokurimeve dhe Sektori i Auditit Financiar, por edhe Sektori i Urbanistikës. Nga llogaritë paraprake të kursimit të mundshëm rezulton se nga bashkimi mund të kursehen rreth 60%-70% e kostove për personelin dhe rreth 10% e shpenzimeve për mirëmbajtjen e zyrave. Përlllogaritjet e mëposhtme janë bazuar mbi këtë model.

Tabela 79: Kursimet nga shpenzimet për personelin dhe mirëmbajtjen

	Kursimi nga shpenzimet për personelin 60%)	Kursimi nga shpenzimet për zyrat (10%)
Ballaban	3600	200
Çarshovë	3600	300
Deshnicë	1200	400
Frashër	5400	800
Këlcyrë	7800	1000
Përmet		
Petran	4800	400
Qendër Piskovë	4200	400
Sukë	3600	200
Gjithsej	34 200	3700
Kursimi si % e zërit përkatës	38%	6%
Kursimi si % e shpenzimeve totale	18%	2%

Burimi; Llogaritjet e autorëve



Me supozimet e bëra, në zonën funksionale Përmet, pas bashkimit, kursehen rreth 38 milionë lekë ose 20% e shpenzimeve totale të kryera nga të gjitha njësitë. Këto fonde të gjeneruara janë të përafërta me përqindjen e buxhetit që caktohet për investime në këtë zonë. Pra, teorikisht këto kursime administrative mund t'i rrisin pothuajse dyfish investimet.

Treguesit sociale

Arsimi dhe infrastruktura

Një tjetër kategori e rëndësishme e shërbimeve që ofrohen pjesërisht në nivel vendor e pjesërisht në atë qendror është arsimi. Sot NJQV-të janë përgjegjëse për mirëmbajtjen e infrastrukturave arsimore. Në figurën në vijim prezantohet pikërisht shpërndarja dhe cilësia e këtyre strukturave. Ajo që vihet re, pothuaj në secilin qark t ZF-së së propozuar, është se cilësia e dobët e infrastrukturave arsimore lidhet drejtpërdrejtë me gjenerimin e ulët të të ardhurave nga NJQV-të (kuptohet edhe si rezultat i nivelit të ulët të transfertave). Riorganizimi në një NJQV më të madhe, sipas zonës funksionale të propozuar, do të rezultonte në efikasitet dhe shpërndarje më të mirë të fondeve në dispozicion. Madje, duke shkuar më tej dhe duke përdorur si argument kryesor parimin e subsidiaritetit, do të kishte kuptim ideja që edhe pjesë të tjera të funksionit (siç mund të jetë emërimi i stafit dhe i drejtuesve, etj.) të jenë përgjegjësi e nivelit vendor të qeverisjes.


Figura 05: Harta e shpërndarjes së infrastrukturave të arsimit t në Shqipëri dhe cilësia e infrastrukturës arsimore në ZF




Burimi: Ministria e Arsimit dhe Sportit, Interpretimi dhe paraqitja grafike tonat

Niveli arsimor dhe faktori gjeografik

Në Përmet situata duket jo aq e njëtrajtshme dhe ndryshimet urbane–rurale janë disi të çrregullta. Për t’u përmendur është fakti që raportohet prani minimale edhe në arsimin bazë dhe kuptueshëm zvogëlim i numrit të individëve me arsim të lartë.





Shëndetësia

Përmeti ka një spital, ndërsa shpërndarja e qendrave shëndetësore është si më poshtë:

Përmet	Total MPF	Total MS
Bashkia Përmet	0	0
Q.SH. Përmet	4	1
Bashkia Këlcyrë	0	0
Q.SH. Këlcyrë	1	0
Totale në rreth	5	1
Komunat e Përmetit	0	0
Q.SH. Çarshovë	1	0
Q.SH. Petran	1	0
Q.SH. Piskovë	2	0
Q.SH. Deshnicë	2	0
Q.SH. Sukë	2	0
Q.SH. Ballaban	1	0
Q.SH. Frashër	1	0
Totali	20	2

Raporti i mjekëve për 10 000 banorë në zonën e re funksionale


Komuna/Bashkia	B/K	Popullsia 2011	Dendësia	Nr. i mjekëve	10 000 banorë
Antigonë	K	998	35	1	10
Cepo	K	1727	15	2	12
Gjirokastër	B	19 836	451	46	23
Lazarat	K	2801	67	1	4
Libohovë	B	1992	86	1	5
Lunxhëri	K	1941	24	1	5
Odrie	K	433	2	2	46
Picar	K	937	7	1	11
Qendër Libohovë	K	1264	11	2	16
Zagorie	K	411	3	1	24
Totali		32 340		58	18

Shërbimet sociale

Për sa u përket shërbimeve sociale, në zonën funksionale Përmet nuk ndodhet asnjë qendër shërbimi. Mbulimi me shërbime sociale është një sfidë për të gjithë territorin e vendit e janë duke u artikulluar masat përkatëse në bashkëpunim me shërbimet e tjera sociale, siç janë dhe Zyrat Rajonale të Punësimit. Ndarja në zona më të vogla do të ndihmojë në rritjen e funksionalitetit brenda zonave të reja, të cilat do të funksionojnë si satelitë rreth njësisë/ve kryesore historike ku përqendrohen edhe shërbimet. Masat që po ndërmerren në drejtim të shërbimeve të ndryshme sociale përfshijnë mbulimin e tërë territorit, duke i kushtuar vëmendje të veçantë zonave rurale në të cilat këto shërbime nuk ekzistojnë. Shkrirja e njësive vendore ofron mundësi për menaxhim më të mirë jo vetëm të burimeve financiare, por edhe të atyre ato njerëzore në drejtim të ofrimit të shërbimeve. Duke lehtësuar e rikompozuar sistemin e menaxhimit, do të mund të lehtësohen strukturat aktuale në zonat rurale, për t'u përqendruar më shumë në ofrimin e shërbimeve dhe vlerësimin e nevojave të komunitetit.

Tregues të tjerë hedhin dritë mbi aksesin në shërbime dhe situatën social-ekonomike:


Për sa i përket nivelit të varfërisë, situata në Përmet është qartazi disi më e komplikuar. Në fakt, në zonën e Përmetit, ndonëse largësia nga qendra nuk luan ndonjë rol thelbësor, vihen re nivele më të larta të varfërisë bazuar në shpërndarjen e ndihmës ekonomike. Ka komuna, të tilla si Petrani apo Frashëri, ku përqindja e familjeve që marrin ndihmë ekonomike arrin në rreth 30% ndërkohë që në përgjithësi kjo përqindje arrin deri në rreth 22–27%. Përyjashtim bën qyteti i Përmetit dhe komuna e Ballabanit ku shifrat janë më të ulëta (përkatësisht 8,2% dhe 10,8%).



Për sa i përket furnizimit me ujë dhe aksesit në shërbimin e kanalizimeve, situatë në Përmet rezulton të jetë disi problematike. Përveç Përmetit dhe Këlcyrës, zonat e tjera janë mbrapa për sa u përket këtyre treguesve dhe ka komuna, të tilla si Frashëri, ku familjet kanë vetëm 10% akses në furnizim me ujë dhe vetëm 5% e tyre ka akses në rrjetin e kanalizimeve. Po ashtu, edhe numri i makinave është i ulët, me përqindjen maksimale prej rreth 23% në Përmet. Situata është dramatike për sa i përket aksesit në telefoninë fikse dhe internet, ku mbulimi për këtë të fundit është minimal (13%) në Përmet, shumë i pakët në Këlcyrë (6%) dhe Petran (5%) dhe i papranishëm në zona të tjera. Shërbimi i telefonisë celulare është disi më i mirë dhe shifrat variojnë nga 24 – 28%.

Distanca e njësive të përthithura me qendrën

Figura 0.6: Harta e distancave kohore



Largësia mesatare në kohë udhëtimi me qendrën e zonës funksionale të propozuar, Përmet, është në rreth 30 minuta udhëtim, përveç rastit të Frashërit, i cili është i vetmi me një kohë udhëtimi mbi 1 orë (81 minuta).

Përfundime

Zona funksionale Përmet (bashkitë Përmet, komunat Çarshovë, Frashër, Petran, Qendër, Piskovë,)

ZF Përmet me një popullsi prej 16 727 banorësh, mesatarisht 1859 banorë për njësi

Shpenzimet administrative (paga dhe shpenzime të tjera operative) reduktohen me rreth 44 milionë lekë ose 22,5% e shpenzimeve totale të kryera nga të gjitha njësitë.

Shpenzimet për pagat ulen nga 91 milionë në 51 milionë lekë në vit. Shpenzimet për personelin për frymë do të ulëshin nga 5440 lekë në 3055 lekë për banor në njësinë e re

Buxheti për investimet do të rritej pothuajse dyfish, nga 44 milionë në 87,6 milionë lekë në vit.

Investimet për frymë rriten nga 2630 lekë në 5237 lekë në vit në njësinë e re

Përfundimet e mëposhtme janë llogaritur për ZF Këlcyrë si njësi funksionale që qëndron më vete jashtë ZF Përmet.

1. ZF Këlcyrë (Bashkia Këlcyrë dhe komunat Ballaban, Sukë, Dishnicë)

ZF Këlcyrë e përbërë nga 4 njësi ekzistuese, ka popullsi prej 6,113 banorë, nga mesatarisht 1,528 banorë aktualisht në NJQV ekzistuese;

Reduktim i shpenzimeve administrative të njësisë me rreth 10,6 milionë lekë në vit, ose 24% e shpenzimeve administrative (shpenzime paga dhe operative) dhe 14% e shpenzimeve vjetore gjithsej;

Ulja e shpenzimeve të personelit për banor në masën mbi 36%, nga 4,417 lekë në 2,814 lekë për banor;

Mirëadministrimi i burimeve financiare mund të sjellë rritje të investimeve me 42%, ose nga 25 milionë lekë, në 35,6 milionë lekë në vit

Investimet për banor mund të rriten nga 4,090 lekë, në 5,824 lekë për banor në njësinë e re;

Bashkimi në një zonë funksionale mund të sigurojë rishpërndarje më të mirë të të ardhurave duke zbutur pabarazitë e mëdha mes zonave; pa llogaritur efektet e eficiencës së rritur në menaxhimin e të ardhurave: mesatarisht ZF e re do të realizonte 2,568 lekë të ardhura të veta për frymë, ose 16% më shumë se mesatarja në njësitë ekzistuese (2,205 lekë) dhe 41% më shumë se median i të ardhurave për frymë në njësitë ekzistuese (1,824 lekë).

Zona funksionale Tepelenë

Rrethi i Tepelenës

Rrethi i Gjirokastrës ka një popullsi të përgjithshme prej rreth 19 606 banorësh dhe ka një qendër urbane kryesore: qytetin e Tepelenës, i cili është qartësisht qendra kryesore e zhvillimit ekonomik të rrethit. Qendra tjetër urbane në Tepelenë është Memaliaj, ndonëse këto dy qendra urbane janë mjaft pranë njëra tjetrës. Për këtë arsye, rrethi i Tepelenës është studiuar vetëm në një zonë funksionale.

Zona funksionale Tepelenë

Zona funksionale e Tepelenës (bashkitë Tepelenë dhe Memaliaj, komunat Buz, Fshat Memaliaj, Krahëz, Kurvelesh, Lopëz, Luftinjë, Qendër, Qesarat)

Sipas të dhënave të Census-it të vitit 2011, kjo zonë funksionale ka një popullsi prej 19 606 banorësh dhe përbëhet nga 10 njësi ekzistuese (8 komuna dhe 2 bashki). Dendësia mesatare e popullsisë në këtë zonë funksionale është 24 banorë për km², krahasuar me 20 banorë për km² që është dendësia mesatare në njësitë ekzistuese. Duhet theksuar që rrethi i Tepelenës ka kryesisht reliev -malor, çka shpjegon edhe dendësinë relativisht të ulët të popullsisë.

Vështrim mbi gjendjen ekonomike, financiare dhe administrative

Zhvillimi ekonomik dhe të dhënat ekonomike financiare


Zona funksionale Tepelenë ka gjithsej 451 biznese, mbi 60% e të cilave gjenden në qytetin e Tepelenës. Jashtë qendrave urbane pjesa më e madhe e popullsisë merret me bujqësi, ndërkohë që në qytete shumica e të punësuarve veprojnë në sektorin e shërbimeve.

Tabela 80 Shpërndarja e bizneseve dhe bizneset për frymë

Rrethi	Njësia	B/K	Nr. i bizneseve	Biznese për 1000 banorë
Gjirokastrë	Buz	K	8	8
Gjirokastrë	Fshat Memaliaj	K	11	11
Gjirokastrë	Krahëz	K	8	8
Gjirokastrë	Kurvelesh	K	13	13
Gjirokastrë	Lopez	K	6	6
Gjirokastrë	Luftinjë	K	4	4
Gjirokastrë	Memaliaj	K	29	29
Gjirokastrë	Qendër	K	8	8
Gjirokastrë	Qesarat	K	8	8
Gjirokastrë	Tepelenë	K	64	64
Gjithsej ZF Tepelenë			451	23

Burimi: INSTAT

Figura 152: Numri i bizneseve për 1000 banorë



Burimi: Llogaritjet e autorëve

Siç shihet nga të dhënat, shumica e njësive në zonën funksionale në shqyrtim kanë numër të ulët të bizneseve për 1000 banorë. Kujtojmë se kjo është një zonë kryesisht bujqësore, me përjashtim të qytetit të Tepelenës. Numri i bizneseve për 1000 banorë në njësitë e veçanta varion nga 4 biznese në Luftinjë deri në 64 në Tepelenë. Mesatarisht, para bashkimit në këto 11 njësi ka më pak se 16 biznese për 1000 banorë. Ndërkohë, në zonën funksionale ky tregues rritet në 23 biznese për 1000 banorë për të gjithë zonën funksionale.

Të dhëna buxhetore

Në vitin 2012, të gjitha njësitë e zonës kanë një buxhet (të ardhura) rreth 328 milionë lekë. Nga këto, rreth 24% ose 78 milionë janë siguruar nga bashkia e Tepelenës, e cila siguron edhe 35% të të ardhurave të veta për zonën funksionale.


Tabela 81: Të dhëna buxhetore për zonën funksionale Tepelenë

	Të ardhurat totale	Të ardhurat e veta	Shpenzimet totale
Buz	17 427	243	8000
Fshat Memaliaj	28 610	1765	9000
Krahëz	26 702	2356	10 000
Kurvelesh	19 039	1231	9000
Lopez	12 375	917	6000
Luftinjë	27 006	726	19 000
Memaliaj	51 241	4606	14 000
Qendër	32 413	5458	18 000
Qesarat	35 239	1552	7000
Tepelenë	78 170	10 354	91 000
Gjithsej ZF	328 223	29 206	191 000

Burimi: Llogaritjet e autorëve

Po të vërejmë të ardhurat për frymë, shohim se mesatarja e të ardhurave të veta për frymë për të gjitha njësitë është 1275 lekë. Pas bashkimit, kjo shumë rritet në 1490 lekë për frymë për të gjithë zonën funksionale ose do të jetë 15% më e lartë se niveli mesatar dhe 20% më e lartë se niveli mesatar i të ardhurave për frymë në njësitë ekzistuese.


Figura 153: Të ardhurat e veta për frymë në zonën funksionale Tepelenë



Burimi; Llogaritjet e autorëve

Ndërkohë, për sa u përket treguesve për të ardhurat totale të njësive, situata paraqitet disi më e ndryshme: Mesatarja e të ardhurave për frymë në zonën funksionale pëson njëfarë rënieje, krahasuar me mesataren të ardhurave për frymë të njësive individuale. Kjo shpjegohet me faktin se njësitë më të vogla subvencionohen më shumë nga buxheti i shtetit, duke rezultuar në të ardhura të larta për frymë.

Figura 154: Të ardhurat për frymë në zonën funksionale Tepelenë




Burimi; Llogaritjet e autorëve

Të dhëna mbi shpenzimet

Po të vërejmë shpenzimet për frymë, të dhënat janë të ngjashme:

Figura 155: Shpenzimet për frymë



Burimi: Llogaritjet e autorëve

Shpenzimet për frymë në zonën funksionale të Tepelenës do të ishin rreth 9742 lekë: pra, përkatësisht 8% dhe 28% më të larta se niveli mesatar dhe mediani i shpenzimeve për frymë në njësitë ekzistuese, duke siguruar një shpërndarje më të mirë të fondeve.

Tabela 82: Të ardhurat dhe shpenzimet për frymë në zonën funksionale Tepelenë

	Të ardhurat për fryme	Të ardhurat e veta për frymë	Shpenzimet për frymë
Buz	23 646	330	10 855
Fshat Memaliaj	17 814	1099	5604
Krahëz	10 455	922	3915
Kurvelesh	27 005	1746	12 766
Lopez	17 117	1268	8299
Luftinjë	15 574	419	10 957
Memaliaj	19 358	1740	5289
Qendër	10 196	1717	5662
Qesarat	25 554	1125	5076
Tepelenë	18 003	2385	20 958
ZF gjithsej	16 741	1490	9742

Burimi: Llogaritjet e autorëve


Njësitë shpenzojnë mesatarisht 38% të buxhetit për shpenzime personeli, ku shpenzimet minimale bëhen nga bashkia e Tepelenës dhe komuna Krahëz (20%) dhe shpenzimet maksimale nga komuna Lopez me 83%. Duke marrë parasysh kursimet e parashikuara që do të trajtohen më poshtë, përqindja e shpenzimeve administrative për zonën ulet në 21%..

Tabela 83: Struktura e shpenzimeve në zonën funksionale Tepelenë

	Shpenzim e totale	Shpenzim e për personelin	Shpenzim e operative të tjera	Investim e 2012	Shpenzim e për personelin si % e totalit	Investime t si % e totalit 2012	Shpenzim e operative të tjera si % e totalit
Buz	8000	6000	1000	1000	75%	13%	13%
Fshat Memaliaj	9000	5000	4000	0	56%	44%	0%
Krahëz	10 000	2000	3000	5000	20%	30%	50%
Kurvelesh	9000	7000	2000	0	78%	22%	0%
Lopez	6000	5000	1000	0	83%	17%	0%
Luftinjë	19 000	7000	4000	8000	37%	21%	42%
Memaliaj	14 000	9000	5000	0	64%	36%	0%
Qendër	18 000	8000	3000	7000	44%	17%	39%
Qesarat	7000	5000	2000	0	71%	29%	0%
Tepelenë	91 000	18 000	37 000	36 000	20%	41%	40%
Mesatare	191 000	72 000	62 000	57 000	38%	32%	30%
Gjithsej ZF Tepelenë*	191 000	39 600	59 500	91 900	21%	31%	48%

*Të dhënat për ZF Tepelenë janë nxjerrë bazuar në supozimin se do të kursehet rreth 60% e shpenzimeve administrative dhe 10% e shpenzimeve të tjera operative të njësive që suprimohen

Figura 156: Struktura e shpenzimeve në zonën funksionale, krahasuar me nivelin mesatar të njësive ekzistuese



Burimi: Llogaritjet e autorëve

Treguesit e investimeve

Treguesit e investimeve vrojtohen më mirë në një periudhë të gjatë kohore. Në këtë rast janë shqyrtuar të dhënat gjatë një periudhe pesë vjeçare, të cilat tregojnë se niveli i investimeve në këtë zonë ka qenë mjaft i ulët. Veçanërisht në qytetin e Memaliajt, gjatë këtyre pesë vjetëve janë investuar vetëm 8% e të ardhurave totale. Po të supozojmë se ritmi i investimeve do të ishte ulur në masën e kursimit nga shpenzimet administrative, pesha e investimeve kundrejt buxhetit total të zonës funksionale do të rritej nga 23% që rritej mesatarisht në 36%.

Figura 157: Investimet si përqindje e buxhetit total në zonën funksionale dhe njësitë ekzistuese

	Investime 2008 - 2012	Të ardhurat 2008 - 2012	Investimet si % e të ardhurave totale 2008 - 2012
Buz	46 543	110 043	42%
Fshat Memaliaj	20 913	157 012	13%
Krahëz	32 228	176 108	18%
Kurvelesh	69 326	132 058	52%
Lopez	8796	72 894	12%
Luftinjë	65 454	203 740	32%
Memaliaj	31 446	385 436	8%
Qendër	81 956	209 726	39%
Qesarat	18 373	127 252	14%
Tepelenë	97 639	498 689	20%
Mesatare	472 674	2 072 957	23%
Zona funksionale	756 278	2 072 957	36%

Burimi: Llogaritjet e autorëve

Analiza e efekteve administrative

Bashkimi i njësive në një zonë funksionale do të rezultojë në kursime, veçanërisht nga shpenzimet për personelin dhe një pjesë e shpenzimeve operative për mirëmbajtjen e zyrave. Në mënyrë specifike, në dhjetë nga njëmbëdhjetë njësitë e zonës funksionale do të shkurtohen pozicionet e kryetarit dhe të kabinetit të tij dhe shpenzimet për shpërblimet e këshilltarëve. Gjithashtu, shkurtime të mëtejshme do të ketë nga realizimi i asaj që rëndom quhet si *economy of scope* (efekti i bashkimit), më konkretisht nga shkurtimi i funksioneve administrative të përsëritura, të cilat do të përqendrohen në njësinë administrative të zonës funksionale. Të tilla pozicione janë Sektori i Menaxhimit Financiar (specialistët e financës dhe buxhetit), Sektori i Prokurimeve dhe Sektori i Auditit Financiar, por edhe Sektori i Urbanistikës. Përlllogaritjet paraprake mbi kursimin e mundshëm sugjerojnë se nga bashkimi mund të kursehen rreth 60%-70% e kostove për personelin dhe rreth 10% e shpenzimeve për mirëmbajtjen e zyrave. Përlllogaritjet e mëposhtme janë bazuar në këtë model.

Tabela 84: Kursimet nga shpenzimet për personelin dhe mirëmbajtjen

	Kursimi nga shpenzimet për personelin 60%)	Kursimi nga shpenzimet për zyrat (10%)
Buz	3600	100
Fshat Memaliaj	3000	400
Krahëz	1200	300
Kurvelesh	4200	200
Lopez	3000	100
Luftinjë	4200	400
Memaliaj	5400	500
Qendër	4800	300
Qesarat	3000	200
Tepelenë		
Gjithsej	32 400	2500
Kursimi si % e zërit përkatës	45%	4%
Kursimi si % e shpenzimeve totale	17%	1%



Me supozimet e bëra, në zonën funksionale të Tepelenës, pas bashkimit, kursehen rreth 35 milionë lekë ose 18% e shpenzimeve totale të kryera nga të gjitha njësitë. Këto fonde të gjeneruara mund ta rrisin me mbi 50% përqindjen e buxhetit që caktohet për investime në këtë zonë.

Treguesit socialë

Arsimi dhe infrastruktura

Një tjetër kategori e rëndësishme e shërbimeve që ofrohen pjesërisht në nivel vendor e pjesërisht në atë qendror është arsimi. Sot, NJQV-të janë përgjegjëse për mirëmbajtjen e infrastrukturave arsimore. Në figurën më poshtë prezantohet pikërisht shpërndarja dhe cilësia e këtyre strukturave. Ajo që tërheq vëmendjen në këtë analizë është fakti se cilësia e dobët e infrastrukturave arsimore lidhet drejtpërdrejtë me gjenerimin e ulët të të ardhurave nga NJQV-të (kuptohet edhe si rezultat i nivelit të ulët të transfertave). Riorganizimi në një NJQV më të madhe, sipas zonës funksionale të propozuar, do të rezultonte në efikasitet dhe shpërndarje më të mirë të fondeve në dispozicion. Madje, duke shkuar më tej dhe duke përdorur si argument kryesor parimin e subsidiaritetit, do të kishte kuptim fakti që edhe pjesë të tjera të funksionit (siç mund të jetë emërimi i stafit dhe i drejtuesve, etj.) të jenë përgjegjësi e nivelit vendor të qeverisjes.


Figura 07: Harta e shpërndarjes së infrastrukturave të arsimit në Shqipëri dhe cilësia e infrastrukturës arsimore në ZF




Burimi: Ministria e Arsimit dhe Sportit, Interpretimi dhe paraqitja grafike nga ne

Niveli arsimor dhe faktori gjeografik

Në zonën e Tepelenës ruhen dallimet urbane rurale dhe numri i nxënësve për mësues në arsimin 9-vjeçar raportohet të jetë nga 5 deri në 14. Diçka më i lartë është numri i nxënësve për mësues për shkollat e mesme, i cili është ndërmjet 13–16 nxënës. E njëjta situatë vihet re edhe kur shihet niveli arsimor në lidhje me distancën. Distancat në Tepelenë janë disi të mëdha dhe përveç zonave urbane, vihet re një numër i madh nxënësish për arsimin bazë dhe atë të mesëm.





Shëndetësia

Zona funksionale Tepelenë ka 1 spital, ndërkohë që shpërndarja e qendrave shëndetësore dhe numri i mjekëve për familje (MPF) e i mjekëve specialistë (MS) është si më poshtë:

	Total MPF	Total MS
Bashkia Tepelenë	0	0
Q.SH. Tepelenë	4	0
Total në rreth	4	0
Komunat e Tepelenës	0	0
Q.SH. Memaliaj	1	0
Q.SH. Qesarat	1	0
Q.SH. Krahëz	2	0
Q.SH. Luftinje	1	0
Q.SH. Lops	1	0
Q.SH. Kurvelesh	1	0
Q.SH. Qendër	1	0
Q.SH. Buz	1	0
Total	17	0

Raporti i mjekëve për 10 000 banorë në zonën e re funksionale, Tepelenë, është mesatarisht 33 mjekë për 10 000 banorë.

Komuna/Bashkia	B/K	Popullsia 2011	Dendësia	Nr. I mjekëve	10 000 banorë
Buz	K	737	8	1	14
Fshat Memaliaj	K	1606	32	0	0
Krahëz	K	2554	35	2	8
Kurvelesh	K	705	5	1	14
Lopez	K	723	12	1	14
Luftinjë	K	1734	16	1	6
Memaliaj	B	2647	331	1	4
Qendër	K	3179	13	1	3
Qesarat	K	1379	27	1	7
Tepelenë	B	4342	2171	24	55
Total		19 606		33	17

Shërbimet sociale


Për sa i përket shpërndarjes së shërbimeve sociale, edhe për qarkun Gjirokastrë vërehet i njëjti trend i përgjithshëm i përqendrimit të shërbimeve në qendrat e mëdha urbane, pjesa më e madhe e të cilave gjenden në Gjirokastrë dhe vetëm dy qendra gjenden në Tepelenë. Ndërkohë, zonat rurale mbeten të pambuluara me këto shërbime dhe për t'i marrë ato banorët duhet të udhëtojnë drejt qendrës urbane më të afërt.

Gjithashtu, vihet re që peshën kryesore të shërbimeve sociale e mbajnë ofruesit jopublikë, OJQ-të, ndërsa kategoritë e shërbimeve janë të kufizuara dhe jo detyruesisht ndikohen nga nevojat e komunitetit të cilit i shërbehet, por nga axhendat e donatorëve, të cilët janë dhe mbështetësit kryesor të tyre. Qarku i Gjirokastrës, në këndvështrimin rajonal, ka dhe përqindjen më të lartë të personave me aftësi të kufizuara, e cila arrin në 8,0%. Ky tregues ndikohet nga lidhja e ngushtë që ekziston ndërmjet aftësisë së kufizuar dhe moshës (sidomos pas moshës 50-vjeçare), e pikërisht Gjirokastra veçohet për numrin e madh të popullsisë mbi moshën 65-vjeçare.

Ndërkohë që sipas informacioneve rreth institucioneve e shërbimeve sociale, ky shërbim mungon në nivel qarku. Siç ilustron edhe në tabelë, në zonën funksionale Tepelenë gjenden dy institucione të shërbimi social.

Tregues të tjerë socio-ekonomikë


Nga pikëpamja ekonomike, situata në Tepelenë është edhe më e vështirë. Ka komuna, sidomos ajo e thella në Buz e cila është 65 km larg nga Tepelena, ku 50% e familjeve jetojnë me ndihmë ekonomike. Edhe në komuna të tjera përqindja është pothuajse e tillë ndërkohë që vetëm pak prej tyre bëjnë përjashtim, si p.sh. Fshat Memaliaj (18,6%) apo Qendër (19%).



Nëse shqyrtojmë treguesit e tjerë lidhur me situatën socio-ekonomike në Tepelenë, vlen të veçohet situata tejet e mirë e qytetit të Tepelenës dhe Memaliajt për sa i përket aksesit në shërbimin e furnizimit me ujë dhe të kanalizimit në ujë dhe kanalizime (97– 99%), por me diferencë të madhe me zonat e tjera (18–49% - rrjeti kanalizimeve dhe 9–42% furnizimi me ujë). Përqindja e makinave varion nga 14–26%, ndërsa treguesit e telefonisë dhe internetit janë shumë të ulët, me përqindje më të lartë në zonat urbane. Telefonia celulare përsëri ka një shpërndarje më të gjerë (23–28%).

Distanca e njësive të përthithura me qendrën

Figura 0.8: Harta e distancave kohore



Largësia në kohë udhëtimi nga qendra e bashkisë Tepelenë është rreth 45 minuta. Në rastin e njësive Buz dhe Kurvelesh, kjo distancë është rreth 1 orë e 10-20 minuta.

Përfundime

Zona funksionale e Tepelenës (bashkia Tepelenë, komunat Kurvelesh, Lopez, Luftinjë)

ZF Tepelenë ka një popullsi 19 606 banorë, mesatarisht 1961 banorë për njësi

Nga 16 biznese për 1000 banorë, ky tregues rritet në 23 biznese për 1000 banorë për të gjithë zonën funksionale.

Pas bashkimit, të ardhurat për frymë rriten nga 1275 lekë në 1490 lekë për frymë për të gjithë zonën funksionale ose do të jenë 15% më të larta se mesatarja dhe 20% më të larta se mediani i të ardhurave për frymë në njësitë ekzistuese.

Shpenzimet për frymë do të mund të rriten në rreth 9742 lekë; përkatësisht 8% dhe 28% më të larta se mesatarja dhe mediani i shpenzimeve për frymë në njësitë ekzistuese, duke siguruar një shpërndarje më të mirë të fondeve.

Shpenzimet administrative për zonën do të mund të ulen në 21% të shpenzimeve totale, nga 72 milionë në 34 milionë në vit.

Do të kursehen rreth 40 milionë lekë, ose 21% e shpenzimeve totale të kryera nga të gjitha njësitë, si rezultat i shkurtimeve të shpenzimeve administrative (paga dhe shpenzime operative të tjera).

Pesha e investimeve kundrejt buxhetit total të zonës funksionale do të rritet nga 23% në 36%.

Investimet mund të rriten me rreth 70% në vit, nga 57 milionë në mbi 97 milionë.

Përfundimet e mëposhtme janë llogaritur për ZF Memaliaj si njësi funksionale që qëndron më vete jashtë ZF Tepelenë.

2. ZF Memaliaj (Bashkia Memaliaj dhe komunitat Memaliaj fshat; Luftinjë, Buz; Krahëz; Qesarat)

ZF Memaliaj e përbërë nga 6 njësi ekzistuese, ka popullsi prej 10,657 banorë, nga mesatarisht 1,776 banorë aktualisht në NJQV ekzistuese;

Reduktim i shpenzimeve administrative të njësisë me rreth 18,9 milionë lekë në vit, ose 36% e shpenzimeve administrative (shpenzime paga dhe operative) dhe 26% e shpenzimeve vjetore gjithsej;

Ulja e shpenzimeve të personelit për banor në masën mbi 50%, nga 3,190 lekë në 1,548 lekë për banor;

Mirëadministrimi i burimeve financiare mund të sjellë rritje të investimeve mbi dyfish, ose nga 14 milionë lekë, në 32,9 milionë lekë në vit;

Investimet për banor mund të rriten nga 1,314 lekë, në 3,087 lekë për banor në njësinë e re;


Bashkimi në një zonë funksionale mund të sigurojë rishpërndarje më të mirë të të ardhurave duke zbutur pabarazitë e mëdha mes zonave; pa llogaritur efektet e eficiencës së rritur në menaxhimin e të ardhurave: mesatarisht ZF e re do të realizonte 1,055 lekë të ardhura të veta për frymë, ose 12% më shumë se mesatarja në njësitë ekzistuese (939 lekë).

QARKU KORÇË

Profil i i qarkut Korçë

Qarku i Korçës është i vendosur në juglindje të vendit me një sipërfaqe prej 3692 km². Qarku i Korçës përbëhet nga 37 njësi vendore respektivisht 6 bashki dhe 31 komuna. Në përbërje të këtyre njësive ndahen 344 fshatra. Nënndarjet administrative të qarkut të Korçës janë 4 rrethe, respektivisht rrethet Korçë, Pogradec, Devoll dhe Ersekë. Qendra e qarkut të Korçës është bashkia e Korçës.

Figura 158 Harta administrative e qarkut Korçë



Burimi: Instat

Qarku i Korçës numëron një popullsi prej 220 357 banorësh prej të cilëve 40% ose 87 811 banorë jetojnë në zonat urbane (bashki) dhe 60 % ose diferenca prej 132 546 banorësh jetojnë në zonat rurale (komuna).

Referuar të dhënave të Census-it 2011 dhe popullsia mesatare për njësi të qeverisjes vendore në këtë qark rezulton 5956 banorë/NJQV.

Rreth 43% e njësive ose 16 komuna kanë një popullsi të regjistruar më të vogël se 5000 banorë, ndërsa 11 komuna ose 30% e njësive kanë një popullsi që varion nga 5000 deri në 10

000. Pjesa tjetër prej 24% ose 9 njësi kanë një popullsi më të madhe se 10 000 banorë prej të cilave vetëm 2 ose 5 % e totalit të njësive në qark kanë një popullsi me mbi 30 000 banorë.

Në qarkun e Korçës, komuna Pustec në rrethin e Korçës me një popullsi prej 5281 banorësh, veçohet si një njësi me popullsi në shumicë me origjinë maqedonase.

Dendësia mesatare e popullsisë është 469 banorë/km² krahasuar me 97,4 banorë/km² në rang vendi. Pogradeci (8616 banorë/km²) dhe Korça (3572 banorë/km²) janë njësitë vendore me dendësi më të lartë, ndërsa Komuna Leskovik (1,7 banorë/km²) dhe Çlirim (3,5 banorë/km²) janë njësitë me dendësinë më të ulët, ndërkohë që 10 NJQV kanë dendësi më të ulët se 10 banorë/km² (Barmash, Novoselë, Lekas, Moglicë, Vithkuq, Voskopojë, etj.)

Bazuar në të dhënat e INSTAT qarku i Korçës gjithashtu ka pësuar rënie në numrin e popullsisë në krahasim me 2001 (-18,5%). Rënie kanë pësuar zonat urbane (-13,5%), por më shumë ato rurale (-21%). Dendësia gjithashtu ka rënë në -18,5%.

Propozimi për ndarjen e zonave funksionale në qarkun e Korçës

Ndarja e zonave funksionale në qarkun e Korçës është bërë në respekt të konceptit të zonës funksionale si një hapësirë territoriale banorët e së cilës kanë tradicionalisht një ndërveprim intensiv, garanton vazhdimësi territoriale dhe komunikim të lehtë.

Gjithashtu zonat funksionale⁴ janë të organizuara rreth një qendre urbane, që në dallim nga zona të tjera urbane dhe/ose rurale sigurojnë shërbime dhe funksione që vijnë sipas kriterëve të mëposhtme:

4. Qyteti është qendër qarku (QQ) me popullsi më të madhe 35 000 banorë
5. Qyteti është qendër rrethi (QR) me popullsi më të madhe se 20 000 banorë
6. Qyteti është qendër lokale ose qytet i vogël është qendër rrethi ose qytete të tjera, (QL) me popullsi më të vogël se 10 000 – 20 000 banorë
7. Zonë me shumicë popullsie minoritare (ZM)

Funksionaliteti i zonës është parë gjithashtu edhe nga këndvështrimi i intensitetit dhe i drejtimit të lëvizjes dhe komunikimit. Drejtimi dhe intensiteti i lëvizjes ose komunikimit brenda një zone funksionale është vlerësuar si mundësia për të gjetur punë apo për të marrë shërbime bazë si shërbimet shëndetësore, sociale, arsimore etj. Mbi bazën e kriterëve të mësipërme qarku i Korçës mbulohet nga 6 zona funksionale të cilat nga veriu në jug janë ilustruar si në hartën më poshtë:

⁴Kriteret janë bazuar mbi studimin "Statistikat socio – demografike të Shqipërisë", "Tipologjia e komunave dhe definicioni i aglomerateve në Shqipëri, i publikuar nga INSTAT, 2010 me autor Martin Schuler, Alain Jarne, Ervin Shameti, Ledjo Seferkollli dhe EPFL-CEAT-Lausanne, Zvicër

1. Zona funksionale Korçë
2. Zona funksionale Maliq
3. Zona funksionale Pustec
4. Zona funksionale Pogradec
5. Zona funksionale Devoll/Bilisht
6. Zona funksionale Kolonjë/Ersekë

Figura 159 Ndarja e zonave funksionale në qarkun e Korçës




Tabela 85 Pasqyrimi i kritereve për përzgjedhjen e qendrës së zonës funksionale në qarkun e Korçës.

Qyteti/Fshati	Statusi Administrativ			Qendër ekonomike						
	Qendër qarku	Qendër rrethi	Qendër lokale	Industri	Bujqësi	Shërbime/Tregti	Qendër tradicionale	Kryen funksione qendrore	Zonë përqendrimi minoritar	Pesha në pikë për çdo qendër ZF
Korça	X	x		x		x	x	x		6
Maliq			x	x	x	x				4
Pogradec		x		x		x	x	x		5
Bilisht		x			x	x	x	x		5
Ersekë		x				x	x	x		4
Pustec							x	x	x	3

Burimi: Llogaritjet e autorëve

Tabela 86 Tabela përmbledhëse e qarkut Korçë

N r.	Zona funksionale	Nr. njësi	Qendra e ZF	Popullsia	% popullsi së urbane	Sipërfaqja km ²	Dendësi a banorë/km ²	Sip. bujqësore Ha/1000 banorë	Distanca mesatare nga qendra km
1	Korçë	9	qyteti Korçë	92 263	55%	857	108	418	14,9
2	Pogradec	8	qyteti Pogradec	61 530	34%	497	124	178	17,2
3	Maliq	6	qyteti Maliq	45 800	18%	651	70	231	18,2
4	Devoll	5	qyteti Bilisht	26 716	23%	476	56	382	5,8
5	Kolonjë	8	qyteti Ersekë	11 070	48%	756	15	2.358	35
6	Pustec	1	fshati Pustec	3290	0%	161	21	165	
	Shuma	37		240 669					


Burimi: Llogaritjet e autorëve

Zona funksionale Korçë

Profili administrativo-territorial

Zona funksionale Korçë përfshin 9 njësi territoriale administrative. Qendra urbane e kësaj zone është qyteti i Korçës që në aspektin administrativ përcaktohet si qytet qendër qarku me rendësi kombëtare. Zona funksionale përfshin komunat Drenovë, Mollaj, Bulgarec, Pojan, Voskop, Voskopojë, Vithkuq dhe Lekas, të përcaktuara kryesisht si zona bujqësore (ZB) fushore, malore ose të përziera, të cilat nuk përmbushin kushtet për të qenë qendër e zonës funksionale.

Figura 160 Harta e zonës funksionale Korçë



Profili social-demografik

Zona funksionale Korçë ka një popullsi totale prej 92 263 banorë. Tabela në vijim na jep një përmbledhje të të dhënave bazë socio-demografike të kësaj zone.

Tabela 87 Të dhëna bazë social demografike për zonën funksionale Korçë

Bashki/Komuna	Statusi funksional – administrativ	Popullsia (2013)	Sip. km ²	Dendësia (banorë/km ²)	Sip. km ² /1000 banorë	Sip. bujqësore ha	Sip. ha/1000 banorë	Distanca në km nga qendra e zonës
Korçë (B)	QQ	51 152	7	7750	0,13	23 034	450	0,0
Drenovë	ZB	10 926	93	117	9	1784	163	4,6
Lekas	ZB	392	95	4	242	210	536	38,0
Mollaj	ZB	3498	70	50	8	1361	147	7,5
Pojan	ZB	10 864	86	126	5	4642	270	14,8
Bulgarec	ZB	9022	81	112	6	3688	268	6,0
Vithkuq	ZB	1519	244	6	370	924	608	27,0
Voskop	ZB	3832	75	51	12	2064	342	12,5
Voskopoje	ZB	1058	107	10	20	835	156	24,0
Shuma		92 263	857	108	9,29	38 542	418	134,4
/Mesatare				914			327	14,9
Urban		51 152						
Rural		41 111						
% urban		55%						

Burimi: Llogaritjet e autorëve


Një tregues pozitiv i këtij transformimi është fakti se pas bashkimit 55% e popullsisë jeton në zonë urbane dhe vetëm 45 % në zonë rurale.

Zona ka një sipërfaqe totale prej 857 km² ose 9,29 km² për 1000 banorë dhe një sipërfaqe bujqësore totale prej 38 542 ha ose 418 ha/1000 banorë krahasuar me mesataren prej 327 ha/1000 banorë kur ky tregues vlerësohet veçmas për secilën njësi brenda kësaj zone.

Dendësia e popullsisë do të ulet në 108 banorë për 1 km² ndërsa mesatarja e dendësisë për të gjitha njësitë e marra së bashku është disa herë më e lartë ose 914 banorë për 1 km².


Sipas të dhënave të Census-it 2011, edhe pse raporti i migrimit nga Korça krahasuar me migrimin në Korçë është 2-3 (mesatare vendi), qyteti i Korçës është qendra kryesore e migrimit për banorë e të paktën 8-12 komunave që e rrethojnë atë.

Figura 161 Harta e ndërveprimit ekonomik në zonën funksionale Korçë dhe Maliq



Qyteti i Korçës gjithashtu është destinacioni kryesor (mbas zonës Tiranë – Durrës) për lëvizjen e banorëve të komunave që e rrethojnë për të marrë shërbime si dhe mundësi punësimi.

Figura 162 Harta e shpërndarjes së bizneseve në zonën funksionale Korçë dhe Maliq



Pjesa më e madhe e bizneseve dhe shërbimeve janë vendosur kryesisht në dy qendra, respektivisht në Korçë dhe Maliq të cilat përcaktojnë gjithashtu edhe drejtimet kryesore të lëvizjes për marrjen e shërbimeve dhe mundësive për punësim.

Profili ekonomiko-financiar

Administrata

Duke iu referuar të dhënave për administratën në rrethin e Korçës, aktualisht të gjitha njësitë vendore kanë një personel prej 673 punonjësish. Duke aplikuar një reduktim të personelit në masën 70% për të gjitha njësitë që përthithen dhe duke lënë të pandryshuar personelin e bashkisë së Korçës, numri i personelit do të ulet në 476 punonjës ose 71% më pak se sa numri aktual.

Tabela 88 Shpërndarja e banorëve në njësitë vendore

NJËSIA E QEVERISJES VENDORE	Totali i personelit aktual	Totali i personelit pas bashkimit
Totali bashkia Korçë	392	392
Totali komuna Voskopojë	22	6,6
Totali komuna VITHKUQ	20	6
Totali komuna GORE	22	6,6
Totali komuna QENDËR BULGAREC	39	11,7
Totali komuna MOLLAJ	28	8,4
Totali komuna DRENOVË	42	12,6
Totali komuna LEKAS	13	3,9
Totali komuna VOSKOP	38	11,4
Totali komuna POJAN	57	17,1
TOTALI I ADMINISTRATËS ZF KORÇË	673	476
% e reduktimit të administratës		71%

Burimi: Llogaritjet e autorëve

Shpenzimet

Duke iu referuar të dhënave ekonomiko - financiare të vitit 2012 në zonën funksionale të propozuar, shuma e shpenzimeve të personelit për të gjitha njësitë që përthithen së bashku (112 milion lekë) zë rreth 46% të totalit të shpenzimeve (243 milion lekë), ndërsa shpenzimet për investime zënë vetëm 86 milion lekë ose 35% të totalit.

Tabela 89 Shpenzimet para bashkimit në ZF Korçë.


Njësia	Popullsia 2011	Totali shpenzime 2012 (000/lek)	Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik(milion lek)						
			Pa ga 600	Shpenzimet e administratës Sigurimet shoqërore 601	Shpenzime personel Total	Shpenzime operative 602-604	Grante 720	Interesa të paguara 651	Shpenzime investime 230-231
Korçë	51 152	559	178	21	199	262	0	6	92
Voskopojë	1058	16	7	1	8	3	0	0	5
Lekas	392	10	3	1	4	3	0	0	3
Vithkuq	1519	21	8	2	10	4	0	0	7
Pojan	10 864	53	19	4	23	8	0	0	22
Voskop	3832	26	9	2	11	4	0	0	11
Drenovë	10 926	43	18	4	22	5	0	0	16
Mollaj	3498	48	14	3	17	9	0	0	22
Qendër Bulgarec	9022	29	17	3	20	9	0	0	0
Shuma bashkia Korçë	51 152	559	178	21	199	262	-	6	92
Shuma njësitë e tjera	41 111	246	96	16	115	45	-	-	86
Shuma të gjitha	92 263	806	274	37	314	307	-	6	178
% Shpenzimeve ndaj totalit			34%	5%	39%	38%	0%	1%	22%

Burimi: Llogaritja e autorëve bazohet mbi të dhënat e M. së Financave 2012

Nga reduktimi i shpenzimeve për personelin e reduktuar (pagë dhe sigurime shoqërore), përfshirë këtu edhe numrin e këshilltarëve, në masën 70% vetëm për njësitë që përthithen për efekt të agregimit, vlera e shpenzimeve për personelin do të ulet nga 314 milion në 233,5 milionë lekë duke zënë vetëm 29 % të totalit të shpenzimeve.

Grafiku në vijim ilustron raportin e shpenzimeve të personelit për 1000 banorë. Grafiku tregon qartë se në komuna të tilla si Voskopojë, Lekas, Vithkuq, Mollas etj., kostoja e personelit është disa herë më e larë se në bashkinë e Korçës.

Figura 163 Shpenzimet e personelit për 1000 banorë (mijë lek)



Burimi: Të dhënat e Ministrisë së Financave 2012, Llogaritjet e autorëve

Shpenzimet operative ulen në mënyrë më modeste nga 45 milionë lekë në 40 milionë lekë në njësitë që përthithen ose nga 307 në 302 milionë lekë në të gjithë zonën funksionale.


Nëse diferenca e shpenzimeve të kursyera për efekt të agregimit do të rishpërndahen atëherë shpenzimet për investime në zonën funksionale vetëm për njësitë e përthithura do të rriteshin me 85 milionë, nga 178 në 263 milionë lekë. Pesha e investimeve në buxhetin total të zonës funksionale do të rritej nga aktualisht 22% në 33% pra, duke përfituar një rritje prej 50% më shumë.

Tabela 90 Shpenzimet pas agregimit në njësitë e tjera të ZF, Korçë (përfshijë bashkinë Korçë).

	Shpenzime gjithsej	Personel	Operative	Investime
Totali njësi të tjera të zonës funksionale	805 000	314 000	307 000	178 000
% e shpenzimeve ndaj totalit	100%	39%	38%	22%
Totali i reduktuar njësitë që përthithen	805 000	233 500	302 500	263 000
Struktura e buxhetit në % pas reduktimit	100%	29%	38%	33%
Shpenzime për 1000 banorë para	5,90	2,72	1,1	2,1
Shpenzime për 1000 banorë pas	5,9	0,8	0,3	4,8

Burimi: Të dhënat e Ministrisë së Financave 2012, Llogaritjet e autorëve


Figura 164 Ndryshimi i raportit të shpenzimeve vendore para dhe pas agregimit në zonën funksionale Korçë (mijë lek)



Burimi: Të dhënat e Ministrisë së Financave 2012, Llogaritjet e autorëve

E njëjta tendencë pozitive vërehet edhe kur krahasohet raporti i shpenzimeve të personelit dhe ato operative për 1000 banorë në kuadër të zonës funksionale. Në total këto shpenzime do të ulen nga 39% në 29% të totalit ose nga 314 milionë lekë në 233 milionë lekë, ndërsa shpenzimet për investime për 1000 banorë do të rriteshin po ashtu me 50% ose në vlerë absolute nga 178 milionë në 263 milionë lekë duke llogaritur se shpenzimet si për investime ashtu edhe për shpenzimet e tjera të qendrës së zonës funksionale (qytetit të Korçës) do të mbeteshin të pandryshuara.

Figura 165 Ndryshimi i shpenzimeve lek/1000 banorë para dhe pas agregimit në zonën funksionale Korçë (mijë lek)




Burimi: Të dhënat e Ministrisë së Financave 2012, Llogaritjet e autorëve

Duke ruajtur të pandryshuara shpenzimet për bashkinë e Korçës si qendër e zonës së re funksionale dhe duke shtuar shpenzimet e reduktuara nga zonat e tjera që përthithen në zonën e re, vetëm nga qarkullimi i kursimeve dhe reduktimit të shpenzimeve të personelit dhe operative, njësia e re do të jetë në gjendje të bëjë rreth 263 milionë lekë investime ose 50% më shumë nga totali prej 178 milion lekësh që këto njësi mund të realizojnë të veçuara.

Të ardhurat e veta

Bazuar mbi të ardhurat e raportuara për vitin 2012 shuma e agreguar e të ardhurave të veta (tatimore dhe jo tatimore) është 398,2 milion lekë. E pjesëtuar për numrin e popullsisë në zonë kjo shumë rezulton në një të ardhur prej 4600 lekë/frymë, e cila është 2 herë më shumë mbi mesataren e të ardhurave për frymë krahasuar me vlerën 2800 lekë/frymë.


Figura 166 Krahasimi i të ardhurave të veta për frymë në zonën funksionale Korçë



Burimi: Të dhënat e Ministrisë së Financave 2012, Llogaritjet e autorëve

Shpërndarja e investimeve për banorë në njësitë vendore të krahasuar me zonën funksionale, paraqitet si në grafikun që vijon.


Figura 167 Krahasimi i investimeve për banorë në zonën funksionale Korçë dhe njësitë përbërëse (lek)



Burimi: Të dhënat e Ministrisë së Financave 2012, Llogaritjet e autorëve

Shpërndarja e të ardhurave për frymë në njësitë vendore përbërëse krahasuar me zonën funksionale paraqitet si në grafikun më poshtë.

Figura 168 Krahasimi i të ardhurave të veta totale për banorë në zonën funksionale Korçë dhe njësitë përbërëse.




Burimi: Të dhënat e Ministrisë së Financave 2012, Llogaritjet e autorëve

Buxheti total

Në termat e buxhetit total për banorë zona funksionale përfaqësohet me një vlerë nën mesatare e vlerave të të gjitha njësive që përfshihen rreth qytetit të Korçës.

Figura 169 Krahasimi i buxhetit total për banorë në zonën funksionale Korçë dhe njësitë përbërëse.



Burimi: Llogaritje e autorëve bazuar në buxhetin të vitit 2012 të raportuar nga Ministria e Financave


Të dhëna të tjera për zonën funksionale

Komunikacioni dhe transporti

Zona ka një rrjet rrugor të zhvilluar i cili lejon një qarkullim të lehtësuar dhe lidh me rrugë të kategorisë “Interurbane dytësore⁵” 7 nga 9 qendrat e zonës me përjashtim të fshatit Lekas (qendra e komunës Lekas dhe fshatit Vithkuq (qendra e komunës Vithkuq), të cilat lidhen me rrugët interurbane më të afërta me rrugët lokale (interurbane) të sistemuara në mënyrë të përshtatshme.

⁵Klasifikimi sipas kodit rrugor

Figura 170 Harta administrative dhe rrjeti rrugor në qarkun e Korçës




Distanca mesatare nga qyteti i Korçës (qendra e zonës funksionale) në qendrat e komunave përbërëse është 14,8 km. Pika më e afërt me qytetin është 4,6 km (fshati Drenovë) ndërsa pika më e largët është 38 km (fshati Lekas).

Furnizimi me ujë dhe kanalizime

Në zonën funksionale të Korçës aktualisht operojnë dy operatorë për furnizimin me ujë dhe shërbimin e kanalizimeve, respektivisht Sh.A UK Korçë e cila administron shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizime në qytetin e Korçës dhe Sh.A. UK Korçë Fshat, e cila administron shërbimin e furnizimit me ujë në një pjesë të njësive që përfshihen në zonën funksionale të Korçës dhe një pjesë të njësive që përfshihen në zonën funksionale të Maliqit.

Krijimi i këtyre zonave funksionale mund të shoqërohet në të ardhmen edhe me ndryshime në strukturën e operatorëve dhe shtrirjen e mbulimit me shërbim të furnizimit me ujë dhe kanalizime.

Figura 171 Harta e aksesit ne Ujesjeles Kanalizime



Menaxhimi i mbetjeve

Një funksion tjetër i rëndësishëm i qeverisjes vendore është dhe shërbimi i pastrimit dhe menaxhimit të mbetjeve, përfshirë këtu edhe disa shërbime të tjera publike. Në zonën funksionale të Korçës 56% e shpenzimeve që në vlerë absolute bëjnë 457 milion lekë ose 34 % e buxhetit total shkon kryesisht për menaxhimin e mbetjeve dhe pastrimit. Bashkimi i këtyre njësive do të rrisë efektivitetin e përdorimit të këtyre fondeve duke mbuluar edhe zonat periferike por edhe duke përmirësuar standardin e shërbimit.

Përfundime

Bashkimi i njësive në zonën funksionale me qendër qytetin e Korçës do të bëjë që shpenzimet administrative dhe ato korrente të ulen nga 621 milionë lekë në 536 milionë lekë, duke dhënë një diferencë prej 259 milionë lekësh ose rreth 42% më pak duke marrë të pandryshuara shpenzimet e bashkisë së Korçës që do të mbetet qendër e zonës funksionale.

Kjo diferencë do të bëjë të mundur që njësia e re ose ndryshe zona funksionale Korçë të rrisë shpenzimet vjetore për investime nga 178 milion lekë në 263 milionë lekë vetëm nga shkurtimet e shpenzimeve administrative dhe korrente të marra së bashku.

Qyteti i Korçës gjithashtu është destinacioni kryesor (mbas zonës Tiranë – Durrës) për lëvizjen e banorëve të komunave që e rrethojnë për të marrë shërbime si dhe mundësi punësimi.

Pjesët ekstreme të zonës funksionale Korçë, veçanërisht fshatrat e komunës Vithkuq (27 km) dhe Lekas (38 km) kanë komunikim të vështirë me qendrën e zonës (qyteti i Korçës) për shkak të distancës relativisht të madhe, por edhe për shkak të cilësisë së rrugës që lidh këto dy qendra me rrugët kryesore interurbane të qarkut të Korçës. Aksesit i tyre do të përmirësohet pasi të bëhen pjesë e një projekti të një zone më të madhe.

Juridiksioni administrativ i njësive vendore është fizikisht shumë i kufizuar dhe nuk i jep mundësi për një administrim efikas dhe të suksesshëm infrastrukturës rrugore. Përndryshe, brenda një zone funksionale krijohet mundësia e koordinuar dhe bashkëpunimi i munguar për planifikimin dhe menaxhimin e rrjetit rrugor në të dy kategoritë, përfshirë: (i) rajonale, dhe (ii) lokale.

Zona funksionale do të krijojë mundësinë për strukturimin e shumë shërbimeve publike, veçanërisht të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime që aktualisht administrohet nga dy operatorë, të cilët mund të agregohen në një të tillë duke siguruar reduktimin e shpenzimeve dhe rritjen e kapaciteteve administrative.


Zona funksionale Pogradec

Profili administrativo-territorial

Zona funksionale Pogradec përfshin 8 njësi territoriale administrative. Qendra urbane e kësaj zone është qyteti i Pogradecit që në aspektin administrativ dhe funksional përcaktohet si qytet qendër rrethi (QR).

Zona funksionale përfshin komunat Hudenisht, Buçimas, Cërravë, Proptisht, Trebinjë, Velçan dhe Dardhas, përndryshe të përcaktuara kryesisht si zona bujqësore (ZB) fushore, malore ose të përziera, të cilat nuk përmbushin kushtet për të qenë qendër e zonës funksionale.

Figura 172 Harta e zonës funksionale Pogradec



Profili social-demografik

Zona funksionale Pogradec ka një popullsi totale prej 61 530 banorësh. Katër nga tetë njësi në këtë zonë kanë një popullsi më të vogël se 5000 banorë. Zona më e populluar shtrihet përgjatë bregut të liqenit të Ohrit në komunat Bucimas (15 687), Hudenisht (5990) dhe Pogradec 20 848. Tabela në vijim na jep një përmbledhje të të dhënave bazë socio-demografike të kësaj zone.

Tabela 91 Të dhëna bazë social demografike për zonën funksionale Pogradec

Bashki/Komuna	Statusi funksional – administrativ	Popullsia (2013)	Sipërfaqja km ²	Dendësia banorë/km ²	Sipërfaqja km ² /1000 banorë	Sipërfaqja bujqësore ha	Sipërfaqja ha/1000 banorë	Distanca km nga qendra e zonës
Pogradec	QR	20 848	3	8 339	0	5412	260	0
Hudenisht	ZB	5990	65	93	11	360	60	7,7
Buçimas	ZB	15 687	59	267	4	1177	75	1,2
Cerravë	ZB	7009	89	79	13	1420	203	8,4
Proptisht	ZB	4785	77	62	16	1004	210	46,5
Trebinjë	ZB	2481	118	21	47	997	402	19,3
Dardhas	ZB	2182	87	25	40	585	268	2
Velcan	ZB	2548	82	31	32	480	188	54,5
Shuma		61 530	497	124	8	10 954	178	140
/mesatare				1269	1269		211	17,5
Urban		20 848						
Rural		38 134						
% urban		34%						

Burimi: Llogaritjet e autorëve


Për efekt të agregimit llogaritet që popullsia rurale në zonë të zërë 66% të totalit ndërsa popullsia urbane 34 % të totalit, e cila banon kryesisht në qytetin e Pogradecit.

Zona ka një sipërfaqe totale prej 497 km² ose 9,29 km² për 1000 banorë dhe një sipërfaqe bujqësore totale prej rreth 10 954 ha ose 178 ha/1000 banorë krahasuar me mesataren prej 211 ha/1000 banorë kur ky tregues vlerësohet veçmas për secilën njësi brenda kësaj zone.

Dendësia e popullsisë do të ulet në 124 banorë për 1 km² ndërsa mesatarja e dendësisë për të gjitha njësitë e marra së bashku është disa herë më e lartë ose 1269 banorë për 1 km².


Qyteti i Pogradecit është njëkohësisht qendër rrethi dhe hyn në kategorinë e qyteteve me rëndësi të veçantë ku janë përqendruar institucionet qendrore të cilat sigurojnë shërbime ekstra kur krahasohen me qendra të tjera urbane dhe veçanërisht me komunat në zonat rurale që ë rrethojnë.

Figura 173 Harta e ndërveprimit ekonomik në zonën funksionale Pogradec



Qyteti i Pogradecit gjithashtu është destinacioni kryesor (mbas zonës Tiranë – Durrës) për lëvizjen e banorëve të komunave që e rrethojnë për të marrë shërbime si dhe mundësi punësimi.

Figura 174 Harta e shpërndarjes së bizneseve në zonën funksionale Pogradec



Siç vihet re dhe nga hartat më sipër, evidentohet se Pogradeci është qendër funksionale e zonës për efekt të shërbimeve dhe të numrit më të madh të bizneseve që përqendrohen në këtë qytet, por edhe në zonën e liqenit.

Profili ekonomiko-financiar

Administrata

Duke iu referuar të dhënave për administratën në rrethin e Pogradecit, aktualisht të gjitha njësitë vendore kanë një personel që në total përbëhet nga një numër prej 565 punonjësish⁶. Duke aplikuar një reduktim të personelit në masën 70% për të gjitha njësitë që përthithen dhe duke lënë të pandryshuar personelin e bashkisë së Pogradecit, numri i personelit do të ulet në 350 punonjës ose 40% më pak se sa numri aktual.

Tabela 92 Shpërndarja e njësive vendore

NJËSIA E QEVERISJES VENDORE	Totali i personelit	Totali i personelit pas agregimit
Totali i administratës bashkia POGRADEC	257	257
Totali i administratës komuna HUDENISHT	46	14
Totali i administratës komuna BUCIMAS	102	31
Totali i administratës komuna CËRRAVË	55	17
Totali i administratës komuna TREBINJË	25	8
Totali i administratës komuna PROPTISHT	1	0
Totali i administratës komuna PROPTISHT	30	9
Totali i administratës komuna DARDHAS	22	7
Totali i administratës komuna VELCAN	28	8
TOTALI I ADMINISTRATËS RRETHI POGRADEC	565	350

Burimi: MÇV, Llogaritjet e autorëve

Financat publike

Duke iu referuar të dhënave ekonomiko - financiare të vitit 2012, në zonën funksionale të propozuar, shuma e shpenzimeve të personelit për të gjitha njësitë që përthithen së bashku (94 milion lek) zë rreth 49% të totalit të shpenzimeve (190 milion lekë), ndërsa shpenzimet për investime zënë vetëm 60 milion lekë ose 32% të totalit.

⁶Pa përfshirë këtu numrin e këshilltarëve

Tabela 93 Shpenzimet para bashkimit në ZF, Pogradec

Njësia	Popullsia 2011	Totali shpenzime 2012 (000/lek)	Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik(milion lek)						
			Shpenzimet e administratës		Shpenzime personale Total	Shpenzime operative	Grante	Interesat të paguara	Shpenzime investive
			Pa ga	Sigurimet shoqërore					
			600	601		602-604	720	651	230-231
Pogradec	20 848	224	89	17	106	104		3	11
Buçimas	15 687	60	30	6	36	7			17
Hudenisht	5990	31	12	2	14	8			9
Proptisht	4785	22	8	2	10	3			9
Velçan	2548	20	9	2	11	4			5
Trebinjë	2481	13	4	1	5	2			6
Dardhas	2182	10	2	0	2	3			5
Çerravë	7009	34	13	3	16	9			9
Shuma Pogradec	20 848	224	89	17	106	104	0	3	11
Shuma të tjera	40 682	190	78	16	94	36	0	0	60
Shuma të gjitha	61 530	414	167	33	200	140	0	3	71
% e shpenzimeve ndaj totalit			40%	8%	48%	34%	0%	1%	17%

Burimi: Të dhënat e Ministrisë së Financave 2012 Llogaritje e autorëve


Nga reduktimi i shpenzimeve për personelin (pagë dhe sigurime shoqërore) në masën 70% duke llogaritur një shkurtim edhe për numrin e këshilltarëve, vetëm për njësitë që përthithen për efekt të agregimit, vlera e shpenzimeve për personelin do të ulet nga 94 milionë në 28 milionë lekë duke zënë vetëm 15 % të totalit të shpenzimeve. Po kështu, do të ulen shpenzimet operative nga 36 milion në 32 milionë lekë. Nëse diferenca e shpenzimeve të kursyera për efekt të agregimit do të rishpërndahet në kursin e investimeve, atëherë shpenzimet për investime në zonën funksionale do të rriteshin nga 71 milionë në 140 milionë lekë duke e ndryshuar raportin aktual nga 17% në 34% të totalit të shpenzimeve, rrjedhimisht duke përfituar një rritje prej rreth 200 % ose 2 herë më shumë.

Tabela 94 Shpenzimet pas agregimit në ZF Pogradec (mijë lek)

Totali zona funksionale	414 000	200 000	140 000	71 000
% e shpenzimeve ndaj totalit	100%	48%	34%	17%
Totali i reduktuar zona funksionale	414 000	134 200	136 400	140 400
% reduktuar ndaj totalit	100%	32%	33%	34%
Shpenzime për 1000 banorë para	6,728	3,250	2,275	1,154
Shpenzime për 1000 banorë pas	6,728	2,181	2,217	2,282

Burimi: Të dhënat e Ministrisë së Financave 2012, Llogaritjet e autorëve

Figura 175 Ndryshimi i raportit të shpenzimeve vendore para dhe pas agregimit në zonën funksionale Korçë



Burimi: Të dhënat e Ministrisë së Financave 2012, Llogaritjet e autorëve


E njëjta tendencë pozitive vërehet edhe kur krahasohet raporti i shpenzimeve të personelit dhe operativet për 1000 banorë, të cilat në kuadër të krijimit të zonës funksionale do të ulëshin me 33% nga 200 milionë në 133 milionë lekë, ndërsa shpenzimet për investime për banorë do të rriteshin pothuajse dyfish nga 1154 lekë në 2280 lekë duke llogaritur se shpenzimet si për investime ashtu edhe për shpenzimet e tjera të qendrës së zonës funksionale (qytetit të Pogradecit) do të mbeteshin të pandryshuara.

Duke ruajtur të pandryshuara shpenzimet për bashkinë e Pogradecit si qendër e zonës së re funksionale dhe duke shtuar shpenzimet e reduktuara nga njësitë e tjera që përthithen në zonën e re, vetëm nga qarkullimi i kursimeve pas reduktimit të shpenzimeve të personelit dhe operative, njësia e re do të jetë në gjendje të bëjë rreth 140 milion lekë investime ose 2 herë më shumë nga totali prej 71 milion lekë që këto njësi mund të realizojnë të veçuara.

Të ardhurat e veta

Bazuar mbi të ardhurat e raportuara për vitin 2012 shuma e agreguar e të ardhurave të veta (tatimore dhe jo tatimore) është 176,2 milion lekë. E pjesëtuar për numrin e popullsisë në zonë kjo shumë rezulton në një të ardhur për frymë prej 2865 lekë/frymë, e cila është 1,6 herë më e lartë se mesatarja e të ardhurave për frymë e NJQV-ve individuale (1631 lekë/frymë).

Figura 176 Krahasimi i të ardhurave të veta për frymë në zonën funksionale Pogradec




Burimi: Të dhënat e Ministrisë së Financave 2012, Llogaritjet e autorëve

Buxheti total

Në termat e buxhetit total për banorë zona funksionale përfaqësohet afërsisht si mesatare e vlerave të të gjitha njësive që përthithen rreth qytetit të Pogradecit.

Figura 177 Krahasimi i të ardhurave totale për frymë në zonën funksionale Pogradec dhe njësitë përbërëse.



Burimi: Të dhënat e Ministrisë së Financave 2012, Llogaritjet e autorëve

Të dhëna të tjera për zonën funksionale

Komunikacioni dhe transporti

I gjithë rrjeti rrugor që lidh Pogradecin si qendër e zonës funksionale me fshatrat si qendrat e komunave që përthithen llogaritet në rreth 140 km. Distanca mesatare nga qyteti i Pogradecit (qendra e zonës funksionale) në qendrat e njësive përbërëse është 17,5 km. Pika më e afërt me qytetin është Bucimasi vetëm 1,2 km ndërsa pika më e largët është 54 km (fshati Velcan). Tabela më sipër tregon në mënyrë të detajuar distancat që lidhin qendrën (qytetin) e zonës funksionale me qendrat (fshatrat) e tjerë.

Furnizimi me ujë dhe kanalizime

Në zonën funksionale të Pogradecit aktualisht është funksionale vetëm një operativ për furnizimin me ujë dhe shërbimin e kanalizimeve, përkatësisht Sh.A UK Pogradec i cila administron shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizime në qytetin e Pogradecit dhe pjesërisht në komunën e Bucimasit.

Krijimi i kësaj zone funksionale mund të shoqërohet në të ardhmen edhe me ndryshime në strukturën e operatorëve dhe shtrirjen e mbulimit me shërbim të furnizimit me ujë dhe kanalizime nën menaxhimin e një operatori për të gjithë zonën funksionale. Megjithëse, aktualisht shpenzimet që lidhen me këtë funksion janë pothuaj zero administrimi nga një operator i vetëm për të gjithë zonën do të ndikojë në uljen e kostove administrative dhe në rritjen e kapaciteteve njerëzore për përmirësimin e efikasitetit në kosto dhe menaxhim.

Menaxhimi i mbetjeve

Një funksion tjetër i rëndësishëm i qeverisjes vendore është dhe shërbimi i pastrimit dhe menaxhimit të mbetjeve, përfshirë këtu edhe disa shërbime të tjera publike. Në zonën funksionale të Pogradecit nga totali prej 414 milion lekësh shpenzime 250 milion lekë ose 63% e tyre shkon kryesisht për disa prej shërbimeve publike përfshirë dhe kryesisht menaxhimin e mbetjeve dhe pastrimit. Bashkimi i këtyre njësive do të rrisë efektivitetin e përdorimit të këtyre fondeve duke mbuluar edhe zonat periferike por edhe duke përmirësuar standardin e shërbimit.

Përfundime

Bashkimi i njësive në zonën funksionale me qendër qytetin e Pogradecit do të bëjë që shpenzimet administrative dhe ato korrente të ulen nga 340 milionë në 271 milionë lekë ose rreth 20% më pak duke marrë të pandryshuara shpenzimet e bashkisë Pogradec që do të mbetet qendër e zonës funksionale.

Për diferencë të uljes së shpenzimeve administrative dhe korrente të marra së bashku në njësitë që përthithen me vlerën 70 milionë lekë njësia e re, zona funksionale Korçë do të rrisë shpenzimet vjetore për investime rreth dyfish ose në totalin në 140,4 milionë lekë.

Qyteti i Pogradecit gjithashtu është destinacioni kryesor (mbas zonës Tiranë – Durrës) për lëvizjen e banorëve të komunave që e rrethojnë për të marrë shërbime si dhe mundësi punësimi.

Pjesët ekstreme të zonës funksionale Pogradec, veçanërisht fshatrat e komunave Velçan (54 km) dhe Propotisht (46,5 km) kanë komunikim të vështirë me qendrën e zonës (qyteti i Pogradecit) për shkak të distancës relativisht të madhe, por edhe për shkak të cilësisë së rrugës që lidh këto dy qendra me rrugët kryesore interurbane të qarkut të Korçës.

Juridiksioni administrativ i njësive vendore është fizikisht shumë i kufizuar dhe nuk i jep mundësi për një administrim efikas dhe të suksesshëm infrastrukturës rrugore. Brenda një Zone Funksionale krijohet mundësia e koordinuar dhe bashkëpunimi i munguar për planifikimin dhe menaxhimin e rrjetit rrugor, në të dy kategoritë: (i) rajonale, dhe (ii) lokale.

Zona funksionale do të krijojë mundësinë për strukturimin e shumë shërbimeve publike, veçanërisht të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime që aktualisht administrohen nga një operator i vetëm në dy njësi të cilat mund të agregohen në një të tillë duke sjellë si rrjedhojë reduktimin e shpenzimeve dhe rritjen e kapaciteteve njerëzore administrative.


Zona funksionale Maliq

Profili administrativo-territorial

Zona funksionale Maliq përfshin 6 njësi territoriale administrative. Kjo zonë është ndërtuar rreth qendrës urbane (qytetit) të Maliqit e përcaktuar si qendër lokale. Zona funksionale përthith komunat Libonik, Vreshtas, Pirg, Moglicë dhe Gore, përndryshe të përcaktuara kryesisht si zona bujqësore (ZB) fushore, malore ose të përziera, të cilat nuk përmbushin kushtet për të qenë qendër e zonës funksionale.

Bashkia e Maliqit paraqitet si qendër lokale komunikimi me interes ekonomik kryesisht në sektorin e bujqësisë, por dhe si pikë e kryqëzimit të rrugëve që lidhin këto komuna me qytetin.

Figura 178 Harta e zonës funksionale Maliq



Profili social-demografik

Zona funksionale Maliq ka një popullsi totale prej 45 800 banorësh. Tabela në vijim na jep një përmbledhje të të dhënave bazë socio - demografike për këtë zonë funksionale.


Tabela 95 Të dhëna bazë social demografike për zonën funksionale Maliq

Bashki/Komuna	Statusi funksional – administrativ	Popullsia (2013)	Sip. km ²	Dendësia (banorë/km ²)	Sip. km ² /1000 banorë	Sip. bujqësore ha	Sip ha/1000 banorë	Distanca në km nga qendra e zonës
Maliq (B)	Q	4290	36	223	4	474	59	0
Libonik	ZB	7513	73	188	5	3205	235	1,8
Vreshtas	ZB	8922	70	149	7	3658	352	18
Pirg	ZB	7652	61	157	6	1967	205	10,4
Moglicë	ZB	1565	234	6	163	402	279	35,1
Gore	ZB	951	178	15	67	874	328	18,4
Shuma		30 893	651	70	14	10 580	231	84
/mesatare				123			243	13,95
Urban		4290						
Rural		26 603						
% urban		14%						

Burimi INSTAT 2012, Llogaritjet e autorëve

Zona ka një sipërfaqe totale prej 651 km² ose mesatarisht 14 km² për 1000 banorë dhe një sipërfaqe bujqësore totale prej 10,580 ha ose 231 ha/1000 banorë krahasuar me mesataren prej 243 ha/1000 banorë kur ky tregues vlerësohet veçmas për secilën njësi brenda kësaj zone.

Figura 179 Harta e ndërveprimit ekonomik të NJQV-ve të Maliqit



Në zonën e bashkuar dendësia e popullsisë do të jetë 70 banorë/1 km² kundrejt mesatares prej 123 banorë/km², ndërsa sipërfaqja e tokës bujqësore do të jetë 231 ha/1000 banorë kundrejt mesatares si zonë prej 243 ha/1000 banorë.

Si qendër lokale, qyteti i Maliqit siguron shërbime shtesë kryesisht shëndetësore dhe arsimore në një distancë dhe drejtim komod për banorët e komunave që përthithen në këtë zonë funksionale.

Profili ekonomiko-financiar

Administrata

Duke iu referuar të dhënave për administratën në grupin e njësive rreth bashkisë Maliq, aktualisht të gjitha njësitë vendore kanë një personel prej 224 punonjësish⁷. Duke aplikuar një reduktim të personelit në masën 70% për të gjitha njësitë që përthithen dhe duke lënë të pandryshuar personelin e bashkisë së Maliqit, numri i personelit do të ulet në 91 punonjës ose 61% më pak se sa numri aktual.

⁷Pa përfshirë këtu numrin e këshilltarëve

Tabela 96 Personeli i NJQV para e pas agregimit

NJËSIA E QEVERISJES VENDORE	Totali i personelit aktual	Totali i personelit pas bashkimit
Totali komuna MALIQ	34	34
Totali komuna GORE	22	6,6
Totali komuna LIBONIK	49	14,7
Totali komuna MOGLICE	31	9,3
Totali komuna PIRG	43	12,9
Totali komuna VRESHTAS	45	13,5
TOTALI I ADMINISTRATËS ZF MALIQ	224	91
% e reduktimit te administratës		60%

Burimi: MÇV, llogaritjet e autorëve

Financat publike

Duke iu referuar te dhënave ekonomiko - financiare te vitit 2012, në zonën funksionale të propozuar, shuma e shpenzimeve të personelit për të gjitha njësitë që përthithen së bashku (73 milion lekë) zë rreth 43% te totalit te shpenzimeve (169 milion lekë), ndërsa shpenzimet për investime zënë vetëm 54 milion lekë ose 32% të totalit.


Tabela 97 Shpenzimet para dhe pas agregimit në ZF, Maliq (mijë lek)

Njësia	Popullsia 2011	Totali shpenzime 2012 (000/lek)	Shpenzime	Shpenzime	Shpenzime
			personel Total	operative 602-604	investime 230-231
Maliq	4290	16 000	15 000	4000	16 000
Vreshtas	7513	16 000	8000	18 000	16 000
Libonik	8922	28 000	19 000	-	28 000
Pirg	7652	15 000	8000	13 000	15 000
Gore	1565	10 000	4000	16 000	10 000
Moglicë	951	4000	3000	7000	4000
Shuma Maliq	30 893	89 000	57 000	58 000	89 000
Shuma të tjera	37 768	169 000	73 000	42 000	54 000
Totali zona funksionale		169 000	89 000	57 000	58 000
% e shpenzimeve ndaj totalit		100%	44%	28%	28%
Totali i reduktuar zona funksionale		169 000	26 700	51 300	126 000
% e reduktuar ndaj totalit			13%	25%	62%
Shpenzime për 1000 banorë para		6603	2881	1845	1877
Shpenzime për 1000 banorë pas		6603	864	1661	4079

Burimi: Të dhënat e Ministrisë së Financave 2012, llogaritjet e autorëve

Nga reduktimi i shpenzimeve për personelin (pagë dhe sigurime shoqërore) duke llogaritur një shkurtim të personelit (përfshirë këtu edhe numrin e këshilltarëve) në masën 70% vetëm për njësitë që përthithen për efekt të agregimit, vlera e shpenzimeve për personelin do të ulet nga 89 milionë lekë në 26,7 milionë lekë ose me 70% të shpenzimeve administrative gjithsej..

Figura 180 Ndryshimi i raportit të shpenzimeve vendore para dhe pas agregimit në zonën funksionale Maliq




Burimi: Të dhënat e Ministrisë së Financave 2012, Llogaritjet e autorëve

Po kështu, do të ulen shpenzimet operative nga 57 milionë në 51 milionë lekë. Nëse diferenca e shpenzimeve të kursyera për efekt të agregimit do të rishpërndahet në kursin e shpenzimeve, atëherë shpenzimet për investime në zonën funksionale vetëm për njësitë e përthithura do të rriteshin nga 58 milionë në 126 milion lekë duke e ndryshuar peshën aktuale nga 28% në 62% të totalit, rrjedhimisht duke përfituar një rritje prej mbi 2 herë më shumë. (Figura 180).

E njëjta tendencë pozitive vërehet edhe kur krahasohet raporti i shpenzimeve të personelit dhe ato operative për 1000 banorë, të cilat në kuadër të zonës funksionale do të uleshin me 30% nga 1,59 milion në 0,5 milion lekë, ndërsa shpenzimet për investime për 1000 banorë do të rriteshin po ashtu me 228% ose në vlerë absolute nga 1,18 milion në 2,9 milion lekë për 1000 banorë duke llogaritur se shpenzimet si për investime ashtu edhe për shpenzimet e tjera të qendrës së zonës funksionale (qytetit të Maliqit) do të mbeteshin të pandryshuara.

Figura 181 Ndryshimi i shpenzimeve për banorë para dhe pas agregimit në zonën funksionale Maliq (lek, 2012)



Burimi: Të dhënat e Ministrisë së Financave 2012, Llogaritjet e autorëve

Duke ruajtur të pandryshuara shpenzimet për bashkinë e Maliqit si qendër e zonës së re funksionale dhe duke shtuar shpenzimet e reduktuara nga zonat e tjera që përthithen në zonën e re, vetëm nga qarkullimi i kursimeve pas reduktimit të shpenzimeve të personelit dhe ato operative, njësia e re do të jetë në gjendje të bëjë rreth 126 milionë lekë investime ose mbi dy herë më shumë nga totali prej 58 milion lekë investime që këto njësi mund të bëjnë veç e veç.

Të dhëna të tjera për zonën funksionale

Komunikimi dhe transporti

Edhe kjo zonë ka një rrjet rrugor të zhvilluar i cili lejon një qarkullim të lehtësuar dhe lidh qendrën e zonës (qytetin e Maliqit) me rrugë të kategorisë “Interurbane dytësore⁸” 4 prej 6 njësive/qendrave të tjera të zonës, me përjashtim të fshatit Gore (qendra e komunës Gore që lidhet me rrugët interurbane më të afërta me rrugë lokale.

Distanca mesatare nga qyteti i Maliqit (qendra e zonës funksionale) me qendrat e komunave përbërëse është 13,9 km. Pika më e afërt me qytetin është 1,8 km (fshati Libonik) ndërsa pika më e largët është 35,1 km (fshati Moglicë) që gjithsesi është i lidhur me Maliqin me një rrugë interurbane funksionale. Në fakt pjesa me komunikim të vështirë në këtë zonë janë fshatrat e komunës Gore për efekt të distancës, por veçanërisht cilësisë së rrugës. Por gjithsesi Maliqi, si qendër e zonës funksionale ofron mundësi më të mëdha komunikimi dhe shërbimesh se qendrat e tjera të rrethit.

Shërbime të tjera, furnizimi me ujë dhe menaxhimi i mbetjeve


Furnizimi me ujë në Pirg, Vreshtaz, Libonik si njësi që përthithen dhe qytetin e Maliqit si qendër e zonës funksionale, administrohet nga operator Sh.A Ujësjiellës Korçë Fshat.

⁸Klasifikimi sipas kodit rrugor

Bëjnë përjashtim këtu Moglica dhe Gora të cilat e menaxhojnë këtë shërbim të pavarur nga kompanitë që operojnë në rreth. Aktualisht kontributi ose shpenzimet e njësive në këtë shërbim është i papërfillshëm ose praktikisht 0 lekë.

Vetëm komuna Moglicë ka shpenzuar rreth 1 milion lekë në vitin 2012 për këtë shërbim.

Figura 182 Mbulimi me shërbimin e furnizimit me ujë, ZF Maliq



Burimi: Të dhënat e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës 2012, Llogaritjet e autorëve

Krijimi i zonës funksionale Maliq por edhe ajo e Korçës do të kushtëzojnë edhe riorganizimin dhe ristrukturimin e këtyre ndërmarrjeve, ndoshta një ndërmarrje e re mund të krijohet për të menaxhuar këtë shërbim, por jo vetëm për zonën funksionale të Maliqit.

Nga totali prej 204 milion lekësh, 127 milion lekë ose 60% shkojnë për shërbime publike, kryesisht pastrimi dhe menaxhimi i mbetjeve dhe 54 milion ose 26% janë për transport.

Riorganizimi në një zonë funksionale do të bëjë të mundur një shpërndarje dhe mbulim më të mirë si me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve ashtu dhe shpenzimet e transportit e të tjera.

Përfundime

Agregimi ose bashkimi i njësive në zonën funksionale me qendër qytetin e Maliqit do të sjellë uljen e shpenzimeve administrative dhe ato korrente nga 89 milionë në 27 milionë lekë duke dhënë një diferencë prej 68 milionë lekësh ose rreth 70% më pak se në rastin e funksionimit të veçuar të njësive që bashkohen.

Kjo diferencë do të bëjë të mundur që njësia e re, zona funksionale Maliq të dedikojë burime të mëdha për shpenzimet vjetore për investime nga 58 milionë në 126 milionë lekë vetëm nga shkurtimet e shpenzimeve administrative dhe korrente të marra së bashku.

Pjesët ekstreme të zonës funksionale Maliq, veçanërisht fshatrat e komunës Moglicë (38 km) dhe Gorë (18,5 km) kanë komunikim të vështirë me qendrën e zonës (qyteti i Maliqit) për shkak të distancës relativisht të madhe, por edhe për shkak të cilësisë së rrugës që lidh këto dy qendra me rrugët kryesore interurbane të qarkut të Korçës. Gjithsesi Maliqi është qendra më e afërt administrative për këto njësi kur krahasohen me qendrat e tjera funksionale të qarkut.


Zona funksionale do të krijojë mundësinë për strukturimin e shumë shërbimeve publike, veçanërisht të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve që aktualisht administrohet nga operatori SH.A. U Korçë Fshat. Në të njëjtën mënyrë agregimi mund të sjellë efektivitet në përdorimin e fondeve të tjera për shërbime publike dhe veçanërisht mbulimin me shërbime të tilla si pastrimi dhe menaxhimi i mbetjeve ose transporti publik etj.

Zona funksionale Pustec

Profili administrativo-territorial

Zona funksionale Pustec përputhet me territorin administrativ të komunës me të njëjtin emër. Kjo zonë ndodhet në skajin veri-lindor të qarkut Korçë në kufi me Maqedoninë. Zona përbëhet nga 9 fshatra me qendër në fshatin Liqenas.

Figura 183 Harta e zonës funksionale Pustec



Profili social-demografik

Zona funksionale Pustec ka një popullsi prej 3290 banorësh. Popullsia e zonës funksionale Pustec në pjesën më të madhe përbëhet nga pakica me origjinë Maqedonase, gjë që përbën dhe arsyen kryesore për të cilën kjo njësi është përcaktuar si zonë e veçantë funksionale.

Tabela 98 Të dhënat social demografike për zonën funksionale Pustec

Bashki/Komuna	Statusi administrativ - funksional	Popullsia (2011)	Sip. km ²	Sip. km ² /1000 banorë	Sip. bujqësore ha	Sip ha/1000 banorë	Distanca në km nga qendra e Qarkut
Pustec	ZM	3290	160,1	30	873,9	165	

Burimi: Të dhënat e Ministrisë së Financave 2012, Llogaritjet e autorëve

Zona mbulon një sipërfaqe prej rreth 160 km² dhe ka një densitet prej 16,5 banorë/km².

Profili ekonomiko-financiar

Reforma territoriale administrative nuk pritet të sjellë përfitime të drejtpërdrejta për zonën funksionale/komunën Pustec.

Referuar të dhënave për vitin 2012 komuna Pustec ka një buxhet total prej 70 196 mijë lekësh, prej të cilëve të ardhurat e veta tatimore dhe jo tatimore përbëjnë vetëm 4 % të totalit duke treguar për një performancë fiskale shumë të ulët, ndërsa 67% e përbëjnë të ardhurat nga transfertat e kushtëzuara.

Duke ju referuar të dhënave të vitit 2012 komuna Pustec ka një nivel relativisht të ulët të transfertës së pakushtëzuar për banorë në vlerën prej afro 5600 lekë/banor në vit.

Shpenzimet administrative dhe operative përbejnë 54% të totalit të shpenzimeve prej 35 milion lekësh ose 27% të buxhetit total, ndërsa zëri investime zë vetëm 46% të shpenzimeve ose rreth 23% të buxhetit total vjetor. Pjesa tjetër e buxhetit prej rreth 47% shpenzohet për të mbuluar ushtrimin e disa shërbimeve publike dhe shpenzime transporti.

Pasqyrat e shpenzimeve dhe e të ardhurave në këtë njësi tregojnë se veprimtaria administrative dhe ushtrimi i funksioneve varen tërësisht prej të ardhurave nga transfertat e pakushtëzuar.

Të dhëna të tjera për zonën funksionale

Fshati Liqenas si qendra e zonës funksionale Pustec ndodhet 27,5 km nga qyteti i Korçës si qendra e qarkut. Të dy këto destinacione lidhen me një rrugë interurbane e nivelit të mirë duke e bërë komunikimin dhe transportin në kushte të pranueshme.

Shërbimi i furnizimit me ujësjellësit administrohet nga komuna.

Përfundime

Komuna Pustec qëndron si zonë funksionale vetëm për arsye të faktit se shumica e popullsisë që banon në territorin e saj është e përkatësisë etniko-kulturore maqedonase.

Zona funksionale Kolonjë

Profili administrativo-territorial

Zona funksionale Kolonjë përfshin 8 njësi territoriale administrative. Qendra urbane e kësaj zone është qyteti i Ersekës që në aspektin administrativ dhe funksional përcaktohet si qytet qendër rrethi (QR).

Zona funksionale përfshin komunat Leskovik, Qendër Ersekë, Mollas, Çlirim, Novoselë, Bramash, Qendër Leskovik, përndryshe të përcaktuar kryesisht si zona bujqësore (ZB) fushore, malore ose të përziera, të cilat nuk përmbushin kushtet për të qenë qendër e zonës funksionale.

Figura 184 Harta e zonës funksionale Kolonjë



Profili social-demografik

Zona funksionale Kolonjë ka një popullsi totale prej 11 070 banorësh. Të gjitha njësitë në këtë zonë kanë një popullsi më të vogël se 5000 banorë. Zonat më të populluara janë bashkia Ersekë (3746), komuna Qendër Ersekë (2673), bashkia Leskovik (1525) dhe komuna Mollas (1520).

Tabela 99 Të dhëna bazë social demografike për zonën funksionale Kolonjë

Bashki/Komuna	Statusi funksional – administrativ	Popullsia (2013)	Sip. km ²	Dendësia banorë/km ²	Sip. km ² /1000 banorë	Sip. bujqësore ha	Sip ha/1000 banorë	Distanca në km nga qendra e zonës
Ersekë	Q	3746	6	624	2	21 814	5823	0
Leskovik	Q	1525	7	218	5	117	77	43
Qendër Ersekë	ZB	2673	158	17	59	1852	693	0
Mollas	ZB	1520	70	22	46	1361	895	31,7
Çlirim	ZB	355	115	3	325	249	703	45,5
Novoselë	ZB	355	98	4	275	322	908	59
Bramash	ZB	480	84	6	174	228	476	57
Qendër Leskovik	ZB	416	218	2	524	160	385	43,6
Shuma		11 070	756	15	68	26 105	2358	280
/mesatare				112	176		1245	34,975
Urban		5271						
Rural		7324						
% urban		48%						

Burimi: Të dhënat e Ministrisë së Financave 2012, Llogaritjet e autorëve


Për efekt të agregimit llogaritet që popullsia rurale në zonë të zërë 52% të totalit ndërsa popullsia urbane 48% të totalit, e cila banon kryesisht në qytetin e Ersekës.

Zona ka një sipërfaqe totale prej 756 km² ose 68 km² për 1000 banorë dhe një sipërfaqe bujqësore totale prej rreth 26 105 ha ose 2358 ha/1000 banorë krahasuar me mesataren prej 1245 ha/1000 banorë kur ky tregues vlerësohet veçmas për secilën njësi brenda kësaj zone.

Dendësia e popullsisë do të ulet në 15 banorë për 1 km² ndërsa mesatarja e dendësisë për të gjitha njësitë e marra së bashku është disa herë më e lartë ose 176 banorë për 1 km².

Qyteti i Ersekës është njëkohësisht qendër rrethi. Ai hyn në kategorinë e qyteteve me rëndësi të veçantë, ku janë përqendruar institucionet qendrore të cilat sigurojnë shërbime ekstra kur krahasohen me qendra të tjera urbane dhe veçanërisht me komunat në zonat rurale që e rrethojnë.

Figura 26: Harta e ndërveprimit ekonomik në zonën funksionale Kolonjë



Qyteti i Ersekës gjithashtu është destinacioni kryesor për lëvizjen e banorëve të komunave që e rrethojnë për të marrë shërbime si dhe mundësi punësimi.

Siç vihet re dhe nga hartat më sipër, evidentohet se Erseka është qendër funksionale e zonës për efekt të shërbimeve dhe të numrit më të madh të bizneseve që përqendrohen në këtë qytet.

Profili ekonomiko-financiar

Administrata

Duke iu referuar të dhënave për administratën në rrethin e Kolonjës, aktualisht të gjitha njësitë vendore kanë një personel që në total përbëhet nga një numër prej 170 punonjësish⁹. Duke aplikuar një reduktim të personelit në masën 70% për të gjitha njësitë që përthithen dhe duke lënë të pandryshuar personelin e bashkisë së Ersekës, numri i personelit do të ulet në 68 punonjës ose 40% më pak sesa numri aktual.

⁹Pa përfshirë këtu numrin e këshilltarëve

Tabela 100 Personeli NJQV/1000 banorë para dhe pas agregimit

NJËSIA E QEVERISJES VENDORE	Totali i personelit	Totali i personelit pas agregimit
ERSEKË	55	55
Totali i administratës bashkia LESKOVIK	24	7,2
Totali i administratës komuna QENDËR ERSEKË	26	7,8
MOLLAS	23	6,9
ÇLIRIM	12	3,6
NOVOSELË	10	3
BRAMASH	11	3,3
QENDËR LESKOVIK	14	4,2
TOTALI I ADMINISTRATËS SË RRETHIT KOLONJË	175	91
Ngarkesa për 1000 banorë	15,8	8,2

Burimi: MÇV, llogaritjet e autorëve

Ngarkesa e administratës për 1000 banorë në rrethin e Kolonjës është aktualisht 15,8 punonjës për 1000 banorë, ndërsa në kushtet e zonës funksionale për efekt të agregimit do të jetë 8,2 punonjës për 1000 banorë.

Financat publike

Duke iu referuar të dhënave ekonomike - financiare të vitit 2012 në zonën funksionale të propozuar, shuma e shpenzimeve të personelit për të gjitha njësitë që përthithen së bashku (47 milion lekë) zë rreth 82% të totalit të shpenzimeve (57 milion lekë), ndërsa shpenzimet për investime zënë vetëm 33 milion lekë ose 57% të totalit.

Tabela 101 Shpenzimet para bashkimit në ZF, Kolonjë.

Njësia	Popullsia 2011	Totali shpenzime 2012 (000/lek)	Shpenzime personel Total	Shpenzime operative	Shpenzime investime
				602-604	230-231
Ersekë	3746	50	21	29	0
Leskovik	1525	41	10	7	24
Qendër	2673	22	13	9	0
Mollas	1520	14	9	5	0
Çlirim	355	6	2	1	3
Barmash	480	7	2	2	3
Piskal-Novoselë	355	8	6	2	0
Qendër Leskovik	416	10	5	2	3
Shuma Kolonjë	3746	50	21	29	0
Shuma të tjera	7324	108	47	28	33
Shuma të gjitha	11 070	158	68	57	33
% shpenzimeve ndaj totalit			43%	36%	21%

Burimi: Të dhënat e Ministrisë së Financave 2012, Llogaritjet e autorëve


Nga reduktimi i shpenzimeve për personelin (pagë dhe sigurime shoqërore) në masën 70% pa përfshirë këtu numrin e këshilltarëve, vetëm për njësitë që përthithen për efekt të agregimit, vlera e shpenzimeve për personelin do të ulet nga 47 milion në 14 milion lekë duke zënë vetëm 13 % të totalit të shpenzimeve. Po kështu, do të ulen shpenzimet operative nga 68 milionë në 35 milionë lekë. Nëse diferenca e shpenzimeve të kursyera për efekt të agregimit do të rishpërndahet në kursin e shpenzimeve, atëherë shpenzimet për investime në zonën funksionale do të rriteshin nga 33 milion në 68,7 milionë lekë duke e ndryshuar raportin aktual nga 21% në 43% të totalit të shpenzimeve, rrjedhimisht duke përfitur një rritje prej mbi 2 herë më shumë. (Figura 185).

Tabela 102 Shpenzimet pas agregimit në ZF Kolonjë

	Shpenzime gjithsej	Personel	Operative	Investime
Totali zona funksionale	158 000	68 000	57 000	33 000
% e shpenzimeve ndaj totalit	100%	43%	36%	21%
Totali i reduktuar zona funksionale	158 000	35 100	54 200	68 700
% e reduktuar ndaj totalit	100%	22%	34%	43%
Shpenzime për 1000 banorë para	14 273	6143	5149	2981
Shpenzime për 1000 banorë pas	14 273	3171	4896	6206


Burimi: Të dhënat e Ministrisë së Financave 2012, Llogaritjet e autorëve

Figura 185 Ndryshimi i raportit të shpenzimeve vendore para dhe pas agregimit në zonën funksionale Kolonjë



E njëjta tendencë pozitive vërehet edhe kur krahasohet raporti i shpenzimeve të personelit dhe ato operative për 1000 banorë, të cilët në kuadër të zonës funksionale do të uleshin me 50% nga 6150 në 3171 lekë, ndërsa shpenzimet për investime për banorë do të rriteshin po ashtu me dyfish ose në vlerë absolute nga nën 3 mijë lekë në mbi 6 mijë lekë për banor duke llogaritur se shpenzimet si për investime ashtu edhe për shpenzimet e tjera të qendrës së zonës funksionale (qytetit të Ersekës) do të mbeteshin të pandryshuara.

Figura 186 Ndryshimi i shpenzimeve lekë/1000 banorë para dhe pas agregimit në zonën funksionale Kolonjë



Burimi: Të dhënat e Ministrisë së Financave 2012, Llogaritjet e autorëve


Duke ruajtur të pandryshuara shpenzimet për bashkinë e Ersekës si qendër e zonës së re funksionale dhe duke shtuar shpenzimet e reduktuara nga njësitë e tjera që përthithen në

zonën e re, vetëm nga qarkullimi i kursimeve pas reduktimit të shpenzimeve të personelit dhe operative, njësia e re do të jetë në gjendje të bëjë rreth 68 milionë lekë investime ose mbi 2 herë më shumë nga totali prej 33 milion lekësh që këto njësi mund të realizojnë të veçuara.

Të ardhurat e veta

Bazuar mbi të ardhurat e raportuara për vitin 2012 shuma e agreguar e të ardhurave të veta (tatimore dhe jo tatimore) është 35 813 milion lekë. E pjesëtuar për numrin e popullsisë në zonë kjo shumë rezulton në një të ardhur për frymë prej 4447 lekë/frymë, e cila është rreth 40% më shumë se mesatarja e të ardhurave për frymë në secilën NJQV e llogaritur vetëm në vlerën 3235 lekë/frymë.

Figura 187 Krahasimi i të ardhurave për frymë në ZF Kolonjë dhe mesatarja në njësitë individuale (2012, lek)




Burimi: Të dhënat e Ministrisë së Financave 2012, Llogaritjet e autorëve

Buxheti total

Në termat e buxhetit total për banorë, zona funksionale përfaqësohet afërsisht si mesatare e vlerave të të gjitha njësive që përthithen rreth qytetit të Ersekës.

Figura 188 Krahasimi i buxhetit total për banorë në zonën funksionale Kolonjë dhe njësitë përbërëse.




Burimi: Të dhënat e Ministrisë së Financave 2012, Llogaritjet e autorëve

Të dhënat i referohen buxhetit të vitit 2012 të raportuar nga Ministria e Financave, ndërsa grafikët janë përpunuar nga autori i raportit.

Të dhëna të tjera për zonën funksionale

Transporti

Distanca mesatare nga qyteti i Ersekës (qendra e zonës Funksionale) me qendrat e komunave përbërëse është 35 km. Pika më e afërt me qytetin është 35 km (fshati Mollas) ndërsa pika më e largët është Novoselë 59 km (fshati Novoselë) që gjithsesi është i lidhur me Ersekën me një rrugë interurbane funksionale. Në fakt pjesa më e madhe e qendrave të komunave si dhe të fshatrave që përthithen janë në distancë të madhe dhe rrugë jo cilësore që e bëjnë komunikimin dhe transportin të vështirë në këtë zonë funksionale




Shërbime të tjera, furnizimi me ujë dhe menaxhimi i mbetjeve

Shërbimin e furnizimit me ujë të gjitha komunat që përhithen e administrojnë vetë, ndërsa i vetmi operator në zonë, Sh.A Ujësjetës Ersekë e menaxhon këtë shërbim vetëm për qytetin e Ersekës.

Aktualisht kontributi ose shpenzimet e njërive në këtë shërbim është i papërfillshëm ose praktikisht 0,0 lekë, ndërsa komuna Qendër Leskovik dhe bashkia Leskovik kanë financuar respektivisht nga 1 milion lekë për këtë shërbim gjatë vitit 2012.

Figura 32 Mbulimi me shërbimin e furnizimit me ujë, ZF Kolonjë



Krijimi i zonës funksionale Kolonjë do të kushtëzojë edhe riorganizimin dhe ristrukturimin e këtyre ndërmarrjeve. Një ndërmarrje e re mund të krijohet për të menaxhuar këtë shërbim, por jo vetëm edhe në zonën funksionale të Maliqit.

Nga totali prej 158 milion lekësh 107 milion lekë ose 68% shkojnë për shërbime publike, kryesisht pastrimi dhe menaxhimi i mbetjeve dhe 22 milion ose 14% janë për transport.

Tabela 103 Shpërndarja e shpenzimeve sipas funksioneve kryesore

Kolonjë	Shpërndarja e shpenzimeve sipas funksioneve kryesore				
	Totali	Ujësjellës	Shërbime publike	Transport	Të tjera
Shpenzime	158	2	107	22	27,0
% ndaj totalit	100%	1%	68%	14%	17%

Burimi: Të dhënat e Ministrisë së Financave 2012, Llogaritjet e autorëve

Riorganizimi në një zonë funksionale do të bëjë të mundur një shpërndarje dhe mbulim më të mirë si me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve ashtu dhe shpenzimet e transportit e të tjera.

Përfundime

Bashkimi i njësive në zonën funksionale me qendër qytetin e Ersekës do të sjellë uljen e shpenzimeve administrative dhe ato korrente nga 125 milionë në 89 milionë lekë duke dhënë një diferencë prej 35,7 milion lekësh ose rreth 60% me pak se në rastin e funksionimit të veçuar të njësive që bashkohen.

Kjo diferencë do të bëjë të mundur që njësia e re ose zona funksionale Kolonjë të dedikojë burime të mëdha për shpenzimet vjetore për investime nga 33 milion lekë në 69 milionë lekë vetëm nga shkurtimet e shpenzimeve administrative dhe korrente të marra së bashku.

Pjesët ekstreme të zonës funksionale Kolonjë, veçanërisht fshatrat e komunës Novosele (59 km) dhe Bramash (58 km) kanë komunikim të vështirë me qendrën e zonës (qyteti i Ersekës) për shkak të distancës relativisht të madhe, por edhe për shkak të cilësisë së rrugës që lidh këto dy qendra me rrugët kryesore interurbane të qarkut të Korçës.

Zona funksionale do të krijojë mundësinë për strukturimin e shumë shërbimeve publike, veçanërisht të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve që aktualisht administrohet nga operatori Sh.A. U Ersekë. Në të njëjtën mënyrë agregimi mund të sjellë efektivitet në përdorimin e fondeve të tjera për shërbime publike dhe veçanërisht mbulimin me shërbime të tilla si pastrimi dhe menaxhimi i mbetjeve, transporti publik etj.


Zona funksionale Devoll

Profili administrativo-territorial

Zona funksionale DEVOLL përfshin 5 njësi territoriale administrative. Qendra urbane e kësaj zone është qyteti i Bilishtit që në aspektin administrativ dhe funksional përcaktohet si qytet qendër rrethi (QR).

Zona funksionale përfshin bashkinë Bilisht, komunat Qendër, Proger, Hoçisht dhe Miras, përndryshe të përcaktuar kryesisht si zona bujqësore (ZB) fushore, malore ose të përziera, të cilat nuk përmbushin kushtet për të qenë qendër e zonës funksionale.

Figura 189 Harta e zonës funksionale Devoll



Profili social-demografik

Zona funksionale Devoll ka një popullsi totale prej 26 716 banorësh. Dy nga pesë njësi në këtë zonë kanë një popullsi më të vogël se 5000 banorë. Zona më e populluar është Komuna Miras 6577, bashkia Bilisht 6250 dhe komuna Qendër Bilisht 5440. Tabela në vijim na jep një përmbledhje të të dhënave bazë socio-demografike të kësaj zone.

Tabela 104 Të dhëna bazë social demografike për zonën funksionale Devoll

Bashki/Komuna	Statusi funksional – administrativ	Popullsia (2013)	Sip. km ²	Dendësia banorë/km ²	Sip. km ² /1000 banorë	Sip. bujqësore ha	Sip. ha/1000 banorë	Distanca në km nga qendra e zonës
Bilisht	Q	6250	4	1786	1	-	-	0
Qendër	ZB	5440	100	54	18	2939	540	0
Proger	ZB	3988	90	44	23	1580	396	7
Hocisht	ZB	4461	104	43	23	2686	602	6
Miras	ZB	6577	179	37	27	3007	457	16
Shuma		26 716	476	56	18	10 212	382	29
/mesatare				393			399	5.8
Urban		6250						
Rural		20 466						
% urban		23%						


Burimi: INSTAT 2012, Llogaritjet e autorëve

Për efekt të agregimit llogaritet që popullsia rurale në zonë të zërë 77 % të totalit ndërsa popullsia urbane 23 % të totalit, e cila banon kryesisht në qytetin e Bilishtit. Zona ka një sipërfaqe totale prej 476 km² ose 18 km² për 1000 banorë dhe një sipërfaqe bujqësore totale prej rreth 10 212 ha ose 382 ha/1000 banorë krahasuar me mesataren prej 389 ha/1000 banorë kur ky tregues vlerësohet veçmas për secilën njësi brenda kësaj zone.

Dendësia e popullsisë do të ulet në 56 banorë për 1 km² ndërsa mesatarja e dendësisë për të gjitha njësitë e marra së bashku është disa herë më e lartë ose 393 banorë për 1 km².

Qyteti i Bilishtit është njëkohësisht qendër rrethi. Ai hyn në kategorinë e qyteteve ku janë përqendruar institucionet lokale të cilat sigurojnë shërbime ekstra kur krahasohen me qendra të tjera urbane dhe veçanërisht me komunat në zonat rurale që e rrethojnë.

Figura 36: Harta e ndërveprimit ekonomik të zonës funksionale Devoll



Qyteti i Bilishtit gjithashtu është destinacioni kryesor (mbas zonës Korçë – Pogradec) për lëvizjen e banorëve të komunave që e rrethojnë për të marrë shërbime si dhe mundësi punësimi.

Siç vihet re dhe nga hartat më sipër, evidentohet se Bilishti është qendër funksionale e zonës për efekt të shërbimeve dhe të numrit më të madh të bizneseve që përqendrohen në këtë qytet, por edhe në zonën rreth tij.

Profili ekonomik-financiar

Administrata

Duke iu referuar të dhënave për administratën në rrethin e Devollit, aktualisht të gjitha njësitë vendore kanë një numër prej 176 punonjësish¹⁰. Duke aplikuar një reduktim të personelit në masën 70% për të gjitha njësitë që përthithen dhe duke lënë të pandryshuar personelin e bashkisë së Bilishtit, numri i personelit do të ulet në 91 punonjës ose 40% më pak se sa numri aktual.

¹⁰Pa përfshirë këtu numrin e këshilltarëve

Tabela 105 Ngarkesa e personelit për 1000 banorë në NJQV

NJËSIA E QEVERISJES VENDORE	Totali i personelit	Totali i personelit pas agregimit
BILISHT	54	54
QENDËR	35	10,5
PROGER	31	9,3
HOÇISHT	28	8,4
MIRAS	28	8,4
TOTALI I ADMINISTRATËS DEVOLL	176	90,6
TOTALI I ADMINISTRATËS DEVOLL	15,9	8,2

Burimi: MÇV, llogaritja e autorëve

Ngarkesa e personelit për 1000 banorë do të ulet nga 16 punonjës në 8 punonjës ose afërsisht 50% më pak krahasuar me shumën e njësisve vendore në këtë zonë.

Financat publike

Duke u referuar me të dhënat ekonomiko - financiare të vitit 2012 në zonën funksionale të propozuar, shuma e shpenzimeve të personelit për të gjitha njësitë që përthithen së bashku (59 milion lekë) zë rreth 18% të totalit të shpenzimeve (69 milion lekë), ndërsa shpenzimet për investime zënë vetëm 67 milion lekë ose 33% të totalit.

Tabela 106 Shpenzimet para bashkimit në ZF, Devoll.

Njësia	Popullsia 2011	Totali shpenzime 2012 (000/lek)	Shpenzime personel Total	Shpenzime	
				operative 602-604	investime 230-231
Bilisht	6250	55 000	24 000	29 000	2000
Miras	6577	42 000	17 000	6000	19 000
Hoçisht (Morave)	5440	41 000	10 000	6000	25 000
Qendër-Bilisht	4461	37 000	14 000	7000	16 000
Progër	3988	33 000	18 000	8000	7000
Shuma Devoll	6250	55 000	24 000	29 000	2000
Shuma të tjera	20 466	153 000	59 000	27 000	67 000
Shuma ZF	26 716	208 000	83 000	56 000	69 000
% e shpenzimeve ndaj totalit			40%	27%	33%

Burimi: Të dhënat e Ministrisë së Financave 2012, llogaritjet e autorëve


Nga reduktimi i shpenzimeve për personelin (pagë dhe sigurime shoqërore), duke llogaritur një shkurtim të personelit (përfshirë këtu edhe numrin e këshilltarëve) në masën 70% vetëm për njësitë që përthithen për efekt të agregimit, vlera e shpenzimeve për personelin do të ulet nga 83 milionë lekë në 25 milion lekë duke zënë vetëm 12 % të totalit të shpenzimeve. Po kështu, do të ulen shpenzimet operative nga 56 milionë lekë në 50 milionë lekë. Nëse diferenca e shpenzimeve të kursyera për efekt të agregimit do të rishpërndahen në kursin e shpenzimeve, atëherë shpenzimet për investime në zonën funksionale vetëm për njësitë e përthithura do të rriteshin nga 69 milionë lekë në 132 milionë lekë duke e ndryshuar raportin aktual nga 33% në 64% të totalit të shpenzimeve, rrjedhimisht duke përfituar një rritje prej rreth 189 % ose pothuaj 2 herë më shumë.

Tabela 107 Shpenzimet pas agregimit në njësitë e tjera të ZF Devoll (përfshijto bashkinë Bilisht)

	Shpenzime gjithsej	Personel	Operative	Investime
Totali zona funksionale	208 000	83 000	56 000	69 000
% e shpenzimeve ndaj totalit	100%	40%	27%	33%
Totali i reduktuar zona funksionale	208 000	24 900	50 400	132 700
% e reduktuar ndaj totalit	100%	12%	24%	64%
Shpenzime për 1000 banorë para	7786	3107	2096	2583
Shpenzime pëe1000 banorë pas	7786	932	1887	4967

Burimi: Të dhënat e Ministrisë së Financave 2012, Llogaritjet e autorëve


Figura 190 Ndryshimi i raportit të shpenzimeve vendore para dhe pas agregimit në zonën funksionale Devoll (mijë lek)



Burimi: Të dhënat e Ministrisë së Financave 2012, Llogaritjet e autorëve

Shpenzimet për investime për 1000 banorë do të rriteshin po ashtu me 187% ose në vlerë absolute nga 2583 në 4967 lekë për banor duke llogaritur se shpenzimet si për investime ashtu edhe për shpenzimet e tjera të qendrës së zonës funksionale (qytetit të Bilishtit) do të mbeteshin të pandryshuara.

Figura 191 Ndryshimi i shpenzimeve lek/1000 banorë para dhe pas agregimit në zonën funksionale Devoll




Burimi: Të dhënat e Ministrisë së Financave 2012, Llogaritjet e autorëve

Të ardhurat e veta

Bazuar mbi të ardhurat e raportuara për vitin 2012 shuma e agreguar e të ardhurave të veta (tatimore dhe jo tatimore) është 12,3 milion lekë. E pjesëtuar për numrin e popullsisë në zonë kjo shumë rezulton në një të ardhur për frymë prej 0,5 lekë/frymë, e cila është 0,4 herë më pak se mesatarja e të ardhurave për frymë e llogaritur në vlerën 1,100 lekë/frymë.

Figura 192 Krahasimi i të ardhurave të veta për frymë në zonën funksionale Devoll




Burimi: Të dhënat e Ministrisë së Financave 2012, Llogaritjet e autorëve

Buxheti total

Në termat e buxhetit total për banorë zona funksionale përfaqësohet afërsisht si mesatare e vlerave të të gjitha njësive që përthithen rreth qytetit të Bilishtit.

Figura 193 Krahasimi i buxhetit total për banorë në zonën funksionale Devoll dhe njësitë përbërëse.



Burimi: Të dhënat e Ministrisë së Financave 2012, Llogaritjet e autorëve

Të dhëna të tjera për zonën funksionale

Transporti


Distanca mesatare nga qyteti i Bilishtit (qendra e zonës funksionale) me qendrat e komunave përbërëse është 5,8 km. Pika më e afërt me qytetin është 0 km (komuna Qendër) ndërsa pika më e largët është komuna Miras 16 km (fshati Miras) që gjithsesi është i lidhur me Bilishtin me një rrugë interurbane funksionale. Në fakt pjesa më e madhe e qendrave të komunave si dhe të fshatrave që përthithen janë në distancë të vogël dhe rrugë relativisht cilësore.

Shërbime të tjera, furnizimi me ujë dhe menaxhimi i mbetjeve.

Furnizimi me ujë në të gjitha komunat që përthithen e administrojnë vetë shërbimin e furnizimit me ujë, ndërsa i vetmi operator në zonë, Sh.A Ujësjellës Bilisht e menaxhon këtë shërbim vetëm për qytetin e Bilishtit.

Aktualisht kontributi ose shpenzimet e njërive në këtë shërbim është i konsiderueshëm ose praktikisht 18 lekë ose 9 % e totalit të shpenzimeve. Vetëm komuna Miras ka financuar 6 milion lekë ose 33 % e totalit në vitin 2012.

Figura 41 Mbulimi me shërbimin e furnizimit me ujë, ZF Devoll



Krijimi i zonës funksionale Devoll do të kushtëzojë edhe riorganizimin dhe ristrukturimin e këtyre ndërmarrjeve. Një ndërmarrje e re mund të krijohet për të menaxhuar këtë shërbim, por jo vetëm edhe në zonën funksionale të Devollit.

Nga totali prej 208 milion lekësh, 96 milion lekë ose 46% shkojnë për shërbime publike, kryesisht shërbime pastrimi dhe menaxhimi i mbetjeve dhe 51 milion ose 25% janë për transport.

Figura 194 Shpërndarja e shpenzimeve sipas funksioneve për NJQV

Devoll	Totali	Shpërndarja e shpenzimeve sipas funksioneve kryesore			
		Ujësjiellës	Shërbime publike	Transport	Të tjera
Shpenzime	208	18	96	51	43,0
% ndaj totalit	100%	9%	46%	25%	21%

Burimi: Të dhënat e Ministrisë së Financave 2012, Llogaritjet e autorëve

Riorganizimi në një zonë funksionale do të bëjë të mundur një shpërndarje dhe mbulim më të mirë si me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve ashtu dhe shpenzimet e transportit e të tjera.

Përfundime

Bashkimi i njësive në zonën funksionale me qendër qytetin e Bilishtit do të sjellë uljen e shpenzimeve administrative dhe atyre korrente nga 139 milionë në 75 milionë lekë duke dhënë një diferencë prej 64 milionë lekësh.

Kjo diferencë do të bëjë të mundur që njësia e re ose zona funksionale Kolonjë të dedikojë burime të mëdha për shpenzimet vjetore për investime nga 69 milionë lekë në 133 milionë lekë vetëm nga shkurtime të shpenzimeve administrative dhe korrente të marra së bashku.

Të gjitha njësitë e tjera të zonës funksionale Bilisht kanë komunikim të mirë rrugor me qendrën e zonës. Distanca mesatare nga qendra e komunës është vetëm 5,8 km, ndërsa rrjeti rrugor kryesor është 26 km.

Zona funksionale do të krijojë mundësinë për strukturimin e shumë shërbimeve publike, veçanërisht të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve që aktualisht administrohet nga operatori SH.A. U Bilisht. Në të njëjtën mënyrë agregimi mund të sjellë efektivitet në përdorimin e fondeve të tjera për shërbime publike dhe veçanërisht mbulimin me shërbime të tilla si pastrimi dhe menaxhimi i mbetjeve, transporti publik etj.

QARKU KUKËS


Profili i Qarkut Kukës

Qarku i Kukësit përbëhet nga 27 njësi të qeverisjes vendore në tre rrethe: rrethi i Hasit (4 njësi, qendër Krumë); rrethi i Kukësit (15 njësi, qendër Kukës) dhe rrethi i Tropojës (8 njësi, qendër Bajram Curri). Popullsia e qarkut të Kukësit ishte 85,292 banorë në vitin 2011, ndër të cilët 56% (47,895 banorë) jetojnë në rrethin e Kukësit, 24% (20,517) jetojnë në rrethin e Tropojës dhe rreth 20% (16,790 banorë) jetojnë në rrethin e Hasit. (INSTAT, Census 2011). Qarku i Kukësit ka pasur një humbje neto të popullsisë prej rreth 23% ose mbi 25 mijë banorë krahasuar me të dhënat zyrtare të Regjistrit të Gjendjes Civile të vitit 2011. Sipas të dhënave zyrtare të RGJC në janar 2012 në qarkun e Kukësit ishin të regjistruar 110,826 banorë, më përqendrim shumë të ngjashëm sipas rretheve me atë të raportuar nga Census-i i vitit 2011.

Popullsia e Qarkut Kukës përbën më pak se 4% të popullsisë së vendit, referuar të dhënave të Census-it 2011 dhe popullsia mesatare për njësi të qeverisjes vendore në këtë qark rezulton 3,159 banorë/NJQV, ose 60% më e ulët se mesatarja kombëtare prej 8.016 banorë/NJQV. Rrethi i Tropojës ka mesataren më të ulët të popullsisë në qark. Njësitë më të vogla janë Arrën dhe Kalis në Kukës (më pak se 1300 banorë së bashku).


Dendësia mesatare e popullsisë është 141 banorë/km². Megjithatë, shumica e njësive kanë dendësi shumë të ulët: gjysma janë nën nivelin 28 banorë/km²; ndërkohë që dendësia mesatare e komunave është 33 banorë/km². Zonat urbane kanë dendësi më të lartë, si qyteti i Kukësit (1,222 banorë/km²), Bajram Currit (1749 banorë/km²), ndërkohë që Kruma ka dendësi të ulët (81 banorë/km²).

Figura 195 Harta e qarkut Kukës



Ndërveprimi institucional


Në të gjithë qarkun ka një ndërveprim institucional të zyrave në nivel rrethi të përfaqësuar në qytetin e Kukësit, Bajram Currit dhe Krumës, të tilla si: Nënprefektura, Gjykata, Prokurori etj. Në të gjithë qarkun ka edhe zyra të decentralizuara të qeverisë qendrore në nivel qarku të vendosura në qytetin e Kukësit, të tilla si: arsim, shëndetësi, bujqësi etj. Ky ndërveprim lidhet me përgjegjësitë dhe funksionet që secila prej këtyre zyrave si në nivel rrethi dhe qarku kanë në përgjegjësinë e tyre ligjore.



Ndërveprimi Ekonomik ndërmjet Njësive Vendore

Në qarkun e Kukësit synohet të arrihet një përqendrim i ndërveprimit ekonomik nga komunat drejt qendrave Kukës, Bajram Curri dhe Krumë. Ajo që vihet re dhe në hartën e mëposhtme është pikërisht ndërveprimi i dendur i lëvizjes së banorëve drejt qendrave, për punësim, e cila reflekton edhe përqendrimin ekonomik përkatësisht drejt qyteteve Kukës, Bajram Curri dhe Krumë. Ndërveprim të dendur më qytetin e Kukësit rezultojnë të kenë komunat Tërthorë, Kolsh, Bicaj, Shtiqën, etj. Ky ndërveprim i dendur ndodh edhe për komunat Bujan, Margegaj, Llugaj, etj. me qytetin e Bajram Currit. E njëjtë është lëvizja nga komunat Golaj, Fajze, etj. drejt qytetit Krumë.

Figura 196 Ndërveprimi për punësim në qarkun e Kukësit



Ofrimi i Shërbimeve

Sektori i shërbimeve publike (që përfshin shërbimet e pastrimit e të ngjashme) zë pjesën dërrmuese të shpenzimeve edhe në qarkun e Kukësit, me rreth 63% të shpenzimeve, i ndjekur nga sektori i transportit (që përfshin infrastrukturën rrugore dhe mirëmbajtjen e saj) me rreth 23%. Pesha e njësisive të Qarkut Kukës në totalin e shpenzimeve vendore është rreth 2.8% në vitin 2012, me një rritje të lehtë krahasuar me vitet paraardhëse (2.5%, përfshirë edhe rritje në vlerë absolute).


Të ardhurat e NJQV-ve të Qarkut Kukës përbëjnë rreth 3,5% të totalit të të ardhurave vendore në Shqipëri. Në vitin 2009 të ardhurat rezultojnë më tepër se të trefishuara, në krahasim me vitin 2008, por, në vitet 2010-2012, kanë rënë gradualisht çdo vit në vlerë absolute. Të ardhurat nga burimet e veta përbëjnë më pak se 8% të totalit në Qarkun e Kukësit, ndërkohë që në vitet 2009-2012 mbi 60% e të ardhurave vijnë nga transfertat e kushtëzuara. Në vitin 2012 të ardhurat nga burimet e veta përbëjnë 6%, ndërkohë që ka pasur një rritje të transfertës së pakushtëzuar (32%).

Shpenzimet operative zënë pjesën më të madhe të shpenzimeve totale në Qarkun e Kukësit, pothuajse 70% në vitet 2008-2012, e 65% në vitin 2012. Ndër këto, shpenzimet për personelin janë më shumë së gjysma e shpenzimeve operative gjithsej, ose mesatarisht 38% e shpenzimeve totale të NJQV-ve të qarkut. Shpenzimet kapitale kanë një peshë specifike prej 31% në strukturën totale, ose 35% në vitin 2012, me rritje në krahasim me vitin 2011 (29%).

Ky raport është më i ulët se raportet kombëtare prej 34% në 5 vite, por më i lartë për vitin e fundit (26% në vitin 2012 në nivel kombëtar). Bashkia e Kukësit, e cila ka rreth 19% të popullsisë së qarkut, zë një peshë prej rreth 26% në totalin e shpenzimeve të njëjësive të qarkut, por vetëm 19% në shpenzimet për investime.

Figura 197 Shkëmbimet dhe konsumi në qarkun Fier


Interaction Maps – Consumption



Burimi: Zonat funksionale DLDP

Në qarkun e Kukësit synohet të arrihet një përqendrim i ndërveprimit të konsumit nga komunat drejt qendrave Kukës, Bajram Curri dhe Krumë. Nga sa rezulton nga harta e mësipërme, lëvizjet e banorëve nga komunat drejt qyteteve Kukës, Bajram Curri dhe Krumë janë mjaft të dendura, kjo lëvizje identifikon qendrat e ofrimit të shërbimeve, konkretisht Kukës, Bajram Curri dhe Krumë.


Figura 198 Lëvizja drejt qendrave të arsimit



Burimi: Zonat funksionale DLDP

Në qarkun e Kukësit synohet të arrihet një përqendrim i ndërveprimit të shkollimit nga komunat drejt qendrave Kukës, Bajram Curri dhe Krumë.

Figura 199 Lëvizja drejt qendrave shëndetësore



Burimi: Zonat funksionale DLDP


Në qarkun e Kukësit synohet të arrihet një përqendrim i ndërveprimit të Shërbimit Shëndetësor nga komunat drejt qendrave Kukës, Bajram Curri dhe Krumë.

Propozimi i Zonave Funktionale në Qarkun e Kukësit

Ndarja e zonave funksionale në Qarkun e Kukësit është bërë në respekt të konceptit të Zonës Funktionale si një hapësirë territoriale, banorët e së cilës kanë tradicionalisht një ndërveprim intensiv, ajo garanton komunikim të pandërprerë dhe të lehtë, si dhe zonat rreth saj janë të organizuara rreth një qendre urbane.

Në këtë qark mund të identifikohe fare qartë tre Zonat Funktionale të cilat korrespondojnë me kufijtë e rretheve përbërës të Qarkut. Si qendra Funktionale shërbejnë pikërisht qendrat e rretheve, përkatësisht Kukës, Krumë, Bajram Curri.

Figura 200 Zonat funksionale të propozuara në qarkun e Kukësit



Zona funksionale Kukës

Qarku i Kukësit propozohet të ndahet në 3 Zona Funktionale, përkatësisht:

- Zona Funktionale Kukës, me qendër qytetin e Kukësit
- Zona Funktionale Tropojë, me qendër qytetin e Bajram Currit
- Zona Funktionale Has, me qendër qytetin e Krumës


Në vijim jepet përshkrimi i detajuar për secilën prej zonave funksionale të këtij Qarku.

Bashkia Kukës dhe 14 Komunitetet e Kukësit krijojnë një zonë funksionale të vetme si një hapësirë territoriale ku ka një ndërveprim të dendur dhe të shpeshtë mes banorëve dhe institucioneve për qëllime ekonomike, sociale, zhvillimore dhe kulturore. Kukësi ka prirjen të ndjekë një model të përqendruar të zonës funksionale, në të cilin ka vetëm një qendër të rëndësishme që është qyteti ose qendra administrative e rrethit. Kjo vjen për shkak të strukturës ekonomike të zonës dhe qyteti shikohet si i vetmi vend i rëndësishëm i tregut, në të cilin janë vendosur shërbimet kryesore.

Kukësi, si qendër urbane ka dendësi popullore relativisht të lartë, NjQV-të përreth kanë një dendësi popullore mesatare, ndërsa pjesa tjetër e NJQV-ve, që janë larg nga qendra, janë pak të banuara dhe me ndërveprime shumë të dobëta, duke qenë të distancuara nga zona funksionale.

Duke zbatuar kriterin e zonës funksionale, vetë popullsia do të ndahet duke u orientuar drejt zonës së vet funksionale. Kukësi, si qendër administrative është qendra e gravitetit të të gjithë zonës, pasi aty ndodhen të gjitha shërbimet e nevojshme sociale, administrative, ekonomike. Kukësi hyn në modelin e përqendruar të zonës funksionale, si i tillë ai ofron shërbime dhe është qendra e mishërimit të ndërveprimeve për të gjithë zonën duke rritur mundësinë e gjenerimit të të ardhurave vendore për komunitetin lokal. Qendra e Kukësit si zonë funksionale, dallohet për bashkëveprim për sa i përket punësimit, konsumimit dhe aksesit në shërbime.

Figura 201 Zona funksionale Kukës



Efektet Demografike

Tabela 108 Të dhëna sociale dhe demografike

Njësitë e Qeverisjes Vendore (2012)	Shkolla të mesme	Shkolla 9-vjeçare	Kopshte	Qendra Shëndetësore dhe ambulanca	Qendra Kulture	Qendra Sociale	Qendra Sportive	Pop census 2011	Dendësia Banorë (km ²)	Sipërfaqja (km ²)
Bashkia Kukës	3	7	0	3	2	1	3	16,719	1013	16.5
Komuna Arrën	0	4	0	5	0	0	0	462	8	60.5
Komuna Bicaj	1	7	6	10	1	0	0	5,631	71	79.8
Komuna Bushtricë	1	6	3	7	0	0	0	1,486	37	39.9
Komuna Gryke Çajë	0	5	1	4	0	0	0	1,440	16	90.6
Komuna Kalis	0	6	1	5	0	0	0	827	29	28.6
Komuna Kolsh	0	3	3	3	0	0	0	1,250	27	47
Komuna Mal Zi	1	10	4	14	0	0	0	3,072	19	159.2
Komuna Shishtavec	1	7	6	7	0	0	0	3,835	65	58.8
Komuna Shtiqën	1	2	3	5	0	0	0	3,438	96	36
Komuna Surroj	0	3	1	4	0	0	0	1,099	13	81.7
Komuna Tërthore	1	6	6	5	0	0	0	2,959	42	70
Komuna Topojan	1	5	2	5	0	0	0	1,753	24	73.8
Komuna Ujmisht	0	6	2	7	0	0	0	1,797	33	54.2
Komuna Zapod	1	8	7	8	0	0	0	2,217	63	35.3
Totali B.K+Komunat	11	85	74	92	3	1	3	47,985	51	932
Njësia e Re Vendore (Kukës)	11	85	74	92	3	1	3	47,985	51	932

Burimi INSTAT Census 2011

Shkollat e sistemit parauniversitar (9-vjeçare) nuk janë të shpërndara në përpjesëtimin e duhur në raport me popullsinë. Nëse kemi 7 shkolla 9-vjeçare për Bashkinë Kukës me një popullsi 16.719 banorë, kemi po 7 shkolla edhe për Komunën Bicaj dhe Shishtavec që kanë përkatësisht 5.631 banorë dhe 3.835 banorë. Ndërsa Komuna Mal Zi dhe Zapod kanë respektivisht 10 dhe 8 shkolla për 3,072 dhe 2,217 banorë. Njësia e re vendore do të ketë 85 shkolla 9-vjeçare për 47.985 banorë duke synuar një shpërndarje më të mirë të infrastrukturës shkollore për të gjithë nxënësit, gjë e cila nuk garantohet në sistemin e fragmentuar të qeverisjes vendore. E njëjta situatë paraqitet për shkollat e mesme, ndërsa Bashkia Kukës ka 3 shkolla të mesme, janë 6 komuna të cilat nuk kanë fare shkolla të mesme. Bashkimi në një njësi të vetme vendore do të rrisë numrin e shkollave të mesme në 11 duke ofruar mundësinë e rishpërndarjes më të mirë të nxënësve, natyrisht edhe në varësi të largësisë së nxënësve nga shkollat dhe infrastruktura ekzistuese.

E njëjta situatë do të jetë edhe në kopshtet dhe qendrat shëndetësore. Njësia e re vendore do të ketë 74 kopshte dhe 92 qendra shëndetësore.

Tabela 1 tregon mungesën e aksesit social, kulturor, sportiv të komunave larg qendrës Kukës, mungesë e kushtëzuar nga fakti se shumica e qendrave sociale, kulturore, sportive dhe shëndetësore janë përqendruar vetëm në qendrën urbanë të Kukësit. P.sh.: Komunat Arrën, Kalis, Surroj, Ujmisht, Grykë Çaje, etj. kanë mungesë të shkollave të mesme.

Dy tendenca të rëndësishme janë vënë re në këtë rreth: shpopullimi i përgjithshëm i ndjekur nga migrimet ndër-rajonale nga zonat rurale në qendrat urbane. Vitet e fundit popullsia e bashkive u rrit me 3.8%, ndërsa në komuna ajo ka rënë me 2.5%. Komunat që kanë përjetuar rënien më të madhe janë; Kalis (42.8%), Kolsh 30.6%, Fierzë (13.5%) dhe Topojan (12.8%). Bashkia e Kukësit rezulton NJQV me dendësinë e popullsisë mbi mesataren rajonale, përkatësisht me 2.569 banorë/km². Shifrat më të ulëta të dendësinë janë vërejtur në komunat Arrën (10 banorë/km²) e Grykë-Çaje (20 banorë/km²). Bashkia Kukës ka një popullsi relativisht të re. Tendencat e tre grup-moshave kanë qenë pak a shumë të qëndrueshme që nga viti 2006.

Faktorët kryesorë që kontribuojnë në këto zhvillime demografike janë të lidhura me tranzicionin ekonomik: mbylljen e shumë ndërmarrjeve në pronësi shtetërore dhe papunësisë që e shoqëroi; infrastrukturën e transportit dhe të komunikimit jashtëzakonisht të dobët; terrenit në përgjithësi të vështirë; kushteve të pafavorshme klimatike dhe bujqësore; si dhe shfrytëzimit pa kriter të pyjeve.

Ajo që vihet re në Zonën Funksionale të Kukësit është fakti se afër qendrës funksionale të Kukësit, si qendër urbane ka relativisht një dendësi popullsie të lartë, njësitë e qeverisjes vendore (NjQV) përreth kanë një dendësi popullsie mesatare, ndërsa pjesa tjetër e NJQV-ve, që janë larg nga qendra janë pak të banuara dhe me ndërveprime shumë të dobëta, duke qenë të distancuara nga zona funksionale.

Më poshtë po rendisim faktorët që kontribuojnë në gjendjen aktuale:

1. Tranzicioni ekonomik dhe rënia e ofertës së punës;
2. Migrimi nga zonat rurale në ato urbane brenda qarkut si rrjedhojë e kushteve të vështira të punës në bujqësi, produktiviteti i ulët i këtij sektori dhe aksesit i kufizuar ndaj shërbimeve në zonat rurale,

Me zbatimin e Reformës Administrativo-Territoriale, Zona Funksionale e Kukësit do të bëjë të mundur, siç u tha më sipër, një akses më të përqendruar të bizneseve dhe investimeve të mundshme publike dhe private duke mundësuar:

1. Krijimin e mundësive për punë të qëndrueshme në NJQV-në e re;
2. Përmirësimin e transportit, komunikimin dhe aksesin në shërbime;
3. Krijimin e mundësive në zonat rurale për punimin e tokës dhe stimulimin e aktivitetit blegtoral sipas zonave (p.sh.: dhënia me qira të ulët e mjeteve të punës për bujqësi apo ngritja e baxhove të komunave për grumbullimin e qumështit);
4. Sigurimin e tregut të shitjes për produktet bujqësore dhe blegtorale, të zonës.

Efektet Ekonomike-Financiare

Tabela 109 Të dhëna ekonomike dhe financiare për Bashkinë Kukës/Komunat dhe për Njësinë e re Vendore Kukës (000 lekë)

Njësitë e Qeverisjes Vendore (2012)	Popullsia Census 2011	Totale i bizneseve banorë	Biznese për 1000 banorë	Të ardhurat vetë	Shpenzime Personeli	Shpenzime Operative	Investime	Investime për frymë	Buxheti Total	Buxheti për frymë	Të ardhurat për frymë	Shpenzime për frymë (op+personel)
Bashkia Kukës	16,719	770	46	49,735	79,000	68,000	51,000	3	198,000	11.84	2.97	9
Komuna Arrën	462	3	3	33	5,000	11,000	7,000	15	23,000	49.78	0.07	35
Komuna Bicaj	5,631	15	3	863	1,000	1,000	4,000	1	6,000	1.07	0.15	0
Komuna Bushtricë	1,486	5	3	359	5,000	1,000	0	0	6,000	4.04	0.24	4
Komuna Grykë Çaje	1,440	1	1	111	2,000	3,000	5,000	3	10,000	6.94	0.08	3
Komuna Kalis	827	4	4	76	8,000	6,000	16,000	19	30,000	36.28	0.09	17
Komuna Kolsh	1,250	6	5	1,792	29,000	12,000	7,000	6	48,000	38.40	1.43	33
Komuna Mal Zi	3,072	13	4	1,030	14,000	9,000	18,000	6	41,000	13.35	0.34	7
Komuna Shishtavec	3,835	6	2	314	9,000	5,000	6,000	2	20,000	5.22	0.08	4
Komuna Shtiqën	3,438	10	3	1,978	5,000	2,000	1,000	0	8,000	2.33	0.58	2
Komuna Surroj	1,099	10	9	466	4,000	3,000	1,000	1	8,000	7.28	0.42	6
Komuna Tërthorë	2,959	54	18	6,961	6,000	3,000	7,000	2	16,000	5.41	2.35	3
Komuna Topojan	1,753	4	2	77	5,000	3,000	0	0	8,000	4.56	0.04	5
Komuna Ujmisht	1,797	2	1	190	7,000	5,000	15,000	8	27,000	15.03	0.11	7
Komuna Zapod	2,217	12	5	218	5,000	1,000	0	0	6,000	2.71	0.10	3
Bashkia Kukës dhe Komunat	47,985	915	19	64,203	184,000	133,000	138,000	3	455,000	9.48	1.34	7
Njësinë e re vendore (Kukës)	47,985	915	19	64,203	115,750	128,125	211,125	4	455,000	9.48	1.34	7

Tabela 110 Ndërveprimi ekonomik në ZF Kukës




Figura 202 Shpërndarja e bizneseve në ZF Kukës




Tabela 2 na jep një pamje të qartë të situatës aktuale dhe asaj që do të ofrohet mbas bashkimit në një njësi vendore të vetme. Në kolonën e totalit të bizneseve, bie në sy një shpërpjesëtim i theksuar i shpërndarjes së bizneseve për njësitë vendore të rrethit Kukës. Bashkia e Kukësit

ka një total biznesesh (ku përfshihet biznesi i madh, i mesëm, i vogël dhe të tjera) prej 770 biznesesh, ndërsa komunat paraqiten me një numër të reduktuar biznesesh në totalin e tyre. Për shembull Komuna të tilla si Grykë Çaje dhe Komuna Ujmisht kanë respektivisht 1 dhe 2 biznese në total. Kjo është një diferencë shumë e madhe që tregon se niveli ekonomik i këtyre komunave është shumë i ulët, pasi numri i bizneseve që është tregues i rëndësishëm i ekonomisë së njësive vendore, është shumë i vogël. Njësia e re vendore Kukës do të ketë 915 biznese duke pasur një numër të shtuar, jo vetëm për banorët e Bashkisë Kukës por edhe për komunat e rrethit Kukës që do të bashkohen me Bashkinë Kukës në njësinë e re vendore Kukës.


Bizneset ekzistuese të cilat janë të fragmentuara në territore administrative të ndryshme, me krijimin e një NJQV-je do të funksionojnë brenda së njëjtës hapësirë territoriale administrative, duke u rishpërndarë në mënyrë të tillë që të mund t'i ofrojnë shërbime dhe akses të gjithë komunitetit, edhe qytetarëve që ndodhen më larg qendrave funksionale. Njëkohësisht, bashkimi do të sjellë konkurrencë ndërmjet bizneseve, e cila do reflektohet në rritjen e cilësisë dhe sasisë së prodhimit të shërbimit që ato ofrojnë.

Në kolonën e dytë të tabelës jepen të dhëna mbi numrin e bizneseve për 1000 banorë (Figura 1). I njëjti shpërpjesëtim që cituam për totalin e bizneseve, ekziston dhe për numrin e bizneseve për 1000 banorë. Bashkia Kukës si qendra e rrethit ka rreth 46 biznese për 1000 banorë, ndërkohë që komunat Ujmisht dhe Grykë Çaje kanë në territorin e tyre vetëm 1 biznes për 1000 banorë. Ky shpërpjesëtim nuk do të jetë më, pasi me bashkimin në një NJQV, numri i bizneseve do të reduktohet për Bashkinë Kukës duke u rishpërndarë për të gjitha njësitë vendore që do të bashkohen me Bashkinë Kukës. Njësia e re vendore Kukës do të ketë 19 biznese për 1000 banorë.

Një ndryshim i dukshëm do të rezultojë edhe në treguesit e buxhetit (Figura 203), jo vetëm në buxhetin total të njësisë së re vendore por edhe në buxhetin për frymë. Nëse Bashkia Kukës ka një buxhet prej 198 milion lekësh, tre komuna të rrethit Kukës kanë një buxhet prej 6 milionë lekësh, ndërsa dy prej komunave një buxhet prej 8 milion lekësh i cili është i gjithi i destinuar për të mbuluar shpenzimet e personelit dhe ato operative ndërsa investimet janë zero. Buxheti i njësisë së re vendore Kukës do të jetë 455 milion lekë duke u rritur në terma absolutë për të gjithë qytetarët e njësisë së re vendore. E njëjta situatë paraqitet edhe për buxhetin për frymë. Bashkia Kukës ka një buxhet rreth 11.840 lekë/frymë ndërsa komuna Bicaj ka një buxhet në 1.070 lekë/frymë.

Me bashkimin në një njësi të vetme vendore Kukës do kemi një buxhet prej 9.480 lekësh/frymë, duke reduktuar në maksimum pabarazitë e vëna re aktualisht dhe duke garantuar një buxhet mesatar për çdo qytetar të njësisë së re vendore Kukës. Shpërndarja e pabarabartë në buxhet dhe në resurse do të rregullohet në njësinë e re vendore duke i rishpërndarë ato në mënyrë të drejtë dhe të barabartë për të gjithë qytetarët në njësinë e re vendore.

Figura 203 Buxheti total dhe buxheti për frymë i bashkisë Kukës/komunave dhe i Njësisë së re Vendore Kukës




Burimi: Llogaritjet e autorëve

Në rast se analizojmë të ardhurat dhe shpenzimet për frymë të gjeneruara dhe shpenzuara nga njësitë vendore të rrethit Kukës vëmë re të njëjtin fenomen të pabarazisë ndërmjet njësive vendore. Vihet re (Figura 204) një shpërndarje jo e barabartë e të ardhurave për banor në njësi të ndryshme vendore. Bashkia Kukës shënon nivelin më të lartë për banor me 2.970 lekë, e ndjekur nga Komuna Tërthore dhe Kolsh respektivisht me 2.350 lekë dhe 1.430 lekë për banorë. Komuna Shishtavec shënon nivelin më të ulët të të ardhurave për frymë në 80 lekë. Nga bashkimi i njësive vendore në njësinë e re vendore Kukës, do të kemi 1,340 lekë të ardhura/frymë duke siguruar një rishpërndarje më të drejtë të të ardhurave për frymë për të gjithë banorët e njësisë së re vendore.

Pabarazitë e mësipërme mund t'i vërejmë për sa i përket shpenzimeve/frymë ku përfshihen shpenzimet operative (shpenzimet për shërbime) dhe shpenzime për personelin. Vihet re një pabarazi në të gjitha njësitë vendore të Rrethit Kukës. Komuna Arrën shënon nivelin më të lartë të shpenzimeve 35.000 lekë për banor, e ndjekur nga Komuna Kolsh në 33,000 lekë/banor, ndërsa Bashkia Kukës shpenzon për çdo banor të saj vetëm 9.000 lekë. Eliminimi i fragmentimit dhe bashkimi në një njësi të re vendore do të çojë në një rishpërndarje më të mirë të shpenzimeve për shërbime publike lokale për të gjithë qytetarët e njësisë së re vendore Kukës.

Figura 204 Të Ardhurat dhe shpenzimet (operative+personel) për frymë të bashkisë Kukës/komunave dhe të Njësisë së re Vendore Kukës



Burimi Llogaritjet e autorëve


Figura 205 tregon shpërndarjen e investimeve për të gjitha njësitë vendore të rrethit Kukës. Siç shikohet, njësitë vendore të rrethit Kukës kanë një rishpërndarje jo të barabartë të investimeve të kryera. Investimet më të larta janë kryer nga Bashkia Kukës në vlerën 51.000 mijë lekë, e ndjekur edhe nga Komuna Mal i Zi, Kalis dhe Ujmisht. Ndërsa komunat e tjera paraqiten në nivel zero investime ose pothuajse zero. Ndryshe paraqitet situata nëse shohim investimet për frymë (Figura 5), vihet re që Komuna Kalis dhe Arrën shpërndajnë respektivisht 19.000 dhe 15.000 lekë/banor, të ndjekura nga Komuna Ujmisht me 8.000 lekë/banor. Ndërsa Bashkia Kukës që ka nivelin më të lartë të investimeve në vlerë absolute renditet së bashku me Komunën Grykë Çaje, njësia e gjashtë vendore për sa i takon investimeve për frymë me 3.000 lekë për banor. Kjo vjen si pasojë e mundësive të ndryshme të njësive vendore për të kryer investime me të ardhurat e tyre por edhe nga skema e financimit të shpenzimeve kapitale të kryera nëpërmjet skemës së granteve konkurruese që në përgjithësi ka krijuar një pabarazi në shpërndarjen e tyre. Nëse analizojmë strukturën e investimeve vëmë re se njësitë vendore nuk kanë kryer investime në fushën e zhvillimit ekonomik vendor. Mosrealizimi i investimeve nga njësitë vendore, në fushën e zhvillimit ekonomik vendor ka sjellë një efekt negativ në zhvillimin e bizneseve duke mos i mbështetur dhe duke mos i krijuar atyre kushtet e përshtatshme për zhvillim.

Çfarë do të ndodhë me investimet në zonën e re funksionale Kukës? Në rast se Bashkia Kukës dhe 14 komunat do të bashkoheshin në një njësi të vetme vendore, shumë prej funksioneve të cilat përsëriten për çdo njësi vendore, do të suprimohen dhe do të reduktojnë numrin e personelit për njësinë e re vendore. Pra me zbatimin e kësaj skeme do të përfitonim përqendrimin e funksioneve administrative të komunave si: prokurimin publik, planifikimin urban, shërbimet financiare, administrimin e taksave, etj. çka do të sillte një kursim të konsiderueshëm. Ndërkohë që do eliminohen funksionet e përsëritura në administratën lokale të tilla si financierë, arkëtarë, nënkryetar bashkie, komunë, sekretar i Këshillit Bashkiak, këshilltarë, etj. me një kursim prej afro 65% të shpenzimeve administrative (duke përfshirë kursimin nga përqendrimi i funksioneve+kursimin nga eliminimi i funksioneve të përsëritura). Gjithashtu një kursim tjetër administrativ afro 7,5 % i shpenzimeve operative, do të vijë dhe nga mirëmbajtja dhe kosto operative të zyrave administrative, të cilat do të reduktohen si rezultat i reduktimit dhe përqendrimit të funksioneve të cituara më lart. Kjo do të ndikojë në shpenzimet për mbajtjen e administratës, pra shpenzimet e personelit do të ulen nga 184.000 mijë lekë në 115.750 mijë lekë, duke rezultuar në një kursim të konsiderueshëm prej rreth 68.250 mijë lekësh. Shpenzimet Operative do të ulen nga 133.000 mijë lekë në 128.125 mijë

lekë duke na dhënë një kursim prej 4.875 mijë lekë. Këto kursime do të reflektohen në një rritje në investime prej 73.125 mijë lekësh.

Të gjitha këto fonde të kursyera do të mund të përdoren për rritjen e cilësisë së shërbimeve ose do të mund të investohen në infrastrukturë, transport publik, apo zhvillim ekonomik duke nxitur në këtë mënyrë zhvillimin ekonomik dhe financiar të territorit si edhe thithjen e investimeve të huaja. Për efekt të analizës supozojmë së fondet e kursyera do të përdoren për rritjen e investimeve nga njësia e re vendore. Pra në NJQV e re vendore të Kukësit do të kemi një rritje të investimeve publike me rreth 73,125 mijë lekë si pasojë e reduktimit të shpenzimeve administrative dhe kursimit që përfitohet nga suprimimi i zyrave administrative dhe funksioneve të përsëritura.


Figura 205 Investimet e bashkisë Kukës/Komunave dhe i Njesisë së Re Vendore Kukës



Burimi Llogaritjet e autorëve

Gjithashtu nga bashkimi i Bashkisë Kukës dhe komunave të Rrethit Kukës në një NJQV të vetme do mund të ekuilibrohet shpërpjesëtimi në investime për frymë, duke rishpërndarë ato dhe duke përfituar 4 mijë lekë në NJQV (Figura 206) e re administrative-territoriale, në mënyrë që të rishpërndajmë shpenzimet kapitale për frymë.

Figura 206 Investimet për frymë të bashkisë Kukës/Komunave dhe të Njesisë së re Vendore Kukës



Burimi Llogaritjet e autorëve

Sa më sipër, e gjitha çfarë komentuar, do kontribuonte në një perspektivë më të favorshme, duke bërë të mundur fuqizimin e tyre si një NJQV e vetme dhe duke maksimizuar jo vetëm investimet në njësinë e re vendore si rezultat i rritjes së tyre por edhe duke shpërndarë investimet në zona të cilat gjenerojnë zhvillim ekonomik dhe punësim dhe jo duke i copëzuar e shpërndarë pa asnjë kriter siç ka ndodhur deri më tani. Kjo Reformë do të ishte një katalizator i shpejtë, që do t'i bënte këto zona më të favorshme për investim dhe më përfituese për investitorët duke e bërë zonën më vitale.


Efektet në ofrimin e shërbimeve

Nga të dhënat e mundësuar, vetëm në bashkinë Kukës dhe në dy komuna përkatësisht Bicaj dhe Shtiqën ujësjellësi është SH. A., ndërsa në komunat e tjera është Komunal. Me zmadhimin e territorit do të mundësohet një përfshirje Komunale në Sh. A. duke përfituar një fuqizim, në mënyrë që furnizimi me ujë të jetë i plotë dhe i pandërprerë, në të gjithë zonën duke marrë parasysh dhe relievin gjeografik të saj, për t'u mundësuar një shërbimi eficient dhe cilësor banorëve të saj.

Vëmë re se furnizimi me ujë është i reduktuar. Duke qenë se uji është një shërbim jetësor për banorët, duhet të mundësohet me orar të plotë dhe jo të reduktuar, gjë që me zmadhimin e territorit do të mundësohet edhe në zonat në të cilat nuk ekziston p.sh.: Komuna Ujmisht ose ekziston pjesërisht prania e ujësjellësit.

Për sa i përket infrastrukturës në rrethin e Kukësit ka rrugë të asfaltuara, por ka edhe afërsisht 119 rrugë të paasfaltuara, vihet re se për të përshkuar rrugën nga komunat deri në Kukës si qendër administrative duhet mesatarisht rreth 47 min. Për sa i përket komunave që duan rreth 150 min, me zmadhimin e territorit do të mund të krijohen pika shërbimi komunale, në të cilat banorët e këtyre komunave të mund të marrin shërbimet e nevojshme në vendin e tyre të banimit. Gjithashtu me zmadhimin e NJQV-së do të mundësohet një investim më i madh për sa i përket infrastrukturës, gjithmonë duke marrë parasysh karakteristikat e relievit të zonës.


Figura 207 Zhvendosja e banorëve për të shkuar në punë



Në qytetin e Kukësit, përdorimi i transportit publik nga qytetarët për të shkuar në punë është minimal (0.6%). Niveli më i lartë i përdorimit të transportit publik rezulton në Shtiqën me 2.9%. Aktualisht, infrastruktura e fragmentuar ndërmjet bashkive e komunave bën që aksesin ndaj këtij transporti të jetë i ulët. Me krijimin e një njësie të vetme vendore, shërbimi i

transportit publik do të projektohet e administrohet për të përfshirë interesin e shumë më tepër qytetarëve, duke rritur kështu aksesin në zonat e largëta, e duke i afruar qytetarët me qendrat funksionale.

Figura 208 Punësimi në Qarkun Kukës



Një pjesë e konsiderueshme e banorëve të komunave janë të punësuar në qytetin e Kukësit por edhe në komuna të tjera afër vendbanimeve të tyre. Me heqjen e kufijve ndërmjet komunave e bashkisë, do të eliminohet fragmentimi që aktualisht karakterizon infrastrukturën rrugore dhe transportin publik. Kjo do të sjellë rritje të aksesit, përmirësim të cilësisë për transportin publik e rrjedhimisht përmirësimin e kushteve të jetesës për të gjithë qytetarët.

Figura 209 Shpërndarja dhe gjendja e objekteve arsimore në ZF Kukës





Figura 210 Infrastruktura në ZF Kukës



Përfundime

Ulje të ngarkesës mesatare të administratës vendore për 1000 banorë nga 4.8 aktualisht në 2.9 punonjës për 1000 banorë;

Reduktim të shpenzimeve administrative me 73 milion lekë (personeli dhe operative) dhe uljen e këtyre shpenzimeve për banorë në masën 30% nga 7 mijë lekë në 5 mijë lekë në njësinë e re vendore;

Miradministrimi i burimeve do të sjellë shtim në masën 35% të fondit të investimeve totale në të pesëmbëdhjetë NJQV, nga 138 milion lekë në 211 milion lekë;

Buxheti i investimeve për frymë do të rritet nga 3 mijë lekë në 4 mijë lekë;

Zona Funktionale Tropojë

Bashkia Bajram Curri dhe 7 Komunat e Rrethit Tropojë krijojnë një Zonë Funktionale të vetme si një hapësirë territoriale ku ka një ndërveprim të dendur dhe të shpeshtë mes banorëve dhe institucioneve për qëllime punësimi, ku lëvizja e banorëve drejt qendrës së rrethit Bajram Curri, për tregun e punës është shumë e shpeshtë. Kjo për arsye se institucionet kryesore administrative që ofrojnë kryesisht punësim të banorëve, janë të stacionuara pikërisht në qendrën e rrethit Tropojë që njëkohësisht shërben dhe si qendra funksionale e zonës.


Tendenca e lëvizjes së pjesës më të madhe të banorëve të komunave edhe për arsimim shkon drejt Bajram Currit, pasi siç do të shohim dhe më poshtë nga analizat, edhe institucionet arsimore janë të vendosura në Bajram Curri. E njëjta situatë paraqitet edhe në lidhje me shërbimet shëndetësore dhe sociale, ku ndërveprimi më i dendur është pikërisht drejt qendrës urbane të zonës, pra Bajram Currit.

Nga sa më sipër del qartë tendenca e një modeli të përqendruar të zonës funksionale, në të cilin ka vetëm një qendër të rëndësishme që është qyteti ose qendra administrative e rrethit. Kjo vjen për shkak të strukturës ekonomike të zonës dhe qyteti shikohet si i vetmi vend i rëndësishëm i tregut në të cilin janë vendosur shërbimet kryesore. Rrethi i Tropojës, edhe pse i ndodhur në skajin më të largët në verilindje të Shqipërisë, me terren malor dhe të copëzuar, ka një vazhdimësi territoriale.

Tropoja rezulton të jetë një ndër rrethet më të prapambetura në Shqipëri. Gjendja e rënduar ekonomike ka bërë që komunat të përgjysmohen për shkak të lëvizjes masive të banorëve në drejtim të rretheve më të populluara të vendit.

Duhet të kemi parasysh faktin që, njësitë e qeverisjes vendore me popullsi më të madhe gjenerojnë kapacitete më të mëdha fiskale edhe në formatin aktual të decentralizimit fiskal, duke rritur të ardhurat për frymë të popullsisë.

Figura 211 Zona funksionale Tropojë



Efektet Demografike

Tabela 3 Të dhëna sociale dhe demografike

Njësitë e Qeverisjes Vendore (2012)	Shkollat të mesme	Shkollat 9-vjeçare	Kopshtet	Qendra Shëndetësore dhe ambulanca	Qendra Kulturorë	Qendra Sociale	Qendra Sportive	Popullsia census 2011	Dendësia banorë/km ²	Sipërfaqja (km ²)
Bashkia Bajram Curri	2	3	4	3	1	1	1	5,340	1594,03	3,35
Komuna F. Tropojë	0	12	5	4	0	0	0	4,117	10,38	226,1
Komuna Llugaj	1	3	1	6	0	0	0	1,787	31,39	51,2
Komuna Bujan	0	6	5	4	0	0	0	2,550	38,24	107,65
Komuna Bytyç	2	10	5	9	0	0	0	1,563	10,73	166,5
Komuna Fierze	1	6	3	8	0	0	0	1,607	33,64	75,8
Komuna Lekbibaj	1	11	2	7	0	0	0	1,207	8,09	193,3
Komuna Margegaj	0	5	3	9	0	0	0	2,346	4,55	265,4
Totali BC+Komunat	7	56	28	50	1	1	1	20,517	18,84	1089,3
Njësia e Re Vendore (Tropojë)	7	56	28	50	1	1	1	20,517	18,84	1089,3

Shkollat e sistemit parauniversitar (9-vjeçare) nuk janë të shpërndara në përpjesëtimin e duhur në raport me popullsinë. Nëse kemi 3 shkolla 9-vjeçare për Bashkinë Bajram Curri me një popullsi 5.340 banorë, kemi 12 shkolla për Komunën F. Tropojë dhe 10 e 11 shkolla për komunat Bytyç e Lekbibaj që kanë respektivisht 1.563 banorë dhe 1.207 banorë. Ndërsa Komuna Llugaj ka 3 shkolla për 1.787 banorë. Njësia e re vendore do të ketë 56 shkolla 9-vjeçare për 20.517 banorë duke synuar një shpërndarje më të mirë të infrastrukturës shkollore për të gjithë nxënësit, gjë e cila nuk garantohet në sistemin e fragmentuar të qeverisjes vendore. E njëjta situatë paraqitet për shkollat e mesme, ndërsa Bashkia Bajram Curri ka 2 shkolla të mesme, janë 3 komuna të cilat nuk kanë fare shkollë të mesme. Bashkimi në një njësi të vetme vendore do të rrisë numrin e shkollave të mesme në 7 duke ofruar mundësinë e rishpërndarjes më të mirë të nxënësve dhe duke rritur aksesin në shkollat e mesme edhe të nxënësve të komunave që sot nuk kanë shkolla të mesme.

E njëjta situatë do të jetë edhe me kopshtet dhe qendrat shëndetësore. Njësia e re vendore do të ketë 28 kopshte dhe 50 qendra shëndetësore duke shtuar aksesin e të gjithë banorëve të zonës dhe jo vetëm aty ku ato janë si pasojë e sistemit të fragmentuar të qeverisjes vendore.

Tabela 3 tregon qartë mungesën e aksesit social, kulturor, sportiv të komunave larg qendrës Bajram Curri. Mungesë e kushtëzuar nga fakti se të vetmet qendra sociale, kulturore dhe sportive janë përqendruar vetëm në qendrën urbane të Bajram Currit.

Zona Funktionale e Tropojës karakterizohet nga një kohezion i brendshëm, i cili korrespondon me dendësinë e popullsisë, pasi qendra urbane Bajram Curri ka një dendësi (relativisht) të lartë, njësitë përreth qendrës kanë dendësi të mesme popullore, ndërsa pjesa tjetër e njësive të qeverisjes vendore, larg nga qendra dhe pak të populluara kanë një dendësi popullore shumë të ulët.

Zbatimi i Reformës Administrativo-Territoriale do na ofrojë një kohezion të brendshëm absolutisht të balancuar, me një shpërndarje të popullsisë më homogjene dhe me një përfshirje në zonën funksionale edhe të komunave, të cilat aktualisht janë pothuajse jashtë ofrimit të shërbimeve, tregut të punës, etj.

Megjithëse një rreth me pasuri të shumta natyrore, mungesa e investimeve të mjaftueshme dhe e perspektivës ka detyruar pjesën më të madhe të banorëve të largohen drejt zonave më të ulëta dhe më të populluara të vendit. Aktualisht shumë familje trajtohen më ndihmë ekonomike, ndërkohë që përpjekje të vazhdueshme bëhen për të tërhequr sa më shumë investime në këtë zonë.

Migrimi si pjesë e zhvillimit demografik të rajoneve por edhe treguesi ndryshimeve sociale, është ndër faktorët negativë që ka ndikuar në zhvillimin e zonës së Tropojës dhe do të mënjanohet me bashkimin e komunave dhe bashkisë në një NJQV.

Efektet ekonomiko-Financiare

Tabela 4 Të dhëna ekonomike dhe financiare për bashkinë B. Curri/komunat dhe për Njësinë e re Vendore Tropojë (000 lekë)

Njësitë e Qeverisjes Vendore (2012)	Popullsia census 2011	Totali i bizneseve	Biznese për 1000 banorë	Të ardhurat e veta	Shpenzi me Personeli	Shpenzimet Operative	Investime	Investime për frymë	Buxheti Total	Buxheti për frymë	Të ardhurat për frymë	Shpenzimet për (op+personel)
Bashkia Bajram Curri	5,340	392	73	19,560	27,000	22,000	52,000	9.74	101,000	18.91	3.66	9.18
Komuna F. Tropojë	4,117	39	9	942	6,000	2,000	5,000	1.21	13,000	3.16	0.23	1.94
Komuna Llugaj	1,787	2	1	101	2,000	2,000	13,000	7.27	17,000	9.51	0.06	2.24
Komuna Bujan	2,550	8	3	211	9,000	4,000	0	0.00	13,000	5.10	0.08	5.10
Komuna Bytyç	1,563	13	8	222	13,000	5,000	9,000	5.76	27,000	17.27	0.14	11.52
Komuna Fierzë	1,607	7	4	1448	4,000	2,000	0	0.00	6,000	3.73	0.90	3.73
Komuna Lekbibaj	1,207	1	1	1,812	6,000	9,000	0	0.00	15,000	12.43	1.50	12.43
Komuna Margegaj	2,346	10	4	1,541	40,000	37,000	77,000	32.82	154,000	65.64	0.66	32.82
Bashkia Bajram Curri dhe Komunat	20,517	472	23	25,837	107,000	83,000	156,000	7.60	346,000	16.86	1.26	9.26
NjVR(Tropojë)	20,517	472	23	25,837	55,000	78,425	212,575	10.36	346,000	16.86	1.26	9.26

Tabela 4 na ofron një pamje të qartë të situatës aktuale dhe asaj që do ofrohet pas bashkimit në një njësi vendore të vetme. Tropoja vazhdon të përballet sot me një nivel të lartë të papunësisë dhe varfërisë. Megjithëse një rreth me pasuri të shumta natyrore, mungesa dhe pabarazia e shpërndarjes së bizneseve ka detyruar pjesën më të madhe të banorëve të largohen drejt zonave më të ulëta dhe më të populluara të vendit, me mundësi zhvillimi më të mëdha.

Po të shohim totalin e bizneseve vëmë re se në Bashkinë Bajram Curri ushtrojnë aktivitetin e tyre rreth 392 biznese, ndërkohë që komuna Lekbibaj, si komuna me distancë më të largët nga Bajram Curri ka vetëm 1 biznes në të gjithë territorin e saj. E ndjekur nga komuna Llugaj me 2 biznese. Zhvillimi i bizneseve në një vend është parë si një faktor cilësor për ekonominë e këtij vendi. Nisur nga këto të dhëna, ekonomia e rrethit Tropojë nuk duket aspak premtuese aktualisht.


Vihet re e njëjta situatë lidhur me numrin e bizneseve/1000 banorë. Në bashkinë Bajram Curri operojnë 73 biznese/1000 banorë, ndjekur nga komuna F. Tropojë me 9 biznese/1000 banorë, komuna Bytyç më 8 biznese/1000 banorë, komuna Fierzë dhe Margegaj me nga 4 biznese/1000 banorë, komuna Bujan me 3 biznese/1000 banorë dhe në fund komunat Llugaj dhe Lekbibaj me nga 1 biznes/1000 banorë.

Kjo situatë tërësisht e pabarabartë jo vetëm për banorët, por gjithashtu edhe për bizneset që kryejnë aktivitetin e tyre në rrethin Tropojë duhet të përmirësohet për sa i takon numrit të bizneseve në një territor më të madh administrativ. Ky ndryshim do të bëhet pikërisht me

suprimimin dhe bashkimin e tyre në një NJQV të madhe administrative por edhe ekonomikisht të fortë.

Në NJQV e re do të kryejnë aktivitetin e tyre 472 biznese në total dhe mesatarisht 23 biznese/frymë duke bërë të mundur një rishpërndarje të bizneseve, në mënyrë të tillë që të mund të rrisin aksesin e shërbimeve të tyre për të gjithë banorët në mënyrë më të balancuar.

Figura 212 Buxheti total dhe buxheti për frymë i bashkisë B. Curri/komunave dhe i Njesisë së re Vendore Tropojë



Burimi Llogaritje të autorëve


Një ndryshim i dukshëm do të rezultojë edhe në treguesit e buxhetit (Figura 212), jo vetëm në buxhetin total të njësisë së re vendore por edhe në buxhetin për frymë. Nëse Bashkia Bajram Curri ka një buxhet total prej 101 milion lekë, e ndjekur nga komuna Bytyç me 27 milion lekë, komuna Llugaj me 17 milion lekë, komuna Lekbibaj me 15 milion lekë, komunat F. Tropojë dhe Bujan me nga 13 milion lekë dhe komuna Fierzë me 6 milion lekë, njësia e re vendore Tropojë do të ketë një buxhet prej 346 milion lekësh, duke u rritur në terma absolutë për të gjithë qytetarët e njësisë së re vendore.

Komuna Lekbibaj në kufi me zonën e Shalës në Dukagjin, e klasifikuar si më e varfra në gjithë rrethin e Tropojës, me buxhetin e saj prej 15 milion lekë në total shpenzon 6,000 lekë shpenzime personeli dhe 9.000 lekë shpenzime operative dhe zero lekë investime dhe investime/frymë. Kjo do të thotë që buxheti total i kësaj komune shpenzohet vetëm për rroga personeli dhe mbajtje zyrash. E njëjta situatë shihet dhe në komunën Fierzë.

Me bashkimin në një njësi të vetme vendore Tropojë (Figura 10), buxheti total do të jetë 346 milion lekë duke u rritur në terma absolutë. E njëjta situatë paraqitet edhe për buxhetin për frymë.

Me bashkimin në një njësi të vetme vendore Tropojë do të kemi një buxhet prej 16.860 lekësh/frymë, duke reduktuar në maksimum pabarazitë e konstatuara në situatën aktuale dhe duke garantuar një buxhet mesatar për çdo qytetar të njësisë së re vendore Tropojë. Shpërndarja e pabarabartë në buxhet dhe resurse do të rregullohet në njësinë e re vendore duke rishpërndarë në mënyrë të drejtë dhe barabartë buxhetet dhe resurset për të gjithë qytetarët në njësinë e re vendore.

Figura 213 Të ardhurat dhe shpenzimet (operative+personel) për frymë i bashkisë B. Curri/komunave dhe i Njësisë së re Vendore Tropojë



Burimi Llogaritje të autorëve

Në rast se do të analizojmë të ardhurat dhe shpenzimet për frymë të gjeneruara dhe shpenzuara nga njësitë vendore të rrethit Tropojë vëmë re të njëjtin fenomen të pabarazisë ndërmjet njësisive vendore. Vihet re (Figura 10) një rishpërndarje jo e barabartë e të ardhurave për banorë në njësi të ndryshme vendore. Bashkia Bajram Curri shënon nivelin më të lartë të të ardhurave për frymë me 3.660 lekë, e ndjekur nga Komuna Lekbibaj me 1.500 lekë për banorë. Komuna Llugaj dhe Bujan shënojnë nivelin më të ulët të të ardhurave për frymë me nga respektivisht 60 dhe 80 lekë për banor. Nga bashkimi i njësisive vendore në njësinë e re vendore Tropojë, do të kemi 1.260 lekë të ardhura për frymë, duke siguruar një rishpërndarje më të drejtë të të ardhurave për frymë për të gjithë banorët e njësisë së re vendore.

Pabarazitë e mësipërme mund t'i vërejmë për sa i përket shpenzimeve për frymë ku përfshihen shpenzimet operative (shpenzimet për shërbime) dhe shpenzime personeli. Vihet re një pabarazi në të gjitha njësitë vendore të Rrethit Tropojë. Pabarazi dhe diferenca në shpenzimet për banorë, shihen dhe ndërmjet bashkisë dhe komunave të saj si komuna Bytyç me 11.520 lekë shpenzime për frymë ndërkohë që bashkia Bajram Curri me 9.180 lekë shpenzime/frymë (operative+personel).

Eliminimi i fragmentimit dhe bashkimi në një njësi të re vendore do të rezultojë në një rishpërndarje më të mirë të shpenzimeve për shërbime publike lokale për të gjithë qytetarët e njësisë së re vendore Tropojë. Duke rezultuar në 1.260 lekë të ardhura/frymë dhe 9.260 lekë shpenzime/frymë.


Çfarë do të ndodhë me investimet në zonën e re funksionale Tropojë? Në rast se Bashkia Bajram Curri dhe 7 komunat do të bashkoheshin në një njësi të vetme vendore, shumë prej funksioneve të cilat përsëriten për çdo njësi vendore, do të suprimohen dhe do të reduktojnë numrin e personelit për njësinë e re vendore. D.m.th. me zbatimin e kësaj skeme do të përfitonim përqendrimin e funksioneve administrative si prokurimi publik, planifikimi urban, shërbimet financiare, administrimi i taksave, etj. çka do të sillte një kursim të shpenzimeve administrative. Ndërkohë që do eliminohen, funksionet e përsëritura në administratën lokale të tilla si financierë, arkëtarë, nënkryetar bashkie, komunë, sekretar të Këshillit Bashkiak, këshilltarë, etj. duke përfituar gjithsej një kursim prej afro 65% të shpenzimeve administrative (duke përfshirë kursimin nga përqendrimi i funksioneve+kursimin nga eliminimi i funksioneve të përsëritura). Gjithashtu një kursim tjetër administrativ afro 7,5 % i shpenzimeve operative, do të vijë dhe nga mirëmbajtja dhe kosto operative të zyrave

administrative, të cilat do të reduktohen si rezultat i reduktimit dhe përqendrimit të funksioneve të cituara më lart. Kjo do të thotë që shpenzimet e personelit do të ulen nga 107.000 mijë lekë në 55.000 mijë lekë, duke rezultuar në një kursim të konsiderueshëm prej rreth 52.000 mijë lekësh. Shpenzimet operative do të ulen nga 83.000 mijë lekë në 78.425 mijë lekë duke na dhënë një kursim prej 4.575 mijë lekë. Këto kursime do reflektohen në një rritje në investime nga 156.575 mijë lekë në 212.575 mijë lekë.

Ajo që vihet re përgjithësisht për rrethin e Tropojës është mungesa e investimeve në disa komuna dhe jo vetëm në një. Këto komuna në skemën aktuale të qeverisjes vendore nuk mund të alokojnë absolutisht asnjë lek, pra zero lekë për investime. Kjo vjen jo vetëm si pasojë e mundësive të ndryshme të njësive vendore për të kryer investime me të ardhurat e tyre por edhe nga skema e financimit të shpenzimeve kapitale të kryera nëpërmjet skemës së granteve konkurruese që në përgjithësi ka krijuar një pabarazi në shpërndarjen e tyre. Në fushën e zhvillimit vendor por edhe për sa i përket investimeve për banorë, njësitet vendore të Tropojës nuk kanë kryer asnjë investim për zhvillimin ekonomik të tyre.

Të gjitha këto fonde të kursyera do të mund të përdoren për rritjen e cilësisë së shërbimeve ose do të mund të investohen në infrastrukturë, transport publik, apo zhvillim ekonomik duke nxitur në këtë mënyrë zhvillimin ekonomik dhe financiar të territorit si edhe thithjen e investimeve të huaja. Për efekt të analizës supozojmë që fondet e kursyera do të përdoren për rritjen e investimeve nga njësia e re vendore.

Figura 214 Investimet për frymë të bashkisë B. Curri/komunave dhe të Njesisë së re Vendore Tropojë



Burimi Ministria e Financave 2012, Llogaritje të autorëve

E njëjta situatë përkthehet edhe për investimet për frymë (Figura 214) ku komuna Margegaj paraqitet me nivelin më të lartë të investimeve për frymë ndërkohë që komunat e tjera si Komuna Fierzë, komuna Lekbibaj dhe komuna Bujan kanë nivelin e investimeve/frymë, zero lekë. Me bashkimin në një NJQV të vetme kjo situatë do të mund të rregullohet duke përfunduar një mesatare investimesh prej 10.360 lekëshbanorë. Këto investime do të rrisin nivelin e jetesës dhe ekonominë e NJQV-së së re, duke u mundësuar frymëmarrjen investitorëve vendas dhe të huaj.


Efektet në ofrimin e shërbimeve

Nga të dhënat, vetëm në bashkinë Bajram Curri dhe në komunën Margegaj prania e ujësjellësit është totale ndërsa në komunat e tjera të rrethit Tropojë ka prani të pjesshme ujësjellësish. Gjithashtu vëmë re se ka një ndërthurje të shpërndarjes së ujësjellësve Sh. A. me ata Komunalë, përfshirja e të cilëve në Sh. A., do të mundësohet me zmadhimin e territorit, në mënyrë që furnizimi me ujë të jetë i plotë dhe i pandërprerë, në të gjithë zonën duke marrë parasysh dhe relievin gjeografik të saj, për t'i mundësuar një shërbim eficient dhe cilësor banorëve të saj.

Vëmë re se kohëzgjatja e furnizimit me ujë është e reduktuar. Duke qenë se prania e ujit është e domosdoshme dhe një shërbim jetësor për banorët, ajo duhet të mundësohet me orar të plotë dhe jo të reduktuar, gjë e cila me zmadhimin e territorit do të mundësohet edhe në zonat në të cilat nuk ekziston ose ekziston pjesërisht prania e ujësjellësit.


Për sa i përket infrastrukturës rrugore përgjithësisht rrethi Tropojë ka rrugë të asfaltuara, gjë që ndikon dhe në kohën që duhet për të përshkuar rrugën nga komunat në qendër Bajram Curri. Vihet re se për të përshkuar rrugën nga komunat deri Bajram Curri, si qendër administrative duhet mesatarisht rreth 30 minuta. Për sa i përket komunave që duan më shumë kohë si komuna Lekbibaj rreth 65 minuta, me zmadhimin e territorit do të mund të krijohen pika shërbimi komunale, në të cilat banorët e këtyre komunave të mund të marrin shërbimet e nevojshme në vendin e tyre të banimit.

Figura 215 Zhvendosjet e banorëve për në punë



Në rrethin e Tropojës, përdorimi i transportit publik nga qytetarët për të shkuar në punë arrin nivelin më të lartë në komunën e Fierzës me 25 % ndërkohë që në qendrën funksionale, Bajram Curri është 6.9 %. Infrastruktura e fragmentuar ndërmjet bashkive e komunave bën që aksesin ndaj këtij transporti të jetë i ulët. Me krijimin e një njësie të vetme vendore, shërbimi i transportit publik do të projektohet e administrohet për të përfshirë interesin e shumë më tepër qytetarëve, duke rritur kështu aksesin në zonat e largëta, e duke i afruar qytetarët me qendrat funksionale.

Figura 216 Shpërndarja e të punësuarve



Ndërkohë që përdorimi i transportit publik në qytetin e Tropojës është vetëm 1.9%, një pjesë e mirë e banorëve të komunave udhëtojnë drejt Tropojës për të shkuar në vendet e tyre të punës. Me heqjen e kufijve ndërmjet komunave e bashkisë infrastruktura rrugore dhe ajo e transportit nuk do të jenë më të fragmentuara. Kjo do të sjellë rritje të aksesit, përmirësim të cilësisë për transportin publik e rrjedhimisht përmirësimin e kushteve të jetesës për të gjithë qytetarët.

Përfundime

Zona Funktionale Tropojë

Ulje të ngarkesës mesatare të administratës vendore për 1000 banorë nga 6.8 aktualisht në 3.5 punonjës për 1000 banorë;

Reduktim të shpenzimeve administrative me 56.5 milion lekë (personeli dhe operative) dhe uljen e këtyre shpenzimeve për banorë në masën 30% nga 9.26 mijë lekë në 6.5 mijë lekë në njësinë e re vendore;

Miradministrimi i burimeve do të sjellë shtim në masën 27% të fondit të investimeve totale në të tetë NJQV, nga 156 milion lekë në 213 milion lekë;

Buxheti i investimeve për frymë do të rritet nga 7.6 mijë lekë në 10.36 mijë lekë;

Zona funksionale Has


Rrethi i Hasit gjithashtu bën pjesë në modelin e përqendruar të Zonës Funksionale, çka do të thotë që zona funksionale korrespondon me kufijtë e rrethit dhe me qendër funksionale, qendrën e rrethit që është Bashkia Krumë. Zona funksionale e Hasit karakterizohet nga një ndërveprim i dendur ndërmjet banorëve të komunave dhe institucioneve, me Bashkinë Krumë që është dhe qendra e zonës funksionale të Hasit. Si zonë funksionale rrethi i Hasit, ka një vazhdimësi territoriale me densitet të mesëm popullsie, 16,790 banorë, të cilat karakterizohen nga shkëmbime tradicionale ndërmjet tyre.

Bashkia Krumë dhe 3 komunat e rrethit të Hasit krijojnë një zonë funksionale të vetme, duke mundësuar ofrimin e shërbimeve ekonomike, sociale dhe kulturore banorëve të saj. Rrethi i Hasit është një krahinë etno-gjeografike me kufij të përcaktuar shumë qartë, i rrethuar pothuajse rreth e qark me lumenj, me reliev malor, me kontraste të mëdha, shumë i copëtuar, me mundësi tepër të kufizuara për toka të punëshme, por me mundësi të shumta për zhvillimin e turizmit, blegtorisë, pemëtarisë, pylltarisë etj.

Distanca e Krumës si qendër funksionale nga komunat Fajze, Gjinaj dhe Golaj është e tillë që nuk pengon aspak ofrimin e shërbimeve për komunitetin, me gjithë karakteristikat e territorit të rrethit. Përkundrazi me krijimin e një NJQV të re nga bashkimi i bashkisë dhe komunave do mund të sigurohen mundësi më të mëdha zhvillimi.

Hapësirat e punësimit në rrethin e Hasit janë të pakta. Të rinjtë që përbëjnë dhe fuqinë më të madhe punëtore, përgjithësisht largohen nga rrethi, migrojnë ose emigrojnë pasi nuk gjejnë dot punë. Të vetmet mundësi, ku ata mund të punësohen janë institucionet si bashkia, shkollat apo spitalet.

Figura 217 Zona funksionale Has



Efektet Demografike

Tabela 5 Të dhëna sociale dhe demografike

Njësitë e Qeverisjes Vendore (2012)	Shkollat të mesme	Shkollat 9-vjeçare	Kopshte	Qendra Shëndetësore dhe ambulanca	Qendra Kulturore	Qendra Sociale	Qendra Sportive	Pop. census 2011	Sipërfaqja (km ²)	Densiteti
Bashkia Krumë	1	4	4	6	1	0	0	6,006	78.6	76
Komuna Fajzë	0	5	6	10	0	0	0	3,491	79.1	44
Komuna Gjinaj	0	4	1	6	0	0	0	1,106	71.2	16
Komuna Golaj	1	9	8	12	0	0	0	6,187	169.4	37
Totali B. K+komunat	2	22	19	34	1	0	0	16,790	398	42
Njësia e Re Vendore (Has)	2	22	19	34	1	0	0	16,790	398	42

Shkollat e sistemit parauniversitar (9-vjeçare) nuk janë të shpërndara në përpjesëtimin e duhur në raport me popullsinë. Për të njëjtin numër popullsie të Bashkisë Krumë dhe Komunës Golaj, kanë respektivisht 4 dhe 9 shkolla 9-vjeçare. E njëjta çrregullsi vihet re për shkollat e mesme në lidhje me popullsinë. Bashkia Krumë ka 1 shkollë të mesme, komuna Golaj ka 1 shkollë të mesme ndërkohë që dy komunat e tjera Fajzë dhe Gjinaj nuk kanë fare shkolla të mesme. Situata e cila në varësi edhe me popullsinë e vendit, me përthithjen e komunave në një NJQV-je do mund të mbështeten fuqishëm nga subvencionet qendrore. Njësia e re vendore do të ketë gjithsej 2 shkolla të mesme, 22 shkolla 9-vjeçare dhe 19 kopshte, për 16.790 banorë, duke synuar një shpërndarje më të mirë të infrastrukturës shkollore për të gjithë nxënësit, gjë që nuk garantohet në sistemin e fragmentuar të qeverisjes vendore.

Tabela 5 tregon qartë mungesën e aksesit social, kulturor, sportiv të komunave larg qendrës Krumë. Mungesë e kushtëzuar nga fakti se shumica e qendrave sociale, kulturore, sportive dhe shëndetësore janë përqendruar vetëm në qendrën urbane të Krumës. Kemi vetëm një qendër kulturore në Bashkinë Krumë, ndërkohë që në komunat e tjera mungon tërësisht aksesit kulturor.

Mungon përkrahja për personat me aftësi të kufizuara. Ndërsa shërbimi në spital është i mirë por ka mungesë barnash dhe staf të vogël mjekësor. Ajo që të bie në sy tek tabela më sipër është shifra zero në kolonat e qendrave sociale dhe sportive. Kjo do të thotë që në të gjithë rrethin e Hasit ka një mungesë totale të qendrave sociale dhe sportive. Kjo mungesë aksesit kushtëzon dhe mungesën e zhvillimit. Ajo që tashmë dihet është fakti se qeveritë e vogla vendore përballen me një potencial të shpërndarjes së shërbimeve të copëzuara dhe të paefektshëm. Është kjo arsyeja që këto njësi vendore mbajnë shifrat afër zero ose zero.

Me bashkimin dhe përthithjen në një NJQV të re do krijohen mundësitë për ruajtjen dhe nxitjen e vlerave kulturore dhe historike vendore. Nxitjen për ngritjen dhe zhvillimin e shërbimeve sociale për jetimët, të moshuarit dhe shtresave në nevojë. Zhvillimi i turizmit malor, punësimi në rrethin e Hasit, funksioni i sistemit arsimor si dhe funksioni i shërbimeve sociale do të ndikonin në përmirësimin e situatës ekonomike të banorëve si dhe në hapjen e hapësirave të reja të punësimit.

Në NJQV e re do vazhdohet të promovohen vlerat natyrore dhe kulturore të Hasit, që po tërheqin gjithnjë e më shumë turistë të huaj dhe vizitorë vendas. Do vazhdojnë gjithashtu investimet në fushën e arsimit, në mënyrë që brezat e rinj të jenë sa më konkurrues në tregun e punës. Për të përmirësuar situatën e krijuar në këtë rreth duhet të shfrytëzohen resurset e shumta që ka ky rreth si të zhvillohet turizmi malor, bujqësia, blegtoaria si dhe sektori mineral. Të gjitha këto do të mundësonin zhvillim ekonomik si dhe rritjen e punësimit. Vihet re se përqendrimi i popullsisë është më i madh në Krumë, me një dendësi 76 banorë, kjo nëse marrim parasysh dhe vendbanimet e shtuara të të ardhurve në periferi të qytetit. Ndërkohë që me bashkimin në një NJQV, tendenca për migrim dhe emigrim do të ulet, pasi, treguesit ekonomiko-shoqërorë si faktorët kryesorë për favorizimin e migrimit, synohen të rriten në NJQV-në e re.

Efektet ekonomike dhe financiare

Tabela 6 Të dhëna ekonomike dhe financiare për bashkinë Krumë/komunat dhe për Njësinë e re Vendore Has (000 lekë)

Njësitë e Qeverisjes Vendore (2012)	Popullsia census 2011	Totali i bizneseve	Biznese për 100 banorë	Të ardhura të veta	Shpenzime Personeli	Shpenzime Operative	Investime	Investime për frymë	Buxheti Total	Buxheti për frymë	Të ardhurat për frymë	Shpenzime për frymë (op+personel)
Bashkia Krumë	6,006	168	28	8,758	25,000	22,000	74,000	12.32	121,000	20.15	1.46	15.98
Komuna Fajzë	3,491	8	2	337	15,000	4,000	14,000	4.01	33,000	9.45	0.10	5.16
Komuna Gjinaj	1,106	4	4	468	13,000	5,000	15,000	13.56	33,000	29.84	0.42	18.08
Komuna Golaj	6,187	18	3	3,199	5,000	4,000	0	0.00	9,000	1.45	0.52	0.65
Bashkia Krumë dhe Komunat	16,790	198	12	12,762	58,000	35,000	103,000	6.13	196,000	11.67	0.76	8.22
Njësia e Re Vendore (Has)	16,790	198	12	12,762	36,550	32,375	127,075	6.98	196,000	11.67	0.76	8.22

Tabela 66 mundëson një përshkrim të situatës aktuale dhe asaj që do ofrohet mbas bashkimit në një njësi vendore të vetme. Me gjithë territorin e copëzuar, në kolonën e totalit të bizneseve, bie në sy një shpërpjesëtim i theksuar i shpërndarjes së bizneseve për njësitë vendore të rrethit Has. Biznese në këtë rreth ka shumë pak dhe të shpërndara në mënyrë të pabarabartë gjë që vihet re edhe nga tabela më sipër. Bashkia Krumë ka 168 biznese në total (ku përfshihet biznesi i madh, i mesëm, i vogël dhe të tjera), ndërsa komuna Gjinaj ka vetëm 4 biznese në total. Kjo diferencë reflektohet edhe në biznese për 1000 banorë, ku bashkia Krumë përbëhet nga 28 biznese/1000 banorë, komuna Gjinaj 4 biznese/1000 banorë, komuna Fajzë 2 biznese/1000 banorë.

Mbas bashkimit në një NJQV të vetme (Figura 14) do mund të kemi një rishpërndarje të bizneseve në total dhe bizneseve për frymë, në mënyrë të tillë që të mund t'i ofrojnë shërbime dhe akses të gjithë komunitetit. NJQV e re do ketë 198 biznese në total dhe 12 biznese/1000 banorë duke rritur potencialin për më shumë biznese dhe akses në punësim të të gjithë qytetarëve të zonës, por edhe duke ecur paralel me objektivin e reformës që është pikërisht krijimi i NJQV-ve ekonomikisht të forta dhe administrativisht efçente.

Me bashkimin në një NJQV do mund të sigurohet kontributi optimal i vetë partnerëve lokalë së pari dhe donatorëve së dyti, me qëllim që të sigurojë një rritje të përgjithshme ekonomike dhe zhvillim të qëndrueshëm të Komunitetit të NJQV-së së re. Ky bashkim nxjerr në pah

resurset natyrore dhe njerëzore që disponon zona funksionale. Evidenton problemet dhe vë në dukje vështirësitë. Lehtëson mbështetjen e donatorëve për NJQV-në e re, duke lejuar partnerët e interesuar për zhvillim, të shikojnë se si burimet e tyre mund të shfrytëzohen sa më mirë.


Të vetmit sektorë ku mund të punësohen njerëzit në rrethin e Hasit janë shëndetësia dhe arsimi. Me pas mbetet vetëm vetëpunësimi. Rrethi i Hasit është i pasur me minerale, me krom dhe hekur nikel. Njësia e re Vendore do të krijojë sinergji me investitorët me qëllim shfrytëzimin dhe menaxhimin më të mirë të burimeve natyrore të zonës duke sjellë përmirësim të zhvillimit ekonomik dhe rritjen e punësimit.

Një ndryshim i dukshëm do të rezultojë edhe në treguesit e buxhetit jo vetëm në buxhetin total të njësisë së re vendore por edhe në buxhetin për frymë. Bashkia Krumë ka një buxhet prej 121 milion lekësh për një popullsi prej 6.006 mijë banorësh, ndërsa komuna Golaj ka një buxhet total prej 9 milion lekësh për një popullsi prej 6.187 mijë banorësh, buxhet që është i destinuar tërësisht për të mbuluar shpenzimet e personelit dhe ato operative ndërsa investimet janë zero.

Kjo situatë do të ndryshojë plotësisht duke mundësuar një rishpërndarje të buxhetit në NJQV-në e re duke përfshirë një buxhet total prej 196 milion lekësh. Ky buxhet në njësinë e re vendore do eliminojë pabarazitë në shpërndarjen e tij. E njëjta situatë paraqitet edhe për buxhetin për frymë, Bashkia Krumë ka një buxhet rreth 20.150 lekësh/frymë, ndërsa komuna Gjinaj ka një buxhet prej 29.840 lekësh/frymë për një numër banorësh prej 1.107 banorësh.

Më bashkimin në një njësi të vetme vendore Has do kemi një buxhet për frymë prej 11.670 lekësh/frymë, duke reduktuar në maksimum pabarazitë e vëna re në situatën aktuale dhe duke garantuar një buxhet mesatar për çdo qytetar të njësisë së re vendore Has. Shpërndarja e pabarabartë në buxhet dhe resurse do të rregullohet në njësinë e re vendore duke rishpërndarë në mënyrë të drejtë dhe barabartë buxhetet dhe resurset për të gjithë qytetarët në njësinë e re vendore.

Figura 218 Buxheti total dhe buxheti për frymë i bashkisë Krumë/komunave dhe i Njësisë së re Vendore Has



Në rast se analizojmë të ardhurat dhe shpenzimet për frymë të gjeneruara dhe shpenzuara nga njësitet vendore të rrethit Has vëmë re të njëjtin fenomen të pabarazisë ndërmjet njësive vendore (Figura 16), një shpërndarje jo e barabartë e të ardhurave për banorë në njësi të ndryshme vendore.

Komuna Gjinaj ka nivel të ardhurash 420 lekë/frymë mbas nivelit më të ulët të të ardhurave për frymë që e ka komuna Fajzë me 100 lekë/frymë. Ajo që të bën përshtypje është fakti se komuna Gjinaj e ka nivelin e të ardhurave për frymë shumë të ulët, krahasuar me shpenzimet për frymë që ajo bën.

Nga bashkimi i njësive vendore në njësinë e re vendore Has, do të kemi 760 lekë të ardhura/frymë duke siguruar një rishpërndarje më të drejtë të të ardhurave për frymë për të gjithë banorët e njësisë së re vendore.

Gjithashtu, nga bashkimi do mund të përfitojmë mesatarisht 554 lekë shpenzime për frymë (operative + personel), duke rishpërndarë shpenzimet e komunës Gjinaj për shembull me 16.270 lek shpenzime/frymë me komunën Golaj që ka 1.450 lekë shpenzime/frymë dhe duke mundësuar një rishpërndarje të shpenzimeve për çdo banor të njësisë së re vendore Has.

Eliminimi i fragmentimit dhe bashkimi në një njësi të re vendore do të rezultojë në një rishpërndarje më të mirë të shpenzimeve për shërbime publike lokale për të gjithë qytetarët e njësisë së re vendore Has.

Për sa i përket shpenzimeve për personelin dhe shpenzimeve operative, vëmë re se Bashkia Krumë shpenzon për personelin 25 milion lekë dhe për shpenzime operative 22 milion lekë, ndërsa komuna Golaj shpenzon për personelin 5 milion lekë dhe operative 4 milion lekë. Bashkia dhe komunat bashkë shpenzojnë për personelin e administratës 58 milion lekë dhe shpenzime operative 35 milion lekë. Shifrat e përmendura më sipër rezultojnë të jenë të larta krahasuar me popullsinë e komunave dhe personelin e administratave të tyre.

Duke parë situatën aktuale, një pjesë e mirë e buxhetit të bashkisë dhe komunave shkojnë për mbulimin e shpenzimeve të personelit dhe operative, duke rezultuar në fund më pamjaftueshmëri financiare për tu ofruar qytetarëve shërbime publike lokale, përfshirë edhe ato më të nevojshmet.

Figura 219 Të ardhurat dhe shpenzimet (operative+personel) për frymë i bashkisë Krumë/komunave dhe i Njësisë së re Vendore Has




Figura 220 jep shpërndarjen e investimeve për të gjitha njësitë vendore të rrethit Has. Ajo që vihet re është se Komuna Golaj ka zero investime ndërsa Bashkia Krumë ka nivelin më të lartë të investimeve.


Çfarë ndodh aktualisht me investimet në rrethin e Hasit? Ajo që vihet re është se Bashkia Krumë me një popullsi prej 6.006 banorësh, ka pasur investime prej 74 milion lekësh ndërsa Komuna Golaj me një popullsi prej 6187 banorësh, i ka zero investimet. Ndërsa investimet për frymë janë më të larta në Komunën Gjinaj me 13.560 lekë investime/frymë.

Çfarë do të ndodhë më investimet në zonën e re funksionale Has? Në rast se Bashkia Krumë dhe 3 komunat do të bashkoheshin në një njësi të vetme vendore, shumë prej funksioneve të

cilat përsëriten për çdo njësi vendore, do të suprimohen dhe do të reduktojnë numrin e personelit për njësinë e re vendore. Pra me zbatimin e kësaj skeme do të përfitonim përqendrimin e funksioneve administrative të komunave si: prokurimin publik, planifikimin urban, shërbimet financiare, administrimin e taksave, etj. çka do të sillte një kursim të konsiderueshëm. Ndërkohë që do eliminohen funksionet e përsëritura në administratën lokale të tilla si financierë, arkëtarë, nënkryetar bashkie, komunë, sekretar i Këshillit Bashkiak, këshilltarë, etj. me një kursim prej afro 65% të shpenzimeve administrative (duke përfshirë kursimin nga përqendrimi i funksioneve+kursimin nga eliminimi i funksioneve të përsëritura). Gjithashtu një kursim tjetër administrativ afro 7,5 % i shpenzimeve operative, do të vijë dhe nga mirëmbajtja dhe kosto operative të zyrave administrative, të cilat do të reduktohen si rezultat i reduktimit dhe përqendrimit të funksioneve të cituara më lart. Kjo do të ndikojë në shpenzimet për mbajtjen e administratës, pra shpenzimet e personelit do të ulen nga 58.000 mijë lekë në 36.550 mijë lekë, duke rezultuar në një kursim të konsiderueshëm prej rreth 21.450 mijë lekë. Shpenzimet Operative do të ulen nga 35.000 mijë lekë në 32.375 mijë lekë duke na dhënë një kursim prej 2.625 mijë lekë. Këto kursime do reflektohen në një rritje investimesh nga 103.000 mijë lekë në 127.075 mijë lekë.


Të gjitha këto fonde të kursyera do të mund të përdoren për rritjen e cilësisë së shërbimeve ose do të mund të investohen në infrastrukturë, transport publik, apo zhvillim ekonomik duke nxitur në këtë mënyrë zhvillimin ekonomik dhe financiar të territorit si edhe thithjen e investimeve të huaja. Për efekt të analizës supozojmë se fondet e kursyera do të përdoren për rritjen e investimeve nga njësia e re vendore.

Figura 220 Investimet e bashkisë Krumë/komunave dhe i Njësisë së re Vendore Has



Rritja e investimeve që tregon Figura 28, pasqyrohet dhe nga Figura 29 investimeve për frymë . Nga grafiku vëmë re se investimet për frymë Bashkia Krumë i ka 12.320 lekë, Komuna Fajzë 4.010 lekë ndërsa komuna Golaj zero lekë.

Figura 221 Investimet për frymë të bashkisë Krumë/komunave dhe të Njësisë së re Vendore Has



Nga bashkimi i bashkisë Krumë, me shifër investimesh për frymë më të madhe në rreth, me komunat me shifër 0 ose 4.010 lekë investime për frymë, do përftojme një shifër mesatare prej 7.570 lekësh investime/frymë, duke balancuar në këtë mënyrë diferencën e investimeve për frymë që ekziston aktualisht mes bashkisë dhe komunave. Rritja e investimeve do të mundësojë dhe një rritje të investimeve për frymë nga 6.130 lekë (si rezultat vetëm nga bashkimi i njësive vendore) në 7.570 lekë për NJQV e re si rezultat edhe i kursimeve administrative.


Efektet në ofrimin e shërbimeve

Nga të dhënat e mundësuarra, në rrethin e Hasit prania e ujësjellësit është përgjithësisht Sh. A. vetëm komuna Gjinaj e ka ujësjellësin Komunal dhe pjesërisht të pranishëm. Me zmadhimin e territorit do të mundësohet një përfshirje e komunës Gjinaj që përfiton shërbime nga ky ujësjellës, në Sh. A. duke përfutur një fuqizim, në mënyrë që furnizimi me ujë të jetë i plotë dhe i pandërprerë, në të gjithë zonën duke marrë parasysh dhe relievin gjeografik të saj, për t'i mundësuar një shërbim eficient dhe cilësor banorëve të saj.

Vëmë re së kohëzgjatja e furnizimit me ujë është e reduktuar. Duke qenë se prania e ujit është e domosdoshme dhe një shërbim jetësor për banorët, ajo duhet të mundësohet me orar të plotë dhe jo të reduktuar, gjë e cila me zmadhimin e territorit do të mundësohet edhe në zonat në të cilat nuk ekziston ose ekziston pjesërisht prania e ujësjellësit.

Për sa i përket infrastrukturës rrugore rrethi Has ka mesatarisht 29 rrugë të paasfaltuara. Vihet re se për të përshkuar rrugën nga komunat deri në Krumë, si qendër administrative duhet mesatarisht rreth 31 minuta. Për sa i përket komunave që duan më shumë kohë si komuna Gjinaj rreth 60 minuta, me zmadhimin e territorit do të mund të krijohen pika shërbimi komunale, në të cilat banorët e këtyre komunave të mund të marrin shërbimet e nevojshme në vendin e tyre të banimit.


Figura 222 Mjetet e transportit te perdorura



Në rrethin e Hasit, përdorimi i transportit publik nga qytetarët për të shkuar në punë arrin nivelin më të lartë në komunën Gjinaj me 5.9%, ndërkohë që në qendrën funksionale, Krumë është vetëm 0.7 %. Infrastruktura e fragmentuar ndërmjet bashkive e komunave bën që aksesin ndaj këtij transporti të jetë i ulët. Me krijimin e një njësie të vetme vendore, shërbimi i transportit publik do të projektohet e administrohet për të përfshirë interesin e shumë më tepër

qytetarëve, duke rritur kështu aksesin në zonat e largëta, e duke i afruar qytetarët me zonat funksionale.

Figura 223 Shpërndarja e të punësuarve



Me heqjen e kufijve ndërmjet komunave e bashkisë, infrastruktura rrugore dhe ajo e transportit nuk do të jenë më të fragmentuara. Kjo do të sjellë përmirësimin e cilësisë për transportin publik dhe rritjen e aksesit në zonat e largëta duke krijuar kushte për mobilitet dhe punësim më të lartë.

Përfundime

Ulje të ngarkesës mesatare të administratës vendore për 1000 banorë nga 7 aktualisht në 4.4 punonjës për 1000 banorë;

Reduktim të shpenzimeve administrative me 24 milion lekë (personeli dhe operative) dhe uljen e këtyre shpenzimeve për banorë në masën 26% nga 5.5 mijë lekë në 4.11 mijë lekë në njësinë e re vendore;

Miradministrimi i burimeve do të sjellë shtim në masën 20% të fondit të investimeve totale në të katër NJQV, nga 103 milion lekë në 127 milion lekë;

Buxheti i investimeve për frymë do të rritet nga 6.13 mijë lekë në 7.57 mijë lekë.


QARKU LEZHË

Profili i qarkut Lezhë

Popullsia e qarkut të Lezhës përbën më pak se 6% të popullsisë së vendit dhe është e vendosur në 21 njësi të qeverisjes vendore të organizuara në tri rrethe: rrethi Kurbin (4 njësi me qendër Laçin); rrethi Lezhë (10 njësi me qendër Lezhën) dhe rrethi Mirditë (7 njësi me qendër Rrëshenin). Në vitin 2011, popullsia e qarkut të Lezhës ishte 134 027 banorë, 49% (65 633 banorë) e të cilëve jetojnë në rrethin e Lezhës, 16% (22 103) jetojnë në rrethin e Mirditës dhe rreth 35% (46 291 banorë) jetojnë në rrethin e Kurbin (INSTAT, Census 2011). Megjithatë, shumica e njësive kanë dendësi shumë të ulët: gjysma janë nën nivelin 87 banorë/km², ndërsa dendësia mesatare e popullsisë së komunave është 80 banorë/km². Disa zona urbane kanë dendësi më të lartë, p.sh. qyteti i Lezhës (2864 banorë/km²) apo Lacit (750 banorë/km²), ndërsa qytete si Rrësheni dhe Rubiku kanë dendësi të ulët (55 dhe 37 banorë/km²).

Qarku i Lezhës ka pasur një humbje neto të popullsisë prej rreth 37% ose mbi 78 000 banorë krahasuar me të dhënat zyrtare të Regjistrimit të Gjendjes Civile të vitit 2011. Rrethi i Mirditës ka mesataren më të ulët të popullsisë në qark. Njësitë më të vogla janë Selita, Kacinari dhe Oroshi në Mirditë dhe Ungrej në Lezhë (më pak se 2000 banorë secila), në të cilat jetojnë vetëm 3,9% e të gjithë popullsisë totale të qarkut.

Figura 224 Diferenca mes popullsisë sipas INSTAT-it dhe RGJC-së në 2011 për qarkun e Lezhës



Burimi: Census 2011; Ministria e Brendshme (RGJC) 2012

Popullsia mesatare për njësi të qeverisjes vendore në këtë qark është 6382 banorë/NJQV ose 20% më e ulët se mesatarja kombëtare 8016 banorë/NJQV. Dendësia mesatare e popullsisë është 250 banorë/km², më e lartë krahasuar me mesataren kombëtare prej 97,4 banorë/km².

Për të përcaktuar më saktë modelin e aplikueshëm të zonës funksionale në qarkun e Lezhës, ndërveprimi aktual ndërmjet banorëve të njësive administrative është analizuar më në detaje si në vijim.


Ndërveprimi institucional në qarkun e Lezhës

Institucionet kryesore në qarkun e Lezhës janë prefektura e Lezhës, Drejtoria Rajonale e Arsimit, Drejtoria Rajonale e Bujqësisë, Drejtoria Rajonale e Shëndetit Publik, Drejtoria Rajonale e Pyjeve, Drejtoria Rajonale e Policisë së qarkut Lezhë, Agjencia Rajonale e Mjedisit e qarkut Lezhë. Të gjitha këto drejtori janë të vendosura në qytetin e Lezhës dhe mbulojnë aktivitetet përkatëse të tri rretheve Lezhë, Laç dhe Mirditë. Drejtoria Rajonale e Shëndetit Publik gjendet në bashkinë Lezhë dhe dy Drejtoritë e Shëndetit Publik në rrethet Kurbin dhe Mirditë.

Gjithashtu, siguria në qarkun e Lezhës mundësohet nga Drejtoria e Policisë së qarkut Lezhë, së bashku me komisaritet e policisë së Lezhës, Mirditës dhe Kurbin, të vendosura në qytetet e Lezhës, Rrëshenit dhe Lacit. Njësia rajonale e policisë rrugore Lezhë mbulon Lezhën, Kurbinin, Krujën dhe Mirditën. Shteti i së drejtës në këtë qark sigurohet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, e cila gjendet në Lezhë dhe e shtrin juridiksionin e saj në rrethet Lezhë dhe Mirditë. Prokuroritë e rretheve Lezhë dhe Mirditë gjenden përkatësisht në bashkitë e Lezhës dhe Rrëshenit. Në qytetin e Laçit është vendosur Gjykata e Rrethit Kurbin dhe Prokuroria e Rrethit Kurbin.

Shërbimet që mbulohen nga zyrat e punësimit, zyrat e sigurimeve shoqërore, të tatim taksave, të Regjistrimit të Automjeteve dhe Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme janë të pranishme në nivel komune dhe bashkie në të gjithë qarkun.

Figura 225 Ndërveprimi institucional në qarkun Lezhë




Vendndodhja fizike e këtyre institucioneve në qendrat e rretheve të qarkut Lezhë, ku njerëzit drejtohen për të marrë të mirat dhe shërbimet, përkthehet në një ndërveprim të vazhdueshëm të banorëve të organizuar në njësitë rreth këtyre qendrave.

Ndërveprimi ekonomik ndërmjet njësive vendore të qarkut Lezhë

Të ardhurat e NJQV-ve të qarkut të Lezhës përbëjnë rreth 4,6% të totalit të të ardhurave vendore në Shqipëri. Njësia me buxhet (të ardhurat totale) më të madh është bashkia e Lezhës (242 milionë në vitin 2012). Qyteti i Lezhës ka një peshë specifike prej 20% në buxhetin total të njësive të qarkut, ndërsa realizon rreth 29% të të ardhurave të veta totale. Bashkia e Laçit ka një peshë specifike prej 12% në buxhetin total të njësive të qarkut, ndërsa komuna Shëngjin 10%. Shpenzimet për personelin në këto njësi kanë peshë specifike të përafërt me atë të buxhetit total.

Shpenzimet operative zënë pjesën më të madhe të shpenzimeve totale në qarkun e Lezhës, mesatarisht pothuajse 66% në vitet 2008–2012 e 71% në vitin 2012. Ndër këto, shpenzimet për personelin janë më shumë se gjysma e shpenzimeve operative totale ose mesatarisht 33% e shpenzimeve totale të NJQV-ve të qarkut. Shpenzimet kapitale kanë një peshë specifike prej 34% në strukturën totale ose 29% në vitin 2012, duke pësuar ulje krahasuar me vitet paraardhëse. Ky raport është i ngjashëm me raportet kombëtare prej 34% në 5 vite, por më i lartë për vitin e fundit (26% në vitin 2012 në nivel kombëtar). Bashkia e Lezhës, e cila ka rreth 12% të popullsisë së qarkut, zë një peshë prej rreth 20% në totalin e shpenzimeve të njësive të qarkut në vitin 2012. Njësi të tjera me buxhete më të mëdha në qark përfshijnë bashkinë e Laçit (12% në 2012), Mamurrasit dhe Shëngjinit. Ndërkohë, pothuaj një e treta e të ardhurave të veta (29%) të qarkut të Lezhës gjenerohen në bashkinë Lezhë dhe 17% në Shëngjin.


Figura 226 Shpenzimet kapitale në raport me shpenzimet operative në NJQV-të e qarkut Lezhë



Burimi: Ministria e Financave; Ilogaritjet e autorëve

Sektori i shërbimeve publike (përfshin shërbimet e pastrimit e shërbime të tjera të ngjashme) zë pjesën më të madhe të shpenzimeve edhe në qarkun e Lezhës me rreth 63% të shpenzimeve, i ndjekur nga sektori i transportit (që përfshin infrastrukturën rrugore dhe mirëmbajtjen e saj) me rreth 20% mesatarisht. Pësia e sektorit të shërbimeve publike është rritur ndjeshëm vitin e fundit, ndërkohë që sektori i transportit ka pasur tkurrje.

Figura 227 Shpenzimet sipas sektorëve (funsioneve) në NJQV-të e qarkut Lezhë



Burimi: Ministria e Financave, Llogaritjet e autorëve

Sipas të dhënave të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, në Lezhë janë të regjistruar 4440 biznese, ndër të cilët 91 ose rreth 2% e tyre janë biznese të mëdha dhe të mesme. Në qytetin e Lezhës e zhvillojnë aktivitetin e tyre pothuajse 30% e numrit të përgjithshëm të bizneseve (si dhe e bizneseve të mëdha), rreth 7% në Shëngjin dhe 22% në Laç.

Sipas të dhënave të katërmujorit të tretë të vitit 2013, në qarkun e Lezhës janë 15 371 persona të regjistruar si të papunë, 1077 prej të cilëve përfitojnë pagesë papunësie.


Ofrimi i shërbimeve në nivel qarku

Një tregues i përdorimit të qëndrueshëm të burimeve financiare të njësive vendore është dhe akses i banorëve të këtyre njësive në shërbime dhe infrastrukturë.

Transporti

Qarku i Lezhës përshkohet nga 293,3 km rrugë kombëtare (8% e rrjetit rrugor të vendit), ku 236,4 km janë rrugë të kategorisë C “rrugë interurbane dytësore” dhe vetëm 56,9 km janë rrugë të kategorisë B “rrugë interurbane kryesore”, të cilat administrohen në nivel kombëtar. Infrastruktura rrugore rurale është 9451 km, prej të cilave 4471 km janë rrugë rurale rajonale dhe 4979 km janë rrugë rurale. Kjo infrastrukturë rrugore si dhe shërbimet që lidhen me të janë tashmë në pronësi dhe administrim të pushtetit vendor. Bashkitë dhe komunat janë vendimmarrëse për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e tyre.


Figura 228 Harta e rrjetit rrugor në qarkun Lezhë



Për sa i përket aksesit të transportit dhe kohës së udhëtimit brenda qarkut, vetëm 24% e NJQV-ve gjenden në një largësi më tepër se 40 km nga qendra e qarkut, ku komuna Fan është njësia më e largët (62 km) nga qendra e qarkut.

Shumica e vendbanimeve mund të arrijnë qendrën e qarkut brenda një ore, kurse vetëm dy njësi (Ungrenj dhe Kacinar) duan më tepër se një orë udhëtim.

Figura 229 Largësia e NJQV-ve nga qendra e qarkut Lezhë



Një nga shërbimet e decentralizuara që has vështirësi të mëdha është transporti publik vendor. Në qarkun e Lezhës ky transport organizohet nëpërmjet autobusëve, furgonëve, taksive dhe rrejtësive hekurudhore. Aktualisht shërbimi është shumë i copëzuar brenda qarkut. Ndërkohë që qarku është përgjegjës për përkufizimin e planit të lëvizjes, bashkitë dhe komunat kanë kompetencën administrative të licencimit. Kështu linjat e transportit nuk mund të kalojnë përtej territorit të licencimit. Kjo rezulton në një shërbim mjaft të copëzuar, me kosto të lartë për ofruesin dhe me një cilësi të ulët.

Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizime

Ky shërbim në qarkun e Lezhës mundësohet nga 4 operatorë, të cilët janë SHA UK Lezhë, SHA UK Mirditë, SHA UK Rubik dhe SHA U Kurbin. Përveç SHA UK Rubik ku aksionet zotërohen 100% nga bashkia Rubik pasi zona e mbulimit të saj i përket dhe kufijve administrativë të bashkisë, aksionet e tri shoqërive të tjera janë shpërndarë midis tri NJQV-ve. Tri nga këto shoqëri ofrojnë shërbime për furnizimin me ujë të pijshëm dhe për largimin e ujërave të ndotura sipas tabelës në vijim. Transferimi i shoqërive të ujësjellës kanalizimeve në pronësi të pushtetit vendor në Lezhë dhe Mirditë nuk ka përfunduar akoma.

Tabela 111 Mbulimi i shërbimit të UK-së në qarkun Lezhë

Operatori	Aktiviteti	Nr. i lidhjeve (ujësjellës)	Numri i lidhjeve (ujë i ndotur)	Nr. i punonjësve
Lezhë	UK	7089	7081	81
Mirditë	UK	1204	1038	27
Rubik	UK	498	478	14
Kurbin	U	5289	-	83
Total		14 080	8587	205

Burimi: ERRU, Raporti i Performancës së Sektorit të Ujit 2012

Sipas raportit të performancës së ERRU (2012), SHA UK Lezhë operon me 4,6 punonjës për 1000 lidhje. Kohëzgjatja e furnizimit me ujë të vazhdueshëm nga SHA UK Lezhë në vitin 2012 ishte 20 orë në ditë. SHA UK Lezhë ofron shërbimin e kanalizimit në masën 90,7 %. SHA UK Rubik mundëson furnizimin e vazhdueshëm me ujë të pijshëm 21,8 orë në ditë. SHA U Kurbin mundëson vetëm shërbimin me ujë të pijshëm në 5289 klientë.

Shërbimi i largimit të mbetjeve dhe pastrimit

Ky shërbim sigurohet vetëm për 52% të popullsisë së qarkut të Lezhës. Njësitë e qarkut Lezhë nuk arrijnë të mbulimojnë me shërbimin e grumbullimit dhe largimit të mbetjeve të gjithë territorin në juridiksionin e tyre. Bashkitë e mbulojnë këtë shërbim në masën 57%. Ky shërbim nuk ofrohet në të gjitha fshatrat e bashkive Rubik, Rrëshen dhe Mamurras, prandaj dhe përqindja e tyre e mbulimit në këto bashki është më e ulët se në bashkitë e tjera. Ky shërbim ofrohet vetëm në 6 komuna (Ballëdren, Kallmet, Kolsh, Shëngjin, Shënkoll dhe Zjemen), duke bërë që mbulimi i këtij shërbimi në zonat rurale të jetë për të gjithë qarkun në rreth 53%.

Zona e qarkut të Lezhës aktualisht ka 5 vende tradicionale të asgjësimit të mbetjeve: i) vend depozitimit të Berzanit, ii) vend depozitimit të Cekajt, iii) lëndfilli i Cekajt, iv) vend depozitimi i Laçit, v) vend depozitimi në Mamurras. Me përjashtim të lëndfillit të Cekajt, vend depozitimet e tjera nuk kanë ndërtime inxhinierike të përshtatshme, duke çuar kështu në një ndotje mjedisore të vazhdueshme.

Tabela 112 Vend depozitimet ekzistuese të mbetjeve

Bashkia	Vend depozitimi aktual	Siperfaqe (m ²)	Kapaciteti (m ³)	Dalja e vend pozitimit jashtë funksionit
Lezhë	Lendfilli Bushat		1 000 000	2010-2030
Laç	2 km ne veri te qytetit (fshati Delbnisht)	10 000	300 000	Maks. 2014
Rubik	Vend depozitimi Cekaj	2500	60 000	2010-2018
Rrëshen	Lendfilli Cekaj	2500	60 000	2010-2013
Mamurras	7,5 km në jug-lindje të qytetit	3000	40 000	2010-2015

Burimi: Plani i Menaxhimit të Mbetjeve për Qarkun Lezhë 2013 (Projekti SELEA)

Menaxhimi i funksioneve të përbashkëta në qarkun Lezhë

Shërbimet sociale

Duke qenë se politikat dhe procedurat për mbrojtjen sociale janë përgjegjësi e pushtetit qendror, autoritet vendore janë përgjegjëse për ngritjen e strukturave përkatëse të shërbimit social dhe përgjigjen për ofrimin e shërbimeve ndaj banorëve të tyre. Numri i strukturave që mundësojnë mbulimin e shërbimeve sociale në qarkun e Lezhës është 25 struktura shtetërore dhe 4 private.

Tabela 113 Mbulimi i shërbimeve sociale në qarkun Lezhë në vitin 2013

Tipi i shërbimit social të ofruar	Private	Publike
Shërbime sociale për të moshuar	1	1
Shërbime sociale për gra dhe vajza	-	4
Shërbime sociale për fëmijët	3	10
Shërbime sociale për familjet dhe komunitetet	-	3
Shërbime sociale për PAK	-	6
Shërbime sociale për të rinj me probleme sociale	-	1
Total	4	25

Burimi: Harta e shërbimeve sociale në Shqipëri 2013 (MMSR dhe UNICEF)

Shëndetësia

Shërbimi shëndetësor në qarkun e Lezhës ofrohet nëpërmjet shërbimit shëndetësor parësor dhe atij spitalor. Shërbimi spitalor mundësohet nga tri spitale me një numër total prej 319 shtretërish dhe 155 mjekësh. Këto spitale janë Spitali Rajonal Lezhë i vendosur në qytetin e Lezhës, Spitali Mirditë i vendosur në qytetin e Rrëshenit dhe Spitali i Kurbinit i vendosur në qytetin e Laçit. Kujdesi shëndetësor parësor ofrohet përmes 21 qendrave shëndetësore, 126 ambulancave dhe 2 konsultoreve. Distanca nga qendra më e afërt shëndetësore/mjeku më i afërt në zonat urbane është 23 minuta, ndërsa në zonat rurale është 19 minuta.

Tabela 114 Institucionet shëndetësore në qarkun Lezhë

Rrethi	Spital	Maternitet	Qendra shëndetësore	Ambulanca	Konsultore
Kurbin	1	1	4	20	1
Lezhë	1	1	10	54	1
Mirditë	1	1	7	62	-
Total	3	3	21	126	2

Burimi: Ministria e Shëndetësisë

Arsimi

Në qarkun e Lezhës gjenden 5% e numrit total të institucioneve arsimore në nivel vendi. Infrastruktura për të ndjekur arsimin parashkollor mungon vetëm në komunën Ungrej. Për sa i përket arsimit 9-vjeçar, ai është funksional në të gjitha njësitë e qarkut. Shkollat e mesme mungojnë në komunat Kolç, Kaçinar dhe Selitë.

Tabela 115 Numri i insitucioneve arsimore në qarkun e Lezhës


Rrethi	Kopshte		Shkolla 9-vjeçare		Shkolla të mesme		Popullsia (Census 2011)	
	Bashki	Komuna	Bashki	Komuna	Bashki	Komuna	Bashki	Komuna
Kurbin	12	13	15	15	2	2	32 370	13 921
Lezhë	6	39	4	52	2	10	15 510	50 123
Mirditë	12	18	18	37	2	3	13 257	8846
Total	30	70	37	104	6	15	72 890	61 137

Burimi: Ministria e Arsimit dhe Sportit

Numri i fëmijëve që ndjekin arsimin parashkollor është 4103 fëmijë, (6% i numrit total të fëmijëve të regjistruar në nivel kombëtar). Në vitin akademik 2010-2011 raporti fëmijë/edukatore është 19 fëmijë për një edukatore, i njëjtë me raportin në nivel kombëtar.


Në nivel qarku, 86% e fëmijëve në moshën 9–14 vjeç ndjekin arsimin 9-vjeçar në qarkun e Lezhës. Numri i mësuesve për 10 000 banorë në arsimin 9-vjeçar është 94, kurse në arsimin e mesëm është 28, pra më i lartë se mesatarja kombëtare e cila është 24. Mesatarisht, numri i nxënësve për çdo mësues është 17, kurse në arsimin e mesëm është 20 nxënës, numër i njëjtë me mesataren kombëtare. Përqindja e fëmijëve të moshës 15–19 vjeç që ndjekin shkollën e mesme në nivel qarku është 7401 fëmijë, rreth 52% e numrit total të fëmijëve në këtë grup moshë.

Figura 230 Shpërndarja institucioneve arsimore



Burimet natyrore

Figura 231 Harta e zonave të mbrojtura në qarkun e Lezhës



Propozimi i zonave funksionale në qarkun e Lezhës


Nisur nga analiza e mësipërme e shpërndarjes demografike, si dhe nga përqendrimi i shërbimeve socio-ekonomike, në qarkun e Lezhës identifikohen tri zona funksionale, të cilat përkohet me kufijtë përbërës të ndarjes administrative të rrethëve Lezhë, Kurbin dhe Mirditë. Qendra e qarkut, bashkia Lezhë, do vijojë të mbetet qendra kryesore urbane brenda qarkut, ku sigurohen shumica e shërbimeve, por rigrupimi i njësive do të mundësojë zhvillim më të madh të qendrave të tjera urbane në qark.

Tabela 116 Treguesit kryesorë për bashkimin e NJQV-ve në qarkun e Lezhës

Zona funksionale	NJQV-të e nivelit të parë		Popullsia mesatare (banorë/NJQV)		Dendësia mesatare (banorë/km ²)	
	Para	Pas	Para	Pas	Para (min–maks.)	Pas
Mirditë	7	1	3158	22 103	10–0	24
Lezhë	10	1	6563	65 633	59–2864	159
Kurbin	4	1	11 573	46 291	7-750	133
Totali në qark	21	3	6382	44 676	7–2864	79

Burimi: INSTAT, Census 2011; llogaritjet e autorëve


Figura 232 Harta e zonave funksionale të propozuara për qarkun e Lezhës



Zona funksionale Lezhë

Zona funksionale Lezhë përfshin 10 njësi administrative. Qendra urbane e kësaj zone është qyteti i Lezhës dhe komunat Shënkoll, Shëngjin, Balldren, Blinisht, Dajç, Ungrej, Kolç dhe Zejmen janë pjesë e kësaj zone funksionale.

Figura 233 Shtrirja e zonës funksionale Lezhë



Këto zona njësi administrative ndodhen në distancë të favorshme që mundëson akses të lehtë në qendrën urbane të propozuar të kësaj zone funksionale. Me përjashtim të komunës Ungrej, e cila gjendet rreth 20 km larg dhe e cila ka edhe kohën më të gjatë të udhëtimit (82 minuta), të gjitha komunat e tjera, të ndihmuara dhe nga infrastruktura rrugore, mund të arrijnë në qendrën e zonës funksionale për 10-20 minuta.

Tabela 117 Shpërndarja e popullsisë sipas njësive të qeverisjes vendore në ZF Lezhë

Njësiti përbërëse	Popullsia Census 2011	Popullsia Regjistri Civil 2013	Sip. km ²	Dendësia banorë për km ²	Distanca nga qendra e ZF- së (km)	Koha e udhëtimit në qendrën e ZF-së (min.)
Ungrej	1587	3114	118	13	20	82
Blinisht	3361	5456	48	70	10	16
Dajç	3834	7022	35	109	15	18
Kallmet	4118	6992	38	107	6	13
Kolsh	4228	6848	45	94	2	10
Zejmen	5660	9225	35	163	8	13
Balldren i Ri	6142	10 134	77	79	5	10
Shëngjin	8091	11 826	56	145	7	9
Shënkoll	13 102	16 300	40	326	10	14
Lezhë (B)	15 510	29 176	5	3102	-	-
ZF Lezhë	65 633	106 093	495	133		

Burimi: Censusi 2011, Ministria e Brendshme (RGJC 2013), Google maps, përlogaritjet e autorëve


Për sa i përket demografisë në këtë zonë funksionale, sipas të dhënave të Census-it të vitit 2011 popullsia rezidente e saj është 65 633 banorë. Ndërkohë, të dhënat zyrtare të Regjistrit të Gjendjes Civile të vitit 2013 flasin për numër popullsie të regjistruar rreth 62% më të lartë, me përqendrim të ngjashëm të njësive të qeverisjes vendore të raportuara nga Census-i 2011.

Bazuar në të dhënat e Census-it të vitit 2011, në bashkinë e Lezhës niveli i urbanizimit është tepër i lartë. Dendësia në zonën e re funksionale do të jetë 133 banorë/km², duke ulur kështu diferencimin tejet të lartë të dendësisë (asaj minimale dhe maksimale) të popullsisë ndërmjet zonave rurale të kësaj njësie. Aktualisht, vetëm katër njësi vendore (Zejmen, Shënkoll, Shëngjin dhe Lezhë) gjenden mbi mesataren e zonës funksionale.

Ndikimi i njësisë së re në ndërveprimin institucional në zonën funksionale Lezhë

Aktualisht, në 10 njësitë vendore të kësaj zone funksionale, janë të punësuar 365 punonjës sipas figurës 13. Struktura organizative në këto njësi administrative parashikon funksione drejtuese, funksione mbështetëse, si dhe funksione në përmbushje të shërbimeve të deleguara. Duke qenë se njësia e re funksionale do të synojë menaxhimin sa më efikas të burimeve financiare, pozicionet e dublikuara të funksioneve drejtuese dhe atyre mbështetëse do të shkurtohen dhe do të mbulohen nga stafi në qendrën e kësaj zone funksionale. Aktualisht, ngarkesa e administratës vendore për 1000 banorë është 5,5 (ku më e ulëta është 2,2 në komunën Shënkoll dhe më e larta 10,6 në komunën Shëngjin).

Figura 234 Ngarkesa e administratës në ZF Lezhë



Nisur nga supozimi se shpenzimet e personelit do të shkurtohen me 60%, numri i ri i punonjësve në njësinë e re funksionale parashikohet të jetë 185 punonjës, me një ngarkesë rreth 2,8 punonjës për 1000 banorë. Administrata e mbetur zë rreth 30-40% të administratës aktuale. Funkzionet e NJQV-ve të Shëngjinit, Kolshit, Shënkollit, Zejmenit, Balldrenit, Kallmetit, Dajçit, Blinishtit, dhe Ungrejit do ofrohen në mënyrë qendrore nga qendra e ZF-së. Funkzionet e shkurtuara përbëjnë rreth 60-70% të organikës aktuale të këtyre njësive.

Tabela 118 Punësimi dhe shpenzimet në NjQV-të e ZF-së Lezhë

	Nr. i punonjësve në NjQV	Ngarkesa e administratës për 1000 banorë	Shpenzime në 000/lekë	
			Shpenzime për personelin	Shpenzime operative
Balldren i Ri	34	5,5	16 000	5000
Blinisht	13	3,9	8000	7000
Dajç	14	3,7	10 000	9000
Kallmet	21	5,1	19 000	13 000
Kolsh	23	5,4	8000	3000
Lezhë	108	7	86 000	83 000
Shëngjin	86	10,6	53 000	44 000
Shënkoll	29	2,2	19 000	11 000
Ungrej	13	8,2	6000	5000
Zejmen	22	3,9	15 000	6000
Gjithsej	363	5,5	240 000	186 000
ZF Lezhë*	185	2,8	132 200	175 700

Burimi: Census 2011, Ministria e Financave, përlloraritjet e autorëve

* Pas reduktimit të shpenzimeve administrative

Gjithsesi, ky qendërzim i funksioneve të dublikuara në njësinë e re funksionale nuk do të prekë pozicionet në përmbushje të funksioneve të deleguara, të tilla si gjendja civile, shpërndarja e ndihmës ekonomike, mbledhja e taksave, mirëmbajtja, etj.

Tabela 119 Të dhënat financiare për NJQV-të dhe për ZF-në Lezhë pas bashkimit

(000) leke


	Popullsia (Census 2011)	Të ardhurat e veta	Të ardhurat e veta për frymë	Shpenzimet gjithsej	Shpenzimet për personelin	Shpenzimet operative	Investimet	Shpenzimet për personelin për frymë	Shpenzimet operative për frymë	Investimet për frymë
Ballëdren	6142	20 009	3,3	38 000	16 000	5000	17 000	2,6	0,8	2,8
Blinisht	3361	5793	1,7	21 000	8000	7000	6000	2,4	2,1	1,8
Dajç	3834	5018	1,3	27 000	10 000	9000	8000	2,6	2,3	2,1
Kallmet	4118	10 622	2,6	44 000	19 000	13 000	12 000	4,6	3,2	2,9
Kolsh	4228	5622	1,3	17 000	8000	3000	6000	1,9	0,7	1,4
Lezhë	15 510	99 885	6,4	242 000	86 000	83 000	72 000	5,5	5,4	4,6
Shëngjin	8091	59 116	7,3	125 000	53 000	44 000	28 000	6,6	5,4	3,5
Shënkoll	13 102	12 655	1,0	44 000	19 000	11 000	14 000	1,5	0,8	1,1
Ungrej	1587	833	0,5	11 000	6000	5000	-	3,8	3,2	-
Zejmen	5660	7508	1,3	39 000	15 000	6000	18 000	2,7	1,1	3,2
Gjithsej NJQV/Mesatare	6563	227 061	2,7	608 000	240 000	186 000	181 000	3,7	2,8	2,8
ZF Lezhë*	65 633	227 061	3,5	608 000	132 200	175 700	299 100	2,0	2,7	4,6

*Reduktimi për shkak të rritjes së efikasitetit është llogaritur në masën 70% të shpenzimeve për personelin dhe 10% të shpenzimeve operative të njësisë që suprimohen

Burimi: Ministria e Financave (2012), Census 2011, përllogaritjet e autorëve

Riorganizimi i funksioneve dhe administratës vetëm në këtë zonë funksionale ndikon në reduktimin e shpenzimeve totale për personelin në masën 25% të shpenzimeve të përgjithshme ose 118 milionë lekë, të cilat mund të përdoren për investime të reja në këtë zonë, me qëllim zhvillimin e balancuar dhe harmonik të të gjithë zonës. Reduktimi i këtyre shpenzimeve në sajë të miradministrimit të burimeve në organizimin e ri territorial do të sjellë shtim të investimeve totale në të dhjeta NJQV-të nga 181 milionë lekë në 299 milionë lekë ose në masën 65%.

Figura 6 Sasia e shpenzimeve në ZF Lezhë para dhe pas bashkimit (2012)



Burimi: Ministria e Financave, përllogaritjet e autorëve

Ndikimi i njësisë së re në ndërveprimin ekonomik në zonën funksionale Lezhë

Sipas të dhënave të Instat-it, numri i ndërmarrjeve aktive që ushtrojnë aktivitetin e tyre në zonën funksionale të Lezhës është 1696 biznese, të cilat janë të shpërndara sipas NJQV-ve si më poshtë. Rreth 80% e bizneseve janë vendosur në tri NJQV.


Tabela 120 Shpërndarja e ndërmarrjeve aktive sipas NjQV-ve

Komuna/Bashki	Bujqësia e Peshkimi	Industria	Ndërtimi	Tregtia	Shërbime	Gjithsej	Biznese për 1000 banorë
Balldreni i Ri		8		42	27	81	13
Blinisht	4			19	11	37	11
Dajç		6		23	13	44	11
Kallmet		9		18	12	42	10
Kolsh		4		15	15	37	9
Lezhë	6	93	54	394	414	961	62
Shëngjin	35	19	9	97	116	276	34
Shënkoll	6	17	4	47	51	125	10
Ungrej					9	9	6
Zejmen		18	4	32	30	84	15
ZF Lezhë	55	177	79	687	698	1696	26

Burimi: Instat (2012), Census-i 2011

Numri më i lartë i bizneseve për 1000 banorë vërehet në Lezhë (62) dhe Shëngjin (43) dhe më i ulëti në Ungrenj (6) dhe Kolsh (9). Me rishpërndarjen e re administrative, mesatarja e bizneseve për 1000 banorë në ZF Lezhë është 26 ndërmarrje.

Figura 235 Harta e ndërveprimit ekonomik në zonën funksionale Lezhë



Në këto NJQV, të ardhurat nga biznesi i vogël janë në nivel minimal. Me përjashtim të bashkisë Lezhë dhe komunës Shënkoll ku të ardhurat nga biznesi i vogël janë 25% dhe 23% e totalit të të ardhurave të veta të NJQV-së, si dhe me përjashtim të komunës Shëngjin ku të ardhurat nga biznesi i vogël janë 15%, në të gjitha komunat e tjera pesha e kësaj takse është më e vogël se 8%. Nëse do të merret në konsideratë sasia e të ardhurave nga bizneset në totalin e të ardhurave të ZF-së Lezhë, kjo sasi është 0,15%. Ky nivel i ulët i të ardhurave nga bizneset do të kërkojë nga ZF nga njëra anë përmirësimin e shërbimeve kundrejt tyre dhe nga ana tjetër përmirësim në mbledhjen e të ardhurave.

Figura 236 Të punësuarit sipas sektorëve/aktiviteteve ekonomike në ZF-në e Lezhës (%)

NJQV	Bujqësi, pyje dhe peshkim	Tregti shumicë & pakicë	Ndërtimi	Industria	Shërbimet	E papërcaktuar
Balldreni i Ri	28,6	8,6	15,4	10,2	28,2	9,0
Blinisht	46,7	3,4	11,2	5,0	21,0	12,8
Dajç	43,6	7,1	11,0	6,7	26,0	5,5
Kallmet	10,1	8,2	20,4	13,7	29,1	18,5
Kolsh	19,7	11,2	14,2	14,4	37,4	3,2
Lezhë	2,3	18,0	7,9	13,8	56,5	1,5
Shëngjin	10,5	16,0	9,8	10,4	51,8	1,5
Shënkoll	10,1	10,7	19,0	10,8	42,2	7,1
Ungrej	80,4	0,3	0,3	1,0	13,6	4,2
Zejmen	15,9	11,2	12,2	17,6	37,7	5,5

Burimi: Instat

Shpërndarja e bizneseve të NJQV-të lidhet ngushtë jo vetëm me aksesin e banorëve të këtyre zonave në të mira dhe shërbime, por edhe aksesin e tyre në punësim. Sipas të dhënave të Instat-it, ndërveprimi i të punësuarve që udhëtojnë jashtë qendrës së banimit është relativisht i lartë kur shkojmë drejt qendrës urbane, në të cilën ndodhet dhe numri më i madh i bizneseve.

Ndikimi i njësisë së re në ofrimin e shërbimeve në zonën funksionale Lezhë


Zona e re funksionale gjendet në një pozicion shumë të favorshëm dhe përshkohet nga një rrjet i gjerë rrugësh. Në vijim të investimeve të kryera në këto vite, pjesa më e madhe e rrugëve rajonale dhe komunale janë përmirësuar, duke ndikuar ndjeshëm dhe në kohën e udhëtimit nga njësitë administrative në qendrën e ZF-së.

Tabela 121 Rrjeti i infrastrukturës rrugore në ZF Lezhë

NJQV	Rrugë nacionale (km)	Rrugë rajonale (km)	Rrugë komunale (km)	Koha e udhëtimit në qendrën e ZF-së (min.)
Ungrej			48	82
Blinisht		12	32	16
Dajç	7,2	5	26	18
Kallmet	15,95	39	24	13
Kolç			11	10
Zejmen	5		25	13
Balldreni i Ri	53,3	2	41,5	10
Shëngjin	23,4	2	45	9
Shënkoll	25,6	20	30	14
Lezhë (B)				-
Total	130,45	80	282,5	

Burimi: Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës


Figura 237 Harta e rrjetit të infrastrukturës rrugore në ZF Lezhë



Siç vihet re, % më e lartë e rrugëve janë në varësi të NJQV-ve, të cilat janë përgjegjëse për mirëmbajtjen e tyre. Eksperienca e deritanishme ka treguar që shumë NJQV nuk kanë fonde të mjaftueshme për këtë funksion. Nga ana tjetër, fragmentarizmi i kësaj të mire publike ndërmjet disa NJQV-ve e bën shpeshherë të pamundur bashkëpunimin për të bërë investime apo për të mirëmbajtur rrugën në të gjithë gjatësinë e saj.

Transporti publik vendor është një nga shërbimet e decentralizuara që has vështirësi të mëdha. Qarku është përgjegjës për përkufizimin e planit të lëvizjes, bashkitë dhe komunat kanë kompetencën administrative të licencimit. Me krijimin e zonës së re funksionale, mundësohet dhe rregullimi i linjave të transportit brenda njësisë së re, duke anashkaluar problemin aktual të kufizimit të territorit të licencimit. Nisur dhe nga rrjeti rrugor dhe koha e shkurtër e udhëtimit në qendrën e ZF-së, licencimi i ofruesve të këtij shërbimi për një territor më të madh do të sjellë një shërbim të plotë, me kosto të optimizuara dhe cilësi më të lartë për banorët e kësaj ZF-je.


Figura 238 Harta e distancave kohore në ZF Lezhë



Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizime

Në ZF-në e Lezhës shërbimet e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimit të ujërave të ndotura ofrohen nga shoqëria SHA UK Lezhë. Aksionet e kësaj shoqërie janë të shpërndara në tre NJQV, në bashkinë Lezhë (55%), komunën Shëngjin (22,8%) dhe komunës Ballëdren (22,2%), duke nënkuptuar dhe zonat e shërbimit dhe mbulimit të këtij shërbimi. Në këtë shërbim ka akses rreth 45% e popullsisë së ZF-së, ndërkohë që 35% të popullsisë banuese në komunat Dajç, Blinisht, Kallmet, Kolç, Zejmen, Shënkoll dhe Ungrej nuk iu mundësohet ky shërbim.

Figura 239 Harta e mbulimit me shërbimin e ujësjellës kanalizimeve



Sipas raportit të performancës së ERRU (2012), duke u nisur nga numri i lidhjeve të furnizimit me ujë të pijshëm dhe madhësia e zonës ku ofrohet shërbimi, SHA UK Lezhë bën pjesë në grupin e dytë të shoqërive të ujësjellës kanalizimeve. Në këtë grup ajo renditet në vendin e tretë.

Tabela 122 Të dhënat kryesore të shoqërisë SHA UK Lezhë

	Nr. i klientëve (ujësjellës)	Nr. i klientëve (uji i ndotur)	Punonjës	Prodhi mi m ³	Faturimi mi m ³	Totali i faturimit UK (000/lek)	Të ardhura të tjera	Totali i arkëtimit UK (000/lek)	Kosto O&M UK	Kostoja totale UK
Lezhë	7089	7088	81	2267	1147	82 074	4197	67 550	103 833	130 479

Burimi: ERRU, Raporti i Performancës së Sektorit të Ujit 2012

Situata financiare e shoqërisë nxjerr në pah edhe aftësitë e saj për të mbuluar kostot bazë të saj me anë të të ardhurave nga burimet e veta. Megjithëse gjatë vitit 2012, SHA UK Lezhë ka përmirësuar kostot O&M me 18,5%, aktualisht SHA UK Lezhë nuk arrin t'i mbulojë kostot e drejtpërdrejta O&M (kostot për personelin, kimikatet, energjinë dhe kosto të tjera) nga të ardhurat e realizuara. Kostoja për personelin zë një përqindje të madhe të kostove të O&M të shoqërive të ujësjellës kanalizime (mesatarisht 31% të kostove totale të shoqërive).

Në mënyrë të përmbledhur, treguesit për këtë shoqëri gjatë vitit 2012 janë kohëzgjatja e furnizimit me ujë të vazhdueshëm rreth 20 orë në ditë, ndërkohë që shoqëria paraqet përsëritje të pikave të ndotura. Për këtë nevojitet forcimi i Drejtorisë Rajonale të Institutit të Shëndetit Publik për sa i përket kontrollit të cilësisë së ujit të pijshëm. Shërbimi i trajtimit të ujërave të ndotura parashikon edhe trajtimin e tyre, i cili në ZF-në e Lezhës do të mundësohet nga impianti i ri i trajtimit të ujërave të ndotura për zonat Lezhë-Shëngjin. Cilësia e shërbimit ndaj

konsumatorëve (kohëzgjatja e furnizimit me ujë dhe cilësia e ujit të pijshëm) janë tregues që lidhen me rritjen e shumës totale të arkëtimit, e cila aktualisht është në masën 82%.

Aktualisht, rrjeti ekzistues është drejt rehabilitimit si rezultat edhe i mbështetjes së donatorëve, ndërkohë që kostot shtesë për zgjerimin e tij në zonat e tjera të ZF-së do të kërkojnë mbulimin e tyre me anë të tarifave. Mbulimi total i kostove mund të shkaktojë shqetësim të konsumatorët, dhe sidomos të grupet në nevojë. Prandaj, nevojiten mekanizma të përshtatshëm subvencionimi për të mbrojtur konsumatorët në nevojë dhe njëkohësisht funksionimi i këtyre sistemeve në mënyrë të qëndrueshme. Kjo merr një vlerë më domethënëse kur ekonomia e shkallës merret parasysh duke mundësuar efikasitetin e menaxhimit të shoqërive, investimeve të mëtejshme në zgjerimin e shërbimeve dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit. Këta duhet të jenë tregues dhe në rregullimin e tarifave në të ardhmen.

Shërbimi i largimit të mbetjeve dhe pastrimit

Aktiviteti i menaxhimit të mbetjeve (grumbullimi, transporti, trajtimi dhe asgjësimi) është një praktikë dhe funksion që ushtrohet plotësisht, sidomos në qendrën e propozuar të ZF-së Lezhë. Bashkia e Lezhës (80%) dhe komunat Shëngjin (85%), Zejmen (70%), Shënkoll (70%), Balldren i Ri (70%), Kolç (50%) dhe Kallmet (50%) e kanë të organizuar grumbullimin dhe transportin e mbetjeve urbane, nëpërmjet ndërmarrjeve të shërbimit në komuna ose nëpërmjet kompanive private. Bashkia Lezhë ka filluar t'i grumbullojë dhe depozitojë mbetjet të ndara në dy kategori. Popullsia banuese në komunat Dajç, Ungrej dhe Blinisht nuk mbulohet nga ky shërbim dhe në to zbatohet kryesisht kompostimi individual. Në zonat rurale, ku shërbimi i grumbullimit të mbetjeve nuk ofrohet, ato shkarkohen në kanale, lugina ose në anë të rrugës e së fundmi edhe në lumenj.

NjQV-të që e mundësojnë këtë shërbim kanë përcaktuar dhe rrjetin e pikave për grumbullimin e mbetjeve. Sistemi aktual i pikave të grumbullimit të mbetjeve në të gjitha NJQV-të është i standardizuar dhe i përbashkët për banorët edhe subjektet private. Në bashkinë Lezhë po zbatohet sistemi i grumbullimit të mbledhjeve urbane në mënyrë të diferencuar (një kazan për grumbullimin e mbetjeve të riciklueshme dhe tjetri për mbetjet organike) dhe transportimi i diferencuar në QNMR (Qendra për Ndarjen e Mbetjeve të Riciklueshme), ku bëhet ndarja e mëtejshme në mbetjet letre/kartoni dhe mbetje plastike, si dhe përgatitja e tyre për tregun riciklues. Pjesa tjetër e mbetjeve mbledhen, transportohen dhe asgjësohen në vend depozitimitin e Bushatit.

Asgjësimi i mbetjeve urbane bëhet kryesisht në vend depozitimitin e Bushatit (bashkia Lezhë dhe komunat Balldren e Shëngjin). Ndërkohë që në mjaft raste, mbetjet e komunave Shënkoll, Zejmen dhe Milot depozitohen në vend depozitimitin e Berzantit, në komunën Zejmen. Megjithatë në ditët e sotme është jashtë funksionit, këtu vazhdojnë të depozitohen mbetje. Ky vend depozitim është ngritur në afërsi të deltës së lumit Mat dhe filtrimi i ujërave të shiut dhe i atyre nëntokësore përbëjnë problem serioz për ndotjen e këtij lumi. Një pjesë e mbetjeve urbane, përfshi ato inerte nga ndërtimet dhe prishjet, hidhen përgjatë lumit Drin ose në liqenin e Knallës.

Bashkia e Lezhës ofron shërbimin e largimit të mbetjeve me dy kategori për 13 460 familje ose për 46% të familjeve të qytetit, 1044 biznese dhe 50 institucione. Lezha është e plotësuar me numrin e nevojshëm të kazanëve, si rezultat i zbatimit të projektit holandez në vitin 2011. Bashkia Lezhë mbetet kontribuuesi kryesor edhe në gjenerimin e mbetjeve komerciale, me rreth 52% të totalit të qarkut

Të dhënat financiare tregojnë se buxheti për pastrimin dhe largimin e mbetjeve varion mesatarisht nga 8-12 % të buxhetit total. Pas vitit 2011, bashkia e Lezhës e ka rritur me rreth 60% buxhetin e pastrimit, si rezultat kjo i zgjerimit të zonës së mbulimit dhe i zonës C të qytetit (vendbanimet informale). Të ardhurat e siguruar nga tarifa e shërbimit mbulojnë afërsisht 34% të kostos operative të shërbimit. Kjo tarifë është një shumë fikse vjetore për çdo familje, e cila nuk reflekton madhësinë e familjes apo sasinë e mbetjeve të prodhuara.

Tabela 123 Të ardhurat e bashkisë Lezhë nga shërbimi i largimit të mbetjeve (2012)

	Faturuar (000/lek)	Arkëtuar (000/lek)	% e mbledhur
Familje	10 500	1683	16%
Biznesi i vogël	3717	3259	88%
Biznesi i madh	5350	5495	103%
Institucione	100	66	66%
Total	19 667	10 503	53%

Burimi: Plani i Menaxhimit të Mbetjeve për qarkun Lezhë 2013 (Projekti SELEA)

Niveli i arkëtimit vetëm në bashkinë Lezhë është 53% e shërbimit të faturuar. Kontribuesi kryesor në këtë shërbim mbetet biznesi i madh. Kjo i detyron NjQV-të që për të mbuluar këtë shërbim të përdorin çdo vit nga 1 500 000-20 000 000 lekë nga të ardhurat e tjera. Riorganizimi i njësive aktuale në një zonë funksionale do të mundësojë zgjerimin e këtij shërbimi dhe i praktikave të mira të bashkisë Lezhë edhe në zonat pranë saj.

Shëndetësia

Shërbimi shëndetësor në ZF do të vazhdojë të mundësohet nga shërbimi shëndetësor parësor dhe ai spitalor. Spitali rajonal, i cili ndodhet në qendrën e ZF-së Lezhë, ofron shërbime të kujdesit shëndetësor në patologji, obstetri-gjinekologji, kirurgji, infektiv, pediatri, reaminacion, radiologji dhe shërbime laboratorike. Numri i punonjësve në shërbimin shëndetësor është 35 mjekë specialistë, 104 infermierë, 17 staf mjekësor (laborantë, farmacistë) dhe 100 punonjës personel ndihmës dhe administratë. Aktualisht, ky spital ka një kapacitet prej 162 shtretëri ose 55 shtretër për 10 000 banorë. Numri i pacientëve të shtruar gjatë vitit 2013 ishte 7031, prej të cilëve 27% ishin prej zonave të tjera të qarkut të Lezhës.


Tabela 124 Institucionet shëndetësore në qarkun Lezhë

Rrethi	Spital	Maternitet	Qendra shëndetësore	Ambulanca	Konsultore
Lezhë	1	1	10	54	1

Arsimi

Në ZF Lezhë, infrastruktura për arsimimin përbëhet nga 45 kopshte, 56 shkolla 9-vjeçare dhe 12 shkolla të mesme. Në qendrën e ZF-së ndodhet edhe shkolla e vetme profesionale “Kolin Gjoka”. Arsimi parashkollor mungon vetëm në komunën Ungrej, arsimi 9-vjeçar është funksional në të gjithë njësitë e qarkut, kurse ai i mesëm mungon vetëm në komunën Kolç.

Figura 240 Shpërndarja dhe gjendja e objekteve arsimore në ZF Lezhë




Numri i fëmijëve që ndjekin arsimin parashkollor në ZF-në e Lezhës është 1855 fëmijë. Në vitin akademik 2010-2011 raporti fëmijë/edukatore ishte 19 fëmijë për një edukatore, i njëjtë me raportin në nivel kombëtar. Numri i fëmijëve që ndjekin arsimin në ZF-në e Lezhës është si në figurën e mëposhtme.

Tabela 125 Niveli i frekuentimit të arsimit në ZF Lezhë

Arsimi	Nxënës të regjistruar	Mësues gjithsej	Mësues për nxënës	Mësues për 10 000
Arsimi 9-vjecar	9998	542	18	8
Arsimi i mesëm	3667	181	20	2

Burimi: Ministria e Arsimit dhe Sportit, Census 2011, përlogaritjet e autorëve

Figura 241 Strukturat që ofrojnë shërbimin e arsimit në ZF Lezhë para dhe pas bashkimit



Burimi: Ministria e Arsimit dhe Sportit, Census 2011, përlogaritjet e autorëve

Përfundime

Dendësia në zonën e re funksionale do të jetë 133 banorë/km², duke ulur kështu diferencimin tejet të lartë të dendësisë (asaj minimale dhe maksimale) të popullsisë ndërmjet zonave rurale të kësaj njësie

Zona Ungrej, ku vërehet shpërndarja më e madhe e popullsisë dhe ka kohën më të gjatë të udhëtimit për në qendrën e zonës funksionale, do të kërkojë mobilizim të burimeve për të përmirësuar aksesin e kësaj popullsie në shërbime;

Ngarkesa mesatare e administratës vendore për 1000 banorë do të ulet nga 5,5 që është aktualisht në 2,8 punonjës për 1000 banorë;

Reduktim të shpenzimeve administrative me 118 milionë lekë (shpenzimet për personelin dhe ato operative) dhe ulje e këtyre shpenzimeve për frymë në masën 28% nga 6,5 mijë lekë në 5 mijë lekë në njësinë e re vendore;

Miradministrimi i burimeve do të sjellë shtim në masën 65% të fondit total të investimeve në të dhjeta NJQV-të, nga 181 milion lekë në 299 milionë lekë;

Buxheti i investimeve për frymë do të rritet nga 2,6 mijë lekë në 4,6 mijë lekë;

Rishpërndarje e numrit të bizneseve në 26 ndërmarrje aktive për 1000 banorë në ZF-në Lezhë, duke eliminuar diferencimin tejet të lartë të bizneseve në bashkinë Lezhë dhe zonave përreth saj

Zona funksionale e Mirditës

Zona funksionale e Mirditës përfshin 7 njësi administrative. Qyteti i Rrëshenit është qendra urbane e kësaj zone, kurse bashkia Rubik dhe komunat Selitë, Orosh, Kthellë, Kaçinar dhe Fan janë pjesë e kësaj zone funksionale.

Figura 242 Shtrirja e zonës funksionale Mirditë




Tabela 126 Shpërndarja e popullsisë sipas njësive të qeverisjes vendore në ZF Mirditë

Njësitë përbërëse	Popullsia Census 2011	Popullsia Regjistri Civil 2013	Sip km^2	Dendësia banorë për qendra e ZF në km^2	Distanca nga Koha e udhëtimit (km)	Distanca nga Koha e udhëtimit (min)
Selitë	745	2070	106	7	8.5	13
Kaçinar	1016	2116	107	10	26	58
Orosh	1899	3240	148	13	23	20
Kthellë	209	3103	88	25	13	16
Fan	2977	4735	177	17	22	23
Rubik	4454	7960	129	35	13	13
Rrëshen	8803	14156	154	57	-	-
ZF Mirditë	22 103	37 380	909	24		


Burimi: Instat, Google maps

Këto zona njësi administrative ndodhen në distancë të favorshme, e cila mundëson akses të lehtë në qendrën urbane të propozuar të kësaj zone funksionale. Me përjashtim të komunës Kacinar, e cila gjendet 26 km larg dhe e cila ka dhe kohën më të gjatë të udhëtimit (58

minuta), të gjitha komunat e tjera, të ndihmuara dhe nga infrastruktura rrugore, mund të arrijnë në qendrën e zonës funksionale për 15-25 minuta.

Për sa i përket demografisë në këtë zonë funksionale, sipas të dhënave të Censurit të vitit 2011, popullsia rezidente e saj është 22 103 banorë . Ndërkohë të dhënat zyrtare të Regjistrit të Gjendjes Civile të vitit 2013 flasin për numër popullsie të regjistruar rreth 41% më të lartë.

Figura 243 Dendësia e popullsisë për banor për km² në ZF Mirditë para dhe pas bashkimit



Burimi: Instat, përlloraritjet e autorëve

Bazuar në të dhënat e Censurit të vitit 2011, niveli i urbanizimit në këtë ZF është në nivele të njëjta dhe nuk vërehen diferencime të theksuara ndërmjet njësive përbërëse. Dendësia në zonën e re funksionale do të jetë 24 banorë/km². Ndërkohë, zona e re funksionale bën të mundur ruajtjen e kulturës dhe traditës së kësaj zonë.

Ndikimi i njësisë së re në ndërveprimin institucional në zonën funksionale Mirditë

Numri i të punësuarve në administratën vendore është 217 punonjës, të cilët sipas strukturës organizative në këto njësi kryejnë funksione drejtuese, funksione mbështetëse, si dhe funksione në përmbushje të shërbimeve të deleguara. Duke qenë se njësia e re funksionale do të synojë menaxhimin sa më efikas të burimeve financiare, pozicionet e përsëritura të funksioneve drejtuese dhe atyre mbështetëse do të shkurtohen dhe do të mbulohen nga stafi në qendrën e kësaj zone funksionale. Aktualisht, ngarkesa e administratës vendore për 1000 banorë është 9,8 (më e ulëta 6,7 në komunën Fan dhe më e larta 15 në Selitë).


Tabela 127 Ngarkesa e administratës dhe shpenzimet në NJQV-të e ZF-së Mirditë

	Nr. i punonjësve në NJQV	Ngarkesa e administratës për 1000 banorë	Shpenzime për personelin (000 lekë)	Shpenzime operative (000 lekë)
Fan	20	6,7	7000	3000
Kacinar	14	13,8	5000	3000
Kthelle	11	5,0	9000	7000
Orosh	19	10,0	12 000	4000
Rreshen	86	9,8	42 000	48 000
Rubik	56	12,6	26 000	13 000
Selite	11	14,8	7000	7000
Gjithsej	217	9,8	108 000	85 000
ZF Mirdite	125	5,7	61 800	81 300

Burimi: Ministria e Financave, llogaritjet e autorëve

Nisur nga supozimi se shpenzimet për personelin do të shkurtohen me 70%, numri i ri i punonjësve në njësinë e re funksionale parashikohet të jetë 125 punonjës, me një ngarkesë 5,7 punonjës për 1000 banorë. Administrata e mbetur zë rreth 30-40% të administratës aktuale. Funksionet e NJQV-ve të Selitë, Kacinar, Orosh, Fan, Kthellë, dhe Rubik do të ofrohen në mënyrë qendrore nga qendra e ZF-së. Funksionet e shkurtuara përbëjnë rreth 60-70% të organikës aktuale të këtyre njësive.

Figura 244 Ngarkesa e administratës për 1000 banorë në ZF të Mirditës




Burimi: Llogaritjet e autorëve

Gjithsesi, ky përqendrim i funksioneve të dublikuara në njësinë e re funksionale nuk do të prekë pozicionet në përmbushje të funksioneve të deleguara, të tilla si gjendja civile, shpërndarja e ndihmës ekonomike, mbledhja e taksave, mirëmbajtja, etj.

Tabela 128 Të dhënat financiare për NJQV-në dhe për ZF-në e Mirditës pas bashkimit


Njësia	Popullsia (Census 2011)	Të ardhurat e veta	Të ardhurat e veta për frymë	Shpenzi me gjithsej	Shpenzi me personeli	Shpenzi me operative	Investime	Shpenzi me personeli për frymë	Shpenzi me operative për frymë	Investime për frymë
Fan	2977	2138	0,7	18 000	7000	3000	8000	2,4	1,0	2,7
Kaçinar	2209	563	0,6	12 000	9000	7000	-	4,1	3,2	-
Kthellë	1016	212	0,1	16 000	5000	3000	4000	4,9	3,0	3,9
Orosh	1899	10 586	5,6	24 000	12 000	4000	8000	6,3	2,1	4,2
Rrëshen	8803	27 070	3,1	165 000	42 000	48 000	75 000	4,8	5,5	8,5
Rubik	4454	9751	2,2	64 000	26 000	13 000	25 000	5,8	2,9	5,6
Selitë	745	183	0,2	14 000	7000	7000	-	9,4	9,4	-
Gjithsej NJQV/Mesatare	(Mes) 15 429	50 504	1,8	313 000	108 000	85 000	120 000	4,9	3,8	5,4
ZF Mirditë gjithsej	22 103	50 504	2,3	313 000	61 800	81 300	169 900	2,8	3,7	7,7

Figura 245 Investimet për frymë në ZF Mirditë



Riorganizimi i funksioneve dhe administratës në ZF Mirditë sjell reduktimin e shpenzimeve totale të personelit në masën 40% ose 50 milionë lekë, të cilat mund të përdoren për investime në këtë zonë. Gjatë vitit 2012 niveli i investimeve për dy njësi vendore ka qenë 0 lekë, ndërkohë që në Kthellë ka qenë në nivele shumë të ulëta. Reduktimi i këtyre shpenzimeve në sajë të miradministrimit të burimeve në organizimin e ri territorial do të sjellë shtim të investimeve totale në të shtata njësitë administrative nga 120 milion lekë në 170 milionë lekë, ose në masën 42%.

Figura 246 Niveli i shpenzimeve në ZF Lezhë para dhe pas bashkimit (2012)



Burimi: Ministria e Financave (2012), Census 2011, përlogaritjet e veta

Ndikimi i njësisë së re në ndërveprimin ekonomik në zonën funksionale Mirditë


Numri i ndërmarrjeve aktive që ushtrojnë aktivitetin e tyre në zonën funksionale të Mirditës është 397 biznese, të shpërndara në shtatë NjQV. Rreth 71% e bizneseve janë të vendosura në qendrën e zonës së propozuar funksionale, në Rrëshen. Në strukturën e llojit të bizneseve, sektori i shërbimeve dominon 44% të bizneseve.

Tabela 129 Shpërndarja e ndërmarrjeve aktive sipas NjQV-ve

Komuna / Bashki	Bujqësia e Peshkimi	Industria	Ndërtimi	Tregtia	Shërbime	Gjithsej	Biznese për 1000 banorë
Rrëshen	*	28	21	116	116	281	32
Rubik		10	4	32	32	78	18
Selitë		2		*	*	2	3
Orosh	*	5		*	7	12	6
Kaçinar	*				6	6	6
Kthelle	*	*			4	4	2
Fan		5	*	*	9	14	5
ZF Mirditë	0	50	25	148	174	397	18


Burimi: Instat (2012), Censusi 2011

Figura 247 Harta e shpërndarjes së bizneseve në ZF-në e Mirditës



Numri më i lartë i bizneseve për 1000 banorë vërehet në Rrëshen (32) dhe Rubik (43) dhe më i ulëti në Kthellë (2). Me rishpërndarjen e re administrative, mesatarja e bizneseve për 1000 banorë në ZF Mirditë është 18 biznese.

Figura 248 Numri i bizneseve aktive për 1000 banorë në ZF Mirditë



Burimi: Instat (2012), Census-i 2011

Mbledhja e të ardhurave nga biznesi i vogël është në nivele shumë të ndryshme në njësitë administrative të ZF-së Mirditë. Niveli më i lartë i të ardhurave nga biznesi i vogël në totalin e të ardhurave të veta vërehet në njësinë Orosh 53%, e ndjekur nga bashkia Rrëshen dhe njësia Kacinar (28%). Të ardhurat nga biznesi janë në nivelin 0 në Selishtë.


Nëse do të merret në konsideratë vëllimi i të ardhurave nga bizneset në totalin e të ardhurave të ZFsë së Mirditës, ai është 28%. Ky nivel i ulët i të ardhurave nga bizneset do të kërkojë nga ZF-ja nga njëra anë përmirësimin e shërbimeve kundrejt tyre, dhe nga ana tjetër përmirësim në mbledhjen e të ardhurave.

Tabela 130 Shpërndarja e të punësuarve sipas aktiviteteve ekonomike në ZF Mirditë (në %)

Njësia	Bujqësi, pyje dhe peshkim	Tregti me shumicë dhe pakicë	Ndërtim	Industri	Shërbime	E papërcaktuar
Fan	74,2	1,5	1,9	1,2	14,4	6,8
Kacinar	64,5	0,7	0,7	3,9	25,0	5,3
Kthjelle	71,1	1,3	1,6	2,7	15,4	8,0
Orosh	48,8	5,7	3,7	2,4	36,2	3,3
Rreshen	15,7	14,5	4,9	7,3	54,8	2,7
Rubik	33,0	8,3	4,0	9,7	42,4	2,6
Selite	72,4	1,7	1,7	1,1	21,8	1,1

Burimi: Instat

Figura 249 Harta e ndërveprimit ekonomik, Zf Mirditë



Ndikimi i njësisë së re në ofrimin e shërbimeve në zonën funksionale Mirditë

Transporti


Zona e re funksionale gjendet në një pozicion shumë të favorshëm dhe në një gjatësi të madhe të territorit të saj përshkohet nga Rruga e Kombit (116 km). Ky investim ka mundësuar dhe ka ulur ndjeshëm edhe kohën e udhëtimit nga njësitet administrative në qendrën e ZF. Rrjetin më të dendur të rrugëve e ka bashkia Rrëshen me 31%.

Tabela 131 Rrjeti rrugor në ZF Mirditë

	Rrugë nacionale (km)	Rrugë rajonale (km)	Rrugë komunale (km)	Koha e udhëtimit në qendrën e ZF-së (min)
Rrëshen	93,2	18	10,2	-
Rubik	22,8		12,7	13
Selitë		19	17,5	13
Orosh		35	3,3	20
Kaçinar		33	2,1	63
Kthellë		5	18,7	16
Fan		97	3,8	23
ZF Mirditë	116	207	68,3	


Burimi: Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës

Figura 250 Infrastruktura rrugore në ZF Mirditë



% më e madhe e rrugëve janë në varësi të NJQV-ve, të cilat janë përgjegjëse për mirëmbajtjen e tyre. Eksperienca e deritanishme ka treguar se shumë NQJV nuk kanë fonde të mjaftueshme për të kryer këtë funksion. Nga ana tjetër, ndarja e kësaj të mire publike ndërmjet disa NJQV-ve e bën shpeshherë të pamundur bashkëpunimin për të bërë investime apo për ta mirëmbajtur atë në të gjithë gjatësinë e saj.

Figura 251 Shpërndarja e rrjetit rrugor sipas njësive në ZF Mirditë



Burimi: Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës

Me formimin e zonës së re funksionale mundësohet edhe rregullimi i linjave të transportit publik brenda njësisë së re, duke anashkaluar problemin aktual të kufizimit të territorit të licencimit. Nisur nga rrjeti rrugor dhe koha e shkurtër e udhëtimit për në qendrën e ZF-së, licencimi i ofruesve të këtij shërbimi për një territor më të madh do të sjellë një shërbim të plotë, me kosto të optimizuara dhe cilësi më të lartë për banorët e kësaj ZF-je.

Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizime

Në ZF-në e Mirditës, shërbimet e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimit të ujërave të ndotura ofrohen nga dy shoqëri SHA UK Mirditë dhe SHA UK Rubik. Shoqëria SHA UK Rubik mbulon vetëm bashkinë e Rubikut, e cila zotëron edhe aksionet e plota të kësaj shoqërie.

Aksionet e shoqërisë SHA UK Mirditë janë të shpërndara midis tri NJQV-ve, bashkisë Rrëshen (79%), komunës Selitë (14%) dhe komunës Orosh (7%), duke nënkuptuar edhe zonat e shërbimit dhe mbulimit të këtij shërbimi. Në këtë shërbim ka akses rreth 41% e popullsisë së ZF-së, ndërkohë që pjesës tjetër të popullsisë banuese të njësive Kacinar, Kthellë dhe Fan nuk iu mundësohet ky shërbim.

Tabela 132 Shërbimi i UK në ZF Mirditë

Operatori	Aktiviteti	Nr i klientëve ujësjellës	Numri i klientëve (ujë i ndotur)	Nr i punonjësve
Mirditë	UK	1204	1038	27
Rubik	UK	498	478	14

Burimi: Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës

Shërbimi i largimit të mbetjeve dhe pastrimit

Aktiviteti i menaxhimit të mbetjeve ofrohet në përqindje shumë të vogël vetëm për bashkitë e Rrëshenit (50%) dhe Rubikut (42%). Të dyja këto qytete i depozitojnë mbetjet urbane në vend depozitimitin e Cekajt.

Përfundime

Dendësia e popullsisë në zonën e re funksionale do të jetë 24 banorë/km²;

Ngarkea mesatare e administratës vendore për 1000 banorë ulet nga 9,8 që është aktualisht në 6,5 punonjës për 1000 banorë;

Reduktim të shpenzimeve administrative me 50 milionë lekë (shpenzimet për personelin dhe shpenzimet operative) dhe ulje e këtyre shpenzimeve për frymë në masën 39% nga 8,7 mijë lekë në 6,5 mijë lekë në njësinë e re vendore;

Miradministrimi i burimeve do të shtojë në masën mbi 40% fondin për investimet totale në të shtata njësitë, në mënyrë specifike nga 120 milionë lekë në 170 milionë lekë;


Shpërndarje më të drejtë e investimeve për njësitë ndërmjet njësive administrative;

Buxheti i investimeve për frymë do të rritet nga 5,4 mijë lekë në 7,7 mijë lekë;

Zona funksionale Kurbin

Zona funksionale Kurbin përfshin katër njësi administrative. Qyteti i Laçit është qendra urbane e kësaj zone dhe pjesë të saj janë komunat Fushë-Kuqe, Milot dhe Mamurras.

Figura 252 Zona funksionale Kurbin



Të gjitha këto njësi administrative ndodhen në distancë tepër të favorshme, 10-15 minuta nga qendra e ZF-së, gjë që mundëson akses të lehtë në qendrën urbane të propozuar të kësaj zone funksionale.

Tabela 133 Shpërndarja e popullsisë sipas njësive të qeverisjes vendore në ZF Kurbin


Njësitë përbërëse	Popullsi Census 2011	Popullsia Regjistri Civil 2013	Sip km ²	Dendësia banorë për km ²	Distanca nga qendra e ZF (km)	Koha e udhëtimit qendrën e ZF-së (min)
Fushë-Kuqe	5460	8692	61	89	8,5	13
Milot	8461	11 909	143	59	6,5	10
Mamurras	15 284	22 787	72	213	8,5	12
Laç	17 086	29 426	14	1204	-	-
ZF Kurbin	46 291	72 814	291	159	-	-

Burimi: Instat, RGJC, Google maps

Përsa i përket demografisë në këtë zonë funksionale, sipas të dhënave të Censurit të vitit 2011, popullsia rezidente e saj është 46 291 banorë. Ndërkohë, të dhënat zyrtare të Regjistrit

të Gjendjes Civile të vitit 2013 tregojnë për numër popullsie të regjistruar rreth 36% më të lartë, me përqendrim të ngjashëm të njësive të qeverisjes vendore të raportuara nga Census-i, në vitin 2011.

Figura 253 Dendësia e popullsisë për banor për km² në ZF Kurbin para dhe pas bashkimit



Burimi: Instat, llogaritjet e autorëve

Sipas Census-it të vitit 2011, në bashkinë e Laçit niveli i urbanizimit është tepër i lartë, 1204 banorë për km². Dendësia në zonën e re funksionale do të jetë 159 banorë/km², duke ulur kështu diferencimin e popullsisë ndërmjet zonave të kësaj njësie. Vetëm komuna Mamurras e ka dendësinë e popullsisë mbi mesataren e zonës funksionale.

Ndikimi i njësisë së re në ndërveprimin institucional në zonën funksionale Kurbin

Aktualisht, në njësitë vendore të kësaj ZF-je janë punësuar 238 punonjës. Struktura organizative në këto njësi administrative parashikon funksione drejtuese, funksione mbështetëse, si dhe funksione në përmbushje të shërbimeve të deleguara. Duke qenë se njësia e re funksionale do të synojë menaxhimin sa më efikas të burimeve financiare, pozicionet e dublikuara të funksioneve drejtuese dhe atyre mbështetëse do të shkurtohen dhe do të mbulohen nga stafi në qendrën e ZF-së. Aktualisht, ngarkesa e administratës vendore për 1000 banorë është 13,6 (më e ulëta 3,8 në komunën Fushë Kuqe dhe më e larta 7,1 në Milot).

Nisur nga supozimi se shpenzimet e personelit do të shkurtohen me 70%, numri i ri i punonjësve në njësinë e re funksionale parashikohet të jetë 156 punonjës, me një ngarkesë 3,4 punonjës për 1000 banorë. Administrata e mbetur zë rreth 30-40% të administratës aktuale. Funksionet e NjQV-ve të Fushë Kuqes, Milotit dhe Mamurrasit do të ofrohen në mënyrë të përqendruar nga qendra ZF-ja e Laçit. Funksionet e shkurtuara si rezultat i zvogëlimit të administratës në këto tri njësi përbëjnë rreth 60-70% të organikës aktuale të këtyre njësive.

Tabela 134 Punësimi dhe shpenzimet në NjQV-të e ZF Kurbin

Njësia vendore	Nr. i punonjësve në NjQV	Ngarkesa e administratës për 1000 banorë	Shpenzime në 000 lekë	
			Shpenzime personeli	Shpenzime operative
Fushë Kuqe	21	3,8	7000	2000
Laç	121	7,1	47 000	88 000
Mamurras	59	3,9	29 000	33 000
Milot	37	4,4	13 000	5000
Gjithsej	238	5,1	96 000	128 000
ZF Kurbin	156	3,4	61 700	124 000

Burimi: Ministria e Financave, përllogaritjet e autorëve

Gjithsesi ky qendërzim i funksioneve të dublikuara në njësinë e re funksionale nuk do të prekë pozicionet në përbushje të funksioneve të deleguara, të tilla si gjendja civile, shpërndarja e ndihmës ekonomike, mbledhja e taksave, mirëmbajtja, etj.


Tabela 26: Të dhënat financiare për NjQV-të dhe për ZF të Kurbinit pas bashkimit

Njësia	Popullsia (Census 2011)	Të ardhu rat e veta	Të ardhu rat e veta për frymë	Shpenzi me gjithsej	Shpenzi me për persone lin	Shpenzi me operati ve	Investi me	Shpenzi me për persone lin për frymë	Shpenzi me operati ve për frymë	Investi me për frymë
Fushë Kuqe	5460	3797	0,7	16 000	7000	2000	7000	1,3	0,4	1,3
Laç	17 086	34 146	2,0	141 000	47 000	88 000	6000	2,8	5,2	0,4
Mamurras	15 284	20 158	1,3	81 000	29 000	33 000	19 000	1,9	2,2	1,2
Milot	8461	7468	0,9	32 000	13 000	5000	14 000	1,5	0,6	1,7
Gjithsej NjQV/Mesatare	(Mes.) 11 573	65 569	1,2	270 000	96 000	128 000	46 000	2,1	2,8	1,0
ZF Mirditë gjithsej	46 291	65 569	1,4	270 000	61 700	124 000	84 300	1,3	2,7	1,8

Burimi: Ministria e Financave (2012), Census 2011, përllogaritjet e autorëve

Riorganizimi i funksioneve dhe i administratës në këtë ZF rezulton në reduktim të shpenzimeve totale të personelit në masën 15% të të gjithë buxhetit ose 38 milionë lekë, të cilat mund të përdoren për investime të reja në këtë zonë, me qëllim arritjen e një zhvillimi më të balancuar. Reduktimi i këtyre shpenzimeve në sajë të miradministrimit të burimeve në organizimin e ri territorial do t'i rrisë investimet totale në të katra NjQV-të nga 46 milionë lekë në 84,3 milionë lekë, ose në masën 83%.

Figura 254 Niveli i shpenzimeve në ZF Kurbin para dhe pas bashkimit (2012)



Burimi: Ministria e Financave (2012), përlllogaritjet e autorëve

Ndikimi i njësisë së re në ndërveprimin ekonomik në zonën funksionale Kurbin

Sipas të dhënave të Instat-it, numri i ndërmarrjeve aktive që ushtrojnë aktivitetin e tyre në zonën funksionale të Kurbinut është 837 biznese, të cilat janë të shpërndara në të katër njësitë e kësaj zone. Në qytetin e Laçit gjendet numri më i lartë i bizneseve i cili përbën 60% të tyre.


Tabela 135 Shpërndarja e ndërmarrjeve aktive sipas njësive në ZF Kurbin

Komuna/ Bashki	Bujqësia e Peshkimi	Industria	Ndërtimi	Tregtia	Shërbime	Gjithsej	Biznese për 1000 banorë
Laç	*	55	27	212	211	505	30
Mamurras	*	21	10	87	57	175	11
Milot	*	16	8	41	38	103	12
Fushë Kuqe	11	7	3	18	15	54	10
ZF Kurbin	11	99	48	358	321	837	18

Burimi: Instat (2012), Censusi 2011


Numri më i lartë i bizneseve për 1000 banorë vërehet në Laç (30). Me rishpërndarjen e re administrative, mesatarja e bizneseve për 1000 banorë në ZF të Kurbinut është 18 ndërmarrje.

Figura 255 Numri i bizneseve aktive për 1000 banorë në ZF Kurbin



Burimi: Instat (2012), Census-i 2011

Figura 256 Harta e shpërndarjes dhe lloji i bizneseve në ZF Kurbin



Të ardhurat nga biznesi i vogël janë në nivel të ulët. Bashkia Mamurras ka nivelin më të lartë të të ardhurave nga biznesi i vogël me 29% të totalit të të ardhurave të veta. Niveli më i ulët shënohet në njësinë e Milotit ku të ardhurat nga biznesi përbëjnë vetëm 8% e totalit të të ardhurave të veta.

Nëse do të merret në konsideratë sasia e të ardhurave nga bizneset në totalin e të ardhurave të ZF-së Kurbin, ajo është 22 %. Ky nivel i ulët i të ardhurave nga bizneset do të kërkojë nga ZF nga njëra anë përmirësimin e shërbimeve kundrejt tyre, dhe nga ana tjetër përmirësim në mbledhjen e të ardhurave.

Figura 257 Harta e ndërveprimit ekonomik ZF Kurbin




Tabela 136 Shpërndarja e të punësuarve sipas aktivitetit ekonomik në ZF Kurbin (%)

Njësia	Bujqësi, pyje dhe peshkim	Tregti me shumicë dhe pakicë	Ndërtim	Industri	Shërbime	E papërcaktuar
Fushe Kuqe	32	9	12	15	29	4
Laç	6	22	5	15	48	4
Mamurras	24	16	9	11	36	4
Milot	18	12	11	14	42	5

Burimi: Instat

Ndikimi i njësisë së re në ofrimin e shërbimeve në zonën funksionale Kurbin

Transporti

Zona e re funksionale përshkohet nga një rrjet rrugor me gjatësi totale 172 25 km. Rrjetin më të dendur të rrugëve e ka njësia e Milotit, i cili përbën rreth 38% të të gjithë rrjetit rrugor.


Tabela 137 Rrjeti rrugor në ZF Kurbin

Njësia vendore	Rrugë nacionale (km)	Rrugë rajonale (km)	Rrugë komunale (km)	Koha e udhëtimit në qendrën e ZF-së (min)
Fushë-Kuqe		29	15	13
Milot		28	38,2	10
Mamurras			15,2	12
Laç	46,85			
ZF Kurbin	46,85	57	68,4	

Burimi: Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës

Në ZF Kurbin, rreth 73% e rrjetit të rrugëve është në varësi të njësive vendore. Eksperienca e deritanishme ka treguar që shumë NQJV nuk kanë fonde të mjaftueshme për këtë funksion, duke mos i mirëmbajtur apo duke mos bërë investime në to. Pamundësia për të bërë investime apo mirëmbajtur të gjithë rrjetin rrugor ndikohet dhe nga ndarja e kësaj të mire publike ndërmjet disa NJQV-ve.

Figura 258 Infrastruktura e transportit në ZF Kurbin



Me krijimin e zonës së re funksionale mundësohet edhe rregullimi i linjave të transportit publik brenda njësisë së re, duke anashkaluar problemin aktual të kufizimit të territorit të licencimit. Nisur edhe nga rrjeti rrugor dhe koha e shkurtër e udhëtimit për në qendrën e ZF-së, licencimi i ofruesve të këtij shërbimi për një territor më të madh do të sjellë një shërbim të plotë, me kosto të optimizuara dhe cilësi më të lartë për banorët e kësaj ZF-je.

Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizime

Në zonën funksionale të Kurbin ofrohet vetëm shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm, i cili mundësohet nga SH.U Kurbin. Njësitë aksionare në këtë shoqëri janë bashkia e Laçit (46%), bashkia e Mamurrasit (34%) dhe komuna e Milotit 20%. Komunës Fushë Kuqe nuk i ofrohet ky shërbim. Banorët e kësaj zone, të cilët janë zhvendosur këtu pas viteve '90, furnizohen me ujë nëpërmjet puseve dhe i largojnë ujërat e ndotura nëpërmjet gropave septike.

Tabela 30 Shërbimi i ujësjellësit në ZF Kurbin

Operatori	Aktiviteti	Nr i klientëve ujësjellës	Numri i klientëve (ujë i ndotur)	Nr. i punonjësve
Kurbin	U	5289	-	83

Burimi: Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës

Shërbimi i largimit të mbetjeve dhe pastrimit

Aktiviteti i menaxhimit të mbetjeve ofrohet dhe është i organizuar për bashkitë e Laçit (75%) dhe Mamurrasit (70%). Të dyja këto qytete i depozitojnë mbetjet urbane në vend depozitimin e Mamurrasit, rreth 7,5 km në jug-lindje të qytetit.

Përfundime

Dendësia e popullsisë në zonën e re funksionale do të jetë 159 banorë/km², duke ulur kështu diferencimin të lartë të dendësisë (asaj minimale dhe maksimale) të popullsisë ndërmjet zonave të kësaj njësie;

Ndërveprim më i shpeshtë ndërmjet njësive administrative, si rezultat i aksesit në ZF-në e Kurbin, mundësuar nga kohë të shkurtra udhëtimi;

Ulje e ngarkesës mesatare të administratës vendore për 1000 banorë nga 5,1 që është aktualisht në 3,4 punonjës për 1000 banorë;

Reduktim i shpenzimeve administrative me 38,3 milionë lekë (shpenzimet për personelin dhe shpenzimet operative) dhe ulje e këtyre shpenzimeve për frymë në masën 17% ,nga 4,8 mijë lekë në 4 mijë lekë në njësinë e re vendore;

Miradministrimi i burimeve do të sjellë rritje në masën 80% të fondit total të investimeve në të katra NjQV-të, nga 46 milion lekë në 83 milionë lekë;

Buxheti i investimeve për frymë do të rritet nga 1 mijë lekë në 1,8 mijë lekë

QARKU SHKODËR

Profili i qarkut Shkodër

Qarku i Shkodrës përbëhet nga 33 njësi të qeverisjes vendore në tre rrethe: rrethi i Shkodrës (17 njësi, qendër Shkodër), rrethi i Malësisë së Madhe (6 njësi, qendër Koplik) dhe rrethi i Pukës (10 njësi, qendër Pukë). Popullsia e qarkut të Shkodrës është 215 347 banorë në vitin 2011, ndër të cilët 77% (166 050 banorë) jetojnë në rrethin e Shkodrës dhe 36% në qytetin e Shkodrës. Dy njësitë e tjera më të mëdha pas bashkisë Shkodër janë komunat Rrethinat (21 199 banorë) dhe Bushat (14 000 banorë). Dy bashkitë e tjera qendër rrethi – Koplik dhe Pukë kanë popullsi mjaft të vogël (më pak së 4000 banorë), ndërkohë që bashkia e dytë më e madhe e zonës është Vau i Dejës, me mbi 8000 banorë. Qarku i Shkodrës ka pasur një humbje neto të popullsisë prej rreth 35% ose mbi 118 000 banorë krahasuar më të dhënat zyrtare të Regjistrimit të Gjendjes Civile të vitit 2011. Sipas të dhënave zyrtare të Regjistrimit të Gjendjes Civile në janar 2012 në qarkun e Shkodrës ishin të regjistruar 333 355 banorë me përqendrim të ngjashëm më atë të raportuar nga Census-i 2011.

Duke iu referuar të dhënave të Census-it 2011, popullsia e qarkut Shkodër përbën rreth 32,4% të popullsisë së vendit dhe popullsia mesatare për njësi të qeverisjes vendore në këtë qark rezulton 25 840 banorë/NJQV.

Dendësia mesatare e popullsisë është 147 banorë/km² krahasuar më 97,4 banorë/km² në rang vendi. Dendësinë më të madhe e ka natyrisht Shkodra me mbi 2400 banorë/km², por dendësi të lartë kanë edhe qendrat si Rrethinat (487 banorë/km²) dhe Kopliku (285 banorë/km²). Megjithatë, gjysma e njësive të qarkut kanë dendësi më të ulët se 47 banorë/km².

Figura 259 Shtrirja dhe infrastruktura e qarkut Shkodër




Ndërveprimi institucional në qarkun Shkodër

Në të gjithë qarkun ka një ndërveprim institucional të zyrave në nivel rrethi të përfaqësuar përgjithësisht në qytetet e Shkodrës, Vaut të Dejës, Koplikut dhe Pukës të tilla si: Nënprefektura, Gjykata, Prokuroria etj. Në të gjithë qarkun ka edhe zyra të qeverisë qendrore

të vendosura në qytetin e Shkodrës si: Drejtoria rajonale e arsimit, shëndetësisë, bujqësisë etj. Ky ndërveprim lidhet me përgjegjësitë dhe funksionet ligjore që secila prej këtyre zyrave ka si në nivel rrethi ashtu edhe në nivel qarku.

Figura 1. Harta e ndërveprimit të institucioneve Qarku Shkodër




Burimi: MÇV Llogaritjet e autorëve

Ndërveprimi ekonomik ndërmjet njësive vendore

Qarku Shkodër tenton një përqendrim të ndërveprimit ekonomik nga komunat drejt qendrave Shkodër, Koplik, Vau i Dejës dhe më pak Pukë. Ajo që vihet re dhe në hartën e mëposhtme është pikërisht ndërveprimi i dendur i lëvizjeve të banorëve drejt qendrave për punësim. Kjo reflekton edhe përqendrimin ekonomik përkatësisht drejt qyteteve Shkodër, Vau i Dejës, Koplik dhe Pukë. Ndërveprim të dendur me qytetin e Shkodrës rezultojnë të kenë komunat Ana e Malit, Bërdicë, Dajç, Guri i Zi etj. Ky ndërveprim i dendur ndodh edhe me komunat Bushat, Hajmel, Temal, Shllak etj. me qytetin e Vaut të Dejës. E njëjtë është edhe lëvizja nga komunat Gruemirë, Kastrat, Kelmend etj. drejt qytetit Koplik. Banorët e bashkisë Fushë Arrëz, komunave Gjegjan, Qerret, Qelëz lëvizin drejt qytetit Pukë.

Figura 260 Harta e lëvizjeve drejt qendrave të punësimit Qarku Shkodër



Burimi: MÇV Llogaritjet e autorëve

Ofrimi i shërbimeve në nivel qarku

Sektori i shërbimeve publike (që përfshin shërbimet e pastrimit dhe shërbime të ngjashme) zë pjesën dërrmuese të shpenzimeve me rreth 52% të buxhetit, i ndjekur nga sektori i transportit (që përfshin infrastrukturën rrugore dhe mirëmbajtjen e saj) me rreth mesatarisht 28% të buxhetit.


Të ardhurat e NJQV-ve të qarkut Shkodër kanë pësuar një ulje drastike në 1,9% krahasuar me totalin e njësive vendore në Shqipëri nga 8,4% që zinin në vitin 2008. Nga viti 2008 të ardhurat e njësive të qarkut Shkodër kanë pasur rënie të vazhdueshme. Edhe të ardhurat nga burimet e veta kanë rënie në njësitë e qarkut Shkodër si në vlerë absolute ashtu edhe në peshë specifike në strukturën totale të të ardhurave (56% në vitet 2008-2011 dhe 67% në 2012), ndërkohë që transfertat e pakushtëzuar është ulur lehtë në vlerë. Transfertat e kushtëzuara kanë

ruajtur pak a shumë vlerën (me një rritje në vitet 2010-2011 dhe më tej me ulje të lehtë), por kanë rënie në peshën specifike.

Pesha e njësisve të qarkut Shkodër në totalin e shpenzimeve vendore është mesatarisht 6,5% në pesë vitet 2008 – 2012.

Shpenzimet operative zënë rreth 61% të shpenzimeve totale në qarkun e Shkodrës në vitet 2008 – 2012, por pesha specifike e tyre është rritur 70% në vitin 2012. Ndër këto, shpenzimet për personelin janë në nivelin e 30% të shpenzimeve totale të NJQV-ve të qarkut që në nivel kombëtar zënë rreth 7% të shpenzimeve për paga dhe sigurime ose 2% të shpenzimeve gjithsej. Vetëm bashkia e Shkodrës zinte një peshë prej 46% në shpenzimet totale vendore të njësisve të nivelit të parë në vitin 2011 dhe 39% të shpenzimeve kapitale, ndërsa në vitin 2012 përkatësisht 41% dhe 27%. Shpenzimet kapitale zënë rreth 36% në strukturën totale (25% në 2012). Ky raport është më i lartë së mesatarja kombëtare prej 34% në 5 vite (2008 – 2012), por disi më i ulët së mesatarja kombëtare 26% në vitin 2012. Mbas Shkodrës, njësitë me buxhete më të mëdha janë Bushati, Rrethinat, Velipoja, të cilat së bashku përbëjnë rreth 56% të shpenzimeve vendore ku 50% e buxhetit shkon për pagat dhe për investime (viti 2012).

Figura 261 Harta e lëvizjeve të banorëve drejt tregjeve




Burimi: DLDP

Qarku tenton një përqendrim të ndërveprimit të konsumit nga komunat drejt qendrave Shkodër, Vau i Dejës, Koplík dhe Pukë. Nga sa rezultojnë nga harta e mësipërme, lëvizjet e banorëve nga komunat drejt qyteteve Shkodër, Vau i Dejës, Koplík dhe Pukë janë mjaft të

dendura. Kjo lëvizje identifikon qendrat e ofrimit të shërbimeve konkretisht Shkodër, Vau i Dejës, Koplík dhe Pukë.


Figura 262 Harta e lëvizjes së nxënësve e studentëve drejt qendrave arsimore, Qarku Shkodër



Burimi: DLDP

Qarku Shkodër tenton një përqendrim të ndërveprimit të edukimit nga komunat drejt qendrave Shkodër, Vau i Dejës, Koplík dhe Pukë. Vihet re lëvizja e dendur drejt qyteteve Shkodër, Vau i Dejës, Koplík dhe Pukë për arritjen e shërbimit të arsimimit.

Figura 263 Lëvizjet e banorëve të qarkut Shkodër drejt qendrave shëndetësore



Burimi: DLPD

Vihet re lëvizja e dendur drejt qyteteve Shkodër, Vau i Dejës, Koplik dhe Pukë për arritjen e shërbimit shëndetësor.

Propozimi i zonave funksionale në qarkun Shkodër

Ndarja e zonave funksionale në qarkun e Shkodrës është bërë në respekt të konceptit të zonës funksionale si një hapësirë territoriale banorët e së cilës kanë tradicionalisht një ndërveprim intensiv, garanton komunikim të pandërprerë dhe të lehtë, si dhe janë të organizuara rreth një qendre urbane.

Në këtë qark mund të identifikohen fare qartë 4 zonat (qendrat) funksionale. Si qendra funksionale shërbejnë qendrat Shkodër, Vau i Dejës, Koplik dhe Pukë.

Qarku i Shkodrës propozohet të ndahet në 4 zona funksionale, respektivisht:

- Zona funksionale Shkodër me qendër qytetin e Shkodrës
- Zona funksionale Vau i Dejës me qendër qytetin e Vaut të Dejës
- Zona funksionale M. Madhe me qendër qytetin e Koplikut
- Zona funksionale Pukë me qendër qytetin e Pukës


Në vijim jepet përshkrimi i detajuar për secilën prej zonave funksionale të këtij qarku.

Zona funksionale Shkodër

Shkodra është një model i qartë policentrik, pasi komunat përreth karakterizohen nga një bashkëveprim i ngushtë me qytetin e Shkodrës dhe njëra-tjetrën. Shkodra mbart gjithashtu dhe sipërfaqe të mëdha territoriale të populluara, pothuajse të shkëputura nga zona funksionale si (Dukagjini). Shkodra është shumë komplekse duke përfshirë në vetvete disa kombinime të mundshme të zonave funksionale. Nga këto kombinime të mundshme dalin në pah 4 zona funksionale duke u bazuar në ndërveprimet përcaktuese si qasja në shërbime, qasja drejt tregut të punës, bashkëpunimi ndër komunal, tradita dhe zhvillimi.

Ky model i zonës funksionale karakterizohet nga ekzistenca e një qendre të madhe me një fluks të dendur banorësh. Shkodra është kryeqyteti i rrethit dhe është shumë i rëndësishëm si qendër ekonomike. Ndërkohë që qendra e rrethit është shumë e fuqishme ka edhe nën-qendra më të vogla, të cilat shërbejnë si qendra për zonat e tyre rurale përreth. Në këtë mënyrë këto zona kanë dy qendra: qendrën e madhe si qendër rrethi, por edhe qendrat më të vogla ku banorët marrin disa prej shërbimeve të tyre dhe përdorin tregjet vendore.

Figura 264 Harta e zonës funksionale Shkodër



Burimi: MÇV Llogaritjet e autorëve

Duke qenë se mes njërive të qeverisjes vendore ka një ndërveprim të dendur, kufijtë lokale të rrethit nuk përputhen më kufijtë e zonës funksionale.

Efektet demografike

Tabela 138 Të dhëna sociale dhe demografike

Njësitë e qeverisjes vendore (2012)	Shkolla të mesme	Shkolla 9-vjeçare	Kopshte	Qendra shëndetësore dhe ambulanca	Qendra kulturore	Qendra sociale	Terrene sportive	Popullsia	Sipërfaqja km ²	Dendësia banorë/km ²
Bashkia Shkodër	11	21	24	13	1	2	1	77 075	16,46	4682,56
Komuna Ana e Malit	1	9	6	5	0	0	0	3858	41,8	92,30
Komuna Bërdicë	2	5	6	6	0	0	1	5773	31,02	186,11
Komuna Dajç	1	7	4	3	0	1	1	3885	30,15	128,86
Komuna Guri i Zi	1	7	4	7	0	1	1	8085	81,7	98,96
Komuna Postribë	1	11	3	9	0	0	1	7069	110,9	63,74
Komuna Pult	0	8	0	2	0	0	0	1529	122,9	12,44
Komuna Rrethina	0	12	9	8	0	0	0	21 199	47,05	450,56
Komuna Shalë	1	8	0	2	0	0	0	1804	215,05	8,39
Komuna Shosh	0	1	0	1	0	0	0	304	95,24	3,19
Komuna Velipojë	1	7	1	6	0	0	0	5031	72,4	69,49
Totali	19	96	57	62	1	4	5	135 612	864,67	156,84
Njësia e re vendore (Shkodër)	19	96	57	62	1	4	5	135 612	864,67	156,84

Burimi: Ministria e Financave 2012 Llogaritjet e autorëve

Bashkia Shkodër si qendër funksionale karakterizohet nga një ndërveprim i dendur i banorëve me qendrat shëndetësore, arsimore, sociale, kulturore etj. Në bashkinë Shkodër stacionohen 11 shkolla të mesme, 21 shkolla 9-vjeçare, 24 kopshte dhe 13 qendra shëndetësore dhe ambulanca, të hapura për t'i shërbyer një popullsie shumë herë më të madhe se popullsia e vetë bashkisë, pasi shumë komuna vërshojnë drejt Shkodrës për gjetjen e shërbimeve të nevojshme të tyre.

Po të vëmë re komunën Shosh me një popullsi prej 304 banorë me një densitet shumë të vogël prej 3,19 banorë/km², nuk ka shkolla të mesme as kopshte, ka vetëm 1 shkollë 9-vjeçare. Situata është e njëjtë edhe për qendrat shëndetësore dhe ambulancat me vetëm 1 të tillë edhe pse ato janë shumë të rëndësishme për jetën e banorëve.

Për sa i përket qendrave kulturore, sociale dhe terreneve sportive, pjesa më e madhe e komunave nuk kanë një të tillë, përveç 1 qendre kulturore të stacionuar në bashkinë Shkodër. Qendra sociale janë vetëm 2 në bashkinë Shkodër, 1 në komunën Dajç dhe 1 në komunën Guri i Zi.

Për sa i përket terreneve sportive janë gjithsej 5 të tillë në bashkinë Shkodër dhe nga 1 në 4 komunat Bërdicë, Dajç, Guri i Zi dhe Postribë. Terrene të tjera ndodhen në komunat e tjera, por që janë totalisht jashtë funksionit.

Kjo situatë do të ndryshojë me bashkimin e komunave dhe krijimin e një NJQV të madhe, e cila do të sigurojë shpërndarje të shërbimeve të arritshme për banorët e komunave më të

largëta duke i rishpërndarë në mënyrë të tillë që të eliminohen situatat e pamundësisë në ofrimin e shërbimeve.

Shqipëria ka njohur ndryshime demografike të vrullshme gjatë dy dekadave të fundit, gjë që ka sjellë edhe nevojën për rishikimin e titullit administrativ të fshatrave apo qyteteve në shumë raste. Kjo situatë pasqyrohet edhe në Shkodër, e cila ka pasur lëvizje të ndryshme demografike.

Për shkak të daljes jashtë funksionit të ndërmarrjeve industriale, disa qytete që vijojnë ligjërisht të konsiderohen si industriale, kanë humbur në mënyrë thelbësore aktivitetin ekonomik jo-bujqësor, ndërsa disa fshatra, për shkak të shtimit të shpejtë të popullsisë përmes migrimit të brendshëm, fillimit të disa aktiviteteve ekonomike që nuk kanë lidhje me token bujqësore, kanë pësuar rritje të densitetit të popullsisë dhe humbjen e aktivitetit bujqësor.

Efektet ekonomike-financiare

Tabela 139 Të dhëna ekonomike dhe financiare për bashkinë Shkodër/komunat dhe për njësinë e re vendore Shkodër (në 000 lek)

Njësitë e qeverisjes vendore (2012)	Popullsia Census 2011	Totali i bizneseve	Biznese /1000 banorë	Të ardhurat e veta	Shpenzime personale	Shpenzime operative	Investime	Investime për banor	Buxheti total	Buxheti për banor	Të ardhurat e veta për banor	Pers.+ op. për banor
Ana e Malit	3858	40	10	4521	4000	4000	6000	1,56	14 000	3,63	1,17	2,1
Bërdicë	5773	98	17	8402	8000	4000	11 000	1,91	23 000	3,98	1,46	2,1
Dajç	3885	11	3	7849	9000	5000	15 000	3,86	29 000	7,46	2,02	3,6
Guri i Zi	8085	60	7	5981	24 000	38 000	13 000	1,61	75 000	9,28	0,74	7,7
Postribe	7069	31	4	4436	23 000	7000	8000	1,13	38 000	5,38	0,63	4,2
Pult	1529	4	3	822	6000	3000	2000	1,31	11 000	7,19	0,54	5,9
Rrethina	21 199	148	7	16 016	24 000	8000	48 000	2,26	80 000	3,77	0,76	1,5
Shalë	1804	2	1	2321	3000	2000	6000	3,33	11 000	6,10	1,29	2,8
Shkodër	77 075	3269	42	278 238	221 000	42 1000	127 000	1,65	769 000	9,98	3,61	8,3
Shosh	304	1	1	656	9000	0	0	-	9000	29,61	2,16	29,6
Velipojë	5031	337	67	59 218	40 000	8000	29 000	5,76	77 000	15,31	11,77	9,5
Bashkia dhe Komunat	135 612	4001	30	388 461	371 000	500 000	265 000	1,95	1 136 000	8,38	2,86	6,4
ZF Shkodër	135 612	4001	30	388 461	266 000	492 100	377 900	2,79	1 136 000	8,38	2,86	5,6

Burimi: Ministria e Financave, llogaritjet e autorëve

Nga analiza e tabelës së mësipërme mund të kuptojmë situatën aktuale të Shkodrës si dhe të kuptojmë atë çka do të ofrohet mbas bashkimit në një njësi vendore të vetme. Në kolonën e totalit të bizneseve, shifrat luhaten nga më e larta në më të ultën, përkatësisht bashkia Shkodër me 3269 biznese në total e ndjekur nga komuna Velipojë me 337 biznese në total dhe komuna Rrethina me 148 biznese në total. Ndërkohë që shifrat më të ulëta për biznese kapin komunën

Shosh me 1 biznes në total, komunën Shalë me 2 biznese në total dhe komunën Pult me 4 biznese në total.

Në kolonën e dytë të tabelës jepen të dhëna mbi numrin e bizneseve/1000 banorë. Komuna Velipojë kap shifrën 67 biznese/1000 banorë, shifër e madhe për një popullsi prej 5031 banorësh. Ndërkohë që bashkia Shkodër me popullsinë më të madhe prej 77 075 banorësh numëron 42 biznese/1000 banorë. Komunat me numër më të ulët të bizneseve janë komunat Shalë dhe Rrethinat me nga 1 biznes/1000 banorë.

Qëndrueshmëria e rritjes ekonomike në Shkodër nuk mund të sigurohet pa një stabilitet të qëndrueshëm të treguesve makroekonomikë dhe një zhvillim të përshpejtuar të sektorit privat, ku me përparësi do të veçohej zhvillimi i biznesit të vogël e të mesëm, rritja e përshpejtuar e eksporteve bujqësorë, zgjerimi i bizneseve të shërbimit pranë bizneseve fason që rrisin punësimin etj.


Të gjitha këto përkojnë në radhë të parë me nevojën për rritjen e produktivitetit dhe konkurrenshëmërisë së ekonomisë, përmirësimin e imazhit të rajonit verior dhe përmirësimin e klimës së biznesit për të rritur atraktivitetin e vendit për investime vendase dhe të huaja, politika të qarta për zhvillimin e sektorit privat, hapjen e mëtejshme ekonomike, faktorë që do të bëhen realitet me krijimin e NJQV së re Shkodër. Një ndryshim i dukshëm do të rezultojë edhe në treguesit e buxhetit, jo vetëm në buxhetin total të njësisë së re vendore, por edhe në buxhetin për banor.

Bashkia Shkodër ka një buxhet total prej 769 milionë lekësh, një diferencë shumë e madhe kjo me komunën Pult me vetëm 11 milionë lekë. Edhe komunat e tjera buxhetin total e kanë relativisht të ulët në raport me numrin e banorëve të tyre.

Për sa i përket buxhetit/banor, pabarazitë shfaqen në komunën Shosh me buxhet/banor më të lartë prej 29 mijë lekësh e ndjekur nga komuna Velipojë me 15 mijë lekë/banor. Me bashkimin në një njësi të vetme vendore Shkodër do kemi një buxhet për banor prej 8,38 mijë lekë/banor duke reduktuar në maksimum pabarazitë e vëna re në situatën aktuale dhe duke garantuar një buxhet mesatar për çdo qytetar të njësisë së re vendore Shkodër.

Kjo gjë do mundësonte njësimin e njësive vendore të fragmentuara në një NJQV të madhe me një buxhet më të madh, që do reflektohet në investime për NJQV të re.

Figura 265 Buxheti për banor i bashkisë Shkodër/komunave dhe i njësisë së re vendore Shkodër




Burimi: MÇV Llogaritjet e autorëve

Në rast se analizojmë të ardhurat dhe shpenzimet për banor të gjeneruara dhe të shpenzuara nga njësitë vendore të Shkodrës vihet re pabarazia e tyre qoftë edhe me një vështrim të shpejtë. Tabela 138 nxjerr në pah diferenca shumë të mëdha mes shpenzimeve/banor (op+personel) dhe të ardhurave të veta/banor të disa komunave. Në komunën Velipojë, situata paraqitet ndryshe nga komunat e mësipërme që kishin shpenzimet/banor shumë herë më të larta se të ardhurat/banor. Velipoja i ka të ardhurat/banor më të larta se shpenzimet/banor përkatësisht 11 980 lekë të ardhura/banor dhe 6560 lekë shpenzime/banor. Duhet pasur parasysh që Velipoja është një ndër zonat bregdetare më të pëlqyera dhe me një perspektivë të lartë për zhvillimin ekonomik.

Nga bashkimi do të mund të përfitojmë mesatarisht 2860 lekë të ardhura të veta për banor dhe mund të reduktohen shpenzimet administrative në masën 830 lekë për banor duke rishpërndarë shpenzimet e komunave më nivel të lartë shpenzime/banor me komunat që kanë shpenzimet/banor të ulëta.

Figura 266 Të ardhurat dhe shpenzimet (operative+personel) për banor të bashkisë Shkodër/komunave dhe i njësisë së re vendore Shkodër




Burimi: MÇV Llogaritjet e autorëve

Tabela 139 tregon shpërndarjen e investimeve për të gjitha njësitë vendore të Shkodrës. Siç shikohet, njësitë vendore kanë një rishpërndarje jo të barabartë të investimeve të kryera. Investimet më të larta janë kryer nga bashkia Shkodër në vlerën 127 000 lekë, e ndjekur edhe nga komuna Rrethinat dhe Velipojë. Ndërsa komunat e tjera paraqiten në nivel të ulët në raport me numrin e popullsisë si rasti i komunës Shosh me 0 investime. Ndryshe paraqitet situata nëse shohim investimet për banor (Figura 267), ku komuna Shalë ka investimet/banor më të larta prej 58 760 lekësh.

Çfarë do të ndodhë me investimet në zonën e re funksionale Shkodër? Në rast se bashkia Shkodër dhe 10 komunat do të bashkoheshin në një njësi të vetme vendore, shumë prej funksioneve të cilat përsëriten për çdo njësi vendore do të suprimohen dhe do të reduktojnë numrin e personelit për njësinë e re vendore. Pra, me zbatimin e kësaj skeme do të përfitohej përqendrimi i funksioneve administrative të komunave të Shkodrës si prokurimi publik, planifikimi urban, shërbimet financiare, administrimi i taksave, etj. ç’ka do të sillte një kursim të konsiderueshëm. Ndërkohë që do të eliminohen funksionet e përsëritura në administratat lokale të komunave të tilla si financierë, arkëtarë, nënkryetar bashkie/komune, sekretar të këshillit, këshilltarë, etj. që do të mundësonte një kursim prej afro 65% të shpenzimeve administrative. Gjithashtu një kursim tjetër administrativ afro 7,5 % i shpenzimeve operative do të vinte dhe nga mirëmbajtja dhe kosto operative të zyrave administrative, të cilat do të reduktohen si rezultat i reduktimit dhe përqendrimit të funksioneve të cituara më lart. Kjo do të ndikojë në shpenzimet për mbajtjen e administratës pra, shpenzimet e personelit do të ulen nga 371 000 lekë në 266 mijë lekë duke rezultuar në një kursim të konsiderueshëm prej rreth 105 mijë lekësh. Shpenzimet operative do të ulen nga 500 mijë lekë në 492 mijë lekë duke na dhënë një kursim prej 7,9 milionë lekë në vit. Këto kursime do reflektohen në një rritje në investime prej 113 milionë lekësh.

Të gjitha këto fonde të kursyera do të mund të përdoren për rritjen e cilësisë së shërbimeve ose do të mund të investohen në infrastruktura, transport publik, apo zhvillim ekonomik duke nxitur në këtë mënyrë zhvillimin ekonomik dhe financiar të territorit si edhe thithjen e investimeve të huaja. Për efekt të analizës supozojmë së fondet e kursyera do të përdoren për rritjen e investimeve nga njësia e re vendore.

Figura 267 Shpërndarja e investimeve për të gjitha njësitë vendore të Shkodrës



Burimi: MÇV Llogaritjet e autorëve


Me bashkimin e komunave në një NJQV të vetme Shkodër do t'i jepej mundësi më e madhe investitorëve shqiptarë dhe të huaj në lidhje me aktivitete të ndryshme ekonomike dhe mundësi të nxitjes dhe zhvillimit të biznesit në këtë zonë.

Efektet në ofrimin e shërbimeve

Duke analizuar praninë e ujësjellës-kanalizimeve nga të dhënat e mundësuar, vetëm në bashkinë Shkodër, Ujësjellësi është Sh.A, ndërsa në komunat e tjera të Shkodrës ujësjellësi është komunal dhe pjesërisht i pranishëm. Vëmë re se ka një ndërthurje të shpërndarjes së ujësjellësve Sh.A me ato komunalë, që me zmadhimin e territorit do të mundësojë një përfshirje të komunalëve në Sh.A në mënyrë që furnizimi me ujë të jetë i plotë dhe i pandërprerë në të gjithë zonën duke marrë parasysh dhe relievin gjeografik të saj, për t'i mundësuar një shërbim efikas dhe cilësor banorëve të saj.

Gjithashtu dhe kohëzgjatja e furnizimit me ujë është e reduktuar. Duke qenë se prania e ujit është e domosdoshme dhe një shërbim jetësor për banorët, ai duhet të mundësohet me orar të plotë dhe jo të reduktuar, gjë e cila me zmadhimin e territorit do të mundësohet edhe në zonat në të cilat nuk ekziston ose ekziston pjesërisht prania e ujësjellësit.


Figura 268 Infrastruktura e ZF Shkodër



Burimi: MÇV Llogaritjet e autorëve

Për sa i përket infrastrukturës rrugore Shkodra ka një pozitë të favorshme gjeografike në Shqipëri. Ajo është e lidhur nëpërmjet infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore me pjesën tjetër të Shqipërisë dhe më vende të tjera të Ballkanit si Mali i Zi dhe Kosova. Për sa i përket akseve rrugore, fokus gjithnjë e më të madh i është dhënë edhe rrugëve dytësore përveç atyre kryesore më qëllim daljen në treg të zonave rurale. Në zonën e re funksionale të Shkodrës do të mund t'i jepet prioriteti i nevojshëm rrugëve lidhëse të komunave me qendrën administrative duke mundësuar një shkurtim të kohës së udhëtimit. Sigurisht që zhvillimi i infrastrukturës së rajonit të Shkodrës do të planifikohet në harmoni me zhvillimin infrastrukturor kombëtar dhe më gjerë me atë ndërkombëtar. Gjithashtu në fokus të zhvillimit të ri do të jetë edhe rritja e investimeve në infrastrukturën e ujësjellës-kanalizimeve dhe sistemimin e ujërave të zeza.


Figura 12 Zhvendosja e banorëve të qarkut për në punë



Burimi: MÇV Llogaritjet e autorëve

Në Shkodër, përdorimi i transportit publik nga qytetarët për të shkuar në punë është në nivele të ulëta. Në komunat e largëta si Shllak, Pult, Shalë e Kelmend transporti i etiketuar publik (por jo i tillë prej regjistrimit) është i rrallë. Infrastruktura e fragmentuar ndërmjet bashkive e komunave bën që aksesin ndaj këtij transporti të jetë i ulët. Me krijimin e një njësie të vetme vendore, shërbimi i transportit publik do të projektohet e administrohet për të përfshirë interesin e shumë më tepër qytetarëve duke rritur kështu aksesin në zonat e largëta dhe duke i afruar qytetarët me qendrat funksionale.

Figura 13 Përdorimi i transportit publik në rrethin Shkodër



Burimi: Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, llogaritjet e autorëve

Ndërkohë që përdorimi i transportit publik në qytetin e Shkodrës është shumë i ulët dhe një pjesë e mirë e banorëve të komunave udhëtojnë drejt Shkodrës për të arritur vendet e tyre të punës. Me heqjen e kufijve ndërmjet komunave e bashkisë infrastruktura rrugore dhe ajo e transportit nuk do të jenë më të fragmentuara. Kjo do të sjellë rritje të aksesit, përmirësim të cilësisë për transportin publik e rrjedhimisht përmirësimin e kushteve të jetesës për të gjithë qytetarët.

Përfundime

Ulje të ngarkesës mesatare të administratës vendore për 1000 banorë nga 2,9 aktualisht në 2,25 punonjës për 1000 banorë;

Reduktim të shpenzimeve administrative me 113 milion lekë (personeli dhe operative) dhe uljen e këtyre shpenzimeve për banorë në masën 10% nga 6,44 mijë lekë në 6 mijë lekë në njësinë e re vendore;

Mirë administrimi i burimeve do të sjellë shtim në masën 22% të fondit të investimeve totale në të njëmbëdhjetë NJQV, nga 265 milionë lekë në 378 milionë lekë;


Buxheti i investimeve për banor do të rritet nga 1,9 mijë lekë në 2,8 mijë lekë;

Zona funksionale Vau i Dejës

Duke iu përmbajtur kriterëve që udhëheqin ndarjen administrativo-territoriale, vëmë re se bashkia Vau i Dejës dhe komunat Bushat, Vig Mnelë, Hajmel, Temal dhe komuna Shllak, përbëjnë një zonë funksionale të veçantë me qendër funksionale bashkinë Vau i Dejës.

Qendra funksionale Vau i Dejës ofron një ndërveprim të dendur të banorëve e komunave të përmendura më sipër për sa i përket ofrimit të shërbimeve që komunat e tyre nuk e ofrojnë. Bashkia Vau i Dejës shërben si qendër punësimi për komunën më të afërt të saj komunën Vig Mnelë, por edhe për komunat e tjera ku një pjesë e banorëve kanë mundur të gjejnë punësim në bashkinë Vau i Dejës. Për sa i përket lëvizjeve drejt tregjeve të ndryshme, kryesisht banorët lëvizin drejt tregut të madh që ofron bashkia Shkodër, por banorët e komunave të sipër cituara tregtojnë edhe në bashkinë Vig Mnelë.

Figura 14 Harta e zonës funksionale Vau i Dejës



Burimi: MÇV Llogaritjet e autorëve

Lëvizja më e dendur e banorëve drejt bashkisë Vau i Dejës është për arsye arsimimi ku disa nga komunat Temal, Vig Mnelë, Hajmel sigurojnë shërbimin arsimor në Vaun e Dejës.

Ajo që vihet re në këtë zonë është bashkëpunimi i dendur ndër komunal ndërmjet Vaut të Dejës dhe komunave përreth.

Duke qenë së mes njësive të qeverisjes vendore ka një ndërveprim të dendur, kufijtë lokale të rrethit nuk përputhen me kufijtë e zonës funksionale.

Efektet demografike

Tabela 140 Të dhëna sociale dhe demografike

Njësitet e qeverisjes vendore (2012)	Shkollat mesme	Shkolla 9-vjeçare	Kopshte	Qendra shëndetësore dhe ambulanca	Qendra Kulturorë	Qendra sociale	Terrene sportive	Popullsia	Sipërfaqja km ²	Dendësi a banorë/km ²
Bashkia Vau i Dejës	2	7	5	8	1	1	0	8117	98,5	82,41
Komuna Bushat	3	11	14	12	0	1	2	14 149	92,7	152,63
Komuna Vig Mnelë	0	4	1	0	0	0	0	1509	73,15	20,63
Komuna Hajmel	2	6	4	5	0	0	0	4430	30,6	144,77
Komuna Tëmal	0	5	0	3	0	0	0	1562	101,8	15,34
Komuna Shllak	0	4	0	2	0	0	1	671	72,6	9,24
Totali	7	37	24	30	1	2	3	30 438	469,35	64,85
Njësia e Re vendore(Vau i Dejës)	7	37	24	30	1	2	3	30 438	469,35	64,85

Burimi: MÇV Llogaritjet e autorëve

Nga tabela 3 vëmë re se numrin më të madh të shkollave 9-vjeçare e ka komuna Bushat me 11 shkolla për një popullsi prej 14 149 banorësh. Ndërkohë komuna Shllak me popullsi shumë të vogël prej 671 banorësh ka 4 shkolla 9-vjeçare për shkak të shtrirjes së fshatrave të kësaj komune.

Situata paraqitet ndryshe në lidhje me shkollat e mesme dhe kopshtet. Komuna Vig Mnelë, komuna Temal dhe Shllak kanë 0 shkolla të mesme.

Njësia e re vendore do të ketë 37 shkolla 9-vjeçare, 7 shkolla të mesme dhe 24 kopshte për 30 438 banorë duke synuar një shpërndarje më të mirë të infrastrukturës shkollore për të gjithë nxënësit, gjë e cila nuk garantohet në sistemin e fragmentuar të qeverisjes vendore.

Tabela 3 tregon qartazi mungesën e aksesit social-kulturor-sportiv pothuajse në të gjithë zonën e Vaut të Dejës. Shumë komuna madje edhe bashkia kanë tregues 0 për sa i përket qendrave sociale, qendrave kulturore dhe terreneve sportive, të cilat edhe pse ekzistojnë si të tilla në disa komuna nuk janë funksionale për shkak të mungesës së infrastrukturës dhe personelit.

Mund të themi se gjatë periudhës së tranzicionit ndryshimet demografike që kanë ndodhur në të gjithë Shqipërinë kanë reflektuar edhe në zonën funksionale të Vaut të Dejës. Faktorët kryesorë që kontribuojnë në këto zhvillime demografike janë të lidhura më tranzicionin ekonomik, mbylljen e shumë ndërmarrjeve në pronësi shtetërore dhe papunësisë që i shoqërojnë edhe infrastruktura e transportit dhe e komunikimit me qendra si Shkodra e Lezha, të cilat janë relativisht të dobëta, ndryshimi i shpeshtë i strukturës së prodhimit bujqësor dhe migrimi i forcës së punës.

Me bashkimin në një NJQV të vetme do mundësohet një rritje ekonomike e qëndrueshme, e cila do reflektohet në reduktimin e lëvizjeve demografike dhe rritjen e nivelit të jetesës.

Efektet ekonomiko-financiare

Tabela 141 Të dhëna ekonomike dhe financiare për bashkinë Vau i Dejës/komunat dhe për ZF Vau i Dejës (në 000 lek)

Njësitë e qeverisjes vendore (2012)	Popullsia Census 2011	Totali i bizneseve	Biznese për 1000 banorë	Të ardhurat e veta	Shpenzi me personel	Shpenzime operative	Investime	Investime për banor	Buxheti total	Buxheti për banor	Të ardhurat për banor	Shpenzi me për banor (op+personel)
Bashkia Vau i Dejës	8117	118	15	20 258	49 000	39 000	40 000	2,83	128 000	9,05	3,47	6,2
Komuna Bushat	14 149	236	17	52 521	10 000	9000	8000	1,81	27 000	6,09	0,70	4,3
Komuna Vig Mnelë	1509	4	3	1707	3000	3000	5000	7,45	11 000	16,39	3,22	8,9
Komuna Hajmel	4430	25	6	3690	6000	2000	-	-	8000	5,12	2,79	5,1
Komuna Tëmal	1562	3	2	4488	25 000	31 000	21 000	2,59	77 000	9,49	2,25	6,9
Komuna Shllak	671	2	1	3194	6000	5000	6000	3,98	17 000	11,27	0,99	7,3
Bashkia dhe Komunat	30 438	388	13	85 858	99 000	89 000	80 000	2,63	268 000	8,80	2,58	6,2
Njësia e re (Vau i Dejës)	30 438	388	13	85 858	47 200	83 200	137 600	4,52	268 000	8,8	2,58	4,3

Burimi: Ministria e Financave, llogaritjet e autorëve


Ajo që mund të lexojmë nga Tabela 141 na shërben për të kuptuar më mirë situatën aktuale dhe atë që do të ndodhë nga bashkimi i bashkisë Vau i Dejës me 5 komunat rreth saj. Në këtë zonë funksionale vihet re fakti se edhe kur komuna si ajo e Bushatit që ka popullsinë më të madhe të zonës me 14 149 banorë dhe numrin më të madh të bizneseve prej 236 përsëri bashkia Vau i Dejës me popullsi më të vogël prej 8117 banorësh dhe numër biznesesh 118 shërben si qendra funksionale e zonës.

Dispropocioni qëndron edhe ndërmjet komunave të tjera si p.sh., komuna Hajmel me 25 biznese në total, ndërsa komuna Shllak me vetëm 1 biznes.

Njësia e re vendore Vau i Dejës do të ketë në monitorim dhe si kontribues me taksa 388 biznese duke pasur një buxhet të shtuar jo vetëm për banorët e bashkisë Vau i Dejës, por edhe për komunat e tjera të zonës funksionale që do të bashkohen në njësinë e re vendore Vau i Dejës. Duke përmirësuar efikasitetin dhe cilësinë e shërbimeve edhe ndaj bizneseve, e mbështetur kjo me masat e tjera të parashikuara nga qeveria qendrore, do të krijohen premiset

për formalizimin e bizneseve të lidhura me bujqësinë që do të kontribuojnë në të ardhurat e veta të NJQV të re.

Figura 15 Ndërveprimi ekonomik zona funksionale Vau i Dejës




Burimi: MÇV Llogaritjet e autorëve

Në figurën 16 jepen gjithashtu dhe të dhëna mbi numrin e bizneseve për 1000 banorë. I njëjti dispropocion që cituam për totalin e bizneseve, ekziston dhe për numrin e bizneseve për 1000 banorë. Bashkia Vau i Dejës si qendra e rrethit ka rreth 15 biznese për 1000 banorë, ndërkohë që komuna Bushat ka në territorin e tij 17 biznese për 1000 banorë. Komunitat e tjera kanë numër përgjithësisht shumë të ulët të bizneseve/banorë si p.sh. komuna Shllak me 1 biznes/1000 banorë. Ky dispropocion do të sfumohet pasi me bashkimin në një NJQV numri i bizneseve do të shkojë në një numër mesatar të shifrave të mësipërme në 13 biznese për 1000 banorë.

Në NJQV të re do të përcaktohen fushat e veprimit afatgjatë si dhe ndërhyrjet konkrete të cilat adresojnë nevojat emergjente të popullsisë apo grupeve të ndryshme të interesit, bizneseve etj.

në një mënyrë që të kombinojë gjithashtu edhe tendencat e zhvillimit në lidhje me të ardhmen e NJQV së re.

Figura 16. Totali i bizneseve dhe bizneset për 1000 banorë




Burimi: MÇV Llogaritjet e autorëve

Një ndryshim të dukshëm do të kenë edhe në treguesit e buxhetit (figura 17), jo vetëm në buxhetin total të njësisë së re vendore, por edhe në buxhetin për banor. Bashkia Vau i Dejes ka një buxhet prej 77 milion lekësh, ndërsa komuna Shllak me popullsi prej 671 banorë dhe numër biznesesh 2 biznese në total dhe 1 biznes/1000 banorë ka buxhetin prej 41 milion lekësh, e renditur mbas bashkisë Vau i Dejes. Ndërkohë që komuna Bushat me një popullsi prej 14 149 banorë rezulton me buxhet në total të ulët prej 13 milion lekë.

Buxheti i njësisë së re vendore Vau i Dejes do të ishte 268 milionë lekë duke u rritur në terma absolutë për të gjithë qytetarët e njësisë së re vendore. E njëjta situatë paraqitet edhe për buxhetin për banor ku bashkia Vau i Dejes ka një buxhet rreth 9490 lekë/banor, ndërkohë që komuna Shllak ka buxhetin më të lartë për banor me 16 300 lekë/banor e pasuar nga komuna Vig Mnelë me 11 300 lekë/banor.

Me bashkimin në një njësi të vetme vendore Vau i Dejes do kemi një buxhet banor prej 8800 lekë/banor duke reduktuar në maksimum pabarazitë e vëna re në situatën aktuale dhe duke garantuar një buxhet mesatar për çdo qytetar të njësisë së re vendore Vau i Dejes. Shpërndarja e pabarabartë në buxhet dhe resurse do të rregullohet në njësinë e re vendore duke rishpërndarë në mënyrë të drejtë dhe barabartë buxhetet dhe resurset për të gjithë qytetarët në njësinë e re vendore.


Figura 269 Buxheti total dhe për banor i bashkisë Vau i Dejës/komunave dhe i njësisë së re vendore Vau i Dejës



Burimi: MÇV Llogaritjet e autorëve

Në rast së analizojmë të ardhurat dhe shpenzimet për banor të gjeneruara dhe shpenzuara nga njësitë vendore të zonës funksionale Vau i Dejës vëmë re të njëjtin fenomen të pabarazisë ndërmjet njësisve vendore dhe një rishpërndarje jo të barabartë të të ardhurave për banorë në njësi të ndryshme vendore. Komuna Shllak shënon nivelin e të ardhurave për banorë 4760 lekë e ndjekur nga Komuna Bushat dhe Temal respektivisht 3710 lekë dhe 2870 lekë për banorë. Komuna Hajmel shënon nivelin më të ulët të të ardhurave për banor 83 lekë, ndërsa bashkia Vau i Dejës gjeneron 2500 lekë të ardhura/banorë. Nga bashkimi i njësisve vendore në njësinë e re vendore Vau i Dejës do të kemi 2820 lek të ardhura/banor duke siguruar një rishpërndarje më të drejtë të të ardhurave për banor për të gjithë banorët e njësisë së re vendore.

Figura 270 Të ardhurat dhe shpenzimet (operative+personel) për banor të bashkisë Vau i Dejës/komunave dhe i njësisë së re vendore Vau i Dejës




Burimi: MÇV Llogaritjet e autorëve

Pabarazitë e mësipërme mund t'i vërejmë tek shpenzime/banor ku përfshihen shpenzime operative (shpenzimet për shërbime) dhe shpenzime personeli. Komuna Shllak shënon një nivel të shpenzimeve prej mbi 16 mijë lekësh/banorë e ndjekur nga Komuna Vig Mnelë me 11 200 lek/banorë, ndërsa bashkia Vau i Dejës shpenzon për çdo banor të saj vetëm 9500 lekë. Nga bashkimi do mund të përfitojmë një rishpërndarje të shpenzimeve për çdo banor të

njësisë së re vendore Vau i Dejës. Eliminimi i fragmentimit dhe bashkimi në një njësi të re vendore do të rezultojë në një rishpërndaje më të mirë të shpenzimeve për shërbime publike lokale për të gjithë qytetarët e njësisë së re vendore Vau i Dejës.


Figura 271 Investimet e bashkisë Vau i Dejës/komunave dhe i njësisë së re vendore Vau i Dejës



Burimi: MÇV Llogaritjet e autorëve

Në figurën 19 jepet shpërndarja e investimeve për të gjitha njësitë vendore të zonës funksionale Vau i Dejës. Siç shikohet njësitë vendore të zonës funksionale Vau i Dejës kanë një rishpërndarje jo të barabartë të investimeve të kryera. Investimet më të larta janë kryer nga bashkia Bushat në vlerën 40 000 lekë e ndjekur edhe nga Vau i Dejës me 21 000 lekë. Ndërsa komunat e tjera paraqiten në nivele shumë të ulëta investimesh ose 0 lekë si p.sh., komuna Temal. Nëse shohim investimet për banor (Figura 272), komuna Shllak ka kryer një nivel investimeve/banor prej 7450 lekësh/banorë. Kjo vjen si pasojë e mundësive të ndryshme të njësisë vendore për të kryer investime me të ardhurat e tyre, por edhe nga skema e financimit të shpenzimeve kapitale të kryera nëpërmjet skemës së granteve konkurruese që në përgjithësi ka krijuar një pabarazi në shpërndarjen e tyre. Nëse analizojmë strukturën e investimeve, vëmë re se njësitë vendore nuk kanë kryer investime në fushën e zhvillimit ekonomik vendor. Mos realizimi i investimeve nga njësitë vendore në fushën e zhvillimit ekonomik vendor, ka sjellë një efekt negativ në zhvillimin e bizneseve duke mos i mbështetur dhe duke mos i krijuar atyre kushtet e përshtatshme për zhvillim.

Figura 272 Investimet për banor të bashkisë Vau i Dejës/komunave dhe të njësisë së re vendore Vau i Dejës



Burimi: MÇV Llogaritjet e autorëve

Çfarë do të ndodhë me investimet në zonën e re funksionale Vau i Dejës? Në rast së bashkia Vau i Dejës dhe 5 komunat do të bashkoheshin në një njësi të vetme vendore, shumë prej funksioneve të cilat përsëriten për çdo njësi vendore do të suprimohen duke reduktuar numrin e personelit për njësinë e re vendore. D.m.th. me zbatimin e kësaj skeme do të përfitonim përqendrimin e funksioneve administrative të komunave si prokurimi publik, planifikimi urban, shërbimet financiare, administrimi i taksave, etj. çka do të sillte një kursim të konsiderueshëm. Ndërkohë që do eliminohen funksionet e përsëritura në administratën lokale të tilla si financierë, arkëtarë, nënkryetar bashkie/komune, sekretar të këshillit bashkiak, këshilltarë, etj. me një kursim prej afro 65% të shpenzimeve të administrative (duke përfshirë kursimin nga përqendrimi i funksioneve + kursimin nga eliminimi i funksioneve të përsëritura). Gjithashtu një kursim tjetër administrativ afro 7,5 % i shpenzimeve operative do të vijë dhe nga mirëmbajtja dhe kostot operative të zyrave administrative, të cilat do të reduktohen si rezultat i reduktimit dhe përqendrimit të funksioneve të cituara më lart. Kjo do të ndikojë në shpenzimet për mbajtjen e administratës pra, shpenzimet e personelit do të ulen nga 99 000 lekë në 47 200 lekë, duke rezultuar në një kursim të konsiderueshëm prej rreth 51,8 milionë lekësh. Shpenzimet operative do të ulen nga 89 000 në 83 milionë lekë duke na dhënë një kursim prej 5,8 milionë lekësh. Këto kursime do të reflektohen në një rritje në investime prej 57,6 milionë lekësh duke i rritur ato nga 80 000 në 137,6 milionë lekë.


Të gjitha këto fonde të kursyera do të mund të përdoren për rritjen e cilësisë së shërbimeve ose do të mund të investohen në infrastrukturë, transport publik, apo zhvillim ekonomik duke nxitur në këtë mënyrë zhvillimin ekonomik dhe financiar të territorit si edhe thithjen e investimeve të huaja. Për efekt të analizës supozojmë së fondet e kursyera do të përdoren për rritjen e investimeve nga njësia e re vendore. Pra, në njësinë qendrore vendore të re të Vaut të Dejës do të kemi një rritje të investimeve publike më rreth 57,6 milionë lekë si pasojë e reduktimit të shpenzimeve administrative dhe kursimit që përfitohet nga suprimimi i zyrave administrative dhe funksioneve të përsëritura.

Gjithashtu nga bashkimi i bashkisë Vau i Dejës dhe 5 komunave në një NJQV të vetme do mund të ekuilibrohet dispropocioni në investime për banor duke i rishpërndarë ato dhe duke

përfituar 4500 lekë për banor në NJQV e re administrative-territorial, në mënyrë që të rishpërndajmë shpenzimet kapitale për banor.

NJQV e re do kontribuonte në një perspektivë më të favorshme duke bërë të mundur fuqizimin e saj dhe duke maksimizuar jo vetëm investimet në njësinë e re vendore si rezultat i rritjes së tyre, por edhe duke shpërndarë investimet në zona të cilat gjenerojnë zhvillim ekonomik dhe punësim dhe jo duke i copëzuar e shpërndarë pa asnjë kriter siç ka ndodhur deri më tani.

Figura 21 Harta e infrastrukturës Zona funksionale Vau i Dejës



Burimi: MÇV Llogaritjet e autorëve

Efektet në ofrimin e shërbimeve

Edhe në bashkinë Vau i Dejës ujësjellësi është Sh.A, ndërsa në komunën Bushat dhe komunat e tjera ujësjellësi është komunal dhe pjesërisht i pranishëm. Me zmadhimin e territorit do të

mundësohet një përfshirje e ujësjellësve komunal në Sh.A, në mënyrë që furnizimi më ujë të jetë i plotë dhe i pandërprerë në të gjithë zonën duke marrë parasysh dhe relievin gjeografik të saj për t'i mundësuar një shërbim efikas dhe cilësor banorëve të saj.

Vëmë re se kohëzgjatja e furnizimit me ujë është e reduktuar. Duke qenë se prania e ujit është e domosdoshme dhe një shërbim jetësor për banorët, ai duhet të mundësohet me orar të plotë dhe jo të reduktuar, gjë e cila me zmadhimin e territorit do të mundësohet edhe në zonat në të cilat nuk ekziston ose ekziston pjesërisht prania e ujësjellësit.

Në lidhje me infrastrukturën rrugore zona e Vaut të Dejës në sezonin e dimrit has vështirësi të shumta për shkak të shkarkimeve në hidrocentralin e Vaut të Dejës që sjellin përmbytje të shpeshta. Kjo situatë sigurisht që rëndohet dhe nga infrastruktura jo e përshtatshme, e cila me bashkimin në një NJQV do rishikohet për shkak dhe të fuqizimit si dhe lëvizjeve të shpeshta të banorëve.

Në komunën Bushat është ndërtuar një landfill, i cili do t'i shërbejë rreth 200 000 banorëve. Periudha e shërbimit të landfillit është 20 vjet. Sasia mesatare e mbeturinave që do të depozitohen në këtë landfill është 130 ton në ditë. Por ky landfill aktualisht nuk punon në kapacitetin e tij të plotë. Me zgjerimin e territorit administrativ ky landfill do t'i shërbejë më shumë banorëve. NJQV e re do ta menaxhojë atë më mirë dhe do të mund të përfitojë nga projekte e mbështetje të mundshme.

Përfundime

Ulje të ngarkesës mesatare të administratës vendore për 1000 banorë nga 41,88 aktualisht në 22,7 punonjës për 1000 banorë;

Reduktim të shpenzimeve administrative më 57,6 milionë lekë (personeli dhe operative) dhe uljen e këtyre shpenzimeve për banorë në masën 30% nga 6,2 mijë lekë në 4,3 mijë lekë në njësinë e re vendore;

Mirë administrimi i burimeve do të sjellë shtim në masën e 72% të fondit të investimeve totale në të dhjetë NJQV nga 80 milionë lekë në 137,6 milionë lekë;

Buxheti i investimeve për banor do të rritet nga 2,6 mijë lekë në 4,5 mijë lekë;

Zona funksionale Malësi e Madhe

Ajo që vumë re në qarkun e Shkodrës janë karakteristikat e veçanta të rretheve nga të cilat ky qark përbëhet. Qarku i Shkodrës bënte pjesë kryesisht në modelin policentrik të zonave funksionale me një zonë funksionale përtej kufirit rajonal. Ndërsa Puka dhe Malësia e Madhe janë të orientuara drejt modelit koncentrik të zonave funksionale.

Kufijtë e zonës funksionale të Malësisë së Madhe përputhen plotësisht me kufijtë e rrethit duke pasur si qendër të zonës funksionale bashkinë Koplík. Ndërveprimet përcaktuese të zonës funksionale të Malësisë së Madhe janë konsumi dhe qasja në shërbime, kjo vihet re jo vetëm në punësim ku ndërveprimet e banorëve me bashkinë Koplík janë shumë të dendura, por edhe për arsimim apo për shërbime shëndetësore.


Ndërkohë që në Malësinë e Madhe identifikohet një ndërveprim jo shumë i dendur me zonat ndërkufitare ku ndërmjet komunave Kastrat dhe Kelmend me Malin e Zi ekziston një ndërveprim më intensiv.

Malësia e Madhe si zonë funksionale paraqet mundësi zhvillimi edhe më të mëdha me pak më tepër bashkëpunim mes grupeve të interesit.

Terreni malor i Malësisë së Madhe është shumë i përshtatshëm për zhvillimin e turizmit malor, sepse brenda hapësirës gjeografike të Malësisë Madhe gjenden pasuri dhe burime natyrore me vlera të mëdha ekonomike si pika turistike e Razmës. Një nga aktorët kryesorë në procesin e zhvillimit të infrastrukturës turistike duke ndjekur modele të ngjashme të shteteve fqinje është bashkëpunimi i bashkisë dhe komunave.

Malësia e Madhe shënon një nivel të mesëm ekonomik në krahasim me zonat e tjera malore të Shqipërisë. Koplíku është qendra tregtare e Malësisë së Madhe, është vendi ku fshatrat rurale gjejnë shërbimet e nevojshme nga blerja e sendeve shtëpiake, veshje dhe gjëra të tjera të përditshme për të arritur te shërbime të tilla si kujdesi shëndetësor. Si rezultat, Koplíku është i mbushur me shërbime të ndryshme si dyqane, banka, restorante, apo internet kafe. Si rezultat i statusit të tregtisë dhe qendrës administrative, Koplíku i duhet të përballojë një fluks të vazhdueshëm të njerëzve nga zona përreth.

Figura 273 Harta e ZF Malësi e Madhe



Efektet demografike

Tabela 142 Të dhëna sociale dhe demografike

Njësitë e qeverisjes vendore (2012)	Shkolla të mesme	Shkolla 9-vjeçare	Kopshte	Qendra shëndetësore dhe ambulanca	Qendra kulturore	Qendra sociale	Terrene sportive	Popullsia	Sip. km ²	Dendësi a banorë km ²
Bashkia Koplík	1	1	2	2	1	0	0	3734	9,3	401,51
Komuna Gruemirë	1	14	14	11	0	0	0	8890	113,7	78,19
Komuna Kastrat	2	9	8	12	0	0	1	6883	128,7	53,48
Komuna Kelmend	1	11	1	6	1	0	1	3056	384,5	7,95
Komuna Qendër M. Madhe	0	7	7	6	0	0	0	4740	46,72	101,46
Komuna Shkrel	1	8	5	11	1	0	1	3520	297,2	11,84
Totali	6	50	37	48	3	0	3	30 823	980,12	31,45
Njësia e re vendore (M. Madhe)	6	50	37	48	3	0	6	30 823	980,12	31,45

Burimi: INSTAT, Llogaritja e autorëve

Po të vëmë re shpërndarjen e shkollave të sistemit para universitar shohim se bashkia Koplík ka vetëm 1 shkollë 9-vjeçare për një popullsi prej 3734 banorësh, ndërsa komuna Gruemirë ka të stacionuara në territorin e saj 14 shkolla 9-vjeçare për një popullsi prej 8890 banorësh. Komuna Kelmend me një popullsi prej 3056 banorësh para, më të vogël së bashkia Koplík ka 11 shkolla 9-vjeçare, ndërkohë që bashkia Koplík ka 1 të tillë. Njësia e re vendore do të ketë 50 shkolla 9-vjeçare për 30 823 banorë duke synuar një shpërndarje më të mirë të

infrastrukturës shkollore dhe personelit arsimor për të gjithë nxënësit. Bashkia Koplík ka 1 shkollë të mesme, komuna Kastrat ka 2 të tilla, ndërsa komuna Qendër Malësi e Madhe nuk ka fare shkollë të mesme. Bashkimi në një njësi të vetme vendore do të rrisë cilësinë e shkollave të mesme duke ofruar mundësinë e rishpërndarjes më të mirë të nxënësve dhe duke rritur aksesin në shkollat e mesme edhe të nxënësve në komunat që sot nuk kanë shkolla të mesme.

E njëjta situatë do të jetë edhe me kopshtet dhe qendrat shëndetësore. Njësia e re vendore do të ketë 37 kopshte dhe 48 qendra shëndetësore dhe ambulanca duke shtuar aksesin e të gjithë banorëve të zonës dhe jo vetëm aty ku ato janë si pasojë e sistemit të fragmentuar.

Tabela 5 tregon qartazi mungesën e qendrave social-kulturor-sportive pothuajse në të gjithë Malësinë e Madhe. Shumë komuna madje edhe bashkia kanë tregues 0 për sa i përket qendrave sociale, qendrave kulturore dhe terreneve sportive të cilat edhe pse ekzistojnë si të tilla në disa komuna nuk janë funksionale për shkak të mungesës së infrastrukturës dhe personelit.

Mund të themi së gjatë periudhës së tranzicionit ndryshimet demografike në Malësinë e Madhe kanë qene relativisht të larta. Malësia e Madhe është ndër zonat që kanë humbur popullsi si pasojë e lëvizjeve të brendshme migratore pas vitit 1990. Faktorët kryesorë që kontribuojnë në këto zhvillime demografike janë të lidhura me tranzicionin ekonomik, mbylljen e shumë ndërmarrjeve në pronësi shtetërore dhe papunësisë që e shoqëroi, infrastruktura e transportit dhe e komunikimit jashtëzakonisht e dobët, terrenit në përgjithësi të vështirë, kushteve të pafavorshme klimatike dhe bujqësore, si dhe shfrytëzimit pa kriter të pyjeve. Me bashkimin në një NJQV të vetme do mundësohet një rritje ekonomike e qëndrueshme, e cila do reflektohet në reduktimin e lëvizjeve demografike dhe rritjen e nivelit të jetesës.

Efektet ekonomike dhe financiare

Tabela 6 Të dhëna ekonomike dhe financiare për bashkinë Koplik/komunat dhe për njësinë e re vendore Malësi e Madhe (në 000 lek)


Njësitë e qeverisjes vendore (2012)	Popullsia Census 2011	Totali i bizneseve	Biznese për 1000 banorë	Të ardhurat e veta	Shpenzime personale	Shpenzime operative	Investime	Investime për banor	Buxheti total	Buxheti për banor	Të ardhurat për banor	Shpenzime për banor (op+personel)
Bashkia Koplik	3734	138	37	15 518	23 000	18 000	13 000	3,48	54 000	14,46	4,16	10,98
Komuna Gruemirë	8890	44	5	3225	23 000	14 000	19 000	2,14	56 000	6,30	0,36	4,16
Komuna Kastrat	6883	55	8	8748	31 000	27 000	55 000	7,99	113 000	16,42	1,27	8,43
Komuna Kelmend	3056	9	3	4551	12 000	5000	8000	2,62	25 000	8,18	1,49	5,56
Komuna Qendër M. Madhe	4740	20	4	2387	5000	3000	5000	1,05	13 000	2,74	0,50	1,69
Komuna Shkrel	3520	17	5	13 126	7000	7000	25 000	7,10	39 000	11,08	3,73	3,98
Bashkia dhe Komunat	30 823	283	9	47 555	101 000	74 000	125 000	4,06	300 000	9,73	1,54	5,68
Njësia e re (M. Madhe)	30 823	283	9	47 555	46 400	68 400	179 900	5,84	300 000	9,73	1,54	5,68

Burimi: Llogaritjet e autorëve

Tabela 6 mundëson një pamje të qartë të situatës aktuale dhe asaj që do ofrohet mbas bashkimit në një njësi vendore të vetme. Në kolonën e totalit të bizneseve bie në sy një dispropocion i theksuar i shpërndarjes të bizneseve në raport me numrin e popullsisë së njësisë vendore të Malësisë së Madhe. Bashkia e Koplikut ka numrin më të madh të totalit të bizneseve (ku përfshihet biznesi i madh, i mesëm, i vogël dhe të tjera) prej 138 biznese për 3734 banorë, ndërsa komunat paraqiten me një numër të reduktuar biznesesh në totalin e tyre. Për shembull komuna të tilla si Gruemirë edhe pse më popullsinë më të madhe se bashkia Koplik ka numër biznesesh më të vogël me 44 biznese në total, ndërsa komuna Kastrat ka 55 biznese në total për një popullsi prej 6883 banorësh. Komuna me më pak biznese është komuna Kelmend për shkak të distancës nga qendra e rrethit. Niveli i kufizuar i zhvillimit të biznesit në Malësinë e Madhe vërehet si nga numri i përgjithshëm i bizneseve (283) ashtu dhe madhësia e vogël ose shumë e vogël e tyre me një numër pothuajse 1 person të punësuar ose të vetë punësuar.

Njësia e re vendore Malësi e Madhe do të ketë 283 biznese duke pasur një numër të shtuar jo vetëm për banorët e bashkisë Koplik por edhe për komunat e Malësisë së Madhe që do të bashkohen me bashkinë Koplik në njësinë e re vendore Malësi e Madhe.

Figura 22 Ndërveprimi ekonomik në zonën funksionale Malësi e Madhe




Burimi: MÇV Llogaritjet e autorëve

Bizneset ekzistuese, të cilat janë të fragmentarizuara në territore administrative të ndryshme, me krijimin e një NJQV do të funksionojnë brenda të njëjtës hapësirë territoriale administrative duke u rishpërndarë në mënyrë të tillë që të mund t'i ofrojnë shërbime dhe akses të gjithë komunitetit, edhe qytetarëve që ndodhen më larg qendrave funksionale. Njëkohësisht, bashkimi do prodhojë konkurrencë ndërmjet bizneseve, e cila do të reflektohet në rritjen e cilësisë dhe sasisë të prodhimit dhe shërbimit që ato ofrojnë.

Në kolonën e dytë të tabelës jepen të dhëna mbi numrin e bizneseve për 1000 banorë i njëjti dispropocion që cituam për totalin e bizneseve ekziston dhe për numrin e bizneseve për 1000 banorë. Bashkia Koplík si qendra e rrethit ka rreth 37 biznese për 1000 banorë, ndërkohë që komunat Qendër Malësi e Madhe dhe Kelmend kanë në territorin e tyre përkatësisht 4 biznese/1000 banorë dhe 3 biznese/1000 banorë. Ky dispropocion do të sfumohet pasi me bashkimin në një NJQV numri i bizneseve do të rishpërndahet për të gjitha njësitë vendore që do të bashkohen me Bashkinë Koplík duke na dhënë në NJQV të re me 9 biznese për 1000 banorë.

Figura 274 Totali i bizneseve dhe bizneset për 1000 banorë




Burimi: MÇV Llogaritjet e autorëve

Edhe treguesit e buxhetit (figura 24) do të ndryshojnë dukshëm, jo vetëm buxheti total i njësisë së re vendore, por edhe buxheti për banor. Nëse bashkia Koplík ka një buxhet prej 54 milion lekësh, komuna Kastrat ka një buxhet prej 113 milion lekësh, kjo për faktin edhe se komuna ka 6883 banorë. Ndërkohë që komuna Qendër Malësi e Madhe e ka buxhetin 13 milion lekë, i cili është totalisht i destinuar për të mbuluar shpenzimet e personelit dhe ato operative, ndërsa investimet janë pothuajse 0. Ndërsa buxheti i njësisë së re vendore Malësi e Madhe do të jetë 300 milion lekë duke u rritur në terma absolutë për të gjithë qytetarët e njësisë së re vendore. E njëjta situatë paraqitet edhe për buxhetin për banor, bashkia Koplík ka një buxhet rreth 14 460 lekë/banor, ndërsa komuna Kastrat ka një buxhet më të madh prej 16 420 lekësh/banor.

Të ardhurat nga buxheti i shtetit përbëjnë burimin kryesor të të ardhurave. Ato i tejkalojnë më shumë së dyfish të ardhurat vendore duke nxjerrë në pah varësinë e theksuar financiare të bashkive dhe komunave nga pushteti qendror.

Me bashkimin në një njësi të vetme vendore Malësi e Madhe do kemi një buxhet prej 9730 lekësh/banor duke reduktuar në maksimum pabarazitë e vëna re në situatën aktuale dhe duke garantuar një buxhet mesatar për çdo qytetar të njësisë së re vendore Malësi e Madhe.

Figura 275 Buxheti total dhe buxheti për banor i bashkisë Koplík/komunave dhe i njësisë së re vendore M. Madhe




Burimi: MÇV Llogaritjet e autorëve

Në rast se analizojmë të ardhurat dhe shpenzimet për banor të gjeneruara dhe shpenzuara nga njësitë vendore të Malësisë së Madhe, vëmë re të njëjtin fenomen të pabarazisë ndërmjet njësive vendore. Ajo çka lexojmë nga figura 12 është një rishpërndarje jo e barabartë e të ardhurave për banorë në njësi të ndryshme vendore. Bashkia Koplík shënon nivelin më të lartë për banorë me 4160 lekë e ndjekur nga komuna Shkrel me 3730 lekë për një popullsi prej 3520 banorësh. Komuna Gruemirë shënon nivelin më të ulët të të ardhurave për banor në 36 lekë. Nga bashkimi në një NJQV sigurohet një rishpërndarje më e drejtë e të ardhurave për banor për të gjithë banorët e njësisë së re vendore.

Pabarazitë e mësipërme mund t'i vërejmë tek shpenzimet/banor ku përfshihen shpenzimet operative (shpenzimet për shërbime) dhe shpenzime personeli. Bashkia Koplík shënon nivelin më të lartë të shpenzimeve 10 980 lekë për banorë. Mbas bashkisë Koplík vjen komuna Kastrat me 8430 shpenzime/banor, ndërsa komuna Qendër Malësi e Madhe shpenzon vetëm 1690 lekë/banor.

Nga bashkimi do mund të përfitojmë mesatarisht 5680 lekë shpenzime për banor (operative + personel) duke mundësuar një rishpërndarje të shpenzimeve për çdo banor të njësisë së re vendore Malësi e Madhe.

Figura 276 Të ardhurat dhe shpenzimet (operative+personel) për banor të bashkisë Koplík/komunave dhe të njësisë së re vendore M. Madhe




Burimi: MÇV Llogaritjet e autorëve

Në figurën 27 jepet shpërndarja e investimeve për të gjitha njësitë vendore të Malësisë së Madhe. Siç shikohet, njësitë vendore të Malësisë së Madhe kanë një rishpërndarje jo të barabartë të investimeve të kryera. Komuna Kastrat ka kryer investime në vlerën 55 000 lekë e ndjekur edhe nga komunat Shkrel, Gruemirë dhe bashkia Koplík. Ndërsa komuna me nivel më të ulët investimesh paraqitet komuna Qendër Malësi e Madhe. Pak më ndryshe paraqitet situata nëse shohim investimet për banor ku komunat Shkrel dhe Kastrat alokojnë respektivisht 7100 dhe 7990 lekë/banorë të ndjekura nga bashkia Koplík me 3480 lekë/banorë. Kjo vjen si pasojë e mundësive të ndryshme të njësisë vendore për të kryer investime me të ardhurat e tyre, por edhe nga skema e financimit të shpenzimeve kapitale të kryera nëpërmjet skemës së granteve konkurruese që në përgjithësi ka krijuar një pabarazi në shpërndarjen e tyre. Nëse analizojmë strukturën e investimeve vëmë re se njësitë vendore nuk kanë kryer investime në fushën e zhvillimit ekonomik vendor.

Çfarë do të ndodhë më investimet në zonën e re funksionale Malësi e Madhe? Në rast se bashkia Koplík dhe 5 komunat do të bashkoheshin në një njësi të vetme vendore, shumë prej funksioneve, të cilat përsëriten për çdo njësi vendore do të suprimohen duke reduktuar numrin e personelit për njësinë e re vendore. D.m.th. me zbatimin e kësaj skeme do të përfitonim përqendrimin e funksioneve administrative të komunave si prokurimi publik, planifikimi urban, shërbimet financiare, administrimi i taksave, etj. çka do të sillte një kursim të konsiderueshëm. Ndërkohë që do të eliminohen funksionet e përsëritura në administratën lokale të tilla si financierë, arkëtarë, nënkryetar bashkie/komune, sekretar të këshillit bashkiak, këshilltarë, etj. më një kursim prej afro 65% të shpenzimeve administrative (duke përfshirë kursimin nga përqendrimi i funksioneve+kursimin nga eliminimi i funksioneve të përsëritura). Gjithashtu një kursim tjetër administrativ afro 7,5 % i shpenzimeve operative do të vijë dhe nga kosto të mirëmbajtjes dhe kostove operative të administratës vendore, të cilat do të ulen si rezultat i reduktimit dhe përqendrimit të funksioneve të cituara më lart. Kjo do të ndikojë në shpenzimet për mbajtjen e administratës pra, shpenzimet e personelit do të ulen nga 101 000 lekë në 50 300 lekë duke rezultuar në një kursim të konsiderueshëm prej rreth 50 700 lekësh. Shpenzimet operative do të ulen nga 74 000 lekë në 69 800 lekë duke na dhënë një kursim prej 4200 lekë. Këto kursime do reflektohen në një rritje në investime prej 54 900 lekësh duke i rritur ato nga 125 000 lekë në 179 900 lekë.


Figura 26 Ndërveprimi ekonomik në zonën funksionale Malësi e Madhe



Burimi: MÇV Llogaritjet e autorëve

Të gjitha këto fonde të kursyera do të mund të përdoren për rritjen e cilësisë së shërbimeve ose do të mund të investohen në infrastrukturë, transport publik, apo zhvillim ekonomik duke nxitur në këtë mënyrë zhvillimin ekonomik dhe financiar të territorit si edhe thithjen e investimeve të huaja. Për efekt të analizës supozojmë se fondet e kursyera do të përdoren për rritjen e investimeve nga njësi e re vendore. Pra, në njësinë e re qendrore vendore të Malësisë së Madhe do të kemi një rritje të investimeve publike me rreth 54 900 lekë.


Figura 277 Investimet e bashkisë Koplík/komunave dhe të njësisë së re vendore M. Madhe



Burimi: MÇV Llogaritjet e autorëve

Gjithashtu nga bashkimi i bashkisë Koplík dhe komunave të Malësisë së Madhe në një NJQV të vetme do mund të ekuilibrohet dispropocioni në investime për banor duke rishpërndarë ato dhe duke përfituar 5,84 mijë lekë në NJQV (figura 28) e re administrative territoriale, në mënyrë që të rishpërndajmë shpenzimet kapitale për banor.

Figura 278 Investimet për banor të bashkisë Koplík/komunave dhe të njësisë së re vendore M. Madhe



Burimi: MÇV Llogaritjet e autorëve

Kursimi i argumentuar sa më sipër do kontribuonte fuqizimin e një NJQV të vetme dhe duke maksimizuar jo vetëm investimet në njësinë e re vendore si rezultat i rritjes së tyre, por edhe duke shpërndarë investimet në zona, të cilat gjenerojnë zhvillim ekonomik dhe punësim dhe jo duke i copëzuar e shpërndarë pa asnjë kriter siç ka ndodhur deri më tani. Kjo reformë do të ishte një katalizator i shpejtë që do t'i bënte këto zona më të favorshme për investim dhe më përfituese për investitorët.

Efektet në ofrimin e shërbimeve

Nga të dhënat e mundësuar për Malësinë e Madhe në bashkinë Koplík dhe komunat Gruemirë, Shkrel, Qendër Malësi e Madhe, Kastrat dhe Kelmend është prania e Ujësjetllësit Sh.A Malësia e Madhe që realizon furnizimin e tyre me ujë. Duke qenë se ekziston vetëm një ujësjetllës për të gjitha këto zona, furnizimi me ujë është me ndërprerje dhe jo i plotë. Me zmadhimin e territorit do të mundësohet një fuqizim i ujësjetllësit Sh.A, në mënyrë që furnizimi me ujë të jetë i plotë dhe i pandërprerë.


Për sa i përket infrastrukturës rrugore të Malësisë së Madhe, ajo nuk i shërben zhvillimit të territorit dhe bizneseve përkatëse e aq më pak interesave të banorëve. Duke qenë se prioriteti kryesor i formuluar nga ky rreth është infrastruktura rrugore, me bashkimin në një NJQV, do të justifikohet investimi më i madh në infrastrukturë. Një tjetër përmirësim infrastrukturor do të jetë edhe ndërtimi i ujësjetllësve të rinj dhe riparimi i atyre jo funksionale.

Figura 29. Harta e infrastrukturës në zonën funksionale Malësi e Madhe



Burimi: MÇV Llogaritjet e autorëve


Figura 279 Zhvendosja e banorëve të Malësisë së Madhe për në punë



Burimi: MÇV Llogaritjet e autorëve

Në Malësinë e Madhe përdorimi i transportit publik nga qytetarët për të shkuar në punë është në nivele të ulëta. Infrastruktura e fragmentuar ndërmjet bashkive e komunave bën që aksesin ndaj këtij transporti të jetë i ulët. Me krijimin e një njësie të vetme vendore, shërbimi i transportit publik do të projektohet e administrohet për të përfshirë interesin e shumë më tepër qytetarëve duke rritur kështu aksesin në zonat e largëta dhe duke i afruar qytetarët me qendrat funksionale.

Figura 280 Punësimi në Malësinë e Madhe



Burimi: MÇV Llogaritjet e autorëve

Me heqjen e kufijve ndërmjet komunave e bashkisë, infrastruktura rrugore dhe ajo e transportit nuk do të jenë më të fragmentuara për sa i përket menaxhimit dhe investimeve. Kjo do të sjellë rritje të aksesit në zonat më të largëta, përmirësim të cilësisë për transportin publik e rrjedhimisht rritje të mobilitetit e mundësisë për punësim në zonat funksionale.

Përfundime

Ulje të ngarkesës mesatare të administratës vendore për 1000 banorë nga 32,17 aktualisht në 16,01 punonjës për 1000 banorë;

Reduktim të shpenzimeve administrative më 155 milion lekë (personeli dhe operative) dhe uljen e këtyre shpenzimeve për banorë në masën 58% nga 8,9 mijë lekë në 3,8 mijë lekë në njësinë e re vendore;

Mirë administrimi i burimeve do të sjellë shtim në masën 31% të fondit të investimeve totale në të dhjetë NJQV nga 125 milion lekë në 179 milion lekë;

Buxheti i investimeve për banor do të rritet nga 4,06 mijë lekë në 5,84 mijë lekë;

Zona funksionale Pukë


Pamë që rrethi i Shkodrës bënte pjesë kryesisht në modelin policentrik të zonave funksionale me një zonë funksionale përtej kufirit rajonal. Ndërsa rrethi i Pukës dhe rrethi Malësi e Madhe janë të orientuara drejt modelit koncentrik të zonave funksionale. Kufijtë e zonës funksionale të Pukës përputhen plotësisht me kufijtë e rrethit duke pasur si qendër të zonës funksionale bashkinë Pukë.

Ndërveprimet përcaktuese të zonës funksionale të Pukës janë konsumi dhe qasja në shërbime, por ato vihen re edhe në punësim, arsimim si dhe shërbim shëndetësor. Ndërkohë që bashkia Fushë-Arrëz është gjithashtu një qendër relativisht e rëndësishme për punësim për shkak të vendndodhjes së minierave dhe fabrikave, por nuk është aspak qendër tradicionale apo ofruese e shërbimeve.

Puka është një rajon i pasur me pasuri nëntokësore minerare si, kromi, azbesti, bakri, kaulina etj., por minierat pas viteve '90 e kanë ndërprerë aktivitetin e tyre në Pukë duke rritur ndjeshëm papunësinë. Një nga problemet shqetësuese në Pukë mbetet papunësia, ndërkohë që mbyllja e shumicës së industrive që operonin në Pukë i ka ulur në minimum mundësitë e punësimit. Ndërtimi i rrugës së re e ka lënë Pukën larg rrjetit kombëtar rrugor.

Puka si zonë funksionale paraqet mundësi për të qenë destinacion turistik dhe kjo mund të arrihet me ndërhyrje të të gjithë grupeve të interesit, pushtetit qendror, me përpjekje të vazhdueshme të pushtetit vendor në bashkëpunim me biznesin e zonës dhe shoqërinë civile. Terreni malor i Pukës është shumë i përshtatshëm për zhvillimin e turizmit malor sepse brenda hapësirës gjeografike të Pukës gjenden pasuri dhe burime natyrore me vlera të mëdha ekonomike, kryesisht pyje, bimë mjekësore, pasuri nëntokësore minerare, etj. Një nga modelet kryesore në procesin e zhvillimit të infrastrukturës turistike duke ndjekur eksperiencën të ngjashme të shteteve fqinjë është bashkëpunimi i bashkisë dhe komunave.

Figura 281 Zona funksionale Pukë



Efektet demografike

Tabela 143 Të dhëna sociale dhe demografike

Njësitë e qeverisjes vendore (2012)	Shkolla të mesme	Shkolla 9-vjeçare	Kopsht e	Qendra shëndetësore dhe ambulanca	Qendra kulturore	Qendra sociale	Qendra sportive	Popullsia	Sipërfaqja km ²	Dendësia banorë/km ²
Bashkia Fushë-Arrëz	1	3	3	4	1	0	0	2513	31,06	80,91
Bashkia Pukë	1	1	3	2	1	1	1	3607	40,21	89,70
Komuna Blerim	0	6	2	4	0	0	1	913	102,51	8,91
Komuna Fierze-Pukë	0	10	5	6	0	0	0	1302	81,19	16,04
Komuna Gjegjan	2	10	5	11	0	1	2	2846	164,61	17,29
Komuna Iballë	1	11	2	2	0	0	0	1129	128,02	8,82
Komuna Qaf-Mali	0	6	2	5	0	0	0	1548	143,13	10,82
Komuna Qelëz	1	6	4	3	1	0	0	1761	63,34	27,80
Komuna Qerret	1	6	4	4	1	0	0	1498	230,71	6,49
Komuna Rrapë	0	7	4	4	0	0	2	1357	48,73	27,85
Totali	7	66	34	45	4	2	6	18 474	1033,51	17,88
Njësia e re vendore (Pukë)	7	66	34	45	4	2	6	18 474	1033,51	17,88

Burimi: MÇV Llogaritjet e autorëve


Shpërndarja e shkollave të sistemit para universitar është në një korrelacion të çrregullt për shkollat 9-vjeçare në lidhje me popullsinë. Nëse kemi 1 shkollë 9-vjeçare për bashkinë Pukë me një popullsi 3607 banorë kemi po 3 shkolla 9-vjeçare në bashkinë Fushë Arrëz me popullsi 2513 banorë. Ndërkohë që në komunat Fierzë dhe Gjegjan me popullsi më të ulët respektivisht me 1302 banorë dhe 2846 banorë kanë nga 10 shkolla 9-vjeçare. Njësia e re

vendore do të ketë 66 shkolla 9-vjeçare për 18 474 banorë duke synuar një shpërndarje më të mirë të infrastrukturës shkollore që nuk garantohet në sistemin e fragmentuar të qeverisjes vendore. E njëjtë paraqitet situata për shkollat e mesme, ndërsa bashkia Pukë dhe bashkia Fushë Arrëz kanë secila nga 1 shkollë të mesme. Komunat të cilat nuk kanë fare shkollë të mesme janë 4. Bashkimi në një njësi të vetme vendore do të rrisë numrin e shkollave të mesme në 7 duke ofruar mundësinë e rritjes së cilësisë e kontrollit më të mirë nga pushteti vendor.

E njëjta situatë do të jetë edhe me kopshtet dhe qendrat shëndetësore. Njësia e re vendore do të ketë 34 kopshte dhe 45 qendra shëndetësore duke shtuar aksesin e të gjithë banorëve të zonës dhe jo vetëm aty ku ato janë si pasojë e sistemit të fragmentuar.

Tabela 8 tregon qartazi mungesën e aksesit social-kulturor-sportiv të disa komunave. Ka mungesë të qendrave dhe aktiviteteve për argëtim, sporte për turistët, qendra për fëmijët, lojëra kompjuterike dhe internet me kosto të ulët.

Figura 32. Shpërndarja e shkollave në zonën funksionale Pukë



Burimi: MÇV Llogaritjet e autorëve

Zbutja e nivelit të papunësisë në Pukë mbetet një ndër sfidat më kryesore për autoritetet vendore, pasi papunësia kthehet në një faktor nxitës për largimin e popullsisë nga Puka drejt zonave të tjera me mundësi më të mira punësimi apo drejt emigracionit. Emigracioni është veçanërisht i përhapur në meshkujt e moshës së re. Puka ka një numër popullsie relativisht të

vogël prej 3607 banorësh. Rreth 27% e popullsisë së rrethit jetojnë në qytet, ndërsa në fshat jeton rreth 73%.

Gjatë periudhës 21-vjeçare nga viti 1990 deri 2011, ndryshimet demografike në Pukë kanë qenë relativisht të larta. Puka është ndër zonat që kanë humbur popullsi si pasojë e lëvizjeve të brendshme migratore pas vitit 1990. Faktorët kryesorë që kontribuojnë në këto zhvillime demografike janë të lidhura me tranzicionin ekonomik, mbylljen e shumë ndërmarrjeve në pronësi shtetërore dhe papunësisë që e shoqëroi, infrastruktura e transportit dhe e komunikimit jashtëzakonisht e dobët, terrenit në përgjithësi të vështirë, kushteve të vështira klimatike për zhvillimin e një bujqësie intensive, si dhe shfrytëzimit pa kriter të pyjeve.

Mund të nxjerrim si përfundim se potencialet kryesore të zonës së Pukës janë industria pyjore, industria minerare dhe turizmi malor dhe argëtues. Ekzistenca e zonave të mëdha pyjore përbën një avantazh në nxitjen e këtyre aktiviteteve, të cilat me bashkimin në një NJQV të vetme do mund të kenë interes nga investitorë e bashkëpunime publike dhe private.

Efektet ekonomike dhe financiare

Tabela 9 Të dhëna ekonomike dhe financiare për bashkinë Pukë/komunat dhe për njësinë e re vendore Pukë (në 000 lek)

Njësitë e qeverisjes vendore (2012)	Popullsia Censu s 2011	Totali i bizneseve	Biznese për 1000 banorë	Të ardhurat veta	Shpenzime personale	Shpenzime operative	Investime	Investime për banor	Buxheti total	Buxheti për banor	Të ardhurat për banor	Shpenzime për banor (op+personel)
Bashkia Fushë-Arrëz	2513	84	33	9158	29 000	9000	8000	3,18	46 000	18,30	3,64	15,12
Bashkia Pukë	3607	145	40	11 716	29 000	9000	3000	0,83	41 000	11,37	3,25	10,54
Komuna Blerim	913	4	4	95	8000	8000	39 000	42,72	55 000	60,24	0,10	17,52
Komuna Fierzë-Pukë	1302	5	4	511	16 000	5000	17 000	13,06	38 000	29,19	0,39	16,13
Komuna Gjegjan	2846	20	7	2212	2000	2000	3000	1,05	7000	2,46	0,78	1,41
Komuna Iballë	1129	3	3	369	8000	7000	6000	5,31	21 000	18,60	0,33	13,29
Komuna Qaf-Mali	1548	16	10	3309	16 000	9000	9000	5,81	34 000	21,96	2,14	16,15
Komuna Qelëz	1761	9	5	572	2000	1000	3000	1,70	6000	3,41	0,32	1,70
Komuna Qerret	1498	4	3	3014	7000	6000	7000	4,67	20 000	13,35	2,01	8,68
Komuna Rrapë	1357	4	3	127	10 000	9000	8000	5,90	27 000	19,90	0,09	14,00
Bashkitë dhe Komunat	18 474	294	16	31 083	127 000	65 000	103 000	5,58	295 000	15,97	1,68	10,39
Nj.v. e re (Pukë)	18 474	294	16		63 300	55 925	103 000	9,51	295 000	15,97	1,68	6,45

Burimi: MÇV Llogaritjet e autorëve

Mungesa e zhvillimit të biznesit privat, kryesisht të atij prodhues evidentohet si problem kryesor. Niveli i kufizuar i zhvillimit të biznesit në Pukë vërehet si nga numri i përgjithshëm i bizneseve (145) ashtu edhe nga madhësia e vogël ose shumë e vogël e tyre me një numër pothuajse 1 person të punësuar ose të vetëpunësuar.

Numri i të papunëve në Pukë vlerësohet në nivel më të lartë se mesatarja e vendit. Sot, në qytetin e Pukës janë të regjistruar mbi 558 persona pa punë.


Mungesë të theksuar biznesi vëmë re edhe në bashkinë Fushë-Arrëz me 84 biznese në total. Sigurisht që nga kjo mungesë në biznese nuk përjashtohen as komunat e zonës funksionale Pukë duke llogaritur komunat Blerim me 4 biznese në total, Iballë me 3 biznese në total dhe Rrapë me 4 biznese në total. Ajo që vihet re kryesisht në bizneset lokale është fakti së punonjësit e tyre kanë mungesa të njohurive profesionale dhe trajnimeve që pengojnë në krijimin e avantazheve në treg e turizëm.

Me bashkimin në një NJQV të komunave dhe bashkive 294 biznese do mund të zhvillonin aktivitetin e tyre në një mjedis më të favorshëm për të rritur punësimin dhe produktivitetin.

Nga leximi i figurës 19 arrijmë të nxjerrim në pah edhe mungesën e bizneseve/1000 banorë, ku vendin me numër më të vogël të tyre e mbajnë komunat Qerret dhe Rrapë me nga 3 biznese/1000 banorë ndërsa bashkia Pukë numëron 40 biznese/1000 banorë dhe bashkia Fushë-Arrëz me 33 biznese/1000 banorë.


Mungesa e zhvillimit të biznesit privat dhe diversifikimit të llojeve të tij evidentohet si çështje kryesore, me gjithë rritjen e lehtë prej 7% në vit e numrit të bizneseve përgjatë viteve të fundit.

Figura 33. Harta e ndërveprimit ekonomik Zona funksionale Pukë



Burimi: MÇV Llogaritjet e autorëve

Figura 282 Totali i bizneseve dhe bizneset për 1000 banorë



Burimi: MÇV Llogaritjet e autorëve

Ajo që vihet re nga figura 34 është mungesa e kapaciteteve të mjaftueshme të bashkisë Pukë, bashkisë Fushë-Arrëz dhe komunave për të nxitur aktivitete ekonomike brenda territorit të tyre administrativ.

Gjendja financiare e tyre evidentohet si një ndër pikat më të dobëta të funksionimit të institucioneve të bashkive dhe komunave. Buxheti i bashkisë dhe komunave rezulton mjaft disproporcional ndërmjet dy komponentëve kryesorë të tij.


Të ardhurat nga buxheti i shtetit përbëjnë burimin kryesor të të ardhurave. Ato i tejkalojnë më shumë se dyfish të ardhurat vendore duke nxjerr në pah varësinë e theksuar financiare të bashkive dhe komunave nga pushteti qendror.

Shumica e buxhetit të bashkisë Pukë, bashkisë Fushë-Arrëz dhe komunave mjafton për të përballuar vetëm pagat e punonjësve të administratës dhe për mirëmbajtje infrastrukture.

Kontributi i shtetit është i paparashikueshëm dhe i kushtëzuar duke ulur aftësinë e parashikimit të të ardhurave nga ana e bashkive. Gjithashtu, burimet e pamjaftueshëm financiarë lejojnë që bashkitë të përqendrohen vetëm në nevojat më të ngutshme pa mundur të kenë një orientim strategjik për të zbatuar një politikë financiare publike efikase dhe lehtësuese për bizneset.

Me bashkimin në një NJQV do të reduktohet ky disproporcion ku buxheti total prej 295 milion lekësh do shpërndahet në një buxhet/banor 15 970 lekë duke ulur pabarazinë e vënë re.

Figura 34 Buxheti total dhe buxheti për banor i bashkisë Pukë/komunave dhe i njësisë së re vendore Pukë



Burimi: MÇV Llogaritjet e autorëve

Në rast se analizojmë të ardhurat dhe shpenzimet për banor të gjeneruara dhe shpenzuara nga njësitë vendore të rrethit Pukë vëmë re se niveli i të ardhurave në bashkinë Pukë është në nivele të tilla të ulëta që nuk përballon nevojat për investime që ka kjo bashki në infrastruktura dhe shërbime. E njëjta situatë është edhe për komunat e këtij rrethi.

Vihet re një rishpërndarje jo e barabartë e të ardhurave për banorë në njësi të ndryshme vendore. Bashkia Fushë-Arrëz shënon nivelin më të lartë për banorë me 3640 lekë e ndjekur nga bashkia Puke me 3250 lekë dhe komuna Qafë Mali me 2140 lekë. Komuna Rrapë shënon nivelin më të ulët të të ardhurave për banor me 90 lekë.


Nga bashkimi i njësisve vendore në njësinë e re vendore Pukë do të kemi 1680 lekë të ardhura/banor duke siguruar një rishpërndarje më të drejtë të të ardhurave për të gjithë banorët e njësisë së re vendore.

Pabarazitë e mësipërme mund t'i vërejmë për sa i përket shpenzimeve/banor ku përfshihen shpenzimet operative (shpenzimet për shërbime) dhe shpenzime personeli. Komuna Blerim shënon nivelin më të lartë të shpenzimeve 17 520 lekë për banor e ndjekur nga komuna Qaf Mali me 16 150 lekë/banor, ndërsa bashkia Pukë shpenzon për çdo banor të saj vetëm 10 540 lekë edhe pse ka popullsinë më të madhe se të gjitha njësitë e tjera vendore.

Nga bashkimi do mund të përfitojmë mesatarisht 1,680 lekë shpenzime për banor (operative + personel), duke rishpërndarë shpenzimet e larta të disa komunave për të mundur një rishpërndarje të shpenzimeve për çdo banor të njësisë së re vendore Puke. Eliminimi i fragmentimit dhe bashkimi në një njësi të re vendore do të rezultojë në një rishpërndarje më të

mirë të shpenzimeve për shërbime publike lokale për të gjithë qytetarët e njësisë së re vendore Pukë.

Figura 283 Të ardhurat dhe shpenzimet (operative+personel) për banor të bashkisë Pukë/ komunave dhe të njësisë së re vendore Pukë



Burimi: MÇV Llogaritjet e autorëve


Në figurën 36 jepet shpërndarja e investimeve për të gjitha njësitë vendore të rrethit Pukë. Siç shikohet, njësitë vendore të rrethit Pukë kanë një rishpërndarje jo të barabartë të investimeve të kryera. Ndryshe nga rrethet e tjera, ku investimet më të larta janë kryer nga bashkitë, në këtë rreth investimet më të larta janë kryer nga komuna Blerim në vlerën 39 000 lekë e ndjekur edhe nga komuna Fierzë Pukë me 17 000 lekë. Ndërsa bashkitë Pukë, Fushë-Arrëz dhe komunat e tjera paraqiten në nivel shumë të ulët investimesh. E njëjta situatë paraqitet nëse shohim investimet për banor ku bashkia Pukë edhe pse ka popullsinë më të madhe ka nivelin e investimeve/banor më të ulët në të gjithë rrethin Pukë, përkatësisht me 83 lekë. Ndërsa nivelin më të lartë të investimeve/banor e mban komuna Blerim me 42 720 lekë e ndjekur nga komuna Fierzë Pukë me 13 060 lekë/banor. Nëse analizojmë strukturën e investimeve vëmë re se njësitë vendore që nuk kanë kryer investime në fushën e zhvillimit ekonomik vendor kanë ndikuar negativisht në zhvillimin e bizneseve duke mos i mbështetur dhe duke mos i krijuar atyre kushtet e përshtatshme për zhvillim.

Çfarë do të ndodhë me investimet në zonën e re funksionale Pukë? Në rast së bashkia Pukë, bashkia Fushë-Arrëz dhe 8 komunat do të bashkoheshin në një njësi të vetme vendore, shumë prej funksioneve të cilat përsëriten për çdo njësi vendor do të suprimohen dhe do të reduktojnë numrin e personelit për njësinë e re vendore. Pra, me zbatimin e kësaj skeme do të përfitonim përqendrimin e funksioneve administrative të komunave si prokurimi publik, planifikimi urban, shërbimet financiare, administrimi i taksave, etj. çka do të sillte një kursim të konsiderueshëm. Ndërkohë që do të eliminohen funksionet e përsëritura në administratën lokale të tilla si financierë, arkëtarë, nënkryetar bashkie/komune, sekretar të këshillit bashkiak, këshilltarë, etj., me një kursim prej afro 65% të shpenzimeve administrative (duke përfshirë kursimin nga përqendrimi i funksioneve+kursimin nga eliminimi i funksioneve të përsëritura). Gjithashtu një kursim tjetër administrativ afro 7,5 % i shpenzimeve operative do të vijë dhe nga kosto e mirëmbajtjes dhe kosto operative administrative, të cilat do të ulen si rezultat i reduktimit dhe përqendrimit të funksioneve të cituara më lart. Kjo do të ndikojë në shpenzimet për mbajtjen e administratës pra, shpenzimet e personelit do të ulen nga 127 000 lekë në 63 300 lekë duke rezultuar në një kursim të konsiderueshëm prej rreth 63 700 lekësh.

Shpenzimet operative do të ulen nga 65 000 lekë në 55 92 lekë duke na dhënë një kursim prej 9075 lekësh. Këto kursime do të reflektohen në një rritje në investime prej 72 775 lekësh.

Të gjitha këto fonde të kursyera do të mund të përdoren për rritjen e cilësisë së shërbimeve ose do të mund të investohen në infrastrukturë, transport publik, apo zhvillim ekonomik duke nxitur në këtë mënyrë zhvillimin ekonomik dhe financiar të territorit si edhe thithjen e investimeve të huaja. Për efekt të analizës supozojmë se fondet e kursyera do të përdoren për rritjen e investimeve nga njësitë e re vendore. Pra, në njësinë e re qendrore vendore të Pukës do të kemi një rritje të investimeve publike me rreth 72 775 lekë si pasojë e reduktimit të shpenzimeve administrative dhe kursimit që përfitohet nga suprimimi i zyrave administrative dhe funksioneve të përsëritura.


Figura 36. Investimet e bashkisë Pukë/komunave dhe i njësisë së re vendore Pukë



Burimi: MÇV Llogaritjet e autorëve

Gjithashtu nga bashkimi i bashkive dhe komunave të rrethit Pukë në një NJQV të vetme do mund të ekuilibrohet dispropocioni në investime për banor duke rishpërndarë ato dhe duke përfituar 9510 lekë në NJQV të re administrative-territoriale, në mënyrë që të rishpërndajmë shpenzimet kapitale për banor.

Figura 37. Investimet për banor të bashkisë Pukë/komunave dhe të njësisë së re vendore Pukë



Burimi: MÇV Llogaritjet e autorëve

Bashkimi sa më sipër, do kontribuonte në fuqizimin e NJQV së vetme duke maksimizuar jo vetëm investimet në njësinë e re vendore si rezultat i rritjes së tyre por edhe duke shpërndarë investimet në zona të cilat gjenerojnë zhvillim ekonomik dhe punësim. Kjo reformë do të ishte një katalizator i shpejtë që do t'i bënte këto zona më të favorshme për investime dhe më përfituese për investitorët.

Efektet në ofrimin e shërbimeve

Në bashkinë Pukë ujësjellësi është Sh.A, ndërsa në komunat e tjera ujësjellësi është komunal dhe pjesërisht i pranishëm. Me zmadhimin e territorit do të mundësohet një përfshirje e ujësjellësve komunalë në Sh.A në mënyrë që furnizimi me ujë të jetë i plotë dhe i pandërprerë në të gjithë zonën duke marrë parasysh dhe relievin gjeografik të saj për t'i mundësuar një shërbim efikas dhe cilësor të gjithë banorëve.

Edhe në bashkinë Fushë-Arrëz ujësjellësi është Sh.A, ndërsa në komunat e tjera është komunal dhe pjesërisht i pranishëm. Vëmë re së kohëzgjatja e furnizimit me ujë është e reduktuar. Me zmadhimin e territorit do të mundësohet furnizimi me ujë edhe në zonat në të cilat nuk ekziston ose ekziston pjesërisht prania e ujësjellësit.

Figura 38. Rrjeti infrastrukturës Zona Funktionale Pukë




Burimi: MÇV Llogaritjet e autorëve

Në Pukë gjatë stinës së dimrit raportohet vazhdimisht për bllokime të rrugëve komunale si komuna Qerret, Rrapë, Qafë Mali dhe Iballë e kjo ndodh jo vetëm për shkak të reshjeve të shumta të dëborës, por edhe nga gjendja jo e mirë e rrugëve lidhëse. Kjo gjendje do mund të rishikohet përsëri me bashkimin në një NJQV të vetme duke i dhënë përparësi jo vetëm

rindërtimit të tyre, por edhe sistemimit me barriera duke iu përgjigjur standardeve evropiane. Rrugët, përveç vlerave turistike duhet të kthehen në rrugë ku banorët duhet të lëvizin për angazhime të përditshme.


Figura 284 Zhvendosjet e banorëve të rrethit Pukë



Burimi: MÇV Llogaritjet e autorëve

Infrastruktura e fragmentuar ndërmjet bashkive e komunave bën që aksesin ndaj transportit me furgona e autobusë të jetë i ulët. Me krijimin e një njësie të vetme vendore, shërbimi i transportit publik do të projektohet e administrohet për të përfshirë interesin e shumë më tepër qytetarëve, duke rritur cilësinë dhe kontrollin e transportit në zonat e largëta dhe duke i afruar qytetarët me zonat funksionale.

Figura 40 Punësimi në rrethin Pukë



Burimi: MÇV Llogaritjet e autorëve

Përfundime

Përfundimet për zonën e rrethit Pukë janë llogaritur në variantin me dy njësi funksionale më vete, përkatësisht ZF Pukë dhe ZF Fushë-Arrëz.

1. ZF Pukë (Bashkia Pukë dhe komunat Gjegjan, Qelez, Qerret, Rrape)

ZF Pukë e përbërë nga 5 njësi ekzistuese, ka popullsi prej 11,069 banorë, nga mesatarisht 2,214 banorë për njësi aktualisht;

Reduktim I shpenzimeve administrative të njësisë me rreth 16,5 milionë lekë në vit (shpenzime paga dhe operative);

Ulja e shpenzimeve të personelit për banor në masën 30%, nga 4,517 në 3,189 lekë;

Mirëadministrimi I burimeve financiare mund të sjellë rritje të investimeve në masën 70%, ose nga 24 milionë lekë, në 40.5 milionë lekë në vit;

Investimet për banor mund të rriten nga 2,168 lekë në 3,659 lekë në njësinë e re;

Bashkimi në një zonë funksionale mund të sigurojë rishpërndarje më të mirë të të ardhurave, pa llogaritur efektet e eficiencës së rritur në menaxhimin e të ardhurave, mesatarisht ZF e re do të realizonte 1,478 lekë për frymë të ardhura të veta; ose 22% më shumë se mesatarja ekzistuese e të ardhurave për frymë në NJQV aktuale (1,211)dhe pothuaj dyfish sa mediani i të ardhurave për frymë në njësitë aktuale (754).

2. Fushë Arrëz (Bashkia Fushe-Arrez, Komuna Fierze, Blerim, Qafe-Mali, Iballe)

ZF Fushë-Arrëz e përbërë nga 5 njësi ekzistuese, ka popullsi prej 7,405 banorë, nga mesatarisht 1,481 banorë për njësi aktualisht;

Reduktim I shpenzimeve administrative të njësisë me rreth 36,5 milionë lekë në vit (shpenzime paga dhe operative);

Ulja e shpenzimeve të personelit për banor në masën 44%, nga 10,398 në 5,861 lekë

Mirëadministrimi i burimeve financiare mund të sjellë rritje të investimeve në masën 50%, ose nga 79 milionë lekë, në 115,5 milionë lekë në vit;

Investimet për banor mund të rriten nga 10,668 lekë në 15,598 lekë në njësinë e re;


Bashkimi në një zonë funksionale mund të sigurojë rishpërndarje më të mirë të të ardhurave, pa llogaritur efektet e eficiencës së rritur në menaxhimin e të ardhurave: mesatarisht ZF e re do të realizonte 1,784 lekë për frymë të ardhura të veta; ose 37% më shumë se mesatarja ekzistuese e të ardhurave për frymë në NJQV aktuale (1,298)dhe 5 herë më shumë se mediani i të ardhurave të veta për frymë në njësitë aktuale (382).

QARKU TIRANË

Profili i qarkut Tiranë

Qarku i Tiranës përbëhet nga 29 njësi të qeverisjes vendore në dy rrethe: rrethi i Kavajës (10 njësi, qendër Kavajë) dhe rrethi i Tiranës (19 njësi, qendër Tiranë). Popullsia e qarkut të Tiranës ishte 749 395 banorë në vitin 2011, ndër të cilët pothuajse 56% (418 495 banorë) jetojnë në qytetin e Tiranës dhe 91% jetojnë në rrethin e Tiranës. Qyteti i dytë më i madh në qark është bashkia Kamëz me rreth 66 mijë banorë, e cila është edhe një nga tetë bashkitë më të mëdha të vendit; por ka edhe njësi të tjera me popullsi të madhe për standardet e sotme, si Kashari (43 mijë), Paskuqani (37 mijë), Farka (22 mijë) dhe Dajti (20 mijë), (INSTAT, Census 2011). Kavaja, si qendër e rrethit të Kavajës është relativisht e vogël në popullsi, me rreth 20 mijë banorë.


Figura 1. NJQV-të në qarkun e Tiranës sipas popullsisë



Burimi: INSTAT, Census 2011; Llogaritjet e autorëve

Qarku i Tiranës ka pasur një humbje neto të popullsisë prej rreth 25% ose mbi 246 mijë banorë krahasuar me të dhënat zyrtare të Regjistrit të Gjendjes Civile të vitit 2011. Sipas të dhënave zyrtare të RGJC-së në janar 2012 në qarkun e Tiranës ishin të regjistruar 995 786 banorë, me përqendrim të ngjashëm me atë të raportuar nga Census-i 2011 (pra 62% në bashkinë Tiranë dhe 88% në rrethin e Tiranës). Megjithatë, qarku i Tiranës është i vetmi, krahas Durrësit, në vend që ka regjistruar rritje të popullsisë në krahasim me Census-in e vitit 2001, me 2,1%.

Figura 2. Ndryshimi i popullsisë gjatë viteve 2001 – 2011



Burimi: INSTAT, Census 2001; Census 2011; Llogaritjet e autorëve

Popullsia e qarkut Tiranë përbën rreth 32,4% të popullsisë së vendit, referuar të dhënave të Census-it 2011 dhe popullsia mesatare për njësi të qeverisjes vendore në këtë qark rezulton 25 840 banorë/NJQV ose mbi trefish më e lartë se mesatarja kombëtare prej 8016 banorë/NJQV. Kjo mesatare rritet ndjeshëm për shkak të përqendrimit të madh të popullsisë në qendrat urbane dhe periferike në rrethin e Tiranës, ku madhësia mesatare e njësisë është pothuaj 15 mijë banorë pa llogaritur qytetin e Tiranës. Njësitë e rrethit të Kavajës janë më të vogla, me një mesatare prej 6224 banorësh ose 22% më të vogël se mesatarja kombëtare.

Tabela 1. Klasifikimi i NJQV-ve të qarkut Tiranë sipas numrit të popullsisë krahasuar me shifrat në nivel vendi

Klasifikimi i NJQV-ve sipas numrit të popullsisë	Tirana	Shqipëria
Popullsia	27%	100%
Popullsia Mesatare për NJQV	25 840	8016
< 2000	3,4%	27,6%
2000-5000	34,5%	34,6%
5000-10 000	34,5%	26,3%
10 000-20 000	3,4%	6,7%
20 000-30 000	10,3%	1,6%
30 000-50 000	6,9%	1,1%
50 000-100 000	3,4%	1,6%
100 000-200 000	0,0%	0,3%
> 200 000	3,4%	0,3%

Burimi: INSTAT, Census 2011; Llogaritjet e autorëve

Dendësia mesatare e popullsisë është 830 banorë/km², krahasuar me 97,4 banorë/km² në nivel vendi. Dendësinë më të madhe e ka natyrisht Tirana, me mbi 10 mijë banorë për km²; por dendësi mjaft të lartë kanë edhe qendra si Kamza (2697 banorë/km²) dhe Paskuqani (3013 banorë/km²); apo Kavaja (2531 banorë/km²). Megjithatë, gjysma e njësive të qarkut kanë dendësi më të ulët se 127 banorë/km².

Propozimi i zonave funksionale në qarkun Tiranë


Duke iu referuar përcaktimit të zonës funksionale (ZF) sipas kritereve të miratuara nga Komisioni Parlamentar për Reformën Territoriale Administrative (KPRTA) – “një hapësirë territoriale ku ka një ndërveprim të dendur dhe të shpeshtë mes banorëve dhe institucioneve për qëllime ekonomike, sociale, zhvillimore dhe kulturore” – më poshtë do të analizojmë pikërisht këto forma të ndërveprimit për të identifikuar zonat funksionale në qarkun e Tiranës.

Ndërveprimi institucional në qarkun Tiranë

Sot në Shqipëri si rudiment i organizimit më të hershëm të shtetit dhe qeverisjes, qendrat e rretheve janë përqendrimet kryesore të institucioneve qendrore (kryesisht ministrive të linjës) në nivelin më pranë qytetarit. Në qendrat e rretheve vendosen zyrat arsimore, zyrat e punësimit, drejtoritë shëndetësore rajonale, drejtoritë e shërbimit pyjor, gjykata e rrethit gjyqësor, prokuroria dhe degët e tatimeve. Në disa prej qendrave të rrethit janë vendosur dhe një sërë institucionesh sociale, shëndetësore dhe arsimore: shtëpitë e të moshuarve, shtëpitë e foshnjës, qendrat e formimit profesional, qendrat e zhvillimit, etj.

Kjo është ndër arsyt kryesore që bën që qendrat e rretheve të shndërrohen në pika kontakti për sa i përket ndërveprimit institucional (pra të institucioneve me njëra tjetrën) por njëkohësisht dhe të qytetarit me institucionet. Bizneset po ashtu duket se preferojnë të vendosen në qendrat e rretheve po për të njëjtën arsye; praninë e institucioneve e cila shoqërohet njëkohësisht me kapacitete më të mira njerëzore, cilësi më të lartë shërbimi dhe mundësi më të mira zgjedhjeje për sa i përket fushës së aktivitetit.

Figura 3. Shpërndarja e institucioneve dhe agjencive qendrore dhe ndërveprimi institucional në qarkun e Tiranës



Burimi: MÇV; Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve

Institucionet që kryejnë aktivitetin dhe janë vendosur në qendrën e qarkut janë: ministrinë dhe agjencitë qendrore; Drejtoria e Bujqësisë; Bordi i Kullimit; Drejtoria Rajonale AKU; Drejtoria Shëndetësore Rajonale; Drejtoria e Arsimit; Drejtoria Rajonale Punësimit; Zyra e Kujdesit Social, Inspektorati Shtetëror i Punës; Drejtoria e Shërbimit Pyjor; Gjykata e Apelit; Prokuroria e Apelit, Drejtoria e Policisë, SHISH; Dega e Thesarit, Dega e Tatimeve Rajonale.


Pikërisht për këtë arsye, duke iu referuar ndërveprimit institucional, përqendrimit të popullsisë dhe bizneseve si dhe ndërveprimit mes këtyre të fundit, në qarkun e Tiranës identifikojmë dy zona funksionale kryesore: atë me qendër Tiranën dhe atë me qendër Kavajën. Pranë Tiranës, me qendër Kamzën tenton të krijohet një tjetër zonë e vogël funksionale si rezultat kryesisht i ndërveprimit mes banorëve dhe përqendrimit të bizneseve.

Ndërveprimi ekonomik në qarkun Tiranë

Do ta vlerësojmë nëpërmjet lëvizjeve për punësim: shërbimet, partneritetet, rrjeti i infrastrukturave, zinxhiri i vlerave (bizneset), etj. – dendësia e popullsisë; shpeshësia e udhëtimit për në punë; përqendrimi i bizneseve dhe diversiteti i aktiviteteve, potenciali i zhvillimit ekonomik; cilësia e jetës dhe shërbimet.

Le të shikojmë përqendrimin e bizneseve dhe llojin e aktiviteteve kryesore të biznesit.

Figura 4. Përqendrimi i bizneseve dhe lloji i aktiviteteve në qarkun Tiranë




Burimi: INSTAT 2012; Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve

Duke iu referuar përqendrimin të bizneseve dhe shumëllojshmërisë së aktivitetit të tyre (i cili indirekt dëshmon për nivel më të lartë të shërbimeve), në qarkun e Tiranës sërisht identifikohen qartë dy zona funksionale: ajo me qendër Tiranën dhe ajo me qendër Kavajën. Veç këtyre dy qendrave, lexojmë një tjetër zonë që tenton të krijohet mes Vorës dhe Kamzës.

Për të qartësuar me tej zonat funksionale, le të shikojmë drejtimet kryesore të lëvizjes së të punësuarve brenda qarkut të Tiranës.

Figura 5. Përqendrimi i popullsisë dhe drejtimet kryesore të lëvizjes së të punësuarave në qarkun e Tiranës




Burimi: INSTAT, Census 2011; Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve

Përsëri konfirmohen zonat funksionale me qendër Tiranën dhe Kavajën, por njëkohësisht lexohen tendencat për krijimin e zonave të tjera funksionale më të vogla me qendër përkatësisht Kamzën, Vorën dhe Rrogozhinën.

Aksesi në shërbime dhe cilësia e jetës në qarkun Tiranë

Një tjetër element që vlerësojmë për të përcaktuar zonat funksionale në qarkun e Tiranës është përqendrimi i shërbimeve dhe infrastrukturave. Materialet e mëposhtme grafike prezantojnë qendrat kryesore me nivelin më të lartë të shërbimeve prej nga përfitojnë edhe periferitë urbane dhe rurale duke krijuar kështu një tjetër shtresë (*layer*) të përcaktimit/identifikimit të zonave funksionale.

Figura 6. Qendrat dhe aksesin në shërbime (internet dhe telefoni fikse)




AKSESI NË SHËRBIME DHE QENDËRSITË | CILËSIA E JETËS

Burimi: INSTAT, Census 2011; Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve

Kështu, duke iu referuar hartave që prezantojnë lidhjet me internetin dhe telefoninë fikse vërejmë përsëritjen e tendencës dhe qendrave me zonat e prezantuara me të gjelbër në hartën e zhvendosjeve të popullsisë gjatë viteve 2001 – 2011. Në këtë mënyrë përdorim të dhëna dhe informacione të ndryshme për të identifikuar zonat funksionale në Shqipëri në përgjithësi dhe në këtë rast në qarkun e Tiranës.

Figura 7. Shpërndarja e institucioneve arsimore sipas përqendrimit të popullsisë (kopshtet, shkollat 9-vjeçare dhe shkollat e mesme)




INFRASTRUKTURA ARSIMORE DHE QENDËRSITË | AKSESI NË SHËRBIME

Burimi: INSTAT, Census 2011; Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve

Informacioni për aksesin në shërbime plotësohet me informacionin e prezantuar në hartat e mësipërme për shpërndarjen e institucioneve arsimore (parashkollore dhe të arsimit 9-vjeçar dhe të mesëm), si dhe atyre shëndetësore.

Figura 8 Aksesit në shërbime (ujësjellës dhe kanalizime) dhe shpërndarja e SHAUK



Burimi: INSTAT, Census 2011; DPUK, MTI 2013; Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve


Një tjetër informacion i rëndësishëm që përdorim në evidentimin e zonave funksionale është edhe shërbimi me ujë të pijshëm dhe kanalizime të ujërave të zeza.

Të gjitha këto analiza të vendosura së bashku rikonfirmojnë evidentimin e dy zonave funksionale shumë të qarta në qarkun e Tiranës: ZF Tiranë dhe ZF Kavajë, si dhe tendencën për krijimin e tre zonave të tjera funksionale me qendër Vorën, Kamzën dhe Rogozhinën.

Ndarja e zonave funksionale e propozuar në qarkun Tiranë

Siç përmendëm më sipër, në qarkun e Tiranës evidentohen deri në 5 zona funksionale, të prezantuara grafikisht si më poshtë:

Figura 9. Ndarjet e propozuara sipas 5 varianteve për reformën territoriale (30; 39; 47; 57 dhe 63 zona funksionale)



Varianti 1 me 30 NJQV – Zona funksionale Tiranë me kufij që përputhen me kufijtë e rrethit është e vetmja zonë funksionale e propozuar brenda kufijve të qarkut. Ndërkohë që një pjesë e qarkut bashkohet me zonën funksionale të Durrësit.

Varianti 2 me 39 NJQV – Brenda qarkut të Tiranës evidentohen dy zona funksionale, kufijtë e të cilave përputhen me kufijtë e rretheve: ZF Tiranë dhe ZF Kavajë.

Varianti 3 me 47 NJQV – Brenda qarkut të Tiranës identifikohen tre zona funksionale: ZF Tiranë; ZF Kamëz dhe ZF Kavajë (kjo e fundit përputhet me kufijtë e rrethit).

Varianti 4 me 57 NJQV – Brenda qarkut të Tiranës identifikohen pesë zona funksionale: ZF Tiranë; ZF Kamëz; ZF Vorë; ZF Kavajë dhe ZF Rrogozhinë.

Varianti 5 me 63 NJQV – Brenda qarkut të Tiranës identifikohen pesë zona funksionale: ZF Tiranë; ZF Kamëz; ZF Vorë; ZF Kavajë dhe ZF Rrogozhinë.

Në variantet 4 dhe 5 (respektivisht me 57 dhe me 63 NJQV) në qarkun e Tiranës evidentohen njëllëj 5 zonat funksionale.

Materiali më poshtë do të analizojë pikërisht këto 5 zona funksionale, duke u fokusuar në zonat funksionale të propozuara në variantin e 3-të.

Analiza në nivel zone funksionale


Kur analizojmë zonat funksionale më poshtë, duhet pasur parasysh se:

- Në rastin e zonës funksionale të Tiranës analiza përqendrohet duke konsideruar si pjesë të kësaj zone funksionale NJQV-të ekzistuese: Baldushk; Bërxullë; Bërzhitë; Dajt; Farkë; Kashar; Krrabë; Ndroq; Petrelë; Pezë; Prezë; Shëngjergj; Tiranë; Vaqarr; Vorë dhe Zall Bastar.
- Në rastin e zonës funksionale Kamëz, pjesë e saj janë NJQV-të ekzistuese: Kamëz; Paskuqan dhe Zall Herr.
- Në rastin e zonës funksionale Vorë, konsiderohen NJQV-të ekzistuese: Vorë; Bërxullë dhe Prezë.
- Zona funksionale Kavajë konsideron NJQV-të ekzistuese: Kavajë; Helmas; Golem; Luz i Vogël; Synej; Kryevindh; Sinaballaj; Gosë; Lekaj dhe Rrogozhinë.
- Zona funksionale Rrogozhinë konsideron NJQV-të ekzistuese: Rrogozhinë; Sinaballaj; Gosë; Kryevindh dhe Lekaj.

Zona funksionale Tiranë

Zona funksionale Tiranë shtrihet dhe përfshin 16 njësi ekzistuese të qeverisjes vendore; Tiranë, Baldushk, Bërxullë, Bërzhitë, Dajt, Fark, Kashar, Krrabë, Ndroq, Petrelë, Pezë, Prezë, Shëngjergj, Vaqarr, Vorë dhe Zall Bastar (shiko figurën 10).

Figura 10. Zona funksionale Tiranë sipas Variantit 3 të propozuar (me 47 zona funksionale në nivel vendi)



Do të shikojmë efektet demografike, ekonomiko-financiare, në ofrimin e shërbimeve, distancat dhe aksesin referuar zonës funksionale të propozuar.

Efektet demografike

Popullsia e zonës funksionale Tiranë duke iu referuar të dhënave të Census-it 2011 rezulton rreth 573 544 banorë. Sipërfaqja e ZF Tiranë është 1135 km² dhe dendësia e popullsisë në këtë zonë funksionale është 505 banorë/km². Referuar të dhënave të Regjistrit të Gjendjes Civile raportohet rreth 757 028 banorë.

Tabela 2. Të dhëna demografike për ZF Tiranë dhe NJQV-të ekzistuese që përfshihen në të

Nr.	Njësia Vendore	Popullsia	Dendësia INSTAT	Sipërfaqja	RGJC
		INSTAT	banorë/km ²	km ²	Popullsia
		2011			Janar 2012
1	BALDUSHK	4576	41	113	5315
2	BËRXULLË	9883	635	16	9670
3	BËRZHITË	4973	69	72	5812
4	DAJT	20 139	211	95	12 370
5	FARKË	22 633	807	28	11 899
6	KASHAR	43 353	1108	39	22 158
7	KRRABË	2343	126	19	3093
8	NDROQ	5035	80	63	9185
9	PETRELË	5542	82	67	6442
10	PEZË	6272	58	108	5701
11	PREZË	4727	163	29	6712
12	SHËNGJERGJ	2186	11	206	2797
13	TIRANË	418 495	10 463	40	622 202
14	VAQARR	9106	196	46	9156
15	VORË	10 901	285	38	18972
16	ZALL BASTAR	3380	22	154	5544
Zonë funksionale TIRANË		573 544	505	1135	757 028

Burimi: INSTAT, Census 2011 & RGJC 2012

Kjo është zona funksionale më e madhe e propozuar në nivel vendi për sa i përket numrit dhe dendësisë së popullsisë. Kjo justifikohet me përqendrimin e lartë të numrit të institucioneve dhe aktiviteteve ekonomike në zonë.

Efektet ekonomiko-financiare

Le të shikojmë ndërveprimin dhe efektet ekonomike dhe financiare në zonën funksionale të propozuar me qendër Tiranën.

Tabela më poshtë prezanton përqendrimin e bizneseve dhe llojin e aktiviteteve që zhvillojnë bizneset në këtë zonë. Vihet re se bizneset e përqendruara në shërbime por edhe në tregti përbëjnë numrin më të lartë të aktiviteteve në këtë zonë.


Tabela 3. Ndërmarrjet aktive sipas NJQV-ve ekzistuese në ZF Tiranë dhe aktivitetit ekonomik

Komuna / Bashki	Biznese gjithsej	Popullsia INSTA T 2011	Biznese /1000 banorë	Bujqësia e Peshkimi	Industria	Ndërtimi	Tregtia	Shërbime
Baldushk	43	4576	9	*	4	*	10	25
Bërxullë	137	9883	14	*	21	4	72	40
Bërzhit	117	4973	24	*	11	*	32	68
Dajt	517	20 139	26	4	73	42	159	239
Farkë	544	22 633	24	*	60	43	196	242
Kashar	1458	43 353	34	4	175	115	661	503
Krrabë	49	2343	21	*	5	*	13	29
Ndroq	103	5035	20	4	10	*	42	45
Petrelë	126	5542	23	4	*	9	35	75
Peze	132	6272	21	7	13	*	51	59
Prezë	103	4727	22	*	15	5	44	36
Shëngjergj	7	2186	3	*	*	*	*	4
Tiranë	34 786	418 495	83	43	2417	1408	14 248	16 670
Vaqar	355	9106	39	*	65	27	138	122
Vorë	526	10 901	48	4	75	16	227	204
Zall Bastar	13	3380	4	*	*	*	4	5
Zona funksionale TIRANË	39 016	573 544	68	70	2944	1669	15 932	18 366

Burimi: INSTAT 2012

Tirana dhe Kashari kanë po ashtu një numër të konsiderueshëm të bizneseve të cilat përqendrohen në aktivitete industriale por edhe në ndërtim.


Figura 11. Harta e shpërndarjes dhe llojit të aktiviteteve të biznesit në ZF Tiranë



Burimi: INSTAT 2011. Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve

Siç e kemi përmendur edhe më sipër, vihet re se në qendrat e zonës funksionale lloji i aktiviteteve është më i lartë dhe me largimin prej kësaj qendre në mungesë të një niveli të lartë të shërbimeve, aktivitetet uniformizohen duke u fokusuar vetëm në shërbime.

Figura 12. Harta e ndërveprimit ekonomik në ZF Tiranë: Përqendrimi i bizneseve dhe drejtimi i lëvizjes për punë



Burimi: INSTAT 2011. Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve

Kjo tendencë konfirmohet prej hartës së mësipërme (figura 12), e cila tregon flukset kryesore të lëvizjeve të të punësuarve. Pra, zona funksionale në të cilën niveli i shkëmbimeve në lidhje me punësimin dhe shërbimet prezantohet si më sipër.


Qendrat urbane brenda kësaj zone funksionale bëhen ofruese të infrastrukturave, shërbimeve dhe punësimit, ndërkohë që qendrat rurale për qark tyre bëhen furnizuese me produkte bujqësore dhe kryesisht me fuqi punëtore.

Le të shtjellojmë ndikimin që do të kishte krijimi i një njësie të re vendore, duke iu referuar kufijve të zonës funksionale të propozuar dhe duke konsideruar të gjithë faktorët që ndikojnë buxhetin dhe të ardhurat e njësive ekzistuese vendore të njëjtë.

Siç kemi përmendur edhe më sipër, qëllimi dhe përfitimi kryesor nga riorganizimi i njësive vendore sipas zonave funksionale do të ishte një rishpërndarje më e mirë e shpenzimeve vendore dhe efikase në ofrimin e shërbimeve.

Kështu, nëse i referohemi nivelit të të ardhurave për banor që sot kanë NJQV-të që përbëjnë ZF të Tiranës, vëmë re se ato lëvizin prej 3720 lekë/banor në Baldushk dhe në 18 900 lekë/banor në Vorë. Në kontekstin e zonës funksionale Tiranë në të njëjtat kushte të shpërndarjes së buxhetit (transfertat dhe të ardhurat e veta të njësive), buxheti për banor do të ishte 11 180 lekë, pra rreth katër herë më i lartë se buxheti i NJQV-së më të varfër brenda zonës funksionale dhe thujtse sa buxheti për banor i bashkisë ekzistuese të Tiranës.

Figura 13. Buxheti total për banor në NJQV-të ekzistuese dhe ZF Tiranë




Burimi: Ministria e Financave 2012. Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve

Thuajse e njëjta tendencë prezantohet në lidhje me të ardhurat vendore të krijuara në NJQV-të ekzistuese dhe të parashikuara në ZF Tiranë të propozuar më sipër.

Sot të ardhurat vendore të komunës Zall Bastar janë 150 lekë/banor – më të ulëtat mes NJQV-ve të përfshira në ZF Tiranë, ndërsa të ardhurat vendore të komunës Farkë janë 25 790 lekë/banor – 170 herë më të larta krahasuar me komunën Zall Bastar.

Figura 14. Të ardhurat e veta për banor në NJQV-të ekzistuese dhe ZF Tiranë




Burimi: Ministria e Financave 2012. Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve

Mesatarisht në të njëjtat kushte të ardhurat për banor të parashikuara në ZF Tiranë do të jenë 9490 lekë/banor ose 38 herë më të larta se të ardhurat vendore të komunës Zall Bastar, e thuajse sa të ardhurat për banor të bashkisë ekzistuese të Tiranës.

Një tjetër element i rëndësishëm që lidhet drejtpërdrejtë me efikasitetin në ofrimin e shërbimeve dhe mirëmenaxhimin e fondeve publike në nivel vendor është numri i punonjësve të angazhuar në administratën vendore.

Figura 15. Numri i punonjësve ne administratë në NJQV-të e qarkut Tiranë



Burimi: NJQV-të dhe MSHÇV. Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve


Duke iu referuar situatës ekzistuese në NJQV-të ekzistuese në ZF Tiranë vihet re se, në NJQV të ndryshme peshë e administratës vendore në buxhetin e NJQV-së ndryshon shumë. Ndonëse në disa raste kjo lidhet drejtpërdrejtë me zgjedhjen që bëjnë njësitë e ndryshme në mënyrën se si do të ofrohen shërbimet, sërish në disa raste numri i raportuar i punonjësve vendor për banor është shumë i lartë në krahasim me NJQV-të e tjera.

Figura 4.6 raporton pikërisht këtë shpërndarje në qarkun e Tiranës. Vihet re se në disa NJQV si Petrela apo edhe Vora numri i punonjësve vendor për banor është rreth 15, krahasuar me Tiranën, Kasharin apo Kamzën ku ky numër është më pak se 4.

Le të shikojmë këtë element nga këndvështrimi i kostove për NJQV-në dhe qytetarët. Gjithmonë duke konsideruar të njëjtat kushte ekonomike, financiare por njëkohësisht edhe të përgjegjësive dhe funksioneve, në grafikun më poshtë (figura 16) paraqiten shpenzimet e personelit për banor në NJQV-të ekzistuese të ZF Tiranë.

Duke konsideruar se krijimi i njësisë së re vendore, duke iu referuar kufijve të zonës funksionale, do të përqendroje një pjesë të shërbimeve të cilat sot ofrohen në të gjitha NJQV-të, vetëm në një qendër (të tilla janë zyrat e financave, burimet njerëzore, drejtoritë e mjedisit, drejtoritë e planifikimit urban, kadastrat urbane, etj.), kemi llogaritur se shpenzimet e NJQV-së së re që do të krijohen vetëm për personelin, do të reduktohen me të paktën 70% në rastin e ZF Tiranë. Si rezultat, kosto e personelit për banor do të reduktohet nga një mesatare që sot rezulton rreth 3610 lekë/banor në rreth 3180 lekë për banor.

Figura 16. Shpenzimet e personelit për banor në NJQV-të ekzistuese dhe në ZF Tiranë




Burimi: Ministria e Financave 2012. Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve

Me të njëjtën logjikë analizojmë edhe kostot për shpenzimet operative të NJQV-ve ekzistuese dhe të NJQV-së të propozuar sipas kufijve të ZF Tiranë.

Gjatë kësaj analize duhet të kemi parasysh se, në shpenzimet operative llogariten të gjitha shpenzimet e NJQV-ve për shpenzimet e tyre rutine të mirëmbajtjes apo edhe ofrimit të shërbimeve, por njëkohësisht edhe kostot e qirave dhe mirëmbajtjes së godinave ekzistuese të NJQV-ve. Në një llogaritje të përgjithshme paraprake, vlerësojmë se kostot operative do të reduktohen me rreth 5% si rezultat i efikasitetit të ambienteve dhe stafit pas organizimit të propozuar. Grafiku më poshtë prezanton pikërisht këtë efikasitet, të shprehur në reduktimin e

kostove operative për banor në ZF të Tiranës, krahasuar me mesataren e NJQV-ve përbërëse të ZF-së.


Figura 17. Shpenzimet operative për banor në NJQV-të ekzistuese dhe në ZF Tiranë



Burimi: Ministria e Financave 2012. Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve

Në të njëjtën logjikë – pra duke konsideruar kushtet ekonomike dhe financiare të pandryshueshme, por njëkohësisht edhe tërësinë e përgjegjësive dhe funksioneve të NJQV-ve, bëjmë supozimin se kursimi i fondeve për shpenzimet operative dhe të personelit do të përdoret në masën 100% në rritjen e investimeve kapitale, analizojmë nivelin e investimeve të pritshme për banor në ZF të propozuar.

Figura 18. Investimet për banor në NJQV-të ekzistuese dhe në ZF Tiranë



Burimi: Ministria e Financave 2012. Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve


Figura 18 tregon nivelin e investimeve për banor në NJQV-të ekzistuese si dhe nivelin e investimeve të pritshme në NJQV-në e propozuar. Siç vihet re nga grafiku, niveli i investimeve në ZF Tiranë është rreth 3450 lekë për banor – rreth 16% më i lartë, krahasuar me nivelin mesatar të investimeve sot në të gjitha NJQV-të ekzistuese i cili prezantohet në rreth 2980 lekë/banor.

Efektet në ofrimin e shërbimeve

Veç efikasitetit ekonomik dhe financiar, organizimi i NJQV-ve të propozuara sipas zonave funksionale pritet të krijojë një sërë efektesh dhe eksternalitetesh pozitive në nivelin dhe cilësinë e ofrimit të shërbimeve.

Në një analizë të shpejtë në disa prej shërbimeve të rëndësishme të ofruara prej nivelit vendor në Shqipëri, organizimi sipas zonave funksionale do të krijojë mundësinë për harmonizimin më të mirë të politikave, të cilat kanë nevojë për territor të gjerë, si dhe mundësitë për zhvillimin ekonomik. Kështu copëzimi i madh i territorit sipas kufijve të NJQV-ve ekzistuese ka qenë ndër arsyet kryesore të diskutuara në lidhje me keqmenaxhimin e territorit dhe mjedisit. Riorganizimi sipas konceptit të zonave funksionale në mos do të zhdukë, do të zbusë këtë problem duke mundësuar bërjen e politikave të zhvillimit dhe menaxhimit për territore gjeografike më të plota dhe me potenciale më të mëdha për mirëmenaxhim burimesh.

Figura 19. Harta e zonave të mbrojtura në Shqipëri dhe në ZF Tiranë



Burimi: Ministria e Mjedisit, Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve


Në figurën më sipër prezantohen zonat e mbrojtura në Shqipëri, por edhe në zonën funksionale të propozuar në Tiranë. Deri tani, këto zona në kushte të copëzimit mes shumë NJQV-ve vendore në mos keqpërdorur, nuk kanë përdorur e menaxhuar potencialin e tyre natyror. Në kushtet e riorganizimit pjesa më e madhe e zonave të mbrojtura do të menaxhohen prej një apo maksimumi dy njësi vendore, të cilat do të kenë mundësi dhe shanse më të mira për të ndërtuar mbi potencialin e këtyre zonave.

I njëjti diskutim është i vlefshëm edhe për çështjet e planifikimit të territorit, menaxhimit të tokës apo kontrollit mbi territorin.

Një tjetër kategori e rëndësishme e shërbimeve që ofrohen pjesërisht në nivel vendor e pjesërisht në atë qendror është arsimiti. Sot NJQV-të janë përgjegjëse për mirëmbajtjen e infrastrukturave arsimore. Në figurën më poshtë prezantohet pikërisht shpërndarja dhe cilësia

e këtyre strukturave. Çfarë tërheq vëmendjen në këtë analizë është se cilësia e dobët e infrastrukturave arsimore lidhet drejtpërdrejtë me gjenerimin e ulët të të ardhurave prej NJQV-ve (kuptohet edhe si rezultat i nivelit të ulët të transfertave). Riorganizimi në NJQV më të madhe – sipas zonës funksionale të propozuar do të çonte në efikasitetin dhe shpërndarjen më të mirë të fondeve në dispozicion. Madje duke shkuar më tej dhe duke përdorur si argument kryesor parimin e subsidiaritetit, do të kishte kuptim që edhe pjesë të tjera të funksionit (siç mund të jetë emërimi i stafit dhe drejtuesve, etj.) të jenë përgjegjësi e nivelit vendor të qeverisjes.


Figura 20. Harta e shpërndarjes së infrastrukturave të arsimit të mesëm në Shqipëri dhe cilësia e infrastrukturës arsimore në ZF Tiranë



Burimi: Ministria e Arsimit dhe Sportit, Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve

Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimit të ujërave të zeza, po ashtu pritet të funksionojë më mirë dhe në mënyrë më efikase. Figura më poshtë tregon organizimin e ndërmarrjeve të ujësjellësve dhe të KUZ-ve sot. Siç vihet re edhe nga figura e mëposhtme menaxhimi i ndërmarrjeve të ujësjellësve sot bëhet nëpërmjet bordeve (në më të shumtën e rasteve) të zgjedhura prej një numri të madh NJQV-sh, duke u bërë në shumë raste i vështirë për të marrë vendime dhe mirëmenaxhuar ndërmarrjen. Riorganizimi sipas zonave funksionale duket se krijon kushte më të mira edhe për mirëmenaxhimin dhe organizimin e këtij shërbimi.

Figura 21. Harta e mbulimit me shërbimin e furnizimit me ujë në Shqipëri dhe ZF Tiranë




Burimi: DPU/Ministria e Transportit. Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve

Së fundmi, një nga çështjet më të diskutuara në lidhje me riorganizimin e NJQV-ve sipas zonave funksionale është aksesin dhe distancat në ofrimin e shërbimeve. Më poshtë kemi sjellë dy elementë të rëndësishëm të cilët përpiqen të trajtojnë këtë problem.

Së pari është aksesin në qendrën e zonës funksionale nëpërmjet infrastrukturës rrugore (figura 22) dhe së dyti, në krahasim me këtë është koha e udhëtimit që do t'i duhet çdo banori të zonës për të vajtur në këtë qendër (figura 4.14).

Figura 22. Infrastruktura rrugore dhe aksesin në ZF Tiranë




Burimi: DPR/Ministria e Transportit. Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve

Si rezultat i aksesit përgjithësisht të mirë me infrastrukturën rrugore, thuhet se 90% e popullsisë së zonës funksionale mund të shkojë në qendër në më pak se 30 minuta duke udhëtuar me

automjet. Janë banorët e dy njërive – Zall Bastar dhe Shën Gjergj, aksesit për të cilët është disi më i vështirë (mbi 50 minuta).

Figura 23. Distanca kohore nga qendra në ZF Tiranë



Burimi: DPR/Ministria e Transportit. Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve

Ka disa mënyra për ta trajtuar këtë problem. Një prej tyre lidhet me nevojën që do të kenë banorët për të vajtur në qendrën e ZF-së në të përditshmen e tyre. Në kushtet kur pranë banorëve ekzistojnë shërbimet bazë për të cilat ata kanë nevojë të shkojnë më shpesh, udhëtimi drejt qendrës do të shmanget. Një tjetër mënyrë do të ishte rritja e investimeve dhe përqendrimi i prioriteteve në investime, në infrastrukturën fizike, si dhe transportin që lehtëson këtë akses.

Përfundime

ZF Tiranë me popullsi 573 544 banorë, nga mesatarisht 35 847 banorë për 16 njësitë.

Reduktim i shpenzimeve administrative (paga dhe të tjera operative) me rreth 294 milionë lekë (ose 4% e shpenzimeve totale të kryera nga të gjitha njësitë).

Ulje e shpenzimeve të pagave, nga 2 miliardë lekë në 1,8 miliardë lekë në vit. Shpenzimet për paga për banor ulen, nga 3613 në 3183 lekë për banor në njësinë e re.

Rritje e buxhetit vjetor të investimeve me 20% në vit, nga 1,7 miliardë lekë në 2 miliardë lekë.

Rritje e investimeve për frymë, nga 2976 në 3489 lekë në njësinë e re.

Zona funksionale Kamëz

Zona funksionale Kamëz shtrihet dhe përfshin tre NJQV ekzistuese: Kamëz, Paskuqan dhe Zall Herr. Përcaktimi i zonës funksionale brenda këtyre kufijve vjen si rezultat i ndërveprimit që ndodh mes banorëve, bizneseve apo aktorëve të tjerë që operojnë dhe përqendrohen në këtë zonë. Ne nivel institucional ky ndërveprim duket se mungon, referuar faktit se përqendrimi i institucioneve në Tiranë si qendër e qarkut por edhe si qendër e vendit është shumë i lartë dhe distanca fizike mes Kamzës dhe Tiranës janë fare të vogla për të krijuar një tjetër qendër për sa i përket përqendrimit të institucioneve.

Figura 24. Zona funksionale Kamëz sipas Variantit 3 të propozuar (me 47 zona funksionale në nivel vendi)



Do të paraqesim më poshtë efektet demografike, ekonomiko-financiare, në ofrimin e shërbimeve, distancat dhe aksesin, referuar zonës funksionale të propozuar.

Efektet demografike

Popullsia e zonës funksionale Kamëz, duke iu referuar të dhënave të Censur-it 2011 rezulton rreth 113 579 banorë. Sipërfaqja e ZF Kamëz është 95 km² dhe dendësia e popullsisë në këtë zonë funksionale është 1190 banorë/km². Referuar të dhënave të Regjistrimit të Gjendjes Civile raportohet rreth 131 995 banorë.

Tabela 3. Të dhëna demografike për ZF Kamëz dhe NJQV-të ekzistuese që përfshihen në të

Nr.	Njësia Vendore	Popullsia INSTAT 2011	Dendësia INSTAT banorë/km²	Sipërfaqja km²	RGJC Popullsia Janar 2012
1	KAMEZ	66 841	2697	25	81 674
2	PASKUQAN	37 349	3013	12	39 570
3	ZALL HERR	9389	161	58	10 751
<i>Zonë funksionale KAMEZ</i>		113 579	1190	95	131 995

Burimi: INSTAT, Census 2011 & RGJC 2012

Siç është përmendur më sipër, zona funksionale me qendër Kamzën është e diskutueshme në disa aspekte, veçanërisht për sa i përket përqendrimit të institucioneve dhe ndërveprimit mes tyre, megjithatë ajo prezanton një tendencë për ndërveprim të lartë mes banorëve në NJQV-të e përfshira, si dhe bizneseve të përqendruara brenda territorit të këtyre NJQV-ve.

Efektet ekonomiko-financiare

Le të shikojmë ndërveprimin dhe efektet ekonomike dhe financiare në zonat funksionale të propozuara.

Tabela 4. Ndërmarrjet aktive sipas NJQV-ve ekzistuese në ZF Kamëz dhe aktivitetit ekonomik

Komuna / Bashki	Biznese gjithsej	Popullsia INSTAT 2011	Biznese /1000 banorë	Bujqësia e Peshkimi	Industri a	Ndërtimi	Tregtia	Shërbime
Kamëz	1417	66 841	21	6	158	58	616	579
Paskuqan	338	37 349	9	*	33	28	140	134
Zall Herr	103	9389	11	7	12	10	23	51
Zona funksionale Kamëz	1858	113 579	16	13	203	96	779	764


Burimi: INSTAT 2012

Edhe në rastin e kësaj zonë funksionale, aktivitetet kryesore duket se janë ato në fushën e shërbimeve dhe tregtisë, por nuk përjashtohen edhe aktivitetet në fushën e industrisë dhe ndërtimit. Në NJQV-të e Paskuqanit dhe të Zall Herrit përqendrimi i bizneseve është më i ulët, por ndërveprimi si rezultat i shërbimeve të ofruara në bashkinë e Kamzës duket të jetë i lartë mes këtyre rrjeteve.

Le të shikojmë ndikimin që do të kishte krijimi i një njësie të re vendore, duke iu referuar kufijve të zonës funksionale Kamëz të propozuar dhe duke konsideruar të gjithë faktorët që ndikojnë buxhetin dhe të ardhurat e njësive ekzistuese vendore të njëjtë.

Siç kemi përmendur edhe më sipër, qëllimi dhe përfitimi kryesor nga riorganizimi i njësive vendore sipas zonave funksionale do të ishte një rishpërndarje më e mirë e shpenzimeve vendore dhe efikase në ofrimin e shërbimeve.

Figura 25. Buxheti total për banor në NJQV-të ekzistuese dhe ZF Kamëz




Burimi: Ministria e Financave 2012. Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve

Kështu, nëse i referohemi nivelit të shpenzimeve për banor që sot kanë NJQV-të që përbëjnë ZF të Kamzës, vëmë re se ato lëvizin prej 3200 lekë/banor në Zall Herr dhe në 9470 lekë/banor në Kamëz. Në kontekstin e zonës funksionale Kamëz në të njëjtat kushte të shpërndarjes së buxhetit (transfertat dhe të ardhurat e veta të njëjësive), buxheti për banor do të ishte 6190 lekë, pra më tepër se dy herë më i lartë se buxheti i NJQV-së më të varfër brenda zonës funksionale.

Thujse e njëjta tendencë prezantohet në lidhje me të ardhurat vendore të krijuara në NJQV-të ekzistuese dhe të parashikuara në ZF Kamëz të propozuar më sipër.

Sot të ardhurat vendore të komunës Zall Herr janë 1160 lekë/banor – më të ulëtat mes NJQV-ve të përfshira në ZF Kamëz, ndërsa të ardhurat vendore të bashkisë Kamëz janë rreth 4540 lekë/banor. Mesatarisht të ardhurat për banor të parashikuara për ZF Kamëz janë rreth 3350 lekë (figura 26).

Figura 26. Të ardhurat e veta për banor në NJQV-të ekzistuese dhe ZF Kamëz




Burimi: Ministria e Financave 2012. Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve

Le të shikojmë shpërndarjen e personelit të NJQV-ve nga këndvështrimi i kostove për NJQV-në dhe qytetarët. Gjithmonë duke konsideruar të njëjtat kushte ekonomike, financiare por njëkohësisht edhe të përgjegjësive dhe funksioneve, në grafikun më poshtë (figura 27) paraqiten shpenzimet e personelit për banor në NJQV-të ekzistuese të ZF Kamëz.

Duke konsideruar se krijimi i njësisë së re vendore, duke iu referuar kufijve të zonës funksionale, do të përqendrojë një pjesë të shërbimeve të cilat sot ofrohen në të gjitha NJQV-të, vetëm në një qendër (të tilla janë zyrat e financave, burimet njerëzore, drejtoritë e mjedisit, drejtoritë e planifikimit urban, kadastrat urbane, etj.), kemi llogaritur se shpenzimet e NJQV-së së re që do të krijohen vetëm për personelin, do të reduktohen me të paktën 70% në rastin e ZF Kamëz. Si rezultat kosto e personelit për banor do të reduktohet nga një mesatare që sot rezulton rreth 1850 lekë/banor në rreth 1550 lekë për banor.

Figura 27. Shpenzimet e personelit për banor në NJQV-të ekzistuese dhe në ZF Kamëz




Burimi: Ministria e Financave 2012. Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve

Me të njëjtën logjikë analizojmë edhe kostot për shpenzimet operative të NJQV-ve ekzistuese dhe të NJQV-së të propozuar sipas kufijve të ZF Kamëz.

Gjatë kësaj analize duhet të kemi parasysh se në shpenzimet operative llogariten të gjitha shpenzimet e NJQV-ve të mirëmbajtjes apo edhe ofrimit të shërbimeve, por njëkohësisht edhe kostot e qirave dhe mirëmbajtjes së godinave ekzistuese të NJQV-ve. Në një llogaritje të përgjithshme paraprake, vlerësojmë se kostot operative do të reduktohen me rreth 5% si rezultat i efikasitetit të ambienteve dhe stafit pas organizimit të propozuar. Grafiku më poshtë prezanton pikërisht këtë efikasitet, të shprehur në reduktimin e kostove operative për banor në ZF të Kamzës krahasuar me mesataren e NJQV-ve përbërëse të ZF-së.


Figura 28. Shpenzimet operative për banor në NJQV-të ekzistuese dhe në ZF Kamëz



Burimi: Ministria e Financave 2012. Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve

Duke konsideruar kushtet ekonomike dhe financiare të pandryshueshme, por njëkohësisht edhe tërësinë e përgjegjësisë dhe funksioneve të NJQV-ve, bëjmë supozimin se kursimi i fondeve për shpenzimet operative dhe të personelit do të përdoret në masën 100% në rritjen e investimeve kapitale, analizojmë nivelin e investimeve të pritshme për banor në ZF të propozuar.

Figura 29. Investimet për banor në NJQV-të ekzistuese dhe në ZF Kamëz




Burimi: Ministria e Financave 2012. Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve

Figura 29 tregon nivelin e investimeve për banor në NJQV-të ekzistuese, si dhe nivelin e investimeve të pritshme në NJQV-në e propozuar. Siç vihet re nga grafiku, niveli i investimeve në ZF Kamëz është rreth 4200 lekë për banor – 10% më i lartë, krahasuar me nivelin mesatar të investimeve sot në të gjitha NJQV-të ekzistuese, i cili prezantohet në rreth 3850 lekë/banor.

Zona funksionale Vorë

Zona funksionale Vorë shtrihet dhe përfshin tre NJQV ekzistuese: Vorë, Prezë dhe Bërxullë. Përcaktimi i zonës funksionale brenda këtyre kufijve vjen si rezultat i ndërveprimit që ndodh mes banorëve, bizneseve apo aktorëve të tjerë që operojnë dhe përqendrohen në këtë zonë. Në nivel institucional ky ndërveprim duket se mungon, referuar faktit se përqendrimi i institucioneve në Tiranë si qendër e qarkut por edhe si qendër e vendit është shumë i lartë dhe distanca fizike mes Vorës dhe Tiranës janë relativisht të vogla për të krijuar një tjetër qendër për sa i përket përqendrimit të institucioneve.

Figura 30. Zona funksionale Vorë sipas Variantit 4 dhe 5 të propozuar (respektivisht me 57 dhe 63 zona funksionale në nivel vendi)



Do të paraqesim më poshtë efektet demografike, ekonomiko-financiare, në ofrimin e shërbimeve, distancat dhe aksesin referuar zonës funksionale të propozuar.

Efektet demografike

Popullsia e zonës funksionale Vorë, duke iu referuar të dhënave të Census-it 2011 rezulton rreth 25511 banorë. Sipërfaqja e ZF Vorë është 83 km² dhe dendësia e popullsisë në këtë zonë funksionale është 308 banorë/km². Referuar të dhënave të Regjistrit të Gjendjes Civile raportohet rreth 35 354 banorë.

Tabela 5. Të dhëna demografike për ZF Vorë dhe NJQV-të ekzistuese që përfshihen në të

Nr.	Njësia Vendore	Popullsia INSTAT 2011	Dendësia INSTAT banorë/km²	Sipërfaqja km²	RGJC Popullsia Janar 2012
1	BERXULL	9883	635	16	9670
2	PREZE	4727	163	29	6712
3	VORE	10 901	285	38	18 972
Zonë funksionale VORË		25 511	308	83	35 354

Burimi: INSTAT, Census 2011 & RGJC 2012

Siç është përmendur më sipër, zona funksionale me qendër Vorën është e diskutueshme në disa aspekte, veçanërisht për sa i përket përqendrimit të institucioneve dhe ndërveprimit mes tyre, megjithatë ajo prezanton një tendencë për ndërveprim të lartë mes banorëve në NJQV-të e përfshira si dhe bizneseve të përqendruara brenda territorit të këtyre NJQV-ve.

Efektet ekonomiko-financiare

Le të shikojmë ndërveprimin dhe efektet ekonomike dhe financiare në zonat funksionale të propozuara.

Tabela 6. Ndërmarrjet aktive sipas NJQV-ve ekzistuese në ZF Vorë dhe aktivitetit ekonomik


Komuna / Bashki	Biznese gjithsej	Popullsia INSTAT 2011	Biznese/1000 banorë	Bujqësia e Peshkimi	Industria	Ndërtimi	Tregtia	Shërbime
Bërxullë	137	9883	14	*	21	4	72	40
Prezë	103	4727	22	*	15	5	44	36
Vorë	526	10 901	48	4	75	16	227	204
Zona funksionale Vorë	766	25 511	30	4	111	25	343	280

Burimi: INSTAT 2012

Edhe në rastin e kësaj zone funksionale, aktivitetet kryesore duket se janë ato në fushën e shërbimeve dhe tregtisë, por edhe aktivitetet në fushën e industrisë dhe ndërtimit kanë një tendencë rritjeje. Në NJQV-të e Bërxullit dhe Prezës përqendrimi i bizneseve është më i ulët, por ndërveprimi si rezultat i shërbimeve të ofruara në bashkinë e Vorës duket të jetë i lartë mes këtyre rrjeteve.

Le të shikojmë ndikimin që do të kishte krijimi i një njësie të re vendore, duke iu referuar kufijve të zonës funksionale Vorë të propozuar dhe duke konsideruar të gjithë faktorët që ndikojnë buxhetin dhe të ardhurat e njësisë ekzistuese vendore të njëjtë.

Figura 31. Buxheti total për banor në NJQV-të ekzistuese dhe ZF Vorë



Burimi: Ministria e Financave 2012. Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve


Siç kemi përmendur edhe më sipër, qëllimi dhe përfitimi kryesor nga riorganizimi i njësive vendore sipas zonave funksionale do të ishte një rishpërndarje më e mirë e shpenzimeve vendore dhe efikase në ofrimin e shërbimeve.

Kështu, nëse i referohemi nivelit të shpenzimeve për banor që sot kanë NJQV-të që përbëjnë ZF të Vorës, vëmë re se ato lëvizin prej 5670 lekë/banor në Bërxullë dhe në 18 900 lekë/banor në Vorë. Në kontekstin e zonës funksionale Vorë në të njëjtat kushte të shpërndarjes së buxhetit (transfertat dhe të ardhurat e veta të njësive), buxheti për banor do të ishte 12 430 lekë, pra më tepër se 50% më i lartë se buxheti i NJQV-së më të varfër brenda zonës funksionale.

Thuajse e njëjta tendencë prezantohet në lidhje me të ardhurat vendore të krijuara në NJQV-të ekzistuese dhe të parashikuara në ZF Vorë të propozuar më sipër.

Sot të ardhurat vendore të komunës Bërxullë janë rreth 2000 lekë/banor – më të ulëta mes NJQV-ve të përfshira në ZF Vorë, ndërsa të ardhurat vendore të Komunës Prezë janë 18 650 lekë/banor. Mesatarisht të ardhurat për banor të parashikuara për ZF Vorë janë rreth 10 240 lekë (figura 32).

Figura 32. Të ardhurat e veta për banor në NJQV-të ekzistuese dhe ZF Vorë




Burimi: Ministria e Financave 2012. Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve

Le të analizojmë shpërndarjen e personelit të NJQV-ve nga këndvështrimi i kostove për NJQV-në dhe qytetarët. Gjithmonë duke konsideruar të njëjtat kushte ekonomike, financiare por njëkohësisht edhe të përgjegjësive dhe funksioneve, në grafikun më poshtë (figura 33) paraqiten shpenzimet e personelit për banor në NJQV-të ekzistuese të ZF Vorës.

Duke konsideruar se krijimi i njësisë së re vendore, duke iu referuar kufijve të zonës funksionale, do të përqendrojë një pjesë të shërbimeve të cilat sot ofrohen në të gjitha NJQV-të, vetëm në një qendër (të tilla janë zyrat e financave, burimet njerëzore, drejtoritë e mjedisit, drejtoritë e planifikimit urban, kadastrat urbane, etj.), kemi llogaritur se shpenzimet e NJQV-së së re që do të krijohen vetëm për personelin, do të reduktohen me të paktën 70% në rastin e ZF Vorë. Si rezultat kosto e personelit për banor do të reduktohet nga një mesatare që sot rezulton rreth 3680 lekë/banor në rreth 2720 lekë për banor.

Figura 33. Shpenzimet e personelit për banor në NJQV-të ekzistuese dhe në ZF Vorë




Burimi: Ministria e Financave 2012. Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve

Me të njëjtën logjikë analizojmë edhe kostot për shpenzimet operative të NJQV-ve ekzistuese dhe të NJQV-së të propozuar sipas kufijve të ZF Vorë.

Gjatë kësaj analize duhet të kemi parasysh se, në shpenzimet operative llogariten të gjitha shpenzimet e NJQV-ve të mirëmbajtjes apo edhe ofrimit të shërbimeve, por njëkohësisht edhe kostot e qirave dhe mirëmbajtjes së godinave ekzistuese të NJQV-ve. Në një llogaritje të përgjithshme paraprake, vlerësojmë se kostot operative do të reduktohen me rreth 5% si rezultat i efikasitetit të ambienteve dhe stafit pas organizimit të propozuar. Grafiku më poshtë prezanton pikërisht këtë efikasitet, të shprehur në reduktimin e kostove operative për banor në ZF të Vorës krahasuar me mesataren e NJQV-ve përbërëse të ZF-së.


Figura 34. Shpenzimet operative për banor në NJQV-të ekzistuese dhe në ZF Vorë



Burimi: Ministria e Financave 2012. Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve

Duke konsideruar kushtet ekonomike dhe financiare të pandryshueshme, por njëkohësisht edhe tërësinë e përgjegjësisë dhe funksioneve të NJQV-ve, bëjmë supozimin se kursimi i fondeve për shpenzimet operative dhe të personelit do të përdoret në masën 100% në rritjen e investimeve kapitale, analizojmë nivelin e investimeve të pritshme për banor në ZF të propozuar.

Figura 35. Investimet për banor në NJQV-të ekzistuese dhe në ZF Vorë




Burimi: Ministria e Financave 2012. Interpretimi dhe paraqitja grafike të autorëve

Figura 35 tregon nivelin e investimeve për banor në NJQV-të ekzistuese, si dhe nivelin e investimeve të pritshme në NJQV-në e propozuar. Siç vihet re nga grafiku, niveli i investimeve në ZF Vorë është rreth 7250 lekë për banor – 42% më i lartë, krahasuar me nivelin mesatar të investimeve sot në të gjitha NJQV-të ekzistuese, i cili prezantohet në rreth 5100 lekë/banor.

Zona funksionale Kavajë

Zona funksionale Kavajë shtrihet dhe përfshin pesë NJQV ekzistuese: Kavajë, Golem, Helmës, Synej dhe Luz i Vogël. Përcaktimi i zonës funksionale brenda këtyre kufijve vjen si rezultat i ndërveprimit që ndodh mes banorëve, bizneseve apo aktorëve të tjerë që operojnë dhe përqendrohen në këtë zonë.

Figura 36. Zona funksionale Kavajë sipas Variantit 4 dhe 5 të propozuar (respektivisht me 57 dhe 63 zona funksionale në nivel vendi)



Do të shikojmë më poshtë efektet demografike, ekonomiko-financiare, në ofrimin e shërbimeve, distancat dhe aksesin referuar zonës funksionale të propozuar.

Efektet demografike

Popullsia e zonës funksionale Kavajë, duke iu referuar të dhënave të Census-it 2011 rezulton rreth 40 094 banorë. Sipërfaqja e ZF Kavajë është 199 km dhe dendësia e popullsisë në këtë zonë funksionale është 202 banorë/km². Referuar të dhënave të Regjistrit të Gjendjes Civile raportohet rreth 77 592 banorë.

Tabela 7. Të dhëna demografike për ZF Kavajë dhe NJQV-të ekzistuese që përfshihen në të

Nr.	Njësia Vendore	Popullsia INSTAT	Dendësia INSTAT	Sipërfaqja	RGJC Popullsia
		2011	banorë/km²	km²	Janar 2012
1	GOLEM	6994	128	55	12 234
2	HELMËS	3139	45	70	4979
3	KAVAJË	20 192	2531	8	39 493
4	LUZ I VOGËL	4735	187	25	10 260
5	SYNEJ	5034	124	41	10 626
<i>Zonë funksionale KAVAJË</i>		40 094	202	199	77 592

Burimi: INSTAT, Census 2011 & RGJC 2012

Siç është përmendur më sipër, zona funksionale me qendër Kavajën në disa raste mund të ketë një shtrirje më të gjerë, duke përfshirë edhe NJQV-të e Rrogozhinës, Kryevidhit, Gosës, Sinaballajt dhe Lekajt. Kjo veçanërisht po t'i referohemi ndërveprimit institucional. Ndërkohë, duke konsideruar ndërveprimin mes rrjetit të bizneseve dhe banorëve brenda kufijve të rrethit të Kavajës, identifikojmë dy zona funksionale siç janë trajtuar më tej në këtë material. Kuptohet se për sa i përket aspekteve të efikasitetit ekonomik, organizimi më një zonë të vetme funksionale do të rezultonte më efektiv.

Efektet ekonomiko-financiare

Le të shikojmë ndërveprimin dhe efektet ekonomike dhe financiare në zonat funksionale të propozuara.

Tabela 8. Ndërmarrjet aktive sipas NJQV-ve ekzistuese në ZF Kavajë dhe aktivitetit ekonomik


Komuna / Bashki	Biznese gjithsej	Popullsia INSTAT 2011	Biznese/ 1000 banorë	Bujqësia e Peshkimi	Industria	Ndërtimi	Tregtia	Shërbime
Golem	522	6994	75	28	33	42	117	302
Helmës	68	3139	22	4	16	*	32	13
Kavajë	1055	20 192	52	6	119	44	433	453
Luz i Vogël	127	4735	27	9	18	*	57	42
Synej	99	5034	20	7	11	*	42	37
ZF KAVAJË	1871	40 094	47	54	197	86	681	847

Burimi: INSTAT 2012

Edhe në rastin e kësaj zone funksionale aktivitetet kryesore duket se janë ato në fushën e shërbimeve dhe tregtisë, por nuk përjashtohen edhe aktivitetet në fushën e industrisë. Në NJQV-të e Helmësit, Synejit dhe Luzit të Vogël përqendrimi i bizneseve është më i ulët, por ndërveprimi si rezultat i shërbimeve të ofruara në bashkinë e Kavajës duket të jetë i lartë.

Le të shikojmë ndikimin që do të kishte krijimi i një njësie të re vendore, duke iu referuar kufijve të zonës funksionale Kavajë të propozuar dhe duke konsideruar të gjithë faktorët që ndikojnë buxhetin dhe të ardhurat e njësive ekzistuese vendore të njëjtë.

Figura 37. Buxheti total për banor në NJQV-të ekzistuese dhe ZF Kavajë



Burimi: Ministria e Financave 2012. Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve


Siç kemi përmendur edhe më sipër, qëllimi dhe përfitimi kryesor nga riorganizimi i njësive vendore sipas zonave funksionale do të ishte një rishpërndarje më e mirë e shpenzimeve vendore dhe efikase në ofrimin e shërbimeve.

Kështu, nëse i referohemi nivelit të shpenzimeve për banor që sot kanë NJQV-të që përbëjnë ZF të Kavajës, vëmë re se ato lëvizin prej 4780 lekë/banor në Helmës dhe në 16 730 lekë/banor në Golem. Në kontekstin e zonës funksionale Kavajë në të njëjtat kushte të shpërndarjes së buxhetit (transfertat dhe të ardhurat e veta të njësive), buxheti për banor do të ishte rreth 12 000 lekë, pra më tepër se 2,5 herë më i lartë se buxheti i NJQV-së më të varfër brenda zonës funksionale.

Thuajse e njëjta tendencë prezantohet në lidhje me të ardhurat vendore të krijuara në NJQV-të ekzistuese dhe të parashikuara në ZF Kavajë të propozuar më sipër.

Sot të ardhurat vendore të komunës Helmës janë 1540 lekë/banor – më të ulëtat mes NJQV-ve të përfshira në ZF Kavajë, ndërsa të ardhurat vendore të komunës Golem janë 11 460 lekë/banor. Mesatarisht të ardhurat për banor të parashikuara për ZF Kavajë janë rreth 5140 lekë (figura 38).

Figura 38. Të ardhurat e veta për banor në NJQV-të ekzistuese dhe ZF Kavajë




Burimi: Ministria e Financave 2012. Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve

Le të shikojmë shpërndarjen e personelit të NJQV-ve nga këndvështrimi i kostove për NJQV-në dhe qytetarët. Gjithmonë duke konsideruar të njëjtat kushte ekonomike, financiare por njëkohësisht edhe të përgjegjësive dhe funksioneve, në grafikun më poshtë (figura 39) paraqiten shpenzimet e personelit për banor në NJQV-të ekzistuese të ZF Kavajë.

Duke konsideruar se krijimi i njësisë së re vendore, referuar kufijve të zonës funksionale, do të përqendrojë një pjesë të shërbimeve të cilat sot ofrohen në të gjitha NJQV-të, vetëm në një qendër (të tilla janë zyrat e financave, burimet njerëzore, drejtoritë e mjedisit, drejtoritë e planifikimit urban, kadastrat urbane, etj.), kemi llogaritur se shpenzimet e NJQV-së së re që do të krijohen vetëm për personelin, do të reduktohen me të paktën 70% në rastin e ZF Kavajë. Si rezultat kosto e personelit për banor do të reduktohet nga një mesatare që sot rezulton rreth 3390 lekë/banor në rreth 2800 lekë për banor.

Figura 39. Shpenzimet e personelit për banor në NJQV-të ekzistuese dhe në ZF Kavajë




Burimi: Ministria e Financave 2012. Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve

Me të njëjtën logjikë analizojmë edhe kostot për shpenzimet operative të NJQV-ve ekzistuese dhe të NJQV-së të propozuar sipas kufijve të ZF Kavajë.

Gjatë kësaj analize duhet të kemi parasysh se, në shpenzimet operative llogariten të gjitha shpenzimet e NJQV-ve për shpenzimet e tyre rutine të mirëmbajtjes apo edhe ofrimit të shërbimeve, por njëkohësisht edhe kostot e qirave dhe mirëmbajtjes së godinave ekzistuese të NJQV-ve. Në një llogaritje të përgjithshme paraprake, vlerësojmë se kostot operative do të reduktohen me rreth 5% si rezultat i efikasitetit të ambienteve dhe stafit pas organizimit të propozuar. Grafiku më poshtë prezanton pikërisht këtë efikasitet, të shprehur në reduktimin e kostove operative për banor në ZF të Kavajës krahasuar me mesataren e NJQV-ve përbërëse të ZF-së.


Figura 40. Shpenzimet operative për banor në NJQV-të ekzistuese dhe në ZF Kavajë



Burimi: Ministria e Financave 2012. Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve

Duke konsideruar kushtet ekonomike dhe financiare të pandryshueshme, por njëkohësisht edhe tërësinë e përgjegjësisve dhe funksioneve të NJQV-ve, bëjmë supozimin se kursimi i fondeve për shpenzimet operative dhe të personelit do të përdoret në masën 100% në rritjen e investimeve kapitale, analizojmë nivelin e investimeve të pritshme për banor në ZF të propozuar.

Figura 41. Investimet për banor në NJQV-të ekzistuese dhe në ZF Kavajë



Burimi: Ministria e Financave 2012. Interpretimi dhe paraqitja grafike tonat

Figura 41 tregon nivelin e investimeve për banor në NJQV-të ekzistuese, si dhe nivelin e investimeve të pritshme në NJQV-në e propozuar. Siç vihet re nga grafiku niveli i investimeve në ZF Kavajë është rreth 4080 lekë për banor – 20% më i lartë, krahasuar me nivelin mesatar të investimeve sot në të gjitha NJQV-të ekzistuese i cili prezantohet në rreth 3390 lekë/banor.

Përfundime

Përfundimet për zonën e rrethit Kavajë janë llogaritur në variantin me dy njësi funksionale më vete, përkatësisht ZF Kavajë dhe ZF Rrogozhinë.

ZF Kavajë (Kavajë, Synej, Luz i Vogël, Golem, Helmës)

ZF Kavajë e përbërë nga 5 njësi ekzistuese, ka popullsi prej 40,094 banorë, nga mesatarisht 8,019 banorë aktualisht në NJQV ekzistuese;

Reduktim i shpenzimeve administrative të njësisë me rreth 31,4 milionë lekë në vit (shpenzime paga dhe operative);

Ulja e shpenzimeve të personelit për banor në masën 28%, nga 3,392 lekë në 2,798 lekë për banor;

Mirëadministrimi i burimeve financiare mund të sjellë rritje të investimeve në masën 23%, ose nga 136 milionë lekë, në 167 milionë lekë në vit;


Investimet për banor mund të rriten nga 3,392 lekë, në 4,175 lekë për banor në njësinë e re;

Bashkimi në një zonë funksionale mund të sigurojë rishpërndarje më të mirë të të ardhurave duke zbutur pabarazitë e mëdha mes zonave; pa llogaritur efektet e eficiencës së rritur në menaxhimin e të ardhurave: mesatarisht ZF e re do të realizonte 5,139 lekë të ardhura të veta për frymë, ose 10% më shumë se mesatarja e të ardhurave të veta për frymë në njësitë ekzistuese (4,664 lekë) dhe 57% më shumë se mediani (3,276 lekë).

Zona funksionale Rrogozhinë

Zona funksionale Rrogozhinë shtrihet dhe përfshin pesë NJQV ekzistuese: Rrogozhinë, Lekaj, Sinaballaj, Kryevidh dhe Gosë. Përcaktimi i zonës funksionale brenda këtyre kufijve vjen si rezultat i ndërveprimit që ndodh mes banorëve, bizneseve apo aktorëve të tjerë që operojnë dhe përqendrohen në këtë zonë.

Figura 42. Zona funksionale Rrogozhinë sipas Variantit 4 dhe 5 të propozuar (respektivisht me 57 dhe 63 zona funksionale në nivel vendi)



Do të shikojmë më poshtë efektet demografike, ekonomiko-financiare, në ofrimin e shërbimeve, distancat dhe aksesin referuar zonës funksionale të propozuar.

Efektet demografike

Popullsia e zonës funksionale Rrogozhinë, duke iu referuar të dhënave të Census-it 2011 rezulton rreth 22 148 banorë. Sipërfaqja e ZF Rrogozhinë është 224 km² dhe dendësia e popullsisë në këtë zonë funksionale është 99 banorë/km². Referuar të dhënave të Regjistrit të Gjendjes Civile raportohet rreth 39 612 banorë.

Tabela 9. Të dhëna demografike për ZF Rrogozhinë dhe NJQV-të ekzistuese që përfshihen në të

Nr.	Njësia Vendore	Popullsia INSTAT 2011	Dendësia INSTAT banorë/km²	Sipërfaqja km²	RGJC Popullsia Janar 2012
1	GOSË	4120	86	48	8200
2	KRYEVIDH	4662	72	65	8981
3	LEKAJ	5126	89	58	9166
4	RROGOZHINË	7049	561	13	13 265
5	SINABALLAJ	1191	30	40	-
Zonë funksionale RROGOZHINË		22 148	99	224	39 612

Burimi: INSTAT, Census 2011 & RGJC 2012

E kemi theksuar më sipër që ZF Rrogozhinë ngelet e diskutueshme për sa i përket ndërveprimit të qenësishëm si nga pikëpamja institucionale ashtu edhe e rrjeteve dhe marrëdhënieve të biznesit. Gjithsesi, ekzistojnë premiset për një farë qendre e cila në varësi të politikave të investimeve mund të theksohet ose jo.

Efektet ekonomiko-financiare

Le të shikojmë ndërveprimin dhe efektet ekonomike dhe financiare në zonat funksionale të propozuara.

Tabela 10. Ndërmarrjet aktive sipas NJQV-ve ekzistuese në ZF Rrogozhinë dhe aktivitetit ekonomik

Komuna / Bashki	Biznese gjithsej	Popullsia INSTAT 2011	Biznese/ 1000 banorë	Bujqësia e Peshkimi	Industria	Ndërtimi	Tregtia	Shërbime
Rrogozhinë	214	7049	30	*	26	4	93	89
Gosë	99	4120	24	6	13	*	54	25
Kryevindh	135	4662	29	11	12	*	29	80
Lekaj	90	5126	18	5	16	*	37	31
Sinaballaj	6	1191	5	*	*	*	*	*
ZF	544	22 148	25	22	67	4	213	225
RROGOZHI NË								

Burimi: INSTAT 2012


Edhe në rastin e kësaj zone funksionale aktivitetet kryesore duket se janë ato në fushën e shërbimeve dhe tregtisë, por disa aktivitete në fushën e industrisë. Në NJQV-në e Sinaballaj përqendrimi i bizneseve është më i ulët, ndërkohë që përqendrimi dhe ndërveprimi në bashkinë e Rrogozhinës duket të jetë i lartë.

Le të shikojmë ndikimin që do të kishte krijimi i një njësie të re vendore, duke iu referuar kufijve të zonës funksionale Rrogozhinë të propozuar dhe duke konsideruar të gjithë faktorët që ndikojnë buxhetin dhe të ardhurat e njësive ekzistuese vendore të njëjtë.

Siç kemi përmendur edhe më sipër, qëllimi dhe përfitimi kryesor nga riorganizimi i njësive vendore sipas zonave funksionale do të ishte një rishpërndarje më e mirë e shpenzimeve vendore dhe efikase në ofrimin e shërbimeve.

Kështu, nëse i referohemi nivelit të shpenzimeve për banor që sot kanë NJQV-të që përbëjnë ZF të Rrogozhinës, vëmë re se ato lëvizin prej 4680 lekë/banor në Lekaj dhe në 8940 lekë/banor në Rrogozhinë. Në kontekstin e zonës funksionale Rrogozhinë në të njëjtat kushte të shpërndarjes së buxhetit (transfertat dhe të ardhurat e veta të njësive), buxheti për banor do të ishte 6950 lekë, pra rreth 50% më i lartë se buxheti i NJQV-së më të varfër brenda zonës funksionale.

Figura 43. Buxheti total për banor në NJQV-të ekzistuese dhe ZF Rrogozhinë




Burimi: Ministria e Financave 2012. Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve

Thujse e njëjta tendencë prezantohet në lidhje me të ardhurat vendore të krijuara në NJQV-të ekzistuese dhe të parashikuara në ZF Rrogozhinë të propozuar më sipër.

Sot të ardhurat vendore të komunës Lekaj janë 1100 lekë/banor – më të ulëtat mes NJQV-ve të përfshira në ZF Rrogozhinë, ndërsa të ardhurat vendore të komunës Sinaballaj janë 16 000 lekë/banor. Mesatarisht të ardhurat për banor të parashikuara për ZF Rrogozhinë janë rreth 3150 lekë (figura 43).

Figura 43. Të ardhurat e veta për banor në NJQV-të ekzistuese dhe ZF Rrogozhinë




Burimi: Ministria e Financave 2012. Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve

Le të shikojmë shpërndarjen e personelit të NJQV-ve nga këndvështrimi i kostove për NJQV-në dhe qytetarët. Gjithmonë duke konsideruar të njëjtat kushte ekonomike, financiare por njëkohësisht edhe të përgjegjësive dhe funksioneve, në grafikun më poshtë (figura 44) paraqiten shpenzimet e personelit për banor në NJQV-të ekzistuese të ZF Rrogozhinë.

Duke konsideruar se krijimi i njësisë së re vendore, duke iu referuar kufijve të zonës funksionale, do të përqendrojë një pjesë të shërbimeve të cilat sot ofrohen në të gjitha NJQV-të, vetëm në një qendër (të tilla janë zyrat e financave, burimet njerëzore, drejtoritë e mjedisit, drejtoritë e planifikimit urban, kadastrat urbane, etj.), kemi llogaritur se shpenzimet e NJQV-së së re që do të krijohen vetëm për personelin, do të reduktohen me të paktën 70% në rastin e ZF Rrogozhinë. Si rezultat kosto e personelit për banor do të reduktohet nga një mesatare që sot rezulton rreth 2570 lekë/banor në rreth 1560 lekë për banor.

Figura 44. Shpenzimet e personelit për banor në NJQV-të ekzistuese dhe në ZF Rrogozhinë




Burimi: Ministria e Financave 2012. Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve

Me të njëjtën logjikë analizojmë edhe kostot për shpenzimet operative të NJQV-ve ekzistuese dhe të NJQV-së të propozuar sipas kufijve të ZF Rrogozhinë.

Gjatë kësaj analize duhet të kemi parasysh se, në shpenzimet operative llogariten të gjitha shpenzimet e NJQV-ve të mirëmbajtjes apo edhe ofrimit të shërbimeve, por njëkohësisht edhe kostot e qirave dhe mirëmbajtjes së godinave ekzistuese të NJQV-ve. Në një llogaritje të përgjithshme paraprake, vlerësojmë se kostot operative do të reduktohen me rreth 5% si rezultat i efikasitetit të ambienteve dhe stafit pas organizimit të propozuar. Grafiku më poshtë prezanton pikërisht këtë efikasitet, të shprehur në reduktimin e kostove operative për banor në ZF të Rrogozhinës krahasuar me mesataren e NJQV-ve përbërëse të ZF-së.


Figura 45. Shpenzimet operative për banor në NJQV-të ekzistuese dhe në ZF Rrogozhinë



Burimi: Ministria e Financave 2012. Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve

Duke konsideruar kushtet ekonomike dhe financiare të pandryshueshme, por njëkohësisht edhe tërësinë e përgjegjësive dhe funksioneve të NJQV-ve, bëjmë supozimin se kursimi i fondeve për shpenzimet operative dhe të personelit do të përdoret në masën 100% në rritjen e investimeve kapitale, analizojmë nivelin e investimeve të pritshme për banor në ZF të propozuar.

Figura 46. Investimet për banor në NJQV-të ekzistuese dhe në ZF Rrogozhinë



Burimi: Ministria e Financave 2012. Interpretimi dhe paraqitja grafike e autorëve

Figura 46 tregon nivelin e investimeve për banor në NJQV-të ekzistuese, si dhe nivelin e investimeve të pritshme në NJQV-në e propozuar. Siç vihet re nga grafiku, niveli i investimeve në ZF Rrogozhinë është rreth 2660 lekë për banor – rreth 70% më i lartë, krahasuar me nivelin mesatar të investimeve sot në të gjitha NJQV-të ekzistuese, i cili prezantohet në rreth 1580 lekë/banor.

Përfundime

ZF Rrogozhinë (Rrogozhinë, Sinaballaj, Lekaj, Kryevidh, Gose)

ZF Rrogozhinë e përbërë nga 5 njësi ekzistuese, ka popullsi prej 22,148 banorë, nga mesatarisht 4,430 banorë aktualisht në NJQV ekzistuese;

Reduktim i shpenzimeve administrative të njësisë me rreth 25,4 milionë lekë në vit, ose 21% e shpenzimeve administrative (shpenzime paga dhe operative) dhe 15% e shpenzimeve vjetore gjithsej;

Ulja e shpenzimeve të personelit për banor në masën 39%, nga 2,574 lekë në 1,562 lekë për banor;

Mirëadministrimi i burimeve financiare mund të sjellë rritje të investimeve në masën 73%, ose nga 35 milionë lekë, në 60,4 milionë lekë në vit;

Investimet për banor mund të rriten nga 1,580 lekë, në 2,727 lekë për banor në njësinë e re;

Bashkimi në një zonë funksionale mund të sigurojë rishpërndarje më të mirë të të ardhurave duke zbutur pabarazitë e mëdha mes zonave; pa llogaritur efektet e eficiencës së rritur në menaxhimin e të ardhurave: mesatarisht ZF e re do të realizonte 3,154 lekë të ardhura të veta për frymë. Kjo shifër është më e ulët se mesatarja e të ardhurave të veta për frymë në njësitë ekzistuese (5,160 lekë) e cila është e lartë pasi njëra prej njësive (Sinaballaj) ka nivel shumë të lartë të ardhurash për frymë, në shpërpjesëtim të konsiderueshëm me njësitë e tjera. Mesatarja e të ardhurave të veta në ZF e re është 32% më e lartë se mediani (2,383 lekë) i të ardhurave të veta për frymë në NJQV ekzistuese.

QARKU VLORË

Në këtë kapitull prezantohet një panoramë e situatës dhe performancës fiskale dhe financiare të NJQV-ve në Qarkun e Vlorë. Kapitulli fillon me një profil të përgjithshëm të qarkut dhe njësie vendore që bëjnë pjesë në të, vazhdon me një analizë krahasuese mes NJQV-ve të qarkut duke evidentuar pabarazitë dhe dallimet mes njësie vendore, performancën e tyre financiare dhe fiskale si dhe mundësitë dhe pamundësitë në zhvillimin ekonomik dhe konkurrueshmërinë mes njësie vendore.

Profili i Qarkut Vlorë

Qarku i Vlorës përbëhet nga 3 rrethe: Delvinë, Sarandë dhe Vlorë, si dhe 26 njësi të qeverisjes vendore (NJQV) të organizuara në tre rrethe; përkatësisht 4 njësi në rrethin e Delvinës; 9 në rrethin e Sarandës dhe 13 në rrethin e Vlorës. Qarku i Vlorës ka një popullsi prej 175.640 banorësh (në Rrethin e Delvinës – 11.717 banorë; në Rrethin e Sarandës – 37.798 banorë dhe në Rrethin e Vlorës – 126.125 banorë) (INSTAT, Census 2011).

Tabela 144 Ndryshimi i popullsisë në qarkun Vlorë gjatë viteve 2001-2011

Rrethi	NJQV	INSTAT 2011	INSTAT 2001	Diferenca	Diferenca në %
Delvinë	Delvinë	5.754	6421	-667	-10%
Delvinë	Finiq	1.333	735	598	81%
Delvinë	Mesopotam	2.786	1320	1466	111%
Delvinë	Vergo	1.844	2289	-445	-19%
	Gjithsej Delvinë	11.717	10,765	952	9%
Sarandë	Aliko	3.849	2668	-4.963	1181
Sarandë	Dhivër	1.396	1595	-5.193	-199
Sarandë	Konispol	2.123	2230	-949	-107
Sarandë	Ksamil	2.994	1840	-6.230	1154
Sarandë	Livadhja	1.165	3393	-9.252	-2228
Sarandë	Lukovë	2.916	3149	-6.693	-233
Sarandë	Markat	1.859	2713	-1.215	-854
Sarandë	Sarandë	17.233	15247	-23.511	1986
Sarandë	Xarë	4.263	2254	-3.302	2009
	Gjithsej Sarandë	37.798	35,089	2,709	7.7%
Vlorë	Armen	2.965	5707	-2742	-48%
Vlorë	Brataj	2.849	4901	-2052	-42%
Vlorë	Himarë	2.822	3278	-456	-14%
Vlorë	Kotë	3.516	3556	-1476	-42%
Vlorë	Novoselë	8.209	5064	-1548	-31%
Vlorë	Orikum	5.503	10640	-2431	-23%
Vlorë	Qender	7.621	6376	-873	-14%
Vlorë	Selenicë	2.235	10496	-2875	-27%
Vlorë	Sevaster	1.720	3949	-1714	-43%
Vlorë	Shushicë	3.981	3410	-1690	-50%
Vlorë	Vllahinë	3.111	6212	-2231	-36%
Vlorë	Vlorë	79.513	5887	-2776	-47%
Vlorë	Vranisht	2.080	77652	1861	2%
	Gjithsej Vlorë	126.125	147,128	-21,003	-14%
	Gjithsej qarku Vlorë	175.640	192,982	-17,342	-9%

Burimi: INSTAT Census 2001, 2011

Figura 285 NJQV-të në qarkun e Vlorës sipas popullsisë



Burimi: INSTAT, Census 2011; Llogaritjet e autorëve

Trendi në uljen e popullsisë është i qartë edhe nëse krahasohen të dhënat e Census-it të vitit 2011 me Census-in e vitit 2001. Në vitin 2001 në qarkun e Vlorës ishin regjistruar 192.982 banorë, 9% (17.342 banorë) më shumë se dhjetë vjet më vonë. Megjithatë, në rrethet e Delvinës dhe Sarandës është shtuar popullsia gjatë këtij dhjetëvjeçari: Delvina është rritur me 9% banorë dhe Saranda me 8% banorë, kryesisht falë rritjes në Sarandë, Xarrë dhe Aliko.

Popullsia e Qarkut Vlorë përbën rreth 6.27% të popullsisë së vendit, referuar të dhënave të Census-it 2011 dhe popullsia mesatare, për njësi të qeverisjes vendore në këtë qark rezulton 6.755 banorë/NJQV. Kjo mesatare është rreth 15% më e ulët se mesatarja e popullsisë për NJQV në rang vendi (8.016 banorë/NJQV). Nisur nga morfologjia e territorit por edhe nga lëvizjet migratore e demografike të viteve të fundit rreth 77% e NJQV-ve kanë popullsi më të vogël se 5.000 banorë dhe vetëm 8% e NJQV-ve kanë popullsi më të lartë se 10.000 banorë (Saranda – 17.233 banorë dhe Vlora – 79.513 banorë).

Dendësia mesatare e popullsisë është 174 banorë/km², krahasuar me 97.4 banorë/km² në rang vendi. Vlora (2.900 banorë/km²) dhe Saranda (483 banorë/km²) janë njësitë vendore me dendësi më të lartë, ndërsa Komuna Livadhjé (6.79 banorë/km²) është njësia me dendësinë më të ulët. Me dendësi të ulët janë edhe njësitë Vergo, Dhivër, Sevaster, Orikum e Lukovë.

Disa komuna të qarkut Vlorë (rrethi Delvinë dhe Sarandë) kanë popullsi dominuese që i përket minoritetit grek, ndaj këto zona propozohet të grupohen nën zonën funksionale të Livadhjësë (si komuna më e madhe e zonës), pavarësisht se nuk i përmbushin kriteret e tjera për zonat funksionale.

Ndërveprimi institucional në qarkun Vlorë

Sot në Shqipëri, si rudiment i organizimit më të hershëm të shtetit dhe qeverisjes, në qendrat e rretheve janë përqendruar institucionet kryesore qendrore (kryesisht Ministrinë e Linjës) në nivelin më pranë qytetarit. Në qendrat e rretheve vendosen zyrat arsimore, zyrat e punësimit, drejtoritë shëndetësore rajonale, drejtoritë e shërbimit pyjor, gjykata e rrethit gjyqësor, prokuroria, degët e tatimeve. Në disa prej qendrave të rrethit janë vendosur dhe një sërë institucioneve sociale, shëndetësore dhe arsimore: shtëpitë e të moshuarve, shtëpitë e foshnjës, qendrat e formimit profesional, qendrat e zhvillimit, etj.

Institucionet kryesore në Qarkun Vlorë janë Drejtoria Arsimore Rajonale, Drejtoria Rajonale e Bujqësisë, Drejtoria Rajonale e Shëndetit Publik, Drejtoria Rajonale e Pyjeve, Drejtoria Rajonale e Policisë e Qarkut Vlorë, Agjencia Rajonale e Mjedisit e Qarkut Vlorë. Të gjitha këto Drejtori janë të vendosura në qytetin e Vlorës dhe mbulojnë aktivitetet përkatëse të tri rretheve. Drejtoritë e tatimeve janë të vendosura në qendrën e qarkut dhe në Sarandë.


Vendndodhja fizike e këtyre institucioneve në qendrat e rretheve të qarkut Vlorë, përkthehet në një ndërveprim të vazhdueshëm të banorëve, të organizuar në njësitë rreth këtyre qendrave. Kjo është ndër arsyet kryesore që bën që qendrat e rretheve të shndërrohen në pika qendrore për sa i përket ndërveprimit institucional (pra të institucioneve me njëra-tjetrën), por njëkohësisht dhe të qytetarit me institucionet. Në bazë të këtyre shkëmbimeve identifikohen qartë Vlora, Saranda dhe Delvina si qendra të shkëmbimit institucional.

Ndërveprimi ekonomik në qarkun Vlorë

Ndërveprimi ekonomik vlerësohet nëpërmjet lëvizjeve për punësim: shërbimet, partneritetet, rrjeti i infrastrukturës, zinxhiri i vlerave (bizneset), etj. dendësia e popullsisë, shpeshësia e udhëtimit për në punë; përqendrimi i bizneseve dhe larmia i aktiviteteve, potenciali zhvillimit ekonomik; cilësia e jetës dhe shërbimet.

Qarku Vlorë gjeneron rreth 6% të PBB-së në nivel kombëtar. Kjo peshë specifike e ulët e qarkut në ekonominë kombëtare tregon që mund të ketë pabarazi të mëdha midis qendrës së qarkut dhe rrethinave. PBB për frymë në Qarkun e Vlorës është pothuajse e njëjtë me mesataren kombëtare. Në ekonominë e Vlorës rolin kryesor e luajnë tregtia dhe shërbimet, çka është e natyrshme duke marrë parasysh pozitën gjeografike të Vlorës si një port i rëndësishëm, por edhe qarkun, që përfshin një pjesë të madhe të bregdetit shqiptar. Figura e mëposhtme paraqet shpërndarjen e bizneseve në qarkun e Vlorës, sipas përqendrimit dhe llojit të aktivitetit të tyre.

Figura 145. Përqendrimi i bizneseve dhe lloji i aktivitetit në qarkun e Vlorës



Burimi: INSTAT, paraqitja grafike e autorëve


Industria prodhon vetëm rreth 11% të vlerës së shtuar dhe bujqësia rreth 27%. Shpërndarja e punësimit sipas sektorëve tregon përqendrim më të lartë të punësimit në zonat urbane në industri dhe shërbime, përkundrajt bujqësisë si burimi kryesor i punësimit në zonat rurale. Në zonat urbane të Vlorës burimi kryesor i punësimit janë shërbimet dhe tregtia, ndërkohë që në zonat rurale mbizotëron bujqësia.

Duke iu referuar përqendrimit të bizneseve dhe shumëllojshmërisë së aktivitetit të tyre (i cili indirekt dëshmon për nivel më të lartë të shërbimeve) në Qarkun e Vlorës, sërish identifikohen qartë tri zona funksionale: ajo me qendër Vlorën, ajo me qendër Sarandën dhe, disi më pak, ajo me qendër Delvinën. Gjithashtu, identifikohet paksa edhe zona e Himarës, e cila, si qendër turistike ka përqendrim të lartë të bizneseve dhe që shtrihet deri në veri të Sarandës.

Për të qartësuar me tej zonat funksionale, le të shikojmë drejtimet kryesore të lëvizjes së të punësuarve brenda qarkut të Vlorës. (Figura).

Vlora dhe Saranda shërbejnë si qendrat më të mëdha urbane të zonës duke qenë qytete me traditë të konsoliduar. Vlora, në veçanti, është qendër jo vetëm administrative, por edhe qendër biznesi dhe e aktivitetit ekonomik që tërheq një pjesë shumë të mirë të popullsisë përreth në aktivitete të përditshme.

Figura 3. Ndërveprimi ekonomik në Qarkun e Vlorës



Harta e mësipërme tregon flukset kryesore të lëvizjes së të punësuarve. Qendrat urbane brenda zonave funksionale ofrojnë infrastrukturën, shërbimet dhe punësimin, ndërkohë që qendrat rurale përfaqësojnë furnizimin me produktet bujqësore dhe kryesisht fuqinë punëtore. Përsëri konfirmohen zonat funksionale me qendër si Vlorën, Sarandën dhe Delvinën; por

njëkohësisht lexohen tendencat për krijimin e zonave të tjera funksionale më të vogla me qendër Himarën dhe deri diku edhe Orikumin. Këto të fundit kanë gjasa të shërbejnë si qendra për punësim sezonal.

Le të shikojmë impaktin që do të kishte krijimi i një njësie të re vendore duke iu referuar kufijve të zonës funksionale të propozuar dhe duke konsideruar të gjithë faktorët që prekin buxhetin dhe të ardhurat e njësive vendore ekzistuese.

Siç kemi përmendur edhe më sipër qëllimi dhe përfitimi kryesor nga riorganizimi i njësive vendore sipas zonave funksionale do të ishte një rishpërndarje më e mirë e shpenzimeve vendore dhe efiçenca në ofrimin e shërbimeve.

Njësitë vendore të Qarkut Vlorë zënë rreth 8,4% të totalit të shpenzimeve vendore, ose 0,21% të PBB-së. Niveli më i lartë i shpenzimeve vihet re në vitin 2010 - rreth 9,6% e buxhetit vendor, krahasuar me 8,2% në vitin 2012. Tendanca e shpenzimeve të NJQV-ve të Qarkut Vlorë është disi e ndryshme nga ajo e pjesës më të madhe të qarqeve, në të cilat vihet re niveli më i lartë i shpenzimeve gjatë vitit 2009 dhe rënia e ndjeshme e tyre gjatë viteve 2010 – 2012. Bizneset po ashtu duket se preferojnë të vendosen në qendrat e rretheve po për të njëjtën arsye; praninë e institucioneve e cila shoqërohet njëkohësisht me kapacitete më të mira njerëzore, cilësi më të lartë shërbimi dhe mundësi më të mira zgjedhjeje për sa i përket fushës së aktivitetit. Pjesa dërrmuese e bizneseve në qarkun e Vlorës janë përqendruar në qytetin e Vlorës, ndërkohë që edhe qytetet e Sarandës dhe Delvinës kanë përqendrim më të lartë të bizneseve në krahasim me zonat përreth.

Tabela 2. Të dhëna ekonomike dhe financiare për qarkun e Vlorës

	Popullsia census	Biznese/ 1000 banorë	Të ardhurat e veta	Shpenzime personeli	Shpenzime operative	Investime	Investime për fryme	Buxheti total
Delvinë	5,754	40	20,299	20000	38000	5000	351	63,000
Finiq	1,333	74	3,544	5000	11000	7000	1035	23,000
Mesopotam	2,786	19	7,041	6000	13000	24000	3788	43,000
Vergo	1,844	12	3,437	6000	6000	0	0	12,000
Aliko	3,849	10	8,752	9000	6000	14000	1568	29,000
Dhivër	1,396	21	5,403	9000	16000	3000	454	28,000
Konispol	2,123	28	12,948	15000	8000	7000	2288	30,000
Ksamil	2,994	88	25,062	19000	24000	13000	1416	56,000
Livadhja	1,165	46	7,398	9000	22000	12000	1153	43,000
Lukovë	2,916	47	25,677	9000	28000	19000	1985	56,000
Markat	1,859	6	1,103	6000	9000	0	0	15,000
Sarandë	17,233	105	343,661	121000	197000	78000	1928	396,000
Xarrë	4,263	17	13,733	9000	17000	0	0	26,000
Armen	2,965	13	3,736	8000	8000	39000	5726	55,000
Brataj	2,849	13	1,930	6000	8000	5000	992	19,000
Himarë	2,822	131	114,092	38000	53000	59000	4472	150,000
Hore Vranisht	2,080	11	2,084	9000	9000	4000	973	22,000
Kotë	3,516	23	8,743	8000	8000	8000	1209	24,000
Novoselë	8,209	24	28,702	9000	30000	12000	728	51,000
Orikum	5,503	77	43,271	36000	37000	14000	1222	87,000
Qendër	7,621	30	19,033	10000	48000	24000	1303	82,000
Selenicë	2,235	22	5,391	18000	12000	5000	717	35,000
Sevaster	1,720	9	1,619	7000	6000	7000	2139	20,000
Shushicë	3,981	26	8,302	9000	8000	7000	745	24,000
Vllahinë	3,111	16	3,296	12000	14000	68000	9307	94,000
Vlorë	79,513	56	591,092	127000	447000	183000	1352	762,000

Rrjeti rrugor në qarkun e Vlorës

Qarku Vlorë ka një infrastrukturë të zgjeruar rrugore, me një gjatësi prej 445 km. Akset kryesore kombëtare që përshkojnë qarkun dhe ato që bashkojnë qendrat përkatësisht të Vlorës, Himarës dhe Sarandës me pjesën tjetër të vendit janë rindërtuar vitet e fundit, duke i dhënë hov zhvillimit të turizmit dhe aktiviteteve të lidhura me to (kryesisht ndërtimi dhe shërbimet). Megjithatë, disa zona të qarkut Vlorë kanë reliev malor dhe akses të kufizuar në infrastrukturën rrugore. Kjo është e vërtetë për shumicën e malësisë së Kurveleshit, por edhe për disa zona në jug të Sarandës dhe Delvinës, ndonëse këto janë fushore (Figura 4).

Figura 4. Harta administrative dhe rrjeti rrugor në qarkun e Vlorës



Burimi: MÇV

Figura 5. më poshtë tregon distancat e udhëtimit për në qendrat e banuara në qarkun e Vlorës.

Figura 5. Distancat e njësive nga qendra urbane më e afërt



Siç duket, në përgjithësi njësitë nuk janë më larg se 1 orë nga qendra (Vlorë, Sarandë apo Delvinë). Transporti publik është i kufizuar në këtë zonë. Ashtu siç është tipike për të gjithë vendin, transporti publik kryhet, kryesisht, nga furgonët dhe autobusët. Rrjeti hekurudhor nuk shtrihet përtej qytetit të Vlorës.

Tabela 3. Distancat e njësive nga qendra urbane më e afërt në qarkun Vlorë

Vlorë ZF 3	Sip.(km ²)	Distanca (në km)	Koha e udhëtimit t (min)	Sarandë ZF 2	Distanca në km	Koha e udhëtimit		
Armen	K	68	24	36	Aliko	K	9.1	13
Brataj	K	165	40	57	Dhivër	K	23.7	29
Himarë	B		71.5	69	Konispol	B	43.5	54
Horë	K	204	36.1	83	Ksamil	K	14	15
Vranisht								
Kotë	K	150	22.3	38	Livadhja	K	23.2	25
Novoselë	K	139	22.2	22	Lukovë	K	21	22
Orikum	B	324	17.3	19	Markat	K	38.6	54
Qendër	K	86			Sarandë	B	123	129
Selenicë	B	4	30.6	47	Xarrë	K	44	48
Sevaster	K	99	41.3	137	Delvinë		Distanca (në km)	Koha e udhëtimit (min)
					Delvinë	B	135	140
Shushicë	K	52	43	46.2	Finiq	K	9.3	10
Vllahinë	K	111	21	26	Mesopotam	K	13.6	14
Vlorë	B	23	0	0	Vërgo	K	16.2	33

Furnizimi me ujë të pijshëm dhe kanalizime

Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizime në qarkun e Vlorës kryhet nga 6 SH. A të ndërmarrjes së Ujësjetës Kanalizimeve.

Figura 6. Harta e mbulimit me ujë të pijshëm dhe kanalizime



Ndër këto, katër njësi e zotërojnë plotësisht shoqërinë (janë aksionarë të vetëm-Novosela, Orikumi, Selenica dhe Himara. Ndërkohë, SH. A. UK, Vlorë shërben për pesë njësitë e tjera të rrethit të Vlorës. Zona e mbulimit për shoqëritë e ujësjetësve të Sarandës dhe Delvinës përkon me shtrirjen e rretheve përkatëse.


Njësitë e Qarkut të Vlorës kanë furnizim me ujë të pijshëm për të paktën 64% të banesave (vlëra mesatare). Në qendrat urbane dhe rrethinat e tyre ky tregues është më i lartë, ndërkohë që përkeqësohet në zona më të largëta, si komuna Sevaster (Vlorë) furnizim në masën vetëm 9% apo komuna Livadhjã (Sarandë) me vetëm 4% furnizim. (INSTAT, Census, 2011). Shifrat janë të ngjashme edhe për mbulimin me sistemin e kanalizimeve. Mbulimi me shërbim është në nivelet mesatarisht rreth 76% në rrethin e Delvinës; 57% në rrethin e Sarandës dhe 51% në rrethin e Vlorës.

Propozimi i Zonave funksionale në qarkun e Vlorës


Sipas analizës së mësipërme, në qarkun e Vlorës identifikohen deri në 4 zona funksionale, si dhe një zonë e pestë – zona e Livadhjã, si zonë minoritare.

Varianti 1 me 30 NJQV – Zona Funktionale Vlorë me kufij që përputhen me kufijtë e rrethit së bashku me zonat përreth, janë të vetmet që propozohen brenda kufijve të qarkut, përveç zonës së Livadhjã.

Varianti 2 me 39 NJQV –



Varianti 3 me 47 NJQV – Brenda Qarkut të Vlorës identifikohen pesë zona funksionale: ZF Vlorë, ZF Sarandë, ZF Delvinë, ZF Himarë, si edhe ZF Livadhja.



Varianti 4 me 57 NJQV –



Varianti 5 me 63 NJQV –




Materiali më poshtë do të analizojë pikërisht këto 5 zona funksionale, duke u fokusuar në zonat funksionale të propozuara në variantin e 3-të.

Bazuar në analizën e mësipërme demografike, trendin e lëvizjes së popullsisë, zhvillimin ekonomik dhe social, në qarkun Vlorë identifikohen katër zona funksionale: Zona funksionale e Vlorës, që përfshin të gjitha njësitë e rrethit Vlorë, me përjashtim të bashkisë Himarë dhe komunës Vranisht, të cilat përfshihen në zonën funksionale Himarë; Zona funksionale Sarandë, e cila përkon me kufijtë administrativë të rrethit, me përjashtim të komunave minoritare; zona funksionale Delvinë, si dhe zona e Livadhjësë, e cila përmbledh disa komuna të rrethit të Sarandës dhe Delvinës, me popullsi kryesisht minoritare.

Tabela 146 Të dhëna krahasuese demografike

Zona funksionale	NJQV të nivelit të parë		Popullsia mesatare		Dendësia mesatare	
Vlorë	11	1	11,020	121,223	46	104
Himarë	3	1	2,451	4,902	13.4	13.8
Sarandë	5	1	5,694	28,472	146	111
Delvinë	2	1	3,799	7,598	61	41
Livadhjá	5	1	2,106	10,529	23	33

Figura 7. Harta e zonave funksionale në qarkun e Vlorës



Zona Funksionale Vlorë

Zona Vlorë (bashkia Vlorë, Selenicë, Orikum, komunat Armen, Brataj, Kotë, Novoselë, Qendër, Selenicë, Sevaster, Vllahinë)

Kjo zonë funksionale ka një popullsi prej 126.125 banorësh sipas të dhënave të Censur-it 2011 dhe është e përbërë nga 11 njësi ekzistuese (8 komuna dhe 3 bashki). Zona funksionale Vlorë ka pësuar një humbje të popullsisë me rreth 14% në krahasim me vitin 2001. Dendësia e popullsisë në zonën funksionale është 104 banorë për km², në krahasim me 46 banorë për km², që është vlera mesatare e dendësisë në njësitë ekzistuese.

Zhvillimi ekonomik dhe të dhënat ekonomike financiare

Të dhëna për bizneset


Zona funksionale Vlorë ka 5.678 biznese gjithsej, nga të cilat 78% janë të vendosur në qytetin e Vlorës. Mbi 60% e të punësuarve në zonat urbane të Vlorës veprojnë në sektorin e shërbimeve, ndërkohë që në zonat rurale mbizotëron bujqësia. Vlorë ka një përqindje papunësie rreth 19%, sipas të dhënave administrative për të papunët e regjistruar.

Tabela 147 Shpërndarja e bizneseve në zonën funksionale Vlorë

Rrethi	Njësia	B/K	Nr. i bizneseve	Biznese për 1000 banorë
Vlorë	Armen	K	40	13
Vlorë	Brataj	K	37	13
Vlorë	Kotë	K	80	23
Vlorë	Novoselë	K	196	24
Vlorë	Orikum	B	425	77
Vlorë	Qendër	K	226	30
Vlorë	Selenicë	B	50	22
Vlorë	Sevaster	K	15	9
Vlorë	Shushicë	K	105	26
Vlorë	Vllahinë	K	49	16
Vlorë	Vlorë	B	4,435	56
Gjithsej zona Vlorë para bashkimit			5,658	28
Gjithsej zona Vlorë mbas bashkimit			5,658	45

Burimi: INSTAT

Figura 8. Numri i bizneseve për 1000 banorë



Siç shihet nga të dhënat, shumica e njësive në zonën funksionale në shqyrtim kanë numër të ulët biznesesh për 1000 banorë. Kujtojmë se kjo është një zonë kryesisht bujqësore, me përjashtim të bashkisë Vlorë dhe Orikum, të cilat kanë shërbime të orientuara kryesisht drejt

turizmit, si edhe të bashkisë Selenicë, e cila ka përqendrim më të madh të orientuar drejt industrisë dhe shërbimeve, se zonat kufitare. Bizneset për 1000 banorë në njësitë e veçanta luhaten nga 9 (Sevaster), në 77 në Orikum. Mesatarisht, para bashkimit në këto 11 njësi ka 28 biznese për 1000 banorë. Ndërkohë, në zonën funksionale ky tregues rritet në pothuajse 45 biznese për 1000 banorë për të gjithë zonën funksionale. (Figura 8).

Figura 9 Ndërveprimi ekonomik ZF Vlorë



Të dhëna buxhetore


Të gjitha njësitë e zonës në vitin 2012 kishin një buxhet (të ardhura) prej rreth 1.2 miliardë lekësh. Nga këto, rreth 54% ose 826 milion janë realizuar në bashkinë e Vlorës, e cila realizon edhe 80% të të ardhurave të veta për të gjithë zonën. (Tabela 148)

Tabela 148 Të dhëna buxhetore për zonën funksionale Vlorë

	Të ardhura totale	Të ardhura të veta	Shpenzime totale
Armen	157,525	7,329	55,000
Brataj	41,725	2,467	19,000
Kotë	42,158	11,264	24,000
Novoselë	68,362	18,022	51,000
Orikum	96,057	40,772	87,000
Qendër	91,749	18,853	82,000
Selenicë	45,173	7,967	35,000
Sevaster	62,582	3,416	20,000
Shushicë	51,973	11,166	24,000
Vllahinë	46,829	6,090	94,000
Vlorë	826,135	512,798	762,000
Gjithsej ZF	1,530,266	640,145	1,253,000


Po të vërejmë të ardhurat për frymë (Figura 10), shohim se mesatarja e të ardhurave të veta për frymë për të gjitha njësitë është 3.217 lekë. Pas bashkimit, ky tregues rritet në 5.281 lekë për frymë për të gjithë zonën funksionale, ose bëhet 40% më e lartë se mesatarja dhe mbi 50% më e lartë se vlera mesatare e të ardhurave të veta për frymë në këtë zonë; çka mund të sigurojë një rishpërndarje më të mirë të të ardhurave.

Figura 10 Të ardhurat e veta për frymë në zonën funksionale Vlorë



Ndërkohë situata paraqitet disi më e ndryshme për treguesit mbi të ardhurat gjithsej të njërive: Mesatarja e të ardhurave për frymë në zonën funksionale pëson disi një rënie, në krahasim me mesataren e njërive individuale. Kjo shpjegohet me faktin se njësitë më të vogla subvencionohen në masë shumë të madhe nga buxheti i shtetit, duke rezultuar në të ardhura të larta për frymë.


Figura 11 Të ardhurat për frymë në zonën funksionale Vlorë



Të dhëna për shpenzimet

Po të vërejmë shpenzimet për frymë, të dhënat janë të ngjashme:

Figura 12 Shpenzimet për frymë në ZF Vlorë



Shpenzimet për frymë në zonën funksionale Vlorë do të ishin rreth 10.336 lekë, pra do të luhateshin rreth vlerës mesatare të shpenzimeve për frymë në njësitë ekzistuese. Në mënyrë të ngjashme si në treguesin e të ardhurave për frymë, edhe shpenzimet për frymë ndikohen shumë nga transfertat buxhetore specifike për njësi të veçanta, në mënyrë tipike, të vogla.

Tabela 149 Të ardhurat dhe shpenzimet për frymë në zonën funksionale Vlorë

	Të ardhura për frymë	Të ardhurat e veta për frymë	Shpenzime për frymë
Armen	53,128	2,472	18,550
Brataj	14,645	866	6,669
Kotë	11,990	3,204	6,826
Novoselë	8,328	2,195	6,213
Orikum	17,455	7,409	15,810
Qendër	12,039	2,474	10,760
Selenicë	20,211	3,565	15,660
Sevaster	36,385	1,986	11,628
Shushicë	13,055	2,805	6,029
Vllahinë	15,053	1,958	30,215
Vlorë	10,390	6,449	9,583
ZF gjithsej	12,133	5,281	10,336


Njësitë shpenzojnë mesatarisht 20% të buxhetit për shpenzime administrative, minimumi përfaqësohet nga komuna Vllahinë (13%) dhe maksimumi nga bashkia Selenicë me 51%. Treguesi i shpenzimeve administrative për zonën ulet në 13%, duke marrë parasysh kursimet e parashikuara të cilat do të trajtohen më poshtë; ndërkohë që investimet mund të rriteshin me rreth 8%.

Tabela 150 Struktura e shpenzimeve në zonën funksionale Vlorë

	Shpenzime totale	Shpenzime personel	Shpenzime operative të tjera	Investime 2012	Shp. personel si % e totalit	Operative të tjera si % e totalit	Inv si % e totalit 2012
Armen	55,000	8000	8000	39000	15%	15%	71%
Brataj	19,000	6000	8000	5000	32%	42%	26%
Kotë	24,000	8000	8000	8000	33%	33%	33%
Novoselë	51,000	9000	30000	12000	18%	59%	24%
Orikum	87,000	36000	37000	14000	41%	43%	16%
Qendër	82,000	10000	48000	24000	12%	59%	29%
Selenicë	35,000	18000	12000	5000	51%	34%	14%
Sevaster	20,000	7000	6000	7000	35%	30%	35%
Shushicë	24,000	9000	8000	7000	38%	33%	29%
Vllahinë	94,000	12000	14000	68000	13%	15%	72%
Vlorë	762,000	127000	447000	183000	17%	59%	24%
Mesatare	1,253,000	250,000	626,000	372,000	20%	50%	30%
Gjithsej ZF Vlorë*	1,253,000	176,200	608,100	463,700	13%	49%	38%

*Të dhënat për ZF Vlorë janë nxjerrë me supozimin, se do të kursehet rreth 70% e shpenzimeve administrative dhe 10% e shpenzimeve të tjera operative të njësive që suprimohen.

Figura 13. Struktura e shpenzimeve në Zonën Funksionale krahasuar me mesataren e njësive ekzistuese



Treguesit e investimeve

Treguesit e investimeve vrojtohen më mirë në një periudhë të gjatë kohore. Në këtë rast janë shqyrtuar të dhënat për pesë vjet, të cilat tregojnë se niveli i investimeve në këtë zonë ka qenë në përgjithësi në linjë me mesataren kombëtare. Nivelet më të ulëta të investimeve në këto vite vërehen në disa komuna më të largëta si Kotë dhe Sevaster (përkatësisht 17% dhe 27%), por edhe në bashkinë Vlorë (25%). Po të supozojmë se ritmi i investimeve do të ishte ulur në masën e kursimit nga shpenzimet administrative, pesha e investimeve në buxhetin total të zonës funksionale, do të arrinte në 35% të të ardhurave totale, nga 30% mesatarisht.

Tabela 151 Investimet si përqindje e buxhetit total në zonën funksionale dhe njësitë ekzistuese

Njësia	Investime 2008 - 2012	Të ardh. 2008-2012	Inv si % e të ardh totale 2008 - 2012
Armen	100,861	343,735	29%
Brataj	77,022	213,890	36%
Kotë	34,162	206,329	17%
Novoselë	166,704	469,118	36%
Orikum	313,899	642,892	49%
Qendër	176,307	430,738	41%
Selenicë	95,964	249,708	38%
Sevaster	51,970	193,658	27%
Shushice	112,744	303,653	37%
Vllahinë	136,101	253,829	54%
Vlorë	1,641,607	6,537,482	25%
Mesatare	2,907,341	9,845,032	30%
Zona funksionale Vlorë	3,624,016	9,845,032	35%


Analiza e efekteve administrative

Bashkimi i njësive në një zonë funksionale do të sjellë kursime veçanërisht nga shpenzimet që përdoren për personelin dhe një pjesë të shpenzimeve operative për mirëmbajtjen e zyrave. Në veçanti, në dhjetë nga njëmbëdhjetë njësitë e zonës funksionale do të shkurtohen pozicionet e kryetarit dhe të kabinetit të tij dhe shpenzimet për shpërblimet e këshilltarëve. Gjithashtu, shkurtime të mëtejshme do të ketë edhe nga realizimi i asaj që rëndom quhet si *economy of scope*, më konkretisht shkurtimi i funksioneve të përsëritura administrative të cilat do të përqendrohen në njësinë administrative të zonës funksionale. Të tilla pozicione janë sektori i menaxhimit financiar (specialistët e financës dhe buxhetit); sektori i prokurimeve dhe sektori i auditivit financiar, por edhe sektori i urbanistikës. Nga një llogari paraprake e kursimit të mundshëm del se nga bashkimi mund të kursehen rreth 60%-70% e kostove që përdoren për personelin dhe rreth 10% e shpenzimeve që përdoren për mirëmbajtjen e zyrave. Përlllogaritjet e mëposhtme janë bazuar mbi këtë model.

Tabela 152 Kursimet nga shpenzimet për personelin dhe mirëmbajtjen

	Kursimi nga personeli (70%)	Kursimi nga zyrat (10%)
Armen	5,600	800
Brataj	4,200	800
Kotë	5,600	800
Novoselë	6,300	3,000
Orikum	25,200	3,700
Qendër	7,000	4,800
Selenicë	12,600	1,200
Sevaster	4,900	600
Shushicë	6,300	800
Vllahinë	8,400	1,400
Vlorë		
Gjithsej	86,100	17,900
Kursimi si % e zërit përkatës	34%	3%
Kursimi si % e shpenzimeve totale	7%	1%

Figura 2864 Ngarkesa administrative e NJQV në ZF Vlorë



Me supozimet e bëra, në zonën funksionale Vlorë, pas bashkimit, kursehen mbi 100 milion lekë në vit, ose 7% e shpenzimeve totale të kryera nga të gjitha njësitë. Këto fonde të çliuara janë afërsisht sa një e treta e buxhetit të akorduar për investime në vitin e fundit në shqyrtim, çka do të thotë se me *këto kursime në teori investimet për zonën mund të rriteshin me rreth 28%*.

Treguesit Socialë

Niveli arsimor dhe faktori gjeografik

Në zonën e Vlorës kemi një shpërndarje të njëtrajtshme të treguesve të arsimit dhe shifrat nuk tregojnë dallime të mëdha midis numrit të fëmijëve dhe nxënësve për edukatorë dhe mësues. Numri i fëmijëve luhet nga 15 – 22, ndërsa ai i nxënësve luhet nga 10-17 për shkollat 9-vjeçare dhe 10-14 për shkollat e mesme. Nga pikëpamja e nivelit arsimor zotërimi i arsimit bazë është thuajse i njëtrajtshëm, kurse në zonat urbane të Vlorës dhe Orikumit arsimit mesëm ka epërsi ndaj tij.

Figura 287 Numri fëmijëve për edukator/mësues





Figura 288 Niveli arsimor sipas largësisë nga qendra e zonës



Spitalet dhe poliklinikat

Në Vlorë ka 2 spitale, ndërsa shpërndarja e mjekëve për familje (MPF) dhe mjekë specialistë (MS), është si më poshtë:

Tabela 153 Shpërndarja e mjekëve në ZF Vlorë

Bashkia Vlorë	Mjek familje	Mjek specialist
Q. SH. Nr. 1	9	0
Q. SH. Nr. 2	14	1
Q. SH. Nr. 3	11	0
Q. SH. Nr. 4	10	2
Q. SH. Nr. 5	6	0
Bashkia Orikum	0	0
Q. SH. Orikum	4	0
Q. SH. Selenicë	3	0
Komunat Vlorë		
Q. SH. Novoselë	7	0
Q. SH. Shushicë	4	0
Q. SH. Vllahinë	3	0
Q. SH. Armen	3	0
Q. SH. Kotë	3	0
Q. SH. Sevaster	1	0
Q. SH. Brataj	3	0
Q. SH. Vranisht	2	0
Q. SH. Nartë	7	0
Totali	140	6

Tabela 154 Raporti i mjekëve për 10 mijë banorë

Komuna/Bashkia	popullsia 2011	Nr. mjekësh	10.000 banorë
Armen	2.965	3	10.1
Brataj	2.849	3	10.5
Kotë	3.516	3	8.5
Novoselë	8.209	7	8.5
Orikum	5.503	4	7.3
Qendër	7.621	0	0.0
Selenicë	2.235	3	13.4
Sevaster	1.720	1	5.8
Shushicë	3.981	4	10.0
Vllahinë	3.111	3	9.6
Vlorë	79.513	151	19.0
Total	121.223	182	15.0

Shërbimet Sociale

Për sa i përket shpërndarjes së shërbimeve sociale, në qarkun Vlorë vërehet trend i përgjithshëm i përqendrimit të shërbimeve në qendrat e mëdha urbane, pjesa më e madhe e të cilave gjenden në Vlorë dhe vetëm dy qendra në Sarandë; Ndërkohë që zonat rurale mbeten të pambuluara me shërbime e banorët duhet të udhëtojnë drejt qendrës urbane më të afërt për të marrë shërbimin.

Gjithashtu, vihet re që peshën kryesore të shërbimeve sociale e mbajnë ofruesit jopublikë, NGO-të (OJQ-të), ndërsa kategoritë e shërbimeve janë të limituara dhe të ndikuara jo detyrimisht nga nevojat e komunitetit të cilit i shërbehet, por nga agjendat e donatorëve që janë dhe mbështetësit kryesorë të tyre. Ka pasur përpjekje për financime të qendrave ditore për moshën e tretë nga disa bashki si Tirana, Kukësi Shkodra, Vlora dhe Korça, por këto janë shumë të pamjaftueshme.

Ndërkohë që vihet re që për periudhën 2009-2011, ka pasur një fluks të kthimit të emigrantëve kryesisht në Tiranë, Fier e Vlorë. Të dhënat sociale nxjerrin në pah dhe një problematikë të re sociale që ka të bëjë me ri-integrimin e tyre në vend sipas specifikave të grup-moshës. Fenomeni i rikthimit shton presionin dhe ndaj zyrave të punës në të cilat vetëm në vitin 2013, u regjistruan si të papunë mbi 2,000 emigrantë punëkërkuar të kthyer nga emigracioni, ndërkohë që arsimimi dhe njohja e kualifikimeve të fituara jashtë vendit janë gjithashtu aspekte emergjente. Ndërkohë që qarqet Vlorë dhe Fier kanë dhe një numër të konsiderueshëm të komunitetit Rom dhe Egjiptian, të cilët kanë nevojë për shërbime specifike, të munguara aktualisht ose të ofruara në bazë projektesh, çka i bën ato të paqëndrueshme. Të gjitha këto aspekte shtojnë rëndësinë e një menaxhimi më të mirë të territorit në drejtim të njohjes së nevojave të komunitetit dhe ofrimit të shërbimit të pritshëm dhe efikas.

Argumenti kryesor është që komunat nuk kanë as kapacitetet financiare e as ato njerëzore për të ofruar shërbime sociale. Riorganizimi territorial pritet të ndikojë ndjeshëm në ofrimin e drejtë të shërbimeve, duke i dhënë një prioritet mbulimit të zonave rurale.

Tabela 155 E drejta e përfitimit të shërbimeve sociale

Kategoria e Shërbimit	Ofrues Publik	Ofrues Jo Publik
Shërbime sociale për të moshuar	1	0
Shërbime sociale për gra dhe vajza	0	1
Shërbime sociale për fëmijët	2	1
Shërbime sociale për familjet dhe komunitetet	0	1
Shërbime sociale për PAK	1	0
Shërbime sociale për të rinj me probleme sociale	0	1
Gjithsej	4	4

Ndihma ekonomike dhe aksesimi në shërbime

Situata e ndihmës ekonomike në Vlorë paraqitet më e komplikuar se në zonat e tjera të qarkut. Selenica dhe Vllahina duken me përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në skemën e ndihmës ekonomike me 27.7% dhe 13.8% përkatësisht. Pjesa tjetër e zonës paraqet nivele të ulëta të ndihmës ekonomike që qartëson më së miri pozicionin e mirë të Vlorës në aktivitetin ekonomik dhe të gjenerimit të të ardhurave.

Në zonat e tjera, përveç Delvinës (11.2%), Ksamilit (7.3%) dhe Hore Vranishtit (8.3%) nuk kemi raportim të shpërndarjes së ndihmës ekonomike. me vend të shohim gjendjen e furnizimit me ujë, rrjetin e kanalizimeve si edhe mjetet e komunikimit: internet e telefon apo edhe mobilitetin, të shprehur në numrin e automjeteve.

Në qarkun e Vlorës shohim një situatë problematike në lidhje me gjendjen e furnizimit me ujë dhe rrjetin e kanalizimeve. Komuna si Sevaster e Armen kanë tregues shumë të ulët për të dy rastet (9% dhe 18% për Sevasterin dhe 17% dhe 31% për Vllahinën). Diçka më e mirë situata në Sarandë ndonëse komuna Livadhjá raporton vetëm 4% shërbim me ujë të pijshëm. Për sa i përket makinave ato luhaten nga 15 në Selenicë në 0% në qytetin e Vlorës. Në Sarandë kemi mobilitet më të madh – nga 11% në Dhivër në 38% në qytetin e Sarandës. Aksesit në shërbimet telefonike dhe ato të internetit është tejet i ulët. Vlora ka treguesit më të lartë me 25% dhe 17% respektivisht që gjithsesi janë shumë të ulët, ndonëse ka një depërtim të lartë të telefonisë celulare (63%). Në Sarandë vihet re një numër shumë i ulët i telefonisë fikse (2%) me zonat e tjera që luhaten nga 8-23%. Për internetin qasja është shumë e ulët, bën përjashtim Saranda (gjithsesi me nivel të ulët 15%). Telefonia celulare përsëri ka depërtim më të mirë në komunën e Livadhjasë që raporton 93%. Interesant është fakti që qyteti i Sarandës përsëri ka nivel të ulët (6%).

Distanca e njësive të tjera nga qendra/njësia e re

Koha mesatare e udhëtimit drejt qendrës së zonës funksionale, bashkisë Vlorë, është 35 minuta. Qendra e kësaj zone, arrihet në më pak se një orë nga secila njësi, çka lehtëson mjaft ndërveprimin e qytetarëve me institucionet e qeverisjes vendore dhe aksesin në shërbime. Siç shihet edhe nga Figura 17, infrastruktura e transportit në Vlorë është e mirë në pjesën më të madhe të zonës funksionale, me përjashtim të aksesit për disa komuna (veçanërisht Brataj, Shushicë dhe Sevaster). Bashkimi në një zonë funksionale do të kërkojë edhe vëmendje të shtuar për akordimin e fondeve për të përmirësuar qasjen e këtyre banorëve drejt qendrës. Gjithsesi, pavarësisht bashkimit në një administratë unike për zonën funksionale, do të ruhen sportelet dhe zyrat e shërbimit bazë për qytetarët në komunat ekzistuese në mënyrë që të sigurohet shërbimi normal për nevojat e komuniteteve vendase.

Figura 17 Infrastruktura e transportit në ZF Vlorë



Tabela 156 Distancat e NJQV nga Qendra e re

		Sip. km ²	Distanca (në km)	Koha e udhëtimit (min)
Armen	K	68	24	36
Brataj	K	165	40	57
Kotë	K	150	22.3	38
Novoselë	K	139	22.2	22
Orikum	B	324	17.3	19
Qendër	K	86	NA	NA
Selenicë	B	4	30.6	47
Sevaster	K	99	41.3	137
Shushicë	K	52	43	46.2
Vllahinë	K	111	21	26
Vlorë	B	23	0	0

Burimi: MÇV, Google maps

Përfundime

ZF Vlorë me popullsi 121.223 banorë, nga mesatarisht 11.000 banorë për njësi.

Reduktim i shpenzimeve administrative (paga dhe të tjera operative) me rreth 104 milion lekë në vit, ose 8,3% e shpenzimeve totale të kryera nga të gjitha njësitë.

Ulje e shpenzimeve për pagat nga 250 milion lekë, në 164 milion lekë në vit. Shpenzimet e personelit për frymë do të ulëshin nga 2.062 lekë-në 1.352 lekë për banor në njësinë e re.

Rritje e buxhetit të investimeve me 28%, nga 372 milion lekë në vit, në mbi 476 milion lekë në vit.

Rritje e investimeve për frymë nga 3.069 lekë, në 3.927 lekë çdo vit në njësinë e re.

Të ardhurat e veta për frymë rriten në 5.281 lekë pas bashkimit, ose 40% më e lartë se mesatarja dhe mbi 50% më e lartë se vlera mediane e të ardhurave të veta për frymë në këtë zonë, çka mund të sigurojë një rishpërndarje më të mirë të të ardhurave.

Zona Funktionale Himarë

Zona Himarë (bashkia Himarë, komunat Vranisht, Lukovë)

Kjo zonë funksionale ka një popullsi prej 7.818 banorësh sipas të dhënave të Census-it të vitit 2011 dhe është e përbërë nga 3 njësi ekzistuese (2 komuna dhe 1 bashki). Zona funksionale Himarë ka humbur rreth 28% të popullsisë gjatë dhjetëvjeçarit 2001-2011, sipas të dhënave nga INSTAT. Dendësia mesatare e popullsisë në zonën funksionale është 14 banorë për km², pak më e ulët se 15 banorë për km² që është mesatarja e dendësisë në njësitë ekzistuese.

Figura 18 Harta dhe infrastruktura rrugore e zonës funksionale Himarë



Vështrim i gjendjes ekonomike, financiare dhe administrative

Zhvillimi ekonomik dhe të dhënat ekonomike financiare

Zona funksionale Himarë karakterizohet së pari nga potenciali për zhvillimin e turizmit, pasi kjo zonë përfshin disa nga fshatrat më të bukur bregdetarë në Shqipëri. Për këtë arsye, Himara shërben si destinacion punësimi sezonal dhe është qendër ndërveprimi ekonomik dhe social, jo vetëm për banorët e zonës, por edhe në nivel kombëtar.

Zona funksionale Himarë ka 392 biznese gjithsej, nga të cilët 370 janë të vendosura në Himarë. Rreth 57% e të punësuarve në Himarë veprojnë në tregti dhe shërbime, ndërkohë që rreth 22% janë të punësuar në ndërtim. Vranishti ka karakter kryesisht bujqësor.

Tabela 157 Ndarja e bizneseve në NJQV pas bashkimit

Rrethi	Njësia	B/K	Nr. i bizneseve	Biznese për 1000 banorë
Vlorë	Himarë	B	370	131
Vlorë	Vranisht	K	22	11
Sarandë	Lukovë	K	137	47
Gjithsej zona Himarë mbas bashkimit			529	68

Burimi: INSTAT

Në zonën funksionale ka 68 biznese për 1000 banorë.

Të dhëna buxhetore


Të gjitha njësitë e zonës në vitin 2012 kishin një buxhet (të ardhura) prej rreth 168 milion lekësh. Nga këto, rreth 70% e të ardhurave totale dhe mbi 90% e të ardhurave të veta realizohen në bashkinë Himarë.

Tabela 158 Të dhëna buxhetore për zonën funksionale Himarë

	Të ardhura totale	Të ardhura të veta	Shpenzime totale
Himarë	117.530	46.453	150.000
Vranisht	51.290	4.516	22.000
Lukovë	313.297	11.724	56.000
Gjithsej ZF	1.136.595	4.951	228.000


Po të vërejmë të ardhurat për frymë, shohim se mesatarja e të ardhurave të veta për frymë për të gjitha njësitë është 6.948 lekë. Pas bashkimit ky tregues ulet në 4.951 lekë për frymë për të gjithë zonën funksionale, pasi Vranishti është një njësi mjaft më e varfër se zonat turistike të Himarës dhe Lukovës.

Figura 2899 Të ardhurat e veta për frymë në zonën funksionale Himarë



Situata paraqitet e ngjashme për treguesit për të ardhurat gjithsej të njërive


Figura 20 Të ardhurat për frymë në zonën funksionale Himarë



Të dhëna për shpenzimet

Po të vërejmë shpenzimet për frymë, të dhënat janë të ngjashme: Himara ka tregues mjaft më të mirë se Vranishti, por bashkimi në një zonë funksionale do të siguronte rishpërndarje më të mirë të të ardhurave. Për më tepër, përfundimi i lidhjes së drejtpërdrejtë të infrastrukturës rrugore do t'i jepte hov zhvillimit edhe në Vranisht dhe do të shërbente si zonë mbështetëse për turizmin e Himarës.

Figura 21 Shpenzimet për frymë



Shpenzimet për frymë në zonën funksionale Himarë do të ishin rreth 8700 lekë; pra rreth 15% më të larta se mesatarja e shpenzimeve për frymë në njësitë ekzistuese; ose 30% më e lartë se vlera mediane e shpenzimeve për frymë.

Tabela 159 Të ardhurat dhe shpenzimet për frymë në zonën funksionale Himarë

	Të ardhura për frymë	Të ardhurat e veta për frymë	Shpenzime për frymë
Himarë	41.648	16.461	53.154
Vranisht	24.659	2.171	10.577
Lukovë	25.731	11.724	19.204
ZF gjithsej	31.191	10.892	29.163


Njësitë shpenzojnë mesatarisht 28% të buxhetit për shpenzime administrative, ndërsa vetë Vranishti ka shpenzime personeli në masën 41%. Treguesi i shpenzimeve administrative për zonën ulet në 19%, duke marrë parasysh kursimet e parashikuara të cilat do të trajtohen më poshtë, ndërkohë që investimet rriten nga 26% në 43%.

Tabela 160 Struktura e shpenzimeve në zonën funksionale Himarë

	Shpenzime totale	Shpenzime personel	Shpenzime operative të tjera	Investime 2012	Shp. personel si % e totalit	Inv si % e totalit
Himarë	150.000	38000	53000	59000	25%	39%
Vranisht	22.000	9000	9000	4000	41%	18%
Lukove	56.000	9000	28000	19000		
Mediane	228.000	56.000	90.000	82.000	28%	26%
Gjithsej ZF Himarë*	228.000	43.400	86.300	98.300	19%	43%

*Të dhënat për ZF Himarë janë nxjerrë me supozimin se do të kursehet rreth 70% e shpenzimeve administrative dhe 10% e shpenzimeve të tjera operative të njësisve që suprimohen

Figura 22 Struktura e shpenzimeve në zonën funksionale krahasuar me mesataren e njësisve ekzistuese



Treguesit e investimeve

Treguesit e investimeve vrojtohen më mirë në një periudhë të gjatë kohore. Në këtë rast janë shqyrtuar të dhënat për pesë vjet, të cilat tregojnë se niveli i investimeve në këtë zonë ka qenë i mirë. Po të supozojmë se ritmi i investimeve do të ishte ulur në masën e kursimit nga shpenzimet administrative, pesha e investimeve ndaj buxhetit total të zonës funksionale do të

rritej mesatarisht nga 37%, në 45%. Rritja e investimeve si efekt i kursimit administrativ në zonën funksionale të Himarës nuk është aq domethënëse në vetvete krahasuar me efektet pozitive që mund të sjellë menaxhimi i integruar i këtyre territoreve.

Tabela 161 Investimet si përqindje e buxhetit total në zonën funksionale dhe njësitë ekzistuese

	Investime 2008 - 2012	Të ardh. 2008 - 2012	Inv si % e ardh totale 2008 – 2012
Himarë	90.807	614.389	42%
Vranisht	60.993	208.909	61%
Lukovë	40.525	313.297	
Gjithsej (mediane vjetore)	84.730	227.319	37%
Zona funksionale	101.572	227.319	45%

Analiza e efekteve administrative

Bashkimi i njërive në një zonë funksionale do të sjellë kursime veçanërisht nga shpenzimet që përdoren për personelin dhe një pjesë të shpenzimeve operative për mirëmbajtjen e zyrave. Në veçanti, në dhjetë nga njëmbëdhjetë njësitë e zonës funksionale do të shkurtohen pozicionet e kryetarit dhe të kabinetit të tij dhe shpenzimet për shpërblimet e këshilltarëve. Gjithashtu, shkurtime të mëtejshme do të ketë edhe nga realizimi i asaj që rëndom quhet si *economy of scope*, më konkretisht shkurtimi i funksioneve të përsëritura administrative të cilat do të përqendrohen në njësinë administrative të zonës funksionale. Të tilla pozicione janë sektori i menaxhimit financiar (specialistët e financës dhe buxhetit); sektori i prokurimeve dhe sektori i auditivit financiar, por edhe sektori i urbanistikës. Nga një llogari paraprake e kursimit të mundshëm del se nga bashkimi mund të kursehen rreth 60%-70% e kostove që përdoren për personelin dhe rreth 10% e shpenzimeve që përdoren për mirëmbajtjen e zyrave. Përlllogaritjet e mëposhtme janë bazuar mbi këtë model.

Tabela 17 Reduktimi i shpenzimeve të personelit dhe të mirëmbajtjes

	Kursimi nga personeli 60%)	Kursimi nga zyrat (10%)
Himarë		
Vranisht	6.300	900
Lukovë	6.300	2.800
Gjithsej	12.600	3.700
Reduktimi si % e zërit përkatës	23%	4%
Reduktimi si % e shpenzimeve totale	5.5%	2%

Me supozimet e bëra, në zonën funksionale Himarë pas bashkimit mund të reduktohen shpenzimet administrative për rreth 16.3 milion lekë në vit, ose 7,1% e shpenzimeve totale të kryera nga të gjitha njësitë, si rezultat i rritjes së efijencës administrative.

Treguesit Socialë

Niveli arsimor dhe faktori gjeografik

Në Himarë diferencat janë thujtë të papërfillshme dhe situata është e ngjashme për njësitë e tjera nga pikëpamja e të gjithë treguesve arsimorë të përmendur më lart.

Figura 2903 Numri i fëmijëve për edukator/mësues (Himarë dhe Hore Vranisht)





Figura 24 Niveli arsimor sipas largësisë nga qendra (Himarë dhe Vranisht)



Spitalet dhe poliklinikat

Shpërndarja e mjekëve për familje (MPF) dhe mjekë specialistë (MS), për zonën funksionale Himarë, është si më poshtë:

Tabela 162 Numri i mjekëve në ZF Himarë

RAJONI	Total MPF	Total MS
Q. SH. Himarë	3	1
Q. SH. Vranisht	2	0
Lukovë		

Raporti i mjekëve për 10.000 banorë:

Tabela 163 Raporti I mjekëve për 10 mijë banorë

Komuna/Bashkia	Popullsia 2011	Nr. mjekësh	10.000 banorë
Himarë	2822	11	39.0
Hore Vranisht	2080	2	9.6
Lukovë			
Total	4902	13	26.5

Shërbimet Sociale

Nuk ka qendra shërbimesh sociale në Zonën Funksionale Himarë. Banorët duhet të udhëtojnë drejt Vlorës apo Sarandës për të përfutur nga shërbimet e ofruara nga qendrat e specializuara.

Sigurimi i shërbimeve sociale është një sfidë për të gjithë territorin e vendit e janë duke u diskutuar masat që duhen marrë në koordinim me shërbimet e tjera sociale siç janë dhe Zyrat Rajonale të Punësimit. Ndarja në zona më të vogla do të ndihmojë në rritjen e funksionalitetit brenda zonave të reja, të cilat do të funksionojnë si satelitë rreth njësisë/ve kryesore historike ku ka dhe një përqendrim shërbimesh. Masat që po ndërmerren për sigurimin e shërbimeve të ndryshme sociale, përfshijnë mbulimin e tërë territorit, duke u kushtuar vëmendje të veçantë zonave rurale, ku shërbimet nuk ekzistojnë. Shkrirja e njësisve vendore përbën mundësi për menaxhim më të mirë, jo vetëm të burimeve financiare, por edhe të atyre njerëzore në drejtim të ofrimit të shërbimeve. Duke përmirësuar sistemin e menaxhimit, do të mund të lehtësohen strukturat aktuale në zonat rurale për t'u përqendruar më shumë në drejtim të ofrimit të shërbimeve dhe vlerësimin e nevojave të komunitetit.

Ndihma ekonomike dhe aksesit në shërbime

Situata e ndihmës ekonomike në Vlorë paraqitet më e komplikuar së në zonat e tjera të qarkut. Selenica dhe Vllahina duken me përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në skemën e ndihmës ekonomike me 27.7% dhe 13.8% respektivisht. Pjesa tjetër e zonës paraqet nivele të ulëta të ndihmës ekonomike që qartëson më së miri pozicionin e mirë të Vlorës në aktivitetin ekonomik dhe të gjenerimit të të ardhurave.

Në zonat e tjera përveç Delvinës (11.2%), Ksamilit (7.3%) dhe Hore Vranishtit (8.3%) nuk kemi raportim të shpërndarjes së ndihmës ekonomike.


Për sa i përket treguesve të tjerë jo-monetarë të varfërisë është me vend të shohim gjendjen e furnizimit me ujë, rrjetin e kanalizimeve si edhe mjetet e komunikimit: internet e telefon apo edhe mobilitetin, të shprehur në numrin e automjeteve.

Në qarkun e Vlorës shohim një situatë problematike në lidhje me gjendjen e furnizimit me ujë dhe kanalizimet. Komuna si Sevasteri e Armeni kanë tregues shumë të ulët për të dyja rastet (9% dhe 18% për Sevasterin dhe 17% dhe 31% për Vllahinën) e diçka më e mirë paraqitet situata në Sarandë. Për sa i përket makinave ato luhaten nga 15 në Selenicë në 0% në qytetin e Vlorës. Në Sarandë kemi mobilitet më të madh – nga 11% në Dhivër në 38% në qytetin e Sarandës. Aksesit në telefoni dhe internet është tejet i ulët. Vlora ka treguesit më të lartë me 25% dhe 17% respektivisht që gjithsesi janë shumë të ulët, ndonëse ka një depërtim të ndjeshëm të telefonisë celulare (63%). Në Sarandë vihet re një numër shumë i ulët i telefonisë fikse (2%) me zonat e tjera që luhaten nga (8-23%). Për internetin qasja është shumë e ulët me Sarandën që bën përjashtim (gjithsesi me nivel të ulët 15%). Interesant është fakti që, qyteti i Sarandës përsëri ka nivel të ulët (6%).

Distanca e njësive të tjera nga qendra/njësia e re

Koha mesatare e udhëtimit drejt qendrës së zonës funksionale, bashkisë Vlorë, është 35 minuta. Qendra e kësaj zone, arrihet në më pak se një orë nga secila njësi, çka lehtëson mjaft ndërveprimin e qytetarëve me institucionet e qeverisjes vendore dhe aksesin në shërbime. Transporti rrugor nga Vranishti në Himarë është aktualisht pak më i vështirë, por, së shpejti do të bëhet më i shkurtër dhe lidhja funksionale mes Vranishtit dhe Himarës do të përmirësohet me përfundimin e infrastrukturës rrugore që është duke u përmirësuar.

Figura 25. Distanca e njësive nga qendra e re



Përfundime

ZF Himarë me popullsi 13.684 banorë, me, mesatarisht, 8.959 banorë për njësi.

Reduktim i shpenzimeve administrative (paga dhe të tjera operative) me rreth 16.3 milion lekë në vit, ose 21% e shpenzimeve totale të kryera nga të gjitha njësitë.

Ulje e shpenzimeve të pagave nga 18 milionë lekë, në 5.4 milion lekë në vit. Shpenzimet e personelit për frymë do të ulëshin nga 3.603 lekë-në 1.081 lekë për banor në njësinë e re.

Rritje e buxhetit të investimeve me 70%, nga 23 milion lekë në vit, në pothuaj 40 milion lekë në vit.

Rritje e investimeve për frymë nga 4.604 lekë, në 7.866 lekë çdo vit në njësinë e re

Zona Funktionale Sarandë

Zona Sarandë (bashkia Sarandë, Ksamil, Konispol, komunat Xarrë, Markat)

Kjo zonë funksionale ka një popullsi prej 28,472 banorësh sipas të dhënave të Census-it të vitit 2011 dhe është e përbërë nga 5 njësi ekzistuese (2 komuna dhe 3 bashki). Në zonën e Sarandës është shtuar popullsia gjatë dhjetë viteve të fundit, me 17%, kryesisht falë rritjes së popullsisë në zonat e Xarrës, Ksamilit dhe Sarandës. Dendësia mesatare në zonën funksionale është 555 banorë për km².

Vështrim i gjendjes ekonomike, financiare dhe administrative

Zhvillimi ekonomik dhe të dhënat ekonomike financiare


Zona funksionale Sarandës ka 2.215 biznese gjithsej, nga të cilët 73% janë të vendosur në qytetin e Sarandës. Mesatarisht 30% e të punësuarve në zonat jashtë qytetit të Sarandës veprojnë në sektorin e bujqësisë, ndërkohë që pjesa tjetër janë të shpërndarë në mënyrë të balancuar në shërbime, tregti dhe ndërtim. Punësimi në qytetin e Sarandës mbizotërohet nga shërbimet (43%), i ndjekur nga tregtia (23%).

Tabela 22 Shpërndarja e Bizneseve për NJQV

Rrethi	Njësia	B/K	Nr. i bizneseve	Biznese për 1000 banorë
Sarandë	Konispol	B	60	28
Sarandë	Ksamil	K	264	88
Sarandë	Lukovë	K	137	47
Sarandë	Markat	K	12	6
Sarandë	Sarandë	K	1,808	105
Sarandë	Xarrë	K	71	17
Gjithsej zona Sarandë para bashkimit			2,473	49
Gjithsej zona Sarandë mbas bashkimit			2,473	78

Burimi: INSTAT

Figura 291 Numri i bizneseve për 1000 banore



Siç shihet nga të dhënat, shumica e njësive në zonën funksionale në shqyrtim kanë numër të ulët biznesesh për 1000 banorë. Bizneset për 1000 banorë në njësitë e veçanta variojnë nga 6

(Markat), në 105 në bashkinë Sarandë. Mesatarisht para bashkimit në këto 9 njësi ka 49 biznese për 1000 banorë. Ndërkohë, në zonën funksionale ky tregues rritet në 78 biznese për 1000 banorë për të gjithë zonën funksionale.

Të dhëna buxhetore


Të gjitha njësitë e zonës në vitin 2012 kishin një buxhet (të ardhura) prej rreth 884 milion lekësh. Nga këto, rreth 48% ose 424 milion janë realizuar në bashkinë e Sarandës, e cila realizon edhe 73% të të ardhurave të veta të të gjithë zonës. (Tabela 164).

Tabela 164 Të dhëna buxhetore për zonën funksionale Sarandë

	Të ardhura totale	Të ardhura te veta	Shpenzime totale
Konispol	44.691	14.682	30.000
Ksamil	63.917	24.003	56.000
Markat	44.945	731	15.000
Sarandë	424.460	322.042	396.000
Xarrë	39.720	14.706	26.000
Gjithsej ZF Sarandë	617.733	376.164	523.000


Po të vërejmë të ardhurat për frymë, shohim se mesatarja e të ardhurave të veta për frymë për të gjitha njësitë është 7.493 lekë. Pas bashkimit ky tregues rritet në 13.212 lekë për frymë për të gjithë zonën funksionale, ose 76% më të larta se mesatarja e të ardhurave për frymë dhe 91% më të larta se median i të ardhurave për frymë në këto njësi. Ky tregues është inkurajues për një rishpërndarje më të barabartë dhe më efiçente të të ardhurave.

Figura 292 Të ardhurat e veta për frymë në zonën funksionale Sarandë



Ndërkohë situata paraqitet disi më e ndryshme për treguesit mbi të ardhurat gjithsej të njërive: Mesatarja e të ardhurave për frymë në zonën funksionale pëson disi rënie në krahasim me medianen e njërive individuale. Kjo shpjegohet me faktin se njësitë më të vogla subvencionohen në masë shumë të madhe nga buxheti i shtetit, duke rezultuar në të ardhura të larta për frymë. (Figura 292 dhe Figura).


Figura 28 Të ardhurat për frymë në zonën funksionale Sarandë



Të dhëna mbi shpenzimet

Po të vërejmë shpenzimet për frymë, të dhënat janë të ngjashme:

Figura 29 Shpenzimet për frymë në ZF Sarandë



Shpenzimet për frymë në zonën funksionale Sarandë do të ishin rreth 21.537 lekë, ose një vlerë e përafërt me mesataren e shpenzimeve për frymë në zonën ekzistuese, çka sërish dëshmon për shpërndarje më të barabartë të fondeve për popullsinë e zonës.

Tabela 165 Të ardhurat dhe shpenzimet për frymë në zonën funksionale Sarandë

	Të ardhura për frymë	Të ardhurat e veta për frymë	Shpenzime për frymë
Konispol	21.051	6.916	14.131
Ksamil	21.348	8.017	18.704
Markat	24.177	393	8.069
Sarandë	24.631	18.688	22.979
Xarrë	9.317	3.450	6.099
ZF gjithsej	21.696	13.212	21.537


Njësitë shpenzojnë mesatarisht 30% të buxhetit për shpenzime administrative, minimumi përfaqësohet nga komuna Lukovë (16%) dhe maksimumi nga bashkia Konispol me 50%. Treguesi i shpenzimeve administrative për zonën ulet në 23%, duke marrë parasysh kursimet e parashikuara të cilat do të trajtohen më poshtë; ndërkohë që, nëse këto fonde të çliruara rakordohen për investime, këto të fundit do të rriteshin nga 22% në 31%.

Tabela 166 Struktura e shpenzimeve në zonën funksionale Sarandë

	Shpenzime totale	Shpenzime personel	Shpenzime operative te tjera	Investime 2012	Shp. personel si % e totalit	Inv si % e totalit 2012
Konispol	56.000	19.000	24.000	13000	50%	27%
Ksamil	396.000	121.000	197.000	78000	34%	43%
Markat	30.000	15.000	8.000	7000	40%	60%
Sarandë	15.000	6.000	9.000	0	31%	50%
Xarrë	26.000	9.000	17.000	0	35%	65%
Mediane	523.000	170.000	255.000	98.000	33%	19%
Gjithsej ZF Sarandë*		135.700	249.200	138.100	26%	26%

*Të dhënat për ZF Sarandë janë nxjerrë me supozimin se do të kursehet rreth 70% e shpenzimeve administrative dhe 10% e shpenzimeve të tjera operative të njësive që suprimohen

Figura 30 Struktura e shpenzimeve në zonën funksionale krahasuar me medianen e njësive ekzistuese



Treguesit e investimeve

Treguesit e investimeve vrojtohen më mirë në një periudhë të gjatë kohore. Në këtë rast janë shqyrtuar të dhënat për pesë vjet, të cilat tregojnë se niveli i investimeve në këtë zonë ka qenë shumë i ulët, mesatarisht 24% e të ardhurave totale të këtyre viteve. Po të supozojmë se ritmi i investimeve do të ishte ulur në masën e kursimit nga shpenzimet administrative, pesha e investimeve ndaj buxhetit total të zonës funksionale do të rritej nga 24%, në 35% mesatarisht, çka është një tregues më afër niveleve kombëtare.

Tabela 167 Investimet si përqindje e buxhetit total në zonën funksionale dhe njësitë ekzistuese

	Investime 2008 - 2012	Të ardh 2008 - 2012	Inv si % e ardh totale 2008 - 2012
Konispol	56,987	184,918	31%
Ksamil	156,612	368,381	43%
Markat	93,017	173,839	54%
Sarandë	539,243	2,296,558	23%
Xarrë	32,771	236,149	14%
Gjithsej	878,630	3,259,844	27%
Zona funksionale Sarandë	1,238,151	3,259,844	38%

Analiza e efekteve administrative

Bashkimi i njërive në një zonë funksionale do të sjellë kursime veçanërisht nga shpenzimet që përdoren për personelin dhe një pjesë të shpenzimeve operative për mirëmbajtjen e zyrave. Në veçanti, në dhjetë nga njëmbëdhjetë njësitë e zonës funksionale do të shkurtohen pozicionet e kryetarit dhe të kabinetit të tij dhe shpenzimet për shpërblymjet e këshilltarëve. Gjithashtu, shkurtime të mëtejshme do të ketë edhe nga realizimi i asaj që rëndom quhet si *economy of scope*, më konkretisht shkurtime të funksioneve të përsëritura administrative të cilat do të përqendrohen në njësinë administrative të zonës funksionale. Të tilla pozicione janë sektori i menaxhimit financiar (specialistët e financës dhe buxhetit); sektori i prokurimeve dhe sektori i auditivit financiar, por edhe sektori i urbanistikës. Nga një llogari paraprake e kursimit të mundshëm del se nga bashkimi mund të kursehen rreth 60%-70% e kostove që përdoren për personelin dhe rreth 10% e shpenzimeve që përdoren për mirëmbajtjen e zyrave. Përlllogaritjet e mëposhtme janë bazuar mbi këtë model.

Tabela 168 Reduktimi i shpenzimeve të personelit dhe të mirëmbajtjes

	Kursimi nga personeli (60%)	Kursimi nga zyrat (10%)
Konispol	13,300	2,400
Ksamil		
Markat	10,500	800
Sarandë	4,200	900
Xarrë	6,300	1,700
Gjithsej	34,300	5,800
Reduktimi si % e zërit përkatës	20%	2%
Reduktimi si % e shpenzimeve totale	6.6%	1%

Me supozimet e bëra, në zonën funksionale Sarandë pas bashkimit kursehen rreth 40 milion lekë, ose 7,6% e shpenzimeve totale të kryera nga të gjitha njësitë. Këto fonde të çliruara janë rreth 40% e buxhetit që alokohet për investime në këtë zonë, çka do të thotë se me *këto kursime në teori mund të rriteshin me 40% investimet për zonën.*

Treguesit Socialë

Niveli arsimor dhe faktori gjeografik

Në zonën e Sarandës, situata paraqitet me shpërndarje të njëtrajtshme të fëmijëve dhe nxënësve për edukatorë dhe mësues. Për arsimin parashkollor, Ksamili rezulton me numrin më të madh (29) ndërsa të tjerët luhaten nga 13-22 fëmijë për edukator me një prevalencë të dukshme të shifrës mbi 20. Ndërsa nga pikëpamja e nivelit arsimor, tendenca e njohur dalluese urbane-rurale duket qartë dhe këtu. Distanca nga qendra, luan një rol deri në komunën Markat ku tendenca e qartë e rritjes së personave me arsim bazë është e ndjeshme. Për Konispolin dhe Xarrën kjo tendencë shkon në krahun e kundërt, pasi vihet re një numër në rritje i të arsimuarve me shkollë të mesme dhe me universitet.

Figura 31 Numri i fëmijëve për edukator/mësues





Figura 32293 Niveli arsimor sipas largësisë nga qendra



Spitalet dhe poliklinikat

Në Sarandë ka 1 spital, ndërsa shpërndarja e mjekëve për familje (MPF) dhe mjekë specialistë (MS) sipas vendndodhjes së qendrave shëndetësore, është si më poshtë:

Tabela 169 Shpërndarja e mjekëve në rrethin Sarandë

	Total MPF	Total MS
Bashkia Sarandë		
Q. SH. Sarandë	10	0
Bashkia Konispol	0	0
Q. SH. Konispol	1	0
Komunat Sarandë		
Q. SH. Ksamil	2	0
Q. SH. Xarrë	1	0
Q. SH. Markat	1	0
Q. SH. Dhivër	2	0
Q. SH. Aliko	2	0
Q. SH. Lukovë	2	0

Tabela 170 Raporti i mjekëve për 10 mijë banorë në rrethin Sarandë

Komuna/Bashkia	popullsia 2011	Nr. mjekësh	10.000 banorë
Aliko	3849	2	5,2
Dhivër	1396	2	14,3
Konispol	2123	1	4,7
Ksamil	2994	2	6,7
Lukovë	2916	2	6,9
Markat	1859	1	5,4
Sarandë	17233	38	22,1
Xarrë	4263	1	2,3
Total	36633	49	13,4

Shërbimet Sociale

Për sa i përket shpërndarjes së shërbimeve sociale, ka një përqendrim të shërbimeve në Vlorë, dhe vetëm dy qendra në Sarandë. Ndërkohë që zonat rurale mbeten të pambuluara me shërbime e banorët duhet të udhëtojnë drejt qendrës urbane më të afërt për të marrë shërbimin.

Gjithashtu, vihet re që peshën kryesore të shërbimeve sociale e mbajnë ofruesit jo publikë, NGO-të (OJQ-të), ndërsa kategoritë e shërbimeve janë të limituara dhe të ndikuara jo detyrimisht nga nevojat e komunitetit të cilit i shërbehet, por nga agjendat e donatorëve që janë dhe mbështetësit kryesor të tyre.

Argumenti kryesor është që komunat nuk kanë as kapacitetet financiare e as ato njerëzore për të ofruar shërbime sociale. Riorganizimi territorial pritet të ndikojë ndjeshëm në ofrimin e drejtë të shërbimeve, duke i dhënë një prioritet mbulimit të zonave rurale.

Ndihma ekonomike dhe shërbimet e tjera

Situata e ndihmës ekonomike në Vlorë paraqitet më e komplikuar së në zonat e tjera të qarkut. Selenica dhe Vllahina duken me përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në skemën e ndihmës ekonomike me 27.7% dhe 13.8% respektivisht. Pjesa tjetër e zonës paraqet nivele të ulëta të ndihmës ekonomike që qartëson më së miri pozicionin e mirë të Vlorës në aktivitetin ekonomik dhe të gjenerimit të të ardhurave.

Në zonat e tjera përveç Delvinës (11.2%), Ksamilit (7.3%) dhe Hore Vranishtit (8.3%) nuk kemi raportim të shpërndarjes së ndihmës ekonomike.

Për sa i përket treguesve të tjerë jo-monetarë të varfërisë është me vend të shohim gjendjen e furnizimit me ujë, rrjetin e kanalizimeve si edhe mjetet e komunikimit: internet e telefon apo edhe mobilitetin, të shprehur në numrin e automjeteve.

Në qarkun e Vlorës shohim një situatë problematike në lidhje me gjendjen e furnizimit me ujë dhe kanalizimet. Komuna si Sevasteri e Armeni kanë tregues shumë të ulët për të dyja rastet (9% dhe 18% për Sevasterin dhe 17% dhe 31% për Vllahinën) e diçka më e mirë paraqitet situata në Sarandë. Për sa i përket makinave ato luhaten nga 15 në Selenicë në 0% në qytetin e Vlorës. Në Sarandë kemi mobilitet më të madh – nga 11% në Dhivër në 38% në qytetin e Sarandës. Aksesit në telefoni dhe internet është tejet i ulët. Vlora ka treguesit më të lartë me 25% dhe 17% respektivisht që gjithsesi janë shumë të ulët, ndonëse ka një depërtim të ndjeshëm të telefonisë celulare (63%). Në Sarandë vihet re një numër shumë i ulët i telefonisë fikse (2%) me zonat e tjera që luhaten nga (8-23%). Për internetin qasja është shumë e ulët me Sarandën që bën përjashtim (gjithsesi me nivel të ulët 15%). Interesant është fakti që, qyteti i Sarandës përsëri ka nivel të ulët (6%).

Distanca e njësive të tjera nga qendra/njësia e re

Koha mesatare e udhëtimit drejt qendrës së zonës funksionale, bashkisë Sarandë, është 30 minuta. Qendra e kësaj zone, arrihet në më pak se një orë nga secila njësi, çka lehtëson mjaft ndërveprimin e qytetarëve me institucionet e qeverisjes vendore dhe të drejtën e përfitimit nga shërbimet.

Tabela 171 Distanca e njësive të përthithura me qendrën e re

		Distanca (në km)	Koha e udhëtimit (në min)
Aliko	K	9.1	13
Dhivër	K	23.7	29
Konispol	B	43.5	54
Ksamil	K	14	15
Lukovë	K	21	22
Markat	K	38.6	54
Sarandë	B	0	0
Xarrë	K	44	48

Figura 2943 Infrastruktura rrugore në ZF Sarandë



Përfundime

Përfundimet për zonën e rrethit Sarandë janë llogaritur në variantin me 3 njësi funksionale më vete, përkatësisht ZF Sarandë, ZF Konispol dhe ZF Livadhja.

1. ZF Sarandë (Bashkia Sarandë dhe komuna Ksamil)

ZF Sarandë e përbërë nga 2 njësi ekzistuese, ka popullsi prej 20,227 banorë, nga mesatarisht 10,114 banorë aktualisht në NJQV ekzistuese;

Reduktim i shpenzimeve administrative të njësisë me rreth 15,7 milionë lekë në vit (shpenzime paga dhe operative)

Ulja e shpenzimeve të personelit për banor në masën 10%, nga 6,921 lekë në 6,264 lekë për banor

Mirëadministrimi i burimeve financiare mund të sjellë rritje të investimeve në masën 17%, ose nga 91 milionë lekë, në 106,7 milionë lekë në vit

Investimet për banor mund të rriten nga 4,499 lekë, në 5,275 lekë për banor në njësinë e re

Bashkimi në një zonë funksionale mund të sigurojë rishpërndarje më të mirë të të ardhurave duke zbutur pabarazitë mes zonave; pa llogaritur efektet e eficiencës së rritur në menaxhimin e të ardhurave. Mesatarisht ZF e re do të realizonte 17,108 lekë të ardhura të veta për frymë, ndërkohë që niveli i të ardhurave të veta për frymë në Ksamil është 8,017 lekë; si dhe mund të menaxhohen shërbimet në mënyrë të integruar për të rritur funksionalitetin e zonës turistike

2. ZF Konispol (Bashkia Konispol dhe komunat Xarrë dhe Markat)

ZF Konispol e përbërë nga 3 njësi ekzistuese, ka popullsi prej 8,245 banorë, nga mesatarisht 2,748 banorë aktualisht në NJQV ekzistuese;

Reduktim i shpenzimeve administrative të njësisë me rreth 13,1 milionë lekë në vit, ose 20% e shpenzimeve administrative (shpenzime paga dhe operative) dhe 15% e shpenzimeve vjetore gjithsej;

Ulja e shpenzimeve të personelit për banor në masën 35%, nga 3,639 lekë në 2,365 lekë për banor;

Mirëadministrimi i burimeve financiare mund të sjellë pothuajse trefishim të investimeve; ose nga 7 milionë lekë të realizuara në 2012 (vetëm në bashkinë Konispol janë bërë investime), në 20,1 milionë lekë në vit;

Investimet për banor mund të rriten nga 849 lekë, në 2,438 lekë për banor në njësinë e re;

Bashkimi në një zonë funksionale mund të sigurojë rishpërndarje më të mirë të të ardhurave duke zbutur pabarazitë mes zonave; pa llogaritur efektet e eficiencës së rritur në menaxhimin e të ardhurave. Mesatarisht ZF e re do të realizonte 3,653 lekë të ardhura të veta për frymë, ndërkohë që ka shpërpjesëtim shumë të madh mes nivelit të të ardhurave të veta për frymë në të tre njësitë ekzistuese.

Zona Funktionale Delvinë

Zona Delvinë (bashkia Delvinë, komuna Vergo)

Kjo zonë funksionale ka një popullsi prej 7.598 banorësh sipas të dhënave të Census-it të vitit 2011 dhe është e përbërë nga 2 njësi ekzistuese (1 komunë dhe 1 bashki). Kjo zonë ka ulje të popullsisë prej pothuaj 13%. Dendësia mesatare në zonën funksionale është 41 banorë për km², në krahasim me 107 dhe 14 banorë për km² që është dendësia e popullsisë, përkatësisht në njësitë ekzistuese të Delvinës dhe Vergos.

Vështrim i gjendjes ekonomike, financiare dhe administrative

Zhvillimi ekonomik dhe të dhënat ekonomike financiare


Zona funksionale Delvinë ka 404 biznese gjithsej, nga të cilët më tepër se gjysma janë të vendosur në qytetin e Delvinës. Punësimi në qytetin e Delvinës rezulton si më poshtë: të parat renditen shërbimet (39%), i ndjekur nga ndërtimi (19%) dhe tregtia (18%). Rreth 30% e banorëve të njërive të tjera janë të punësuar në bujqësi, ndërsa pjesa tjetër në shërbime e sektorë të tjerë.

Tabela 172 Shpërndarja e Bizneseve për NJQV

Rrethi	Njësia	B/K	Nr. i bizneseve	Biznese për 1000 banorë
Delvinë	Delvinë	K	229	40
Delvinë	Vergo	K	22	12
Gjithsej zona Delvinë mbas bashkimit			251	33

Burimi: INSTAT

Figura 2954 Numri i bizneseve për 1000 banorë



Siç shihet nga të dhënat, të dyja njësitë në zonën funksionale në shqyrtim kane numër të ulët biznesesh për 1000 banorë. Bizneset për 1000 banorë luhaten nga 12 (Vergo), në 40 në Delvinë. Në zonën funksionale janë 33 biznese për 1000 banorë për të gjithë zonën funksionale.

Të dhëna buxhetore


Të gjitha njësitë e zonës në vitin 2012 kishin një buxhet (të ardhura) prej rreth 175 milion lekësh. Nga këto, rreth 43% ose 75 milion janë realizuar në bashkinë e Delvinës, e cila realizon edhe 50% të të ardhurave të veta të zonës funksionale.

Tabela 173 Të dhëna buxhetore për zonën funksionale Delvinë

	Të ardhura totale	Të ardhura të veta	Shpenzime totale
Delvinë	74,778	23,206	63,000
Vergo	29,765	4,013	12,000
Gjithsej ZF	104,543	27,219	75,000


Po të vërejmë të ardhurat për frymë, shohim se mesatarja e të ardhurave të veta për frymë për të gjitha njësitë është 3.105 lekë. Pas bashkimit ky tregues rritet në 3.582 lekë për frymë për të gjithë zonën funksionale, pasi zona është e përbërë nga dy njësi me shpërpjestim të madh të ardhurash mes tyre.

Figura 2965 Të ardhurat e veta për frymë në zonën funksionale Delvinë



Situata paraqitet e ndryshme për treguesit mbi të ardhurat gjithsej të njërive: Mesatarja e të ardhurave për frymë në zonën funksionale pëson disi rënie në krahasim me mesataren e njësisë më të vogël – Vergos. Kujtojmë se të ardhurat e veta për frymë në Vergo janë pothuajse sa gjysma e këtij treguesi për Delvinën qytet (Figura 296), ndërkohë që të ardhurat e përgjithshme për frymë janë më të larta në Vergo. Kjo tregon se Vergo ka përfituar shumë më tepër nga transfertat e buxhetit të shtetit se Delvina.


Figura 2976 Të ardhurat për frymë në zonën funksionale Delvinë



Të dhëna mbi shpenzimet

Po të vërejmë shpenzimet për frymë, të dhënat janë të ngjashme:

Figura 37 Shpenzimet për frymë në ZF Delvinë



Shpenzimet për frymë në zonën funksionale Delvinë do të ishin rreth 9.871 lekë; pra rreth 13% më e lartë se mesatarja e shpenzimeve për frymë në njësitë ekzistuese.

Tabela 174 Të ardhurat dhe shpenzimet për frymë në zonën funksionale Delvinë

	Të ardhura për frymë	Të ardhurat e veta për fryme	Shpenzime për frymë
Delvinë	12,996	4,033	10,949
Vergo	16,142	2,176	6,508
ZF gjithsej	13,759	3,582	9,871

Njësitë shpenzojnë mesatarisht 35% të buxhetit për shpenzime administrative, ky tregues është më i lartë në komunën Vergo me 50%. Treguesi i shpenzimeve administrative për zonën ulët në 29%, duke marrë parasysh kursimet e parashikuara të cilat do të trajtohen më poshtë. Pesha e investimeve është mjaft e ulët në këto dy njësi: në vitin 2012 vetëm bashkia Delvinë ka bërë disa investime modeste. (Tabela 175).

Tabela 175 Struktura e shpenzimeve në zonën funksionale Delvinë

	Shpenzime totale	Shpenzime personel	Shpenzime operative te tjera	Investime 2012	Shp. personel si % e totalit	Inv si % e totalit 2012	Operative të tjera si % e totalit
Delvinë	63,000	20000	38000	5000	32%	60%	8%
Vergo	12,000	6000	6000	0	50%	50%	0%
Mesatare	75,000	26,000	44,000	5,000	35%	7%	59%
Gjithsej ZF Delvinë*	75,000	21,800	43,400	9,800	29%	13%	58%

*Të dhënat për ZF Delvinë janë nxjerrë me supozimin se do të kursehet rreth 70% e shpenzimeve administrative dhe 10% e shpenzimeve të tjera operative të njësisë që suprimohet

Treguesit e investimeve

Treguesit e investimeve vrojtohen më mirë në një periudhë të gjatë kohore. Në këtë rast janë shqyrtuar të dhënat për pesë vjet, të cilat tregojnë se niveli I investimeve në këtë zonë ka qenë relativisht i lartë në krahasim me mesataren kombëtare. Po të supozojmë se ritmi i investimeve do të ishte ulur në masën e kursimit nga shpenzimet administrative, pesha e investimeve ndaj buxhetit total të zonës funksionale do të rritej në 74%, nga 48% mesatarisht.

Tabela 176 Investimet si përqindje e buxhetit total në zonën funksionale dhe njësitë ekzistuese

	Investime 2008 - 2012	Të ardh 2008 - 2012	Inv si % e ardh totale 2008 - 2012
Delvinë	223,984	606,897	37%
Vergo	57,779	134,948	43%
Mesatare	503,389	1,156,122	48%
Zona funksionale	687,965	1,156,122	74%

Analiza e efekteve administrative

Bashkimi i njësisve në një zonë funksionale do të sjellë kursime veçanërisht nga shpenzimet që përdoren për personelin dhe një pjesë të shpenzimeve operative për mirëmbajtjen e zyrave. Në veçanti, në dhjetë nga njëmbëdhjetë njësitë e zonës funksionale do të shkurtohen pozicionet e kryetarit dhe të kabinetit të tij dhe shpenzimet për shpërblyerjet e këshilltarëve. Gjithashtu, shkurtime të mëtejshme do të ketë edhe nga realizimi i asaj që rëndom quhet si *economy of scope*, më konkretisht shkurtimi i funksioneve të përsëritura administrative të cilat do të përqendrohen në njësinë administrative të zonës funksionale. Të tilla pozicione janë sektori i menaxhimit financiar (specialistët e financës dhe buxhetit); sektori i prokurimeve dhe sektori i auditivit financiar, por edhe sektori i urbanistikës. Nga një llogari paraprake e kursimit të mundshëm del se nga bashkimi mund të kursehen rreth 60%-70% e kostove që përdoren për personelin dhe rreth 10% e shpenzimeve që përdoren për mirëmbajtjen e zyrave. Përlllogaritjet e mëposhtme janë bazuar mbi këtë model.

Tabela 177 Reduktimi i shpenzimeve të personelit dhe të mirëmbajtjes

	Kursimi nga personeli 60%)	Kursimi nga zyrat (10%)
Delvinë		
Vergo	4,200	600
Gjithsej	4,200	600
Reduktimi si % e zërit përkatës	16%	4%
Reduktimi si % e shpenzimeve totale	6%	1%

Me supozimet e bëra, në zonën funksionale Delvinë pas bashkimit kursehen rreth 5 milion lekë që janë afërsisht sa buxheti i akorduar për investime në bashkinë Delvinë gjatë vitit 2012. Kursimet në zonën funksionale Delvinë nuk janë aq domethënëse, pasi komuna Vergo që shkrihet me bashkinë Delvinë ka buxhet mjaft të vogël për të ndikuar në treguesit e përgjithshëm financiarë të zonës së re funksionale. Megjithatë, rritja e territorit pritet të sjellë përmirësime në menaxhimin e zonës funksionale duke rritur efikasitetin në shërbime, për shkak të ekonomive të shkallës, kapaciteteve më të mira njerëzore për zonën në përgjithësi, por edhe rishpërndarje më të mirë të burimeve financiare për frymë. Këto efekte pozitive do të ishin edhe më të dukshme në një territor relativisht më të madh.

Treguesit Socialë

Niveli arsimor dhe faktori gjeografik

Në zonën e Delvinës duke parë treguesit arsimorë, vihet re një diferencë midis qytetit dhe komunave përreth, sidomos për sa i përket numrit të fëmijëve për mësues në shkollat 9 vjeçare. Ndërkohë që në qytet numri i fëmijëve është 17 në atë të Vergos është 38, gjë që tregon presionin e madh për sistemin arsimor për një shpërndarje dhe menaxhim më të mirë. Për sa i përket sistemit parashkollor në qytet e komunat raportohen përreth 7-16 fëmijë për edukatorë. Nga pikëpamja e nivelit arsimor që lidhet dhe me ofertën në tregun e punës, kemi mbizotërim të arsimit bazë dhe arsimit të mesëm e fare pak të diplomuarve nga arsimit lartë.

Figura 37 Numri i fëmijëve për edukator/mësues





Figura 38 Niveli arsimor sipas largësisë nga qendra



Spitalet dhe poliklinikat

Delvina ka një spital, i cili u shërben dhe komunave përreth, ndërkohë që shpërndarja e mjekëve për familje (MPF) dhe mjekë specialist (MS) sipas qendrave shëndetësore, është si më poshtë:

Tabela 178 Shpërndarja e mjekëve në rrethin Delvinë

	Total MPF	Total MS
Bashkia Delvine	0	0
Q. SH. Delvinë	2	0
Komunat Delvine	0	0
Q. SH. Vergo	1	0

Tabela 179 Raporti I mjekëve për 10 mijë banorë

Komuna/Bashkia	B/K	popullsia 2011	Nr. mjekësh	10.000 banorë
Delvinë	B	5754	4	7
Vergo	K	1844	1	5
Total		7598	5	6,6

Shërbimet Sociale

Për sa i përket shërbimeve sociale, në zonën funksionale Delvinë, nuk ndodhet asnjë qendër shërbimesh sociale. Qytetet më të afërta nga të cilat mund të përfitohen shërbime sociale, janë Saranda dhe Gjirokastra, por që dhe këto njësi, sigurisht që nuk ofrojnë tërë kategoritë bazë të shërbimeve.

Sigurimi i shërbimeve sociale është një sfidë për të gjithë territorin e vendit e janë duke u diskutuar masat që duhen marrë në koordinim me shërbimet e tjera sociale siç janë dhe Zyrat Rajonale të Punësimit. Ndarja në zona më të vogla do të ndihmojë në rritjen e funksionalitetit brenda zonave të reja, të cilat do të funksionojnë si satelitë rreth njësisë/ve kryesore historike ku ka dhe një përqendrim shërbimesh. Masat që po ndërmerren për sigurimin e shërbimeve të ndryshme sociale, përfshijnë mbulimin e tërë territorit, duke u kushtuar vëmendje të veçantë zonave rurale, ku shërbimet nuk ekzistojnë. Shkrija e njësisë vendore përbën mundësi për menaxhim më të mirë, jo vetëm të burimeve financiare, por edhe të atyre njerëzore në drejtim të ofrimit të shërbimeve. Duke përmirësuar sistemin e menaxhimit, do të mund të lehtësohen strukturat aktuale në zonat rurale për t'u përqendruar më shumë në drejtim të ofrimit të shërbimeve dhe vlerësimin e nevojave të komunitetit.

Argumenti kryesor është që komunat nuk kanë as kapacitetet financiare e as ato njerëzore për të ofruar shërbime sociale. Riorganizimi territorial pritet të ndikojë ndjeshëm në ofrimin e drejtë të shërbimeve, duke i dhënë një prioritet mbulimit të zonave rurale.

Ndihma ekonomike dhe aksesin në shërbime

Situata e ndihmës ekonomike në Vlorë paraqitet më e komplikuar së në zonat e tjera të qarkut. Selenica dhe Vllahina duken me përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në skemën e ndihmës ekonomike me 27.7% dhe 13.8% respektivisht. Pjesa tjetër e zonës paraqet nivele të ulëta të ndihmës ekonomike që qartëson më së miri pozicionin e mirë të Vlorës në aktivitetin ekonomik dhe të gjenerimit të të ardhurave.

Në zonat e tjera përveç Delvinës (11.2%), Ksamilit (7.3%) dhe Hore Vranishtit (8.3%) nuk kemi raportim të shpërndarjes së ndihmës ekonomike.

Për sa i përket treguesve të tjerë jo-monetarë të varfërisë është me vend të shohim gjendjen e furnizimit me ujë, rrjetin e kanalizimeve si edhe mjetet e komunikimit: internet e telefon apo edhe mobilitetin, të shprehur në numrin e automjeteve.

Në qarkun e Vlorës shohim një situatë problematike në lidhje me gjendjen e furnizimit me ujë dhe kanalizimet. Komuna si Sevasteri e Armeni kanë tregues shumë të ulët për të dyja rastet (9% dhe 18% për Sevasterin dhe 17% dhe 31% për Vllahinën) e diçka më e mirë paraqitet situata në Sarandë. Për sa i përket makinave ato luhaten nga 15 në Selenicë në 0% në qytetin e Vlorës. Në Sarandë kemi mobilitet më të madh – nga 11% në Dhivër në 38% në qytetin e Sarandës. Aksesin në telefoni dhe internet është tejet i ulët. Vlora ka treguesit më të lartë me 25% dhe 17% respektivisht që gjithsesi janë shumë të ulët, ndonëse ka një depërtim të ndjeshëm të telefonisë celulare (63%). Në Sarandë vihet re një numër shumë i ulët i telefonisë fikse (2%) me zonat e tjera që luhaten nga (8-23%). Për internetin qasja është shumë e ulët me Sarandën që bën përjashtim (gjithsesi me nivel të ulët 15%). Interesant është fakti që, qyteti i Sarandës përsëri ka nivel të ulët (6%).


Distanca e njësive të tjera nga qendra/njësia e re

Koha e udhëtimit drejt qendrës së zonës funksionale, bashkisë Delvinë, është 33 minuta, nga Komuna Vergo, pra qendra arrihet në më pak se një orë, çka lehtëson ndërveprimin e qytetarëve me institucionet e qeverisjes vendore dhe aksesin në shërbime. Infrastruktura rrugore nuk është e zhvilluar shumë mirë në komunën Vergo.

Tabela 180 Distancat nga qendra e re

		Distanca (në km)	Koha e udhëtimit (min)
Delvinë	B	0	0
Vergo	K	16.2	33

Figura 298 Infrastruktura rrigore në ZF Delvinë



Përfundime

ZF Delvinë me popullsi 7.598 banorë, me mesatarisht 3.799 banorë për njësi.

Reduktim i shpenzimeve administrative (paga dhe të tjera operative) me rreth 4.8 milion lekë në vit.

Ulje e shpenzimeve të pagave nga 26 milion lekë, në 21.8 milion lekë në vit.

Rritje e buxhetit të investimeve pothuajse dyfish; nga 5 milion në vit, në rreth 9,8 milion lekë në vit.

Rritje e investimeve për frymë nga 658 lekë, në 1.290 lekë çdo vit në njësinë e re.

Zona Funktionale Livadhjá

ZF Livadhjá me popullsi 39.053 banorë, nga mesatarisht 7.811 banorë për njësi. Popullsia është rritur gjatë dhjetëvjeçarit 2001-2011, kryesisht në komunat Finiq dhe Mesopotam.

Reduktim i shpenzimeve administrative (paga dhe të tjera operative) me rreth 25 milion lekë në vit, ose 15% e shpenzimeve totale të të gjitha njësive.

Ulje e shpenzimeve të pagave nga 38 milionë, në 17.7 milion lekë në vit. Shpenzimet e personelit për frymë do të ulëshin nga 3.609 lekë në 1.681 lekë për banor në njësinë e re.

Rritje e buxhetit të investimeve me 40%, nga 68.7 milion në vit, në rreth 93.6 milion lekë në vit.

Rritje e investimeve për frymë nga 6.525 lekë, në 8.890 lekë çdo vit në njësinë e re.

Zona funksionale Livadhjá identifikohet si zonë më vete për shkak të mbizotërimit së popullsisë me origjinë greke në këtë zonë, megjithatë evidentohen disa efekte pozitive nga bashkimi. Të njëjtat efekte pozitive do të evidentoheshin në rastin e bashkimit të komunave të rrethit të Delvinës me zonën funksionale Delvinë.

